



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 27

Tiranë – E premte, 18 shkurt 2022

PËRMBAJTJA

Vendim i Këshillit të Ministrave
nr. 91, datë 9.2.2022

Për miratimin e Planit Kombëtar Për Integrimin Evropian 2022–
2024

Faqe

3089

**VENDIM****Nr. 91, datë 9.2.2022****PËR MIRATIMIN E PLANIT
KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN
EVROPIAN 2022–2024**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024 (PKIE 2022–2024), sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të bashkërendojë dhe të monitorojë zbatimin e PKIE-së 2022–2024 me institucionet përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian (GNPIE), për çdo kapitull.

3. Institucionet përgjegjëse për kryesimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian raportojnë çdo javë pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2022–2024.

4. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ngarkohet të raportojë, çdo 3 (tre) muaj, në Këshillin e Ministrave dhe te Kryenegociatori për negociatat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian për ecurinë e zbatimit të PKIE-së 2022–2024.

5. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të monitorojë përfshirjen, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme të parashikuara në PKIE 2022–2024.

6. Legjislacioni i BE-së, për masat afatmesme të planifikuara në PKIE 2022–2024, t'i nënshtrohet procedurës së përkthimit dhe miratimit të materialeve të përkthyer, sipas parashikimeve të akteve nënligjore përkatëse.

7. Vendimi nr.90, datë 17.2.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2021–2023”, shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Këshillit të Ministrave, në përbërje të grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, për të cilat në PKIE-në 2022–2024 janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**PLANI KOMBËTAR PËR
INTEGRIMIN EVROPIAN
2022 – 2024****PASQYRA E LËNDËS****PJESA 1: HYRJE****1.1 ANËTARËSIMI NË BASHKIMIN
EVROPIAN****1.2 MENAXHIMI I PROCESIT TË
NEGOCIATAVE TË ANËTARËSIMIT****1.3 PLANI KOMBËTAR PËR
INTEGRIMIN EVROPIAN 2022 – 2024****PJESA 2: KRITERI POLITIK****2.1 DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË
DREJTËS****2.1.1 Kuvendi****2.1.2 Zgjedhjet****2.1.3 Qeverisja****2.1.4 Reforma në Administratën Publike****2.1.5 Sistemi gjyqësor dhe reforma në
sistemin e drejtësisë****2.1.6 Anti-korrupsioni****2.2 TË DREJTAT E NJERIUT****2.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE
DETYRIMET NDËRKOMBËTARE****2.3.1 Bashkëpunimi rajonal****2.3.2 Marrëdhëniet Bashkimi Evropian –
Shqipëri****PJESA 3. KRITERI EKONOMIK****3.1 FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË
TREGUT****3.1.1 Zhvillimet ekonomike****3.1.2 Politikat monetare dhe fiskale****3.1.3 Ndërveprimi i forcave të tregut****3.1.4 Hyrja dhe dalja nga tregu**



3.1.5 Sistemi ligjor (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit

3.1.6 Sektori financiar

3.2 KAPACITETET PËR TË
PËRBALLUAR PRESIONET
KONKURRUESE DHE FORCAT E
TREGUT BRENDË BASHKIMIT
EVROPIAN

3.2.1 Kapitali njerëzor dhe kapitali fizik

3.2.2 Struktura sektoriale dhe ajo e
ndërmarrjeve

3.2.3 Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

3.2.4 Integrimi tregtar

PJESA 4

KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E
MALLRAVE

4.1.1 Përmbajtja e kapitullit

4.1.2 Struktura e kapitullit

4.1.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis së Bashkimit Evropian

4.1.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.1.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.1.6 Mangësitë e identifikuar dhe Prioritetet

KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E
PUNËTORËVE

4.2.1 Përmbajtja e kapitullit

4.2.2 Struktura e kapitullit

4.2.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis së Bashkimit Evropian

4.2.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.2.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.2.6 Mangësitë e Identifikuar dhe prioritet

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES
DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

4.3.1 Përmbajtja e kapitullit

4.3.2 Struktura e kapitullit

4.3.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis së Bashkimit Evropian

4.3.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.3.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.3.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E
KAPITALIT

4.4.1 Përmbajtja e kapitullit

4.4.2 Struktura e kapitullit

4.4.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis-it të Bashkimit Evropian

4.4.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.4.5 Lista e Ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.4.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK

4.5.1 Përmbajtja e kapitullit

4.5.2 Struktura e kapitullit

4.5.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis-së së Bashkimit Evropian

4.5.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.5.5 Lista e ministrive dhe institucionet
përgjegjëse

4.5.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR
SHOQËRITË TREGTARE

4.6.1 Përmbajtja e kapitullit

4.6.2 Struktura e kapitullit

4.6.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis së Bashkimit Evropian

4.6.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.6.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.6.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË
INTELEKTUALE

4.7.1 Përmbajtja e kapitullit

4.7.2 Struktura e kapitullit

4.7.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis së Bashkimit Evropian

4.7.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore

4.7.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse

4.7.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 8: POLITIKA E
KONKURRENCËS

4.8.1 Përmbajtja e kapitullit

4.8.2 Struktura e kapitullit

4.8.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe
acquis së Bashkimit Evropian

4.8.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore



4.8.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.8.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet
KAPITULLI 9: SHËRBIMET
FINANCIARE
4.9.1 Përmbajtja e kapitullit
4.9.2 Struktura e kapitullit
4.9.3 Kërkesat e MSA-së dhe acquis së
Bashkimit Evropian
4.9.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.9.5 Lista e Ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.9.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet
KAPITULLI 10: SHOQËRIA E
INFORMACIONIT DHE MEDIA
4.10.1 Përmbajtja e kapitullit
4.10.2 Struktura e kapitullit
4.10.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.10.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.10.5 Lista e ministrive dhe institucionet
përgjegjëse
4.10.6 Mangësitë e identifikuar dhe
prioritetet
KAPITULLI 11: BUJQËSIA DHE
ZHVILLIMI RURAL
4.11.1 Përmbajtja e kapitullit
4.11.2 Struktura e kapitullit
4.11.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.11.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.11.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.11.6 Mangësitë e identifikuar dhe
prioritetet
KAPITULLI 12: POLITIKAT E SIGURISË
USHQIMORE, VETERINARISË DHE
MBROJTJES SË BIMËVE
4.12.1 Përmbajtja e kapitullit
4.12.2 Struktura e kapitullit
4.12.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.12.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.12.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.12.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritet

KAPITULLI 13: PESHKIMI
4.13.1 Përmbajtja e kapitullit
4.13.2 Struktura e kapitullit
4.13.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.13.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.13.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.13.6 Mangësitë e identifikuar dhe
prioritetet
KAPITULLI 14: POLITIKA E
TRANSPORTIT
4.14.1 Përmbajtja e kapitullit
4.14.2 Struktura e kapitullit
4.14.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.14.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.14.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.14.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet
KAPITULLI 15: ENERGJIA
4.15.1 Përmbajtja e kapitullit
4.15.2 Struktura e kapitullit
4.15.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.15.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.15.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.15.6 Mangësitë e identifikuar dhe
prioritetet
KAPITULLI 16: TATIMET
4.16.1 Përmbajtja e kapitullit
4.16.2 Struktura e kapitullit
4.16.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian
4.16.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet
kryesore
4.16.5 Lista e ministrive dhe institucioneve
përgjegjëse
4.16.6 Mangësitë e identifikuar dhe
prioritetet
KAPITULLI 17: POLITIKA
EKONOMIKE DHE MONETARE
4.17.1 Përmbajtja e kapitullit
4.17.2 Struktura e kapitullit
4.17.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së
dhe acquis të Bashkimit Evropian



4.17.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.17.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.17.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 18: STATISTIKAT

4.18.1 Përmbajtja e kapitullit

4.18.2 Struktura e kapitullit

4.18.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.18.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.18.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.18.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

4.19.1 Përmbajtja e kapitullit

4.19.2 Struktura e kapitullit

4.19.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.19.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.19.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.19.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

4.20.1 Përmbajtja e kapitullit

4.20.2 Struktura e kapitullit

4.20.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.20.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.20.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.20.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 21: RRJETET TRANS-EVROPIANE

4.21.1 Përmbajtja e kapitullit

4.21.2 Struktura e kapitullit

4.21.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

4.21.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.21.5 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

4.21.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 22: POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORË

4.22.1 Përmbajtja e kapitullit

4.22.2 Struktura e kapitullit

4.22.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

4.22.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.22.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.22.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

4.23.1 Përmbajtja e kapitullit

4.23.2 Struktura e kapitullit

4.23.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.23.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.23.5 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

4.23.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

4.24.1 Përmbajtja e kapitullit

4.24.2 Struktura e kapitullit

4.24.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.24.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.24.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.24.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

4.25.1 Përmbajtja e Kapitullit

4.25.2 Struktura e kapitullit

4.25.3 Kërkesat e MSA-së dhe acquis të BE

4.25.4 Situata aktuale dhe arritjet kryesore

4.25.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.25.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet



KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

4.26.1 Përmbajtja e kapitullit

4.26.2 Struktura e kapitullit

4.26.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.26.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.26.5 Lista e Ministrive dhe Institucioneve Përgjegjëse

4.26.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritet

KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.27.1 Përmbajtja e kapitullit

4.27.2 Struktura e kapitullit

4.27.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.27.4 Situata aktuale në shqipëri dhe arritjet kryesore

4.27.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.27.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETT

4.28.1 Përmbajtja e kapitullit

4.28.2 Struktura e kapitullit

4.28.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.28.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.28.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.28.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 29: BASHKIMI DOGANOR

4.29.1 Përmbajtja e kapitullit

4.29.2 Struktura e kapitullit

4.29.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.29.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.29.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.29.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

4.30.1 Përmbajtja e kapitullit

4.30.2 Struktura e kapitullit

4.30.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.30.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.30.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.30.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

4.31.1 Përmbajtja e kapitullit

4.31.2 Struktura e kapitullit

4.31.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.31.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.31.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.31.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

4.32.1 Përmbajtja e kapitullit

4.32.2 Struktura e kapitullit

4.32.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.32.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.32.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.32.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

4.33.1 Përmbajtja e kapitullit

4.33.2 Struktura e kapitullit

4.33.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

4.33.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

4.33.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

4.33.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet



PJESA 1: HYRJJE

1.1 Anëtarësimi në Bashkimin Evropian

Integrimi Evropian është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme të saj. Ky objektivi strategjik bazohet në vullnetin dhe mbështetjen e plotë të qytetarëve shqiptarë dhe sikurse përcaktuar në rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë të datave 11 prill 2019, 3 tetor 2019 dhe 18 qershor 2020, mbi përparimin e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Në bazë të prioriteteve të Programit qeverisës për periudhën 2021 – 2025, prioriteti i politikës së jashtme të Shqipërisë është avancimi më shpejt drejt anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në BE. Arritja e një vendimi pozitiv për nisjen faktike të negociatave nëpërmjet mbajtjes së Konferencës së parë Ndërqeveritare, pas marrjes së vendimit politik të marsit 2020 për hapjen e negociatave, është prioriteti ynë afatshkurtër për vitin 2022.

Shqipëria u bë pjesë e Procesit të Stabilizim-Asociimit, të shpallur për vendet e Evropës Juglindore në Samitin e Zagrebit, në vitin 2000.

Shqipëria nënshkroi dhe ratifikoi në vitin 2006, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Komunitetet Evropiane dhe Shtetet Anëtare të tyre, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2009. Siç përcaktohet në Nenin 1 të saj, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit synon “... të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; për të kontribuar në stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit; të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë; të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulon kjo Marrëveshje”.

Neni 70 i MSA-së përcakton përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian. Hartimi i Planit Kombëtar të Integritimit

Evropian është shprehje e këtij detyrimi që Shqipëria e plotëson që prej vitit 2014.

Plani Kombëtar i Integritimit Evropian ka reflektuar nga viti në vit, angazhimin e shtuar të Shqipërisë, në përputhje me statusin e saj përkundrejt BE-së, për të përafruar legjislacionin e BE, në mënyrë që të arrihet një kuadër ligjor, normativ dhe standardesh që do të bëjë të mundur marrjen përsipër të detyrimeve të anëtarësimit.

Në qershor 2014 Këshilli Evropian i akordoi Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.¹

Pas dy rekomandimeve të Komisionit Evropian, përkatësisht në Raportin për Shqipërinë në 2016, publikuar më 9 nëntor 2016² dhe në Raportin për Shqipërinë³ dhe Strategjinë e Zgjerimit 2018⁴ publikuar më datë 17 prill 2018, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, i 26 qershorit 2018, vendosi që t'i përgjigjet pozitivisht progresit të bërë nga Shqipëria dhe hapi rrugën për hapjen e negociatave për anëtarësim në qershor 2019.

Bazuar në mandatin politik nga Këshilli i qershor 2018, Komisioni Evropian inicioi në muajin tetor 2018, takimet shpjeguese në kuadër të procesit *screening*, si hapi i parë i nisjes së negociatave të anëtarësimit. Procesi *screening* filloi me takimin shpjegues për Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore, në shtator 2018. Takimet shpjeguese për të gjithë kapitujt negociues u përfunduan brenda vitit 2019.

Takimet shpjeguese ishin një hap i madh përpara që i dhanë një shtysë të re procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së. Në vijim të takimeve shpjeguese, Shqipëria nisi përgatitjet për takimet bilaterale, të cilat nisën me një analizë të mangësive ligjore, administrative e institucionale përkundrejt legjislacionit të BE, sipas kapitujve negociues. Këto përgatitje u zhvilluan më tej gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Gjatë vitit 2019, pavarësisht se Komisioni Evropian, në Paketën e Zgjerimit të datës 29 maj

¹ <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8288-2014-INIT/en/pdf>

² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20161109_strategy_paper_en.pdf

³ <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf>

⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_en.pdf



2019, i rekomandoi përsëri Këshillit hapjen e pakushtëzuar të negociatave të anëtarësimit, ashtu sikurse bëri edhe në Paketën e Zgjerimit të vitit 2018⁵, Këshillat e Çështjeve të Përgjithshme të Bashkimit Evropian, i 18 qershorit 2019 dhe 17–18 tetor 2019, nuk morën asnjë vendim për ecurinë e Shqipërisë në procesin e negociatave të anëtarësimit.⁶

Më datë 2 mars 2020, Komisioni Evropian, në raportin e përditësimit vlerësoi se Shqipëria i kishte rritur përpjekjet dhe kishte arritur rezultate të tjera të prekshme dhe të qëndrueshme në fushat kryesore të identifikuar në Konkluzionet e Këshillit të qershorit 2018. Për këtë arsye, në linjë me rekomandimin e Paketës së Zgjerimit të vitit 2019, Komisioni rekomandoi përsëri hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Më 25 mars 2020, Këshilli Evropian vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur mbi reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara në unanimitet nga Këshilli i qershorit 2018. Këshilli në Konkluzionet e tij vlerësoi se Shqipëria kishte demonstruar vendosmëri për të çuar përpara agjendën reformuese në kuadër të BE dhe kishte dhënë rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme, duke përmbushur kushtet e identifikuar nga Këshilli i Qershorit 2018 për hapjen e negociatave e pranimit.⁷

Këshilli përcaktoi se Konferenca e parë Ndërqeveritare do të thirret sa më shpejt pas miratimit të kuadrit negociues nga Këshilli, duke pasur parasysh që Shqipëria deri atëherë të ketë:

- Miratuar reformën zgjedhore në përputhje të plotë me rekomandimet e OSBE/ODHIR, duke siguruar financim transparent të partive politike dhe fushatave elektorale;

- Siguruar zbatimin e vazhdueshëm të reformës në drejtësi, përfshirë sigurimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën përkatëse ndërkombëtare, përfshirë opinionet e zbatueshme të Komisionit të Venecias;

- Përfunduar ngritjen e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

- Forcuar më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, edhe nëpërmjet bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe përmes plan veprimit për të adresuar rekomandimet e Task Forcës të Veprimit Financiar (FATF).

Komisioni i paraqiti Këshillit propozimet e tij për kuadrin negociues me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në 1 korrik 2020. Këto propozime integruan dhe zhvilluan më tej përjasjen e përforcuar në procesin e zgjerimit.

Më datë 6 tetor 2020, Komisioni publikoi Raportin për Shqipërinë⁸ dhe Strategjinë e Zgjerimit të Bashkimit Evropian⁹. Në Strategjinë e Zgjerimit, Komisioni Evropian vlerësoi se “Shqipëria ka avancuar drejt objektivave të saj strategjike me vendimin e Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE ... Shqipëria ka bërë përparim vendimtar dhe është afër plotësimit të kushteve të vëna nga Këshilli në lidhje me Konferencën e parë Ndërqeveritare”.

Në 1 janar 2021, Portugalia mori Presidencën e Këshillit të BE-së gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 (janar – qershor 2021). Presidenca portugeze e Këshillit të BE-së e përfshiu temën e zgjerimit në prioritetet e saj, bazuar edhe në një angazhim të marrë në kuadër të Treshes së Presidencave të BE-së. Pikësynimi ishte mbajtja e Konferencës së parë Ndërqeveritare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut sa më shpejt që të ishte e mundur, brenda mandatit të Presidencës portugeze.

Më 1 mars 2021, në Bruksel u mbajt takimi i 11-të i Këshillit të Stabilizim Asociimit me pjesëmarrjen e Kryeministrit Edi Rama dhe Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikën e Jashtme, Josep Borrell. Këshilli i 11-të i Stabilizim Asociimit bëri një bilanc të përparimit të Shqipërisë në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit duke përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, etj., pas miratimit të vendimit të Këshillit të marsit 2020 për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe

⁵ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-communication-on-eu-enlargement-policy_en.pdf

⁶ <https://www.consilium.europa.eu/media/41123/17-18-euco-final-conclusions-en.pdf>

⁷ <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>

⁸ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

⁹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20201006-communication-on-eu-enlargement-policy_en.pdf



Maqedoninë e Veriut. Shqipëria rikonfirmoi angazhimin në vijimin e përmbushjes së reformave të lidhura me integrimin evropian. Bashkimi Evropian rikonfirmoi se Shqipëria i kishte përmbushur kushtet për zhvillimin sa më parë të Konferencës së parë Ndërqeveritare pas miratimit të kuadrit negociues. Në takim u konfirmua gjithashtu vijimi i partneritetit prioritar të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor, vijimi i mbështetjes së BE-së në kapërcimin e pasojave të pandemisë dhe sigurimin e vaksinave anti COVID-19.

Në 1 korrik 2021, Sllovenia mori Presidencën e Këshillit të BE-së për gjysmën e dytë të vitit 2021 (korrik – dhjetor 2021). Presidenca sllovene e Këshillit të BE-së e përfshiu temën e zgjerimit në prioritetet e saj të Presidencës, me synim mbajtjen e Konferencës së parë Ndërqeveritare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut sa më shpejt që të ishte e mundur, brenda mandatit të saj.

Me 15 shtator 2021, BE miratoi Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit 2021 – 2027 (IPA III). IPA III ka një buxhet prej 14.2 miliardë euro për të mbështetur zbatimin e reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Miratimi i këtij instrumenti i hapi rrugë zbatimit të Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili përcakton një paketë të konsiderueshme investimesh që mobilizon rreth 30 miliardë euro për rajonin gjatë shtatë viteve të ardhshme, që arrijnë në një të tretën e GDP-së së rajonit. Kjo është e përbërë nga 9 miliardë euro në financimin e grantit dhe 20 miliardë euro të shfrytëzuar nga Fondi i ri i Garancisë për Ballkanin Perëndimor.

Më datë 6 tetor 2021, në Slloveni u zhvillua Samiti Bashkimi Evropian – Ballkani Perëndimor. Në përfundim të takimit, udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe të shteteve të tij anëtare, në konsultim me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor, miratuan një deklaratë e cila në pikën e saj të parë theksonte “BE-ja riafirmon mbështetjen e saj të qartë për Perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe mirëpret angazhimin e partnerëve të Ballkanit Perëndimor në perspektivën evropiane, e cila është në interesin tonë strategjik reciprok dhe mbetet zgjedhja jonë e përbashkët strategjike. BE-ja konfirmon angazhimin e vet në procesin e

zgjerimit dhe vendimet e marra prej saj për këtë, bazuar në reformat e besueshme nga partnerët, kushtëzimi i drejtë dhe rigoroz dhe parimi i meritave të veta. Ne do të intensifikojmë më tej angazhimin tonë të përbashkët për të çuar përpara transformimin politik, ekonomik dhe social të rajonit, duke njohur ndërkohë progresin e bërë nga Ballkani Perëndimor. Ne kujtojmë gjithashtu rëndësinë se BE-ja të mund të mbajë dhe thellojë zhvillimin e saj, duke siguruar kapacitetin e saj për të integruar anëtarë të rinj”.¹⁰

Në Raportin për Shqipërinë publikuar më 19 tetor 2021 si pjesë e paketës së zgjerimit 2021, Komisioni Evropian arriti në konkluzionin se “Për kuadrin negociues me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, është thelbësore që vendet anëtare të BE-së të përfundojnë diskutimet pa vonesa të mëtejshme dhe që konferencat e para ndërqeveritare me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut të mbahen sa më shpejt të jetë e mundur nën Presidencën Sllovene... Përparimi i Shqipërisë në reformën zgjedhore dhe vazhdimi i rezultateve të mira në zbatimin e reformave kyçe të shtetit të së drejtës kanë përforcuar vlerësimin e Komisionit se vendi ka përmbushur kushtet për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare të negociatave të anëtarësimit. Vonesat në nisjen zyrtare të negociatave të anëtarësimit po ndikojnë negativisht në besueshmërinë e BE-së”.¹¹

Megjithatë, përgjatë vitit 2021, përveç faktit se përparimi që ka bërë Shqipëria është pranuar dhe vlerësuar nga të gjithë partnerët evropianë, nuk është arritur miratimi i pozicionit negociues për Shqipërinë dhe vendimi për zhvillimin e konferencës së parë ndërqeveritare. Këto vijnë të mbetet të lidhura me dosjen e Maqedonisë së Veriut.

1.2 Menaxhimi i procesit të negociatave të anëtarësimit

Roli i Kuvendit të Shqipërisë, në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian rregullohet me Ligjin nr. 15/2015, datë 5.03.2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Në përputhje me këtë Ligj, është ngritur dhe funksionon Këshilli

¹⁰ <https://www.consilium.europa.eu/media/52286/eu-wb-summit-brdo-declaration-6-october-2021-04.pdf>

¹¹ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2021-10/Communication-on-EU-Enlargement-2021-v2-and-annexes_en.pdf



Kombëtar i Integritetit Evropian si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integritetin evropian. Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritetit.

Në zbatim të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave paraqet çdo vit në Kuvendin e Shqipërisë një raport të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të detyrimeve në kuadër të Planit Kombëtar për Integritetin Evropian, procesin e negociatave të anëtarësimit dhe menaxhimit të asistencës së Bashkimit Evropian. Këshilli i Ministrave paraqet edhe një raport të veçantë mbi Raportin vjetor të Komisionit për Shqipërinë.

Për sa i përket koordinimit ndërinstitucional, Qeveria shqiptare realizoi rikonceptualizimin e plotë të strukturave përgjegjëse për integritetin evropian. Ky proces u krye duke pasur parasysh se negociatat e anëtarësimit janë një proces tepër teknik dhe i komplikuar, të cilat kërkojnë një koordinim sa më të mirë dhe për një përdorim sa më eficient të kapaciteteve institucionale të administratës publike shqiptare.

Ky proces u iniciua me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

Për zbatimin e këtij Vendimi u miratuan aktet e mëposhtme:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 6.05.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, i ndryshuar¹²;

¹² Ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 994, datë 9.12.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit, për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian” dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 746, datë 9.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator

- Urdhri i Kryeministrit nr. 93, datë 20.05.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Teknik të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës”;

- Urdhri i Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integritetin evropian”;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 113, datë 30.08.2019 “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integritetin evropian”.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore, përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e traktatit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, në maj 2020 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 422, datë 6.05.2020 “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

U emërua Kryenegociatori për aderimin e Shqipërisë në BE dhe Grupi Negociator i përbërë nga 22 negociatorë. Vendimi përcakton përgjegjësitë e tyre në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, përfshirë në hartimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar për Integritetin Evropian.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 749, datë 19.12.2018 përcakton se Grupi Negociator “monitoron dhe bashkërendon zbatimin e detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të dokumenteve strategjike për procesin e Integritetit Evropian” dhe “drejton procesin e përditësimit të planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”.

Për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përditëson çdo vit Planin Kombëtar për Integritetin Evropian, si instrumenti planifikues për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Plani Kombëtar për Integritetin Evropian 2021 – 2023, u miratua me Vendimin e Këshillit të

dhe detyrat e kryenegociatorit, për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të ndryshuar

Ministrave nr. 90, datë 17.02.2021, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 – 2023”.

Nga monitorimi i realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 – 2023, u vërejt se, për vitin 2021:

- Nga 87 projektakte të planifikuara, u miratuan 66 akte;

- Realizimi total i PKIE në përqindje është 76%.

Niveli i zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 – 2023 ishte pak më i ulët se ai i arritur gjatë vitit 2020 në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2020 – 2022. Zbatimi i tij për vitin 2020 është në shkallën 87%.

1.3 Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024

Neni 70 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton angazhimin e Republikës së Shqipërisë për të përafuar legjislacionin shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Njëkohësisht, përafrimi i plotë i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe zbatimi i plotë dhe efektiv i tij, janë një nga kriteret e Kopenhagenit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Procesi i negociatave të

anëtarësimit është në vetvete procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.


Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka për qëllim të koordinojë këtë proces përafrimi duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe detyrimet që lindin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hartimi në kohë dhe me cilësi i Planit dhe monitorimi i tij janë parakusht për përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Cikli i hartimi dhe monitorimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian përbëhet nga këto procese:

1. Puna përgatitore;
2. Analiza e mangësive;
3. Planifikimi;
4. Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
5. Konsultimi dhe miratimi;
6. Monitorimi, raportimi, dhe vlerësimi.

Skematikisht, ky cikël programimi tregohet në figurën më poshtë.

Figura: Lidhja mes proceseve të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian





Veçanërisht të rëndësishme në këtë cikël planifikimi dhe monitorimi janë fazat e analizës së mangësive dhe planifikimit. Rezultati i këtyre proceseve mishërohet në dokumentin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, i cili tregon prioritetet e përafrimit të legjislacionit, ministrinë përgjegjëse për hartimin e projektakteve shqiptare, shkallën e përafrimit, si dhe datën e miratimit.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme inicioi identifikimin e masave ligjore që do të përfshiheshin në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 që në fillim të muajit shtator 2021. Në këtë fazë, të gjitha ministrinë dhe institucionet koordinuese u udhëzuan që të fillojnë analizën e mangësive dhe identifikimin e prioritetëve duke marrë në konsideratë përgjegjësitë në kuadër të strategjive ekzistuese ndërsektoriale/ sektoriale dhe hapësirën fiskale, sikurse përcaktuar gjatë fazës së parë të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme inicioi njëkohësisht rishikimin e metodologjisë së hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, bazuar në eksperiencën e hartimit të Planeve të mëparshme. Në këtë proces, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme u ndihmua edhe nga projekti “Mbështetje për integrimin evropian”, financuar nga Bashkimi Evropian.

Metodologjia e hartimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2021 – 2023 u miratua nga Grupi Negociator me datë 27 tetor 2021.

Metodologjia e PKIE 2022 – 2024 paraqet këto ndryshime krahasuar me metodologjinë pararendëse:

- Bën një ndarje më të detajuar në proceseve të ndryshme në të cilat kalon hartimi, monitorimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian;

- Thekson dhe jep udhëzime më të plota në lidhje me procesin e analizës së mangësive ligjore dhe institucionale në këndvështrimin e negociatave të anëtarësimit;

- Jep udhëzime më të detajuara në lidhje me identifikimin e masave ligjore që do të planifikohen në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian;

- Jep udhëzime më të detajuara për kostimin e veçantë të çdo mase ligjore dhe zbatuese, në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm;

- Përfshin dhe jep udhëzime mbi kryerjen e konsultimit me shoqërinë civile në kuadër të

Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

Në vijim të miratimit të metodologjisë së Planit Kombëtar për Integrimin Evropian u zhvillua një cikël i plotë trajnimesh për drejtoritë/ njësitë e integritimit në ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe për stafin kyç të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e këtij dokumenti. Edhe këto trajnime u zhvilluan në bashkëpunim me projektin “Mbështetje për integrimin evropian”, financuar nga Bashkimi Evropian.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022 – 2024 përfshin masa ligjore dhe zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme që shtrihen deri në vitin 2024, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

PKIE-ja është e strukturuar në katër pjesë kryesore:

- Hyrja, në të cilën jepet një përshkrim i shkurtër i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, strukturat e koordinimit në këtë proces dhe një përshkrim i vetë PKIE;

- Pjesa e dytë paraqet situatën aktuale dhe arritjet më të fundit në çështjet që kanë të bëjnë me Kriterin Politik. Kjo pjesë përfshin edhe arritjet në reformat kyçe të lidhura me shtetin e së drejtës, etj.;

- Pjesa e tretë përmbledh çështjet që kanë të bëjnë me Kriterin Ekonomik duke u fokusuar në situatën makroekonomike, stabilitetin financiar, etj.;

- Pjesa e katërt është pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues.

Plani nuk përfshin Kapitullin 34: Institucionet dhe Kapitullin 35: Çështje të tjera. Kapitulli 34 rregullon pjesëmarrjen e shtetit anëtar në institucionet e Bashkimit Evropian, ndërsa, Kapitulli 35 (aktet ligjore të BE-së që bëjnë pjesë në këtë kapitull) përvijon fazat e fundit të negociatave për anëtarësim.

PJESA 2: KRITERI POLITIK

Interesi kryesor kombëtar dhe qëllimi strategjik i Qeverisë të Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE. Kriteret e anëtarësimit përcaktojnë stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si edhe ekzistencën e një ekonomie tregu funksionale, si shtyllat kryesore të politikës kombëtare dhe politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë.



Qeveria e Republikës së Shqipërisë konsideron se përmbushja e Kriterit Politik mbart rëndësi thelbësore në procesin e anëtarësimit të BE-së. Gjithashtu, Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në jetësimin e prioritetëve kyç që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administratën publike.

2.1 Demokracia dhe shteti i së drejtës

Qeveria e Shqipërisë është plotësisht e angazhuar për të ndërmarrë dhe zbatuar të gjitha reformat e nevojshme për të forcuar procesin legjislativ, sistemin zgjedhor, qeverisjen qendrore dhe lokale, administratën publike, si dhe sistemin e drejtësisë. Fokusi i punës së Qeverisë Shqiptare do të jetë zbatimi i reformave të nevojshme për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) BE-Shqipëri dhe në veçanti, për të adresuar rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian 2021 për Shqipërinë.

Përsa i takon administratës publike, Qeveria Shqiptare është e angazhuar për zbatimin e një reforme të mirëfilltë, për trajtimin dhe vlerësimin e bazuar në merita dhe angazhimin e punonjësve duke krijuar një rrjet institucional efektiv dhe efikas që ofron shërbime më të mira për qytetarët. Gjithashtu, Qeveria shqiptare ka si objektiv përfundimtar krijimin e një administrate publike efikase, të aftë për të zbatuar plotësisht angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Çdo veprim i ndërmarrë nga Qeveria në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit ka për qëllim përfundimtar krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës në Shqipëri, i cili është në gjendje të ofrojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe për të zbatuar legjislacionin e përafuar me *acquis*-në e BE-së.

Lufta kundër korrupsionit është një prioritet kyç i Qeverisë Shqiptare. Drejtimit kryesor të politikës antikorrupsion përfshijnë një sërë masash për parandalimin e korrupsionit, forcimin e institucioneve, monitorimin e përgjithshëm nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe ndëshkimin përmes masave të natyrës administrative dhe/ose penale të zyrtarëve të korruptuar. Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015 – 2023 ka synuar të kontribuojë në

reduktimin e qëndrueshëm të korrupsionit si dhe marrjen e masave efektive për parandalimin e korrupsionit në të gjitha nivelet.

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti për zbatimin e mëtejshëm të politikave kundër diskriminimit, për të përmirësuar situatën në lidhje me të drejtat sociale me fokus të veçantë në grupet vulnerabël dhe të miturit. Reformat konsistojnë si në fushën e të drejtave të pronësisë ashtu edhe në zbatimin e vendimeve gjyqësore të GjEDNj-së për kthimin dhe kompensimin e pronës.

2.1.1 Kuvendi

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vendit. Kuvendi përfaqëson vullnetin e popullit dhe është mbrojtësi i vlerave të demokracisë. Si organi i zgjedhur që përfaqëson popullin shqiptar, Kuvendi është organi ligjvënës, i cili shqyrton dhe miraton ligje në dobi të interesave të shoqërisë dhe të zhvillimit të vendit. Kuvendi ushtron funksionin e kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit dhe monitoron institucionet e pavarura. Gjithashtu, Kuvendi luan një rol thelbësor në procesin e integritetit evropian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të procesit.

Gjatë periudhës janar – tetor 2021 Kuvendi ka bërë progres të rëndësishëm në plotësimin e rekomandimeve të Raportit 2020 të Komisionit Evropian për Shqipërinë të cilat lidhen me funksionimin e Kuvendit.

Kuvendi hartoi dhe miratoi Planin e tij të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian, i cili përmban 5 objektivat kryesore të punës së Kuvendit për periudhën Tetor 2020 – Tetor 2021 si dhe masat konkrete (38 masa) për realizimin e këtyre objektivave. Zbatimi i masave të Planit të Veprimit është monitoruar në vazhdimësi përmes raportimeve periodike që Shërbimet e Kuvendit i kanë dërguar Konferencës së Kryetarëve dhe Ministrisë së Drejtësisë. Deri në përfundimin e afatit për zbatimin e Planit të Veprimit (6 Tetor 2021), nga 38 masat e parashikuara, 35 masa (ose 92%) u realizuan plotësisht, 2 masa (ose 5%) u realizuan pjesërisht dhe për 1 masë (ose 3%) fillimi i zbatimit të saj ishte i kushtëzuar me zhvillimin e Konferencës së Parë Ndërqeveritare.



Në datën 10 shtator 2021 u zhvillua mbledhja e parë e legjislaturës së re të Kuvendit (legjislatura e X) të dalë nga zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021. Në seancën e dytë plenare të Kuvendit të zhvilluar po në datën 10 shtator 2021, Komisioni i Përkohshëm i Verifikimit të Mandateve i paraqiti Kuvendit raportin për vlefshmërinë e mandateve të deputetëve të Kuvendit dhe menjëherë pas verifikimit të mandateve deputetët bënë betimin. Menjëherë pas kryerjes së betimit nga deputetët, Kuvendi me 79 vota pro zgjodhi Znj. Lindita Nikolla në detyrën e Kryetares së Kuvendit (vendimi nr. 64/2021). Në seancat plenare të datave 13 dhe 23 shtator 2021, Kuvendi zgjodhi 2 Zëvendëskryetarët e Kuvendit, 6 Sekretariatet e Kuvendit, kryesinë dhe përbërjen e 8 Komisioneve të përhershme të Kuvendit. Në seancën plenare të datës 16 shtator 2021, Kryeministri i emëruar në detyrë, Z. Edi Rama prezantoi programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Pas 20 orë diskutimesh parlamentare lidhur me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, të zhvilluara në datat 16 dhe 17 shtator 2021, Kuvendi i Shqipërisë në datën 17 shtator 2021, miratoi me 77 vota pro (vendimi nr. 68/2021), përbërjen dhe programin politik të Këshillit të Ministrave.

Roli legjislativ i Kuvendit është rritur ndjeshëm gjatë periudhës janar – tetor 2021, nëpërmjet shtimit të nismave ligjore të propozuara nga vetë deputetët (26 nisma ligjore) si dhe shtimit të amendamenteve të propozuara drejtpërdrejt nga deputetët për projektligjet e shqyrtuara nga Kuvendi (421 amendamente). Nga 137 projektligjet e depozituara në Kuvend për shqyrtim dhe miratim 26 nisma ligjore (ose 19%) janë propozuar nga deputetët. Veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit në komisionet parlamentare dhe në seancë plenare ka vazhduar pa ndërprerje edhe në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Gjatë periudhës janar – tetor 2021, Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi 206 akte parlamentare nga të cilat 102 ligje, 80 vendime dhe 24 rezoluta¹³. Të gjitha ligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe (102), janë miratuar me konsensus mes shumicës parlamentare dhe opozitës parlamentare. Nga 102 ligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe, 11 ligje janë

miratuar me shumicë të cilësuar prej 3/5, 24 ligje janë miratuar me shumicë absolute dhe 67 ligje janë miratuar me shumicë të thjeshtë. Kuvendi ka miratuar ndryshimet në 10 ligje¹⁴ të reformës në drejtësi me qëllim forcimin e mëtejshëm të efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe të kapaciteteve të tij për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Komisionet e përhershme të Kuvendit kanë shqyrtuar dhe miratuar 110 projektligje, 23 projektvendime dhe 24 projektrezoluta. Komisionet kanë zhvilluar 211 mbledhje. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komisione, deputetët kanë propozuar 421 amendamente, të cilat janë miratuar edhe në seancë plenare. Gjatë shqyrtimit të projektligjeve në Komisione përfaqësuesit e qeverisë iu përgjigjën 410 pyetjeve të deputetëve mbi projektligjet.

Gjithashtu, Komisionet i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë dëgjësive me grupet e interesit (17 përfaqësues të grupeve të interesit) si dhe marrjes së mendimit dhe sugjerimeve të tyre për projektligjet e propozuara Kuvendit. Gjatë periudhës raportuese rezultoi se nga 421 amendamentet e propozuara në Komisionet parlamentare, 37 (ose 9%) janë amendamente të cilat bazohen në vërejtjet e paraqitura nga grupet e interesit për projektligjet përkatëse.

14 1) Ligji nr. 41/2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”; 2) Ligji nr. 42/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”; 3) Ligji nr. 43/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”; 4) Ligji nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”; 5) Ligji nr. 45/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar”; 6) Ligji nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”; 7) Ligji nr. 47/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”; 8) Ligji nr. 48/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”; 9) Ligji nr. 49/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, datë 03.05.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar”; 10) Ligji nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

¹³ Të dhënat e Kuvendit janë për periudhën 1 janar – 20 tetor 2021.



Transparenca në procesin ligjvënës të Kuvendit është forcuar më tej, përmes ngritjes së platformës *online* për konsultimin e projektligjeve si dhe transmetimit të mbledhjeve të komisioneve parlamentare drejtpërdrejt në kanalën televiziv të dedikuar Kuvendit dhe në mediat sociale.

Kuvendi ka forcuar kontrollin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara me *acquis* të BE-së, duke garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafuar. Gjatë periudhës janar – tetor 2021, Kuvendi ka miratuar 13 ligje që synonin përafrim të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së¹⁵. Komisioni për Integrimin Evropian (KIE) ka luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces. Gjatë shqyrtimit dhe miratimit të projektligjeve që synonin përafrimin me *acquis* e BE-së (13 projektligje gjatë periudhës janar – tetor 2021), KIE ka propozuar 72 amendamente, me qëllim për të siguruar një përafrim më të saktë të projektligjeve me *acquis* të BE-së, të cilat janë miratuar edhe në seancën plenare.

Roli kontrollues i Kuvendit u forcua më tej gjatë periudhës janar – tetor 2021, përmes përdorimit më intensive dhe cilësor të instrumenteve të mbikëqyrjes parlamentare të parashikuara në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit dhe Ligjin Nr. 15/2015 (5 *interpelanca me anëtarë të Këshillit të Ministrave*; 29 *seanca dëgjimore në Komisione me ministrat, zëvendësministrat dhe drejtues të institucioneve të tjera qendrore*; 43 *kërkesa për informacion me shkrim nga deputetët*; 2 *komisione hetimore parlamentare*). Ministrat, Zëvendësministrat dhe drejtues të institucioneve të

tjera qendrore u paraqitën në 29 seanca dëgjimore para komisioneve të përhershme parlamentare dhe u përgjigjën 153 pyetjeve të deputetëve.

Gjatë periudhës janar – tetor 2021, Kuvendi ka miratuar ngritjen e 2 komisioneve hetimore parlamentare. Kuvendi me vendimin nr. 45/2021, datë 07.05.2021, vendosi ngritjen e Komisionit Hetimor “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”, përcaktoi përbërjen e komisionit hetimor me përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare, si dhe objektin e punës së komisionit si vijon:

a) Hetimi dhe verifikimi nëse aktet e kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës;

b) Verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë;

c) Verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës, në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

Komisioni hetimor zhvilloi veprimtarinë e tij brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Kuvendit nr. 45/2021, nga data 08.5.2021 deri më datën 28.05.2021. Gjatë kësaj periudhe Komisioni zhvilloi 10 mbledhje. Komisioni Hetimor, në përfundim të procesit hetimor dhe shqyrtimit të akteve dhe materialeve të administruara gjatë këtij procesi, në mbledhjen e datës 28.05.2021, bazuar në nenin 20 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, miratoi Raportin Përfundimtar të hetimeve. Komisioni hetimor, në përfundim të hetimit, në lidhje me pikat “a” dhe “b” të objektit të punës së Komisionit Hetimor, arriti në konkluzionin se Presidenti i Republikës me aktet dhe qëndrimet e tij ka shkelur nenet 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 86/1, 88/3, 89, 94, 100/1, 100/2, 102/1, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës. Në lidhje me pikën “c” të objektit të punës së Komisionit Hetimor, Komisioni arrin në konkluzionin se aktet, sjelljet dhe qëndrimet e Presidentit të Republikës

15 1) Ligji nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”; 2) Ligji nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 124/2015 “Për eficientën e energjisë”, të ndryshuar”; 3) Ligji nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”; 4) Ligji nr. 63/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”; 5) Ligji nr. 64/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”; 6) Ligji nr. 73/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”; 7) Ligji nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”; 8) Ligji nr. 79/2021 “Për të huajt”; 9) Ligji nr. 88/2021 “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”; 10) Ligji nr. 89/2021 “Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor”; 11) Ligji nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare”, sh.a”; 12) Ligji nr. 91/2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare”; 13) Ligji nr. 96/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar”.



vijnë në kundërshtim me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese. Në përfundim Komisioni hetimor i propozoi Kuvendit:

a) Miratimin e Raportit Përfundimtar të Komisionit Hetimor “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”, së bashku me anekset e tij;

b) Shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës për shkelje të rënda të neneve 2/2, 4, 7, 13, 18, 45, 86/1, 88/3, 89, 94, 100/1, 100/2, 102/1, 124, 135, 145 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në seancën plenare të datës 9 qershor 2021, Kuvendi i Shqipërisë me 104 vota pro miratoi Vendimin nr. 54/2021 “Për miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë” së bashku me anekset e tij”, dhe Vendimin nr. 55/2021 “Për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës z. Ilir Meta për shkak të shkeljeve të rënda të Kushtetutës”. Kryetari i Kuvendit, bazuar në nenin 90, pika 3 të Kushtetutës dhe nenin 112, pika 4 të Rregullores së Kuvendit, vendimin e Kuvendit për shkarkimin e Presidentit të Republikës, ia ka dërguar Gjykatës Kushtetuese. Neni 90, pika 3 e Kushtetutës parashikon se: “Vendimi i Kuvendit i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, e cila, kur vërteton fajësinë e Presidentit të Republikës, deklaron shkarkimin e tij nga detyra”.

Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 79/2021, datë 14.10.2021 vendosi ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor, për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore për qëllime elektorale në zgjedhjet e 25 prillit 2021”, përcaktoi përbërjen e komisionit hetimor me përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare, si dhe objektin e punës së komisionit si vijon:

1) Verifikimi i përdorimit të të dhënave personale për qëllime elektorale;

2) Verifikimi i përdorimit të fondeve publike për qëllime elektorale, duke përfshirë edhe shpërblimin e dëmeve nga tërmeti i vitit 2019;

3) Verifikimi i përdorimit të procesit të legalizimeve të ndërtimeve informale për qëllime elektorale;

4) Verifikimi i punësimeve në administratën publike për qëllime elektorale. Komisioni hetimor

ka filluar të ushtrojë veprimtarinë e tij, duke diskutuar për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komisionit, zgjedhjen e sekretarit të komisionit dhe miratimin e Planit Paraprak të Hetimit.

Roli kontrollues i Kuvendit në çështjet e integritetit evropian është forcuar më tej gjatë periudhës janar tetor 2021. Komisioni për Integritetin Evropian (KIE) dhe Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian (KKIE) kanë luajtur një rol kyç për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

KKIE ka vijuar të monitorojë ecurinë e procesit të integritetit evropian dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në BE përmes takimeve periodike me përfaqësues të qeverisë. Gjatë periudhës janar – tetor 2021, KKIE ka zhvilluar 3 takime. Në datën 25 janar 2021 u zhvillua on line takimi i radhës me temë: “Zbatimi i Planit të Veprimit për hapjen e negociatave të miratuara në Kuvend me rezolutën e datës 24.09.2020 mbi “Hapjen e Negociatave të Anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe Miratimin e Planit të Masave për Përmbushjen e Përparësive të Përcaktuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian”. I pranishëm për të informuar anëtarët e KKIE, në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit ishte Kryenegociatori i Shqipërisë për integritetin në Bashkimin Evropian, Z. Zef Mazi. Në pjesën e dytë të këtij takimi u diskutua dhe miratua nga anëtarët e KKIE, Raporti i veprimtarisë së KKIE për vitin 2020¹⁶. Pas miratimit në KKIE, ky raport u prezantua në seancë plenare nga Kryetari i KKIE në datën 22 shkurt 2021. Në datën 22 shkurt 2021, u zhvillua online takimi i radhës me temë: “Ecuria e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin e vitit 2020 për Shqipërinë referuar fushës së bujqësisë dhe sigurisë ushqimore si edhe menaxhimi i asistencës financiare të BE për këto dy fusha”. E ftuar në këtë takim ishte Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, znj. Milva Ekonomi e cila informoi anëtarët dhe të ftuarit e KKIE mbi temën. Në datën 20 Tetor 2021 u zhvillua takimi i radhës i KKIE, në të cilin Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Evropian

¹⁶

<https://www.parlament.al/Files/Integrimi/Raporti%20i%20KKIE%20p%C3%ABr%20vitin%202020.pdf>



në Shqipëri Z. Lugi Sorecca, prezantoi “Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021”. Gjithashtu, në këtë takim morën pjesë dhe diskutuan mbi hapat për ndjekjen e rekomandimeve të këtij Raporti: Znj. Olta Xhaçka, Ministre për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe Z. Zef Mazi, Kryenegociator i Shqipërisë me Bashkimin Evropian.

Kuvendi ka ushtruar kontroll parlamentar jo vetëm mbi ekzekutivin, por edhe mbi organet kushtetuese apo ato të krijuara me ligj për të verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar prej tij. Gjatë periudhës janar – tetor 2021, 27 institucione të pavarura kanë raportuar në komisionet parlamentare për veprimtarinë e tyre për vitin 2020, nga të cilat 24 institucione të pavarura kanë raportuar edhe në seancë plenare. Kuvendi ka miratuar në seancë plenare 24 Rezoluta, përmes të cilave ka vlerësuar veprimtarinë vjetore të 24 institucione të pavarura për vitin 2020, si dhe u ka caktuar atyre detyra konkrete për vitin 2021.

Mekanizmi ndërinstitutional “Qeveri – Kuvend – Institucione të Pavarura”, i miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 49/2017 për ndjekjen dhe monitorimin sistematik të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, sipas Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit është në proces rishikimi. Në kuadër të rishikimit të vendimit të Kuvendit nr. 49/2017, Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura me mbështetjen e OSBE-së zhvilloi në datën 4 qershor 2021 një takim me institucionet e pavarura dhe përfaqësuesit e ekzekutivit. Platforma ndërinstitutionale përditësohet vazhdimisht nga ana e Kuvendit dhe institucioneve të pavarura. Pavarësisht rishikimit, Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ka përpunuar periodikisht çdo 4 muaj të dhënat mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura adresuar ekzekutivit dhe agjencive të varësisë.

Kuvendi në ushtrim të funksionit zgjedhës, gjatë periudhës janar – tetor 2021, miratoi 21 vendime për zgjedhje ose emërim në institucionet kushtetuese apo të krijuara me ligj, nga të cilët: 2 vendime për emërim të ministrave (MEPJ dhe Ministri i Mbrojtjes), 1 vendim për miratimin e përbërjes dhe të programit politik të Këshillit të

Ministrave (*shih më lart*), 18 vendime për zgjedhjen ose emërimin e titullarëve dhe/ose anëtarëve të 8 institucioneve të pavarura (kryetarin dhe 7 anëtarë të Komitetit Drejtues të Radio Televizionit Shqiptar; DRTSH-së; 1 anëtar të Këshillit Drejtues të AKEP-it; 1 anëtar të AMF-së; 2 anëtarë të Komisionit të Konkurrencës; 3 anëtarë të KPP-së; 1 anëtar të Këshillit të Statistikave; anëtarin e dytë zëvendësuese për pozicionin Komisioner i KPK dhe anëtarin e parë zëvendësuese për pozicionin e Komisionerit Publik; kryetaren e AMA-s). Gjithashtu, Kuvendi ka miratuar 1 vendim për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës (*shih më lart*).

Kuvendi, në datën 23 korrik 2021, ka bërë shpalljen për plotësimin e vakancave që do të krijohen në dhjetor 2021, përkatësisht 2 vakanca për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe 2 vakanca për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), nga trupa e pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës. Në datën 12 tetor 2021, Drejtuesit e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Shkollës së Magjistraturës zhvilluan në mjediset e Kryesisë së Kuvendit mbledhjen e posaçme për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së, e thirrur nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Pas zhvillimit të mbledhjes së posaçme vijon procesi për zgjedhjen e kandidatëve.

Prioritetet e Kuvendit për vitin 2022 janë:

– Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve parlamentare (*përfaqësimi, ligjberja, kontrolli parlamentar*);

– Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritetit evropian;

– Rritja e transparencës në veprimtarinë e Kuvendit;

– Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit.

Këto prioritete të Kuvendit do të ndiqen përmes realizimit të objektivave dhe masave të mëposhtme:

– Forcimi i rolit ligjberës të Kuvendit, nëpërmjet: organizimit të workshop-eve dhe sesioneve të informimit me deputetët për procesin legjislativ në komisione dhe seancë plenare; monitorimit efektiv të përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara Kuvendit me acquis të BE-së për të garantuar një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafëruar.



- Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, nëpërmjet: organizimit të workshop-eve dhe sesioneve të informimit për orientimin e deputetëve në përdorimin efektiv dhe eficient të instrumenteve të kontrollit parlamentar (seancat dëgjimore, vizitat monitoruese në terren, interpelancat dhe pyetjet, mocionet me debat, kërkesat për informacion); përdorimit më të shpeshtë dhe cilësor të instrumenteve të kontrollit parlamentar për monitorimin e reformave dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit evropian; rishikimit të Ligjit Nr. 15/2015 për të parashikuar një mekanizëm efektiv të mbikëqyrjes së veprimtarisë së qeverisë (rishikimin e pozicionit negociues) gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit, bazuar në praktikën më të mirë në këtë fushë; krijimit në Platformën Ndërinstitucionale të Kuvendit të një hapësire për rekomandimet e raportit vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë, adresuar institucioneve të pavarura.

- Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Kuvendin në Raportin 2021 të KE-së për Shqipërinë si dhe monitorimi i zbatimit të tij.

- Forcimi i transparencës në veprimtarinë e Kuvendit nëpërmjet: zhvillimit të sesioneve të trajnimit me grupet e interesit dhe me OSHC-të që bashkëpunojnë me Kuvendin për procesin ligjvënës, procesin e konsultimit dhe dëgjimet publike; organizimit të takimeve periodike të deputetëve me qytetarët për të prezantuar veprimtarinë e Kuvendit; zhvillimit të seancave dëgjimore publike nga komisionet e përhershme të Kuvendit për marrjen e mendimeve edhe nga aktorët e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, gjatë procesit vendimmarrës të Kuvendit; rinxhinierizimi i paraqitjeve publike online të informacionit parlamentar përmes teknologjisë së informacionit (IT) për të mundësuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve; publikimit të raportit të Kuvendit mbi pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2021; forcimit të bashkëpunimit të Kuvendit me shoqërinë civile, si një partner shumë i rëndësishëm në ecurinë e suksesshme të reformave të integritetit; publikimit periodik online të Newsletter-it të Kuvendit lidhur me veprimtarinë e Kuvendit në procesin e integritetit evropian.

- Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integritetit evropian.

2.1.2 Zgjedhjet

Roli i Komisionit Qendror të zgjedhjeve është mjaft i rëndësishëm në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri. Ky organ drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore, të medias në raport me zgjedhjet. Ligji nr. 101/2020, krijoi një arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tre organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë:

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
- Komisioni Rregullator;
- Komisioni Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Presidenti i Republikës, më datë 6 shtator 2020, dekretoi datën 25 prill 2021, si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Në zbatim të kuarorit të ri ligjor zgjedhor, zgjedhjet u mbajtën më 25 prill 2021. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve edhe pse në afatet e ngushta kohore për realizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, mundi:

- Të zbatonte të gjitha rekomandimet kyçe të OSCE/ODIHR të raportit të vitit 2019.

- Të respektoj lirinë themelore të organizimit dhe subjektet zgjedhore patën mundësi të bënin fushatë lirisht, pavarësisht kufizimeve të vendosura për shkak të pandemisë.

- Të kryhej procesin e identifikimit elektronik në 5199 qendrat e votimit, me më pak se 150 qendra votimi të cilat zhvilluan një proces manual të identifikimit.

- Të marrë në shqyrtim, të hetojë administrativisht dhe të ketë vendimmarrje nga ana e KSHZ për të gjitha rastet e denoncimeve në lidhje me kryerjen e veprimtarive të ndaluara nga subjektet zgjedhore apo kandidatët për deputet sipas parashikimeve të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.



Sipas raportit të OSCE/ODIHR të vitit 2021¹⁷ Zgjedhjet parlamentare ishin përgjithësisht të organizuara mirë nga administrata zgjedhore. Administrata e re elektorale fitoi besimin e shumicës së grupeve të interesit.

Në zgjedhjet e ardhshme për Organet e Qeverisjes Vendore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka prioritet të tij:

- Realizimin e votimit elektronik në më shumë Qendra Votimi;

- Realizimin e procesit të votimit nga jashtë vendit, duke ju dhënë të drejtën e votës të gjithë shtetasve shqiptarë që jetojnë në diasporë dhe më gjerë;

- Garantimin e të drejtës themelore për zgjedhje të lira e të fshehta, ruajtjen e parimit të barazisë, heqjen e kufizimeve për shkak të aftësive të kufizuara, lehtësimin e informimit të pakicave kombëtare;

- Identifikimin, hetimin dhe ndjekjen penale në rastet e shitblerjes së votës, shpërdorimin e burimeve shtetërore;

- Nxitjen/promovimin për sigurinë e të dhënave personale dhe sigurinë juridike;

- Investim në programet e edukimit zgjedhor, informim në kohë për votuesit, me prioritet përfshirjen e votuesve për herë të parë dhe programe të dedikuara për nxitjen e rolit të grave në procesin zgjedhor;

- Digjitalizimi i të gjitha proceseve të punës që kanë të bëjnë kryesisht me regjistrimin e subjekteve politike, dorëzimi i raporteve financiare, monitorimi i fushatës zgjedhore e auditimi i fondeve, rekrutimi i stafit, komisionet zgjedhore.

2.1.3 Qeverisja

Qeveria qendrore përcakton vizionin dhe politikat kyçe dhe propozon legjislacionin për forcimin e demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Qeverisë/Këshillit të Ministrave (i përbërë nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Ministrat e Kabinetit) parashikohet në dispozitat themelore kushtetuese dhe në Ligjin Nr. 9000 datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Përsheptimi i reformave dhe përgatitja e vendit për t’u bashkuar me Bashkimin

Evropian mbetet një prioritet i madh i Qeverisë Shqiptare.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE 2030) është dokumenti kryesor strategjik për vendin, që paraqet drejtimet e përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, në rrugën e integritetit të tij në Bashkimin Evropian, përfshirë dhe ndërlidhjen me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, në funksion të arritjes së synimeve të Agjendës 2030.

SKZHIE 2030 përbën shtyllën kryesore të Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe orienton në nivel afatmesëm dhe afatgjatë politikat prioritare të zhvillimit të vendit. Ajo përbën dokumentin ombrellë, që siguron prioritetizimin e politikave në nivel afatmesëm dhe afatgjatë dhe shërben si dokument kuadër për të gjitha politikat dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale.

Aktualisht ka filluar procesi për hartimin e SKZHIE 2030, e cila do të shtrihet në harkun kohor dhjetëvjeçar 2021 – 2030, dhe vijon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2016 – 2020 (SKZHIE II) në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integritetit të saj në Bashkimin Evropian dhe integrimin me Agjendën 2030. Në dallim nga ciklet e mëparshme të kuadrit strategjik, SKZHIE 2030 synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht më të gjatë kohore.

Ka përfunduar procesi për identifikimin e prioritetëve afatmesme 2022 – 2024 dhe afatgjata 2024 – 2030, përmes përgatitjes së fushave të Politikave Prioritare që sigurojnë:

- Përgatitjen e tavanëve të buxhetit për periudhën 2022 – 2024;

- Identifikimin e prioritetëve për 2030, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030/Agjendës 2030.

Në kuadër të përgatitjes së SKZHI 2030, është angazhuar mbështetje me asistencë teknike nga OKB për hartimin e draftit të SKZHIE 2030, mbështetur në metodologjinë dhe termat e referencës të përgatitura nga DZHM – Ekspertizë e dedikuar për përgatitjen e draftit – (eksperti i përzgjedhur është duke punuar), si dhe ekspertizë e dedikuar përsëri nga OKB, për analizën e rritjes ekonomike dhe kostimin e SKZHIE 2030 (rishtazi janë përzgjedhur dy ekspertët e rekrutuar nga

¹⁷ <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>



OKB, të cilët kanë filluar punën për analizën e kostimit të SKZHIE III).

Me ndryshimet e fundit në kuadër të krijimit, organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndhmës, në varësi të Kryeministrit, e njohur edhe si State Agency for Strategic Programming and Aid Coordination (SASPAC)¹⁸, do të jetë kjo Agjenci e cila do të sigurojë hartimin, zbatimin dhe harmonizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjive sektoriale, bashkërendimin e ndihmës së huaj, bashkërendimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar.

Roli i KN

Kryenegociatori ka vijuar të monitorojë ecurinë e procesit të integritetit evropian dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në BE përmes takimeve dhe informimit periodik me Grupin Negociator. Gjatë takimeve, Kryenegociatori ka regjistruar rregullisht përditësimet mbi progresin e raportuar dhe komentet e parashtruara.

Në periudhën janar – dhjetor 2021, Kryenegociatori ka paraqitur rregullisht raporte javore për Këshillin e Ministrave, ku janë pasqyruar zhvillimet mbi ecurinë e përafrimit të legjislacionit dhe implementimin e angazhimeve të PKIE 2021 – 2023. Gjithashtu raportet javore përmbajnë mangësitë ligjore dhe administrative, informacion për punën dhe stadin ku ndodhen GNPIE-të, planet e detyrave në fushat e 33 kapitujve të *acquis* dhe 2 kriterëve, si dhe vlerësimi i nevojave për mbështetje që duhen filtruar dhe trajtuar si çështje nga Kryenegociatori. Në vijim të detyrave përgatitore, Kryenegociatori është koordinuar me negociatorët e kapitujve për hartimin dhe dorëzimin e tre raporteve tremujore për vitin 2021.

Kryenegociatori ka ndjekur dhe monitoruar rregullisht takimet javore të Drejtorive Juridike, mbi statusin e përmbushjes së masave ligjore PKIE 2021, për të adresuar problematikat mbi vonesat në instancat e larta vendimmarrëse.

Në periudhën janar – dhjetor 2021, Kryenegociatori, në koordinim me MEPJ dhe Negociatorët ka monitoruar mbledhjen e informacioneve periodike dhe mbarëvajtjen e

takimeve vjetore të Nënkomiteteve të Stabilizimit dhe Asociimit BE-Shqipëri duke përfshirë dhe Komitetin e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, ku ka marrë pjesë edhe Kryenegociatori. Informacionet shtesë dhe raportet përfundimtare të këtyre Nënkomiteteve i janë dërguar strukturave të Komisionit Evropian (KE).

Raportet përfundimtare të këtyre Nënkomiteteve, përpara se të dërgohen tek strukturat e Komisionit Evropian, janë konsultuar paraprakisht me Kryenegociatorin. Në rastet që ka qenë e nevojshme, materialet janë adresuar sërish tek institucionet kontribuuese nga Kryenegociatori, me propozimet apo vërejtjet mbi punën përgatitore, me qëllim intensifikimin e përpjekjeve për respektimin e afateve të përgatitjes së materialeve, mbulimin e të gjitha çështjeve dhe rritjes së qartësisë së raportimit.

Anëtarët e Grupit Negociator në bashkërendim me Kryenegociatorin, kanë dhënë mendim gjatë procesit të identifikimit të prioriteteve relevante me qëllim garantimin e mbështetjes për kapitujt specifikë gjatë hartimit të programimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian sipas kapitujve përkatës. Kryenegociatori ka marrë të gjitha masat që paketa e Dokumenteve të Veprimit për IPA 2021 dhe IPA 2022 si dhe Përgjigja Strategjike Kombëtare për IPA III (2021 – 2027) të dorëzohen në Bruksel brenda afatit.

Në periudhën janar – dhjetor 2021, Kryenegociatori ka ndjekur dhe monitoruar procesin e ngritjes dhe funksionimit të Platformave të Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), punimet mbi mbledhjet teknike të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për kapitujt respektivë të *acquis* si dhe në koordinim me MEPJ dhe Negociatorët ka përgatitur Kornizën Kombëtare Negociuese.

Gjatë vitit 2021, Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian, ka organizuar 7 takime periodike dhe ndërgjegjësuere. Kryenegociatori dhe kabineti i tij kanë marrë pjesë aktivisht në takimet më poshtë:

- **Në datën 25 janar 2021**, mbi “Hapjen e Negociatave të Anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe Miratimin e Planit të Masave për Përmbushjen e Përpërësive të Përcaktuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian”.

¹⁸ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 642, datë 29.10.2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndhmës”



- **Në datën 20 tetor 2021**, mbi prezantimin e “Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2021”.

- **Në datën 15 dhjetor 2021** në Tryezën e Rrumbullakët midis anëtarëve dhe të ftuarve të KKIE me 22 përfaqësues të Organizatave të shoqërisë civile mbi rolin dhe kontributin e OSHC-ve gjatë procesit të negociatave.

Kryenegociatori ka përgatitur draft-Pozicionin Nacional të Shqipërisë për K1NQ si dhe një manual ushtrimor me udhëzime për hartimin e Kornizave Negociuese të Kapitujve Negociues. Gjatë vitit të ardhshëm ky ushtrim do të realizohet për të gjithë kapitujt.

Kryenegociatori ka monitoruar nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe pjesëmarrjes fizike ose online, veprimtarinë e disa projekteve të asistencës teknike të kapitujve të *acquis* me qëllim që t’i kushtohet vëmendje e veçantë kapitujve të grupimit themelor. Në këtë kuadër, Kryenegociatori ka marrë Pjesë në seminare/*workshope* të ministrive të linjës dhe OJQ të huaja akredituar në Tiranë dhe jashtë vendit; veprimtari binjakëzim, etj.

Lidhur me bisedimet me BE, Kryenegociatori ka zhvilluar një seri takimesh me përfaqësues të Ministrive të Jashtme dhe Sekretarë Shteti të vendeve të BE-së lidhur me ecurinë e vendit drejt anëtarësimit. Gjithashtu, Kryenegociatori ka ndjekur dhe komunikuar me Komisionin Evropian nëpërmjet Delegacionit të BE në Tiranë, qëndrimet dhe shqetësimet e palës shqiptare mbi tekstet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, memorandumet, rekomandime/konkluzione, kryesisht në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Kryenegociatori ka realizuar takime të rregullta të dedikuara me shumicën e ambasadorëve të vendeve të BE-së të akredituar në Tiranë, si dhe ka kryer vizita në disa kryeqytete të vendeve të BE-së (duke përfshirë dhe tre vizita në Bruksel), pas të cilave është raportuar rregullisht tek Kryeministri për rezultatet kyçe të vizitave;

Se fundmi, Kryenegociatori ka marrë pjesë në konferenca dhe takime pune të nivelit të lartë, si për shembull konferenca rajonale “Future Europe”, organizuar nga Kryenegociatori e Malit të Zi.

Konferenca kishte për qëllim perspektivën e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt të ardhmes Evropiane. Temat e diskutuara ishin:

1. Ballkani Perëndimor – si pjesë e BE-së
2. Ndryshimi Klimatik dhe objektivat mjedisore
3. Investimi tek rinia në të ardhmen Evropiane

Kryenegociatori ka zhvilluar gjithashtu takime të vazhdueshme pune, lidhur me shkëmbimin e përvojave dhe transferimin e njohurive mes Kryenegociatorëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përmendet me notë të lartë, takimi produktiv zhvilluar me z. Vladimir Drobnjak, Kryenegociator i Kroacisë, i cili ka një përvojë të gjerë në përmbylljen me sukses të negociatave dhe ndjekjen e gjithë punës për Integrimin Evropian.

Reforma Administrative Territoriale

Zbatimi i reformës së decentralizimit vendor ka synuar qartazi që të rrisë përgjegjësitë e njësive të qeverisjes vendore në shumë sektor publik, kryesisht shërbime të cilat përgjithësisht pranohet se janë më eficientë kur ato ushtrohen nga niveli qeverisës që është më afër qytetarëve me qëllim fuqizimin e qeverisjes vendore dhe procesit të decentralizimit, garantimin e një efieciencie më të lartë të qeverisjes vendore dhe rritjen e autonomisë financiare dhe funksionale.

Në kuadër të vlerësimit afatmesëm dhe raporteve vjetore të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore dhe Planit të saj të Veprimit, të cilat analizojnë periudhën pas reformës, vizioni dhe objektivat e Reformës Administrative Territoriale janë arritur me sukses. Shumë përpjekje u bënë për të mbështetur procesin e konsolidimit territorial, administrativ dhe financiar nga qeverisja qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë. Aktorët si në nivelin qendror ashtu dhe në atë vendor besojnë se reforma ka bërë që bashkitë të rrisin aftësitë e tyre menaxheriale; kapacitetin e planifikimit të integruar; të rrisin kapacitetet për rritjen e të ardhurave nga burimet e veta; si dhe të sigurojnë shërbime më cilësore për qytetarët e tyre dhe të rrisin shkallën e mbulimit me shërbime. Një sërë arritjesh të rëndësishme kanë hedhur themelet për funksionimin e sistemit të ri të qeverisjes vendore që hyri në fuqi në 2015, përfshirë përpjekjet intensive për transferimin ligjor dhe inventarët financiarë e fizikë të bashkive të reja dhe krijimin e zyrave me një ndalesë, për të përmirësuar cilësinë dhe afatet kohore të shërbimeve administrative ndaj qytetarëve në nivel vendor.

**Shoqëria civile**

Udhërrëfyesi për Politikën e Qeverisë drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 25.7.2019, përmban tri drejtime strategjike dhe nëntë prioritete si më poshtë vijon:

Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunim i institucionalizuar qeveri – shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian;

Drejtimi Strategjik 2: Mundësimi i mjedisit ligjor dhe qeverisjes së të dhënave;

Drejtimi strategjik 3: Kuadër fiskal dhe financues i favorshëm.

Në kuadër të zbatimit të projektit “Mbështetje për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Politikën e Qeverisë” drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile (2019/413554), Kuvendi më datë 24 qershor 2021 miratoi Ligjin Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

Me qëllim implementimin e suksesshëm të Udhërrëfyesit për shoqërinë civile, me mbështetjen e BE-së, është marrë Asistencë Teknike (Support to the Implementation of the Road Map for the Government Policy Towards a More Enabling Environment for Civil Society Development (2019/413554)), e cila deri më tani, ka mbështetur Grupin e Punës përgjegjës për implementimin e Udhërrëfyesit. Nën mbështetjen e Asistencës Teknike janë arritur shumë objektiva të cilat janë parashikuar në Planin e Veprimit të Udhërrëfyesit:

1. Metodologjia që do të përdoret për monitorimin dhe raportimin e Udhërrëfyesit;

2. Analizë mbi modelet e regjistrimit të shoqërisë civile;

3. Plan komunikimi dhe ndërgjegjësimi;

4. Analizë mbi modalitetet e mbledhjes së të dhënave për OJF-të dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit aktual;

5. Plani i Veprimit për komunikimin dhe ndërgjegjësimin;

6. Analizë mbi bazën ligjore dhe funksionet e KKSHC-së;

7. Manual i standardeve ndërkombëtare për regjistrimin e OJF-ve;

8. Komente mbi përditësimin e ligjit për regjistrimin e OJF-ve;

9. Organizimi i 4 fushatave ndërgjegjësuere për shoqërinë civile;

10. Analizë mbi të dhënat e OJF-ve që do të hidhen në sistemin elektronik të regjistrimit të OJF-ve;

11. Dizenjimi i sistemit ueb për mundësitë e financimit të OJF-ve;

12. Propozimi teknik për sistemin elektronik të regjistrimit të OJF-ve dhe specifikimet teknike.

Të gjitha këto produkte kontribuojnë në përmirësimin e tre drejtimeve kryesore strategjike të parashikuara në Udhërrëfyes për shoqërinë civile.

2.1.4 Reforma në Administratën Publike

Reforma në Administratën Publike është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare e lidhur ngushtë me procesin e Integritetit Evropian. Zhvillimi i vendit dhe zbatimi i çdo reforme të ndërmarrë mund të arrihet vetëm duke pasur si themel një administratë publike që funksionon me përgjegjësi dhe profesionalizëm dhe përfshin në radhët e saj nëpunës të kualifikuar dhe të paanshëm që u shërbejnë qytetarëve me integritet dhe përkushtim.

Të gjitha këto parime të diktuar nga vizioni i qeverisë për përmirësimin, transformimin dhe digjitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve publike janë parashikuar nën kontekstin strategjik, ku dhe mbështetet zbatimi i reformës në administratën publike.

Që nga viti 2015 Qeveria Shqiptare ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike (SNRAP 2015 – 2022), e cila është baza mbi të cilën implementohet dhe monitorohet zbatimi i Reformës në Administratën Publike.

Kjo Strategji gjen mbështetje në vizionin dhe objektivat strategjike të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet (SKZHI 2015 – 2020) si dokumenti themelor strategjik që kombinon agjendën e integritetit në Bashkimin Evropian me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG/ OZHQ).

Korniza strategjike e Reformës në Administratën Publike është zgjatur deri në vitin 2022 për të siguruar mbështetjen strategjike për programin IPA 2019 – 2020 ku dhe është miratuar Plani i Veprimit 2018 – 2022 për vitet në vijim. Qëllimet kryesore të politikave strategjike në planin e ri 2018 – 2022 korrespondojnë me katër



shtyllat prioritare të strategjisë, të cilat janë fokusi kryesor i Reformës:

- Politikëbërja dhe cilësia e legjislacionit;
- Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike;
- Shërbimi Civil dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Procedurat administrative dhe mbikëqyrja.

Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave

Qeveria ka vijuar punën në drejtim të forcimit të sistemit të planifikimit strategjik, monitorimit të politikave dhe legjislacionit, raportimit dhe vlerësimit duke i shndërruar prioritetet e saj në veprime konkrete. Përmes ngritjes së sistemeve të informacionit për planifikimin e politikave dhe financave publike është synuar përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis ministrive, rritjes së transparencës për dokumentet strategjike të qeverisë dhe monitorimit në kohë reale.

Sigurimi i përgjegjshmërisë së qeverisjes ka qenë në nivele të larta nga ku rezulton se indeksi i zbatueshmërisë së standardeve të sistemit për hartimin e kuadrit strategjik për gjashtë-mujorin e parë të vitit 2022 paraqitet në 96.5%. Në këtë kuadër 75% të dokumenteve strategjike përmbushin cilësisht dhe në nivel të lartë protokollat e sistemit bazuar në parimet e mirëqeverisjes.

Vëmendje e veçantë është treguar dhe për strukturimin e kuadrit të performancës, i cili bën të mundur vlerësimin e gjendjes së kuadrit strategjik për vitin 2020¹⁹, si dhe progresin e bërë gjatë kësaj periudhe. Kuadri i performancës paraqet një sërë treguesish sasiorë dhe cilësorë, duke u fokusuar si në parakushtet e reformave të suksesshme (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira) ashtu edhe në zbatimin aktual të reformave dhe rezultateve që pasojnë këto reforma. Në këtë aspekt, progres është arritur dhe në kuadrin e performancës/monitorimit dhe raportimit (R&M) të kuadrit strategjik gjatë vitit 2020, ku në total janë hartuar 15 raporte monitorimi/performance në sektorë të rëndësishëm në nivel sektorial/ndërsektorial ku 40% të hartuara në fushën e zhvillimit dhe 60% në fushën e mirëqeverisjes, prej të cilave 87% janë finalizuar

dhe miratuar, ndërsa 13% janë akoma në fazë konsolidimi.

Në bazë të të dhënave për tremujorin e parë 2021 rezultojnë se (i) janë hartuar 6 paketa vlerësimesh në zbatim të Parimeve të Mirëqeverisjes në rolin e vlerësuesit të cilësisë (6 rishikime në total) nga ku (i) 34% kategorizohen sipas sistemit të vlerësimit në Kategorinë III: Cilësi e moderuar/përmbush pjesën më të madhe të standardeve dhe kanë përputhshmëri të pjesshme (ii) 33% kategorizohen sipas sistemit të vlerësimit në Kategorinë II: Cilësi e moderuar por nuk përmbush standardet e sistemit; (ii) 33% kategorizohen sipas sistemit të vlerësimit në Kategorinë I: Cilësi e dobët për përmirësim.

Krahasuar me tremujorin e dytë 2021 rezultojnë me trend rritës performanca nga ku (i) janë hartuar 9 paketa vlerësimesh në zbatim të Parimeve të Mirëqeverisjes në rolin e vlerësuesit të cilësisë (8 rishikime në total) dhe (i) 13% kategorizohen sipas sistemit të vlerësimit në Kategorinë III: Cilësi e moderuar/përmbush pjesën më të madhe të standardeve dhe kanë përputhshmëri të pjesshme (ii) 25% kategorizohen sipas sistemit të vlerësimit në Kategorinë II: Cilësi e moderuar por nuk përmbush standardet e sistemit; (ii) 62% kategorizohen sipas sistemit të vlerësimit në Kategorinë I: Cilësi e dobët për përmirësim.

Progres është arritur dhe në një nga objektivat kryesorë të sistemit të mirëqeverisjes që lidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës, duke pasur si komponent kryesor procesin e konsultimit publik. Për gjashtëmujorin e parë 2021 rezultojnë se Indeksi i konsultimit publik është 72.22% dhe shkalla e progresivitetit kap një trend progresiv pavarësisht se rezultatet përkojnë vetëm me gjysmën e parë të vitit. Shkalla e progresit ka një rritje me 50% krahasuar me vitin 2020 vs 2019 (krahasime me periudhat respektive). Ndërsa indeksi i cilësisë për këtë periudhë ka një trend rritës me koeficient konstant, që rezultojnë 4.94 pikë krahasuar me vitin 2020 (5.66) dhe 2019 (5.15 pikë) dhe sigurisht paraqitet një rritje e ndjeshme me vitin 2018 (3.27 pikë).

Për gjashtëmujorin e parë 2021 janë trajnuar 75% (305) e nëpunësve civilë të administratës publike për kuadrin metodologjik dhe procesin e konsultimit publik si dhe janë organizuar 25 workshope/webinare trajnimi OJT me fokus

¹⁹ Raportet Vjetore 2020 të hartuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021



rritjen e kapaciteteve dhe ekspertizës së njohurive të Koordinatorëve të Konsultimit Publik.

Në kuadër të vlerësimit të ndikimit, aktet ligjore të hartuara gjatë gjashtëmujorit të parë të 2021 kanë vijuar të kalojnë procesin e vlerësimit të ndikimit ku janë hartuar gjithsej 41 raporte RIA. Cilësia e akteve të hartuara dhe të shoqëruara me RIA për këtë periudhë është vlerësuar në nivel 76%.

Menaxhimi Financiar Publik

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vijuar me zbatimin e reformave të ndërmarra në fushën e menaxhimit të financave publike, të cilat materializohen në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022, e cila u miratua në 18 dhjetor 2019. Kjo strategji përbëhet nga shtatë objektiva specifike (OS), si:

- OS1: Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm;

- OS2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas;

- OS3: Mbledhja e të ardhurave;

- OS4: Zbatim efikas i buxhetit;

- OS5: Transparenca e financave publike;

- OS6: Kontroll i brendshëm efektiv;

- OS7: Mbikëqyrje efektive e financave publike.

Plani i Veprimit të Strategjisë së MFP-së u rishikua në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020.

MFE ndërmori një proces të plotë rishikimi të kornizës logjike të Strategjisë dhe planit të veprimit me një fokus të madh në treguesit, synimet dhe afatet kohore të tyre, në mënyrë që të marrë në konsideratë, ndikimin negativ të tërmetit në vitin 2019 dhe pandeminë e COVID-19 në arritjen e rezultateve të strategjisë së MFP-së.

Raporti i Monitorimit në zbatimin e Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022 është miratuar. Arritjet kryesore paraqiten si vijon:

- Ligji Organik i Buxhetit u ndryshua në Korrik të vitit 2020, duke shtuar rregulla të reja fiskale. Rregulli i ri kishte të bënte me bilancin primar, i cili duke filluar nga viti 2023 nuk mund të jetë negativ;

- Rishikimi Afatmesëm i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI II) u finalizua;

- U miratua VKM nr. 290, me qëllim krijimin e një baze të dhënash IPSIS që do të shërbejë si sistemi kryesor për planifikimin, analizën, përgatitjen, monitorimin e të gjitha dokumenteve strategjike;

- Në sistemin i ri AFMIS u bënë pjesë të gjitha Ministrinë e Linjës dhe Institucionet Buxhetore gjatë vitit 2020;

- Komiteti i Planifikimit Strategjik miratoi Dokumentin e Prioritetit të Politikave në Mars dhe në Korrik 2020;

- 15 Organizata të Shoqërisë Civile janë trajnuar mbi buxhetimin me pjesëmarrje dhe buxhetimin gjinor;

- Lista e Unifikuar e Projekteve është miratuar gjatë vitit 2020;

- U rishikua kuadri rregullator mbi proceset e Programit Buxhetor Afatmesëm në Njësitë e Qeverisjes Vendore;

- Janë publikuar Raportet e Detyrimeve të Prapambetura në Nivel Vendor;

- Të gjitha bashkitë kanë përgatitur “Raportin mbi Statusin e Vështirësive Financiare të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore”;

- Është miratuar Plani Kombëtar Sistematik i të Dhënave (NSPD) 2020 – 2027;

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përditësoi bazën e të dhënave të stokut të borxhit tatimor sipas planeve;

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave vazhdoi punën për përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator me *acquis* të BE-së: Udhëzime të përditësuara mbi Informacionin e Detyrueshëm Tarifor (IDT);

- Sidoqoftë, 110 nga 1100 institucione të reja buxhetore po përdorin WebPortal-i për arkivin elektronik;

- Testimi i integritetit me Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përfundoi me sukses;

- Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit përmirësoi parashikimin dhe monitorimin e likuiditetit. Parashikimi i likuiditetit është përgatitur dhe përditësuar në baza ditore dhe mujore;

- Strategjia e Menaxhimit të Borxhit 2021 – 2023 u miratua në janar 2021;

- U krye analiza e sjelljes së tregjeve të huamarrjes vendore dhe të jashtme;

- Një Ligj i ri i Prokurimit Publik (Ligji Nr. 162/2020) u miratua nga Parlamenti më 24 Dhjetor 2020, dhe gjithashtu Rregullat e reja të Prokurimit Publik janë miratuar në Maj 2021 përmes VKM Nr. 285, datë 19.05.2021;



– Sistemi i apelimit elektronik i Komisionit të Prokurimit Publik, i cili konsiston në krijimin e një sistemi të menaxhimit të ankesave, është duke u finalizuar;

– U krijua integrimi i *Sistemit të Informacionit Financiar të Qeverisë Shqiptare* AGFIS me Sistemin e Prokurimit Elektronik;

– Sistemi Informatik për Menaxhimin e Ndhmës së Huaj (EAMIS) po plotësohet me të dhëna të futura nga pikat e kontaktit të gjashtë Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim, nga 40 në total;

– U përmirësua baza e të dhënave të skemave të ndihmës shtetërore dhe u përgatit raporti vjetor i ndihmës shtetërore; Janë lançuar 3 skema të reja të ndihmës shtetërore (nga 2 të planifikuara);

– INSTAT publikoi dokumentin “Harmonizimi i Politikave Revizionuese për Statistikat Makroekonomike”;

– U përgatit dhe u publikua një Udhëzues për Buxhetin për Qytetarët;

– Është përgatitur dhe zbatuar një kalendar i seancave dëgjimore të buxhetit me proceset kryesore buxhetore;

– Tre Institucione Buxhetore i regjistruan asetet në modulën e aseteve në AGFIS;

– U miratua Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) 2021–2022 në Shqipëri;

– U miratua Udhëzimi “Për delegimin e detyrave të punonjësve në njësitë e sektorit publik”;

– U miratua metodologjia e vlerësimit të cilësisë së kontrollit të brendshëm;

– U krijuan baza të të dhënave të ndara për gjetjet dhe rekomandimet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) dhe Auditit të Brendshëm (AB);

– Manuali i Auditit të Brendshëm u rishikua në janar të vitit 2020 me qëllim përmirësimin e cilësisë së raporteve të auditimit të brendshëm;

– U përgatit Plani Vjetor i Auditimit bazuar në metodologjinë e rishikuar të bazuar në risk;

– Është rishikuar kuadri rregullator si manualët e përputhshmërisë, financiare dhe të auditimit të performancës dhe është ndryshuar Rregullorja e Auditimit;

– Është miratuar manuali i ri “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe Regjistrin Institucional të Rekomandimeve”.

Më datë 25 nëntor 2021, Kuvendi i Shqipërisë miratoi buxhetin e qeverisë për vitin 2022.

Prioritetet

Prioritetet e qeverisë në fushën e financave publike, vijnë të qëndrojnë të njëjta si para pandemisë, por me një angazhim në rritje, konkretisht si:

– Reduktimi i borxhit publik;

– Shlyerja dhe parandalimi i detyrimeve të prapambetura;

– Mobilizimi i vazhdueshëm për mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore;

– Përmirësimi i menaxhimit të projekteve të investimeve publike duke përfshirë Partneritetin Publik Privat dhe dhënien me koncesione;

– Sigurimi i një lidhjeje më të mirë të planeve strategjike me Programin Buxhetor Afatmesëm;

– Një angazhim më të strukturuar dhe në kohë me qytetarët, me organizatat e shoqërisë civile dhe me akademinë në planifikimin, monitorimin dhe raportimin e buxhetit;

– Rritja e përpjekjeve për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve dhe gjetjeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Shërbimi Civil dhe menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Shqipëria konsiderohet tashmë një lider në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Publike duke u renditur e para në Ballkanin Perëndimor për ecurinë e përmbushjes së një prej parimeve kryesore dhe më të rëndësishme të Reformës në Administratën Publike të përcaktuar nga SIGMA/OECD²⁰.

Departamenti i Administratës Publike mbështetur nga ekspertiza e projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në të gjithë administratën publike” ka vijuar punën për hartimin dhe harmonizimin e përshkrimeve të punës për ministrinë e linjës dhe përfundimin e tyre për të tre shtyllat kryesore (sipas organizimit strukturor) që kanë të bëjnë me (i) politikën dhe zhvillimin e sektorëve në fushën e përgjegjësisë; (ii) aspektin rregullator dhe përputhshmërisë; (iii) aspektin ekonomik dhe të shërbimeve mbështetëse.

²⁰ <http://www.sigmaweb.org/publications/principles-public-administration-overview-alb.pdf>



Në të njëjtën linjë me rishikimin e përskrimeve të punës, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim të ngushtë me ekspertizën e projektit ka identifikuar dhe hartuar proceset e rrjedhës së punës në ministritë e linjës duke detajuar proceset horizontale/të ngjashme dhe ato vertikale që janë specifike për secilën ministri. Kështu, janë identifikuar procese analoge horizontale të punës në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Integrimi në BE dhe hartimi i projekteve IPA; Hartimi i legjislacionit dhe Vlerësimi i Ndikimit Rregullator; Financimi dhe buxheti si dhe dizenuar 20 procese horizontale.

Në lidhje me përgatitjen për miratimin e politikës së pagave për nëpunësit civilë është krijuar një dokument i politikës së pagave i cili përcakton elementët dhe mënyrën e zbatimit të sistemit të pagave. Reforma e sistemit të pagave dhe zbatimi i saj është një mekanizëm i rëndësishëm që synon rritjen e motivimit dhe performancës së nëpunësve civilë si dhe të bëjë më tërheqëse administratën publike për profesionistë të kualifikuar dhe në përputhje me parimin “Paga e njëjtë për punë të njëjtë”.

Edhe pse situata pandemike ka ndikuar në këtë proces, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga takimi i Grupit të Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE – Shqipëri (PAR SG), është krijuar dhe po ndiqet me prioritet plani i detajuar i punës me fazat dhe hapat konkretë drejt finalizimit dhe miratimit të dokumentit të politikës së pagave për të bërë të mundur realizimin e një reforme kaq të rëndësishme. Implikimet buxhetore për këtë periudhë raportimi janë përlogaritur për katër institucione.

Synohet që gjatë 6-mujorit të parë të vitit të ardhshëm të bëhen llogaritjet e kostos për një numër më të madh institucionesh, në mënyrë që, bazuar në fondet në dispozicion, të mund të përcaktohet se si do të bëhet implementimi i dokumentit të rishikimit të sistemit të pagave. Me qëllim rregullimin e mëtejshëm të performancës së nëpunësve civilë është finalizuar manuali i vlerësimit të rezultateve në punë. Ky manual përfshin ndër të tjera edhe rekomandime për ndryshime ligjore të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi, amendime për të cilat DAP tashmë ka filluar të punojë.

Lidhur me finalizimin dhe ndërtydhjen e Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

(SIMBNJ) me sistemin e thesarit dhe shkëmbimin e të dhënave midis sistemeve, tashmë është vendosur lidhja midis SIMBNJ dhe thesarit. Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 833, datë 28.10.2020, i cili përcakton detyra të qarta për institucionet publike, ka qenë një zhvillim pozitiv për sa i përket përgjegjshmërisë së institucioneve në zbatimin e kësaj baze ligjore dhe përditësimin e vazhdueshëm dhe periodik të sistemeve.

Gjithashtu, në maj 2021 midis DAP dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është nënshkruar udhëzimi i përbashkët nr. 1, datë 21.05.2021 “Për formën, elementët dhe plotësimin e listëpagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Ky proces do të pasohet me një plan trajnimi për të bërë të mundur ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve në fushën e burimeve njerëzore dhe financave për gjenerimin e listës së pagave përmes sistemit.

Në vijim të këtij udhëzimi, DAP dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë kanë hartuar një plan pune për institucionet/njësitë shpenzuese me qëllim gjenerimin e listës së pagesave mujore përmes SIMBNJ dhe dorëzimin automatik të tyre në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) dhe kryerjen e trajnimeve përkatëse për të gjithë përdoruesit nëpërmjet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.

Deri më tani, në koordinim me MFE-në (me mbështetjen teknike të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit), janë më shumë se 25 institucione që kanë zbatuar planin e trajnimeve.

Gjithashtu, ndryshimet e diktuar nga VKM nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrat qendror të personelit” dhe Udhëzimit nr. 1 datë 21.05.2021 u akomoduan në sistemin e SIMBNJ (listëpagesa e unifikuar dhe urdhër shpenzimi për pagat).

Për sa i përket standardizimit të procesit të rekrutimit, një mjet i rëndësishëm efikas në këtë drejtim ka rezultuar dhe përdorimi i platformës “Administrata.al”. Platforma e krijuar për të bërë të mundur identifikimin dhe standardizimin e procedurave dhe praktikave në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka lehtësuar punën duke vënë në dispozicion të nëpunësve civilë në nivel qendror dhe lokal të gjithë kuadrin



ligjor, modele të gatshme, module me hapa të detajuar për proceset e rëndësishme të menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil si ristrukturimi, rekrutimi, vlerësimi i performancës, përshkrimi i punës, proceset gjyqësore etj.

Që nga krijimi i kësaj platforme është bërë progres i konsiderueshëm për të përfshirë modulet përkatëse të cilat lehtësojnë dhe unifikojnë punën e nëpunësve civilë në fushën e Burimeve Njerëzore në nivelin qendror dhe lokal.

Përveç moduleve, platforma përmban gjithashtu: (i) proceset kryesore të punës në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; (ii) seksionin e raporteve; dhe (iii) setin e indikatorëve kryesorë në fushën e raportimit. Për të njohur dhe përdorur këto module në fushën e Burimeve Njerëzore, më shumë se 175 punonjës (përdorues të portalit) janë trajnuar gjatë vitit 2021.

Gjithashtu, në përputhje me miratimin e manualit praktik “Për zbatimin e Kodit të Procedurave Administrative”, u zhvilluan trajnime për sqarimin e parashikimeve të Kodit të ri të Procedurave Administrative dhe zbatimin uniform të dispozitave gjatë ushtrimit të funksioneve nga administrata publike. Kështu, trajnimet për kuadrin ligjor të Shërbimit Civil dhe Kodin e ri të Procedurave Administrative janë zhvilluar për këtë periudhë raportimi (dhjetor 2020 – gusht 2021) në nivel vendor, ku u trajnuan 347 punonjës të Njërive të Qeverisjes Vendore, të cilët u njohën me manualët dhe udhëzimet e hartuara për Menaxhimin e burimeve njerëzore, setin e indikatorëve dhe SIMBNJ.

DAP ka vazhduar të monitorojë modulin online (bazën e të dhënave) në lidhje me vendimet gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore në platformën www.administrata.al për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore. Departamenti i Administratës Publike ka bashkëpunuar me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil duke ndihmuar dhe monitoruar të gjithë procesin, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe afatet kohore për Komisionet Speciale të ngritura në secilin institucion. Gjatë periudhës janar – shtator 2021 janë ekzekutuar 65 vendime gjyqësore.

Gjatë periudhës janar – tetor 2021 të dhënat statistikore të ASPA në drejtim të forcimit të kapaciteteve tregojnë zhvillim pozitiv dhe në rritje.

Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në bashkëpunim me ASPA-n, ka nisur procesin e

trajnit të NJBNJ në administratën vendore, me trajnues stafin e Komisionerit.

Në lidhje me procedurat administrative dhe mbikëqyrjen në institucionet e pushtetit qendror, vendor dhe ato të pavarura, ka vijuar veprimtaria e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për nxjerrjen e udhëzimeve dhe rekomandimeve në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në shërbimin civil bazuar në problematikat e evidentuara.

Në adresim të rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2021, në seancën e datës 11.11.2021 të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë, gjatë shqyrtimit të projektligjit për buxhetin e vitit 2022, u miratuan edhe propozimet e Komisionerit për ndryshime në strukturën e institucionit.

Prioritet kryesorë për vitin e ardhshëm janë:

- Hartimi i strategjisë së re të Reformës në Administratën Publike (brenda 2022/2023):

- (i) vlerësimi i situatës ekzistuese dhe analiza e masave dhe treguesve për të shmangur mbivendosjen me strategjitë e tjera nën ombrellën e RAP;

- (ii) përcaktimin e fushave prioritare ku do të mbështetet strategjia e re, kostimi, konsultimi;

- (iii) miratimi i strategjisë së re.

- Integrimi Evropian vijon të mbetet prioritet i shkollës shqiptare të administratës publike. Rritja e kapaciteteve të administratës publike në këtë fushë mbetet fokus i ASPA;

- Rritja e kapaciteteve të nëpunësve civilë për zbatimin rigoroz të legjislacionit të shërbimit civil nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve në nivel qendror dhe lokal për përdorimin e platformës “Administrata.al” si dhe ndërgjegjësimin për përfitimet që sjell përdorimi i platformës në unifikimin dhe zbatimin e procedurave në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;

- Përdorimi dhe raportimi i vazhdueshëm nga institucionet në Regjistrin Qendror të Personelit (SIMBNJ) dhe platformën e bashkëpunimit “administrata.al” sipas dispozitave të akteve nënligjore që rregullojnë përdorimin e tyre;

- Avancimi drejt zbatimit të reformës së pagave;

- Ngritjen e kapaciteteve të punonjësve për të përdorur formatet dhe standardet e reja të sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë për të siguruar një sistem objektiv dhe të drejtë të vlerësimit të

performancës si një kusht i domosdoshëm për motivimin e nëpunësve civilë që çon në një angazhim dhe përkushtim më të lartë në shërbim të publikut.

Ofrimi i shërbimit për qytetarët e bizneset

Në vitet e fundit, Shqipëria është bërë një shembull praktik i mirë për t'u ndjekur në drejtim të transformimit digjital. Transformime të cilat sigurojnë drejtësi, komoditet për qytetarët dhe godasin fenomenin e korrupsionit. Këto ndryshime janë pjesë e realitetit të përditshëm dhe janë vlerësuar gjithashtu edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare. Sipas raportit të Kombeve të Bashkuara, Shqipëria u rendit e 59-ta në botë për indeksin e qeverisjes elektronike dhe u ngjiti në vendin e 31 për shërbimet online, duke lënë pas të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) e ka vlerësuar Shqipërinë si të vetmin vend në Ballkanin Perëndimor që plotëson të gjithë treguesit e qeverisjes digjitale, ndërsa Departamenti Amerikan i Shtetit ka vlerësuar për dy vitet e fundit me radhë platformën e-Albania, si një përparim i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve online, veçanërisht në luftën kundër korrupsionit. Gjatë dy viteve të fundit, Komisioni Evropian ka vlerësuar progresin e bërë në shërbimet e qeverisjes elektronike dhe ka theksuar ndikimin e tyre në uljen e korrupsionit dhe informalitetit. Gjithashtu Shqipëria është vlerësuar me çmimin për qeverisjen digjitale nga ReSPA (iniciativa e BE-së) dhe OECD/SIGMA për zbatimin e praktikave, iniciativave, shërbimeve online dhe masave efektive për të përballuar krizën e koronavirusit.

Aktualisht çdo aplikim për shërbime publike bëhet vetëm online nëpërmjet platformës unike qeveritare e-Albania, ku qytetarët dhe bizneset marrin 95% të shërbimeve nëpërmjet kësaj platforme, pa radhë dhe pa pagesa fizike. **Portali qeveritar e-Albania ofron mbi 1209 shërbime elektronike.** Portali numëron mbi **104 milionë transaksione (janar – korrik 2021) mes sistemeve të ndërlidhura ku 55 sisteme elektronike** janë lidhur në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale dhe mundësuar më tepër shërbime elektronike tek qytetarët. Në platformën e-Albania janë të regjistruar 2.2 milionë përdorues dhe 12.5 milionë aplikime për shërbime publike.

Qytetarët mund të marrin çdo dokument, nga certifikatat personale deri te certifikatat e pronës, të paguajnë faturat mujore, shërbimet shëndetësore, të marrin certifikata gjyqësore, certifikata sigurimi dhe çdo shërbim tjetër komunal. E njëjta gjë vlen edhe për bizneset. Mjafton një klikim për të mbyllur çdo detyrim me shtetin. Qytetarët dhe bizneset nuk mbledhin më dokumente shoqëruese të prodhuara nga shteti, pasi të gjitha dokumentet administrative shoqëruese sigurohen nga vetë institucionet, me nënshkrim ose vulë elektronike dhe monitorohen në kohë reale afatet për mbledhjen e dokumentacionit shoqërues për dosjen e aplikantit.

Lidhur me shërbimet publike për këtë periudhë **numri i zyrave të përbashkëta ADISA të cilat ofrojnë shërbime publike është rritur në 23 qendra në total.** Gjatë kësaj periudhe është hapur zyra në Tepelenë dhe në Himarë ku janë mundësuar shërbime publike për qytetarë të cilët asistohen për marrjen e shërbimeve online përmes portalit e-albania.

Prioritet kryesor për vitin e ardhshëm janë:

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka si prioritet digjitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve ekzistuese, duke rritur nivelin e automatizimit të tyre me qëllim ofrimin e dokumentit elektronik përfundimtar për qytetarin dhe biznesin.

- Realizmi i investimeve për të bërë të mundur shtrirjen e ADISA në territor nëpërmjet qendrave të integruara dhe zyrave të përbashkëta me një ndalesë pranë ambienteve të bashkive

- Funksimi i qendrave të integruara dhe kanaleve të tjera të shërbimit nuk do të ishte i plotë pa monitorimin dhe vlerësimin rigoroz të performancës për të ndihmuar në identifikimin e mënyrave për të përmirësuar vazhdimisht aktivitetin e qendrave/sportelevë të shërbimit kundrejt objektivave dhe synimeve. Vlerësimi i performancës së ADISA për sportelet e shërbimit synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët dhe rritjen e kënaqësisë së përgjithshme të përdoruesve të shërbimeve.

- Krijimi dhe zbatimi i standardit të menaxhimit të cilësisë në të gjitha qendrat e integruara si dhe sigurimi që mjetet e kontrollit të cilësisë të paraqiten gjithashtu në të gjitha institucionet publike që ofrojnë shërbime në sportel.



2.1.5 Sistemi gjyqësor dhe reforma në sistemin e drejtësisë

Për më shumë informacion referohuni tek Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.

2.1.6 Anti-korrupsioni

Lutemi referohuni tek Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.

2.2 Të drejtat e njeriut

Lutemi referohuni tek Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”.

2.3 Çështjet rajonale dhe detyrimet ndërkombëtare

2.3.1 Bashkëpunimi rajonal

Prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në rajon është promovimi dhe kontributi në stabilitetin politik, paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik nëpërmjet bashkëpunimit si në nivel dypalësh ashtu edhe në atë shumëpalësh. Një rajon i sigurt dhe politikisht i qëndrueshëm që zhvillon lidhjet e duhura ekonomike brenda tij dhe me pjesën tjetër të botës, i shërben interesave kombëtare të Shqipërisë, por është edhe në interes të të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të fqinjëve tanë.

Shqipëria mbetet një pjesëmarrëse dhe përfituese aktive e Procesit të Berlinit, që synon, ndër të tjera, thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar brenda Ballkanit Perëndimor.

Duke iu referuar Samitit të Berlinit 2021, vlerësojmë se bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës është një faktor themelor për partnerët e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE dhe jo një zëvendësues i anëtarësimit. Ne përgëzojmë koordinimin pozitiv midis projekteve të nisura në kuadër të Procesit të Berlinit dhe politikave të BE-së, me fokus të veçantë në Planin Ekonomik dhe të Investimeve, Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe Tregun e Përbashkët Rajonal. Ne e pranojmë se Plani Ekonomik dhe i Investimeve është i përqendruar në projektet e transportit të qëndrueshëm, energjisë së pastër dhe lidhjes digjitale të zbatuara përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Në fushën e lidhjes digjitale, ne njohim zbatimin e plotë të Marrëveshjes Rajonale për Roaming dhe fillimin e regjimit të roamingut falas në Ballkanin Perëndimor që nga 1 korriku 2021. Ne kemi vullnetin për të vazhduar punën në *Draft Roadmap* për Uljen e Tarifave të roamingut ndërmjet BE-së dhe BP. Ulja e tarifave të roamingut ndërmjet BE-

së dhe BP është në përputhje me Masat në mbështetje të një Agjende Digjitale për Ballkanin Perëndimor, agjendën e Tregut të Përbashkët Rajonal 2021 – 2024 dhe angazhimin e drejtuesve të BP për të punuar ngushtë me të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë qeveritë dhe operatorët telefonik si nga BP ashtu edhe nga BE, në mënyrë që të mbështesin zbatimin e një udhërrëfyese për të lehtësuar uljen e kostove të roaming midis BE-së dhe BP. Ne e pranojmë se arrijtjet e Korridoreve të Gjellbra rajonale janë; fluksi i furnizimeve bazë mjekësore dhe ushqimore gjatë pandemisë COVID-19. Korridoret e Gjellbra ishin një shembull i shkëlqyer sesi bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës mund të lehtësojë një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj efekteve shkatërruese të krizës.

“Open Balkan” aktualisht një bashkëpunim mes tre vendeve të rajonit, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, synon të zbatojë sa më shpejt të jetë e mundur, katër liritë e BE-së, lëvizjen e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, që do të zbatohen në të gjithë rajonin. Kjo nismë do t’u mundësojë vendeve bashkëpunuese të rajonit hapjen e kufijve për të lehtësuar jetën e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Nisma mbështetet nga SHBA dhe BE dhe është në përputhje me Planin e Tregut të Përbashkët Rajonal të Procesit të Berlinit, pra në vetvete “Ballkani i Hapur” është një mekanizëm i procesit të Berlinit. Kjo nismë duhet parë si një lëvizje e parë e suksesshme për rajonin dhe ndihmon në integrimin në BE të vendeve tona, forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe gjenerimin e rritjes ekonomike. Ballkani i Hapur gjithashtu plotëson bashkëpunimin rajonal në kuadrin e nismave të ndryshme rajonale, si Tregu i Përbashkët Rajonal, Agjenda Digjitale, Lidhshmëria, Agjenda e Gjellbër e BP, Korridoret e Gjellbra dhe Procesi më i gjerë i Berlinit. Kjo nismë është në funksion dhe plotëson përpjekjet e vendeve të rajonit drejt integritimit në BE.

Ballkani i Hapur mbetet i hapur për të gjitha vendet e rajonit dhe është konceptuar si një nismë gjithëpërfshirëse rajonale.

Republika e Kosovës

- Republika e Shqipërisë ka marrëdhënie të shkëlqyera me Republikën e Kosovës, bazuar në Deklaratën e Përbashkët për Bashkëpunim dhe Partneritet Strategjik. Nuk ka çështje të pazgjidhura midis dy vendeve. Punohet intensivisht për



thelimin e marrëdhënieve ekonomike dhe për të rritur vëllimin e tregtisë;

- Bashkëpunimi midis dy vendeve konsiderohet strategjik, stabilizues për rajonin dhe orientues për perspektivën Euro-Atlantike;

- Partneriteti Strategjik me Kosovën zbatohet përmes marrëveshjeve dhe protokolleve të nënshkruara gjatë shtatë takimeve ndërqeveritare (G2G) (G2G7 me 26 nëntor 2021) që kanë ndodhur deri më tani. Ato kanë mundësuar një paketë për të zhvilluar marrëveshje bilaterale që mbulojnë të gjitha fushat e bashkëpunimit, përfshirë zhvillimin e tregtisë, bashkëpunimin midis autoriteteve doganore, infrastrukturën e transportit, bashkëpunimin energjetik, bujqësinë, turizmin, arsimin, bashkëpunimin kulturor, por edhe bashkëpunimin e sigurisë, lehtësimin e kontrollit të kufirit procedurat, luftën kundër krimit të rëndë dhe të organizuar, zbatimin e politikës së jashtme, dhe më shumë;

- Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht dialogun e drejtuar nga BE midis Kosovës dhe Serbisë, rezultati përfundimtar i së cilës duhet të jetë një Marrëveshje e detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellët mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës.

- Vlerësohet bashkëpunimi ekonomik aktual me Kosovë, si dhe gatishmëria e të dy vendeve për të forcuar më tej këtë bashkëpunim.

Bosnje dhe Hercegovina

- Marrëdhëniet me Bosnjë dhe Hercegovinën (BiH) janë të mira me gatishmëri për të intensifikuar dialogun politik.

- Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht sovranitetin, integritetin territorial, kohezionin shoqëror të Bosnjë dhe Hercegovinës, si dhe përparimin e saj në rrugëtimin Euro-Atlantike;

- Shqipëria është e vendosur kundër çdo përpjekje destabilizuese dhe retorikës “separatiste” që vjen nga brenda dhe jashtë Bosnje dhe Hercegovinës;

- Shqipëria ndjek me shumë shqetësim rritjen e tensioneve më të fundit etnike në vend, përpjekjet e liderëve serbë të BiH për t'u tërhequr nga institucionet e përbashkëta shtetërore, veçanërisht nga forcat e armatosura të përbashkëta të BiH.

- Shqipëria pret nga Bosnje dhe Hercegovina më shumë angazhim në bashkëpunimin rajonal,

përfshirë përfshirjen e të gjashtë vendeve të BB në iniciativat rajonale, si dhe një qëndrim më të hapur ndaj përfshirjes së Republikës së Kosovës në mekanizmat e bashkëpunimit rajonal;

- Shqipëria beson se ka ardhur koha për të miratuar një pozicion të ri ndaj Kosovës dhe duhet të rishikojë njohjen e dokumenteve të Republikës së Kosovës dhe lehtësimin e regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës;

- Vëllimi i tregtisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinës mbetet modest. Ndërsa një regjim pa viza ka qenë në fuqi që nga viti 2010, në vitin 2018 u mundësua udhëtimi i qytetarëve nga të dy vendet vetëm me letërnjoftim.

Serbia

- Qeveria shqiptare i nënkupton marrëdhëniet dypalëshe me Serbinë në dritën e implikimeve dhe ndikime të shumëfishta në nivel rajonal, përfshirë Kosovën dhe shqiptarët që jetojnë në rajon;

- Prej janarit 2021 mes dy vendeve tona është bërë efektive marrëveshja për lëvizjen e lirë të qytetarëve tanë me letërnjoftime;

- Shqipëria ruan një vëmendje të veçantë për shqiptarëve që jetojnë në jug të Serbisë dhe kërkon për ta, më shumë respekt dhe përfshirje në jetën socio-ekonomike të vendit të tyre, në përputhje me normat ndërkombëtare dhe të drejtën evropiane;

- Një çështje e rëndësishme për ne është çregjistrimi i adresave të shqiptarëve, më së shumti në Medvegje. Adresat e fshira në komunën e Medvegjes nuk janë një rast i izoluar, por një politikë e vazhdueshme që i privon ata nga të drejtat themelore.

- Shqetësim mbetet edhe përdorimi i vazhdueshëm i gjuhës dhe termave diskriminuese ndaj popullit shqiptar dhe pakicës shqiptare nga autoritetet e larta në Republikën e Serbisë.

- Shqipëria mbështet fuqimisht dialogun Kosovë – Serbi të udhëhequr nga BE, rezultati përfundimtar i së cilës duhet të jetë një Marrëveshje e detyrueshme ligjore, që mundëson njohjen e ndërsjellët mes dy vendeve, anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe BE, si dhe trajtim të drejtë të minoriteteve, konform Kushtetutës së Kosovës.

- Shqipëria pret që pala serbe të jetë e drejtpërdrejtë dhe e sinqertë në dialogun me Kosovën;

- Ekziston një ofensivë diplomatike e vazhdueshme nga Serbia kundër shteteve të



ndryshme në mënyrë që të tërhiqet njohja e KS dhe të pengohet anëtarësimi i Kosovës në nismat më të rëndësishme rajonale. Kjo ofensivë është kundër frymës së bashkëpunimit rajonal, Procesit të Berlinit dhe Dialogut të lehtësuar nga BE. Serbia duhet të ndalojë këtë ofensivë, në kundërshtim me Ligjin Ndërkombëtar dhe minimin e stabilitetit rajonal;

Mali i Zi

– Marrëdhëniet me Malin e Zi janë shumë të mira, miqësore dhe vijnë të intensifikohen më tej. Një marrëdhënie dinamike dhe produktive ka prodhuar një bashkëpunim dypalësh në rritje. Shqipëria mirëpret përparimin e bërë nga Mali i Zi gjatë negociatave të pranimit në BE;

– Pas Mbledhjes së Parë të Përbashkët të dy Qeverive në Shkodër (2018), të dy vendet po punojnë për të përgatitur G2G të dytë këtë vit. Konsultimet për çështje të ndryshme janë mbajtur rregullisht;

– Bashkëpunimi ndërkufitar u forcua me projekte konkrete që përmirësojnë infrastrukturën në të dy anët e kufirit;

– Shembull shumë pozitiv i bashkëpunimit konkret është hapja e pikës së përbashkët kufitare Grabom – Zatrijebacka Cijevna, në praninë e kryeministrit Rama dhe kryeministrit Krivokapic (29 korrik 2021);

– Shqipëria mbetet e përkushtuar për të punuar me faktorin politik, përfshirë faktorin shqiptarë, në Mal të Zi dhe thekson vullnetin për të bashkëpunuar më tej me çdo qeveri që ka në agjendën e saj perspektivën Euro-Atlantike;

– Ka pasur një shkëmbim intensiv gjithashtu në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, në kuadrin e pranimit në BE, NATO, Procesi i Berlinit dhe Iniciativa Trepalëshe Shqipëri – Mali i Zi – Kroaci.

– Të dy qeveritë janë të përkushtuara për të punuar drejt rritjes së vëllimit të tregtisë që aktualisht mbetet modeste;

Maqedonia e Veriut

– Marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut janë intensifikuar dhe vazhdojnë të jenë veçanërisht të mira dhe miqësore. Dialogu ndërshtetëror midis qeverive është i qëndrueshëm, i fortë dhe i integruar përmes bashkëpunimit të gjerë dypalësh në shumë sektorë dhe fusha;

– Dialogu politik progresiv me shkëmbimet e vizitave në nivelet më të larta janë intensifikuar me

vizitat e ndërsjella në nivelin e kreut të shtetit, kryetarët e parlamenteve, kryeministrit, ministrat e punëve të jashtme dhe të tjerë;

– Shqipëria mirëpret përpjekjet dhe arritjet e qeverisë së Maqedonisë së Veriut për të ndërtuar një shoqëri funksionale multi-etnike bazuar në zbatimin e plotë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe Ligjit për Gjuhët dhe shpreson që autoritetet në Shkup të bëjnë përpjekje të mëtejshme për këtë çështje;

– Të dy vendet po punojnë për të përgatitur G2G 2. Një agjendë ambicioze po diskutohet për takimin e dytë të përbashkët qeveritar në Maqedoninë e Veriut, i cili përfshin forcimin e lidhjes, përfundimin e korridoreve të infrastrukturës, energjisë dhe lëvizshmërisë, me një fokus të veçantë në projektet madhore të infrastrukturës dhe lidhjes së energjisë: si Korridori i 8-të, Segmenti Durrës – Elbasan – Shkup;

Rruga e Arbrit dhe shtrirja në segmentin Bllata – Shkup; Përfundimi i interkonektorit 400 KV; Ndërtimi i hekurudhës Kiçovo – Ohër me shtrirje deri në Lin; Pika e përbashkët doganore dhe e Kalimit Kufitar në Qafë – Thanë.

– Vëllimi i tregtisë megjithëse relativisht modest është në një trend rritës.

Greqia

– Marrëdhëniet me Greqinë mbeten të mira. Greqia është një fqinj i çmuar, por edhe partneri i Shqipërisë në rrugën e saj drejt demokracisë, progresit dhe integritetit evropian;

– Për vite Greqia ka qenë në krye të listës së partnerëve në tregti dhe investime të huaja direkte. Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Shqipërisë është orientuar drejt Greqisë, duke i bërë ekonomitë e të dy vendeve fort të ndërlidhura ndërmjet tyre. Të dyja vendet kanë dëshirë të thellojnë akoma më shumë bashkëpunimin ekonomik dhe rritjen e prezencës së investimeve greke në fushën e energjisë, turizmit, transportit, infrastrukturës, agrikulturës etj;

– Arritjet në bashkëpunimin dypalësh përfshijnë zbatimin e marrëveshjes për kërkimin, zhvarrosjen, identifikimin dhe varrosjen e ushtarëve grekë të rënë në territorin shqiptar gjatë luftës greko – italiane të 1940 – 1941, tërheqjen e rezervës greke për Vulën Apostile ndaj Shqipërisë, finalizimi i suksesshëm i rishikimit të teksteve shkollore,



nënshkrimi i marrëveshjes për njohjen reciproke të lejeve të drejtimit, më 18 janar 2021 të dy vendet nënshkruan një marrëveshje për ngritjen e një qendre të përbashkët të bashkëpunimit kufitar dhe më 26 janar 2021 u firmos marrëveshja për akordimin e një granti prej 2,5 milion eurosh, me qëllim rindërtimin e një shkolle profesionale në kompleksin “5 Maji” në Tiranë në kuadër të rindërtimit pas tërmetit të 26 nëntor 2019;

– Dialogu politik midis dy vendeve bëri një hap shumë pozitiv gjatë vizitës së fundit (20 tetor 2020) të Ministrit grek të Punëve të Jashtme Dendias gjatë së cilës të dy vendet bënë publik vendimin e tyre për të referuar pranë Gjykatës së Drejtësisë në Hagë çështjen e caktimit të hapësirave detare në Detin Jon, duke hapur kështu rrugën për zgjidhjen e çështjes bilaterale më të vështirë të hapur midis Shqipërisë dhe Greqisë;

– Minoriteti grek dhe komuniteti shqiptar në Greqi janë ura që iu shërbejnë marrëdhënieve të mira midis vendeve tona;

– Që nga fillimi i shfaqjes së pandemisë COVID-19 të dy vendet kanë pasur bashkëpunim të frytshëm për masat dhe luftën kundër saj. Greqia ka dhuruar 120.000 doza vaksinash AstraZeneca për Shqipërinë.

Italia

– Marrëdhëniet me Italinë janë jashtëzakonisht të mira. Italia mbetet një nga partnerët kryesorë strategjikë të Shqipërisë;

– Bashkëpunimi bazohet në marrëdhënie të jashtëzakonshme historike, kulturore dhe ekonomike. Dialogu ndërshtetëror midis qeverive është i qëndrueshëm, i fortë dhe i integruar përmes bashkëpunimit të thellë dypalësh në shumë sektorë dhe fusha;

– Kemi një intensifikim të dialogut politik me shkëmbimet e vizitave në nivele të larta : vizita zyrtare e KM Rama me ftese të Kryeministrit Dragi më 17 nëntor 2021, në Romë;

– Bashkëpunimi në fushat e mbrojtjes dhe drejtësisë dhe punët e brendshme u forcua më tej, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore, migracionit të paligjshëm dhe azilit. Shqipëria po bashkëpunon ngushtë me Italinë për migracionin e parregullt. Italia mbetet partneri i parë tregtar i Shqipërisë dhe një nga

donatorët kryesorë të Shqipërisë.

Turqia

– Shqipëria vlerëson partneritetin strategjik dhe marrëdhëniet tradicionale shumë të mira dhe miqësore me Turqinë;

– Lidhjet tona strategjike si dhe partneriteti i ngushtë i shërbejnë fqinjësisë së mirë, stabilitetit, paqes dhe përparimit në rajon dhe më gjerë;

– Shqipëria dhe Turqia janë partner të besueshëm në NATO;

– Intensifikimi i dialogut politik dhe bashkëpunimi i gjithanshëm dypalësh reflektohet në shkëmbimin e vizitave të nivelit të lartë si vizita e KM Rama në Ankara (6 janar dhe 3 qershor 2021) Kryetarit të Kuvendit turk dhe vizitave reciproke të një sërë ministrash në Tiranë dhe Ankara, si dhe me nënshkrimin e një sërë marrëveshesh me interes reciprok;

– Ka një prani në rritje të investimeve turke, veçanërisht në fushat e energjisë, sistemit bankar, turizmit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës. Turqia është partneri i 4 më i madh tregtar i Shqipërisë. Investimet turke kapin shifrën e 3.6 miliard dollarëve, ndërkohë që 15 mijë shtetas shqiptar punojnë në kompanitë turke;

– Ka pasur një shkëmbim intensiv në nivel rajonal, në kuadër të nismave rajonale dhe ato ndërkombëtar.

2.3.2 Marrëdhëniet Bashkimi Evropian – Shqipëri

Integrimi evropian ka qenë një nga prioritetet më të rëndësishme të politikës së jashtme të Shqipërisë dhe forca shtytëse për arritjen e mirëqenies ekonomike, sociale dhe stabilitetin politik.

Shqipëria është vend kandidat pas Mbledhjes së Këshillit të Bashkimit Evropian të qershorit 2014 në Bruksel. Dhënia e statusit kandidat ishte rezultat i përpjekjeve të Shqipërisë për reforma gjatë viteve të fundit dhe pranimi nga ana e BE-së e përpjekjeve të bëra dhe progresit të arritur në rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë. Vendimi gjithashtu inkurajon Shqipërinë për të vazhduar me reformat ekzistuese dhe për të nisur reforma të reja të nevojshme për ta përgatitur Shqipërinë për nisjen më tej të negociatave të anëtarësimit. Një dialog politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm mbetet thelbësor për të konsoliduar dhe vazhduar reformat.



Më 1 korrik 2021, Sllovenia mori Presidencën e radhës së Këshillit të Bashkimit Evropian. Si një mbështetëse e fortë e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe pjesë e treshes së bashku me Gjermaninë dhe Portugalinë, Sllovenia e shndërroi këtë çështje në një nga prioritetet e presidencës së saj.

Programi gjashtëmujor i Presidencës Sllovene bazohet në katër prioritate. Nën sloganin “*Together. Resilient. Europe*”, Sllovenia po përpaket të lehtësojë rimëkëmbjen e BE-së dhe të forcojë qëndrueshmërinë e saj, të reflektojë mbi të ardhmen e Evropës, të forcojë sundimin e ligjit dhe vlerat evropiane dhe të rrisë sigurinë dhe stabilitetin përreth kufijve të Evropës. Në prioritetin e katërt, vëmendje e veçantë Sllovenia po i kushton vendeve të Ballkanit Perëndimor, të ardhmes së tyre në Evropë dhe vazhdimin e një procesi të besueshëm zgjerimi të BE-së. Sllovenia është zotuar të përpaket për rimëkëmbjen ekonomike të vendeve në rajon dhe të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet tranzicionit të gjelbër dhe digjital, duke përmirësuar ndërkohë lidhjen brenda rajonit dhe mes rajonit dhe Bashkimit Evropian. Sllovenia u angazhua gjithashtu për organizimin e samitit BE – Ballkani Perëndimor, më 6 tetor 2021.

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar debati dhe diskutimet në lidhje me përshpejtimin e procesit të zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Takimi i Forumit Strategjik të Bledit, të zhvilluar në Slloveni më 1 shtator 2021, ishte pjesërisht i dedikuar kësaj tematike. Po ashtu, në takimet e zhvilluara gjatë muajit shtator, rëndësia politike e rajonit ka qenë pjesë e mesazheve të përcjella. Kancelarja gjermane Angela Merkel, vizitoi Tiranën më 14 shtator 2021 dhe u takua me kryeministrat e rajonit, ku theksoi pikërisht rëndësinë e integritetit në BE të Ballkanit Perëndimor si dhe nevojën për një bashkëpunim më të fortë rajonal.

Presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen, gjatë fjalimit të saj në Parlamentin Evropian, më 15 shtator 2021, mbi situatën në Bashkimin Evropian, ngriti çështjen e rëndësisë së procesit të zgjerimit dhe premtoi të udhëtojë në rajon përpara samitit të Ballkanit Perëndimor (6 tetor 2021). Kryeqyteti i parë që ajo zgjodhi të vizitojë, ishte Tirana, më 28 shtator 2021.

Gjithashtu gjatë vitit 2021, përveç faktit se përparimi që ka bërë Shqipëria është pranuar dhe vlerësuar nga të gjithë partnerët evropianë, nuk ka

pasur zhvillime të reja në avancimin e dosjes së integritetit evropian. Kjo për arsye se ende vazhdon të mos ketë përparim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, çka vazhdon të pengojë edhe Shqipërinë. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë diskutim nga aktorët vendimmarrës evropianë rreth mundësisë për të trajtuar veçmas Shqipërinë nga Maqedonia e Veriut.

PJESA 3. KRITERI EKONOMIK

3.1 Funksionimi i ekonomisë së tregut

3.1.1 Zhvillimet ekonomike

Aktiviteti ekonomik është rritur me ritme të shpejta përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021. Zgjerimi i PBB-së me mesatarisht prej 12% në nivel vjetor është udhëhequr nga përshpejtimi i ritmit rritës të konsumit, investimeve private dhe publike, si dhe të eksporteve. Ndonëse këto ritme të forta të rritjes së ekonomisë janë të ndikuara nga baza e ulët krahasuese e vitit 2020, prirjet e përbërësve të kërkesës agregate tregojnë për një kapërcim të ndikimit negativ nga pandemia dhe për një rikthim në trendet e tyre afatmesme. Për më tepër, bazuar dhe në statistikën më të fundit ekonomike, impakti negativ i pandemisë vlerësohet të mos ketë ndikuar trendet dhe ekuilibrat afatgjatë të ekonomisë.

Masat e ndërmarra gjatë vitit 2020 nga qeveria dhe Banka e Shqipërisë ndihmuan në lehtësimin e ndikimeve imediate të krizës dhe në ruajtjen e stabilitetit financiar, duke mbështetur rimëkëmbjen e ekonomisë përgjatë këtij viti. Sistemi financiar mbetet i qëndrueshëm dhe sektori bankar është likuid, i mirë-kapitalizuar dhe me përfutueshmëri. Raporti i kredive me probleme ka vijuar trendin rënës duke arritur nivelin 6.5% gjatë muajit shtator të vitit 2021. Pas një zgjerimi të fortë gjatë vitit 2020 në reflektim të masave stimuluese të ndërmarra, deficitin dhe borxhi publik kanë ardhur në rënie. E njëjta tendencë vlerësohet edhe për ecurinë e deficitit të llogarisë korrente, i cili është rikthyer në nivelet e regjistruara përpara pandemisë.

Deficiti i llogarisë korrente shënoi 554.1 milionë euro në gjysmën e parë të vitit 2021, duke u ngushtuar me 9.6% në terma vjetorë. Ai vlerësohet në nivelin 7.7% të PBB-së, nga 9.9% në gjysmën e parë të vitit 2020 dhe 8.8% për gjithë vitin 2020. Ngushtimi i deficitit erdhi si pasojë e rritjes së shpejtë me 75.8% të suficitit të nën-llogarisë së shërbimeve si rezultat i rikuperimit të fortë të



eksportit të “shërbimeve të udhëtimit”. Nga ana tjetër, deficit i llogarisë së mallrave u rrit me 22.8%, për shkak të rritjes së shpejtë të importeve të lidhura me rikuperimin e kërkesës agregate. Zgjerimi i suficitit të shërbimeve ka nxitur edhe një përmirësim të përgjithshëm me 1.1% të deficitit tregtar, në krahasim me një vit më parë. Ndërkohë, balanca e të ardhurave parësore ka vazhduar të përkeqësohet si pasojë e flukseve dalëse të investimeve. Nga ana tjetër, balanca e të ardhurave dytësore është përmirësuar ndjeshëm si pasojë e zgjerimit të fluksit hyrës të remitançave me 24.4%.

Hyrjet neto në llogarinë kapitale regjistruan vlerën 146.7 milion EUR në gjysmën e parë të vitit 2021, nga 51.6 milionë EUR në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Detyrimet neto në llogarinë financiare u pakësuan me 32.6% në terma vjetorë, të ndikuara edhe nga emetimi i Eurobondit në tremujorin e dytë 2020. Flukset neto të Investimeve të Huaja Direkte ranë me 1.7%, të ndikuara kryesisht nga reduktimi i IHD-ve të sektorit energjetik ku projektet e mëdha janë në fazë e fundit. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, struktura e financimit të deficitit korrent mbetet e mbështetur te flukset jo-borxh krijuese.

Borxhi i jashtëm bruto i Shqipërisë është reduktuar në 62.6% të PBB-së në fund të gjysmës së parë të vitit 2021, nga 65.6% në fund të vitit 2020. Borxhi shënon vlerën 8,811.4 milion EUR, duke regjistruar një rënie vjetore me 1.5%. Sipas ndarjes sektoriale evidentohet një shpërndarje e borxhit si në vijim: (i) qeveria e përgjithshme zotëron rreth 47.8% të tij; (ii) korporatat depozitë-marrëse rreth 16.5%; (iii) sektorët e tjerë rreth 16.6% ; (iv) investimet e huaja direkte (IHD) rreth 18.5%; dhe (v) autoriteti monetar rreth 0.01% të borxhit. Shpërndarja e borxhit sipas instrumenteve evidenton se “investimet e tjera” në formën e “huave” dhe “monedhave e depozitave” përfaqësojnë instrumentin kryesor të borxhit, i cili pasohet nga IHD-hua ndërkompani. Ndërkohë, emetimi i Eurobondit vitin e kaluar ka shkaktuar një rritje të peshës së “investimeve të portofolit”, e cila mbetet edhe gjatë vitit 2021. Sipas maturitetit, borxhi afatgjatë përbën rreth 92.0% të totalit të borxhit. Ai është pakësuar në terma vjetorë me rreth 3.7%.

Niveli i rezervave valutore të Bankës së Shqipërisë në fund të muajit shtator rezulton afërsisht 4,204 milionë euro, rreth 2% më i lartë se

e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Raporti i mbulimit me rezervë është më i lartë se kriteret e mjaftueshmërisë. Kështu, në tremujorin e tretë të vitit rezervat valutore janë të mjaftueshme për mbulimin rreth 3 herë të stokut të borxhit të jashtëm afatshkurtër, dukshëm mbi nivelin minimal të mjaftueshëm për mbulimin në masën 100% të tij. Në të njëjtën kohë, stoku i rezervave valutore për të njëjtën periudhë mbulon rreth 8 muaj importe mallrash dhe shërbimesh, sërish mbi nivelin minimal të përcaktuar prej 4 muajsh.

Inflacioni ka ndjekur një trend rritës gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2021, duke u rritur nga 0.9% në tremujorin e parë, në 1.8% dhe 2.4% në tremujorin e dytë dhe të tretë, respektivisht. Në terma mesatarë inflacioni rezultoi 1.7%. Rritja e tij i atribuohet më së shumti: (i) rritjes së çmimit të naftës, e cila ndër të tjera u ndikua nga efekti i bazës së ulët krahasuese të një viti më parë. Gjatë muajve gusht – shtator 2021, indeksi i këtij nëngrupi i është afruar shumë nivelit të parapandemisë, duke sinjalizuar për një stabilizim të kontributit të tij në inflacionin total; (ii) rritjes së çmimeve të ushqimeve të papërpunuara, kryesisht perimeve; (iii) rritjes së çmimeve të ushqimeve të përpunuara, kryesisht gjatë muajve qershor – shtator, si pasojë e shtimit të presioneve nga rritja e çmimeve të ushqimeve në tregjet e huaja.

Lehtësimi i masave anti-COVID, u shoqërua me rritje të kërkesës për shërbime të caktuara, duke sjellë një rritje graduale të inflacionit të tyre. Inflacioni i grupit “Argëtim e kulturë” shënoi rritje veçanërisht gjatë tremujorit të tretë. Inflacioni i grupit “Hotele, kafene dhe restorante” ishte më i lartë se një vit më parë, kryesisht gjatë periudhës qershor – shtator. Rritje shënuan edhe normat vjetore të inflacionit të shërbimeve si “Transport”, “Shëndet” dhe “Komunikim”.

Në aspektin makroekonomik, rritja e inflacionit pasqyroi kryesisht goditjet që vijnë nga ambienti i huaj në formën e rritjes së çmimeve të lëndëve bazë. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste kanë ardhur në rritje, por mbeten të moderuara. Kjo ecuri diktohet nga rritja ende e pamjaftueshme e punësimit dhe e pagave, ndërkohë pritjet inflacioniste qëndrojnë nën objektiv. Inflacioni bazë rezultoi 1.5% gjatë nëntëmujorit të parë të vitit, duke qëndruar në nivele të përafërta me një vit më parë. Kontributi i tij në formimin e inflacionit total ishte relativisht i



qëndrueshëm, 1 pikë përqindje në terma mesatarë.

Në afat të shkurtër presionet inflacioniste pritet të shtohen të ndikuara nga rritja e çmimeve në tregjet e huaja për mallrat bazë. Këto të fundit pritet të vijnë drejt normalizimit pas mesit të vitit 2022. Nga ana tjetër, presionet e brendshme inflacioniste pritet të forcohen në linjë me përmirësimin e aktivitetit ekonomik dhe shfrytëzimin më të plotë të kapaciteteve prodhuese. Kjo ecuri do të shoqërohet me rritjen dinamike të pagave dhe të kostove të tjera të prodhimit, duke mbështetur kthimin e qëndrueshëm të inflacionit në objektiv. Inflacioni parashikohet të kthehet në objektivin prej 3%, brenda vitit 2022.

Politika stimuluese e Bankës së Shqipërisë ka mundësuar krijimin e kushteve të favorshme monetare në mbështetje të rimëkëmbjes së ekonomisë dhe rritjes së inflacionit drejt objektivit. Tregu financiar është i qetë, normat e interesit mbeten në nivele të ulëta dhe primet e rrezikut kanë qenë të përmbajtura. *Yield*-et e letrave me vlerë të qeverisë janë luhatur pranë niveleve të vitit të mëparshëm, me një tendencë të lehtë rënëse në maturitetet afatgjata. Sistemi financiar ka pasur hapësira të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e qeverisë për financim pa reflektuar stres të shtuar. Normat e interesit të kredisë kanë vijuar të luhaten pranë niveleve të vitit 2020 për bizneset, mesatarisht prej 5.6%, dhe kanë rënë më tej për individët në 6.2%. Tregu valutë ka qenë i qetë. Leku ka shfaqur një mbiçmim të lehtë ndaj euros, i përqendruar në tremujorin e tretë të vitit në reflektim të aktivitetit turistik. Aktualisht, kursi eur/lek luhet rreth nivelit 121.5 lekë/euro, me një mbiçmim të lekur prej 2.0% kundrejt një viti më parë.

Kredia bankare ka njohur norma të larta rritjeje, e mbështetur nga kushtet e favorshme të financimit, rritja e kërkesës dhe përqasja pozitive e bankave ndaj kreditimit. Kredia për sektorin privat është rritur mesatarisht me 8% gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2021, krahasuar me rritjen prej 6.8% në vitin 2020. Rritja e kreditimit ka financuar zgjerimin e investimeve si për bizneset dhe individët, sikurse edhe nevojat e tyre për likuiditet. Kredia për individë u rrit me 8% gjatë kësaj periudhe, duke u mbështetur nga kredia hipotekare (10.9%) edhe nga kredia konsumatore (5.3%). Nga ana tjetër, norma e rritjes së kredisë për biznese ka mbetur stabil rreth nivelit 7.6%, duke u

mbështetur ndër të tjera edhe nga skema e garancisë publike, e prezantuar vitin e kaluar nga qeveria dhe ristrukturimi i kredisë. Për më tepër, kreditimi vijon të ruajë dy cilësi pozitive. Së pari, kredia në lekë vazhdon të rritet me ritme të larta duke krijuar kushte të përshtatshme për një transmetim të mirë të stimullit monetar në ekonomi. Po ashtu rritja e peshës së kredisë në lek ndihmon në forcimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Së dyti, raporti i kredive të këqija ndaj totalit ka rënë në 7% në muajin gusht, duke sugjeruar një cilësi të kënaqshme të portofolit të kredisë.

Në të ardhmen, kredia pritet të rritet në mënyrë të qëndrueshme, duke u mbështetur nga rritja ekonomike dhe kushtet e favorshme monetare. Këto pritshmëri mbështeten nga shëndeti i mirë i sektorit bankar, i cili është likuid, i mirëkapitalizuar dhe me fitim.

Stabiliteti makroekonomik

Viti 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështira në tre dekada. Shqipëria, përveç tronditjes nga pandemia e COVID-19 që u përhap në të gjithë botën, pak përpara saj u godit edhe nga tërmeti, e sigurisht efekti negativ në ekonomi është i amplifikuar. Sidoqoftë, me gjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë pasur, në sajë të përgjigjeve relativisht mjaft të mira të politikave ekonomike (fiskale e monetare), të dhënat statistikore të disponueshme dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë. Gjithashtu dhe në vitin 2021, ekonomia po rifiton ritmin shumë më shpejt nga pritshmëritë fillestare. Deri më tani duket se stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj këtyre goditjeve.

Ekonomia shqiptare përgjatë vitit 2020 regjistroi një recesion prej 4 përqind, duke arritur kulmin e tkurrjes së PBB-së në tremujorin e dytë në rreth - 11.3 përqind. Shenja të rimëkëmbjes u shfaqën, dhe rikthimi në terrenin pozitiv filloi në tremujorin e fundit të vitit 2020. Ndonëse i gjithë viti 2020 regjistroi një recesion të fortë për historikun tonë ekonomik (në tre dekada ka pasur recesion vetëm në vitin 1997 në nivelin 11 përqind, madje edhe gjatë krizës globale financiare të viteve 2008 – 2009 ekonomia shqiptare arriti të shmangë recesionin), vlen të theksohet se ky recesion ishte shumë më i



përmbajtur sesa parashikimet fillestare që varionin nga rreth - 6 përqind (projeksioni i MFE) deri në rreth - 8 përqind nga institucione të tjera vendase dhe ndërkombëtare.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, ekonomia shqiptare shfaq shenja mjaft inkurajuese duke shënuar rikuperim të shpejtë të aktivitetit ekonomik. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 ka shënuar rritje prej rreth 11.9 përqind krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 sipas vlerësimit më të fundit të disponueshëm nga INSTAT. Ky rikuperim mbështetet në një gamë të gjerë faktorësh dhe është prezent në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Reduktimi deri në pothuajse heqje të kufizimeve pas rënies së infektiveve - ku një rol kyç ka pasur edhe procesi vaksinimit, rritja e besimit të biznesit e konsumatorit, përmirësimi i ekonomive partnere, si dhe politikat mbështetëse fiskale e monetare, kanë sjellë rritje të konsumit të familjeve, të investimeve publike e private, si dhe të eksporteve. Nga këto zhvillime kanë përfituar si sektori prodhues dhe ai i shërbimeve, duke ofruar rimëkëmbje për biznesin dhe punësimin dhe duke krijuar premisa të mira në perspektivën afat-mesme.

Sipas optikës së kërkesës agregate, në gjysmën e parë të vitit 2021 vlerësohet se të gjithë komponentët e kërkesës agregate kanë shënuar rritje të fortë duke reflektuar kështu rifillimin normal të aktivitetit ekonomik, pas bllokimit të fortë që përjetoi në vitin 2020. Rritja përgjatë gjysmës së parë të vitit 2021 u gjenerua pothuajse e gjitha nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto vlerësohet të ketë pasur gjithashtu një kontribut pozitiv në rritjen totale, por mjaft më të moderuar. Kjo sepse kontributi i lartë pozitiv prej rritjes së fortë e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve u kundërpothuajse tërësisht nga kontributi negativ nga rritja gjithashtu e fortë e importeve të mallrave e shërbimeve.

Në këtë kontekst, konsumi final total, i cili përbën peshën më të madhe në ekonomi, pësoi rënie me rreth 1.9 përqind në terma realë vjetorë përgjatë vitit 2020, gjithashtu dhe konsumi final i popullatës u ul me rreth 2.3 përqind. Ndërkohë për gjysmën e parë të vitit 2021, konsumi final

shënoi rritje të konsiderueshme prej 6.1 përqind, ndërsa konsumi privat shënoi rritje prej 5.7 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Formimi i Kapitalit Fiks Bruto (investimet totale) pati rënie me rreth 2 përqind në terma realë vjetorë përgjatë vitit 2020, ndërkohë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 kjo normë shënoi rritje prej 29.7 përqind. Kjo rritje i atribuohet në një masë të konsiderueshme edhe rritjes së investimeve publike gjatë gjysmës së parë të vitit, përfshirë ato për rindërtimin pas tërmetit.

Zhvillimet në tregtinë e jashtme të mallrave treguan një rritje të ndjeshme në terma vjetorë, si në eksporte ashtu edhe në importe, në tremujorin e tretë të vitit 2021. Vijimi i trendit rritës që nga tremujorët e mëparshëm dhe fakti që vlerat kanë pësuar rritje të konsiderueshme, janë tregues për rikuperimin e tregtisë së jashtme të mallrave në nivel të përgjithshëm. Eksportet e mallrave për periudhën nëntëmujore 2021 shënuan rritje prej +36.5% krahasuar me një vit më parë. Ndërsa importet e mallrave për periudhën nëntëmujore 2021 shënuan rritje prej +29.6% krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar për periudhën janar – shtator 2021 është rritur me 23.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Norma e mbulimit të eksporteve ndaj importeve për këtë periudhë është 47.8%.

Në anën e ofertës agregate, kontribut pozitiv në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 dhanë të gjitha degët, përveç bujqësisë e cila regjistroi një rënie dhe kontribut të lehtë negativ. Konkretisht: Industria regjistroi rritje prej 31.7% dhe kontribut pozitiv prej 4.0 pikë përqindje në rritjen totale të PBB prej 11.9 përqind; Ndërtimi regjistroi rritje prej 31.9% dhe kontribut 2.46 pikë përqindje; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit regjistruan rritje prej 21.8% dhe kontribut prej 0.62 pikë përqindje; Arte, argëtim dhe çlodhje regjistruan rritje prej 18.3% dhe kontribut prej 0.39 pikë përqindje; Administrata publike dhe mbrojtja, arsimi e shëndetësia regjistruan rritje prej 10.6% dhe kontribut prej 1.3 pikë përqindje. Ndërsa “Bujqësia, pyjet dhe peshkimi”, e cila gjatë të njëjtës periudhë të vitit të shkuar ishte i vetmi sektor që regjistronte rritje pozitive, gjatë gjysmës së parë të këtij viti regjistroi një rënie të lehtë prej - 0.3 përqind dhe kontribut negativ prej 0.1 pikë përqindje. Pra, është



evidente që në të gjithë sektorët, si ata me rritje pozitive të fortë, ashtu edhe në rastin “kontrast” të bujqësisë me rënie, “efekti i bazës” përbën peshën substanciale.

Gjithashtu implikimet në tregun e punës deri më tani nuk duket të kenë qenë shqetësuese, veçanërisht në lidhje me implikimet strukturore afatgjata për këtë fundament të ekonomisë. Të dhënat më të fundit nga INSTAT, në tremujorin e tretë 2021, sipas Anketës Tremujore të Forcave të Punës (LFS), tregojnë se shkalla e papunësisë për grupmoshat 15 – 64 vjeç është 11.6%, kundrejt 12.1% që ishte për të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndërsa për grup-moshën e punës 15 vjeç e lart, shkalla e papunësisë zyrtare në tremujorin e tretë të vitit 2021 shënoi vlerën prej 11.3%. Numri i personave të papunë në moshë pune (15 – 64 vjeç) në tremujorin e tretë të vitit 2021 ishte 156,406 persona.

Në tremujorin e tretë të vitit 2021 numri të punësuarve në moshë pune (15 – 64 vjeç) ishte 1 196 838 persona. Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T3-2020), numri i personave të punësuar, u rrit me 42 462 persona ose + 0.2 %.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë, një tjetër themel tejet i rëndësishëm dhe tipikisht vulnerabël përballë goditjeve të tilla, mbeti relativisht mjaft solid. Në tremujorin e dytë të vitit 2021, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi negativ dhe në rënie të mjeteve valutores (rezervës) prej rreth 117 milionë euro. Deficiti i llogarisë korrente shënon 243 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 134 milionë euro ose 36%. Përmirësimi i deficitit korrent, në masën më të madhe është diktuar nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime, në reflektim të rritjes së konsiderueshme të të ardhurave nga “udhëtimet” pas lehtësimit të masave kufizuese në kuadër të pandemisë COVID-19. Në të njëjtën kohë, prurjet valutores të emigrantëve u rritën në terma vjetorë. Kontributi pozitiv i këtyre faktorëve ka kompensuar plotësisht thellimin e deficitit tregtar në mallra si dhe zgjerimin e balancës negative të të ardhurave parësore. Stoku i rezervës valutores, në fund të qershorit 2021 shënon 3 925 milionë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 8.4 muaj importe mesatare në mallra dhe shërbime.

Në gjysmën e parë të vitit 2021, Investimet e Huaja Direkte shënuan vlerën +480.2 milionë euro

ose -2.3%, krahasuar me +491.4 milionë euro në gjashtëmujorin e parë 2020. Ndërsa vetëm për tremujorin e dytë 2021, IHD regjistruan vlerën +243.4 milionë euro ose +1.8%, krahasuar me +239.0 milionë euro në tremujorin e dytë të 2020. Këtë tremujor, fluksi hyrës i investimeve të huaja direkte në formën e zgjerimit të kapitalit ishte i përqendruar kryesisht në sektorin e hidrokarbureve (në masën 23%), ndërmjetësimit financiar (në masën 16%), energjetikës (në masën 6%), si dhe në sektorët e ndërtimit dhe komunikacionit (respektivisht në masën 5%).

Në gjysmën e parë të vitit 2021, të hyrat nga shërbimet të lidhura përgjithësisht me Turizmin pësuan rritje prej +68.2%, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2020. Gjithashtu për këtë periudhë, Remitancat shënuan rritje prej +24.4%.

Qëndrueshmëria e pozicionit të jashtëm të ekonomisë u reflektua edhe në tregun valutor, ku kursi i këmbimit të Lekut kundrejt valutave kryesore mbeti relativisht mjaft stabil gjatë gjithë vitit 2020 dhe vijon të mbetet i tillë.

Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një themel tjetër i fortë dhe vijueshmërisht i përmirësuar i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të muajit korrik nivelin prej rreth 7.05% nga 24% që kulmuan rreth dy vite më parë. Stoku total i kredive bankare në muajin Gusht 2021, pati një rritje me 6.6%, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2020. Stoku i kredive në lekë shënoi një rritje prej 8.2%, ndërsa ai në valutë rritje prej 4.9%, krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë, ka njohur tashmë një zgjerim të qenësishëm deri në fund të muajit Gusht 2021, duke regjistruar një rritje mbi 7% kundrejt një viti më parë për kreditë ndaj bizneseve dhe mbi 8% për kreditë drejt konsumatorëve.

Sa i përket Depozitave, referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit gusht të vitit 2021 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 9.8% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2020. Stoku total i depozitave në Lekë pësoi rritje me 7.1%, ndërsa ai në valutë është rritur me 12.2%. Në gusht 2021 rezultoi se rreth 44.8% e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 55.2% përbëhet nga depozitimet në valutë të huaja. Stoku total i



depozitave vetëm për muajin gusht 2021 shënoi rritje me 20.7 miliardë Lekë kundrejt muajit paraardhës (korrik 2021). Stoku total i depozitave të bizneseve në muajin gusht të vitit 2021 shënoi rritje prej 27.0% krahasuar me Gushtin e vitit 2020, ndërsa stoku total i depozitave të individëve ka shënuar rritje prej 6.7% krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë.

Në muajin shtator 2021 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është +2.5%, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte +1.5%. Inflacioni mesatar për periudhën janar – shtator 2021 është +1.7%. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Shtator 2021, krahasuar me gusht 2021 është 0.5%. Inflacioni mesatar për vitin 2021 parashikohet të qëndrojë në nivelin prej 2.2%, ende pak më poshtë se objektiv i Bankës Qendrore prej 3%.

Për vitin 2021 në tërësi rritja ekonomike parashikohet në 7.6 përqind dhe parashikohet të qëndrojë rreth nivelit prej 4 përqind përgjatë periudhës afatmesme në vijim.

Stabiliteti financiar dhe përsbhejtimi i kreditimit të ekonomisë.

Sektori bankar ruajti një nivel të përshtatshëm të kapitalizimit, pozicionit të likudititetit dhe përfitueshmërisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të muajit gusht 2021 nivelin prej rreth 7% të totalit të kredisë nga 8% një vit më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë, ka njohur një zgjerim të qenësishëm, duke plotësuar nevojat për likuiditet dhe investime të familjeve dhe bizneseve.

Pozicioni i jashtëm i ekonomisë dhe bilanci i pagesave mbetet përgjithësisht i qëndrueshëm

Deficiti i llogarisë korente ka ardhur drejt ngushtimit në gjysmën e parë të këtij viti, duke reflektuar rikuperimin e flukseve tregtare të shërbimeve dhe zgjerimin e remitançave. Nga ana tjetër, balancat negative të mallrave dhe të të ardhurave parësore janë zgjeruar.

Flukset neto pozitive në llogarinë kapitale janë rritur ndjeshëm, ndërkohë që fluksi i investimeve të huaja direkte është pakësuar lehtë si pasojë e zvogëlimit të investimeve në sektorin energjetik. Nga ana tjetër, vihet re një rikuperim i ndjeshëm i investimeve të huaja direkte në sektorin e hidrokarbureve.

Aktualisht, bilanci i përgjithshëm i pagesave dhe pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet i

qëndrueshëm dhe stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 9 muaj importe në mallra dhe shërbime.

3.1.2 Politikat monetare dhe fiskale

Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare stimuluese në dekadën e fundit, në kushtet e presioneve të ulëta inflacioniste nga ambienti i brendshëm dhe ai i huaj. Stimuli monetar i ka shërbyer rritjes së ekonomisë drejt nivelit potencial dhe forcimit gradual të presioneve të brendshme inflacioniste. Stimuli monetar u intensifikua në vitin 2020 me përhapjen e pandemisë COVID-19, kur norma bazë e interesit u ul me 50 pikë bazë, në nivelin 0.50%. Ky nivel ka mbetur i pandryshuar gjatë vitit 2021. Banka e Shqipërisë ka vijuar të ofrojë likuiditet të pakufizuar në sistemin bankar me synim funksionimin e qetë të tregjeve financiare gjatë pandemisë. Krahas masave monetare, paketa e reagimit të Bankës së Shqipërisë ndaj krizës COVID-19 përfshin dhe masa të tjera mikro dhe makroprudenciale (shih seksionin 3.1.6), të cilat, së bashku me paketat fiskale mbështetëse të qeverisë, kanë zbutur efektin negativ të goditjeve në sistemin financiar dhe në ekonomi, duke krijuar premisa për rigjallërimin e aktivitetit ekonomik.

Transmetimi i stimulit monetar në ekonomi ka qenë efektiv. Normat e interesit të huamarrjes janë në nivele të ulëta dhe kredia për ekonominë ka vijuar të rritet me ritme të qëndrueshme. Financimi me kredi i është përgjigjur nevojave të familjeve dhe bizneseve, dhe është i balancuar në terma të monedhës. Po ashtu, stimuli i shtuar monetar, së bashku me sinjalizimin për të ardhmen, kanë reduktuar pasiguritë në tregjet financiare dhe tek agjentët ekonomikë në të ardhmen.

Politika monetare do të vijojë të orientohet nga arritja e objektivit të stabilitetit të çmimeve. Pas tkurrjes së ekonomisë në vitin 2020, aktiviteti ekonomik po rimëkëmbet në vitin 2021 dhe të rritet me ritme të qëndrueshme gjatë viteve të ardhshme. Kjo rimëkëmbje do të mbështetet nga stimuli makroekonomik, nga reduktimi i pasigurisë dhe përmirësimi i mjedisit të huaj ekonomik. Me rritjen e pandërprerë të ekonomisë dhe afrimin me potencialin e saj afatgjatë, presionet inflacioniste pritet të forcohen duke mbështetur rritjen e qëndrueshme të inflacionit. Norma e inflacionit pritet ta arrijë objektivin prej 3% brenda vitit 2022.



Banka e Shqipërisë pret që politika monetare të normalizohet gradualisht me përmirësimin e perspektivës për inflacionin. Megjithatë, politika monetare do të mbetet në kahun akomodues dhe normat e interesit nën nivelin ekuilibër, gjatë horizontit afatmesëm.

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë në fushën e kriterit ekonomik përfshijnë:

- Ndjekjen e një politike monetare të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve;
- Përmirësimin e mekanizmit të transmetimit, inkurajimin e përdorimit të monedhës vendase në tregjet financiare dhe zhvillimin e tregut sekondar dhe të instrumenteve mbrojtës ndaj riskut të kursit të këmbimit;
- Modernizimin e sistemit të pagesave dhe zgjerimin e shërbimeve të ofruara;
- Harmonizimin e vazhduar të politikës monetare, fiskale dhe asaj makroprudenciale;
- Përsosjen e ekspertizës teknike dhe aftësive analitike për të siguruar një proces vendimmarrës të mirëinformuar;
- Plotësimin dhe implementimin e regjimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për të paraprirë daljen e disiplinuar nga tregu bankar.

Kombinimi aktual i politikave ekonomike është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të ruajtur stabilitetin makroekonomik, për të mbështetur gjallërimin e aktivitetit ekonomik dhe për kthimin e tij në një trajektore rritjeje të qëndrueshme.

Politika fiskale

Në vitet e fundit, deri përpara goditjes nga pandemia, financat publike kishin hyrë në një trajektore të sigurtë dhe optimale të konsolidimit fiskal, e materializuar në parametrat më kyç të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo u materializua në uljen e deficitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% të PBB në 2013 në nën 2% deri në vitin 2019.

Ndërsa në vitin 2020, si kundër përgjigje kryesore për amortizimin në një farë mase të goditjes prej pandemisë, u ndërmor një politikë fiskale mjaft ekspansioniste. Rrjedhimisht, deficit i përgjithshëm buxhetor arriti në vlerën rreth 6.8% të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 76% të PBB-së, pra me rreth 10 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2019.

Për të kryer një politikë të tillë fiskale ekspansioniste në kundërpërgjigje të goditjes, qeverisë iu desh që të aktivizonte gjatë vitit 2020 “klauzolat e devijimit” nga rregullat fiskale, si

klauzola të parashikuara që më parë në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB). Gjithashtu, me synimin për të ruajtur, sa më shumë të ishte e mundur, të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, element kyç ky për financat publike si një fundament makroekonomik, sidomos për vende të vogla dhe me nevoja ri-financimi buxhetor relativisht të larta siç është Shqipëria, u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore në korrik të 2020 (në kulmin e pandemisë) duke përfshirë një rregull tjetër të ri fiskal në LOB, i cili sanksiononte ligjërisht që balanca primare e buxhetit të rikthehej së paku në një nivel të balancuar (pra, jo më e vogël se sa zero) duke filluar nga viti 2024 e në vijim²¹.

Ky rregull u mirëprit mjaft pozitivisht nga të gjitha institucionet ndërkombëtare (përfshirë dhe agjencitë e rating-ug) dhe rrjedhimisht nga aktorët ekonomikë në tërësi, si një iniciativë mjaft e duhur dhe efektive për të ruajtur kredibilitetin dhe qëndrueshmërinë e financave publike, jo vetëm në periudhën afatmesme por dhe në atë afatgjatë. Vlerësojmë se ishte mjaft ndihmuese për të siguruar një financim (huamarrje) relativisht normale edhe në afatin e shkurtër përgjatë goditjes në vitin 2020 dhe në pjesën e parë të vitit 2021, pavarësisht magnitudës mjaft më të lartë të huamarrjes se sa tipikisht.

Tashmë, duke nisur nga viti 2022 dhe në vijim, objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse, do jetë sërish konsolidimi fiskal.

Politika fiskale do targetojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale por e përvitshme, ndërsa balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv nga viti 2024 e në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskale në LOB.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, do të synohet ruajtja e një raporti të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale – investimet publike do synohen të jenë rreth 5 përqind e PBB-së në çdo vit buxhetor.

²¹ Rregulli origjinal sanksiononte “që prej 2023”, por më pas kjo u ndryshua sërish në Korrik të 2021 dhe u bë “që prej 2024”.



Deficiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5.4 përqind të PBB-së nga rreth 6.8 përqind i pritshëm për vitin 2021. Balanca primare edhe për këtë vit pritet të jetë sërish negative në rreth -2.7 përqind, gjithsesi në një përmirësim nga rreth -4.6 përqind sipas pritshmërive për vitin 2021. Megjithatë, balanca korrente fiskale (diferenca midis investime publike dhe deficit fiskal) do të jetë pozitive në vitin e ardhshëm 2022, në nivelin prej 1 përqind të PBB nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 0.5 përqind këtë vit, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal (“rregullin e artë” të buxhetit). Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do t’i rikthehet një trajktoreje rënëse duke filluar nga viti 2022, në përputhje me rregullin respektiv fiskal, ku pritet të bjerë në rreth 78.9 përqind të PBB-së nga rreth 80 përqind i pritshëm për këtë vit. Balanca primare mund të rikthehet së paku në balancë (zero) që në vitin 2023, por me një siguri më të lartë ajo do të jetë pozitive nga viti 2024 e në vijim. Ky target tashmë bëhet ligjërish i detyrueshëm duke filluar nga viti buxhetor 2024 e në çdo vit në vijim, ku balanca primare do të duhet të jetë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 74.9 përqind në vitin 2025 dhe më tej në rreth 67.9 përqind në vitin 2028.

3.1.3 Ndërveprimi i forcave të tregut

Procesi i privatizimit mbetet një prioritet, veçanërisht në sektorët strategjikë, duke synuar tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendas që do të kishte një ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik. Në privatizimet strategjike dhe jo strategjike nuk ka kufizime për pjesëmarrësit.

Privatizimi i paketave aksionere strategjike (shoqërive tregtare që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) zbatohet në përputhje me Ligjin Nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Në kuadër të realizimit të objektivave lidhur me privatizimin e pasurive shtetërore, Ministri përgjegjës për ekonominë rishikon çdo vit planin për privatizimin e pasurive shtetërore.

- “Plani i veprimit për privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore në sektorët strategjikë për periudhën 2015 – 2020”, si Dokumenti Nr. 7476, datë 30.09.2015.

- “Plani i veprimit për privatizimin e pasurive për periudhën 2016 – 2020”, si Dokumenti Nr. 3459, datë 29.04.2016, ndryshuar për periudhën 2018 – 2020, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 88, datë 21.03.2018.

- “Plani i veprimit për privatizimin/likuidimin e ndërmarrjeve shtetërore në sektorët jo strategjikë 2017 – 2020”, si Dokumenti Nr. 2564, datë 29.03.2017.

Gjatë vitit 2020 janë privatizuar në total 12 asete shtetërore, duke realizuar 401 539 296 lekë dhe 303 767 835 Bono Privatizimi (në lekë). Ndërsa gjatë periudhës janar – tetor të vitit 2021 janë privatizuar në total 7 asete shtetërore, duke realizuar 24,696,978 lekë dhe 57,852,504 Bono Privatizimi.

Shitja e aseteve shtetërore bëhet nëpërmjet procedurës së ankandit publik ku ish-pronarët e tokës kanë të drejtën e parablerjes. Disa nga këto pasuri janë blerë nga pronarët e truallit, duke ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes.

Për më shumë informacion mbi privatizimin, ju lutem referojuni Kapitullit 20: Sipërmarrja dhe Politika industriale.

3.1.4 Hyrja dhe dalja nga tregu

Në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator, gjatë vitit 2021 për nënindikatorin dalje nga tregu mund të përmendim miratimin e VKM-së Nr. 65, date 3.02.2021 “Për miratimin e rregullores së marrëveshjeve jashtëgjyqësore të riorganizimit të përsheptuar”. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat për lidhjen e marrëveshjeve të riorganizimit të përsheptuar jashtë gjykatës ndërmjet debitorit, i cili është objekt i ligjit për falimentimin, dhe dy ose më shumë kreditorëve, nëse debitori është i paafte.

Deri në vitin 2007, regjistrimi i personave juridikë bëhej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që regjistrimi i personave fizikë bëhej pranë Gjykatave të Rretheve. Për këtë arsye, duke qenë se regjistrimi ishte një procedurë tërësisht gjyqësore, krijimi i një biznesi në Shqipëri haste një numër të madh barrierash gjyqësore dhe administrative, të cilat shtonin kostot dhe krijonin vështirësi në ushtrimin e aktivitetit tregtar. Për më tepër, në atë kohë, mungonte një regjistër tregtar lirisht i aksesueshëm nga publiku dhe informacioni nuk mund të merrej në kohë reale nga personat e interesuar.

Me qëllim thjeshtimin e procedurave dhe uljen e kostove, me ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për



regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, u krijua Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), e cila ka si funksion kryesor trajtimin e procedurave të regjistrimit të biznesit, si dhe mbajtjen dhe administrimin e Regjistrit Tregtar.

Me krijimin e QKR-së, regjistrimi i biznesit nga një proces gjyqësor u transformua në një proces administrativ me vetëdeklarim, në një qendër me një ndalesë. Falë kësaj, u mundësua që me regjistrimin e subjekteve në regjistrin tregtar të realizohej edhe regjistrimi i njëkohshëm i tyre pranë administratës tatimore qendrore dhe vendore, skemës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore, Inspektoratit të Punës dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Reforma në fushën e regjistrimit u pasua me reformën në fushën e licencimit dhe lejimit të biznesit. Procesi i licencimit/lejimit deri në vitin 2009 ishte shumë i gjatë, burokratik, i kushtueshëm dhe jo transparent. Ekzistonte një numër i madh licencash/lejesh dhe institucionesh të përfshira në këtë proces. Aplikimi bëhej në formë shkresore dhe procedurat, afatet dhe formatet e aplikimit nuk ishin të standardizuara. Gjithashtu, nuk ekzistonte një regjistrë kombëtar për licencat dhe lejet.

Krijimi i Qendrës Kombëtare të Licencimit, solli një përmirësim të mëtejshëm të klimës së biznesit në vend, reduktim të barrierave administrative, si dhe rritje të transparencës në procedurat e licencimit/lejimit. Një risi tjetër, ishte edhe transformimi i procesit të licencimit/lejimit nga një proces shkresor në një proces tërësisht elektronik, me anë të ngritjes dhe funksionimit të Regjistrit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Në dhjetor 2015, u miratua Ligji Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)”, i cili krijoi institucionin e ri, Qendrën Kombëtare të Biznesit ku ndër funksionet e kësaj qendre është edhe trajtimi i procedurave të regjistrimit dhe licencimit/lejimit të biznesit.

Bashkimi i QKR-së dhe QKL-së mundësoi krijimin e QKB-së, si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit. Kjo ka sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Krijimi dhe funksionimi i QKB-së u mirëprit nga subjektet, pasi tashmë procedurat dhe i gjithë informacioni i

nevojshëm për të operuar në tregun shqiptar mund të gjendet lehtësisht në një qendër të vetme.

Shërbimet administrative të ofruara nga QKB ofrohen me procedura të thjeshta, në mënyrë elektronike, brenda afateve kohore të shkurtra dhe me tarifa simbolike.

Ndërkohë, nga fillimi i vitit 2020, QKB ka ofruar të gjitha shërbimet e saj vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, dhe për aplikimet online nuk zbatohet tarifa e aplikimit në QKB prej 100 ALL.

Regjistri Tregtar është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji, dhe mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas ligjit regjistrohen nga QKB-ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjistrë. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese: a) të paraqitura nga aplikantët në format elektronik, sipas këtij ligji, ruhen dhe arkivohen nga QKB-ja vetëm në format elektronik; b) të paraqitura në format shkresor, sipas këtij ligji, konvertohen dhe ruhen nga QKB-ja në format elektronik. QKB-ja nuk ka detyrim të mbajë e të arkivojë aplikimet dhe dokumentet shoqëruese të paraqitura në format shkresor.

Regjistri përmban gjithashtu të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj.

Sipas Ligjit Nr. 9723/2007, subjektet që detyrohen të regjistrohen janë:

- subjektet tregtare;
- shoqëritë e thjeshta, sipas dispozitave të Kodit Civil;
- personat fizikë, sipas kuptimit të Kodit Civil, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo një profesion të pavarur;
- zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare dhe të shoqërive të huaja;
- shoqëritë dhe unionet e kursim-kreditit;
- shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- çdo subjekt tjetër, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së.



Çdo person i interesuar mund të kryejë, sipas këtij ligji, pa pagesë, pranë çdo sporteli shërbimi, kërtime në bazën e të dhënave elektronike për çdo të dhënë të regjistruar, me përjashtim të adresës së banimit të individëve.

Aplikimi për regjistrim bëhet elektronikisht përmes sportelit elektronik (aplikimi online) ose në sportelet e shërbimit të QKB, të ndodhura në zyrat qendrore të QKB-së, si dhe në njësitë e qeverisjes vendore ose dhomat e tregtisë, si dhe në zyrat noteriale (vetëm on-line aplikim).

Aplikimi online mund të bëhet nga çdo individ/qytetar ose subjekt (i pajisur me NUIS/NIPT) (pa pasur nevojë që të paraqitet pranë sporteleve fizike të QKB), i cili së pari duhet të regjistrohet në portalin unik qeveritar e-Albania. Regjistrimi në këtë portal bëhet duke plotësuar të dhënat e kërkuara përkatësisht në varësi të faktit nëse aplikimi do të kryhet nga një individ ose një subjekt.

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, kapitali fillestar për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar është 100 lekë, me përjashtim të shoqërive aksionare, kapitali i parë fillestar i të cilave varion nga 3 500 000 lekë te shoqëritë aksionere me ofertë private në 10 000 000 lekë te shoqëritë aksionere me ofertë publike.

Miratimi i Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të ndërmarrjeve tregtare” mundësoi bashkimin ndërkufitar midis një kompanie të huaj dhe asaj shqiptare. Për më tepër, në përputhje me parashikimet e ligjit të sipërcituar, Qendra Kombëtare e Biznesit ka zhvilluar funksione të reja në regjistrin elektronik, që mundësojnë aplikimin për bashkim ndërkufitar mes një shoqërie të huaj dhe një shoqërie shqiptare. Megjithatë, aktualisht aplikimi mund të bëhet vetëm për bashkimin ndërkufitar që rezulton në krijimin e një shoqërie të re shqiptare.

Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” është ndryshuar në shkurt 2015 me Ligjin Nr. 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, me qëllim përafrimin e këtij ligji me Direktivën 2009/101/EC, duke parashikuar depozitimin elektronik të pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të auditimit nga subjektet.

Njësia ekonomike regjistron dhe depoziton në regjistrin tregtar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur këto dokumente duhet të ruhen deri në 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet elektronikisht përmes portalit e-Albania.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, si dhe me mbështetjen e Bankës Botërore është implementuar projekti “Përmirësimi i cilësisë së raportimit financiar”. Me anë të këtij projekti është mundësuar:

- Përcaktimi i qartë i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar;
- Rritja e mëtejshme të transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar;
- Përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare;
- Zbatimi i formatit (sistemit) të ri për dërgimin e deklaratave të shërbimit në QKB, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, duke përdorur një format të komunikimit elektronik (XML).

Në shkurt 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit nënshkroi një marrëveshjen për pjesëmarrjen e regjistrin tregtar shqiptar në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtare (BIFIDEX). Falë këtij projekti, mundësohet komunikimi në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtarë të vendeve pjesëmarrëse, si dhe baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në vendet pjesëmarrëse. Portali do të mundësojë gjithashtu ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato të rajonit, duke mundësuar rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të vendeve të rajonit.

Ndërkohë, si rregull, çdo aktivitet ekonomik kryhet lirisht në Shqipëri. Sidoqoftë, disa aktivitete që mund të ndikojnë në shëndetin publik, sigurinë kombëtare, etj, kërkohet që t’i nënshtrohen procesit të licencimit.

Në aneksin e Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohen fushat dhe kategoritë kryesore të licencave/ autorizimeve/lejeve të lëshuara në Shqipëri nga institucionet qendrore.



Ndërkohë, në VKM-në Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, bëhet ndarja e mëtejshme e licencave dhe lejeve të lëshuara nga institucionet qendrore, në licenca/leje të trajtuara nga ose nëpërmjet QKB-së dhe në licenca/leje të trajtuara pa përfshirjen e QKB-së.

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të regjistruar dhe të pajisur me NUIS/NIPT, mund të aplikojnë në sportelet e shërbimit të QKB-së për pajisjen me një nga licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKB-së. Duke filluar nga viti 2020, shërbimet me licencë/leje ofrohen vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-albania. Ndërkohë, AKSHI, si institucioni përgjegjës për administrimin e portalit qeveritar e-Albania, ka bërë me dije se shërbimet e mbetura për personat juridikë janë gati dhe pasi të implementohen dhe testohen do të jenë gati për t’u përdorur nga biznesi deri në fund të vitit 2021.

Megjithatë, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, Qeveria e Shqipërisë ka krijuar një grup pune për reformën e rregullimit në fushën e licencimit, ku QKB është një institucion kontribuues. Në kuadër të kësaj reforme, grupi i punës ka propozuar eliminimin e 22 licencave dhe përmirësimin e mëtejshëm të procesit të licencimit, me anë të riklasifikimit të licencave ose reduktimit të afatit të vendimmarrjes për 49 licencat e tjera. Aktualisht janë eliminuar 11 licenca, si më poshtë:

1) Licenca “Ndërzimi natyror i kontrolluar (stacionet e ndërzimit natyror)”, me kodin II.2.A.2

2) Licenca “Prodhim tregtim i farave dhe fidanëve”, me kodin II.4

3) Licenca “Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis”, me kodin III.2.A

4) Licenca “Shërbime të ekspertizës dhe ose profesionale lidhur me pyje apo kullota”, me kodin III.7.A

5) Licenca “Shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me burimet minerare”, me kodin IV.4.A

6) Licenca “Shërbime ekspertize dhe ose profesionale lidhur me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B

7) Licenca “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi”, me kodin VII.3.B.3

8) Licenca “Agjenci që trajtojnë praktikantë e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4

9) Licenca “Shërbimi i Përmbarimit”, me kodin XI.2

10) Licenca “Auditues energjetik”

11) Licenca “Shërbimet energjetike”

3.1.5 Sistemi ligjor (të drejtat e pronësisë; zbatimi i ligjit dhe i kontratave; efektshmëria e gjyqësorit

Për më shumë informacion në lidhje me kadastrën e tokës, ju lutemi shikoni Kapitullin 23: “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, në Seksionin Gjyqësori dhe seksionin e të Drejtave të Pronës.

3.1.6 Sektori financiar

Veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, pavarësisht sfidave që paraqiti situata e pandemisë në vend. Masat operacionale të marra nga bankat për sigurimin e vijueshmërisë së funksioneve kritike dhe marrëdhënieve me klientelën dhe masat e marra nga autoritetet publike për zbutjen e goditjes së pandemisë mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të vendit, mundësuan që veprimtaria e ndërmjetësimit financiar të vijojë në mënyrë të përshtatshme dhe treguesit financiarë të sektorit bankar të mbeten në nivele të mira. Pasiguria për zhvillimet ekonomike në kushtet e pranisë së pandemisë mbetet e konsiderueshme, dhe të tilla mbeten edhe sfidat për veprimtarinë bankare e financiare. Megjithatë, vlerësimet e industrisë bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës (stress test), sugjerojnë që kapacitetet e sektorit bankar për t’u përballur me këto sfida janë aktualisht të mjaftueshme. Treguesit e performancës së sistemit financiar duke përfshirë atë të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira. Shkalla e ndërlidhjes mes institucioneve financiare mbetet e qëndrueshme dhe reflekton rëndësinë e qëndrueshmërisë së sektorit bankar për të gjithë sistemin financiar. Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar ndaj sektorit jo-bankar vlerësohet të jetë i ulët, ndërsa ecuria e sektorit bankar mbetet kritike për veprimtarinë dhe qëndrueshmërinë e sektorit jo-bankar.



Sektori financiar dhe roli i tij ndërmjetësues, i matur me madhësinë e aktiveve të tij, ka vijuar të zgjerohet. Aktiviteti i sistemit financiar u zgjerua me gati 4 pikë përqindje (pp) gjatë gjysmës së parë të vitit 2021, duke u ngjitur në 122.4% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Sektori bankar dha kontributin më të lartë në zgjerimin e aktiveve të sistemit financiar,

mbështetur kryesisht nga zgjerimi në kreditim dhe në investime në titujt e qeverisë. Segmenti jo bankar i sistemit financiar ka pasur një ecuri përgjithësisht të mirë, duke zgjeruar lehtë peshën e tij në rreth 13% të PBB-së. Rritja e peshës është përqendruar në segmentin e institucioneve financiare jo-bankare, si në atë të fondeve të investimeve ashtu dhe në fondet e pensionit.

Tabela 1. Pesha e aktiveve të segmenteve përbërës të sistemit financiar ndaj PBB-së²² së vendit.

Autoriteti Licencues dhe Mbikëqyrës	Banka e Shqipërisë			Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare			Ndërmjetësimi financiar
	Sistemi financiar	Sektori bankar	IFJB	SHKK dhe Unioni	Shoqëri sigurimi	Fonde pensionari	Fonde investimi
2011	88.1	2.7	0.8	1.5	0.0		93.1
2012	92.1	2.7	0.8	1.6	0.0	1.2	98.6
2013	94.8	2.7	0.7	1.7	0.0	3.9	103.8
2014	97.6	3.0	0.8	1.9	0.0	4.8	108.2
2015	97.3	2.9	0.8	2.1	0.1	5.0	108.0
2016	100.5	3.0	0.6	2.1	0.1	4.7	111.0
2017	99.4	3.1	0.6	2.1	0.1	5.0	110.3
2018	96.0	3.5	0.6	2.1	0.2	4.5	106.9
2019	95.5	4.2	0.7	2.2	0.2	4.3	107.2
2020	105.9	4.5	0.8	2.6	0.2	4.5	118.5
2021	109.6	4.6	0.8	2.6	0.3	4.6	122.4

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

*Të dhënat më të fundit për bilanci e segmenteve të sektorit jobankar përkatësinë të parë të vitit 2021.

²² Burim zyrtar -INSTAT



Sektori bankar shqiptar në strukturën e tij numëron 12 banka, nga të cilat 8 banka janë me kapital të huaj dhe 4 banka me kapital vendas.

Gjatë muajit gusht 2021 aktivet e sektorit bankar u rritën me rreth 38 mld lekë dhe arritën në nivelin 1 697 mld lekë. Rritja e aktiveve të sektorit bankar ka ardhur si pasojë e zgjerimit të investimeve ndër-bankare dhe kredive. Investimet në tituj vijnë të zgjerojnë aktivet e sektorit bankar. Fondi i provigjioneve zgjeroi lehtësisht nivelin e aktiveve me rreth 0.4 miliardë lekë. Nga ana e detyrimeve, e gjithë rritja ka ardhur nga zgjerimi me rreth 28 mld lekë ose me 2% në zërin veprime me klientët (depozita). Niveli aktual i depozitave është i mjaftueshëm për të financuar rreth 81% të aktivitetit bankar dhe në fund të gushtit depozitat shënuan nivelin 1 367 mld lekë. Në terma vjetorë, aktivet e sektorit bankar u rritën me rreth 10% (rreth 153 mld lekë) dhe rritja reflekton kryesisht zgjerimin në tituj dhe të portofolit të investimeve ndër-bankare. Investimet në kredi shënuan një rritje vjetore prej rreth 7%. Niveli i mirë i likuiditetit të sektorit bankar dhe zgjerimi i vazhdueshëm i bazës së depozitave, kanë ulur varësinë e sektorit bankar nga financimi i huaj. Në gusht 2021, detyrimet jo-rezidente zin rreth 3% të totalit të detyrimeve të sektorit bankar, duke ruajtur këtë nivel përgjatë muajve të vitit 2021.

Gjatë vitit 2021 teprica e kredisë së sektorit bankar ka shënuar rritje të lehtë dhe në fund të muajit gusht u ngjiti në nivelin 633 mld lekë (nga 609 mld lekë në dhjetor 2020).

Përveç kredisë afatshkurtër dhe asaj të dhënë për sektorin publik, të cilat kanë shënuar rënie krahasuar me fundin e vitit të kaluar, të gjitha kategoritë e tjera të kredisë sipas sektorit, valutës dhe afatit janë zgjeruar krahasuar me dhjetorin 2020. Megjithatë, kontributin kryesor në ecurinë pozitive të stokut të kredisë për periudhën e dha zgjerimi i kredisë afatgjatë, kredisë për bizneset, kredisë për individët dhe asaj në monedhën vendase. Sipas klasave të kredisë, zgjerim është vënë re kryesisht për klasën e parë të klasifikimit (ajo standard), ndikuar si nga fluksi i kredisë së re ashtu edhe nga rritja e vlerës së kredive të pashlyera në kohë brenda kësaj klase. Për kategoritë e tjera të klasifikimit të kredisë, është regjistruar tkurrje, ku vlen të veçohet tkurrja e kredive në klasat nënstandard dhe të dyshimta, si rrjedhojë e shlyerjeve dhe ristrukturimit të një pjese të tyre.

Stoku i kredive nënstandard dhe atyre të dyshimta u tkurr me 9% dhe 33%, respektivisht, krahasuar me dhjetorin 2020. Për shkak të peshës së konsiderueshme të kredisë në valutë (50%) zhvillimet në kursin e këmbimit luajnë një rol të rëndësishëm në kundërvlerën nominale të saj në monedhën vendase. Efekti i kursit të këmbimit në ndryshimin e kredisë në valutë të konvertuar në lekë gjatë tetë muajve të parë të vitit 2021 ishte negativ me 3.5 mld lekë dhe ky efekt reflekton forcimin e Lekut ndaj Euros. Duke përjashtuar ndikimin e kursit të këmbimit ndryshimi i kredisë në valutë referuar fundit të vitit 2020, do të ishte +3.7% nga +2.5%.

Kredia e re e dhënë gjatë tetë muajve të parë të vitit 2021 ishte rreth 34% më e lartë në krahasim me atë dhënë për të njëjtën periudhë një vit më parë, ndërsa kredia e re e dhënë gjatë muajit gusht ishte sa mesatarja mujore e 12 muajve të fundit. Rreth 70% e kredisë së re (dhënë gjatë vitit 2021) është akorduar për subjektin biznes, të cilët kredinë e re e kanë marrë kryesisht për qëllime afatshkurtra (overdraft dhe kapital qarkullues). Ndërkohë, gjatë tetë muajve të parë të vitit, fluksi i kredisë për investime në pasuri të paluajtshme për bizneset është zgjeruar me 33% krahasuar me të njëjtën periudhë një viti më parë.

Cilësia e kredisë ka vijuar të përmirësohet në harkun kohor të një viti dhe raporti i kredive me probleme (RKP) shënoi nivelin më të ulët, me 7%, përgjatë dekadës së fundit (që prej muajit dhjetor 2009). Krahasuar me një vit më parë, teprica e kredive me probleme u tkurr me 8.5%, ndërsa RKP ra me 1.2 p.p., duke reflektuar rënien e shpejtë në stokun e kredive me probleme. Përmirësimi i stokut të kredive me probleme në terma vjetorë është shënuar për të gjitha kategoritë e kredisë, përveç kredisë për individët dhe asaj në lek. Kredia me probleme për sektorin e individëve u zgjerua me 6.4% gjatë 12 muajve të fundit, ndërsa kredia në lekë mbeti e pandryshuar. Gjatë kësaj periudhe, ecuria e kredive me probleme është përcaktuar nga rritja e shlyerjeve dhe rriklassifikimi i një pjese të kredive në klasat “nënstandard” dhe “të dyshimta”.

Struktura e kredive me probleme dominohet nga kreditë e humbura (52%), ndërsa kreditë e dyshimta dhe ato nënstandard zënë përkatësisht 19% dhe 28% të totalit. Pesha e kredive të humbura ndaj tepricës së përgjithshme të kredive



me probleme ka shënuar rritje vitin e fundit, dhe kjo rritje pasqyron rënien në stokun e kredive në klasat e tjera të kredive me probleme.

Cilësia e kredisë mbetet për tu monitoruar në vijimësi, pasi me shfuqizimin e masave të marra nga Banka e Shqipërisë për shtyrjen e pagesës së kësteve të kredisë nga ana e bizneseve, stoku i kredive me probleme mund të shënojë rritje.

Treguesit e likuiditetit shënuan rritje të lehtë gjatë muajit gusht, ndërkohë që të gjitha bankat ruajnë raporte dukshëm më të larta në krahasim me kufijtë e poshtëm rregullatorë, si për monedhat e veçanta, ashtu edhe për totalin e aktiveve likuide. Raporti kredi/depozita shënoi 46% duke rënë ndaj një viti më parë (48%). Për valutën raporti shënoi rënie ndërsa për monedhën vendase ky raport u rrit lehtë ndaj një muaji dhe një viti më parë. Rezultati financiar i sektorit bankar në fund të gushtit ishte pozitiv (+13.2 mld lekë), por më i lartë (+28%) ndaj një viti më parë. Rezultati neto nga interesat rezultoi 30 mld lekë, ose rreth 1.9 mld lekë më i lartë se një vit më parë. Në këtë zhvillim kanë ndikuar kryesisht rritja në të ardhurat nga interesat e arkëtuara nga klientët, por edhe rënia e shpenzimeve për interesa. Shpenzimet për provigjionimin e kredive bankare gjatë periudhës janar – gusht ishin rreth 1.5 mld lekë ose 2 mld lekë më pak në krahasim me një vit më parë. Shpenzimet për provigjionimin e mjeteve të tjera financiare ishin rreth 1.3 mld lekë nga një vlerë e papërfillshme një vit më parë. Efekti i kombinuar i të dyja tipeve të shpenzimeve për provigjione në rezultatin neto të sektorit bankar ishte pozitiv me 0.7 mld lekë.

Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe asnjë bankë e sektorit nuk ka raportuar normë mjaftueshmërie nën minimumin rregullator prej 12%. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për të gjithë sektorin ra në 18% nga 19% gjashtë muaj më parë. Në krahasim me një vit më parë kjo normë ishte 0.2 p.p. më e ulët dhe rënia reflekton rritjen e nivelit të aktiveve të peshuara me rrezik. Në rënien me 0.8 p.p. të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit gjatë gjysmës së parë të vitit, ka ndikuar rritja e aktiveve të peshuara me rrezik. Gjatë periudhës, niveli i kapitalit rregullator të sektorit bankar regjistroi një rritje të lehtë duke arritur në 158 miliardë lekë në fund të muajit qershor. Rritja në kapitalin rregullator të bankave u ndikua nga rritja e fitimit të pashpërndarë dhe rezervave. Fitimi

i pashpërndarë i periudhave të mëparshme ka qenë elementi me kontributin kryesor në rritjen e kapitalit aksioner dhe atij rregullator gjatë dy viteve të fundit. Në ruajtjen e fitimit të pashpërndarë nga periudhat e mëparshme ka ndikuar edhe ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë me vendimet e muajve prill dhe korrik²³ të vitit 2020 dhe janar 2021²⁴, për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat.

Për të vlerësuar rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve nga ekonomia reale ose tregjet financiare në një horizont afatmesëm, Banka e Shqipërisë kryen në mënyrë periodike ushtrimet e provës së rezistencës. Prova e rezistencës për mjaftueshmërinë e kapitalit tregon shkallën e rezistencës së bankave individuale në terma të kapitalit dhe synon të evidentojë përshtatshmërinë e kapitalit në përballimin e goditjeve të supozuara mbi rritjen ekonomike, kredinë, nivelet e kursit të këmbimit dhe normat e interesit. Në tërësi, këto ushtrime të kryera për fundin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, dhe të shtrira në periudhën 2021 – 2022, tregojnë që sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj goditjeve të mundshme makroekonomike. Rezultatet gjithashtu tregojnë që banka të veçanta janë më të ekspozuara ndaj goditjeve të supozuara dhe kanë nevojë të fuqizojnë pozicionet e tyre të kapitalit.

Rrezikët e sektorit bankar

Bankat kanë perceptuar rritje të rreziqeve ekonomike dhe financiare gjatë periudhës, por besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar është ruajtur i pandryshuar në vijim të treguesve të mirë financiarë dhe masave të marra për ruajtjen e tyre. Rreziku i kredisë shënoi rënie të ndjeshme gjatë periudhës. Një përmirësim është shfaqur pothuaj në të gjitha kategoritë e kredive, dhe ka ardhur njëkohësisht nga ulja e stokut të kredive me probleme dhe rritja e tepicës së kredisë.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar vlerësohet në nivele të mira por ka nevojë për monitorim të kujdesshëm. Treguesit e likuiditetit, në lek dhe valutë, mbeten ndjeshëm mbi nivelet

²³ Vendimi nr. 24, dt. 08.04.2020 dhe vendimi nr. 40, dt. 01.07.2020 “Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat” me efekt përkatësisht deri në fund të muajit qershor dhe muajit dhjetor të vitit 2020.

²⁴ Vendimi nr.4, dt.13.01.2021 “Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat” me efekt deri në 31 dhjetor 2021.



minimale rregullative. Hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur, në raport me totalin e aktiveve në afatin e shkurtër, vijon të mbetet i lartë. Prania e vlerave të larta të aktiveve likuide dhe prania e vlerave të zgjeruara të hendekut të maturimit në afatin e shkurtër, janë dy faqe të së njëjtës medalje. Kjo do të thotë që për shkak të ndryshimit të strukturës së detyrimeve të sektorit bankar dhe orientimit të tyre drejt instrumenteve pa afat, bankat janë të prirura të investojnë në aktive me cilësi më të lartë të likuiditetit. Kjo qasje mundëson likuidimin e këtyre aktiveve në rast nevojë për të përballuar një situatë stresi në përmbushjen e detyrimeve.

Rreziqet e tregut, nuk shfaqën ndryshime të rëndësishme gjatë periudhës por administrimi i kujdesëm i tyre mbetet i nevojshëm. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit ka shënuar një rënie të lehtë në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit të shkuar. Treguesi i mospërputhjes valutore për të gjitha monedhat shënoi rënie. Në lidhje me rrezikun e normës së interesit vërehet një rritje e ekspozimit të sektorit bankar ndaj tij. Madhësia e ndikimit për shkak të pozicionit total neto të peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator të sektorit bankar, shënoi 5.6% në fund të vitit, duke u rritur me 1.3pp ndaj periudhës së mëparshme. Kontributi në rritjen e treguesit erdhi nga të dy elementët përbërës që i referohen diferencës së peshuar të aktiveve me pasivet me normë interesi të fiksuar dhe asaj për aktivet dhe pasivet me normë të ndryshueshme interesi. Duke qenë se pozicioni total neto është pozitiv, sektori mbart ekspozim relativ ndaj ndryshimit të normës së interesit, por ndikimi vlerësohet relativisht i ulët duke qenë ndjeshëm nën limitin e sipërm rregullator.

Rreziqet e veprimtarisë bankare reflektojnë dhe ndërthuren me zhvillime të natyrës strukturore. E tillë është ekzistenca për një kohë të gjatë e mjedisit me norma të ulëta interesi, i cili ruan presionin mbi rezultatit financiar të bankave, nxit ndryshimin e strukturës së financimit të tij drejt burimeve më afatshkurtra dhe nevojës për aktive likuide të larta, si dhe ruan potencialin për rritje të stresit të veprimtarisë në rastin e një korrigjimi të fortë e të papritur. Përdorimi i lartë i valutës në sektorin bankar shoqërohet me rreziqe për administrimin e riskut të likuiditetit në valutë. Në tërësi, indekset e

vlerësimit të rrezikut sistematik shfaqin rritje gjatë periudhës.

Nëpërmjet veprimeve rregullatore të natyrës mikroprudenciale dhe instrumenteve të politikës makroprudenciale, Banka e Shqipërisë është përpjekur t'i adresojë këto rreziqe. Disa akte të reja rregullatore që po zbatohen, ku përfshihen ai për raportin e mbulimit të likuiditetit, paketa e masave për de-euroizimin, si edhe rregullorja për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, synojnë zbutjen e rreziqeve dhe forcimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj tyre.

Banka e Shqipërisë vlerëson se sistemi financiar dhe sektori bankar kanë vijuar të performojnë në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht rreziqeve të veprimtarisë. Situata më e mirë në shëndetin publik dhe rigjallërimi i aktivitetit ekonomik në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit tregon për ndërvartësinë që ekziston mes këtyre elementëve dhe evidenton rëndësinë që ka përsheptimi i procesit të vaksinimit dhe kuptimi i këtij procesi nga publiku. Paralelisht, zhvillimet e javëve të fundit tregojnë për pasigurinë që ende mbart ecuria e pandemisë, dhe nevojën që politikat ekonomike, financiare e prudenciale të mbeten të orientuara drejt zbutjes së efektit të këtyre pasigurive mbi performancën e ekonomisë. Për sektorin bankar, mbetet aktuale rëndësia e vlerësimit të rregullt të shkallës së ekspozimit ndaj rreziqeve, dhe e ruajtjes së një qëndrimi proaktiv në drejtim të marrjes së masave për zbutjen dhe përballimin e tyre.

Politika makroprudenciale

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021, Banka e Shqipërisë iu përmbajt masave me natyrë prudenciale të marra për lehtësimin e kërkesave për klasifikimin dhe provigjonimin e kredive të ndikuara nga pandemia, edhe në kushtet e ristrukturimit të tyre. Me një mundësi më të lartë të rritjes së kredive me probleme pas heqjes së këtyre masave dhe nevojën për të pasur nivele sa më të përshtatshme të kapitalit, Banka e Shqipërisë përcaktoi edhe disa kufizime lidhur me shpërndarjen e fitimit të bankave në formën e dividendit.

Përgjatë periudhës, është vlerësuar se këto masa kanë qenë të përshtatshme, duke konsideruar:

- strukturën e sektorit bankar, karakteristikat e ekonomisë dhe nevojën për të operuar me nivele relativisht më të larta të kapitalit;



- mundësinë e krijuar nga lehtësimet rregullative prudenciale që bankat të zbusin goditjen në treguesit e tyre financiare, duke përfshirë edhe nivelet e kapitalit;

- nevojën për të ruajtur hapësirën për të vepruar, në rast se kjo bëhet e nevojshme nga zhvillimet e ardhshme.

Në këto kushte, në zbatim të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, është vijuar me publikimin e vendimeve të Guvernatorit²⁵, për zbatimin e këtyre shtesave.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka vijuar me operacionalizimin e vlerave të kapitalit që mbulojnë rreziqet strukturore të sistemit financiar, si dhe konceptimin e instrumenteve që parandalojnë rritjen e tepërt të kredisë dhe të borxhmarrjes, kryesisht nga sektori i individëve.

Sektori bankar vijoi të shfaqë një trend të qëndrueshëm në drejtim të shpërndarjes dhe përdorimit të burimeve financiare. Kjo u pasqyrua edhe në Indeksin Herfindahl, i cili mat nivelin e përqendrimit në sektorin bankar. Treguesit e përqendrimit, të matur nga Indeksi Herfindahl, për totalin e aktiveve, depozitave dhe huave, kanë dëshmuar për një përqendrim relativisht të lartë në sektorin bankar në terma të aktiveve, depozitave dhe më pak për kreditë. Megjithatë, ka një shpërndarje pak më të mirë të peshave në treg gjatë viteve të fundit që rrjedhimisht tregon rritjen e konkurrueshmërisë

²⁵Mund të gjenden në adresën:

https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/



Tabela 2. Indeksi i përqendrimit Herfindahl i aktiveve, kredive dhe depozitave

Treguesi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Gusht 2021
HI aktive	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15	0.14	0.14	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.15	0.14
HI depozita	0.17	0.15	0.16	0.16	0.15	0.14	0.14	0.14	0.14	0.15	0.15	0.15	0.15	0.14
HI kredi	0.11	0.11	0.11	0.12	0.12	0.12	0.12	0.12	0.13	0.13	0.13	0.12	0.12	0.12

Tabela 3. Hua me probleme, në përqindje

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Gusht 2021
Raporti i huave me probleme	6.64	10.48	13.96	18.77	22.49	23.49	22.8	18.22	18.27	13.2	12.9	8.4	8.1	7.0

Tabela 4. Diferenca e normave të interesit

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Gusht 2021
Spread i normave të interesit (mesatarja e normave të kredisë dhe depozitave)	5.69	6.81	5.96	5.6	5.4	6.1	5.89	5.67	4.76	5.13	5.02	4.99	4.91	4.36

Tabela 5: Treguesit kryesorë të përfitueshmërisë, në përqindje (kumulative)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Gusht 2021
Të ardhura nga interesi/aktiveve mesatare që sjellin të ardhura	8.1	8.11	7.78	7.73	7.31	6.28	5.72	5.2	4.71	4.51	4.10	3.98	3.88
Shpenzime interesi/pasive mesatare që shkatojnë shpenzime	4.06	3.78	3.57	3.72	3.42	2.14	1.29	0.94	0.69	0.66	0.61	0.54	0.46
Marzhi neto i interesave (NIM)	4.04	4.32	4.2	4.01	3.88	4.15	4.42	4.23	3.92	3.77	3.43	3.39	3.36

Burimi: Banka e Shqipërisë

*Tregu i sigurimeve*

Tregu i sigurimeve përbëhet nga 12 shoqëri sigurimesh. Në strukturën e tregut, 8 shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës dhe 4 në sigurimet e Jetës. Një nga shoqëritë e Jo-Jetës kryen edhe aktivitetet risigurimi. Bazuar në pasqyrën e llogarisë teknike të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës, edhe gjatë këtij viti vihet re se tregu i sigurimeve vazhdon të dominohet nga portofoli i MTPL së brendshme.

Totali i primeve të shkruara bruto, për tregun e sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës më 31.12.2020 ishte 16.61 miliardë lekë duke shënuar një ulje prej 1,010 milionë lekë ose e përkthyer në përqindje në masën 5.73% krahasuar me një vit më parë. Kjo ulje ka ardhur si rezultat i një ulje të volumit të primeve të shkruara bruto në masën 960 milionë lekë ose 5.85% për tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës ka shënuar një ulje prej 51 milionë lekë ose 4.18 %. Rënia në të ardhurat e primeve nga sigurimet për të gjithë tregun e sigurimeve është shkaktuar nga masat e marra si pasojë e pandemisë COVID-19, të cilat kufizuan lëvizjen e automjeteve dhe qytetarëve.

Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit për tregun e Jo-Jetës është i mjaftueshëm, me 2.7 miliardë lekë mbi nivelin e kërkuar, ose 169.66%. Për tregun e Jetës treguesi është sërish i mjaftueshëm me rreth 558 milionë lekë mbi nivelin e kërkuar ose 137.72%. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka pësuar rritje për të dyja tregjet e sigurimeve.

Treguesit e Rentabilitetit ROE (Kthimi nga kapitalet e veta) dhe ROI (Kthimi nga investimi), janë përkatësisht: ROE në nivelin 8.73% dhe ROA 2.68%. Të dy treguesit kanë pësuar rritje për vitin 2020, duke reflektuar një rritje të qëndrueshme dhe në përpjesëtim të drejtë të fitimeve, aktiveve dhe kapitaleve të veta të shoqërive të sigurimit.

Totali i aktivitetit të tregut të sigurimit, sipas pasqyrave financiare, është 38.86 miliardë lekë dhe ka pësuar rritje në vlerën 61.65 milion lekë. Kjo rritje ka ardhur kryesisht nga sektori i Jetës si rezultat i rritjes së zërit “Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare”. Totali i aseteve në tregun e Jetës u rrit me 709 milionë ose 17.3% më shumë krahasuar me vitin 2019.

Rezultati financiar neto i tregut të sigurimeve është pozitiv në vlerën 1 miliard lekë.

Në janar – shtator 2021, tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 18.06%. Volumi i primeve të shkruara bruto arriti shifrën 14.17 miliardë lekë.

Totali i aktiveve të tregut të sigurimeve sipas të dhënave të raportuara në 30.06.2021, është 39 miliardë lekë, me rritje prej rreth 3% krahasuar me fund vitin 2020.

Tregu i Fondeve të Investimeve

Struktura e tregut të Fondeve të Investimeve deri më 31.12.2020 përbëhej nga tetë fonde investimi.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 31.12.2020, vlera neto e aseteve të Fondeve, ishte mbi 67.4 miliardë lekë me një rritje prej 0.9% krahasuar me fundin e vitit 2019.

Numri i investitorëve që kanë investuar në këtë treg më 31.12.2020 arriti në 32 656 investitorë, duke shënuar një rritje prej 11.67% krahasuar me 31.12.2019. Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve më 30.06.2021, vlera neto e aseteve të Fondeve ishte mbi 71.85 miliardë lekë me një rritje prej 6.60% krahasuar me 31.12.2020.

Tregu i Pensioneve Private Vullnetare

Struktura e tregut të pensioneve private vullnetare përbëhet nga katër fonde pensioni, të cilat administrohen nga tre shoqëri të ndryshme administrimi.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 31.12.2020 tregon një total të aktiveve neto prej 3.6 miliardë lekë me një rritje prej 23.8% krahasuar me fundin e vitit 2019.

Gjatë vitit 2020, investimet e tregut të Fondeve të Pensioneve përbëhen nga Obligacione thesari të Republikës së Shqipërisë me afat maturimi 5, 7 dhe 10 vjeçar.

Analiza e të dhënave për tregun e pensioneve private vullnetare më 30.06.2021 tregon një total të aktiveve neto prej 3.98 miliardë lekë me një rritje prej afro 372.02 milionë lekë, ose 10.32% krahasuar me fundin e vitit 2020.

3.2 Kapacitetet për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

3.2.1 Kapitali njerëzor dhe kapitali fizik

Funksionimi i tregut të punës

Implikimet në tregun e punës deri më tani nuk duket të kenë qenë shqetësuese, veçanërisht në



lidhje me implikimet strukture afatgjata për këtë fondament të ekonomisë.

Referuar anketës tremujore të forcës së punës nga INSTAT, shkalla e punësimit për popullsinë 15 – 64 vjeç, në tremujorin e tretë të vitit 2021 është 62.0%. Gjatë këtij tremujori, numri i të punësuarve gjithsej u rrit me 2.1% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë (T3-2020), ky tregues u rrit me 0.2%. Ritmi vjetor i ndryshimit të punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i tretë i vitit 2020 në tremujorin e tretë 2021, është +0.7%. Në terma vjetorë, sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë, punësimi u rrit me 10.1% në sektorin e industrisë, me 0.5% në sektorin e shërbimeve, ndërsa u ul me 4.5% në sektorin e bujqësisë.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për popullsinë 15 – 64 vjeç, ishte 70.1%. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës ishte 0.3 pikë përqindje më e lartë, ndërkohë krahasuar me tremujorin e mëparshëm (T2-2021) ky tregues u rrit me 1.1 pikë përqindje.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15 – 29 vjeç, gjatë tremujorit të tretë 2021, ishte 53.5%. Ky tregues u rrit me 0.2 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020, dhe me 1.6 pikë përqindje në krahasim me tremujorin e dytë 2021. Për popullsinë 30 – 64 vjeç, në tremujorin e tretë 2021, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 78.5%.

Në tremujorin e tretë të vitit 2021, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11.3%. Shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0.3 pikë përqindje, si në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2020, ashtu dhe me tremujorin e dytë të vitit 2021.

Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 19.9%. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2020, shkalla e papunësisë për të rinjtë, në tremujorin e tretë 2021, u ul me 0.8 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e dytë 2021, ky tregues ka mbetur në të njëjtin nivel. Shkalla e papunësisë për grup-moshën 30 – 64 vjeç ishte 8.7%. Në terma vjetorë ky tregues ka rënë me 0.3 pikë përqindje, ndërsa krahasuar me tremujorin e mëparshëm ulet me 0.8 pikë përqindje.

Dinamika e tregut të punës po përmirësohet vazhdimisht duke reflektuar efektivitetin e politikave të ndërmarra nga qeveria që shkon në favor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe nxitjes së punësimit



Tabela e të dhënave të tregut të punës (15 vjeç e lart)

(Në %)		Shkalla Zyrtare e Papunësisë	Shkalla e Punësimit	Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore
2012	Q1	12.9	51.1	58.7
	Q2	13.3	50.2	57.9
	Q3	13.6	48.6	56.2
	Q4	13.6	48.7	56.4
2013	Q1	14.3	47.0	54.9
	Q2	16.0	44.1	52.5
	Q3	16.8	42.9	51.5
	Q4	16.8	42.4	50.9
2014	Q1	18.2	41.5	50.8
	Q2	17.2	44.4	53.6
	Q3	17.0	45.8	55.2
	Q4	17.6	45.6	55.3
2015	Q1	16.9	45.6	54.8
	Q2	17.0	45.8	55.2
	Q3	17.2	46.3	55.9
	Q4	17.3	47.0	56.8
2016	Q1	16.6	47.5	56.9
	Q2	15.5	48.4	57.2
	Q3	14.7	49.9	58.6
	Q4	14.2	49.1	57.2
2017	Q1	14.2	49.2	57.3
	Q2	13.9	50.0	58.1
	Q3	13.6	50.7	58.7
	Q4	13.4	51.2	59.1
2018	Q1	12.5	51.9	59.3
	Q2	12.4	52.0	59.3
	Q3	12.2	52.2	59.4
	Q4	12.3	52.3	59.6
2019	Q1	12.1	52.5	59.7
	Q2	11.5	53.6	60.6
	Q3	11.4	53.8	60.7
	Q4	11.2	53.8	60.6
2020	Q1	11.4	53.1	60.0
	Q2	11.9	51.7	58.8
	Q3	11.6	53.2	60.2
	Q4	11.8	52.0	59.0
2021	Q1	11.9	51.9	58.8
	Q2	11.6	52.4	59.3
	Q3	11.3	53.7	60.5

Burimi: INSTAT



Lidhur me shpenzimet për arsim, totali i fondeve/ tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me Vendimin Nr. 527, datë 22.7.2020 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021 – 2023”, për vitin 2021 është 43 miliard e 852 milion lekë, krahasuar me fondet e rishikuara të vitit 2020 ka një rritje prej 5.5%. Për vitin 2022 janë miratuar 44 miliard e 431 milion lekë dhe për vitin 2023 janë miratuar 45 miliard e 512 milion lekë. Fondet e miratuara për vitin 2023, krahasuar me vitin 2020 sipas VMK-së Nr. 527, datë 22.7.2020 kanë një rritje prej 9%.

Fondet e parashikuara në sistemin e arsimit bazuar në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, për periudhën afatmesme 2022 – 2024, janë sa vijon:

- Fondet e miratuara për vitin 2022, me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, janë në vlerën 45 miliard e 658 milion lekë, krahasuar me fondet e miratuara për vitin 2021 kanë një rritje prej 2 miliard e 676.7 milion lekë ose 6.2% më shumë se viti 2021.

- Fondet e miratuara për vitin 2023, me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, janë në vlerën 44 miliard e 484 milion lekë, krahasuar me fondet e miratuara për vitin 2022, kanë një ulje prej 1 miliard 174.4 milion leke ose -2.6% më pak se viti 2022.

- Fondet e miratuara për vitin 2024, me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2022”, janë në vlerën 45 miliard e 956 milion lekë, krahasuar me fondet e miratuara për vitin 2023, kanë një rritje prej 1 miliard e 472 milion lekë ose 3.3% më shumë se viti 2023.

Fondet e parashikuara për arsimin, sipas projektligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, parashikohet të arrijnë në 7.16% të shpenzimeve publike për vitin 2022, në 7.1% të këtyre shpenzimeve në vitin 2023, si dhe në 6.97% në vitin 2024. Fondet për arsimin janë parashikuar të arrijnë në 2.45% të PBB-së në vitin 2022, në masën 2.26% të PBB-së në vitin 2023, si dhe në nivelin 2.22% të PBB-së për vitin 2024.

Fondet për “Sektorin e Arsimit” parashikuar për periudhën afatmesme 2022 – 2024 përfshijnë: të ardhurat dytësore të IAL publike; të ardhurat e tjera për arsimin nga të tretë; fondet e parashikuara nga

Ministria e Mbrojtjes “Akademia e Forcave të Armatosura”; fondet e parashikuara nga Ministria e Drejtësisë “Shkolla e magistraturës”; fondet e parashikuara nga Ministria e Brendshme “Akademia e Sigurisë”; fondet e parashikuara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë “Fonde për arsimin dhe formimin profesional”; fondet e parashikuara të njësive të vetëqeverisjes vendore “për shërbimet dhe funksionet në arsimin parauniversitar”, si dhe fondet nga projekte të veçanta të donatorëve (*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private)

- Në vitin 2022, fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 65.6 miliard lekë, ose 10.29% të shpenzimeve publike, ose 3.51% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

- Në vitin 2023, fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 67.04 miliard lekë, ose 10.71% të shpenzimeve publike, ose 3.41% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

- Në vitin 2024, fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 71.3 miliard lekë, ose 10.91% të shpenzimeve publike, ose 3.47% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB).

3.2.2 Struktura sektoriale dhe ajo e ndërmarrjeve

Statistikat për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) bazuar në rezultatet e vrojtimet të Statistikave Strukturore, për vitin 2019, shprehin se:

- 99.8% të ndërmarrjeve aktive e zënë NVM, në të njëjtën përqindje si në vitin 2018.

- 81.6% e të punësuarve janë punësuar nga NVM nga 79.8% që ishte në vitin 2018.

- 78.9% të shitjeve neto realizohen nga NVM nga 77.4% të realizuara në vitin 2018.

- 68.2% të investimeve në vend kryhen nga NVM nga 70.6% të kryera në vitin 2018.

- Në numrin e ndërmarrjeve, sektori i tregtisë ka peshën më të madhe të NVM-ve me 40.1%, ndërsa përqindjen më të ulët e ka sektori i energjisë elektrike, ujë dhe menaxhimit të mbetjeve me 0.6%.

- Në numrin e të punësuarve, sektori i tregtisë punëson 28.5% të NVM-ve, ndërsa sektori me numrin më të vogël të të punësuarve në NVM është sektori i industrisë nxjerrëse me 1.8%.

- Në vlerën e shitjeve neto, sektori i tregtisë mbizotëron me 52.4%, ndërsa sektori me



përqindjen më të ulët të shitjeve të realizuara nga NVM-të është sektori i industrisë nxjerrëse me 2.4%.

- Në vlerën e investimeve, sektori me përqindjen më të lartë të investimeve të kryera në NVM është sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 31.4%, ndërsa sektori i industrisë nxjerrëse ka përqindjen më të ulët të investimeve prej 2.2%.

- Ndërmarrjet me 250+ të punësuar edhe pse përbëjnë vetëm 0.2 % të ndërmarrjeve gjithsej në vend, punësojnë 18.4% të të punësuarve, kryejnë 31.8 % të investimeve dhe realizojnë 21.1% të shitjeve neto.

- 3.1% e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme eksportojnë mallra nga 2.5% që eksportuan në vitin 2018. Vlera e eksporteve të mallrave të NVM përbën 59.4% të vlerës së eksporteve gjithsej. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve eksportuese është industria nxjerrëse me 23.7%.

- 10.8% e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë importuese nga 8.8% që ishin në 2018, të cilat përbënë 78.0% të vlerës së importeve të mallrave për 2019. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve importuese është sektori i industrisë nxjerrëse me 24.2%.

Për më shumë të dhëna dhe shpjegime metodologjike referojuni linkut në vijim: <http://instat.gov.al/media/8121/rezultatet-e-nvm-2019.pdf>.

3.2.3 Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

Raporti vjetor i ndihmës shtetërore për vitin 2020 është përgatitur në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore. Raporti vjetor i ndihmës shtetërore për vitin 2020 nuk përfshin të dhëna për ndihmat në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, sepse këta sektorë janë jashtë objektit të zbatimit të ligjit Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

Shuma totale e ndihmës shtetërore gjatë vitit 2020 arriti në vlerën 30 761.82 milionë lekë (248.56 milionë euro), e kategorizuar në:

- Ndihma shtetërore horizontale – në vlerë absolute për vitin 2020 ishte 28 843.57 milionë lekë (233.06 milionë euro) dhe krahasuar me vitin 2019 u rrit me 24 633.13 milionë lekë. Pesha për këtë kategori ishte 93.76%;

- Ndihma sektoriale shtetërore në vlerë absolute për vitin 2020 ishte 1 918.25 milionë lekë (15.5 milionë euro) dhe krahasuar me vitin 2019 u ul me 2 328.12 milionë lekë. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës shtetërore në vitin 2020 ishte 6.24%.

Në terma nominalë, totali i shpenzimeve për ndihmën shtetërore në vitin 2020 u rrit me 22 305.01 milion Lek, krahasuar me vitin 2019. Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore gjatë vitit 2020 ishin garancitë shtetërore, grantet dhe përjashtimet nga taksat.

Gjatë vitit 2021, Sektori i Nxitjes së Biznesit, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur projektligjin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Miratimi i projektligjit synohet të bëhet brenda vitit 2022. Elementët kryesorë të projektligjit të ri, janë si më poshtë:

- Përafrimi i Rekomandimit të Komisionit të datës 6 maj 2003 në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe metodat e llogaritjes për kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (Njoftimi zyrtar L 124 , 20/05/2003 P. 0036 - 0041). CELEX 32003H0361) dhe zbatimin e metodologjisë për përdorimin e saj nga bizneset;

- Është shtuar edhe përkufizimi për ndërmarrjet e mesme;

- Sigurimi i mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore;

- Përcaktimi i formave të mbështetjes shtetërore për sipërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si: mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, nga partnerë zhvillimi vendas apo të huaj, garanci për kreditë shtetërore sipas legjislacionit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore, në zbatim të politikave specifike të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parimet dhe rregullat fiskale për qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe kufizimet e borxhit shtetëror dhe garancive të kredive shtetërore, si dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse publike për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA);

- Përgatitja e raportit vjetor nga AIDA, bazuar në bazën e të dhënave të skemave financiare dhe



mbështetjes së shërbimeve publike për NMVM-të e ofruara nga autoritetet shtetërore si dhe nga partnerë zhvillimi vendas apo të huaj;

- Krijimi dhe funksionimi i Këshillit Konsultativ për ndërmarrjet;

- Një referencë ligjore për hartimin dhe miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve.

Një kopje e projektligjit është dërguar pranë shërbimeve të Komisionit Evropian për konsultim paraprak.

Në zbatim të Aktit Normativ Nr. 15 datë 15.04.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, fondet e AIDA-s për vitin 2020 u administruan nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe iu shpërndanë kompanive shqiptare si skema mbështetëse për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19.

Gjatë vitit 2021, një grup pune i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të AIDA-s, si dhe nga ekspertë të TAIEX, punoi për të hartuar skemën e re në mbështetje të NVM-ve shqiptare. Grupi i punës miratoi ndryshimet e skemës, bazuar në Direktivat e BE-së, propozimet e komunitetit të biznesit, si dhe në rekomandimet e ekspertëve. Procesi i ridizajnit të skemës përfundoi dhe tani është në proces miratimi për lançim. Lancimi i skemës varet nga miratimi i projektligjit “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”.

3.2.4 Integrimi tregtar

Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë janë të përqëndruara me vendet e BE-27.

Sipas publikimit të INSTAT, të nëntorit 2021, shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 58.0% të të gjithë tregtisë. Në nëntor 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70.8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 52.1% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30.1%), Greqia (8.0%), Turqia (8.0%), Greqia (7.2%) dhe Kina (5%).

Shkëmbimet tregtare për 11-mujorin 2021, me vendet e BE-së zënë 60.2% të të gjithë tregtisë. Në periudhën janar – nëntor 2021, eksportet drejt

vendeve të BE-së zënë 72.0% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54.6% të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30.1%), Turqia (7.8%), Greqia (7.2%) dhe Gjermania (6.5%)

Në këtë 11-mujor eksportet e mallrave arritën vlerën 337 mld lekë, duke u rritur me 35%, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 713 mld lekë, duke u rritur me 31.1%, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 376 mld lekë, duke u rritur me 27.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

PJESA 4

KAPITULLI 1: LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

4.1.1 Përmbajtja e kapitullit

Parimi i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton që produktet duhet të tregtohen në mënyrë të lirë nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian në një tjetër. Në një numër sektorësh ky parim i përgjithshëm plotësohet nga kuadri rregullator i harmonizuar në “qasjen e vjetër” (vendosja e specifikave të sakta në mallrat) ose “qasja e re” (vendosja e kërkesave të përgjithshme në mallrat). Legjislacioni i harmonizuar evropian në lidhje me mallrat, i cili duhet të transpozohet, përfaqësohet në pjesën më të madhe të *acquis* në këtë kapitull. Përveç kësaj, kjo kërkon kapacitete të mjaftueshme administrative të cilat janë thelbësore në notifikimin e kufizimeve në tregti si dhe për të zbatuar masa horizontale dhe procedurale në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

4.1.2 Struktura e kapitullit

1. Parimet e përgjithshme

1.1 Masat me efekt të njëjtë me kufizimet sasiore

1.2 Njohja e ndërsjellë e produkteve

1.3 Shkëmbimi i informacionit mbi pengesat në lëvizjen e lirë të mallrave

2. Çështjet horizontale

2.1 Standardizimi

2.2 Akreditimi

2.3 Vlerësimi i konformitetit

2.4 Metrologjia

2.5 Mbikëqyrja e tregut

3. Direktivat e përqasjes së vjetër

3.1 Mjetet motorike

3.2 Kimikatet

3.3 Praktikat e mira laboratorike



3.4 Prekursorët e drogave

3.5 Detergjentet

3.6 Plehrrat kimike

4. Direktivat e përqasjes së re

4.1 Pajisjet elektrike brenda disa kufijve të tensionit

4.2 Pajisjet e thjeshta nën presion

4.3 Siguria e lodrave

4.4 Siguria e makinerive

4.5 Pajisjet mbrojtëse personale

4.6 Lëndët plasëse për përdorime civile dhe fishekzjarrët

4.7 Pajisjet dhe sistemet në ambiente potencialisht shpërthyes

4.8 Ashensorët

4.9 Instrumentet e peshimit jo automatik

4.10 Instrumentet matës

4.11 Pajisjet nën presion

4.12 Bojlerët me ujë të nxehtë

4.13 Pajisjet e gazit

4.14 Pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit

4.15 Përputhshmëria elektromagnetike

4.16 Anijet çlodhëse

4.17 Instalime teleferike të projektuara për transport personash

4.18 Produktet e ndërtimit

4.19 Pajisjet e transportueshme nën presion

4.20 Emetimi i zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura

4.21 Limitet e emetimit dhe aprovimi i tipit të motorëve për përdorim jo-rrugor

4.22 Ecodesign për produktet me ndikim në energji

4.23 Pajisjet aerosol

4.24 Parapaketimet

4.25 Shishet enëmatëse

4.26 Njësitë matëse

4.27 Informacioni i konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet me ndikim në energji

5. Masat procedurale

5.1 Informacioni mbi rregulloret teknike

5.2 Armët e zjarrit

5.3 Transferimi i produktet në fushën e mbrojtjes

5.4 Xhami i kristalit

5.5 Tekstile

5.6 Këpucë

5.7 Transparenca e cmimeve të produkteve farmaceutike

5.8 Kthimin e objekteve kulturore të zhvendosura në mënyrë të paligjshme

4.1.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përfuar legjislacionin shqiptar me kapitullin 1 të legjislacionit evropian buron nga neni 70 dhe 75 i MSA-së.

Këto dispozita detyrojnë Shqipërinë që teknikisht të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë që ai të zbatohet dhe të hyjë në fuqi. Kështu, tashtë në këtë fazë të procesit të para-anëtarësimit, organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshira në ushtrimin e përafritit të legjislacionit shqiptar me atë të *acquis* që është në fuqi.

Për më tepër, kur legjislacioni i BE-së është subjekt konstant zhvillimi, përafriti i ligjeve nuk do të jetë i plotë me përshtatjen e legjislacionit shqiptar me atë të legjislacionit evropian aktualisht në fuqi. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve të BE-së është i nevojshëm si për përpjekjet e paraprimit, ashtu dhe përgatitjen e Shqipërisë si realitet i përditshëm për anëtarësimin në të ardhmen në BE.

Në kuadër të MSA-së, Partneriteti Evropian me Shqipërinë është instrumenti kryesor për të ndihmuar autoritetet shqiptare në realizimin e perspektivës evropiane të vendit.

Parimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë të mallrave nënkupton se produktet duhet të tregtohen lirisht nga një vend i Bashkimit Evropian në një tjetër. Lëvizja e lirë e mallrave është faktor kyç në rritjen dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. Ky parim është përcaktuar në nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), duke parandaluar Shtetet Anëtare të miratojnë ose të ruajnë kufizime të pajustificuara në tregtinë brenda BE-së.

Dispozitat e TFBE-së nuk përjashtojnë ndalimet e justifikuar për shkak të moralit publik, politikës publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose mbrojtjes së pronës industriale dhe tregtare, si dhe kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh. mbrojtjen e mjedisit). Megjithatë, ndalesa të tilla duhet të mbeten proporcionale dhe nuk duhet të përbëjnë



diskriminim arbitrar ose një kufizim të fshehtë në lidhje me tregtinë midis Shteteve Anëtare.

Masat që kanë efekt të njëjtë me kufizimet sasiore janë të ndaluara me përjashtim të një grupi të vogël masash kufizuese. Kjo konkretisht nënkupton eliminimin e pengesave teknike dhe përmbushjen e parimit të njohjes reciproke. Dispozitat administrative relevante duhet të miratohen për të zbatuar procedurat e njohjes reciproke të mallrave të tregtuara ligjërisht në një shtet tjetër anëtar, të përcaktuara në Rregulloren (EU) 2019/515 dhe shkëmbimit të informacionit në Rregulloren “Strawberry” (KE) Nr. 2679/98.

Në një numër sektorësh parimi i përgjithshëm plotësohet nga një kornizë rregulluese e harmonizuar. Masat horizontale përcaktojnë infrastrukturën e cilësisë që Shtetet Anëtare duhet të vendosin në fusha të tilla si standardizimi, vlerësimi i konformitetit, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut.

Legjislacioni i harmonizuar në lidhje me produktet evropiane, i cili duhet të transpozohet nga çdo shtet anëtar, përfaqëson pjesën më të madhe të *acquis* së këtij kapitulli. Ajo bazohet në “përqasjen e vjetër” që imponon specifikimet specifike të produktit dhe “përqasjen e re dhe globale” (imponon kërkesat e përgjithshme të produktit).

Legjislacioni në kuadër të përqasjes së re përfshin pajisjet e tensionit të ulët (LVD), përputhshmërinë elektromagnetike (EMC), lodrat, makineritë, ashensorët, emetimet e zhurmave në ambient, shkarkimet ndotëse nga pajisjet motorike të lëvizshme në rrugë, pajisjet personale mbrojtëse (PPE) sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera shpërthyes (ATEX), , aparate të gazit, enë nën presion, teleferikët, prodhimet e ndërtimit, anijet rekreative, kërkesat e projektimit ekologjik për produktet e lidhura me energjinë (ERP), etj. Legjislacioni i përqasjes së vjetër mbulon fushat e automjeteve, kimikateve, detergjenteve, prekursorët e drogave, praktikatat laboratorike.

Zbatimi në mënyrën e duhur i një sërë masash procedurale kërkojnë gjithashtu kapacitete të mjaftueshme administrative. Këto përfshijnë procedurën e njohjes në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve të përcaktuara në Direktivën 1535/2015/EU, legjislacionin mbi tregtinë e armëve, produktet e mbrojtjes, xhamin e

kristaltë, këpucët, etiketimin e tekstilit, çmimet e produkteve mjekësore dhe Direktivën 2014/60/BE për kthimin e objekteve kulturore të zhvendosura në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar në atë të një shteti tjetër anëtar.

4.1.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Rreth 55% (30 akte) e akteve nën këtë kapitull janë harmonizuar pjesërisht, ndërkohë që 45% janë të paharmonizuara. Gjatë periudhës raportuese ka pasur një progres të limituar në përafrimin sektorial me legjislacionin e produkteve të “përqasjes së re dhe globale” dhe në akreditimin e trupave të tjerë të vlerësimit të konformitetit.

Parimet e përgjithshme

Sa i përket fushës së pa harmonizuar dhe aplikimit të parimeve të parashikuara nga nenet 34 – 36 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian, Shqipëria është duke marrë masat për hartimin e një plani veprimi për heqjen e masave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore për tregtinë në mallra. Metodologjia për shqyrtimin e këtyre masave/barrierave është e finalizuar dhe puna për shqyrtimin e masave në disa sektorë të përcaktuar ka nisur. Planin i veprimit për shfuqizimin e masave në sektorët e përzgjedhur pritet të finalizohet, sipas planifikimeve, deri në fund të vitit 2022 (më shumë informacion të detajuar në seksionin 1.4.2). Duhet thënë se Planin i Veprimit pritet të jetë një dokument që do të duhet të përditësohet periodikisht.

Çështjet horizontale

Parimet e tregtimit të produkteve dhe mbikëqyrjes së tregut në Shqipëri rregullohen nga:

- ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtinë dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore” (i cili harmonizon pjesërisht Vendimin 768/2008/KE dhe Rregulloren 765/2008/KE, tashmë të ndryshuar me Rregulloren 2019/1020); si edhe

- legjislacioni specifik që rregullon veprimtarinë e institucioneve të infrastrukturës së cilësisë (standardizimi, akreditimi, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut).

Aktualisht ka nisur puna për hartimin e një dokumenti me natyrë strategjike për fushën e lëvizjes së lirë të mallrave (Roadmap) i cili do të parashikojë planifikimin e harmonizimit të



mëtejshëm ligjor dhe institucional për të gjithë fushën e harmonizuar, për një periudhë 7 vjeçare. Ky dokument pritet të finalizohet, deri në fund të vitit 2022 (info më e detajuar jepet në pikën 1.4.2).

Mbikëqyrja e tregut

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve zbatuese të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është kryer nëpërmjet ndryshimit të struktura të ISHMT si dhe nëpërmjet rritjes së numrit të inspektorëve. Struktura e inspektoratit është e plotësuar në nivelin 95%, rekrutimi i vendeve vakante të mbetura është në proces dhe pritet të përfundojë në fund të vitit 2021. Në Shtator 2020, ISHMT u zhvendos në ambientet e reja, ku u numri i zyrave u katërfishua dhe çdo punonjësi i institucionit ka hapësirën personale të punës gjë që çon në përmirësimin e lehtësimin e kryerjes së detyrave operacionale. ISHMT është pajisur me 23 pajisje testuese që do të ndihmojnë inspektorët të identifikojnë jo-konformitetet në produkte. Këto pajisje do të jenë të dobishme për inspektorët në gjetjen e jo-konformiteteve në parapaketime, pajisje elektrike, lodra, makineri, ashensorë etj. Gjithashtu 3 makina (auto-laboratorë) iu shtuan Sektorit të Inspektimit Metrologjik në ISHMT nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Të gjithë inspektorët janë trajnuar vazhdimisht gjatë 2021 (më së shumti online për shkak të pandemisë). ISHMT (së bashku me autoritete të tjera të mbikëqyrjes së tregut në WB6) është gjithashtu pjesë e projektit SEE QI (South East Europe Quality Infrastructure) e financuar nga PTB lidhur me kërkesat ligjore dhe implementimin e disa direktivave mbi sigurinë e produkteve joushqimore kryesisht makineritë dhe pajisjet e mbrojtjes personale (PMP). Takimet online dhe trajnimet lidhur me këto çështje kanë qenë të vazhdueshme. Gjithashtu ISHMT, në kuadër të një projekti të mbështetur nga TAIEK, në tremujorin e fundit të 2021 ka të planifikuar zhvillimin e disa trajnimeve mbi sigurinë e ashensorëve dhe pajisjeve të gazit.

Standardizimi

Legjislacioni në fushën e standardizimit siguron qartë rregulla dhe procedura në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, si CEN, CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382, datë 27.06.2018

“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e BE-së Nr. 1025/2012 “Për standardizimin evropian”. Për një transpozim të plotë të kësaj rregulloreje, DPS ka planifikuar ndryshimet në VKM 382, datë 27.06.2018. Ndryshimet janë miratuar më VKM nr. 673, datë 10.11.2021” Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 382, datë 27.06.2018, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit”.

Përveç legjislacionit në fuqi, të gjitha proceset e standardizimit bazohen në rregulloret e brendshme të DPS që janë në përputhje me rregulloret evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) është anëtare me të drejta të plota në Institutin Evropian të Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI) dhe anëtar i asociuar i Komitetit Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komitetit Evropian për Standardizimin Elektroteknik (CENELEC), anëtar korrespondent në Organizatën Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) dhe anëtare me të drejta të kufizuara vote (vetëm për 3 Komitete Teknike) në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC).

- Më 14 Qershor 2021 DPS aplikoi në CEN & CENELEC, duke dërguar gjithë dokumentacionin për t'u pranuar si anëtar i plotë i CEN dhe i CENELEC. Së bashku me aplikimin zyrtar u paraqitën gjithashtu, dosja me materialet ku sigurohen informacione të hollësishme për të demonstruar se DPS plotëson kriteret për anëtarësimin e plotë në CEN dhe CENELEC të përcaktuara në Rregullat e Brendshme të CEN – CENELEC Pjesa 1 – Organizimi dhe struktura (korrik 2018), 1D “Kërkesat e anëtarësimit në CEN dhe CENELEC”.

- Janë adoptuar mbi 94% e standardeve të CEN&CENELEC dhe 89% të standardeve të telekomunikacionit të publikuara nga ETSI, 14% të standardeve ndërkombëtare të fushës elektroteknike të publikuara nga IEC, dhe 18% të standardeve ndërkombëtare të publikuara nga ISO.

- Databaza e DPS është përmirësuar në lidhje me regjistrimin / arkivimin e standardeve, terminologjinë e standardeve për përkthimin e tyre, ndërlidhjen me databazat e standardeve të organizmave evropiane e ndërkombëtare të përmendura më lart.



Akreditimi

Ligji Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” ka harmonizuar në mënyrë të plotë dispozitat përkatëse për akreditimin të Rregullores (KE) Nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008 Kërkesat për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Ky ligj rregullon funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, bordit të saj të akreditimit, komitetet teknike dhe çështje të tjera procedurale si dhe është plotësisht në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 765/2008, prandaj nuk ka planifikim për përafrim të mëtejshëm. Aktet dytësore në fushën e akreditimit janë miratuar në korrik – shtator 2015. Me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 2 datë 12.01.2021 është miratuar struktura dhe organika e re e DPA.

Struktura administrative përgjegjëse për akreditimin është e ngritur dhe është funksionale që nga viti 2004. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) funksionon nën varësinë e Ministrisë e Financave dhe Ekonomisë si një organ i pavarur dhe i paanshëm.

DPA kryen veprimtarinë e akreditimit me kompetencë dhe është anëtare me të drejta të plota në organizatën e Bashkëpunimit Evropian për Akreditim (EA) dhe anëtare nënshkruese e EA MLA në fushën e testimit, certifikimit të sistemit të menaxhimit, certifikimit të personave dhe organeve të inspektimit. DPA është anëtare nënshkruese e ILAC MRA në fushën e testimit dhe inspektimit dhe IAF MLA për certifikimin e sistemit të menaxhimit.

Metrologjia

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) është anëtar i EURAMET si dhe anëtar i asociuar i WELMEC. DPM ka implementuar dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë së DPM-së në laboratorët e DMSHI-së, në përputhje me standardin e ri SSH ISO/IEC 17025:2017 “Kompetencat teknike të laboratorëve të testimit dhe kalibrimit”.

Në lidhje me vlerësimin e menaxhimit të Cilësisë së DPM-së, u organizua dhe u realizua me sukses vlerësimi i laboratorëve të masës, volumeve, presionit nga Organizata Evropiane e Metrologjisë EURAMET dhe projekti EURAMET Nr. 1465, në lidhje me plotësimin e kërkesave të standardit të ri ISO/IEC 17025:2017 dhe Marrëveshjes

Ndërkombëtare të Njohjes së Ndërsjellë (CIPM MRA).

Sistemi Menaxhimit të Cilësisë mori besueshmërinë e Organizatës Evropiane (EURAMET) në Prill të vitit 2019 dhe hapi rrugën për ripublikimin e aftësive matëse dhe kalibruese (CMC) të fushës së masës në databazën e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe Masave, BIPM KCDB.

Zbatimi i projektit me PTB-në “*Fondi Rajonal i Konsulencës të Infrastrukturës të Cilësisë*” është në proces, përkatësisht në laboratorin e temperaturës, laboratorin elektrik, laboratorin e gjatësisë, laboratorin e kimisë dhe fushën e testeve të zotësisë.

Janë në proces deklarimi Aftësitë matëse dhe kalibruese (CMC) të laboratorit të presionit dhe volumeve. CMC-të e Volumeve janë pranuar nga EURAMET si dhe nga 4 Organizata Rajonale (RMO) dhe janë në pritje të përgjigjes nga Sistemi i Metrologjisë Ndër Amerikan (SIM).

COVID-19 ka krijuar një situatë të vështirë, megjithatë laboratorët e DPM-së kanë nisur procesin e ndërkrahimeve laboratorike me institutet homologe, me qëllim akreditimin e laboratorëve. Gjithashtu, DPM është koordinatorë në projektin me PTB për realizimin e ndërkrahimeve dhe testeve laboratorike sipas standardit ISO/IEC 17043: 2010. Ky proces ju vjen në ndihmë shumë laboratorëve dhe subjekteve vendas, pasi kushtin kryesor për t’u akredituar, ndërkrahimin apo testin e zotësisë, do ta realizojnë brenda Republikës së Shqipërisë dhe me më pak kosto financiare.

Është në proces, ndërkrahimi i fushës së temperaturës dhe lagështisë si projekt i EURAMET-it me pilot INRIM, Itali. Gjithashtu, ka filluar krahasimi ndërlaboratorik bilateral në fushën e presionit me Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës, ku DPM ka rolin e pilotit. Edhe fusha e forcës ka iniciuar krahasim ndërlaboratorik bilateral me Institutin Metrologjik Turk (UME). Në bashkëpunim me Institutin e Metrologjisë Greke (EIM), janë në proces krahasimet ndërlaboratorike bilaterale në fushën e gjatësisë, temperaturës dhe lagështirës, si dhe në fushën elektrike. Ndërkohë është në proces testi i zotësisë në fushën e kimisë me Institutin e Metrologjisë Gjermane (PTB).



Direktivat e Përqasjes së Vjetër

Në lidhje me **kimikate**, ligji nr. 27/2016 “Për Menaxhimin e Kimikateve” dhe aktet nënligjore zbatuese të tij janë pjesërisht në përputhje me dispozitat e Rregullores për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) dhe akteve të tjera përkatëse të *acquis*. Paketa ligjore me bazë REACH (1 ligj dhe 3 VKM) ka transpozuar në legjislacionin kombëtar të gjithë elementët e mundshëm të Rregullores së BE 1907/2006, të cilat mund të përafrohen nga vendet candidate. Legjislacioni kombëtar për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin kimik (CLP) është në përputhje me Sistemin e Harmonizuar të Kombeve të Bashkuara për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve. Projekti “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve”, ka filluar implementimin nga Marsi 2019, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze / SIDA, do të zbatohet nga Agjencia Suedeze e Kimikateve (KemI) për një periudhë 3 vjeçare, duke kontribuar në ngritjen e aftësive teknike dhe administrative të institucioneve të përfshira në fushën e kimikateve, si dhe zbatimin e legjislacionit të miratuar në këtë fushë.

Sa i takon **detergjenteve**, Rregullorja 648/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 mars 2004 mbi detergjentet, është pjesërisht e harmonizuar nëpërmjet ligjit nr. 10216/2010 “Për detergjentet”; VKM-së Nr. 669 datë 28.09.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentet” dhe VKM-së nr. 220, datë 28.3.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”.

Në lidhje me **mjetet motorike**, Ministria përgjegjëse për transportin ka transpozuar në legjislacionin shqiptar 3 direktiva kuadër për mjetet rrugore, motomjetet dhe traktorët bujqësorë dhe pyjorë përkatësisht: direktiva 2007/46/EU, direktiva 2002/24/EU dhe direktiva 2003/37/EU përmes akteve nënligjorë të miratuar nga Ministria me udhëzimet Nr. 11, datë 6.6.2011 “Mbi miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre dhe sistemeve, komponentëve dhe njësive teknike të veçanta të tyre”, Nr. 12, datë 6.6.2011 “Mbi miratimin e tipit të motorëve me dy dhe tre rrota”, Nr. 10, datë 30.5.2011 “Mbi

miratimin e tipit të traktorëve bujqësorë dhe pyjorë dhe makinerive ndërshtëmbyeshme të tërhequra së bashku me sistemet e tyre, komponentët dhe njësitë teknike të veçanta.”

Ndërkohë këto direktiva janë shfuqizuar dhe aktualisht janë miratuar 3 rregullore të reja Evropiane që kanë të njëjtin objekt me direktivat e shfuqizuara (Rregullorja 2018/858 mbi miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, komponentëve dhe njësive teknike të veçanta që përdoren në to; Rregullorja Nr. 168/2013 mbi miratimin e tipit dhe mbikëqyrjen e tregut të motorëve me 2,3 dhe 4 rrota dhe Rregullorja 167/2013 mbi miratimin e tipit dhe mbikëqyrjen e tregut të traktorëve bujqësorë dhe pyjorë.)

Direktivat e Përqasjes së Re

Shqipëria ka harmonizuar pjesërisht rreth 15 direktiva/rregullore që bien nën përqasjen e re, ku përfshihen: pajisjet e tensionit të ulët, përputhshmëria elektromagnetike, lodrat, ashensorë dhe komponentët e tij, makineritë, emetimi i zhurmave nga pajisjet për përdorim në ambiente të jashtme, pajisjet në presion, pajisjet e transportueshme nën presion, pajisjet radio, instrumentet matëse, instrumentet jo-automatike të peshimit, pajisjet aerosol, parapaketimet, shishet enëmatëse, lëndët plasëse për përdorim civil dhe fishekzjarrët.

Sipas fushës së përgjegjësisë, institucionet zbatuese përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut janë Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut, Inspektorati Shtetëror, Teknik dhe Industrial, Autoriteti i Komunikimeve elektronike dhe Postare (pajisjet radio).

Kontrolli i lëndëve plasëse për përdorim civil dhe artikujve piroteknike realizohet nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse për prodhimin, importin eksportin dhe kontrollin mbi konformitetin të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe artikujve piroteknike, ndërsa Ministrinë e tjera janë përgjegjëse për përdorimin, asgjësimin, magazinimin dhe transportin e këtyre mallrave.

Masat procedurale

Sa i përket fushës së **tekstileve, xhamit kristal dhe veshjeve të këmbës**, legjislacioni përkatës evropian është pjesërisht i harmonizuar respektivisht me VKM nr. 1058/2016 “Për



miratimin e rregullit teknik “Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketime markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile”, VKM nr. 221/2012 “Për miratimin e rregullave teknike “për etiketimin e produkteve të qelqit kristal” dhe VKM nr. 222/2012 “Për miratimin e rregullave teknike për etiketimin e materialeve që përdoren në përbërësit kryesorë të veshjeve të këmbës, në shitje për konsumatorët”. ISHMT është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut për këto produkte.

Lidhur me **armët**, prioriteti për Shqipërinë ka qenë, është dhe do të vazhdojë të jetë krijimi i një mjedisi më të sigurt për qytetarët e tij dhe të huaj, bizneset dhe shoqërinë në përgjithësi. Posedimi i paautorizuar i armëve të zjarrit në vendin tonë aktualisht është shqetësim, për shkak të situatës së trashëguar ndër vite, por edhe për shkak të një rritje të qarkullimit të mallrave dhe njerëzve, gjë që sjell edhe rritje të aktivitetit kriminal në fushën e armëve të zjarrit, trafikimit të paligjshëm në armë dhe municione.

Parlamenti shqiptar ka miratuar një numër ligjesh të cilat synojnë një kontroll më efektiv të armeve. Me aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimet e Ministrit të Brendshëm ose institucioneve të tjera të ngarkuara me ligj, paketa e akteve ligjore dhe nënligjore në Shqipëri është e plotë për të lejuar aktivitete të ligjshme me armë për ato kategori që plotësojnë kushtet dhe kriteret, por edhe për të penalizuar ata qytetarë që synojnë të kryejnë dhe organizojnë veprimtari të paligjshme në këtë drejtim.

Vendi ynë ka marrëveshje të mëdha ndërkombëtare për kontrollin e armëve, duke përfshirë: Traktatin e Tregtisë së Armëve, Programin e Veprimit të Armëve të Vogla dhe Armët e Lehta, Protokollin e Armëve të Zjarrit, dhe ka përqafuar nismat rajonale për të forcuar kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW), në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në të gjithë rajonin.

Ligji 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2014/60/BE dhe Rregulloren e Këshillit Nr. 116/2009 për sa i përket lëvizjes së lirë të pasurive kulturore. Në zbatim të ligjit, është miratuar VKM Nr. 432, datë 26.6.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë

Kulturore”, si dhe Urdhri nr. 136, datë 21.10.2019 i Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore”.

Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK) është përgjegjës për administrimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore (RKPK)”, me qëllim identifikimin, regjistrimin, ruajtjen dhe lidhjen në kohë reale online të këtij shërbimi me institucionet shtetërore, subjektet private (Fizike/Juridike) që posedojnë dhe administrojnë Fonde të Pasurive Kulturore për regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë për objektet pasuri kulturore në pronësi publike dhe private, shërbimin doganor të Republikës së Shqipërisë për monitorimin e lëvizjeve dhe të pronësisë së objekteve të pasurive kulturore në pronësi publike dhe private brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe me Policinë e Shtetit për shkëmbim informacioni në sistem lidhur me rastet e grabitjeve dhe vjedhjeve të objekteve të trashëgimisë kulturore në vend dhe denoncimet nga institucionet ndërkombëtare që operojnë brenda dhe jashtë vendit, sekuestrimin e objekteve pasuri kulturore.

Parimet e përgjithshme

Gjatë vitit 2021, ka avancuar puna për hartimin e Planit të Veprimit për identifikimin dhe heqjen e barrierave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore në tregtinë e mallrave. Ky Plan Veprimi pritet të sigurojë përputhshmëri me nenet 34 – 36 TFBE sa i përket legjislacionit ekzistues. Në periudhën shkurt – tetor 2021 janë realizuar:

- Finalizimi i Koncept dokumentit të Planit të Veprimit, ku paraqitet metodologjia dhe struktura e tij; (shkurt 2021);

- Identifikimi paraprak i legjislacionit nga ministrinë/institucionet e linjës me qëllim krijimin e “inventarit” të akteve ligjore/nënligjore mbi bazën e të cilit do të vijojë puna për shqyrtimin dhe analizën e barrierave (në proces përditësimi të vazhdueshëm);

- Konsultimi paraprak me grupet e interesit nga komuniteti i biznesit për masa potenciale të ndeshura gjatë veprimtarisë së tyre (shkurt 2021);

- Identifikimi dhe shqyrtimi i masave me efekt të njëjtë për rreth 18 sektorë/produkte, ku janë analizuar rreth 36 akte ligjore/nënligjore (pajisje mjekësore, kimikate, hidrokarburet dhe vajrat



lubrifikantë, barnat për përdorim njerëzor, kripa, qeset e lehta plastike, lodra, ashensorë, makineri, pajisjet mbrojtëse personale, pajisjet nën presion, pajisjet radio, emetimi i zhurmave nga pajisje për përdorim të jashtëm, instrumentet matëse, detergjente, produktet e mbrojtjes së bimëve, produktet organike). Janë në proces konsultimet me institucionet e linjës për rakordimin e gjetjeve dhe planifikimin e shfuqizimit të masave. Është gjithashtu në proces analiza për fushën e veterinarisë ku do të analizohen rreth 15 akte ligjore/nënligjore relevante;

Hapat në vijim janë konsultimi/dakordësimi i analizës për të gjithë sektorët e mësipërm, planifikimi i shfuqizimit të masave, konsultimi me institucionet shtetërore dhe grupet e interesit përmes edhe Platformës së partneritetit për Integrimin Evropian, me qëllim hartimin e Planit të Veprimit me sektorët e përzgjedhur.

Gjithë procesi i përgatitjes së Planit të Veprimit mbështetet nga projekti SANECA që zbatohet nga GIZ me asistencën financiare të Qeverisë Gjermane.

Çështjet horizontale

Gjatë vitit 2021 ka nisur puna për hartimin e një dokumenti me natyrë strategjike (Roadmap) për fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, i cili do të përmbajë planifikimin e harmonizimit të legjislacionit dhe ngritjen/forcimin e kuadrit institucional përgjegjës për zbatimin, për të gjithë fushën e harmonizuar. Gjatë vitit 2021 janë realizuar:

- Finalizimi i Concept Note të Roadmap-it, i cili identifikon ndër të tjera objektivat, misionin dhe strukturën e Roadmap-it;

- Mbledhja dhe rishikimi i kontributeve të ministrive të linjës sipas fushave të përgjegjësisë për secilin produkt, të cilat do të jenë pjesë e seksionit kryesor të roadmapit lidhur me situatën aktuale, mangësitë ligjore dhe institucionale/administrative, mangësitë dhe planet për adresimin e tyre.

Hapat në vijim janë hartimi i draft të parë të Roadmapit, konsultimi me institucionet shtetërore dhe grupet e interesit përmes edhe Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe finalizimi i Roadmap-it.

Mbikëqyrja e tregut

Me qëllim rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë së konsumatorëve ISHMT ka zhvilluar 770 inspekte, në fushat e parapaketimeve,

instrumenteve matës, lodrave, detergjenteve, këpucëve, tekstileve, produkteve elektrike, produkteve mekanike etj. Janë marrë 82 masa administrative nga të cilat 12 gjoba, 58 paralajmërimet dhe 12 masa urgjente (ndalim tregtimi dhe shkatërrim produktesh). Në total janë kontrolluar 4,556 produkte, nga të cilat 198 kanë rezultuar jo në konformitet. Është marrë masa ndalim i përhershëm tregtimi për mbi 23 modele produktesh elektrike (Rreth 2471 njësi në total).

Standardizimi

Legjislacioni në fushën e standardizimit siguron rregulla dhe procedura në përputhje me ato të përdorura nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardizimit, të tilla si CEN, CENELEC, ETSI, ISO dhe IEC. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 382, datë 27.06.2018 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” ka transpozuar pjesërisht Rregulloren e BE-së Nr. 1025/2012 “Për standardizimin evropian”.

Për një transpozim të plotë të rregullores së mësipërme të BE-së Nr. 1025/2012 “Për standardizimin evropian”, DPS në bashkëpunim me MFE përgatiti disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 382, datë 27.06.2018. Ndryshimet janë miratuar më VKM nr. 673, datë 10.11.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 382, datë 27.06.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit”. Për periudhën janar – shtator 2021 janë miratuar gjithsej 1 415 standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare, nga ku:

- **533** standarde të publikuara nga CEN;
- **301** standarde të publikuara nga CENELEC;
- **250** standarde të publikuara nga ETSI;
- **235** standarde të publikuara nga ISO;
- **96** standarde të publikuara nga IEC.

Janë miratuar **100%** të standardeve të harmonizuara evropiane si standarde të harmonizuara shqiptare. Janë shfuqizuar **194** standarde dhe dokumente standardizimi siç janë shfuqizuar nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të standardeve.

Struktura e arkivit të standardeve shqiptare, sipas origjinës së tyre, përbëhet nga: **79% e EN, 16% e standardeve ndërkombëtare (ISO / IEC), 5% standarde puro shqiptare.**



Akreditimi

Në 12 janar 2021, u miratua struktura dhe organika e DPA me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 2 “Për miratimin e strukturës dhe skemës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”. Numri i personelit të DPA-së u rrit nga 14 në 20 dhe drejtorja e akreditimit u nda në dy drejtori: drejtorja e laboratorëve të testimit, kalibrimit dhe mjekësorë dhe drejtorja e organeve të certifikimit dhe inspektimit. Ndërkohë është krijuar pozicioni i menaxherit të cilësisë i cili ishte kryer deri më tani nga një anëtar i stafit të DPA-së, pozicioni i Drejtorit të drejtorisë së laboratorëve të testimit, kalibrimit dhe mjekësorë dhe pozicioni i Drejtorit të drejtorisë së organeve të certifikues dhe inspektues. Struktura e re do t’i përgjigjet më shumë nevojave të tregut për shërbimin e akreditimit. Struktura e re filloi të zbatohet në 1 mars 2021.

Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) e kaloi me sukses vlerësimin e ndërsjellët të EA, i cili u krye në Shkurt dhe Prill 2021. Grupi i vlerësimit të EA konfirmoi me kënaqësi që funksionimi i përgjithshëm i DPA është në përputhje me kërkesat e specifikuara (ISO/IEC 17011 dhe Rregullorja Evropiane 765/2008) dhe se grupi i vlerësimit është i impresionuar me strukturën organizative të DPA, aftësitë dhe njohuritë e personelit të DPA në lidhje me procedurat e tyre dhe dokumentacionin e sistemit të menaxhimit. Vendimi për mirëmbajtjen e statusin nënshkrues në fushat e testimit, inspektimit, certifikimit të personave dhe certifikimit të sistemeve të menaxhimit është marrë më 27 tetor 2021.

Në kuadrin e procesit të derregullimit, DPA implementoi një sistem elektronik të shërbimit të akreditimit i cili përfshin aplikimin online, ngarkimin e dokumentacionit të akreditimit, dërgimin e faturave, raporteve dhe korrespondencave nga të dy palët, dhe dërgimin e certifikatës së akreditimit në OVK. Ky sistem gjithashtu parashikon: thjeshtimin e procedurave dhe kursimin e kohës për komunikim, regjistrimin në çdo kohë të ndonjë veprimi të ndërmarrë, shkurtimin e afateve të procedurës së akreditimit, dhe do të jetë një mënyrë e mirë për të kontrolluar procesin e akreditimit për të siguruar paanshmërinë

Aktualisht janë akredituar në total 94 organe të vlerësimit të konformitetit nga DPA. Shifrat e akreditimit deri në Tetor 2021 janë si më poshtë:

- 44 Laboratorë testues;
- 4 laboratorë mjekësorë;
- 1 laborator kalibrues;
- 28 trupa inspektues;
- 11 trupa certifikues të personave;
- 6 trupa certifikues të sistemeve të menaxhimit.

Metrologjia

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë, për vitin 2021 ka realizuar të ardhura në vlerë 45 075 089 lekë (pa TVSH) përkatësisht për 36 106 instrumente matës të verifikuar dhe kalibruar.

Gjatë vitit 2021 puna për harmonizimin e legjislacionit vendas me *acquis* i Bashkimit Evropian ka vazhduar duke punuar me:

- Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave “Për njësitë e matjes”, i cili është dërguar për konsultim me ministrinë e linjës;

- Ndryshimi i Udhëzimit nr. 1897/3, datë 03.08.2016 “Për kërkesat dhe procedurat e miratimit të sistemit për parapaketimet” i cili është miratuar me Udhëzimin nr. 1, datë 15.01.2021 të Ministrit të MFE;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 349, datë 16.6.2021 “Për miratimin e rregullores për shishet enë matëse”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 443, datë 22.7.2021 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”.

Gjatë 2021 është rritur numri i verifikimeve dhe kalibrimeve të instrumenteve matës. Evidentohet një përmirësim i ndjeshëm i shërbimit metrologjik konkretisht në fushën e verifikimit dhe kalibrimit, duke ulur në nivelin zero, ankesat nga konsumatori dhe bizneset.

Janë realizuar ndërkrasime laboratorike dhe është marrë pjesë në Komitetet Teknike, sipas fushave përkatëse. Është realizuar trajnimi i stafit teknik të institucionit “Për matësit elektrike”.

Direktivat përqasjes së re

Sa i përket harmonizimit të legjislacionit, janë miratuar aktet e mëposhtme:

- VKM nr. 349, datë 16.6.2021 “Për miratimin e rregullores për shishet enë matëse”;

- VKM nr. 443, datë 22.7.2021 “Për miratimin e rregullores për parapaketimet”;

- VKM nr. 925, datë 25.11.2020 “Për miratimin



e Rregullit Teknik “Për pajisjet e aerosolit”, i cili përafron pjesërisht Direktivën e Këshillit Evropian 75/324/KE të datës 20 Maj 1975 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me pajisjet e aerosolit;

- Ligji 73/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e **artikujve piroteknikë**”, i cili harmonizon pjesërisht Direktivën 2013/29/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 12 qershor 2013 “Për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të artikujve piroteknikë”;

- Ligji 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e **lëndëve plasëse për përdorim civil**” i cili harmonizon pjesërisht Direktivën 2014/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, gjatë vitit 2021 situata paraqitet si më poshtë:

Inspektorati Shtetëror për mbikëqyrjen e Tregut ka realizuar inspektime mbi:

- **Lodrat:** janë kryer 15 inspektime dhe janë marrë 3 masa administrative (1 gjobë, dhe 2 masa urgjente ndalim tregtimi dhe shkatërrim produkti). Në total janë kontrolluar 167 produkte nga të cilat 5 kanë rezultuar jo në konformitet. Pjesa më e madhe e jokonformiteteve u zbulua në produkte të cilat ishin reklamuar në Safety Gate.

- **LVD & EMC:** u kryen 72 inspektime nga Sektori i Produkteve Elektrike mbi përputhshmërinë e produkteve në lidhje me LVD dhe EMC. Gjithsej 240 produkte u kontrolluan në lidhje me Markën CE dhe në lidhje me Deklaratën e Konformitetit (pajisje shtëpiake, lavatriçe, fshesa me korrent, kondicionerë, frigoriferë, karikues, si dhe produkte të tjera të ndryshme elektrike që bien nën GPSD), nga të cilat 33 produkte nuk ishin në përputhje me konformitetin formal dhe atyre u ndalua tregtimi i tyre. Nga këto 33 produkte 28 nuk ishin në përputhje me kërkesat e konformitetit formal dhe 5 ishin produkte ishin të botuan në RAPEX (Safety Gate) Këto produkte ishin në kategoritë e: karikuesve, ngrohësve elektrikë, llambave LED, adaptorë, kablo zgjatues, kondicioner etj. (Gati 2500 njësi). Janë vendosur 10 masa administrative të

vendosura në formën e masave urgjente “Ndalimi i Përhershëm i Tregtisë” dhe 3 gjoba.

- **RED:** janë kryer 11 inspektime nga sektori i produkteve elektrike mbi përputhshmërinë e produkteve në lidhje me RED (Gjatë këtyre inspektimeve u kontrollua edhe përputhshmëria e produkteve të tjera elektrike që bien në direktiva të tjera). Gjithsej 120 produkte u kontrolluan për Markën CE dhe për 17 prej tyre u kërkuar DoC. Të gjitha produktet u gjetën në përputhje. Asnjë masë administrative nuk është marrë.

- **Makineritë:** janë kryer inspektime në 2 subjekte. Në total janë kontrolluar 11 produkte të cilat kanë rezultuar në konformitet. Inspektimet e thelluara në këtë fushë kanë filluar në shtator 2020.

- **Ashensorët:** janë kryer 6 inspektime mbi importuesit e produkteve brenda Direktivës së Ashensorëve. Në total janë kontrolluar 13 produkte dhe të gjitha ato ishin në përputhje me markimin CE dhe të shoqëruara me Deklaratën e Konformitetit të BE-së.

- **Pajisjet e mbrojtjes personale:** janë kryer inspektime në 28 subjekte dhe është marrë 1 masë administrative me gjobë. Në total janë kontrolluar 310 produkte nga të cilat 5 kanë rezultuar jo në konformitet.

- **Pajisjet e gazit:** ende nuk është kryer ndonjë inspektim për pajisjet me gaz. Fokusi kryesor i sektorit përgjegjës ka qenë regjistrimi i ashensorëve, dhe për faktin se nuk ka importues të mëdhenj që fokusohen tërësisht në pajisjet me gaz, në inspektimet mbi produktet e grupit të tjerë, nëse vërehen pajisje të gazta ato kontrollohen nëse përputhen me kërkesat e rregullit teknik ne fuqi. Deri në shtator 2021, asnjë produkt që bie në këtë direktivë nuk është ndaluar nga tregtimi.

- **Enët e thjeshta ne presion (SPVD):** ende nuk është kryer ndonjë inspektim për enët e thjeshta ne presion. Fokusi kryesor i sektorit ka qenë regjistrimi i ashensorëve, dhe për faktin se nuk ka importues të mëdhenj që fokusohen tërësisht në pajisjet me gaz, në inspektimet mbi produktet e grupit të tjerë, nëse vërehen pajisje të gazta ato kontrollohen nëse përputhen me kërkesat e rregullit teknik ne fuqi. Deri në shtator 2021, asnjë produkt që bie në këtë direktivë nuk është ndaluar nga tregtimi.



- **Emetimi i zhurmës në mjedis nga pajisjet për përdorim jashtë (OND)** ende nuk është kryer ndonjë inspektim në OND. Fokusi kryesor i sektorit ka qenë regjistrimi i ashensorëve, dhe për faktin se nuk ka importues të mëdhenj që fokusohen tërësisht në OND. Gjatë inspektimeve mbi produktet e grupeve të tjerë, nëse vërehen OND ato kontrollohen nëse janë në përputhje me kërkesat e direktivës.

- **Artikujt Piroteknik:** ende nuk është kryer ndonjë inspektim në lidhje me artikujt piroteknik. Inspektimet e thelluara në këtë fushë pritet të fillojnë në muajin dhjetor 2021.

- **Pajisjet e Aerosolit** Direktiva e pajisjeve të aerosolëve u transpozua në legjislacionin shqiptar vetëm në fund të vitit 2020 dhe inspektorët nuk kanë kryer ende asnjë inspektim për zbatimin e tij.

Parapaketimet: janë zhvilluar 283 inspektime. Në total janë kontrolluar 1351 produkte, të cilat kanë rezultuar në konformitet.

- **Instrumentet e Peshimit Jo-automatik:** në Shtator 2020 kanë filluar inspektimet e para të thelluara në importues dhe prodhues të këtyre instrumenteve. Për vitin 2021 është zhvilluar 1 inspektim produktet e të cilit kanë rezultuar në konformitet.

- **Instrumentet Matës:** në Shtator 2020 kanë filluar inspektimet e para të thelluara në importues të këtyre instrumenteve. Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT për vitin 2021 ende nuk ka kryer ndonjë inspektim për Instrumentet Matës.

- **Shishet si enë matëse:** Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT për vitin 2021 ende nuk ka kryer ndonjë inspektim për Shishet si enë matëse. Shpesh këto inspektime kanë shkuar së bashku me ato të para-paketimit dhe informacioni është kryesisht i përzier.

- **Njësitë matëse (Units of measurements):** Sektori i Inspektimit Metrologjik në ISHMT ndër vite ka kryer inspektime për Njësitë e Matjeve, për vitin 2021 këto inspektime kanë shkuar sipas atyre të para-paketimit dhe informacioni është kryesisht i përzier. Ajo që dihet është fakti se asnjëherë nuk është marrë një masë paralajmëruese ose korrigjuese gjatë këtyre inspektimeve në njësitë e matjeve.

- **Informacioni i konsumit të energjisë dhe burimeve të tjera për produktet me ndikim në energji:** Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT që

ka të rekrutuar 6 nga 7 punonjës. Për zbatimin e këtij legjislacioni nuk janë zhvilluar inspektime të dedikuara, por subjektet janë informuar mbi të gjatë kontrolleve që ka zhvilluar Sektori i Produkteve Elektrike në ISHMT. Deri tani kontrollet kanë qenë vetëm mbi dokumentacionin dhe nuk është konstatuar asnjë produkt jo në konformitet por që janë udhëzuar subjektet në lidhje me afishimin e duhur të etiketave përkatëse.

Direktivat e përqasjes së vjetër

Në zbatim të Ligjit 27/2016, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, është ngritur Zyra e Kimikateve, e cila do të ketë në përbërje të saj një strukturë 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 Specialistë.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, gjatë vitit 2021, nuk janë zhvilluar inspektime nga ISHMT lidhur me **detergjentet**, pasi po punohet mbi legjislacionin në këtë fushë.

Masat procedurale

Sa i përket zbatimit të legjislacionit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut gjatë vitit 2021, nuk ka zhvilluar inspektime lidhur me **tekstilet, këpucët, dhe qelqin e kristaltë**, sepse është fokusuar në fusha të tjera me risk më të lartë. Meqenëse ISHMT është një institucion i ri është përpjekur të menaxhojë burimet e tij njerëzore me kapacitete të vogla në dispozicion për zonat që janë treguar më problematike dhe që kanë nevojë për veprim të menjëhershëm. Në të ardhmen e afërt pritet të ketë inspektime në këtë fushë në mënyrë që të vlerësohet situata.

Në vitin 2020 u miratua ligji nr. 152/2020, datë 17.12.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 74/2014 “Për armët”. Ligji është përafëruar pjesërisht me Direktivën (BE) 2017/853 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17 Maj 2017 që ndryshon Direktivën e Këshillit 91/477/KEE, datë 18 qershor 1991 “Për kontrollin e blerjeve dhe posedimit të armëve”. Gjithashtu ligji ka përafërim të pjesshëm dhe me Rregulloren nr. 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 mars 2012, në zbatim të nenit 10, të protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse të tyre dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe që vendos masat për autorizimin e importit, eksportit dhe transitit të armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse të tyre dhe municioneve.



Ministria e Brendshme në vitin 2021 ka draftuar dhe miratuar 7 akte nënligjore në zbatim të ligjit 74/2014 “Për armët” në lidhje me procedurat licencimit të veprimtarive të lejuara me armët, rregullat e sigurisë për armët, regjimin e hyrje/daljes dhe markimit të armëve të zjarrit etj. Duke rregulluar aspekte procedurale dhe harmonizuar më tej legjislacionin në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta me atë të Bashkimit Evropian. Këto vendime janë si më poshtë vijon:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 94, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për armët, në rastet e deklarimit të vdekjes, deklarimit të mbylljes ligjore të aktivitetit, për qëllime studimore, të humbjes së armës, vjedhjes së saj apo dokumentit/autorizimit”;

2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 270, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 96, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të deklarimit, ruajtjes, regjistrimit dhe paaftësisë për armët e koleksionit”;

3. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 271, datë 12.5.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 275, datë 01.04.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e sigurisë armëve”;

4. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 12.5.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 348, datë 29.04.2015 “Për procedurat e hyrjes/daljes, vulosjes së armëve dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë e të huaj me armë të kategorisë “B” dhe “C” në territorin e Republikës së Shqipërisë”;

5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 289, datë 19.5.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 95, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për vlerësimin e kërcënimit të rrezikut për jetën dhe pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme”;

6. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 26.5.2021 “Për miratimin e llojeve të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese dhe të mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit”;

7. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 30.7.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 421, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e shqyrtimit të

kërkesave, dokumentacionin, afatet e shqyrtimit dhe kriteret e veçanta të licencimit të veprimtarive të lejuara me armët”.

Përgjatë vitit 2021, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin, Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore kanë bërë të mundur miratimin e akteve si vijon:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave me Nr. 199 datë 31.3.2021 “Për Përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës, tarifave të aplikimit dhe kuotizacionin vjetor të licencave për veprimtari tregtare të pasurive kulturore”;

2. Vendim i Këshillit të Ministrave me Nr. 583 datë 6.10.2021 “Për Përcaktimin e procedurave dhe mënyrave të administrimit të bazës së të dhënave të pasurive kulturore të vjedhura”.

Ndërsa në proces miratimi është Udhëzimi për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura, në zbatim të pikës 6, të nenit 130, të Ligjit 27/2018.

Aktualisht janë në proces draftimi dy udhëzime të cilat kërkojnë miratimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore të lidhura me Licencimin e Tregtarëve të Pasurive Kulturore;

- Udhëzimi për krijimin dhe funksionimin e “Regjistrimit të tregtimit të pasurive kulturore”, në zbatim të pikës 7, të nenit 116, të Ligjit 27/2018.

- Udhëzimi i përbashkët për vlerat mbi të cilat është i detyrueshëm një përkrahje me i detajuar i pasurive kulturore, objekte të veprimeve tregtare, në zbatim të pikës 8, të nenit 116, të Ligjit 27/2018.

- Udhëzimi për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura, në zbatim të pikës 6, të nenit 130, të Ligjit 27/2018. Ky i fundit është në proces miratimi.

Përputhshmëria e plotë me Direktivën 2014/60/EU of the European Parliament and of the Council of 5 May 2014 “On the return of cultural objects unlawfully removed from the territory of a Member State”, do të jetë vetëm në momentin kur Shqipëria të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, pasi disa prej neneve të kësaj direktive gjejnë zbatimin vetëm për vendet anëtare.

Masat në proces në kuadër të detyrimeve të tjera:



Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore janë në proces të hartimit të akteve të lidhura me procedurat e monitorimit të qarkullimit civil dhe fizik të pasurive kulturore, akte këto të parashikuara për tu realizuar nga Project AL/IPA2015/13 “Building capabilities of the Albanian Public Administration on free movement and fight against illicit trafficking of Cultural goods” përkatësisht;

- Udhëzim për procedurat dhe transferimin e pasurive kulturore jashtë vendit, në zbatim të pikës 4 të nenit 123 të ligjit 27/2018;

- Udhëzim për miratimin e përcaktimeve të përgjithshme, në zbatim të neneve 124, pika 3, dhe nenin 128 pika 3, sipas neneve 123, 124 dhe 128 të ligjit 27/2018;

- Udhëzim për kushtet, mënyrën, procedurën dhe mënyrën e dhënies ose rinovimit të lejes së importit, sipas paragrafit 6, nenit 129 të ligjit 27/2018.

Gjithashtu, Qeveria Shqiptare ka miratuar 2 (dy) strategjitë:

- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025 dhe Planin e Veprimit 2021 – 2022, miratuar me VKM Nr. 1140 datë 24.12.2020. Ministria e Kulturës dhe IKRTK janë në proces hartimi të Planit Kombëtar të Veprimit për luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore (pjesë e detyrimeve të Strategjisë);

- Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Plani i Veprimit 2021 – 2027 (Strategji ndërsektoriale).

Trajnime:

MK dhe IKRTK pjesëmarrëse në trajnimin një javor me titull “Technical Training on the Law Enforcement on Prevention of Illicit Trade of Cultural Heritage and the Fight Against Illicit Trafficking” – i cili u zhvillua në Tiranë më 18 – 22 tetor 2021 në Tiranë.

Për vitin 2022 është planifikuar marrja e masave për finalizimin e akteve të renditura më sipër në bashkëpunim me projektin nga IPA Kombëtare me titull “Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore”.

Sa i takon përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave dhe ngritjes/funksionimit të Tryezës së Rrumbullakët për Kapitullin 1, MFE ka

shpallur thirrjen për aplikime për Tryezën e Rrumbullakët të Kapitullit 1 të PPEI në Mars 2021. Tryeza përkatëse e Kapitullit 1 u krijua në maj 2021, është organizuar mbledhja e parë e tij (korrik 2021) dhe janë miratuar rregullat të procedurës për funksionimin e duhur të saj si një platformë konsultimi midis aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë në procesin e anëtarësimit në kapitullin përkatës.

4.1.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Inspektorati Shtetëror, Teknik dhe Industrial
- Ministria e Mbrojtjes
- Ministria e Brendshme/ Policia e Shtetit
- Ministria e Kulturës
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore

4.1.6 Mangësitë e identifikuar dhe Prioritetet
Parimet e përgjithshme

Sa i përket fushës së paharmonizuar dhe aplikimit të parimeve të parashikuara nga nenet 34 – 36 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian, Shqipëria ende nuk ka një plan veprimi për heqjen e masave me efekt të barasvlershëm me kufizimet sasiore për tregtinë në mallra, detyrim ky që rrjedh drejtpërdrejt nga MSA. Megjithatë, puna për hartimin e këtij plani veprimi ka nisur dhe disa masa me efekt të njëjtë janë identifikuar tashmë në disa prej sektorëve/produkteve të analizuar. Prioritet në këtë fushë mbetet:

- finalizimi dhe dakordësimi i gjetjeve të analizës për sektorët/produktet e analizuar dhe planifikimi konkret i shfuqizimit të tyre, në varësi të analizës;

- përcaktimi i sektorëve/produkteve të tjerë për t’u shqyrtuar.

Ndërkohë dy rregulloret kyçe më këtë fushë lidhur me njohjen e ndërsjellë të produkteve të tregtuara ligjërisht në një shtet tjetër anëtar (Rregullorja 2019/515) dhe me shkëmbimin në kohë reale të informacionit ndërmjet shteteve



anëtare në rastet e ekzistencës së pengesave që mund të pengojnë lëvizjen e lirë të mallrave (Rregullorja Strawberry 2679/98), nuk janë të harmonizuara në legjislacionin tonë, duke qenë se ato janë relevante pas anëtarësimit në BE. Gjithsesi, masat paraprake që mund të ndërmerren paraprakisht do të jenë pjesë e Planit të Veprimit, për të bërë të mundur përgatitjen në avancë të strukturës institucionale që do të jetë përgjegjëse për zbatimin e detyrimeve që përcaktojnë këto rregullore.

Çështjet horizontale

Në përfundim të analizës së mangësive ligjore dhe institucionale të finalizuar nga GNPIE e kapitullit 1, si pjesë e përgatitjeve për takimin bilateral, rezulton se:

- për një numër të konsiderueshëm aktesh të harmonizuara tashmë (rreth 32 akte) ende ka dispozita të legjislacionit evropian që nuk janë përafruar, çka e bën harmonizimin e tyre të pjesshëm; gjithashtu kuadri institucional përkatës ka nevojë për t'u përforcuar më tej, për të përmirësuar zbatimin;

- rreth 19 akte evropiane janë të paharmonizuara në legjislacionin shqiptar.

Në këto kushte, procesi i harmonizimit të mëtejshëm ligjor dhe institucional do duhet të mbështetet mbi një dokument me natyrë strategjike, për të përcaktuar vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të tij, mbi bazën e një planifikimi të mirëmennduar, që i shërben edhe procesit të negociatave, por edhe nevojave dhe kapaciteteve të brendshme të vendit. Kërkesa për hartimin e një dokumenti të tillë është përmendur vazhdimisht edhe në Raportet e progresit si dhe takimet e nënkomitetit Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet.

Për këtë arsye, prioriteti kryesor në këtë fushë, mbetet hartimi i Roadmap-it në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Puna për hartimin e tij ka avancuar, siç është përmendur dhe seksionet më sipër, dhe pritet që ai të finalizohet gjatë vitit 2022.

Përqasja e re

Sa i përket përqasjes së re, rreth 37 % e akteve të *acquis* që bien në këtë nënkapitull nuk janë të transpozuar ende në legjislacionin shqiptar (p.sh. *acquis* që lidhet me pajisjet dhe sistemet në ambiente potencialisht shpërthyes, instalimet teleferike të projektuara për transport personash, produktet e ndërtimit, pajisjet e thjeshta nën

presion, pajisjet e gazit etj.). Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, mbështetur edhe në rekomandimet e dhëna në Raport Progresin për Shqipërinë, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në këtë nënkapitull. Gjithashtu, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, si përmes shtimit të numrit të stafit, ashtu edhe ndërmarrjes së masave për rritjen e ekspertizës nëpërmjet trajnimeve apo instrumenteve të tjera, në strukturat e ngarkuara me hartimin dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Përqasja e vjetër

Sa i përket përqasjes së vjetër, rreth 50% e akteve të *acquis* që bien në këtë nënkapitull nuk janë të transpozuar ende në legjislacionin shqiptar (p.sh. *acquis* që lidhet me mjetet motorike, praktikant e mira laboratorike, prekursorët e drogave). Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, mbështetur edhe në rekomandimet e dhëna në Raport Progresin për Shqipërinë, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në këtë nënkapitull. Gjithashtu, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, si përmes shtimit të numrit të stafit, ashtu edhe ndërmarrjes së masave për rritjen e ekspertizës nëpërmjet trajnimeve apo instrumenteve të tjera, në strukturat e ngarkuara me hartimin dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Masat procedurale

Sa i përket masave procedurale, rreth 35% e akteve të *acquis* që bien në këtë nënkapitull nuk janë të transpozuar ende në legjislacionin shqiptar (p.sh. *acquis* që lidhet me informacionin mbi rregulloret teknike, transparenca e çmimeve të produkteve farmaceutike etj.). Me qëllim arritjen e një shkalle më të lartë të transpozimit, nevojitet vijimi i punës për përafrimin e *acquis* në këtë nënkapitull. Gjithashtu, nevojitet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative, si përmes shtimit të numrit të stafit, ashtu edhe ndërmarrjes së masave për rritjen e ekspertizës nëpërmjet trajnimeve apo instrumenteve të tjera, në strukturat e ngarkuara me hartimin dhe monitorimin e legjislacionit në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave.

Prioritetet

- Vijimi i punës për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit të paharmonizuar të BE-së;



- Forcimi i kapaciteteve të institucioneve zbatuese dhe në veçanti të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut;

- Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit, përmes funksionimit të Tryezës së Rrumbullakët për Kapitullin 1, tashmë të ngritur në kuadër të Platformës së Partneriteti për Integrimin Evropian;

- Rritja e kapaciteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, lidhur me përfundimin e fazës *screening* dhe me tej me procesin e bisedimeve të anëtarësimit për Kapitullin 1;

- Legjislacioni për produktet e mbrojtjes dhe prokurimin nuk është i përafëruar me *acquis*-në.

- Ligji 27 / 2018 “Për Trashëgiminë kulturore dhe muzetë” është i përafëruar pjesërisht me *Acquis* për kthimin e objekteve kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar. Vazhdon puna për hartimin dhe miratimin e akteve tjera nënligjore për këtë qëllim, të parashikuara në zbatim të ligjit, si dhe të normave përkatëse të *acquis*.

Masat ligjore të planifikuara 2022 – 2024

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik “Për enët e thjeshta nën presion” dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, që synon përafrimin e pjesshëm me Direktivën 2014/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 26 shkurtit 2014 për harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të enëve të thjeshta nën presion (SPVD). **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2022.**

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e gazit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, që synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren (BE) 2016/426 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 9 Mars 2016 mbi pajisjet e gazit. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2023.**

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, që synon përafrimin e pjesshëm me Rregulloren BE 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 20 Qershor 2019 mbi

mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve, si dhe Rregulloren BE 2019/515 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 19 Mars 2019 mbi njohjen reciproke të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024.**

- Projektligji “Mbi përcaktimin e autorizimeve të eksportit, dhe masat për importin, transitin e armeve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve”, i cili synon harmonizimin e Rregullores 258/2012. **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024.**

- Projekt Ligji “Për produktet e ndërtimit” i cili synon harmonizimin e pjesshëm të Rregullores 305/2011 mbi përcaktimin e kushteve të harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërtimit dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 89/106/KEE; **Planifikohet të miratohet në tremujorin e katërt të vitit 2024.**

KAPITULLI 2: LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE

4.2.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve parashikon që qytetarët e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar, duke u mundësuar atyre të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët vendas. Lëvizja e lirë e personave bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian dhe Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Këto parime përfshijnë heqjen e pengesave për lëvizjen e lirë të punëtorëve, qasjen e barabartë në tregun e punës dhe ndalimin e diskriminimit. *Acquis* në këtë kapitull parashikon që shtetasit e BE-së kanë të drejtë të lëvizin dhe të punojnë në vende të tjera anëtare të BE-së, të qëndrojnë aty për këtë qëllim së bashku me familjet e tyre dhe të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët kombëtarë sa i përket kushteve të punës, si dhe çështjeve sociale dhe tatimore. Për më tepër, *acquis* përfshin instrumentet e BE-së për koordinimin e sistemeve të ndryshme kombëtare të sigurisë sociale.

4.2.2 Struktura e kapitullit

- Aksesit në tregun e punës;



- Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

4.2.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit përmban detyrime të shumta, që burojnë nga dispozitat e neneve 48 dhe 49 të MSA, në fushën e qasjes në tregun e punës për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, lëvizjen e punëtorëve, kushtet e punësimit dhe trajnimit profesional. Aspekte të tjera të lëvizjes së lirë të punëtorëve kanë të bëjnë me promovimin e shkëmbimeve rinore dhe përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe për punësimin dhe formimin profesional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon që, në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme, Shqipëria dhe Shtetet Anëtare të BE-së të sigurojnë që shtetasit e vendit partner të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e tyre nuk janë objekt diskriminimi, për sa i përket kombësisë, kushteve të punës, shpërblyerimit apo pushimit nga puna.

Detyrimi i Shqipërisë për koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore buron nga nenet 48 e 99 të MSA-së. Nenet 46, 47, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 70 MSA përcaktojnë shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e aksesit në tregun e punës për qytetarët e BE-së.

Trajtimi i punëtorëve që janë shtetas shqiptarë dhe të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar rregullohet sipas Neneve 46 dhe 47 të MSA.

4.2.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Në Raportin e KE për vitin 2020 për kapitullin 2 “Për lirinë e lëvizjes për punëtorët”, Shqipëria ka arritur një farë niveli të përgatitjes. Progres është bërë përparim në këtë fushë, veçanërisht me lëvizjen e lirë të anëtarëve të familjes së qytetarëve të BE-së; në përfundimin e marrëveshjeve të reja bilaterale të sigurimeve shoqërore dhe në përgatitjen për t’u bashkuar me Rrjetit Evropian të Punësimit (EURES) pas aderimit.

Akresi në tregun e punës

Qytetarët e BE-së kanë të drejtë të punojnë në Shqipëri pa leje pune. Kjo mundësohet nga dispozitat e Ligjit për të Huajt dhe ndryshimeve pasuese, të cilat parashikojnë se të huajve nuk iu

nevojitet leje pune apo certifikatë regjistrimi biznesi, nëse janë shtetas të një Shteti Anëtar të BE-së ose vendi Schengen dhe me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri. Përshatshmëria e skemave të sigurimeve shoqërore dhe njohja e pensioneve profesionale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe. Politikat e pranimit të emigrantëve nuk vendosin pengesa ndaj vendbanimit të përhershëm të familjarëve të punëtorëve nga vendet e BE-së.

Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me detyrimet e integritetit evropian në kuadër të kapitullit 2, synon të krijojë mundësi për qasje të barabartë dhe pa diskriminim në tregun e punës, formimit profesional, lëvizjes së punëtorëve të BE, si dhe kushteve të punësimit, njësoj si shtetasit shqiptarë.

Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”, në lidhje me punësimin e shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjes së tyre me shtetësinë e një vendi anëtar ose jo, krijojnë mundësinë e punësimit në tregun e punës në vend, pa qenë të kufizuar nga kuotat vjetore të punësimit, detyrimi për tu pajisur me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë.

Së fundmi, është miratuar një ligj i ri integral për të huajt. Ligji 79/2021 “Për të huajt”, miratuar tashmë në Kuvendin e Shqipërisë, synon përafrim me *acquis* e BE në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve dhe imigrimit për motive punësimi. Një risi e këtij ligji ishte bashkimi i dy lejeve dhe procedurave për qëndrimin dhe punësimin e të huajve në vend në një leje unike. Shtetasit e BE dhe anëtarët e familjeve të tyre që nuk kanë shtetësinë e një Shteti Anëtar të BE apo Zonës Shengen, edhe me ligjin e ri për të huajt, gëzojnë të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës në vend njësoj si shtetasit shqiptarë, pa u kufizuar nga kuotat për punësimin e të huajve apo detyrimi për t’u pajisur me leje unike për punësim apo ndonjë autorizim tjetër të ngjashëm me të. Me miratimin e ligjit të ri 79/2021 “Për të huajt”, institucionet shqiptare (Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë) kanë filluar punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.

Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” i cili përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit,



programet aktive dhe pasive të tregut të punës dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Sipas këtij ligji, shtetasit e BE-së që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime punësimi, kanë të drejtë të përfitojnë nga shërbimet e ofruara në strukturën rajonale/lokale. (Neni 4). Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, e ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 31.4.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, siguron përmbushjen e këtyre të drejtave.

Ligji nr. 7961/1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet edhe ndaj shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjeve të tyre njësoj si për shtetasit shqiptarë për çështje që lidhen me punësimin e tyre dhe marrëdhëniet e punës, të cilat nuk mbulohen nga ligji 108/2013 për të huajt (neni 4). Sipas nenit 9 të këtij Kodi, : “1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 2. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët....”.

Lidhur me përgatitjen për t’u bashkuar EURES (Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit), Shqipëria ka krijuar një databazë të integruar për sistemin e shërbimit të punësimit. Kjo do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet departamenteve TI të gjendjeve civile, të sistemit tatimor, sistemit të kujdesit të detyrueshëm shëndetësor dhe sistemit të ndihmës ekonomike.

Qytetarët italianë, të cilët përbëjnë numrin më të madh të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës, janë të punësuar kryesisht në fushën e mjekësisë, shërbimeve, marketingut, tregtisë,

industrisë përpunuese, informacionit dhe telekomunikacionit. Qytetarët rumunë, të cilët janë grupi i dytë më i madh i qytetarëve të BE-së që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, janë të punësuar kryesisht në fushën e tregtisë dhe shërbimeve dhe call centers.

Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

Koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, në pajtim me Nenin 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, MFE ka ndërmarrë angazhimin për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar me elementet e sigurimeve shoqërore. Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore me vendet e tjera është një nga angazhimet thelbësore për t’u bërë pjesë e familjes evropiane.

Marrëveshjet dypalëshe mbi sigurimet shoqërore ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve përkatëse janë ratifikuar dhe kanë hyrë në fuqi me: Republikën Turke, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Dukatin e Madh të Luksemburgut, Hungarinë, Republikën Çeke, Republikën Federale të Gjermanisë, Mbretërinë e Belgjikës, Republikën e Austrisë dhe Bullgarisë.

Priten të hyjnë në fuqi marrëveshjet dypalëshe me:

- Rumaninë, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 42 datë 14.04.2016;
- Kanadanë e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 58, datë 12.09.2019.

Marrëveshja me Konfederatën Zvicerane, është miratuar me VKM Nr. 533, datë 31.07.2019 “Për Miratimin në Parim të Marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, për Mbrojtjen Shoqërore”, por nuk është ratifikuar. Jemi njoftuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme që midis datave 17 – 19 shkurt 2022 do të firmoset në Tiranë midis palëve Marrëveshja.

Marrëveshja me Republikën e Bullgarisë është miratuar në parim me VKM Nr. 820, datë 24.12.2021. Është dërguar shkresë tek Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për ta venë në dijeni dhe për të caktuar hapin e radhës nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Marrëveshja me Republikën e Kosovës u miratua në parim me VKM Nr. 719, datë



24.11.2021. U firmos nga palët në datë 26.11.2021. Që në datë 20.01.2022 është në proces ratifikimi në Parlament.

Aksesi në tregun e punës

Me VKM-në Nr. 659/2019 u miratuan në tetor 2019 “Strategjia për Punësimin dhe Aftësitë” dhe Plani i saj i Veprimt. Vizioni i Strategjisë së Punësimit dhe Aftësive është: “Aftësi më të larta dhe punë më e mirë për të gjithë gratë dhe burrat”. Strategjia rishikoi treguesit deri në vitin 2022, duke u bazuar në të dhëna të konfirmuara nga bashkëpunimi i ngushtë me INSTAT. Për më tepër, Plani i Veprimt 2019 – 2022 dhe treguesit për zbatimin e tij, detajojnë buxhetin e planifikuar për secilën masë, në bashkëpunim dhe me kontributin e donatorëve. Secila masë do të zbatohet nga mbështetja e parashikuar në SRC, si dhe nga projektet e donatorëve që janë duke u zbatuar, si dhe nga projektet e aprovuara që do të fillojnë të zbatohen.

Miratimi i ligjit 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, sipas të cilit edhe anëtarët e familjes së shtetasve të një prej vendeve të BE, të cilët nuk kanë shtetësinë e këtyre vendeve, gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë për tu punësuar në tregun e punës në vend, pa u detyruar të pajisen me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë si dhe pa kufizime të kuotave për pranimin dhe punësimin e tyre.

Ndryshimet patën si qëllim të arrijnë përafrim më të plotë me nenet 23 dhe 24 të Direktivës 2004/38/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 29 prillit 2004 mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të Shteteve Anëtare duke ndryshuar Rregulloren (KEE) Nr. 1612/68/360/KEE, 75/34/KEE, 75/35/KEE, 90/364/KEE, 90/365/KEE, dhe 93/96/KEE.

Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”.

Ndryshimi i programeve të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të punësimit, është realizuar nëpërmjet miratimit të 5 (pesë) vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe 8 (tetë) programeve, përfshirë edhe programet për të nxitur punësimin e personave të dalë të papunë për shkak të COVID-19.

Me qëllim përmirësimin e kushteve të punës të punëmarrësve, me urdhër të Kryeministrit në 24 nëntor 2020 u miratua struktura e re e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si organ që kontrollon zbatimin e legjislationit të punës në subjektet që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë.

Kjo strukturë solli rritje të stafit të SLISS si dhe një riorganizim të saj, ku një vend të posaçëm zë krijimi i Sektorit të Analizës së Riskut, i cili pjesë të punës së tij ka analizën e riskut, procesin e menaxhimit të risqeve për planifikimin dhe monitorimin e punës inspektuese të terrenit.

Procesi i analizës së Riskut duke qenë i centralizuar do të sigurojë që trupa inspektuese e punës të ketë një pamje të plotë të risqeve dhe të ndërmarrë strategjitë e duhura.

Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

Lidhur me shtetet e mëposhtme, statusi i lidhjes së marrëveshjeve, paraqitet sa vijon:

- **Bullgaria** – u miratuar në parim me VKM Nr. 820, datë 24.12.2021. Është dërguar shkresë tek Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për ta venë në dijeni dhe për të caktuar hapin e radhës nëpërmjet rrugëve diplomatike;

- **Kosova** – u miratua në parim me VKM Nr. 719, datë 24.11.2021. U firmos nga palët në datë 26.11.2021. Që në datë 20.01.2022 është në proces ratifikimi në Parlament;

- **Mali i Zi** – është shprehur interesimi i palës malazeze për hapjen e bisedimeve për dakordësimin e një marrëveshjeje dypalëshe.

Në përgjithësi kuadri ligjor nuk është ende plotësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së.

4.2.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH)
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale / Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit



- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

4.2.6 Mangësitë e Identifikuara dhe prioritet

Në vijim të miratimit të ligjit 79/2021 Për të huajt, lind nevoja e përshtatjes të akteve nënligjore me ligjin e ri, si dhe e trajnimeve të punonjësve të AKPA dhe hartimit të manualeve për zbatimin e duhur të legjislacionit në fuqi.

Nevojitet një analizë e përditësuar e mangësive ligjore dhe institucionale për aktet ligjore të këtij kapitulli me legjislacionin vendas, trajnime të punonjësve të institucioneve të përfshira në përafrimin e legjislacionit të këtij kapitulli dhe takime periodike të GNP së këtij kapitulli. Në lidhje me aksesin në tregun e punës, është e nevojshme analiza sektor për sektor lidhur me aksesin e shtetasve të BE në to dhe barrierat që ekzistojnë. Duke parë që punonjësit e Sektorit të Politikave të Punësimit dhe Migratore janë të angazhuar edhe në kapituj të tjerë, asistencë me ekspertizë dhe burime njerëzore në këtë drejtim është e nevojshme.

Fokusi kryesor i Institucioneve të Qeverisë Shqiptare është:

- Të përafrojnë legjislacionin e BE-së për lëvizjen e lirë të punëtorëve dhe të zhvillojë një sistem IT që të krijojë mundësinë e lidhjes me EURES. Kjo do të thotë se qytetarët e BE-së do të kenë akses për punësim në Shqipëri dhe do të trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit shqiptarë në aspektin e punësimit, kushtet e punësimit, shpërblimit, studimit dhe formimit profesional.

- Të zbatojnë legjislacionin në fuqi në fushën e të huajve, punësimit, formimit e arsimit profesional si dhe i kushteve të punës dhe marrëdhënieve të punës, për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë, si dhe të punojnë në përafrimin e vazhdueshëm të tij me *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve.

Në adresim të rekomandimeve të Komisionit Evropian, Qeveria shqiptare ka përqendruar përpjekjet e saj në koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore për qytetarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, si dhe punëtorët e Shteteve Anëtare të BE-së të punësuar në Shqipëri. Kjo përfshin nënshkrimin e marrëveshjeve të mbrojtjes sociale me shumë vende. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale dhe me Ministrinë për Evropën dhe Punëve të Jashtme po punon për të forcuar koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me vendet ku ka një numër të konsiderueshëm të qytetarëve shqiptarë, veçanërisht në Itali dhe Greqi. Për koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore ekzistojnë marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me: Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Austrinë, Rumaninë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Kanadanë, Kosovën dhe Turqinë.

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

4.3.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që e drejta e krijimit të personave kombëtarë dhe juridikë të BE-së në çdo shtet anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkuftare nuk pengohet nga legjislacioni kombëtar, në varësi të përjashtimeve të përcaktuara në Traktat. *Acquis* harmonizon gjithashtu rregullat në lidhje me profesionet e rregulluara për të siguruar njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve dhe diplomave midis Shteteve Anëtare; për disa profesione të rregulluara duhet të ndiqet kurrikula e zakonshme minimale e trajnimit në mënyrë që kualifikimi të njihet automatikisht në një shtet anëtar të BE-së. Sa i përket shërbimeve postare, *acquis* gjithashtu synon hapjen e sektorit të shërbimeve postare për konkurrencën në një mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kornize rregullatore që siguron një shërbim universal.

4.3.2 Struktura e kapitullit

- E drejta e vendosjes
- Liria për të ofruar shërbime ndërkuftare
- Shërbimet postare
- Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

4.3.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Nenet e MSA-së që kanë rëndësi për këtë kapitull janë: 50, 57, 58, 70 dhe 100.

Neni 50 kërkon që Shqipëria të lehtësojë krijimin e veprimtarisë në territorin e saj nga kompanitë dhe shtetasit e Komunitetit (duke përfshirë filialet dhe degët), duke u dhënë atyre trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u akordohet kompanive të tij ose ndonjë kompanie të vendit të tretë, cilado që është më e mirë. Neni 57 kërkon që të dy palët të ndërmarrin hapa të domosdoshëm



për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë përkatëse ose shtetasit të cilët janë themeluar në një palë të ndryshme nga ajo e personit për të cilin shërbimet janë të destinuara. Në hap me këtë proces liberalizimi, palëve u kërkohet të lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë që ofrojnë shërbimin ose që janë të punësuar nga ofruesi i shërbimit si personel kyç. Neni 58 kërkon që Shqipëria të mos vendosë ndonjë masë apo veprimi të ri që i bëjnë kushtet më të rrepta për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit e BE-së në krahasim me situatën ekzistuese përpara hyrjes në fuqi të MSA-së.

Sipas nenit 70 të MSA-së, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së, si dhe të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet siç duhet.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se e drejta e vendosjes e shtetasve dhe personave juridikë të BE-së në çdo Shtet Anëtar dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare, siç parashikohet në nenin 49 dhe 56 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE) nuk pengohet nga legjislacioni kombëtar, duke iu nënshtruar përjashtimeve të përcaktuara në Traktat. Pjesa thelbësore e *acquis* në këtë fushë është Direktiva 2006/123 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve). Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje me nenet 49 dhe 56 është gjithashtu pjesë e *acquis*.

Acquis në këtë kapitull është e natyrës horizontale dhe mund të ndahet në tre fusha të përgjithshme:

i) e drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve (nenet 49 dhe 56 të TFBE dhe Direktiva e Shërbimeve);

ii) njohja ndërsjellë e kualifikimeve profesionale (kryesisht Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi njohjen e kualifikimeve profesionale e ndryshuar kohët e fundit nga Direktiva 2013/55/KE);

iii) shërbimet postare, (kryesisht Direktiva 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar) të cilat përbëhen nga një kornizë rregullatore specifike sektoriale që siguron ofrimin e shërbimeve postare universale dhe krijimin e një tregu të brendshëm postar.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime, Direktiva e Shërbimeve përmban dispozita

që synojnë të lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për ofruesit e shërbimit, si dhe të ofrojnë shërbime të përkohshme ndërkufitare në një Shtet tjetër Anëtar. Direktiva është një instrument horizontal që mbulon një gamë të gjerë shërbimesh të ndryshme dhe që ka gjasa të ndikojë në një numër të konsiderueshëm të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare. Zbatimi i saj kërkon që Shtetet Anëtare të ndërmarrin një kombinim të masave legjislative dhe jo-legjislative (masa organizative ose praktike).

Për këtë arsye, dhe sa i përket legjislacionit zbatues, kërkohet një përzierje e masave legjislative horizontale dhe specifike që ka të ngjarë të përfshijë ndryshimin e ligjeve ekzistuese, si dhe miratimin e legjislacionit të ri specifik dhe të një ligji kuadër horizontal. Dispozitat e Direktivës bazohen në masë të madhe në jurisprudencën relevante të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të cilat mbeten plotësisht të zbatueshme. Direktiva kërkon caktimin e një Pike të Vetme Kontakti (PVK), ku ofruesit e shërbimeve mund të marrin informacion elektronik dhe të plotë mbi procedurat administrative që kërkohen për akses dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit. Për më tepër, autoritetet e shteteve anëtare duhet të marrin pjesë në një sistem elektronik të shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve administrative (Sistemi i brendshëm i informacionit të tregut ose IMI) që lejon bashkëpunimin në mbikëqyrjen e aktiviteteve të shërbimeve dhe shkëmbimin efektiv të informacionit midis shteteve anëtare.

Përsa i përket njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale, Direktiva 2005/36 “Për njohjen e kualifikimeve profesionale” e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar, përcakton rregullat në lidhje me njohjen e kualifikimeve profesionale ndërmjet shteteve anëtare për të lehtësuar aksesin në profesione të rregulluara për shtetasit evropianë që dëshirojnë të ushtrojnë profesionin e tyre në një Shtet Anëtar të ndryshëm nga ai ku kanë përfituar kualifikimet respektive. Direktiva lehtëson gjithashtu ofrimin e shërbimeve të përkohshme dhe të rastësishme nga profesionistët (që mbulohen nga Titulli II i Direktivës). Për disa profesione të rregulluara, duhet të ndiqet një program i përbashkët trajnimi minimal, me qëllim që kualifikimi të njihet automatikisht në një Shtet Anëtar të BE-së (mbuluar nga Kapitulli III i Titullit III të Direktivës). Në rastin e profesioneve të sektorit të shëndetësisë, kërkesat minimale të



trajnimin janë të detyrueshme në çdo Shtet Anëtar si kushte për aksesin në profesion edhe në nivel kombëtar. Përveç Direktivës së lartpërmendur, njohja e kualifikimeve profesionale për disa profesione rregullohet nga legjislacioni specifik. Brenda Kapitullit 3 ekzistojnë 5 direktiva të tilla.

Dy direktiva kanë të bëjnë me profesionet që merren me produkte toksike: Direktiva 74/557/KEE “Mbi arritjen e drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime në lidhje me aktivitetet e personave të vetëpunësuar dhe të ndërmjetësve që angazhohen në tregtimin dhe shpërndarjen e produkteve toksike” si dhe Direktiva 74/556/KEE, që përcakton dispozita të hollësishme në lidhje me masat kalimtare në lidhje me aktivitetet, tregtinë dhe shpërndarjen e produkteve toksike dhe aktivitetet që përfshijnë përdorimin profesional të produkteve të tilla duke përfshirë aktivitetet e ndërmjetësve, sepse disa Shtete Anëtare kërkojnë kualifikime specifike për profesionet që merren me produkte toksike.

Sidoqoftë, profesionistët që vijnë nga një shtet anëtar i BE-së që nuk kërkojnë kualifikime të tilla, ende mund t'i kryejnë këto aktivitete nëse ata ofrojnë dëshmi për përvojën profesionale. Direktivat mbulojnë profesionistët që merren me substancat toksike në vijim: pesticide, substanca helmuese, produkte medicinale (fito-farmaceutike dhe produkte të destinuara për përdorim si ruajtës të ushqimit), herbicide, produkte të dëmshme për përdorim në industri, gazra toksike, produkte mjekësore kirurgjikale, baktericide, germicide dhe desinfektantë) dhe produktet kozmetike dhe ngjyresit që përmbajnë substanca helmuese.

Dy direktiva të tjera mbulojnë ushtrimin efektiv të profesionit të avokatit, Direktiva 77/249/KEE dhe Direktiva 98/5/KE, e para trajton ofrimin e shërbimeve dhe e dyta të drejtën e vendosjes.

Direktiva e fundit (Direktiva 86/653/KEE) rregullon profesionin e agjentëve tregtarë, ndërmjetësve të vetëpunësuar të autorizuar për të negociuar shitjen dhe blerjen e mallrave, në emër për llogari të një personi tjetër). Direktiva harmonizon rregullat për: të drejtat dhe detyrimet e agjentëve tregtarë dhe porositësve të tyre; shpërblimin e agjentëve tregtarë; dhe lidhjen dhe përfundimin e kontratave të agjencisë, si dhe çdo dëmshpërblim ose kompensim për agjentët k në rast të përfundimit të kontratës.

Acquis për shërbimet postare synon hapjen e sektorit të shërbimeve postare ndaj konkurrencës në mënyrë graduale dhe të kontrolluar, brenda një kuadri rregullator i cili garanton ofrimin e shërbimeve postare universale. Pjesa kryesore e legjislacionit përfshin tre direktivat postare në vijim: i) Direktiva e parë (kornizë) është ajo 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e ndryshuar nga ii) Direktiva e dytë postare 2002/39/KE e Parlamentit dhe Këshillit, dhe iii) Direktiva e tretë postare 2008/6/KE. *Acquis* parashikon krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe promovon një shërbim postar të cilësisë së lartë për përdoruesit fundor. Për sa i përket kapacitetit administrativ, krijimi i një Autoriteti Kombëtar Rregullator (AKR) të pavarur në këtë fushë, është vendimtar për zbatimin e duhur të legjislacionit përkatës të BE-së.

4.3.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime. Sipas raportit të progresit të KE-së vitit 2021, është arritur progres i mirë në periudhën raportuese, veçanërisht përmes inicimit të ushtrimit të shqyrtimit të legjislacionit për t'u përafruar me *acquis* në disa sektorë. Ky përparim është ngritur dy nivele me vlerësimin e vitit 2020.

Rekomandimet e vitit 2021 mbeten të njëjta me ato të vitit 2020:

- finalizimi i shqyrtimit të legjislacionit ekzistues për të identifikuar pengesat për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve me synimin për të përafruar më tej legjislacionin vendas me Direktivën e Shërbimeve;

- të shtojë përpjekjet për të harmonizuar legjislacionin e tij me *acquis* të BE-së dhe të sigurojë kapacitetin e duhur institucional në fushën e njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale.

Në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve, legjislacioni për minierat dhe politikat sociale është gjerësisht në përputhje me Direktivën e Shërbimeve. Klinikat dhe spitalet veterinare licencohen sipas Ligjit Nr. 10081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga Qendrat Kombëtare të



Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”- pjesa e kategorisë II.2.

Legjislacioni që rregullon profesionin e avokatit është përafruar pjesërisht me *acquis* të BE-së ndërsa ende ka kufizime veçanërisht për noterët dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë.

Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP) për Kapitullin 3, i mbështetur nga projekti GIZ SANECA, në shtator të vitit 2020 kreu një analizë të parë gjithëpërfshirëse të mangësive ligjore, institucionale dhe administrative për të përcaktuar nivelin e përafrimit me *acquis* të kuadrit ligjor dhe institucional vendas dhe për të planifikuar masat e nevojshme për harmonizimin e mëtejshëm. Analizat gjithashtu u përditësuan në fillim të shkurtit të vitit 2021 dhe janë objekt përditësimi sipas ndryshimeve në nivelin e përputhshmërisë me *acquis* në vend dhe masave të planifikuara për harmonizim.

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime

E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve rregullohen nga Ligji Nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa regjimi i përgjithshëm për krijimin dhe regjistrimin e një biznesi rregullohet nga Ligji Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Ligji Nr. 9723/2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar. Ligji Nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, rregullon regjimin e përgjithshëm të dhënies së autorizimeve për bizneset, ndërsa parimet kryesore të Direktivës së Shërbimeve të BE-së gjejnë parashikim në Ligjin Nr. 44/2015” Për kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë sip.sh., e drejta për informim, procedurat elektronike, kushtet për lëshimin e autorizimeve, përfshirë miratimin në heshtje.

Ligji nr. 66/2016 “Për shërbime në Republikën e Shqipërisë” transpozon shumicën e dispozitave kryesore të Direktivës së Shërbimeve të BE-së në lidhje me të drejtën e vendosjes. Ai u garanton personave fizikë dhe juridikë (të brendshëm dhe të huaj) aksesin në treg dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit pa diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në bazë shtetësie, p.sh., duke ndaluar kritere si shtetësia, rezidenca ose kufizime të pjesëmarrjes në shoqëri ose testin e nevojës ekonomike. Ai garanton akses jo diskriminues në shërbime, si për marrësit e shërbimeve vendas,

ashtu dhe për të huaj, parashikon standarde cilësie për ofrimin e shërbimeve dhe kërkon ngritjen e një pike të vetme kontakti (PVK), si pjesë e portalit e-Albania. Kjo e fundit është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1147, datë 9.12.2020 “Për Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “portali unik qeveritar e-Albania” dhe për miratimin e rregullave “Për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit”, i cili vepron si one-stop-shop për ofruesit e shërbimeve dhe përfituesit e tyre. Pika e Vetme e Kontaktit shërben për të marrë informacion mbi kërkesat për akses dhe ushtrim të aktivitetit të shërbimit, për detajet e kontaktit të autoriteteve kompetente që rregullojnë aksesin në treg për aktivitetet përkatëse të shërbimit, për shoqatat ose organizatat nga të cilat ofruesit dhe marrësit e shërbimeve mund të asistohen, mjetet juridike në rast mosmarrëveshjeje dhe mundësia për të përfunduar procedurat dhe formalitetet për aksesin dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimit online.

Legjislacioni vertikal, pra legjislacioni sektorial që rregullon aksesin dhe ushtrimin e aktiviteteve të veçanta të shërbimeve në sektorë të ndryshëm, p.sh. në turizëm, tregti, shërbimet e biznesit, etj., duhet të jenë në përputhje me parimet e përcaktuara në Ligjin për Shërbimet dhe, rrjedhimisht, me Direktivën e Shërbimeve të BE-së. Autoritetet kompetente duhet të rishikojnë legjislacionin ekzistues sektorial në juridiksionin e tyre për përputhshmëri me Ligjin për Shërbimet dhe Direktivën e BE-së për Shërbimet, duke siguruar gjithashtu përputhshmërinë me to të iniciativave ligjore/rregullatore të ardhshme përmes sistemit të njoftimi të parashikuar nga Ligji për Shërbimet.

Në këtë kuadër dhe në vijim të rekomandimit të Komisionit Evropian për të përfunduar shqyrtimin e legjislacionit ekzistues (*screening*), me qëllim identifikimin e barrierave për lirinë e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe për të harmonizuar më tej legjislacionin me Direktivën e Shërbimeve, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), ministria përgjegjëse për Kapitullin 3, në bashkëpunim me autoritetet kompetente përkatëse, përfundoi në korrik 2020 shqyrtimin (*screening*) e 20 nga 35 sektorët e shërbimeve prioritare të identifikuar më parë. Aktualisht po punohet për të përfunduar shqyrtimin e të gjithë sektorëve përkatës të shërbimeve deri në nëntor 2022, në



mënyrë që të arrihet përafrimi i mëtejshëm me *acquis*. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) vepron si një qendër me një ndalesë për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit. QKB administron regjistrin tregtar (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe ai mbahet në format elektronik. QKB administron edhe Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike për të gjitha licencat / lejet e lëshuara në Shqipëri. Qendra Kombëtare e Biznesit operon përmes pikave të shërbimit në të gjithë vendin, si dhe nëpërmjet portalit *e-Albania*.

Prej vitit 2015, Qendra Kombëtare e Biznesit ka ofruar shërbimet e saj online nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* pa kosto. Ndërkohë, duke filluar nga vitit 2020, shërbimet e regjistrimit të personave fizikë, pezullimit dhe aktivizimit të aktivitetit të subjekteve, si dhe pajisjes me licencë/leje ofrohen vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*. Në periudhën raportuese, rreth një milion përdorues të regjistruar të *e-Albania* përfituan nga mbi 500 000 shërbime elektronike në muaj.

Ligji nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” ka transpozuar plotësisht Direktivën 2005/56/KE “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar” të ndryshuar. Ligji rregullon procedurat, autoritetet përgjegjëse të përfshira në rastin e bashkimeve ndërkufitare ndërmjet një shoqërie shqiptare dhe një shoqërie të themeluar në një shtet anëtar të BE-së, duke lehtësuar bashkimin pa kaluar në likuidim. Për të lehtësuar zbatimin e ligjit në praktikë, i) bëhet një komentim i ligjit dhe një TOT për noterët, pasi ato janë caktuar nga ligji me detyrën e shqyrtimit të ligjshmërisë së bashkimit; ii) 15 formularë regjistrimi ndërkufitar janë në dispozicion në QKB.

Në fushën e shërbimeve postare, legjislacioni është i përafruar plotësisht me Direktivën 97/67/KE, të ndryshuar, me përjashtim të rregullores për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare për pakot. Tregu postar është hapur ndaj konkurrencës që nga viti 2017. Ekziston një ofrues i shërbimit universal në treg (Posta Shqiptare Sh.A) dhe 33 ofrues të tjerë shërbimesh postare që janë pajisur me Autorizim

nga AKEP. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është institucioni rregullator përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë. Strategjia e Re për Sektorin Postar 2021+ është hartuar dhe është publikuar për konsultim publik gjatë vitit 2021. Pritet të dërgohet për konsultime nëpërmjet sistemit *e-Akte*, pranë ministrive të linjës.

Profesionet e rregulluara në Shqipëri rregullohen me Ligjin nr. 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili transponon disa aspekte të Direktivës së BE-së për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale (Direktiva “Për njohjen e kualifikimeve profesionale 2005/36/KEE dhe 2013/55/KE”).

Për t’iu përgjigjur rekomandimit të Komisionit Evropian për të forcuar përpjekjet për përafrimin e legjislacionit të Shqipërisë me *acquis* të BE-së dhe për të siguruar kapacitetin e duhur institucional në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, Ministria e Arsimit dhe Sporteve me mbështetjen e projektit të GIZ SANECA, miratoi konceptin për përgatitjen e një udhërrëfyesi për përafrimin me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale në prill 2021 dhe planin e punës për përgatitjen e udhërrëfyesit në maj 2021. Identifikimi fillestar i aktorëve institucionalë që do të përfshihen në procesin përgatitor u realizua në korrik 2021. Për këtë qëllim janë ngritur grupe specifike pune. Ndërkohë po punohet veçanërisht në lidhje me përgatitjen e inventarit të legjislacionit që do të vlerësohet për përputhshmëri me *acquis* dhe listën e profesioneve të rregulluara. Udhërrëfyesi pritet të përgatitet brenda vitit 2022.

Krahas këtyre, Shqipëria është angazhuar të integrojë dhe zbatojë njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale për profesionet e rregulluara në rajon, në përputhje me *acquis*, si pjesë e agjendës së saj të integritetit rajonal, p.sh., nismës/planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021 – 2024, miratuar nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në nëntor 2020.

Në veçanti, RCC do të lehtësojë procesin e njohjes automatike të kualifikimeve profesionale për 7 profesione (profesionet sektoriale) bazuar në sistemin e njohjes automatike të BE-së. Në janar 2021, RCC paraqiti një projekt marrëveshje për të vendosur njohjen automatike për tre nga shtatë



profesionet e negociuara më parë nga palët (mjekët, dentistët dhe arkitektët), ndërsa katër profesionet e mbetura do të vazhdojnë të negociohen.

Sekretariati i CEFTA-s është ngarkuar të marrë drejtimin në miratimin e një kuadri për njohjen e kualifikimeve profesionale bazuar në regjimin e përgjithshëm të njohjes të BE-së në një sektor pilot (inxhinierët), me shtrirje graduale çdo vit në sektorë të tjerë që mbulohen nga regjimi i përgjithshëm i njohjes i BE-së.

Përmbledhje e arritjeve kryesore

Të përgjithshme

Me mbështetjen e projektit të GIZ SANECA, GNPIE e Kapitullit 3 përditësoi analizën e mangësive ligjore, institucionale dhe administrative në shkurt 2021.

Përveç kësaj, MFE zhvilloi një metodologji për identifikimin dhe hartëzimin e palëve të interesuara, ndër të tjera në Kapitullin 3, bazuar në një matricë rëndësi-ndikim, me qëllim të ngritjes së tryezës përkatëse të konsultimit për Kapitullin 3 në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrim Evropian (PPIE). MFE nisi thirrjen për aplikime për Tryezën e Konsultimit të Kapitullit 3 PPIE në mars 2021 dhe mbajti sesione informues për të rritur ndërgjegjësimin e aktorëve jo shtetërorë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen në Platformë. Tryeza përkatëse e Kapitullit 3 u krijua në maj 2021 dhe tashmë disponon rregullat e punës për funksionimin e duhur si një platformë konsultimi midis aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në procesin e anëtarësimit në kapitullin përkatës.

E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

Në korrik 2021, MFE përfundoi shqyrtimin e legjislacionit sektorial (*screening*) për përputhshmëri me Direktivën e Shërbimeve të BE-së për 20 nga 35 sektorët e shërbimeve prioritare të identifikuara më parë. Në *screening* u përfshinë sektorët shërbimeve si në vijim: profesionet ligjore (avokatët, ndërmjetësit dhe noterët), sektori i minierave, shërbimet sociale private, tatimet (agjentët tatimorë), doganat (agjentët doganorë dhe agjencitë doganore), veterinaria, pronësia industriale, tregtia elektronike, turizmi, zejet, mjedisi (vetëm në nivel ligjesh), profesionet financiare (audituesit dhe kontabilistët), shërbimet financiare, lojërat e fatit, ndërmjetësit në tregun e punës, arsimit dhe formimit profesional, infrastruktura e cilësisë, tregtia e kafshëve,

ushqimeve, farërave, fidanëve dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve. Si rezultat janë identifikuar 350 aktivitete shërbimi dhe mbi 100 barrierat në tregun e shërbimeve. Më shumë se 200 dispozita në kuadrin rregullator vendas konsiderohen si të papërputhshme me *acquis* dhe duhen shfuqizuar ose ndryshuar. Në procesin *screening* janë përfshirë 20 institucione që rregullojnë aksesin në treg dhe ushtrimin e aktiviteteve të caktuara të shërbimit dhe 48 përfaqësues institucionale janë trajnuar dhe kanë përfituar *coaching* për qëllime të procesit. Po ashtu, janë zhvilluar gjithsej 20 takime konsultative me përfaqësuesit e institucioneve kompetente për të rënë dakord mbi gjetjet e *screening* dhe për të siguruar angazhimin e institucioneve të përfshira për të hequr barrierat në tregun e shërbimeve për sektorët në fjalë. Aktualisht, institucionet e përfshira pritet të miratojnë zyrtarisht rezultatet e *screening* dhe të angazhohen për heqjen e barrierave të identifikuara brenda afateve të caktuara.

Ndërkohë, MFE-së i janë njoftuar nga autoritetet kompetente për vlerësimin e përputhshmërisë me Ligjin për Shërbime tri akte ligjore/nënligjore për fushat si tregtia me pajisje mjekësore, turizmi detar dhe metrologjia nga autoritetet kompetente.

Nëpërmjet projektit “Përmirësimi i cilësisë së Raportimit Financiar” të Bankës Botërore është bërë i mundur përcaktimi qartësisht i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar; rritja e mëtejshme e transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar; përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare; zbatimi i formatit (sistemit) të ri për dërgimin e deklaratave të shërbimit në QKB, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, duke përdorur një format komunikimi elektronik (XML).

Në shkurt 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) nënshkroi një marrëveshje për pjesëmarrjen e regjistrimit tregtar shqiptar në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtar (BIFIDEX). Falë këtij projekti, mundësohet komunikimi në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtarë të vendeve pjesëmarrëse, si dhe baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në vendet pjesëmarrëse. Portali mundëson gjithashtu ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato



të rajonit, duke mundësuar rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të vendeve të rajonit.

AKSHI, si institucioni përgjegjës për administrimin e portalit qeveritar e-Albania, ka bërë me dije se shërbimet e mbetura për personat juridikë janë gati dhe pasi të implementohen dhe të testohen do të jenë gati për t'u përdorur nga biznesi.

Bazuar në rekomandimet e MONEYVAL, është miratuar Ligji Nr. 112/2020, "Për regjistrin e pronarëve përfitues", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore përkatëse. Me miratimin e këtij ligji, u bë i mundur përcaktimi i pronarit përfitues, subjekteve raportuese që kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë në regjister të dhënat e pronarëve të tyre përfitues dhe procedura dhe afatet e nevojshme për regjistrimin e të dhënave të pronarët përfitues. Me miratimin e këtij ligji, u krijua Regjistri i Pronarëve Përfitues, i cili administrohet nga QKB.

Gjithashtu, është krijuar Sporteli Unik (PSC) nr. 1620, datë 10.08.2020 "Për administrimin, funksionimin dhe përdorimin e platformës E-leje". Sporteli unik funksionon si pjesë e strukturës të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Sporteli unik mundëson komunikimin dhe çështjet e ndihmës reciproke për sigurimin e shërbimeve siç parashikohet nga legjislacionin për trashëgiminë kulturore dhe muzetë. Shërbimet e ofruara nga kjo njësi janë të lidhura me Platformën Kombëtare Digjitale e-Albania.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratuan në prill 2021 "Konceptin e përgatitjes së udhërrëfyesit për harmonizimin gjithëpërfshirës me *acquis* për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, ndërsa në maj 2021 u rishikua plani i punës për përgatitjen e Udhërrëfyesit. MAS realizoi në korrik 2021 identifikimin fillestar të aktorëve institucionalë që duhen përfshirë në procesin e përgatitjes së Udhërrëfyesit dhe formoi grupe të dedikuara pune me anëtarë nga institucionet politikbërëse, rregullatore, urdhra profesionale dhe institucione të arsimit të lartë, përgjegjës për aspekte të ndryshme horizontale dhe sektoriale që kërkojnë përafrim me *acquis* në fushën e njohjes së kualifikimeve profesionale dhe profesionet e rregulluara. Në dhjetor 2021, me mbështetjen e projektit GIZ SANECA dhe praninë e ekspertizës ndërkombëtare e kombëtare të mobilizuar, u

mbajtën 5 sesione trajnimi në format hibrid (online dhe fizikisht) mbi përmbajtjen e *acquis*, implikimet ligjore dhe institucionale të tij dhe hapat në procesin e përgatitjes së Udhërrëfyesit, ku morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës kryesisht nga organet rregullatore dhe akademike që lidhen me profesionet e rregulluara.

Shërbimet postare

Nënfusha e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë rregullohet me Ligjin Nr. 46/2015, datë 7.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", plotësisht i përafruar me Direktivën 97/67/KE, të ndryshuar nga Direktiva 2002/39/KE dhe Direktiva 2008/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 20 shkurt 2008, i cili përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve postare në një treg të hapur, të një shërbimi universal postar dhe të financimit të shërbimeve universale dhe aktet e tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Bazuar në këtë ligj janë miratuar 3 Vendime të Këshillit të Ministrave si dhe 8 Rregullore.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", skema e re për licencimin e operatorëve është në përputhje me nenin 9 të Direktivës Postare dhe zona e rezervuar është hequr duke filluar nga 1 janari 2017.

Gjithashtu, me anë të Udhëzimit Nr. 5 datë 25.06.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë "Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare" është përafruar Rregullorja (BE) 2018/644 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 18 prill 2018 mbi shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare.

4.3.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR)

- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës (MIE)
- Ministria e Kulturës (MK)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
- Ministria e Brendshme (MB)



- Banka e Shqipërisë
 - Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)
 - Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
 - Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)
 - Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)
 - Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK)
 - Instituti i Statistikave (INSTAT)
 - Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK)
 - Agjencia Kombëtare Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)
 - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)
 - Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)
 - Qendra e Edukimit Shkencor (CES)
 - Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK)
 - Dhoma Kombëtare e Avokatisë
 - Instituti i Shëndetit Publik
 - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
 - Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve
 - Dhoma Kombëtare e Zëjtarisë
 - Urdhri i Psikologut
 - Agjencia Kombëtare e Formimit Profesional (AKFP)
 - Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)
 - Agjencia e Sigurisë të Cilësisë në Arsim e Lartë (ASCAL)
 - Urdhri Profesional i Infermierit
 - Urdhri Profesional i Veterinerit
 - Urdhri Profesional i Mjekut
 - Urdhri Profesional i Dentistit
 - Urdhri Profesional i Farmacistit
- 4.3.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet
- E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare*

Mangësitë e identifikuara:

- Mospërdorimi i *screening* për të gjithë sektorët përkatës të shërbimeve; MFE planifikon të përfundojë *screening* për të gjithë sektorët përkatës të shërbimeve, p.sh., për rreth 18 sektorë të tjerë si bujqësia, e drejta e autorit, ndërtimi, planifikimi urban, etj., deri në vitin 2022.
- Mospërputhja e Ligjit për Shërbimet me Direktivën e BE-së lidhur me nenet 16 – 18 ofrimin e shërbimeve ndërkufitare dhe bashkëpunimin administrativ. Për më tepër,

nevoja për transpozim të nenit 23 (përgjegjësia profesionale) dhe 25 (shërbimet shumëdisiplinore) të Direktivës së Shërbimit;

- Mungesa e kapaciteteve pranë institucioneve përgjegjëse për kryerjen e *screening*.

Prioritetet:

- Finalizimi i *screening* të legjislacionit sektorial të shërbimeve brenda vitit 2022;
- Përgatitja e planit të veprimit për përafrim me Direktivën e Shërbimeve për të gjithë sektorët relevant të shërbimeve brenda 2022;
- Licencimi i klinikave dhe spitaleve veterinarë aktualisht është i rregulluar nga Ligji Nr. 10081 datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar dhe VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga Qendrat Kombëtare të licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”- pjesa e kategorisë II.2;
- Në sektorin juridik me miratimin e Ligjit për Avokatinë, legjislacioni në këtë fushë është pjesërisht i përafëruar me *acquis* të BE-së, por ekzistojnë kufizime, sidomos për noterët dhe përmbaruesit privatë.

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Mangësitë e identifikuara:

- Mungesa e përafrimit të Direktivës për Kualifikimet Profesionale dhe *acquis* të posaçëm që rregullon fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve (Direktiva 2018/958 për testin e proporcionalitetit dhe *acquis* që rregullon profesione specifike, siç avokatin, agjentët tregtarë dhe tregtarët e produkteve toksike);
- mungesa e kapaciteteve institucionale për përafrimin e Direktivës në fjalë;
- mungesa e kapaciteteve për koordinimin/menaxhimin e procesit/ve të njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

Prioritetet:

- Përgatitja e Udhërrëfyesit për përafrim të plotë me *acquis* në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale brenda vitit 2022.
- Autoritetet shqiptare duhet të forcojnë kapacitetet institucionale për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.
- Përafrimi i mëtejshëm i Direktivës së Kualifikimeve përmes ligjit për profesionet e rregulluara dhe akteve nënligjore në zbatim të



përcaktimeve të *acquis*, si dhe kuadrit ligjor që lidhet me profesionet e rregulluara.

Shërbimet postare

Prioritetet:

- Miratimi i dokumentit të politikave për zhvillimin e sektorit postar për periudhën 2021+, për të përcaktuar objektivat për zhvillimin e sektorit në mënyrë që t'i përgjigjet ndryshimeve për shkak të ndikimit të zhvillimeve teknologjike në sektor, për të garantuar universale postare shërbimi, si dhe promovimin e zhvillimit të tregtisë elektronike.

- Zbatimi i rregullave të miratuara për shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare, bazuar në praktikën e BE-së, me qëllim promovimin e zhvillimit të tregtisë elektronike.

Mangësitë e identifikuar:

- Me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë janë miratuar e rregullat mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare²⁶, në harmoni me Rregulloren (BE) 2018/644 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 18 Prill 2018 mbi shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare.

- Monitorimi i tarifave për këto shërbime nga ana e AKEP pritët të fillojë nga 1 Janari 2022.

KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

4.4.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet anëtare duhet të heqin, me disa përjashtime, të gjitha kufizimet për lëvizjen e kapitalit si brenda BE-së ashtu edhe ndërmjet Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. *Acquis* përfshin gjithashtu edhe rregullat në lidhje me pagesat ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i kërkon bankave dhe operatorëve të tjerë ekonomikë, veçanërisht kur kanë të bëjnë me veprime me vlerë të lartë dhe me transaksione të mëdha në *cash*, të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet e dyshuara. Një kërkesë kryesore për të luftuar krimin financiar është krijimi i kapaciteteve efektive të administrimit dhe zbatimit, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrëse, të zbatimit të ligjit dhe të prokurorisë.

Liberalizimi i pagesave është një kërkesë thelbësore për lëvizjen e lirë të kapitalit.

Më konkretisht, ashtu si dhe për komponentët e tjerë, është e nevojshme që të eliminohen të gjitha kufizimet në lëvizjet e pagesave midis Shteteve Anëtare, si dhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta me përjashtime në rrethana të caktuara. Garantimi i lëvizjes së lirë të pagesave kontribuon gjithashtu në rritjen ekonomike duke mundësuar promovimin e përdorimit të euros si brenda Bashkimit Evropian, ashtu dhe si një monedhë ndërkombëtare. Në këtë kuadër, *acquis* e Bashkimit Evropian synon pikërisht krijimin e Zonën Unike të Pagesave në Euro (Single Euro Payment Area), e cila vepron në të njëjtat rregulla në të gjithë tregun për sa i përket rregullimit të shërbimeve të pagesave dhe mbrojtjes së konsumatorit dhe njëkohësisht promovon pagesat elektronike dhe nxitjen e konkurrencës nëpërmjet prezantimit të aktorëve të rinj.

Më konkretisht, Direktiva 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm²⁶, ka për qëllim lehtësimin e transaksioneve të pagesave brenda BE-së, duke krijuar një kornizë ligjore për Zonën Unike të Pagesave në Euro (Single Euro Payment Area- SEPA). Një direktivë tjetër e rëndësishme është edhe Direktiva e Parasë Elektronike 2009/110/EC²⁷, e cila parashikon kornizën legjislative për marrjen e hapave të mëtejshëm për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të bizneseve dhe të parasë elektronike, si dhe krijon një treg të vetëm në shërbimet e parasë elektronike, duke synuar nxitjen e përdorimit të këtyre shërbimeve nga publiku i gjerë pavarësisht faktit se nuk disponon një llogari bankare.

Akt tjetër i rëndësishëm, i cili mbështet funksionimin e SEPA-s është Rregullorja EC Nr. 924/2009 për pagesat ndërkufitare, e cila rregullon tarifat e vendosura nga një institucion për transaksionet e pagesave elektronike në euro dhe valuta të tjera të njoftuara të Shtetit Anëtar (p.sh. transfertat e kredive, debitime të drejtpërdrejta, pagesa me karta, tërheqje nga ATM-të).

²⁶ që ndryshon Direktivat 2002/65 / EC, 2009/110 / EC dhe 2013/36 / BE dhe Rregulloren (BE) Nr. 1093/2010 dhe shfuqizimin e Direktivës 2007/64 / EC.

²⁷ që ndryshon Direktivat 2005/60/EC dhe 2006/48/EC dhe ndryshon Direktivën 2000/46/EC.



Gjithashtu, edhe Rregullorja e BE-së nr. 260/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 mars 2012, që përcakton kërkesat teknike dhe të biznesit për transfertat e kreditit dhe debitë direkte në euro dhe ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 924/2009, është një akt i rëndësishëm për rregullimin e transfertave të kreditit dhe debitimeve direkte në euro brenda Zonën Unike të Pagesave në Euro (*Single Euro Payment Area*- SEPA).

Për më tepër, pjesë e *acquis* së këtij kapitulli është dhe Rregullorja (BE) 2015/751 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29 prill 2015 “Mbi tarifat e këmbimit për transaksionet e pagesave me kartë” e cila synon të rregullojë tarifat e këmbimit të aplikuara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave tek përdoruesit e kartave të debitit dhe të kreditit duke vendosur një vlerë tavan.

Pjesa kryesore e legjislacionit në fushën kundër pastrimit të parave është Direktiva (EU) 2015/849 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 maj 2015 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, e cila ndryshon Rregulloren (EU) 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/EC. Direktiva kërkon që subjektet që i nënshtrohen asaj të zbatojnë kujdesin e duhur ndaj klientit dhe të raportojnë transaksione të dyshimta, si dhe të marrin masa të rëndësishme mbështetëse, të tilla si ruajtja e të dhënave, trajnimi dhe vendosja e procedurave të brendshme. Për më tepër, Rregullorja (EC) 1889/2005, e cila rregullon paratë cash që hyjnë ose dalin nga BE, dhe Rregullorja (EC) 1781/2006 (që do të zëvendësohet nga Rregullorja (EU) 2015/847) parashikojnë që transferimet e fondeve duhet të shoqërohen me informacione kuptimplota mbi pagesin për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë të fondeve.

Për të luftuar me sukses krimin financiar, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të ketë një kapacitet efektiv administrativ dhe zbatues, duke përfshirë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë.

4.4.2 Struktura e kapitullit

- Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat
- Sistemet e pagesave
- Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

4.4.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis*-it të Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit, me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 60-62 dhe 70 të MSA-së. Pastrimi i parave është parashikuar në nenet 4 dhe 82 të MSA-së.

Neni 62 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit parasheh që gjatë tre viteve të para pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe që deri në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asociimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

4.4.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Në vijim të mbledhjeve të kryera nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, i ngritur me urdhr të Kryeministrit nr. 141 datë 29.10.2020, për liberalizimin e shitblerjes së pasurive të paluajtshme në Shqipëri, për shtetasit e BE-së, filialet dhe degët e shoqërive komunitare, si dhe në përmbushje të detyrimit që buron nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, është përgatitur në vijim një përmbledhje e legjislacionit shqiptar për të drejtat e shtetasve të huaj mbi pasuritë e paluajtshme. Në lidhje me këtë angazhim është hartuar dokumenti me kontributin e të gjitha palëve, si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Referuar legjislacionit në fuqi për fushat nën përgjegjësinë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nuk ka dispozitë konkrete për lejimin/ndalimin e të drejtës së shitblerjes së pasurive të paluajtshme shtetasve të BE-së. Sa i përket çështjes së pronësisë mbi pyjet, gjithashtu nuk ka dispozitë konkrete për lejimin/ndalimin e të drejtës së shitblerjes së pasurive të paluajtshme shtetasve të BE-së.

Ndërkohë, ekzistojnë disa dispozita ligjore që favorizojnë/kufizojnë përdorimin e pasurive shtetërore në funksion të mbrojtjes së mjedisit, zonave të mbrojtura, pyjeve dhe për zhvillimin e qëndrueshëm në fushën e turizmit si: ligji Nr.



57/2020 “Për pyjet”; ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”; ligji Nr. 93/2015, datë 27.07.2015 “Për turizmin”; vendimi Nr. 162, datë 2.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat, procedurat dhe mënyrat e vënies në dispozicion të pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit”.

Referuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), shtetasit e huaj aktualisht gëzojnë vetëm të drejtën e qiramarrjes për tokën bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave. Kjo bazohet në ligjet: Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i shfuqizuar i cili parashikonte se këta persona kanë të drejtë të marrin me qira tokën bujqësore, por ky ligj nga ana tjetër nuk rregullonte të drejtën e blerjes së saj. Ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”, i ndryshuar, neni 3/a, në mënyrë eksplicite parashikonte se: *“pronarët e tokës bujqësore mund t’ua japin atë me qira personave fizikë ose juridikë vendas a të huaj. Për dhënien me qira të tokës bujqësore, zbatohen dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë”*.

Ligji nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, sanksionon moslejimin e ushtrimit të së drejtës për blerjen e tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave, nga persona fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj. Konkretisht, neni 4, parashikon se: *“kalimi i së drejtës së pronësisë të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave nuk iu njihet personave fizikë dhe juridikë të huaj. Personat fizikë dhe juridikë të huaj gëzojnë të drejtën e marrjes së saj me qira deri në 99 vjet. Dhënia me qira e tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil”*.

Kushtetuta i jep mbrojtje të veçantë të drejtës për pronë private dhe publike. Veçanërisht një mbrojtje e tillë ose garanci ligjore synon garantimin e të drejtave të pronësisë të parashikuara në nenin 11, paragrafi 2, dhe garanton të drejtën e pronës private në nenin 41, paragrafi 1. Në përputhje me pikën 1, të nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëllëj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara. Në këtë kuptim, referuar edhe analizës së mësipërme, Kushtetuta

nuk e ka lidhur të drejtën e pronës vetëm me shtetësinë shqiptare. Gjithashtu, Kodi Civil nuk përmban dispozita që pengojnë shitjen e pasurisë së paluajtshme për shtetasit e BE-së, filialet apo degët e shoqërive komunitare.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave” është përfshirë në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) për vitin 2022, afati i të cilit për miratim në Këshillin e Ministrave pritet të bëhet në 4-mujorin e fundit të vitit 2022. Në rastin e kapitullit 4, nenet 63 – 66 të Traktatit të funksionimit të Bashkimit Evropian (TFEU) rregullojnë lëvizjen e kapitalit, ndërsa përkufizimet e llojeve të ndryshme të lëvizjes së kapitalit bazohen në Direktivën 88/361/KEE mbi zbatimin e nenit 67 të Traktatit.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Disa përparime janë shënuar gjatë periudhës raportuese, veçanërisht me implementimin e legjislacionit të sistemeve të pagesave 2020 që hyri në fuqi në janar 2021. Ky konstatim haset edhe në Progresin Raportin e fundit të vitit 2021. Raporti evidenton se angazhimi i rrjedhur nga MSA-ja në lidhje me liberalizimin e shitblerjes së pasurive të paluajtshme për shtetasit e BE-së, nuk është përmbushur ende, ndërkohë që edhe ligji “Për investimet” është ende i pa miratuar.

Sistemet e pagesave

Bankat e huaja kanë të drejtë të hapin degë në Shqipëri, si dhe të ofrojnë pagesa ndërkufitare. Pagesat *jo-cash* trajtohen sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë për sistemin dhe instrumentet e pagesave. Kuadri rregullator i Bankës së Shqipërisë (BSH) rregullon sistemet dhe instrumentet e pagesave dhe lejon që transaksionet e pagesave mund të kryhen jo vetëm nga bankat, por edhe nga institucionet financiare jo-bankare dhe shoqëritë e kursim-kreditit. Për më tepër, masat që Banka e Shqipërisë vendosi në mars 2020 për shkak të bllokimit të COVID-19 për të ulur kostot e shërbimeve të sistemeve të pagesave dhe për të promovuar *home banking*, vijojnë të jenë në fuqi edhe aktualisht. Kuadri ligjor dhe rregullator për pagesat elektronike në Shqipëri mbetet i njëjtë për pagesat kombëtare dhe ato ndërkufitare pa krijuar kufizime. Nga ana tjetër, Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP) ka krijuar kushtet e



nevojshme rregullatore për pjesëmarrjen në të të përfaqësuesve të institucioneve financiare jo-banka dhe operatorëve të sistemit. Ndërkohë vijon zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (2018 – 2023), ku zhvillime janë shënuar veçanërisht me miratimin e ligjit “Për shërbimet e Pagesave” në vitin 2020, i cili synon përafrimin me Direktivën II të Shërbimit të Pagesave (PSD II). Ligji, i cili do të sjellë efektet e zbatimit të plotë në treg deri në korrik 2022, ndjek qasjen PSD II për kushtet e transparencës dhe kërkesat për informacion për shërbimet e pagesave. Një nga objektivat e strategjisë ku ende duhet arritur progres është rritja e edukimit financiar në popullsinë shqiptare me qëllim rritjen e raportit të popullsisë shqiptare të rritur që zotëron një llogari pagese, në masën 70% deri në vitin 2023. Ndërkohë, në zbatim të ligjit nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë”, bankat mund të operojnë me agentë për ofrimin e shërbimeve të pagesave.

Vlen të theksohet se Direktiva e Parasë Elektronike 2009/110/EC është transpozuar në legjislacionin shqiptar nëpërmjet Ligjit nr. 10481, datë 17.11.2011, Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe kuadrit rregullator në zbatim. Aktualisht, në tregun shqiptar operojnë 6 institucione të parasë elektronike, duke shënuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, si dhe dy nga 12 bankat ofrojnë produkte të parapaguara. Gjatë viteve të fundit është evidentuar një prirje në rritje e instrumenteve të parapaguara të emetuara nga këto institucione, si dhe një zgjerim i konsiderueshëm i terminaleve ku mund të përdoren këto instrumente si mjet pagese. Gjithashtu, gjatë dy viteve të fundit evidentohet një rritje e konsiderueshme e pagesave me kartë dhe të transfertave të kreditit të iniciuara nëpërmjet shërbimeve “*home banking*”.

Aktualisht, po punohet për anëtarësimin e institucionit të parë të parasë elektronike në sistemin AECH. Gjithashtu, në kuadër të projektit *Instant Payment* është hartuar një raport me asistencën e Bankës Botërore i cili analizon të gjithë skenarët e mundshëm të realizimit të projektit, avantazhet dhe disavantazhet duke evidentuar skenarin më të realizueshëm në kontekstin shqiptar. Zhvillime janë shënuar edhe në lidhje me sistemin e shlyerjes së pagesave në euro brenda vendit, ku aktualisht Banka e Shqipërisë është në

proces testimi të sistemeve të përfshira në projekt. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, gjatë kësaj periudhe janë hartuar aktet ligjore e nënligjore në kuadër të transpozimit të Direktivës 2014/92/EU “Për llogarinë e pagesës”, të cilat janë në proces konsultimi me ofruesit e shërbimeve të pagesave.

Për sa i përket arritjeve, në fushën e sistemeve të pagesave janë shënuar zhvillime të rëndësishme. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi në datë 30.4.2020 ligjin 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili transponon Direktivën 2015/2366/BE për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm, dhe përafruar më tej Direktivën e Parasë Elektronike 2009/110/EC, duke shënuar përafrim të mëtejshëm me *acquis* e këtij kapitulli.

Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 123, datë 2.7.2020 dhe ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2021 ndërkohë zbatimi i dispozitave kalimtare të tij nga aktorët e tregut duhet të plotësohet deri në korrik të vitit 2022.

Banka e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të Ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, ka miratuar rregulloren Nr. 59, datë 24.11.2021 “Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave”. Gjithashtu, në këtë kuadër janë rishikuar edhe një sërë rregulloresh të cilat lidhen me licencimin dhe rregullimin e institucioneve që mund të ofrojnë shërbime pagesash sipas përcaktimeve të ligjit 55/2020 nëpërmjet vendimeve të mëposhtme:

1. Vendimin Nr. 60, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”. Ndryshimet e kësaj rregulloreje ishin parashikuar për tremujorin e dytë të 2022, por u miratuan në nëntor të vitit 2021.

2. Vendimin Nr. 61, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”;

3. Vendimin Nr. 62, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre”;

4. Vendimin Nr. 63, datë 24.11.2021 “Për disa ndryshime në rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen



veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare”.

Në këtë linjë vlerësohet se me miratimin e rregullores 59/2021 dhe të ndryshimeve të rregullores 60/2021 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, është përafuar më tej Direktiva e Parasë Elektronike 2009/110/EC si nga pikëpamja e përafritit të niveleve të kapitalit fillestar minimal ashtu dhe kërkesave për licencim.

Nga ana tjetër, ligji për “Shërbimet e Pagesave” konsiderohet si një hap i rëndësishëm i integritetit në *Single European Payment Area* (SEPA) dhe kërkesave të Kapitullit 4 në aspektin e shërbimeve të pagesave. Gjithashtu, nga pikëpamja e zhvillimit të tregut vendas vlerësohet se do të ndikojë drejtpërdrejt në nxitjen e konkurrencës dhe të inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu efikasitetin e tyre dhe reduktimin e kostove, që mbart përdorimi i tyre. Ligji në fjalë synon të balancojë hapësirat për ofrimin e shërbimeve të pagesave midis bankave dhe institucioneve të pagesave, duke i lejuar këto të fundit të hapin llogari pagese dhe të emetojnë instrumente elektronike pagesash. Për më shumë, ligji vlerësohet të rrisë transparencën në shërbimet e ofruara nga tregu dhe të krijojë një kuadër të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit.

Në lidhje me zbatimin e Strategjisë Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël 2018 – 2023, përveç miratimit të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, i cili synon nxitjen e përfshirjes financiare dhe të përdorimit të pagesave elektronike, janë ndërmarrë edhe një sërë masash të tjera, ku mund të përmendim hartimin dhe miratimin e rregullores së Debitimit Direkt në muajin tetor të vitit 2021, e cila transpozon pjesërisht Rregulloren (BE) nr. 260/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 mars 2012, që përcakton kërkesat teknike dhe të biznesit për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte në euro. Vlen të theksohet se strategjia është pjesë Programit për Reformat Ekonomike (ERP) 2022 – 2024.

Lufta kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2020, Shqipëria ka ndërmarrë një angazhim politik për të punuar me Grupin e Posaçëm të Veprimit Financiar (Financial Action Task Force, ndryshe FATF) dhe MONEYVAL, me qëllim forcimin e

luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Përmes vendimit nr. 1 datë 19.02.2020, “Për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për të përmbushur rekomandimet e ICRG-FATF” të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, u ngrit grupi ndërinstitucional i punës, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri dhe me pjesëmarrjen e institucioneve dhe ministrive kryesore, të tilla si MFE, MEPJ, MM, MPB, MD, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria Speciale, SPAK, BSH, AMF, DPSH dhe SHISH.

Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) në këtë grup pune ka rolin e sekretariatit teknik, me detyrën e raportimit në bazë javore të ecurisë së zbatimit të planveprimit të ICRG-së dhe masat dhe veprimet që Shqipëria duhet të përmbushë në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Drejtorja e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, në përmbushje të rekomandimeve të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (Financial Action Task Force – FATF), si dhe nëpërmjet adresimit të çështjeve të evidentuara nga Moneyval, gjatë periudhës janar – qershor 2021 përgatiti projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar në kuadër të përafritit të plotë me Direktivën nr. 849/2015 ndryshuar nga 843/2018 të BE “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”. Qëllimi i këtij projektligji është mbrojtja e sistemit financiar dhe e ekonomisë në tërësi nga kërcënimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke forcuar integritetin e sistemit parandalues në vend dhe duke kontribuar për paqen, sigurinë si dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të fushës.

Ndryshimet ligjore kryesisht konsistojnë në:

- qartësinë e disa prej të përkufizimeve të nevojshme për zbatimin e këtij ligji;
- përcaktimin e disa të dhënave të nevojshme të cilat duhet të zbatohen nga subjektet gjatë zbatimit të masave të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar;
- përcaktimi i disa masave shtesë të vigjilencës të zgjeruar që duhet të zbatojnë subjektet raportuese në rastet e transaksioneve apo



kategorive të klientëve me vendet me rrezik të lartë;

- vendosja e afateve për mbajtjen e dokumentacionit nga subjektet raportuese;
- vendosja e sanksioneve të mëtijshme administrative, në përputhje me Direktivën.

Në kahun e arritjeve, DPPPP ka vijuar të raportojë mbi baza katër mujore pranë ICRG/FATF plani e veprimit shkurt 2020 – shkurt 2022.

Gjithashtu, hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, shënon progres të rëndësishëm në përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Projektligji u miratua nga Këshilli i Ministrave, datë 22.09.2021 dhe pasi kaloi në diskutim në Komisionet Parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë, u miratua në seancën plenare të datës 2 Dhjetor dhe u botua Ligj nr. 120/2021, në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë nr. 197. Miratimi i këtij projektligji solli përafrimin e plotë me direktivën (BE) 2015/849, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 maj 2015, “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon rregulloren (BE) nr. 648/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe direktivën e Komisionit 2006/70/KE”, të ndryshuar.

Në periudhën Janar – Qershor 2021, numri i raportimeve të transaksioneve të dyshimta është 704, ndërsa numri i shpërndarjeve në LEA është 107. Regjimi i STR-ve është në të vërtetë i kënaqshëm dhe në përputhje me rreziqet e identifikuar nga autoritetet përkatëse. Të dhënat e hollësishme mbi RVV-të, inspektimet midis njësive raportuese, referimet në QLA-të etj, janë raportuar nën Kapitullin 24. Trajnim i vazhdueshëm sigurohet edhe për stafin.

Në Progres Raportin e fundit 2021 në fushën e parandalimit të pastrimit të parave evidenton një progres kryesisht nëpërmjet ngritjes së grupit ndërinstitucional të punës për zbatimin e planit të veprimit të ICRG/FATF, afati i të cilit është

brenda datës shkurt 2022. Aktualisht po punohet për të përmbushur rekomandimet e ICRG-FATF.

4.4.5 Lista e Ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ)

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

4.4.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Siç është bërë prezent në raport progresin e fundit të bërë publik më 19.10.2021, mangësitë në kapitullin 4 konsistojnë në:

1) Mos miratimin e Projektligjit ‘Për investimet’. Projektligji prej kohësh vazhdon të jetë në proces koordinimi me institucionet e tjera relevante, përfundimi i të cilit është ende pa një afat kohor të qartë.

2) Mos përmbushjen e angazhimit që rrjedh nga MSA, mbi liberalizimin e shitblerjes së pasurive të paluajtshme për shtetasit e BE-së.

Tërësia e prioritetëve është listuar si më poshtë.

1) Zbatimi i planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël 2018 – 2023. Kjo strategji, synon nxitjen e përfshirjes financiare të popullsisë dhe promovimin e përdorimit të pagesave elektronike në ekonominë shqiptare.

2) Operacionalizimin e sistemit të shlyerjes së euros dhe monitorimin e efekteve në treg (2022 – 2023).

3) Do të vazhdohet me zbatimin e rekomandimeve të raportit Moneyval dhe përafrimin me *acquis* të BE-së për kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit.

KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK

4.5.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis për prokurimin publik përfshin parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe mosdiskriminimit. Për më tepër, rregulla specifike të BE-së zbatohen për koordinimin e dhënies së kontratave publike për punë, shërbime dhe mallra,



për entet kontraktore tradicionale dhe për sektorë të veçantë. *Acquis* gjithashtu specifikon rregullat për procedurat e rishikimit dhe disponueshmërinë e mjeteve juridike. Nevojiten organe të specializuara zbatuese.

4.5.2 Struktura e kapitullit

Ky kapitull është i ndarë 5 (pesë) nënkapituj si më poshtë vijojnë:

1. Prokurimet klasike;
2. Prokurimet në fushën e sektorëve utilitarë;
3. Ankesat në fushën e prokurimit publik;
4. Koncesionet dhe partneriteti publik-privat;
5. Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

4.5.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis*-së së Bashkimit Evropian

Kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përfshihen në Nenin 74 “Kontratat Publike”, i cili përcakton se Shqipëria dhe BE do të konsiderojnë hapjen e dhënies së kontratave publike në bazë të mosdiskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së, si një objektiv të dëshirueshëm.

Neni 70 i MSA-së, në anën tjetër, përcakton detyrimin e përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë për të përafëruar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së.

Acquis e prokurimit publik bazohet në parimet e përgjithshme siç janë transparenca, trajtimi i barabartë, konkurrenca e lirë dhe mosdiskriminimi që rrjedhin nga Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), Pjesa e tretë, Titulli IV dhe Titulli VII, Direktiva 2014/23/BE, Direktiva 2014/24/BE, Direktiva 2014/25/BE, Direktiva 2009/81/KE, Direktiva 89/665/KEE dhe 92/13/KEE, dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED).

4.5.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Sipas raportit vjetor për 2021 të Komisionit Evropian, ky kapitull “ka një përgatitje mesatare” dhe ka pasur përparim të mirë, veçanërisht nëpërmjet miratimit të ligjit të ri për prokurimin publik dhe strategjisë kombëtare për prokurimin publik pas konsultimeve të gjera publike. Gjithashtu, theksohet se rekomandimet e dhëna në vitin 2020 janë zbatuar në masën më të madhe. Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimin publik si dhe ka pasur përparim të mirë.

Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik, sikurse miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 850, datë 4.11.2020 përbën kuadrin strategjik për zhvillimin e prokurimeve publike në Republikën e Shqipërisë. Kjo Strategji synon që të identifikojë të gjithë objektivat kryesore strategjike në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të sistemit të prokurimit, si dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë për arritjen e këtyre objektiveve.

Kuadri ligjor

Ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” është miratuar në dhjetor të vitit 2020. Ky ligj transpozon gjerësisht direktivat e BE-së si më poshtë vijojnë:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE”, e ndryshuar”.

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014 “Për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE”, e ndryshuar”.

- Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”.

- Direktivën e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave të Komunitetit për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacionit”, e ndryshuar”.

Kuadri ligjor në fushën e prokurimit publik plotësohet nga aktet e tjera nënligjore:

1. VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;

2. VKM. nr. 384, datë 30.06.2021 “Për formën e komunikimit në procedurat e prokurimit publik”;

3. VKM nr. 457, datë 30.07.2021 “Për miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit”;

4. VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të



rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”;

5. Dokumentet standarde të tenderit;
6. Udhëzime;
7. Rekomandime;
8. Manuale teknike.

Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar rregullon koncesionet dhe partneritetin publik-privat në Republikën e Shqipërisë. Ky Ligj është pjesërisht i përafuar me Direktivën 2014/23/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 26 shkurt 2014 për dhënien e kontratave të koncesioneve.

Kuadri ligjor në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik privat plotësohet nga aktet e tjera nënligjore:

1. VKM nr. 280, datë 7.4.2020 “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të komitetit të përzgjedhjes së projekteve të koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar”;

2. VKM nr. 285, datë 10.4.2020 “Për organizimin, funksionimin si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtit të Koncesioneve (ATRAKO)”;

3. VKM nr. 420, datë 27.05.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, të ndryshuar”.

Sa i takon prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, Ligji Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” përafrohet pjesërisht Direktivën 2009/81/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 korrik 2009 “Për koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon Direktivat 2004/17/KE dhe 2004/18/KE”.

Kuadri ligjor për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë plotësohet nga aktet e tjera nënligjore:

- VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;

- VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe software-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave”;

- VKM nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”;

- Dokumentet standarde të tenderit.

Kuadri institucional

Në fushën e prokurimit publik (klasik dhe kontrata sektoriale), kompetencat institucionale janë si vijojnë:

- Institucion politikëbërës: Agjencia e Prokurimit Publik

- Institucion propozues për akte ligjore dhe nënligjore: Agjencia e Prokurimit Publik.

- Institucion monitorues dhe verifikues për procedurat e prokurimit : Agjencia e Prokurimit Publik

- Institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave: Komisioni i Prokurimit Publik.

- Institucion zbatues: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara; Autoritetet dhe entet kontraktore sipas përcaktimeve në ligjin e prokurimit publik.

Në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, kompetencat institucionale janë si vijojnë:

- Institucion politikëbërës dhe propozues i akteve ligjore e nënligjore: Agjencia e Trajtit të Koncesioneve dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- Institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave: Komisioni i Prokurimit Publik.

- Institucion monitorues për ligjshmërinë e procesit të prokurimit: Agjencia e Prokurimit Publik

- Institucion zbatues: Autoritetet kontraktore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve.



Në fushën e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kompetencat institucionale janë si vijojnë:

- Institucion politikëbërës: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme.
- Institucion përgjegjës për shqyrtimin e ankesave: Komisioni i Prokurimit Publik.
- Institucion monitorues për ligjshmërinë e procesit të prokurimit: Agjencia e Prokurimit Publik;
- Institucion monitorues në lidhje me sigurinë e informacionit: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Institucion zbatues: Autoritetet kontraktore sipas përcaktimeve të legjislacionit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Arritjet kryesore

Arritjet kyç të konstatuara gjatë vitit 2021 përfshijnë:

1. Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”. Miratimi i këtyre ligjeve përafroi më tej legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe plotësoi kuadrin ligjor në lidhje me prokurimin publik;

2. Në kuadër të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 162/2020 dhe të miratimit të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, APP, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Tiranë, nga data 25 Maj deri më 16 qershor 2021, ka organizuar on line 12 sesione informuese për Autoritetet dhe Entet Kontraktore, me qëllim njohjen e tyre me kuadrin e ri ligjor dhe risitë e sjella prej tij. Gjithashtu, APP, në bashkëpunim me ASPA, ka nisur procesin e trajnimit sipas moduleve dhe fushave tematike të dakorduara, për Autoritetet dhe Subjektet Kontraktore. Në këtë kuadër, gjatë muajit korrik janë organizuar 5 sesione trajnimi treditore.

3. Në lidhje me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, u miratua VKM nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”;

4. Në lidhje me sistemin e shqyrtimit të ankesave, është bërë mundur finalizimi dhe bërja publike e bazës së të dhënave për ankesat në faqen e KPP, si dhe finalizimi i Sistemit të Ankesave Elektronike.

4.5.5 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse

- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATRAKO)
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Agjencia e Blerjeve të Përqendruara;
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar;
- Instituti i Statistikave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

4.5.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Sa i takon fushës së prokurimit publik, me anë të miratimit të Ligjit të ri për prokurimin publik në 2020, të rregullave për prokurimin publik në Maj të 2021, DST-ve, udhëzimeve, VKM për format e komunikimit, VKM për kodet CPV është arritur një përafrim shumë i konsiderueshëm i Direktivës 2014/24/BE dhe Direktivës 2014/25/BE.

Sa i takon shqyrtimit të ankesave, me anë të miratimit të Ligjit të ri për prokurimin publik në 2020 dhe të rregullave për prokurimin publik në Maj të 2021, është arritur një përafrim shumë i konsiderueshëm i Direktivave 89/665/KEE dhe 92/13/KEE.

Sa i takon koncesioneve dhe PPP-ve, shkalla e përafrimit me Direktivën 2014/23/BE është vlerësuar si e pjesshme. Një vlerësim i mangësive ligjore për këtë direktivë është duke u zhvilluar nga ATRAKO me anë të një asistence teknike të huaj.

Sa i takon prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, me anë të miratimit të Ligjit 36/2020 për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të rregullave për prokurimet në këtë fushë në Dhjetor të 2020, si dhe të DST-ve në prill të 2021 është arritur një përafrim shumë i konsiderueshëm i Direktivës 2009/81/EC.

Në përgjithësi, *acquis* e BE-së për Kapitullin 5 janë përafruar në masën më të gjerë me anë të ndryshimeve të fundit ligjore, me përjashtim fusha e koncesioneve e cila do të kërkojë një përafrim të mëtejshëm.

Prioritetet në fushën e prokurimit publik për periudhën 2022 – 2024 janë:



- Garantimi që kushtet e marrëveshjeve ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta të jenë në përputhje me kërkesat e *acquis* të përfshira në MSA, veçanërisht me ato në fushën e prokurimit publik.

- Përafrimi i mëtejshëm i ligjit për koncesionet dhe PPP me Direktivën 2014/23/EU.

Përafrimi i Direktivës 2014/23/EU do të arrihet me anë të rishikimit të ligjit aktual për koncesionet dhe PPP (ligji 125/2013), brenda tremujorit të parë të 2023.

KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE

4.6.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni për shoqëritë tregtare përfshin rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e kompanive. Në fushën e raportimit financiar, *acquis* përcakton rregulla për paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara, përfshirë rregullat e thjeshtuara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa subjekte të interesit publik. Për më tepër, *acquis* përcakton rregulla për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore.

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

4.6.2 Struktura e kapitullit

- Legjislacioni tregtar
- Kontabiliteti dhe auditimi

4.6.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenet 70 (3), 49, 50 (1), 51 (1), 55 (1) dhe 56 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria është e angazhuar të përafrojë legjislacionin e shoqërive tregtare me *acquis* të BE-së.

Neni 49 kërkon që legjislacioni shqiptar të ketë koncepte të përcaktuara qartë për shoqëritë tregtare, filialet, degët dhe ndërmarrjet.

Përveç kësaj, neni 50 parashikon lehtësimin e fillimit të aktiviteteve në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga shoqëritë dhe qytetarët e BE-së, duke garantuar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive në një vend të tretë, si dhe bashkëpunëtorët dhe degët e tyre.

Neni 51 i MSA-së parashikon që çdo Palë mund të rregullojë vendosjen dhe funksionimin e shoqërive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregullore nuk krijojnë diskriminim ndaj shoqërive dhe shtetasve të Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj. Krijimi dhe zbatimi i një kuadri ligjor tregtar në përputhje me standardet e BE-së, krijimi i shoqërive tregtare, zvogëlimi i barrierave të hapjes së biznesit, thjeshtësimi dhe standardizimi i praktikave të biznesit në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Ky kapitull përfshin rregulla të harmonizuara në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, duke përfshirë kërkesat për raportim financiar, që synojnë lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së themelimit.

Në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, Direktiva për bashkërendimin e masave mbrojtëse që kërkohet nga shoqëritë tregtare për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të palëve të treta (2009/101/KE -Direktiva e mëparshme për Shoqëritë tregtare) përfshin masat mbrojtëse që parashikojnë kërkesat e detyrueshme dhënien e informacioneve shpjeguese, duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e detyrimeve të lidhura nga shoqëritë tregtare, si dhe duke kufizuar arsyet për pavlefshmërinë e shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva (89/666/KEE) parashikon gjithashtu kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me degët e hapura në një Shtet Anëtar të qeverisur nga ligji i një shteti tjetër. Direktiva 2012/30/BE (e ndryshuar nga Direktiva 77/91/KEE) përmban rregulla për formimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre. Direktiva 2009/102/KE kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë që ligji i tyre i brendshëm të njohë shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me një dege.

Direktivat 2011/35/BE dhe Direktiva 82/891/KEE harmonizojnë rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve në kontekstin e bashkimit të brendshëm dhe ndarjeve të shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva 2009/109/KE paraqet kërkesa të thjeshtuara për raportim dhe dokumentim në rastin e bashkimeve dhe ndarjeve. Direktiva 2005/56/KE për bashkimet ndërkufitare parashikon rregullat dhe procedurat për të lehtësuar bashkimet ndërkufitare të shoqërive publike me



përgjegjësi të kufizuara. Direktiva 2004/25/KE për marrjet e ofertave të blerjeve (take over bids) përcakton rregullat e harmonizuara për të lehtësuar blerjet ndërkufitare brenda BE-së, si dhe përmirësimin e transparencës dhe mbrojtjen e aksionarëve të pakicave në kontekstin e marrjeve të tilla. Direktiva 2012/17/BE për ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të shoqërive përcakton krijimin e sistemit të interkonjeksionit të regjistrave të biznesit, që përfshin një platformë qendrore evropiane përmes së cilës regjistrat kombëtarë të biznesit do t'i bëjnë të disponueshme informacionet e tyre në lidhje me mekanizmat e zbulimit ndërkufitar, duke përfshirë edhe portalin e-Drejtësisë.

Acquis e BE-së gjithashtu parashikon forma të caktuara evropiane ligjore: p.sh. Grupimi Evropian i Interesit Ekonomik (GEIE - Rregullorja 2137/85) dhe Shoqëria Evropiane (Societas Europaea ose SE - Rregullorja 2157/2001), duke lënë disa aspekte të strukturës së tyre të brendshme dhe të funksionimit të rregullohen përmes legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare.

Direktiva 2007/36/KE e të drejtave të aksionarëve paraqet standardet minimale për ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve në shoqëritë e listuara. Rekomandimet e Komisionit (2004/913/KE, 2005/162/KE dhe 2009/385/KE, dhe 2009/384/KE) adresojnë parimet e një qeverisje korporatash për institucionet financiare në lidhje me shpërblimin e drejtorëve, pavarësinë e drejtorëve joekzekutivë dhe komisionet e bordit. Rekomandimi i Komisionit 2014/208/BE mbi cilësinë e raportimit të qeverisjes së korporatave jep udhëzime se si shoqëritë e listuara duhet të shpjegojnë ndryshimet nga rekomandimet e kodeve përkatëse të qeverisjes së korporatave.

Direktiva 2004/109/KE kërkon harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me shoqëritë e listuara.

Në fushën e kontabilitetit, *acquis* përfshin njohjen, vlerësimin dhe shpalosjen e rregullave dhe skemave për bilancin dhe llogarinë e fitimit dhe humbjes për pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara (Direktiva 2013/34/BE) të shoqërive publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar. Kjo direktivë gjithashtu përcakton se kush ka nevojë për një auditim, si dhe detyrimet e publikimit. Përveç kësaj, Rregullorja (KE) Nr. 1606/2002 mbi

aplikimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, kërkon që shoqëritë tregtare të BE-së të listuara në një treg të rregulluar të hartojnë pasqyrat financiare të tyre të konsoliduara në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë miratuar nga Bashkimi Evropian. Sipas kësaj rregulloreje, Shtetet Anëtare gjithashtu mund të vendosin të zbatojnë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për pasqyrat financiare individuale dhe / ose të konsoliduara të shoqërive tregtare.

Direktiva 2006/43/KE për auditimet ligjore harmonizon rregullat duke përfshirë, ndër të tjera, miratimin dhe regjistrimin e audituesve ligjorë, sigurimin e jashtëm të cilësisë, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e audituesit dhe zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Amendimi i Direktivës 2014/56/BE përcakton kërkesat shtesë për të përmirësuar cilësinë e auditimit, me fokus në pavarësinë e audituesit, raportet e auditimit dhe mbikëqyrjen e auditimit publik. Rregullorja e re 537/2014/BE paraqet kërkesa specifike lidhur me auditimin ligjor të Njësive të Interesit Publik (NJIP). NJIP-të janë institucione të kreditit, shoqëri të listuara, ndërmarrje të sigurimeve, dhe subjektet të tjera të përcaktuara si të tilla nga Shtetet Anëtare. Rregullorja gjithashtu parashtron kërkesa specifike për organizimin e sistemit të mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe kontrollon firmat e auditimit të cilat auditojnë PIE-të.

4.6.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Sipas Raportit të Komisionit Evropian 2021 për Kapitullin 6, konstatohet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim. Ky vlerësim është i njëjtë me atë të vitit 2020.

Në fushën e së drejtës për shoqëritë tregtare, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur. Sipas raportit të progresit të BE-së 2021, në periudhën raportuese është bërë progres, në veçanti, duke përmirësuar transparencën e pasqyrave financiare të kompanive në regjistrin e biznesit, dhe në përafrimin e mëtejshëm të kornizës së saj me *acquis* të BE-së në raportimin jofinanciar dhe në raportimin e qeverisjes së korporatës. Megjithatë, nuk ka pasur përparim në rekomandimin lidhur me ligjin për shoqëritë tregtare. Sipas raportit të BE-së, në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të konsiderojë:



- Rishikimin e legjislacionit ekzistues në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të përfunduar përafrimin me *acquis* të BE-së,

- Përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe auditimin me *acquis* më të fundit të BE-së në këto fusha.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vijojë me procesin e analizës së mangësive ligjore dhe kryerjes së amendimeve të ligjit të shoqërive tregtare.

Bazuar në Ligjin Nr. 9723/2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, pasqyrat financiare depozitohen dhe publikohen në regjistrin tregtar. Duke filluar nga viti 2015, procesi i depozitimit të pasqyrave financiare bëhet tërësisht elektronik përmes portalit qeveritar e-Albania. Në vitin 2019, me asistencën teknike dhe financiare të BB, në QKB u zbatua një sistem i modernizuar i raportimit elektronik për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare.

Pra, ligjërisht dhe teknikisht, është mundësuar që pasqyrat financiare dhe raportet përkatëse të depozitohen në mënyrë elektronike në regjistrin tregtar. Aktualisht, po punohet për publikimin e një prej raporteve të dorëzuara nga subjektet, së bashku me pasqyrat financiare, që për arsye teknike nuk kanë mundur të publikohen.

Referuar rekomandimeve të adresuara nga Komisioni Evropian, në fushën e së drejtës së shoqërive tregtare, legjislacioni shqiptar është përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” rregullon formimin, organizimin dhe zhvillimin e organizatave të biznesit në Shqipëri. Ligji përputhet kryesisht me legjislacionin përkatës të BE-së, me amendimet e bëra me kalimin e kohës. Progres i mëtejshëm është bërë me miratimin e Ligjit Nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” që përafron legjislacionin shqiptar me kërkesat e direktivës 2005/56/KE të BE-së, datë 26 tetor 2005 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar” e ndryshuar.

Ka përfunduar infrastruktura teknike për aplikimin e nënshkrimit elektronik (e-signature). Janë akredituar dy ofrues të Shërbimit të Certifikimit (CSHC): një publik- Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), dhe një CSHC private, “Aleat Ltd”.

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) vepron si një qendër me një ndalesë për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit. QKB administron regjistrin tregtar (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit dhe ai mbahet në format elektronik, dhe Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimet dhe Lejeve (i njohur si një bazë të dhënash shtetërore), i cili është një bazë të dhënash unike për të gjitha licencat / lejet e lëshuara në Shqipëri.

Prej vitit 2015, Qendra Kombëtare e Biznesit ka ofruar shërbimet e saj online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania pa kosto. Ndërkohë, duke filluar nga vitit 2020, shërbimet e regjistrimit të personave fizikë, pezullimit dhe aktivizimit të aktivitetit të subjekteve, si dhe pajisjes me licencë/leje ofrohen vetëm online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

AKSHI, si institucioni përgjegjës për administrimin e portalit qeveritar e-Albania, ka bërë me dije se shërbimet e mbetura për personat juridikë janë gati dhe, pasi të implementohen dhe të testohen, do të jenë gati për t’u përdorur nga biznesi deri në fund të vitit 2021.

Ligji Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, është amenduar në shkurt të vitit 2015 me Ligjin Nr. 8/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007” “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, duke u përshtatur më tej me Direktivën 2009/101/KE me qëllim dorëzimin në formë elektronike të balanceve vjetore dhe raporteve të auditimit nga shoqëritë tregtare.

Subjekti do të regjistrojë dhe dorëzojë në regjistrin tregtar, pasqyrat financiare vjetore, raportin e progresit të aktivitetit dhe raportin e auditimit, të mbajtur në përputhje me kërkesat ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar. Dorëzimi i tyre bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet portalit e-Albania.

Ligji nr. 110/2012 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare” ka transpozuar plotësisht Direktivën 2005/56/KE “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar” të ndryshuar.



Përsa i përket ofertave të marrjes në detyrë, Shqipëria ka transpozuar plotësisht Direktivën 2004/25/KE “Për ofertat e marrjes në detyrë” sipas Ligjit Nr. 10236 datë 18.2.2010 “Për marrjen nën kontroll të shoqërive me ofertë publike”.

Në fushën e kontabilitetit të korporatave, prej vitit 2008 janë shpallur të detyrueshme për zbatim Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (përfshirë përditësimet e vazhdueshme të tyre) dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë miratuar nga viti 2008 dhe ndryshimet e tyre janë miratuar që nga korriku 2014 me hyrje në fuqi më 1 janar 2015. Kërkesat e standardeve kombëtare të përmirësuara janë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) për Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla (SME-të), ndërsa paraqitja e pasqyrave financiare është plotësisht e përafëruar me kërkesat e Direktivës së BE-së 2013/34 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e amenduar (Direktiva e Kontabilitetit).

Në lidhje me këtë nënfushë, është arritur progres në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së në fushën e kontabilitetit të korporatave përmes miratimit të ligji të kontabilitetit Nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili synonte përafrimin e mëtejshëm me *acquis* në fushën e kontabilitetit të shoqërive tregtare, konkretisht me Direktivën Nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 qershor 2013, ku progres vihet re dhe në zbatimin e këtij ligji.

Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* për pasqyrat financiare vjetore dhe të konsoliduara.

Kapaciteti i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, i cili përkthen pa ndryshime nga origjinali SNRF-të, harton dhe mirëmban standardet e kontabilitetit si dhe monitoron zbatimin e të dyja seteve të raportimit financiar, duhet të përforcohet dhe më shumë. Gjithsesi, në ndryshimet ligjore të reja, në ligjin e ri të kontabilitetit, është parashikuar detyrë specifike për Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, në nenin 24, pika f) e cila përcakton “të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar”, e cila nuk ka qenë e përfshirë në ligjin e mëparshëm.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka rishikuar shënimet shpjeguese për njësitë e vogla të

përcaktuara në SKK, në mënyrë që t'i pakësojë ato në masën e parashikuar në Direktivën 34/2013, art. 16 “Përmbajtja e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare në lidhje me të gjitha ndërmarrjet” dhe pikat (a), (m), (p), (q) dhe (r) të Artit. 17 (1) “Shënimet shpjeguese për njësitë e mesme dhe të mëdha dhe njësitë me interes publik”.

Shënimet shpjeguese kanë përfunduar dhe janë publikuar për komente në faqen e KKK. Procesi pritet të përfundojë në tre mujorin e parë 2022.

Gjithashtu, nëpërmjet përdorimit të SNRF -të në Shqipëri, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha PIE-të (përveç atyre njësive ekonomike që klasifikohen si PIE-të për shkak të natyrës, madhësisë dhe numrit të punonjësve të tyre, por nuk i kalojnë pragjet e përcaktuara në Ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Art. 4, pika 1.3), kemi përafrim të plotë me Rregulloren Nr. 1606/2002 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 19 Korrik 2002 mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Në lidhje me fushën e auditimit ligjor, Ligji Nr. 10091 datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar synoi krijimin e bordit të mbikëqyrjes publike si një strukturë e përhershme nga burimet e veta financiare. Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), i themeluar si autoritet i pavarur rregullator me burimet e tij financiare shërben për të realizuar mbikëqyrjen publike dhe për të siguruar që audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të jenë subjekt i një sistemi që jep siguri për cilësinë e auditimeve të kryera.

Gjatë vitit 2019, në zbatim të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 të auditimit ligjor, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 17 datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike, gjatë periudhës 2018 – 2021, u fokusua në krijimin e kuadrit të nevojshëm rregullator, si kërkesë e parashikimeve ligjore, duke hartuar e miratuar një sërë rregulloresh që lidhen me funksionimin e strukturës së tij mbështetëse, mbledhjen e të ardhurave, investigimin dhe disiplinën.



Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka emëruar Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës, i cili prej korrikut të vitit 2019 ka propozuar marrjen e masave disiplinore për auditues ligjorë/shoqëri auditimi, si dhe në shqyrtim të kontabilistëve të miratuar në proces.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve kryesore të tij, BMP luan rol aktiv për bashkëpunimin me institucione të tjera të tilla si, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe institucione të tjera rregullatore me qëllim realizimin e vizionit mbikëqyrës. Në këtë kuadër është zhvilluar më tej bashkëpunimi ndërmjet BMP-së dhe rregullatorëve financiarë (Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) me fokus në çështjet e auditimit.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike është gjithashtu në proces të përmbushjes së gjithë kërkesave të parashtruara në rekomandimet e Moneyval dhe të planit të veprimit të ICRG/FATF. Në këtë kuadër, të tilla kërkesa janë përfshirë edhe në procesin e kontrollit të cilësisë së audituesve ligjorë dhe kontabilistëve të miratuar.

Shoqëritë tregtare

Ligji Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare” ka përafruar Direktivën 2005/56/KE “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar” të amenduar. Ligji rregullon procedurat, autoritetet përgjegjëse të përfshira në rastet e shkrirjes së jashtme dhe të brendshme ndërmjet një shoqërie shqiptare dhe një shoqërie të themeluar në një shtet anëtar të BE-së, duke lehtësuar bashkimin pa kaluar në likuidim. Për të mundësuar zbatimin e ligjit në praktikë, janë hartuar:

- Një komentari i ligjit dhe një ToT për noterët, përderisa ata janë caktuar nga ligji me detyrën e shqyrtimit të ligjshmërisë lidhur me bashkimet; si dhe

- 15 forma të regjistrimit ndërkufitar janë në dispozicion në QKB.

Me qëllim përmirësimit akoma edhe me tej të procesit të depozitimit të pasqyrave financiare në regjistrin tregtar, është implementuar projekti “Përmirësimi i cilësisë së Raportimit Financiar” me ndihmën e Bankës Botërore. Me anë të këtij projekti është mundësuar:

- Përcaktimi qartësisht i dokumenteve që duhet të hartohen nga subjektet, në varësi të

klasifikimit të tyre, gjatë procesit të raportimit financiar;

- Rritja e mëtejshme të transparencës për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të subjekteve të regjistruara në regjistrin tregtar;

- Përpunimi dhe gjenerimi i raporteve për të dhënat e pasqyrave financiare

- Zbatimi i formatit (sistemit) të ri për dërgimin e deklaratave të shërbimit në QKB, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, duke përdorur një format komunikimi elektronik (XML).

Në shkurt 2020, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) nënshkroi një marrëveshje për pjesëmarrjen e regjistrin tregtar shqiptar në Portalin Rajonal të Regjistrave Tregtar (BIFIDEX). Falë këtij projekti, mundësohet komunikimi në kohë reale i të dhënave të besueshme, të përditësuara për të gjitha subjektet tregtare të regjistruara në regjistrat tregtarë të vendeve pjesëmarrëse, si dhe baza për krijimin e shërbimeve globale për të gjitha subjektet në vendet pjesëmarrëse. Portali do të mundësojë gjithashtu ndërlidhjen e bizneseve shqiptare me ato të rajonit, duke mundësuar rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar të vendeve të rajonit.

Bazuar në rekomandimet e MONEYVAL, është miratuar Ligji Nr. 112/2020, “Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore përkatëse. Me miratimin e këtij ligji, u bë i mundur përcaktimi i pronarit përfitues, subjekteve raportuese që kanë detyrimin ligjor të regjistrojnë në regjister të dhënat e pronarëve të tyre përfitues dhe procedura dhe afatet e nevojshme për regjistrimin e të dhënave të pronarët përfitues. Gjithashtu, me miratimin e këtij ligji, u krijua Regjistri i Pronarëve Përfitues, i cili administrohet nga QKB. Regjistri i Pronarëve Përfitues është një bazë të dhënash elektronike shtetërore, në të cilën regjistrohen të dhënat e pronarëve përfitues të subjekteve që kanë detyrimin t’i raportojnë, i cili mbledh në kohë reale të dhënat e regjistruara në regjistrat shtetërorë përkatës të administruar nga institucionet shtetërore përkatëse, si dhe shërben si arkiv zyrtar elektronik dhe siguron transparencë në fushën e pronarëve përfitues.

Më 14.05.2020 u miratua Ligji 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, i cili hyri në fuqi më 01.09.2020. Ligji “Për tregjet e kapitalit” është përafruar pjesërisht me Direktivën e Tregjeve në Instrumentet Financiare (MIFID II), si dhe me



Direktivën 2004/109 / KE mbi harmonizimin e kërkesave të transparencës në lidhje me informacionin në lidhje me emetuesit, letrat me vlerë të cilëve pranojnë të tregtohen në një treg të rregulluar.

Kontabiliteti

Në fushën e kontabilitetit, që nga viti 2008, sipas Ligjit Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të amenduar, janë përkthyer rregullisht në gjuhën shqipe, nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), të gjitha ndryshimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, siç është publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB), Londër. Ndryshimet e SNRF-ve bëhen të detyrueshme me Urdhër të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë si dhe publikohen në faqen elektronike të MFE dhe KKK. Për vitin 2021 janë miratuar Urdhri Nr. 164, datë 08.09.2021 “Për shpalljen e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve SNK nr. 12 “Tatimet mbi të Ardhurat”, Urdhri Nr. 134 datë 21.07.2021 “Për ndryshimin e referencës ligjore në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar”, Urdhri Nr. 96 datë 25.5.2021 “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”, Urdhri Nr. 101 datë 25.5.2021 “Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 16 “Qiratë”. Në përputhje me praktikën vjetore të BSNK-së, përgatitet dhe publikohet versioni i konsoliduar i SNRF-ve në gjuhën shqipe në faqen e internetit të KKK.

Në zbatim të rekomandimit të Komisionit Evropian, në qershor 2020, KKK botoi “Udhëzuesin për hartimin e raportit jo-financiar”.

Në fund të vitit 2020 janë përfunduar nga KKK Udhëzuesit për zbatim të SKK 4 “Inventarët”, SKK 5 “Aktivet Afatgjata”, SKK 7 “Qiratë”, SKK 9 “Kombinimi i bizneseve” dhe SKK 13 “Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare”, si dhe është publikuar Rekomandimi për cilësinë e Raportit të drejtimit të brendshëm (raporte që kërkohen në nenet 18 dhe 19 të ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”. Gjithashtu, janë monitoruar nga KKK pasqyrat financiare të 50 njësive ekonomike, nga të cilat 25% janë njësi ekonomike me interes publik.

Në kuadër të rekomandimit të KE, ku sipas së cilit në fushën e kontabilitetit të shoqërive ligji i ri për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare është përafruar pjesërisht me Direktivën, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka rishikuar shënimet shpjeguese për njësitë e vogla të përcaktuara në SKK, në mënyrë që t'i pakësojë ato në masën e parashikuar në Direktivën 34/2013, art. 16 “Përmbajtja e shënimeve shpjeguese në pasqyrat financiare në lidhje me të gjitha ndërmarrjet” dhe pikat (a), (m), (p), (q) dhe (r) të Artit. 17 (1) “Shënimet shpjeguese për njësitë e mesme dhe të mëdha dhe njësitë me interes publik”. Shënimet shpjeguese kanë përfunduar dhe janë publikuar për komente në faqen e KKK. Procesi pritet të përfundojë në 20 janar 2022.

Në korrik 2021 janë publikuar për komente ndryshimet e shënimeve shpjeguese të setit të plotë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (1 – 15). Sipas rregullores afati për komente mund të shtyhet deri në 6 muaj me miratim të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

Së fundmi, ka përfunduar rishikimi i të gjithë udhëzuesve për zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (1 – 14). Materiali parashikohet që të publikohet në hard copy brenda 6 muajve të parë 2022.

Auditimi

BMP ka realizuar një proces mbikëqyrje që mbështetet mbi një analizë risku dhe një metodologji të mirëfilltë në kryerjen e kontrollit të cilësisë ndaj auditimeve ligjore. Me qëllim rishikimin e cilësisë së auditimit dhe sigurimin e promovimit të përmirësimit të cilësisë së auditimeve në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, BMP gjatë 2019 – 2021 ka realizuar inspektimin e 19 shoqërive audituese dhe 30 angazhimeve individuale prej këtyre shoqërive të auditimit. Ndërkohë, në të njëjtën periudhë kohore është realizuar inspektimi tematik për çështje të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit për 8 subjekte të tjera.

Prej korrikut të vitit 2019 është bërë e mundur zbatimi i rregullores Nr. 4 “Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore” nëpërmjet krijimit të strukturave të përshtatshme, për implementimin e saj, si pjesë integrale e Bordit të Mbikëqyrjes Publike. Kështu, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka emëruar Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës, i cili prej korrikut të



vitit 2019 ka propozuar marrjen e masave disiplinore për 31 auditues ligjorë/shoqëri auditimi. Ky komision në të njëjtën periudhë kohore ka marrë në shqyrtim 74 raste të kontabilistëve të miratuar në proces të verifikimit të përcjella prej Komisionit Ad Hoc të ngritur në funksion të zbatimit të Rregullores Nr. 9, datë 27.02.2019 “Për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe organizatave të tyre profesionale”, ndryshuar.

Gjithashtu, për herë të parë, Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka publikuar renditjen në tregun e auditimit për personat fizikë dhe personat juridikë të ndarë përkatësisht sipas formës së organizimit, duke konsideruar volumin e të ardhurave nga shërbimet e auditimit dhe volumin e numrit të klientëve. Publikimi i konsoliduar i renditjes, sipas këtyre dy kriterëve, është bërë pavarësisht formës juridike të organizimit. Ky publikim është i pari në llojin e tij në 23 vite që ekziston profesioni kontabël.

Në zbatim të rregullores Nr. 12 datë 02.07.2020 të BMP-së “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, që shërben si udhëzues për matjen e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit si pjesë e rregullores dhe manualit për mbikëqyrjen e subjekteve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, BMP ka miratuar një plan inspektimi, që është kryer përkatësisht, 4 në muajt nëntor – dhjetor 2020 dhe 4 në muajt janar – shkurt 2021.

Gjithashtu, gjatë muajit korrik 2020, inspektorët e BMP-së kanë kryer inspektimin në vend të Komitetit të Regjistrimit të IEKA-s, në lidhje me procedurat e ndjekura mbi veprimtarinë e regjistrimit të saj. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe, me mbështetjen e Bankës Botërore, BMP ka rishikuar dhe përmirësuar kuadrin rregullator të provimeve për kandidatët për auditues ligjor dhe kontabilist i miratuar, përkatësisht rregulloren Nr. 2 datë 22.02.2018 “Për funksionimin e komisionit të provimeve të aftësive profesionale dhe mbikëqyrjes së procesit të testimit të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist të miratuar”, e ndryshuar dhe rregulloren nr. 6, datë 31.05.2018 “Për procedurat e testimit dhe sistemin e vlerësimit në provimin e aftësive profesionale të kandidatëve për auditues ligjor dhe kontabilist i miratuar”, e ndryshuar.

Në kuadër të rekomandimeve të KE, ku evidentohet se Shqipëria duhet të vazhdojë të forcojë kapacitetin e BMP dhe të harmonizohet me rregullat e auditimit ligjor, gjatë vitit 2021 janë realizuar 4 (katër) kontrolle të plota për sistemin e kontrollit të cilësisë pranë audituesve ligjorë ku janë rishikuar 7 angazhime auditimi. Gjithashtu, janë realizuar 4 (katër) kontrolle të kufizuara për audituesit ligjorë me më pak se 5 vite eksperiencë, ku janë rishikuar 4 dosje angazhimi auditimi. Gjatë muajit gusht 2021, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, ka realizuar njoftimin e inspektimit të kontrollit të cilësisë në 13 subjekte auditues ligjorë / shoqëri auditimi në përputhje me kalendarin vjetor të punës për inspektimet e kontrollit të sigurimit të cilësisë. Gjatë muajit shtator është realizuar dorëzimi i informacionit të kërkuar për realizimin e procesit të kontrollit të cilësisë dhe gjatë muajve tetor – dhjetor 2021 ekipi i inspektorëve të kontrollit të cilësisë së BMP-së do të vijojë me vizitat në terren.

BMP do të vijojë realizimin e veprimtarisë së vet, me fokus të veçantë kontrollin e cilësisë ndaj auditimeve të njëjësive ekonomike me interes publik, si dhe marrjen e masave disiplinore në rastet përkatëse.

4.6.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- Bordi i Mbikëqyrjes Publike
- Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Banka e Shqipërisë
- INSTAT

- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

4.6.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet Shoqëritë Tregtare

Prioritetet në këtë fushë janë:

Sipas raportit të BE-së, në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet në veçanti të konsiderojë:

- Rishikimin e legjislacionit ekzistues në fushën e ligjit për shoqëritë tregtare me qëllim identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të përfunduar përafrimin me *acquis* të BE-së,
- Përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për kontabilitetin dhe auditimin me *acquis* më të fundit të BE-së në këto fusha.



Mangësitë e identifikuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë po bashkërendon me donatorët potencialë mbi mundësinë e ofrimit të një asistencë teknike prej tyre në MFE për të ndihmuar gjatë procesit të analizës së mangësive dhe kryerjes së amendamenteve të ligjit, të nevojshme për të përfunduar përafrimin me *acquis* të BE-së.

Përveç kësaj, duhet të rishikohet legjislacioni ekzistues në fushën e të drejtës së ndërmarrjeve duke synuar identifikimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për përafrimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Kontabiliteti dhe Auditimi

Prioritetet në këtë fushë janë:

Në përmbushje të rekomandimeve të Komisionit Evropian si dhe analizës së arritjeve dhe mangësive në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, në lidhje me kapitullin 6 vlerësohen prioritetet si më poshtë:

- Përafrimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor për kontabilitetin me *acquis* më të fundit të BE-së në këtë fushë.

- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike (BMP) dhe harmonizimi me rregullat e auditimit ligjor të BE.

Mangësitë e identifikuar:

Për sa i përket fushës së kontabilitetit, ligji i ri 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” është harmonizuar pjesërisht me Direktivën Nr. 2013/34/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të datës 26 qershor 2013. Gjithashtu, nëpërmjet përdorimit të Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar SNRF-të në Shqipëri, të cilat janë të detyrueshme për të gjitha njësi ekonomike me interes publik PIE-të (përveç atyre njësi ekonomike që klasifikohen si PIE-të për shkak të natyrës, madhësisë dhe numrit të punonjësve të tyre, por nuk i kalojnë pragjet e përcaktuara në Ligjin 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Art. 4, pika 1.3), kemi përafrim të plotë me Rregulloren nr. 1606/2002 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian të datës 19 Korrik 2002 mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Nga tabelat e përputhshmërisë që shoqëron miratimin e ligjit, vihet re që ka ende disa çështje si pragjet apo kufijtë, të cilat nuk janë në përputhje të plotë me Direktivën. Kjo ndodh për shkak se

kërkesat e paraqitura në këto nene janë:

1. Opsionale edhe për shtetet anëtare; ose
2. jo relevante ose jo të zbatueshme për njësitë ekonomike shqiptare;

Ndërsa, referuar fushës së auditimit ligjor, Ligji Nr. 10091 datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesioneve të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar, është në një nivel shumë të gjerë në përputhje me kërkesat e vendosura nga Direktiva 2014/56/BE si dhe Rregullorja e re 537/2014/BE. Nga tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë këtë ligj, vihet re që ka ende disa çështje specifike, të cilat nuk janë në përputhje të plotë me Direktivën dhe Rregulloren.

Kjo ndodh për shkak se kërkesat e paraqitura në këto nene janë:

1. Opsionale edhe për shtetet anëtare; ose
2. jo relevante ose jo të zbatueshme për njësitë ekonomike shqiptare;

Në kuadër të fushës së auditimit, Bordi i Mbikëqyrjes Publike është në proces të përafrimit të Rregullores 537/2014 të KE (Rregullorja 537/2014 për auditimin) mbi kërkesat e posaçme në lidhje me auditimin ligjor të njësi ekonomike me interes publik, për sa është e aplikueshme, nëpërmjet Rregullores Nr. 7 datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e Kontrollit të Cilësisë të Auditimit Ligjor”. Në këtë kontekst, do të përafrohen neni 4, neni 5, neni 15, përafrim i pjesshëm i nenit 27, i rregullores 537/2014 për auditimin. Gjithashtu, një pjesë e madhe e dispozitave të Direktivës 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 17 Maj 2006 mbi auditim ligjor të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, që ndryshon Direktivën e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 84/253/KEE, janë të reflektuara edhe në dispozitat e ligjit 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar. Ato dispozita të cilat janë përafruar pjesërisht ose nuk janë përafruar me ligjin e auditimit dhe me rregulloren nr. 7 datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë të auditimit ligjor”, të cilat janë dispozita të pazbatueshme në kontekstin tonë ose janë të parëndësishme për momentin, do të rishikohen në periudhat në vijim.

Në këtë kuadër, theksohet se akti do të ketë përafrim të mëtejshëm brenda një të ardhme të parashikueshme, por jo në një afat të shkurtër. Ndërkohë, institucioni i Bordit të Mbikëqyrjes



Publike vazhdon punën e tij në kuadër të përmirësimit të kontrollit të cilësisë, marrjes së masave disiplinore, si dhe përmirësimit të profesionit të kontabilistit të miratuar dhe audituesit ligjor.

KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

4.7.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis mbi të drejtat e pronësisë intelektuale specifikon rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Dispozita të veçanta zbatohen për mbrojtjen e bazave të të dhënave, programeve kompjuterike, topografive të gjysmëpërçuesve, transmetimit satelitor dhe ritransmetimit kabllor. Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, *acquis* përcakton rregulla të harmonizuara për mbrojtjen ligjore të markave dhe disenjove. Dispozita të tjera specifike zbatohen për shpikjet bioteknologjike, farmaceutike dhe produktet për mbrojtjen e bimëve. *Acquis* gjithashtu përcakton një markë tregtare të Komunitetit dhe dizajnin e Komunitetit. Së fundi, *acquis* përmban rregulla të harmonizuara për zbatimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe të drejtave të pronësisë industriale. Kërkohen mekanizma të përshtatshëm zbatues, në veçanti kapacitete efektive të zbatimit.

4.7.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli Pronësia Intelektuale ndahet në tre nënkapituj si më poshtë:

- Pronësia industriale
- E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura
- Zbatimi i të drejtave të pronësisë industriale

4.7.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* të BE-së. Përafrimi i ligjit shqiptar me *acquis* të BE-së për pronësinë intelektuale ka filluar shumë vite më parë dhe tashmë ka arritur nivele të mira përputhshmërie.

Neni 73 Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit përcakton se:

- Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Shqipëria dhe Bashkimi Evropian konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe

imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

- Shqipëria merr përsipër masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje si dhe një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.

- Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.

- Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

- Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe sigurimi i një niveli mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e Qeverisë Shqiptare parashikuar në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, (neni 73). Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e pronësisë intelektuale me *acquis*, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

Për sa i përket legjislacionit të Bashkimit Evropian, ai pjesërisht duhet të transpozohet përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Por, disa nga aktet ligjore që rregullojnë pronësinë intelektuale do të fillojnë të zbatohen vetëm pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Veçanërisht, Rregullorja 2017/1001 për markën e BE-së, Rregullorja 6/2002 për dizajnin e Komunitetit, Rregullorja 1257/2012 për Konventën Evropiane të Patentave, Rregullorja 1260/2012 për regjimin gjuhësor për Patentat Evropiane, përmbajnë regjime vetë-ekzekutuese të cilat do të zbatohen plotësisht për Shqipërinë vetëm pas aderimit.

Duhet të theksohet gjithashtu se në fushën e pronësisë intelektuale (përfshirë pronësinë



industriale), Shqipëria, ashtu si shumë vende të tjera kandidate dhe vetë shtetet anëtare të BE-së, është gjithashtu palë në një sërë marrëveshjesh ndërkombëtare. Për shembull, pas anëtarësimit të saj në Organizatën Botërore të Tregtisë, Shqipëria është palë e Marrëveshjes për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIPS). Ajo është gjithashtu palë në disa Marrëveshje të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Së bashku, ato formojnë një grup rregullash që duhet të pasqyrohen në rendin juridik kombëtar.

4.7.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje/është e përgatitur mesatarisht për të drejtat e pronësisë intelektuale.

Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016 – 2020 sikurse miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 527 datë 20.07.2016 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016 – 2020” përbën kuadrin strategjik në fushën e pronësisë intelektuale. Zbatimi i kësaj Strategjie ka pasur ecuri të mirë si për sa i përket përmbushjes së aktiviteteve dhe arritjes së objektivave ashtu edhe bashkëpunimit ndërinstitucional në zbatimin dhe monitorimin e saj nën drejtimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

Ndërkohë është duke u përgatitur Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2021 – 2026. Hartimi i Strategjisë u realizua nga Grupi Ndërinstitucional i Punës i ngritur bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 118, datë 23.09.2020 “Për krijimin dhe funksionimin e grupit ndërinstitucional të punës, i cili do të merret me hartimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale”. Hartimi i Strategjisë u mbështet me ekspertizë teknike edhe nga WIPO. Kjo është strategjia e tretë në fushën e pronësisë intelektuale dhe se tashme institucionet shqiptare janë më se të ndërgjegjësuar për detyrat e veta funksionale në procesin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për pronësinë intelektuale. Miratimi i kësaj Strategjie dhe zbatimi i saj synojnë zhvillimin e kuadrit ligjor dhe forcimin e zbatimit të tij nga të gjitha ministratë dhe institucionet sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë.

Kuadri ligjor në lidhje me të drejtën e autorit përbëhet së pari nga Ligji Nr. 35/2016 “Për të

drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i cili është përafëruar plotësisht me:

- Direktivën 2006/116/KE, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, “Mbi afatin e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura” e amenduar”;

- Direktivën 2004/48/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 29 prill 2004, “Mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”;

- Direktivën 2001/29/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 maj 2001, “Mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të në shoqërinë e informacionit”;

- Direktivën 2001/84/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 27 shtator 2001, “Mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit të një veprë origjinale të artit”;

- Direktivën 96/9/ KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 1996, “Mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave”;

- Direktivën 2009/24/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 prill 2009, “Mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike”;

- Direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, “Mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën e kreditimit dhe mbi disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale”.

Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën e Këshillit 93/83/KEE, datë 27 shtator 1993, “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kablore”;

- Direktivën 2014/26/ BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për menaxhimin kolektiv të së drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të dhe licencimi multi-territorial i të drejtave në veprat muzikore për përdorim në internet në tregun e brendshëm”.

Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, kuadri ligjor përfshin së pari, Ligji Nr. 9947 “Për pronësinë industriale”, (i ndryshuar). Ky Ligj është plotësisht i përafëruar me *acquis* e mëposhtme të BE-së:



- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 korrikut 1998 mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;

- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 mbi mbrojtjen ligjore të disenjove;

- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 6/2002 e datës 12 dhjetor 2001 mbi disenjot e Komunitetit;

- Direktiva 87/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Dhjetor 1986 mbi mbrojtjen ligjore të topografive dhe produkteve gjysmëpërçues;

- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 29 prill 2004 mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale;

- Direktiva 2015/2436/EC, dt. 16.12.2015 “Për harmonizimin e bazës ligjore të vendeve anëtare në lidhje me markat tregtare”;

- Rregullorja Nr. 1151/2012/EC të datës. 21.11.2012 “Për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”;

- Rregullorja Nr. (EEC) Nr. 1308/2013/EC dt. 17.12.2013 “Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe shfuqizimin e rregulloreve (EEC) Nr. 922/72, (EEC) Nr. 234/79, (EC) Nr. 1037/2001 dhe (EC) Nr. 1234/2007”.

- Direktiva 2004/48/EC mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale

- Direktiva 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 maj 2016 mbi mbrojtjen e njohurive dhe informacioneve të biznesit kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të tyre të paligjshëm (sekreti tregtar).

Ky akt ligjor u ndryshua së fundmi me Ligjin Nr. 96/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, për të përafuar më tej në legjislacionin shqiptar Direktivën 2016/943 për mbrojtjen e sekreteve tregtare, krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Pronësisë Industriale, Sistemi i Administrimit të Pronësisë Industriale (SAPI) si dhe disa ndryshime mbi rregullimin e parimeve të përgjithshme të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) në fushën e PI.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale si dhe Drejtoria e të Drejtës së Autorit pranë

Ministritë së Kulturës janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuara direkt me çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale bashkëpunon me Drejtorinë e të Drejtave të Autorit në aktivitete të përbashkëta, siç parashikohet edhe në dokumentet strategjike.

Të dy institucionet përgatisin, promovojnë, shpërndajnë materiale informative, organizojnë fushata sensibilizimi për institucionet, grupet e interesit dhe publikun nëpërmjet medias elektronike dhe të shkruar, si dhe aktivitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, si seminare, konferenca, trajnime etj. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucioneve të tjera, siç janë Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve etj., të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë. Bashkëpunimi ndërinstitucional, ka rezultuar i suksesshëm në rritjen e ndërgjegjësimit, vendosjen e ekuilibrave të duhur ndërmjet të drejtave të pronarëve të objekteve të Pronësisë Intelektuale dhe interesave të përdoruesve dhe luftën kundër informalitetit.

Republika e Shqipërisë është bërë pjesë e WIPO Global Brand & Design Database, me mbi 18 000 regjistrime, databazë ku bëjnë pjesë shumica e shteteve anëtare të WIPO.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka nënshkruar Marrëveshjen për reduktimin e tarifës së raportit të kërkimit me Zyrën Evropiane të Patentave. Shpikësit e pavarur, sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, universitetet dhe organizatat jo fitimprurëse përfitojnë ulje me 75% të tarifës bazë, rreth 100 aplikime shqiptare.

Aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale është rritur nga viti në vit në përputhje me zhvillimin e ekonomisë shqiptare dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e pronësisë industriale. Për rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve shqiptare mbi të drejtat e pronësisë industriale dhe mbrojtjen e tyre, gjatë periudhës janar – tetor 2021, kjo Drejtoria zhvilloi mbi 200 takime me biznese në mbi 30 qytete dhe rrethe të Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe, pranë DPPI u depozituan 2 335 aplikime për markë, nga të cilat 727 prej tyre janë me aplikantë shtetas shqiptarë, krahasuar me



vitin 2020 ku u depozituan 566 aplikime po nga shtetas shqiptarë. Po ashtu, u dorëzuan 17 aplikime për patentë kombëtare krahasuar me 8 të tilla gjatë vitit 2020, 28 aplikime për diseno industriale krahasuar me 11 aplikime gjatë vitit 2020 dhe 1 aplikim për emërtim origjine.

Ndërkohë, viti 2020 u mbyll me 4 100 aplikime për markë me një rritje prej 6.8% krahasuar me vitin 2019 nga të cilat 1 164 janë aplikime kombëtare.

Si rezultat i rritjes së numrit të aplikimeve, DPPI e mbylli vitin 2020 me një rritje prej 13.15% të të ardhurave i cili përkthehet në shërbime më cilësore ndaj qytetarëve dhe nivele më të larta të performancës.

Përfshirja e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale në portalin unik qeveritar e-Albania me 154 shërbime online për biznesin apo çdo individ i cili mban apo ka krijuar një objekt të pronësisë industriale, ka krijuar lehtësira shumë të mëdha. Deri tani, 81 aplikime janë bërë me anë të këtij portali dhe kanë vijuar me proceset apo janë pajisur me certifikatën përkatëse.

Drejtoria e të Drejtave të Autorit, pjesë e Ministrisë së Kulturës, ushtron veprimtarinë në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Kjo Drejtori bashkëpunon me autoritetet shtetërore kompetente, aktorë të cilët kanë një rol të rëndësishëm në fushën e të drejtave të autorit, në zbatim të ligjit.

Në zbatim të ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to”, administrimi kolektiv kryhet nga agjencitë e administrimit të të drejtave të autorit, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbledhjen e të ardhurave për përdorimin e veprave dhe shpërndarjen e tyre të titullarët e së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Agjencia e administrimit kolektiv licencohet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit pas propozimit nga Drejtoria e të Drejtës të Autorit (DDA). Licenca e agjencive të administrimit kolektiv për ushtrimin e veprimtarisë është e vlefshme për 3 vjet si dhe mund të jetë e rinovueshme. Agjencitë e administrimit kolektiv mbikëqyrën nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit mbi të gjithë veprimtarinë e funksionimit të tyre. Aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e administrimit kolektiv katër agjenci të administrimit kolektiv.

Sporteli Unik në Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka qëllim kryerjen e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga përdorimi i veprave të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet përdorues, si një sportel i vetëm në emër të të gjitha agjencive të administrimit kolektiv të licencuara, si dhe shpërndarjen e këtyre të ardhurave tek këto agjenci në përputhje me legjislacionin në fuqi. Më pas, këto agjenci bëjnë shpërndarjen e të ardhurave të titullarët e të drejtave që përfaqësojnë.

Regjistrimi i së drejtës së autorit dhe kalimit të të drejtave kryhet në portalin e-Albania. Gjatë periudhës janar – shtator 2021, janë kryer 165 regjistrime për të drejtën e autorit dhe kalim të drejtave të autori.

Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor, por edhe më gjerë mbi aspekte të tjera sa i takon të drejtës së autorit, Drejtoria e të Drejtave të Autorit është përfshirë në dy projekte konkretisht:

- Projekti i binjakëzimit “Forcimi i mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të Pronësisë Intelktuale”;

- Projekti për bashkëpunimin bilateral në Pronësinë Intelktuale.

Në fushën e zbatimit të pronësisë intelektuale, Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut (ISHMT) është përgjegjës dhe garantues i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në tregun e brendshëm nëpërmjet inspektimeve të planifikuara dhe në bazë të kërkesës ankesave të paraqitura nga mbajtësit e të drejtave.

Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 36, datë 20.01.2016. Veprimtaria e ISHMT mbështetet në Ligjin Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjet specifike, Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe Ligjin Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i ndryshuar. Miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 96/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale” përmirësoi edhe procedurat për mbikëqyrjen e tregut në lidhje me shkeljet e objekteve të pronësisë industriale. Për të zbatuar ndryshimet e mësipërme ligjore, aktualisht si nevojë imediate është hartimi i një metodologjie risku për administrimin dhe



analizën e riskut për të iniciuar inspektimet *ex officio*, si dhe hartimi dhe miratimi i një rregulloreje për shkatërrimin e mallrave të falsifikuara dhe pirate. Me shumë rëndësi është edhe një komentari mbi zbatimin e dispozitave ligjore mbi të cilat do të mbështetet aktiviteti i ISHMT.

Organika e ISHMT përfshin ndër të tjera Drejtorinë e Pronësisë Intelektuale të përbërë nga Sektori i së Drejtës së Autorit (SDA) dhe Sektori i Pronësisë Industriale (SPI). Sektori i së Drejtës së Autorit përbëhet nga 1+9 inspektorë, dhe Sektori i Pronësisë Industriale përbëhet nga 1+6 inspektorë. Stafi i ISHMT ka marrë pjesë në trajnime me tematikë mbi objektet e pronësisë intelektuale dhe standardet e BE dhe praktikën e mbikëqyrjes së tregut në lidhje me luftën kundër piraterisë dhe falsifikimit të objekteve të Pronësisë Intelektuale.

Gjatë periudhës janar – nëntor 2021 janë kryer 313 inspektime mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to dhe janë vendosur 57 dënime administrative kryesore dhe janë paraqitur 20 kërkesë ankese për cenimin e markave tregtare, për të cilat janë legjitimuar dhe janë kryer 7 inspektime dhe janë vendosur 6 masa administrative me gjobë. Të gjitha këto procese inspektimi janë kryer online me anë të sistemit e-inspection duke i kushtuar rëndësi të veçantë procedurave të rregullta ligjore.

Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (DMPI) është strukturë përbërëse e Departamentit Operativ – Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Stafi i saj është i përbërë nga një drejtor dhe katër specialistë.

Objekti i punës së DMPI-së është të zbatojë legjislacionin për mbrojtjen e pronësisë intelektuale sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi për territorin doganor shqiptar, të koordinojë punën ndërmjet drejtorive të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, institucioneve të treta dhe/ose grupeve të interesit për çështjet e pronësisë intelektuale, të administrojë me profesionalizëm kërkesat e/i interesuarve të paraqitura pranë DMPI-së, duke mbajtur në vëmendje respektimin e afateve kohore, procedurale dhe trajtimin e çështjeve në mënyrë profesionale.

Baza ligjore mbi të cilën vepron sistemi doganor është: Marrëveshja TRIPS, nenet 51 – 60, Ligji Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si,

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 651, datë 10.11.2017, i ndryshuar ka përafuar pjesërisht në nenet 364 – 392, Rregulloren (BE) Nr. 608/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 qershor 2013 në lidhje me zbatimin nga doganat të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe shfuqizimin e Rregullosës së Këshillit (KE) Nr. 1383/2003.

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian është vënë në përdorim sistemi Ines + (databaza e të dhënave për aplikim për veprim dhe e mallrave të konstatuara si cenuese të të drejtave të pronësisë intelektuale) dhe është trajnuar administrata doganore për përdorimin e saj dhe janë përgatitur manualët e përdorimit të sistemit Ines +.

Gjatë periudhës janar – tetor 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka trajtuar 107 aplikime për mbrojtje të dorëzuar në bazë VKM-së nr. 651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndër të cilat 102 aplikime janë miratuar dhe 5 janë refuzuar për arsye të ndryshme.

Gjatë kontrollove të përbashkëta me Degët Doganore/struktura të tjera të Departamentit Operativ-Hetimor dhe i/e strukturave të treta që trajtojnë çështje të pronësisë intelektuale janë kryer kontrole gjatë të cilave janë pezulluar dhe shkatërruar mallrat të cilat janë vërtetuar nga mbajtësit e së drejtës që ishin të falsifikuara. Janë përditësuar profilet e riskut në bazë të të dhënave të ofruara nga mbajtësit e së drejtës dhe/ose informacioneve nga profilet e riskut.

Gjatë kësaj periudhe janë përditësuar të dhënat e kurrikulat e ASPA-s si dhe është rritur niveli i modelit *training on the job* duke përfshirë të gjithë degët doganore të Republikës së Shqipërisë, totali i personave të trajnuar është 110 persona.

Arritjet e vitit 2021 përfshijnë përgatitjen dhe miratimin e Ligjit Nr. 96/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, i cili përafroi më tej legjislacionin shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Nga 31 maj 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale të Shqipërisë (DPPI) është pjesë e DESIGNclass e cila do të përdorë dhe do të pranojë listën e termave nga databaza e



harmonizuar me përshkrimet e produkteve (HDBPI) në DESIGNclass. DESIGNclass u ofron përdoruesve mundësinë për të kërkuar dhe për të përkthyer përshkrimet e produkteve në 29 gjuhë. Miratimi i HDBPI nga DPPI është një rezultat konkret i programit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar të menaxhuar nga EUIPO në bashkëpunim me partnerët e tij ndërkombëtarë.

Ministria e Kulturës gjatë vitit 2021 përgatiti ndryshimet në Ligjin Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” për të përafruar më tej legjislacionin e Bashkimit Evropian, konkretisht duke përafruar pjesërisht Direktivën (BE) 2017/1564 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 shtator 2017 mbi disa përdorime të lejuara të veprave të caktuara dhe fusha të tjera të mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to në përfitim të personave të cilët janë të verbër, me shikim të dëmtuar ose ndryshe me aftësi të kufizuara në leximin e materialeve të printuara, dhe amendimin e Direktivës 2001/29/KE mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në shoqërinë e informacionit dhe Direktivën 2012/28/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetor 2012 për përdorime të caktuara të lejuara të veprave pa autor. Ky projektligj u konsultua me shërbimet e Komisionit Evropian dhe i është paraqitur Kuvendit të Shqipërisë për miratim.

Përgjatë vitit 2021 me urdhër të Ministrit të Kulturës janë licencuar katër agjenci të administrimit kolektiv:

1. Agjencia “ALBAUTOR” për të drejtat e autorëve për veprat muzikore me apo pa tekst;
2. Agjencia “AKDIE” për të mbrojtur të drejtat e artistëve interpretë dhe/ose ekzekutues të veprave;
3. Agjencia “FMAA” në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale;
4. Agjencia e Administrimit Kolektiv “Faber Collective Phonogram” në fushën e të drejtave të prodhuesve të fonogramit.

4.7.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale;
- Ministria e Kulturës/Drejtoria për të Drejtën e Autorit;

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Policia e Shtetit – Drejtoria e Krimit Ekonomik;

- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Shkolla e Magjistraturës.

4.7.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë së re të Pronësisë Intelektuale 2021 – 2025 është një nga prioritetet e të gjitha institucioneve shqiptare të përfshira në mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Dokumenti është duke u finalizuar dhe pritet të miratohet së shpejti nga Këshilli i Ministrave.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në përputhje me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe kërkesat e negociatave të anëtarësimit mbetet një prioritet i Ministrisë së Kulturës/ Drejtorisë së të Drejtave të Autorit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë/ Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Në lidhje me përafrimin e legjislacionit duhet pasur parasysh se një pjesë e *acquis* së Bashkimit Evropian për pronësinë industriale do të harmonizohet plotësisht vetëm kur Shqipëria të jetë shtet anëtar në BE.

Në periudhën 2022 – 2025 për sa i takon harkut kohor të zbatimit të Strategjisë së re, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale do të ndërmarrë një reformë të re ligjore në fushën e pronësisë industriale, duke hartuar një ligj të ri për çdo objekt të pronësisë industriale, ashtu siç e kanë dhe shumë vende të zhvilluara si dhe duke përafruar të gjitha direktivat e fushës për çdo objekt të pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2022, DPPI ka marrë angazhim të fillojë me hartimin e ligjit të ri “Për markat tregtare dhe të shërbimit” si dhe të ligjit “Për patentat dhe modelet e përdorimit”. Këto dy akte ligjore do të miratohen brenda vitit 2025.

Deri në vitin 2025, DPPI do të përafrojë legjislacionin në fushën e pronësisë industriale me direktivat/rregulloret e BE për pjesën e mbetur, pa prekur nenet që janë kusht që plotësohet me hyrjen në BE si më poshtë:



1. Direktiva (BE) 2015/2436 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare e datës 16 dhjetor 2015;

2. Rregullorja (BE) 2017/1001 për markën tregtare të Bashkimit Evropian e datës 14 qershor 2017;

3. Direktiva 98/71 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 tetor 1998 për mbrojtjen ligjore të disenjove.

Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit të ri në fushën e pronësisë industriale do të kërkojë më shumë trajnime të thelluara dhe lind nevoja që të ketë shtim kapacitetesh administrative.

Fuqizimi i Qendrës së Trajnimeve vijon të mbetet një tjetër prioritet dhe angazhim i DPPI me qëllim ofrimin e trajnimeve të specializuara në fushën e pronësisë industriale. Në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale – 26 prill, u lancua ngritja e Qendrës së Trajnimeve, e cila ka zhvilluar deri më sot trajnime të dedikuara për universitetet në shkallë vendi. Prioritet mbetet për momentin përgatitja e moduleve të PI, të cilat janë të dedikuara për çdo objekt të PI. Aktualisht ka filluar përkthimi i moduleve të cilat janë të përgatitura nga WIPO Academy dhe do të përdoren nga Qendra e Trajnimeve pas dakortësimit me këtë akademi.

Trajnimi i mësuesve në shkallë vendi në lidhje me lëndën e pronësisë intelektuale do të jetë një nga objektivat kryesore të DPPI për vitin 2022, si një indikator shumë i qëndrueshëm në edukimin e brezave në fushën e pronësisë intelektuale. Ky trajnim do të behët në bashkëpunim me ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para-Universitar) dhe do të shtrihet në të gjitha qytetet.

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale bazuar në kalendarët vjetorë të punës do të fokusohet në takimet me biznesin, trajnime të struktura të arsimit para-universitar dhe universitar, strukturat shtetërore, përfaqësuesit e autorizuar etj.

Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” është një ligj i harmonizuar dhe i integruar me Direktivat e Bashkimit Evropian. Megjithatë, përafrimi i legjislacionit do të vijojë në përputhje me zhvillimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë të Informacionit kanë hartuar termat e referencës për realizimin e procedurës me objekt “Ngritja e

platformës digjitale për të drejtën e autorit”. Gjatë vitit 2022 pritet të ngrihet platforma për të drejtën e autorit në të cilën përfshihen: baza e të dhënave për veprat e regjistruara pranë DDA; baza e të dhënave për kontratat e kalimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to; baza e të dhënave për veprat pa autor; menaxhimi i ri i Sportelit Unik Suada, sipas ndryshimeve ligjore; drejtimi i Sportelit unik nga një strukturë e përbërë nga agjencitë e licencuara; agjencitë e licencuara të administrimit kolektiv dhe veprimtaria e tyre; monitorimi i përdorimit të të drejtës së autorit nga subjektet përdoruese dhe pajisjen e tyre të detyrueshme me kontratat, autorizimet e lëshuara nga AAK-të.

Nëpërmjet platformës do të gjenerohet informacion për të gjithë të interesuarit në fushën e të drejtës së autorit, do të reduktohet puna manuale dhe do të kryhet digjitalizimi i arshivës fizike.

Institucionet e angazhuara në ndjekjen e zbatimit të legjislacionit përballen në aktivitetin e tyre me një nivel të ulët ndërgjegjësimi nga ana e operatorëve ekonomikë mbi respektimin e të drejtave të pronësisë intelektuale. Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë do të jetë një tjetër fushë ku do të fokusohet aktiviteti i institucioneve të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

Më tej do të forcohen edhe kapacitetet administrative të këtyre institucioneve. Kështu, stafi i ISHMT do të trajnohet mbi ndryshimet dhe risitë e fundit në fushën e të drejtave të autorit si dhe të drejtave të pronësisë industriale. Forcimi i kapaciteteve logjistike do të ndikojë po ashtu në rritjen e numrit dhe efikasitetit të inspektimeve. Inspektimet për respektimin e të drejtave të autorit dhe të pronësisë industriale do të përfshijnë inspektime të planifikuara dhe inspektime të pa planifikuara mbi bazën e ankesave nga konsumatorët, operatorët ekonomikë, të njoftimeve nga Dogana, palë të treta, etj.

Për Sektorin e të Drejtave të Autorit në zbatim të Ligjit Nr. 35 datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, prioritet do të jenë këto fusha inspektimi:

- Inspektimi i programeve kompjuterike;
- Inspektimi i fotokopjeve;
- Inspektimi i veprave audio-vizuale;
- Inspektimi i shtëpive botuese;
- Inspektimi i shtypshkronjave.



Për Sektorin e Pronësisë Industriale në zbatim të Ligjit Ligji Nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale” (i ndryshuar), prioritet do të jetë trajtimi i çështjeve dhe kryerja e inspektimeve mbi bazën e kërkesë-ankesave që do të depozitohen pranë ISHMT për shkeljen e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale.

Së fundmi, të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale do të forcojnë bashkëpunimin mes tyre, edhe në kuadër të zbatimit të Strategjisë së re të Pronësisë Intelektuale, dhe me institucionet homologe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe në vendet e rajonit.

Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024, ministritë dhe institucionet shqiptare të përfshira në zhvillimin dhe mbrojtjes e të drejtave të pronësisë intelektuale do të fokusohen në këto prioritetet kyçe:

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të me legjislacionit të Bashkimit Evropian;

- Përmirësimi i funksionimit të organizatave të menaxhimit kolektiv dhe pagesës së honorarëve për mbajtësit e të drejtave;

- Harmonizimi i legjislacionit për të drejtat e pronësisë industriale dhe i sistemit të zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale.

KAPITULLI 8: POLITIKA E KONKURRENCËS

4.8.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika e konkurrencës në Evropë është një pjesë thelbësore e funksionimit të tregut të brendshëm. Qëllimi i saj është të sigurojë për të gjithë në Evropë mallra dhe shërbime me cilësi më të mirë dhe me çmime më të ulëta duke synuar promovimin dhe mbrojtjen e konkurrencës. Politika e konkurrencës ka të bëjë me zbatimin e rregullave për t'u siguruar që ndërmarrjet konkurrojnë në mënyrë të lirë dhe efektive me njëra-tjetrën. Kjo inkurajon ndërmarrjen dhe efikasitetin, krijon një zgjedhje më të gjerë për konsumatorët dhe ndihmon në uljen e çmimeve dhe përmirësimin e cilësisë.

Acquis në këtë kapitull përfshin si politikat anti-trust ashtu edhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Kuadri ligjor përfshin rregulla dhe procedura për të luftuar sjelljet anti-konkurrese (marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimin me pozitën dominuese), për të

shqyrtuar përqendrimet ndërmjet ndërmarrjeve dhe për të parandaluar qeveritë nga dhënia e ndihmës shtetërore që shtrembëron konkurrencën në tregun e brendshëm. Në përgjithësi, rregullat e konkurrencës janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjithë Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare duhet të bashkëpunojnë plotësisht me Komisionin për zbatimin e tyre.

4.8.2 Struktura e kapitullit

1. Politika e Konkurrencës

2. Ndihma Shtetërore

3. Liberalizimi

4.8.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikat e konkurrencës, rregullohet në disa nene të MSA-së. Së pari, në Titullin IV “Përafrimi i legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, neni 70 përcakton se Shqipëria do të përpiket që të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të Komunitetit dhe se do të sigurohet që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.

Neni 71 “Konkurrenca dhe dispozitat e tjera ekonomike”, përcakton qartë se dispozitat në vijim pjesë të këtij neni, si marrëveshjet e ndaluara ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe ndërmarrjesh dhe praktika të koordinuara ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kanë si objekt të tyre ose pasojë, parandalim, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës; abuzim me pozitën dominuese, nga një ose më shumë ndërmarrje në territorin e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre; çdo ndihme shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara, nuk janë në përputhje me funksionimin e duhur të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Me qëllim përmbajtjes jo vetëm të dispozitave të MSA por edhe të legjislacionit të BE, Shqipëria është angazhuar në përafrimin e legjislacionit të saj të brendshëm me atë të BE.

4.8.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Raporti i Progresit 2021 për Shqipërinë parashikon se Shqipëria ka një nivel përgatitjeje / është e përgatitur mesatarisht në politikën e



konkurrencës. Ka pasur progres të kufizuar gjatë periudhës së raportimit, veçanërisht me miratimin e disa udhëzimeve nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës (ASHK), duke përfshirë ato për zbatimin efektiv dhe garantimin e funksionimit të duhur të tregut.

Qëllimi i Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Dispozitat e ligjit zbatohen si në rastet e marrëveshjeve të ndaluara midis ndërmarrjeve, abuzimit me pozitën dominuese dhe procedurat e kontrollit të përqendrimeve midis ndërmarrjeve.

Rregullat e BE gjithashtu përcaktojnë një sistem të kontrollit të ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse plotësohen kushtet kufizuese, me qëllim parandalimin e shtrembërimit të konkurrencës.

Konkurrenca

Kuadri ligjor në fushën e konkurrencës është gjerësisht në të njëjtën linjë me EU *acquis* dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (SAA). Ligji nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar është plotësisht i përfaruar me nenin 101 TFEU (Marrëveshjet e ndaluara) dhe nenin 102 TFEU (Abuzimi me pozitën dominuese). Ligji parashikon procedura paraprake për kontrollin e përqendrimeve, në linjë me Rregulloren e Përqendrimeve të BE. Kuadri ligjor zbatues është plotësisht i përfaruar me rregulloret përkatëse të BE dhe me Udhëzimet e Komisionit Evropian.

Autoriteti i Konkurrencës e mbështet veprimtarinë e tij në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar si dhe në një set të plotë aktesh nënligjore, përfshirë rregullore dhe udhëzime konkrete. Ligji dhe kuadri ligjor dytësor janë plotësisht të përfaruar me kuadrin ligjor të BE-së në fushën e konkurrencës, nenet 101 TFEU (Marrëveshjet e ndaluara) dhe nenin 102 TFEU (Abuzimi me pozitën dominuese). Gjithashtu ligji parashikon procedura paraprake për kontrollin e përqendrimeve, në linjë me Rregulloren e Përqendrimeve të BE. Kuadri ligjor zbatues është plotësisht i përfaruar me rregulloret përkatëse të BE dhe me Udhëzimet e Komisionit Evropian, të tilla si Rregulloren e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit; Rregulloren e Këshillit

Evropian (EC) Nr. 139/2004, të datës 20 janar 2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” (Rregullorja e Përqendrimit të KE); Njoftimin e Komisionit mbi përcaktimin e tregut përkatës për qëllimet e ligjit komunitar të konkurrencës; Njoftimin e Komisionit mbi imunitetin nga gjobat dhe uljen e gjobave në rastet e karteleve; Udhëzimin për metodën e përcaktimit të gjobave të vendosura në përputhje me nenin 23 (2) (a) të Rregullores nr. 1/2003; Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet me rëndësi të vogël të cilat nuk e kufizojnë ndjeshëm konkurrencën sipas nenit 81(1) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian (de minimis), etj, si dhe akte të tjera ligjore të BE-së etj.

Bazuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9121/2003, AK është një autoritet i pavarur, i cili në respektim të nenit 24 të ligjit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës paraqet dhe raporton pranë Kuvendit të Shqipërisë raportin vjetor të Autoritetit.

Në nenin 24 të ligjit janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit ku është përcaktuar se KK mund të miratojë akte nënligjore zbatuese, në formën e rregulloreve dhe udhëzimeve në zbatim të ligjit. Në zbatim të nenit 41 të Ligjit, AK me nismën e vet, më kërkesë të Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatorë të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse dyshohet se konkurrenca në treg është kufizuar ose shtrembëruar.

Në mbështetje të nenit 42 dhe 43 të Ligjit, AK fillon procedurat e hetimit paraprak ose të hetimit të thelluar lidhur me kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës në treg.

Neni 44 i Ligjit parashikon së në rastet e një rreziku të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencës, kur ka të ngjarë të ketë shkelje të neneve 4 dhe 9 të ligjit, mund të merren masa të përkohshme. Detyrimet ndaj ndërmarrjeve përfshirë edhe masat strukturore lidhur me ndalimin e shkeljeve të konkurrencës përcaktohen në nenin 45 të ligjit. Në këtë nen janë përcaktuar edhe rastet kur ndërmarrjet e interesuara marrin angazhime në formën e kushteve dhe detyrimeve, në përgjigje të vërejtjeve të bëra nga AK në vlerësimin paraprak.

Procedurat e kontrollit të përqendrimeve janë parashikuar në nenet 53 – 64 të ligjit lidhur me analizën dhe vlerësimin që kryhet nga AK.

Dispozitat ligjore parashikojnë procedurën paraprake në rastet kur përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg, apo procedurën e thelluar kur konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese.

Ligji, në nenet 69 dhe 70 të tij parashikon detyrimin që kanë organet e administratës qendrore dhe vendore për të kërkuar vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që ka të bëjë me kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin, vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara për ndërmarrje ose për produkte të caktuar apo imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes. Dispozitat ligjore parashikojnë detyrimin që kanë autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë që gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike, të zbatojnë dispozitat e ligjit të konkurrencës dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

Lidhur me kapacitetet administrative, stafi i AK ka përfutur nga një seri trajnimesh:

1. Në kuadër të projektit IPA 2015, Binjakëzim me Autoritetin Spanjoll të Konkurrencës (CNMC- Komisioni Kombëtar Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën), projekt *twinning* i financuar nga Komisioni Evropian me titull: “Forcim kapacitetesh për Autoritetin e Konkurrencës për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”;

2. Në kuadër të projektit me EBRD, ku AK ishte përfutur i projektit me titull “Asistencë teknike për Autoritetin e Konkurrencës, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”, etj.

3. Në kuadër të OECD/RCC, UNCTAD, etj.

Në zbatim të PKIE 2021 – 2023 janë përfutur një sërë aktesh nënligjore të tilla si Direktiva (EU) 2019/1 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 11 dhjetor 2018 për fuqizimin e autoriteteve të konkurrencës që të jenë zbatues më efektive dhe të sigurojnë funksionimin e duhur të tregut të brendshëm; Udhëzuesi “Për praktikën më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e neneve 101 dhe 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU)”; Udhëzuesi “Mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje”, Udhëzimi “Praktikat më të mira për dorëzimin e provave me

karakter ekonomik dhe mbledhjen e të dhënave në rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e artikujve 101 dhe 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) dhe në rastet e përqendrimeve” etj.

Aktet nënligjore të miratuara nga AK, përcaktojnë në mënyrë të detajuar procedurat të cilat ndihmojnë Autoritetin e Konkurrencës në realizimin e misionit sipas objektivit të ligjit, në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e përafrimit të legjislacionit me atë të *acquis* të BE-së. Veprimtaria e institucionit ka qenë në zbatim të ligjit të konkurrencës, Rezolutës së Kuvendit të RSH “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020”, si dhe të detyrave të përcaktuara në Raportet e Progresit nga Komisioni Evropian, në takimet e Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca përfshirë mbrojtjen e konsumatorit”, takimet e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, etj.

Gjatë periudhës 1 janar 2021 – 30 shtator 2021, KK ka aprovuar në total 80 (tetëdhjetë) vendime ku përmendim vendime lidhur me hapjen e procedurave hetimore për shkelje të dyshuara të nenit 4 (marrëveshje të ndaluara) dhe 9 (abuzim me pozitën dominuese), vendime për autorizim përqendrimesh, vendime për vendosje sanksionesh, vendime për dhënien e kushteve dhe detyrimeve, vendime për marrjen e masave të përkohshme, për miratim aktesh nënligjore etj.

Në lidhje me zbatimin e nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, kanë qenë objekt hetimi nga AK për marrëveshje të ndaluara, tregu i prokurimit publik të blerjes së ushqimeve; tregu i prokurimit publik të shërbimit të shtypshkrimeve (printimi dhe zarfimi i faturave, pulla kontrolli, produkte speciale poste etj.); tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, Nitrat dhe Ure; tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve para-mjekësore (ku përfshihen importi dhe tregtimi me shumicë i maskave; importi, prodhimi dhe tregtimi me shumicë i alkoolëve dhe gel-dezinfektues; importi dhe tregtimi me shumicë i termometrave).

Në lidhje me zbatimin e nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, për sa i përket rasteve të abuzimit me pozitën dominuese, janë realizuar hetime në tregun



e ngarkim-shkarkimit, importit, depozitimit, shitjes me shumicë të karburanteve; në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka; në tregun e ngarkim- shkarkim, import, depozitim, shitje me shumicë të GLN.

Në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 9121/2003, AK ka kryer një hetim të përgjithshëm në tregun e shërbimet spitalore, duke përfshirë të gjitha shërbimet e ofruara nga spitalet publike dhe jopublike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me kontrollin e përqendrimeve, janë zbatuar dispozitat ligjore për përqendrimet në tregje dhe sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare të tillë si tregu i shërbimeve mediatike audio, tregu i prodhimit të energjisë elektrike, duke përmendur edhe një numër të konsiderueshëm njoftimesh dhe transaksionesh që kanë ndodhur në tregun ndërkombëtar, pa sjellë pasoja mbi konkurrencën në tregun e brendshëm.

Me Vendimin e KK nr. 757, datë 23.12.2020 “Miratimi i dokumentit – “Advokacia e konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”, është miratuar dokumenti “Advokacia e Konkurrencës dhe Strategjia e komunikimit”. Ky dokument synon promovimin e një mjedisi konkurrues, duke bashkëpunuar ngushtësisht me të gjitha institucionet shtetërore dhe rregullatore për rritjen e ndërgjegjësimin të publikut dhe komunitetit të biznesit, lidhur me përfutimet që sjell një konkurrencë e lirë dhe efektive në treg; Përpjekjet e AK, duke përfunduar, nga njëra anë, rolin advokues të institucionit dhe nga ana tjetër, strategjinë e komunikimit, në drejtim të një grupi të larmishëm të palëve të synuara të interesit.

Ndihma shtetërore

Kuadri legjislativ për ndihmën shtetërore përpunohet gjerësisht me *acquis* të BE dhe MSA. Ligji për ndihmën shtetërore pasqyron kryesisht nenet 107 dhe 108 TFEU. Legjislacioni zbatues është përafshuar pjesërisht me *acquis* të BE-së në disa fusha, p.sh. Rregullorja e Përgjithshme e Përfundimit të Bllokut. Nevojitet një harmonizim i mëtejshëm me legjislacionin zbatues të BE-së për kontrollin e ndihmës shtetërore. Sa i përket kornizës institucionale, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për ndihmën shtetërore, i mbështetur nga struktura tekniko-administrative sekretariati për ndihmën shtetërore në ministrinë përgjegjëse për ekonominë.

Sipas Ligjit nr. 9374/2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, masat e reja të ndihmës duhet t’i njoftohen KNSH, e cila duhet t’i vlerësojë ato në përputhje me ligjin e ndihmës shtetërore përpara se të zbatohen. KSA mund të urdhërojë rikuperimin e ndihmës së paligjshme dhe të papajtueshme, por nuk e ka bërë atë deri më tani. Vendimet e tij i nënshtrohen apelit gjyqësor.

Në përgjithësi Shqipëria ka plotësuar detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në këtë fushë. Ligji shqiptar për ndihmën shtetërore, Ligji Nr. 9374, datë 21.04.2005 “Për ndihmën Shtetërore” është amenduar dhe është plotësisht i përfunduar me direktivat e mëposhtme të BE-së: Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1407/2013 e datës 18 dhjetor 2013 për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën e minimis; Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e datës 17 qershor 2014 për disa kategori ndihme të përputhshme me tregun e brendshëm në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Tekstit të Traktatit; Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e 17 qershor 2014 për deklarimin e disa kategorive të ndihmës shtetërore në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të Nenit 107 dhe 108 të Traktatit; Vendimi i Komisionit Evropian për zbatimin e Nenit 106(2) TFEU për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve që janë mandatuar për të ofruar shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik.

Baza ligjore e miratuar e ndihmon Strukturën e Ndihmës Shtetërore në veprimtarinë e tij dhe realizimin e misionit dhe të objektit të ligjit, në kuadër të ndalimit të çdo ndihme të dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo formë e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.

Gjatë periudhës 1 janar 2021 – 30 tetor 2021, Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka aprovuar si vijon:

- Vendim i KNSH Nr. 103/2021 “Autorizim i Ndihmës Shtetërore “Për Fuqizimin e Grave dhe Nxitja e Sipërmarrjes”



- Vendim i KNSH Nr. 102/2021 “Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat shtetërore të vitit 2020”

Në lidhje me liberalizimin, ligjet për mbrojtjen e konkurrencës dhe për ndihmën shtetërore janë të zbatueshme për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive, përveç rasteve kur zbatimi i tyre pengon kryerjen e detyrave të veçanta të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik që u caktohen atyre.

4.8.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Autoriteti i Konkurrencës;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (sekretariati i ndihmës shtetërore);
- Komisioni i Ndihmës Shtetërore;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Instituti i Statistikave.

4.8.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Autoriteti i Konkurrencës i kushton rëndësinë e duhur mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg nëpërmjet zbatimit të rregullave dhe parimeve të konkurrencës në zbatim të dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi. Komisioni Evropian në Progres Raportin për vitin 2021 shpreh se Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje / është e përgatitur mesatarisht në politikën e konkurrencës.

Bazuar në Takimin Shpjegues lidhur me *acquis* e BE-së për Politikën e Konkurrencës, të datave 4 – 6 nëntor 2019 të mbajtur në Bruksel, janë identifikuar aktet e BE-së të cilat janë përfaruar plotësisht ose pjesërisht si dhe akte të cilat do të parashikohen për tu përfaruar në të ardhmen. Mbi këtë bazë është hartuar Analiza e Mangësive Ligjore si dhe janë parashikuar nismat konkrete ligjore për të përfaruar në vitet në vijim.

Disa nga prioritetet e PKIE 2022 – 2024 në fushën e konkurrencës janë hartimi i disa udhëzimeve për te plotësuar kuadrin ligjor dytësor, të tilla si:

- Në vitin 2022 është parashikuar Udhëzuesi “Mbi kufizimet e konkurrencës sipas objektit”

për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Njoftimi De Minimis”, në përputhje me Udhëzimin mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Njoftimi De Minimis, Dokument i Komisionit Evropian, version i datës 3.06.2015 (Bruksel 25.06.2014/SWD (2014) 198);

- Në vitin 2023 është parashikuar Rregullorja “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren “Për Funksionimin e AK”, në përputhje me Manualin e Procedurave të Sjelljeve Anti-Konkurruese të BE (Dokument i Komisionit Evropian, Nëntor 2019);

- Në vitin 2023 është parashikuar Udhëzuesi “Mbi praktikën më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas rregullores së Përqendrimeve”, në përputhje me Praktikën më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas rregullores së Përqendrimeve (2 Qershor 2015/Dokument i Komisionit Evropian);

- Në vitin 2024 është parashikuar Udhëzuesi “Mbi referimin e rasteve në lidhje me përqendrimet”, në përputhje me Njoftim i Komisionit për referimin e rasteve në lidhje me përqendrimet (2005/C 56/02).

Progres Raporti për vitin 2021, në përshkrimin e situatës në Shqipërisë për sa i përket politikës së konkurrencës, ka vënuar me dhënien e disa rekomandimeve drejtuar Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të cilat kanë të bëjnë me:

- Rritjen dhe sigurimin e pavarësisë operacionale të KNSH dhe rritjen e ndjeshme të kapaciteteve administrative të sekretariatit të KNSH (Komisioni i Ndihmës Shtetërore;

- Përafrimin e kuadrit ligjor në fushën e ndihmës shtetërore me EU *acquis*;

- Rritjen e ndërgjegjësimit të KNSH me ministrinë e linjës, autoritetet rajonale dhe lokale, për të siguruar njoftimin paraprak të masave të ndihmës si dhe forcimin e zbatimit të rregullave të ndihmës shtetërore.

Strukturat e ndihmës shtetërore do të punojnë për :



- Zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128/2019 “Për ngritjen e grupit ndërmintor të punës për ndihmën shtetërore”;

- Zbatimin e masave të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019 – 2022, objektivin “Forcimin e efektivitetit të Ndihmës Shtetërore”. Ky objektiv parashikohet të rrisë efikasitetin e vendimeve për shpenzimet publike, politikën fiskale si dhe transparencën e burimeve shtetërore;

- Dhënien e këshillimit dhe mbështetjes për njoftimin e skemave të dhënës të ndihmës (ministritë e linjës dhe autoriteteve rajonale dhe lokale) me qëllim kuptimin dhe zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore.

Në këtë kuadër Komisioni për Ndihmën Shtetërore për ndjekjen e rekomandime të sipërpërmendur si dhe institucionet e tjera pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integritetin Evropian, do të përpiqen që të sigurojnë që kuadri ligjor ekzistues i këtij kapitulli dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me *acquis* të BE dhe se do të sigurohet që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet në mënyrën e duhur.

KAPITULLI 9: Shërbimet financiare

4.9.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e shërbimeve financiare synon të garantojë konkurrencën e barabartë midis institucioneve financiare dhe stabilitetin e tyre financiar, veçanërisht në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve. *Acquis* i këtij kapitulli përfshin rregulla mbi licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.

4.9.2 Struktura e kapitullit

1. Bankat dhe konglomeratet financiare
2. Sigurimet dhe pensionet
3. Infrastruktura e tregut financiar

4.9.3 Kërkesat e MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Përafrimi i kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve financiare me *acquis*, lind si detyrim për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të neneve 50, 57, 70,82 dhe 89 të MSA-së.

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përmban rregulla për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve

suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve.

Përafrimi i kuadrit ligjor në fushën e shërbimeve financiare me *acquis*, lind si detyrim për përmbushjen e angazhimeve të marra në kuadër të zbatimit të neneve 50, 57, 70,82 dhe 89 të MSA-së.

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përmban rregulla për licencimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushat e veprimtarisë bankare, sigurimeve, pensioneve suplementare, shërbimet e investimeve dhe tregjet e titujve.

4.9.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Raporti i Progresit i vitit 2021 i Komisionit Evropian për Shqipërinë vuri në dukje se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Disa përparime në rekomandimet e vitit të kaluar u bënë me miratimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit për rimëkëmbjen, ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe mbikëqyrjen e bankave.

Bankat dhe konglomeratet financiare

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për hartimin e akteve të reja nënligjore dhe për rishikimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës në fuqi, duke synuar përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të Bashkimit Evropian dhe standardet e Komitetit të Bazelit në lidhje me kërkesat e Bazelit III, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjike të integritetit evropian, të tilla si Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, raportet vjetore të Komisionit Evropian, Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, objektivave strategjike, etj.

Më konkretisht, Banka e Shqipërisë ka shënuar arritje të mëtejshme në përafrimin e kërkesave të Rregullores 575/2013/EU²⁸ (CRR), si dhe të ndryshimeve më të fundit të saj nëpërmjet Rregullores 2019/876/EU (CRR2) në kuadrin rregullativ mbikëqyrës, veçanërisht për raportin e levës financiare të bankave, raportin neto të financimit të qëndrueshëm të bankave dhe ekspozimet e mëdha. Gjithashtu janë në proces

²⁸ Rregullore (BE) Nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 “Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit, dhe që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 648/2012”.



rishikimi kërkesat e rregullores së mjaftueshmërisë së kapitalit (për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e tregut), si dhe hartimi i një udhëzimi për bankat për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së likuiditetit (ILAAP).

Banka e Shqipërisë, në kuadër të përafrimit të vazhdueshëm me aktet e BE-së dhe më në veçanti me kërkesat e Bazel III:

- Miratoi me vendimin nr. 63, datë 4.11.2020, Rregulloren “Për raportin e levës financiare të bankave”, në përputhje me dispozitat e Rregullores 2019/876/EU (CRR2);

- miratoi me vendimin nr. 70, datë 2.12.2020, rregulloren “Për raportin e neto të financimit të qëndrueshëm të bankave”, në përputhje me dispozitat e Rregullores 2019/876/EU (CRR2), si dhe miratoi disa ndryshime të kësaj rregulloreje me vendimin nr. 45, datë 1.9.2021, veçanërisht në drejtim të shtimit të dy anekseve, që përmbajnë formularët e raportimit dhe udhëzuesit për plotësimin e formularëve, në përputhje me Aneksin 12 dhe 13 të EBA²⁹;

- miratoi me vendimin nr. 46, datë 1.9.2021, një ndryshim në rregulloren “Për raportin e mbulimit me likuiditet”, në lidhje me rishikimin e përkufizimit të konceptit “monedhë e rëndësishme”, në përputhje me përkufizimin e rishikuar sipas Rregullores 2019/876/EU;

- miratoi me vendimin nr. 47, datë 1.9.2021, disa ndryshime në rregulloren “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare”, që synojnë të sigurojnë praktika të drejta në treg, në lidhje me nivelin e normave të interesit, si dhe të kamatëvonesave dhe penalteteve të aplikuara, sidomos nga subjektet jobanka, për produktet e kredisë konsumatore. Për rrjedhojë, u miratuan me vendimin nr. 48, datë 1.9.2021, edhe disa ndryshime në rregulloren “Për funksionimin e regjistrimit të kredive në Bankën e Shqipërisë, si dhe kushtet dhe procedurat për njohjen, përdorimin dhe rishikimin e të dhënave që administrohen në të” në përputhje me ndryshimet e sipërpërmendura;

- ka hartuar disa ndryshime në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”, të cilat synojnë përafrimin e mëtejshëm me

Rregulloren 575/2013/EU (CRR) dhe Rregulloren 2019/876/EU (CRR2), për sa lidhet me trajtimin e rrezikut të kredisë dhe rrezikut të kredisë së kundërpartisë.

Një fokus të veçantë gjatë vitit 2021 ka pasur hartimi i kuadrit rregullativ në zbatim të dispozitave të ligjit 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”, i cili përafron aktet e BE-së (Udhëzimet e EBA-s, rregullore të BE-së, në zbatim të Direktivës 2015/2366/EU³⁰ (PSD2)) që lidhen me çështje të shërbimeve të pagesave, të trajtuar në listën e akteve të Kapitullit 4.

Gjithashtu, ka filluar puna për transpozimin e Direktivës 2014/92/EU “Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike” (PAD), si dhe të tre rregulloreve përkatëse³¹ në zbatim të saj, në kuadrin ligjor e rregullativ shqiptar. Për këtë, janë përgatitur draftet përkatëse që do të konsultohen në vijim me ofruesit e shërbimeve të pagesave. Kapitujt e Direktivës 2014/92/EU që trajtojnë kërkesat e transparencës dhe krahasueshmërisë së tarifave, si dhe të transferimit të llogarive të pagesave janë transpozuar në formën e një projektregulloreje, ndërsa kapitujt që kanë të bëjnë me aksesin në llogarinë e pagesave me shërbime bazike, janë transpozuar në formën e një projektligji.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të marrë masat e nevojshme dhe të monitorojë ndikimet e situatës së krijuar nga pandemia, në nivelin e kapitalit dhe të përfitueshmërisë së bankave dhe në veçanti në cilësinë e portofolit të kredive. Gjithashtu, në fillim të vitit 2021 u miratuan edhe disa ndryshime rregulative në lidhje me pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat, të realizuar gjatë viteve 2020 – 2021; shtyrjen e periudhës së pezullimit të klasifikimit dhe provigjionimit të kredive nga bankat, deri në fund të mars 2021; shtyrjen e hyrjes në fuqi (për në muajin janar 2022) të ndryshimeve të miratuara me vendimet 53/2020 dhe 54/2020, në lidhje me ekspozimet e mëdha dhe mbikëqyrjen e konsoliduar.

²⁹ “Implementing Technical Standards on supervisory reporting changes related to CRR2 and Backstop Regulation”.

³⁰ Directive (EU) 2015/2366 of the European Parliament and of the Council of 25 November 2015 on payment services in the internal market

³¹ Rregulloret 2018/32/EU, 2018/33/EU dhe 2018/34/EU.



Totali i aktiveve të sistemit bankar u rrit me 8.5% gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2021, si dhe aktiviteti i tij ka qenë fitimprurës (ROA shënon vlerën 1.31% dhe ROE, 12.83%). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi vlerën 18.3% në fund të shtatorit 2021. Portofoli i kredisë u rrit me pothuajse 5% dhe u shoqërua me rënien e portofolit të kredive me probleme, me 16%. Treguesi “Kredi me probleme/Totali i portofolit të kredive” arriti në nivelin 6.49%, me një rënie prej 1.62 pikë përqindje që nga fillimi i vitit 2021. Raporti i likuiditetit qëndron në një nivel mjaft të lartë prej 45.9%, kundrejt minimumit të kërkuar prej 20%.

Pjesa e mbetur e vitit 2021 dhe viti 2022 pritet të dëshmojnë rezultate të ngjashme të aktivitetit bankar me rritje të qëndrueshme, rezultat financiar pozitiv, nivele të qëndrueshme kapitali dhe raport të lartë likuiditeti. Ndërsa mund të ketë një rritje të mëtejshme të portofolit të kredisë, portofoli i kredive me probleme mund të përballet me sfida të caktuara si pasojë e pandemisë COVID, por edhe e ecurisë dhe parametrave ekonomikë në vend.

Politika makroprudenciale

Banka e Shqipërisë iu përmbajt masave me natyrë prudenciale të marra për lehtësimin e kërkesave për klasifikimin dhe provigjonimin e kredive të ndikuara nga pandemia, edhe në kushtet e ristrukturimit të tyre. Me një mundësi më të lartë të rritjes së kredive me probleme pas heqjes së këtyre masave dhe nevojën për të pasur nivele sa më të përshtatshme të kapitalit, Banka e Shqipërisë përcaktoi edhe disa kufizime lidhur me shpërndarjen e fitimit të bankave në formën e dividendit.

Përgjatë periudhës, është vlerësuar se këto masa kanë qenë të përshtatshme, duke konsideruar:

- strukturën e sektorit bankar, karakteristikat e ekonomisë dhe nevojën për të operuar me nivele relativisht më të larta të kapitalit;
- mundësinë e krijuar nga lehtësimet rregullative prudenciale që bankat të zbusin goditjen në treguesit e tyre financiare, duke përfshirë edhe nivelet e kapitalit;
- nevojën për të ruajtur hapësirën për të vepruar, në rast se kjo bëhet e nevojshme nga zhvillimet e ardhshme.

Në këto kushte, në zbatim të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, është vijuar

me publikimin e vendimeve të Guvernatorit³², për zbatimin e këtyre shtesave.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë ka vijuar me operacionalizimin e vlerave të kapitalit që mbulojnë rreziqet strukturore të sistemit financiar, si dhe konceptimin e instrumenteve që parandalojnë rritjen e tepërt të kredisë dhe të borxhmarrjes, kryesisht nga sektori i individëve.

Disa akte të reja rregullatore që janë futur në zbatim, ku përfshihen ai për raportin e mbulimit të likuiditetit, paketa e masave për de-euroizimin, si edhe rregullorja për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, synojnë zbutjen e rreziqeve dhe forcimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj tyre.

Ndërhyrja e jashtëzakonshme

Në fushën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në banka, Banka e Shqipërisë ka vijuar më tej aktivitetin e saj në drejtim të plotësimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, forcimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme nëpërmjet planifikimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe heqjes së pengesave potenciale si dhe monitorimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2021, me qëllim përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe në funksion të plotësimit të kuadrit rregullator dhe implementues për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë, miratoi:

- Me vendimin nr. 20, datë 7.04.2021, rregulloren “Për njohjen kontraktuale të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit”, e cila përafron rregulloren e Komisionit Evropian (EU) 2016/1075, të 23 mars 2016, e cila amendon Direktivën 2014/59/EU të Këshillit dhe Parlamentit Evropian.
- Me vendimin nr. 33, datë 7.07.2021, rregulloren “Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë për administrimin e aktiveve”, mbështetur në praktikën më të mira Evropiane.
- me vendimin nr. 34, datë 7.07.2021, rregulloren “Për kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të detyrimeve në

³²Mund të gjenden në adresën:

https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Instrumentet_dhe_Vendimet/



kapital”, e cila përafron udhëzuesin “Mbi raportin e konvertimit të detyrimeve në kapital gjatë rikapitalizimit nga brenda” sipas nenit 50 (4) të Direktivës 2014/59/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, EBA/GL 2017/03 e dt. 5.04.2017.

- Me vendimin nr. 35, datë 07.07.2021, rregulloren “Për llojet e marrëveshjeve që do të mbrohen në transferimin e pjesshëm” e cila përafron Rregulloren e Komisionit Evropian (EU) 2017/867 të datës 7 shkurt 2017 “Mbi klasat e marrëveshjeve që do të mbrohen në një transferim të pjesshëm sipas nenit 76 të Direktivës 2014/59/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”.

Banka e Shqipërisë, ka vijuar me zhvillimin e mëtejshëm të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe komunikimin me bankat sistemike për të monitoruar përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Banka e Shqipërisë si Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, për heqjen e pengesave potenciale lidhur me aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, të identifikuar në ciklin vjetor të planeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Për vitin 2021, planet përmbajnë një analizë më të plotë lidhur me përzgjedhjen e strategjisë së preferuar dhe instrumentit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme. Ato përmbajnë një vlerësim dhe informacion më të plotë të besueshmërisë dhe zbatueshmërisë së strategjisë së likuidimit të detyruar, duke vlerësuar nëse ndërhyrja e jashtëzakonshme plotëson testin e interesit publik. Gjithashtu, në vijim të miratimit të rregullores “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, nr. 78/2020 Banka e Shqipërisë hartoi dokumentin metodologjik të vitit 2021, për përcaktimin e kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar – MREL, sipas dokumentit të SRB “Politika e MREL, sipas paketës bankare 2020”. Në planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për vitin 2021 përcaktohet niveli i ndërmjetëm i kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, për t’u plotësuar brenda vitit 2022 si dhe kërkesa përfundimtare për vitin 2027.

Në kuadër të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme Banka e Shqipërisë monitoron rregullisht performancën e mjeteve financiare të

Fondit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, sipas raportimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave si administrator i Fondit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme.

Banka e Shqipërisë kryen përditësimin vjetor të nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe kontributeve vjetore të bankave për plotësimin e këtij niveli dhe monitorimin e administrimit të mjeteve financiare të tij. Për vitin 2021, Banka e Shqipërisë përllogariti nivelin e synuar dhe kontributet vjetore të bankave, të cilat u paguan brenda afateve rregullore.

Sigurimet dhe pensionet

Për sa i përket tregjeve nën mbikëqyrje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka vazhduar përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullativ mbikëqyrës me kërkesat e *acquis* së BE-së.

AMF gjatë vitit 2021 ka monitoruar zhvillimet në tregjet nën mbikëqyrje dhe ka vlerësuar rregullisht ndikimin e pandemisë në këto tregje, të cilat u përballën me sfida të reja. Në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të tij, AMF vijoi punën për mbikëqyrjen efektive dhe rregullimin e tregjeve, bazuar në “Procedurën e Mbikëqyrjes në Raste Krizash” të Autoritetit.

Përsa i përket tregut të sigurimeve, AMF ka vijuar ta mbikëqyrë dhe analizojë, duke vlerësuar pozicionin financiar të shoqërive që operojnë në këtë treg, si në nivel individual ashtu edhe në tërësi për të gjithë tregun. Situata financiare e shoqërive të sigurimit u paraqit me një nivel të përshtatshëm likuiditeti, duke ruajtur treguesit financiarë në nivel tregu.

Në përmbushje të rekomandimit Raportit të KE-së u miratua Ligji Nr. 32/2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, nga Kuvendi i Shqipërisë më 16.03.2021 dhe hyri në fuqi më 1.07.2021. Ligji u hartua në përputhje me Direktivën 2009/103/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009, për sigurimin e përgjegjësisë civile në lidhje me përdorimin e mjeteve motorike dhe për zbatimin me forcë të detyrimit për të marrë një sigurim të tillë.

Në zbatim të Ligjit nr. 32/2021 si me lartë cituar, janë hartuar dhe miratuar rregulloret e mëposhtme:

- Rregullore nr. 191, datë 26.10.2021 “Mbi administrimin e fondit të kompensimit”.



- Rregullore nr. 190, datë 26.10.2021 “Mbi administrimin e fondit të garancisë dhe rregullat e trajtimit të dëmeve të kartonit jeshil”.

- Rregullore nr. 189, datë 26.10.2021 “Për komisionet e ndërmjetësimit”.

- Rregullore nr. 126, datë 28.07.2021 “Për llogaritjen e fondit të kompensimit si dhe rastet e prekjës, të ndërhyrjes dhe rivendosjes së vlerës minimale të fondit të kompensimit”.

- Rregullore nr. 125, datë 28.07.2021 “Për përcaktimin e rregullave dhe metodologjisë së llogaritjes së dëmshpërblimit që mbulohet nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

- Rregullore nr. 105, datë 30.06.2021 “Për regjistrin elektronik të dëmeve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.

- Rregullore nr. 104, datë 30.06.2021 “Për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Shqiptare të Sigurimit”.

- Rregullore nr. 103, datë 30.06.2021 “Për mënyrën e administrimit dhe pagesave të dëmeve fond kompensimi me datë aksidenti përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 32/2021”.

AMF ka vazhduar bashkëpunimin me konsulentët e Bankës Botërore për zbatimin e projektit të financuar nga SECO, “Përmirësimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare -“Fokus Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve”.

AMF ka hartuar projektligjin “Për fondet e pensionit privat” me qëllim përafrimin e projektligjit me Direktivën (BE) 2016/2341 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 14 dhjetor 2016 për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II). Projektligji është dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të vazhduar procesi i miratimit.

Me qëllim edukimin financiar të konsumatorit/investitorit për tregjet nën mbikëqyrje, AMF ka ngritur një grup pune brenda institucionit për të hartuar strategjinë për Edukimin Financiar të popullatës për tre vitet e ardhshme. Strategjia do të përcaktojë prioritetet e AMF në këtë drejtim dhe ka për qëllim të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë të sigurt, transparente dhe efikase, për të lehtësuar qasjen në produktet financiare.

Infrastruktura e tregut financiar

AMF ka intensifikuar vazhdimisht përpjekjet për të përmirësuar infrastrukturën dhe për të krijuar një bazë të nevojshme rregullatore për zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar jobankar. Sipas angazhimeve në kuadrin e MSA-së, AMF ka vazhduar punën për përmirësimin dhe përafrimin e legjislacionit ekzistues me direktivat e BE-së.

Miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ligjeve të rëndësishme në fushën e tregjeve të kapitalit dhe të fondeve të investimit, Ligji Nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, Ligji Nr. 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, Ligji Nr. 66/2020 “Për Tregjet Financiare bazuar në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë”, forcojnë mbikëqyrjen dhe rregullimin e këtyre tregjeve, si dhe përmirësojnë ndjeshëm kuadrin ligjor të fushës.

Ligjet e reja në fushën e tregut të kapitaleve dhe fondeve kanë për synim nxitjen e zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve, sigurimin e integritetit të tyre dhe rritjen e transparencës në funksion të mbrojtjes së interesave të investitorëve. Këto ligje përbëjnë bazën për mundësi të reja të financimit për biznesin, alternativa të reja investimi, nxitjen e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri, duke ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit dhe ruajtjen e një sistemi financiar të qëndrueshëm. Domosdoshmëria e këtyre ligjeve lidhet ngushtë edhe me procesin e integritetit evropian të Shqipërisë. Ligjet janë hartuar në përputhje me direktivat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian në fushën e tregut të kapitaleve dhe fondeve.

Miratimi i Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit” solli përmirësim të kuadrit ligjor dhe rregullativ. Ligji ka si qëllim rregullimin e tregjeve të kapitalit, mënyrës dhe kushteve për ofrimin, blerjen dhe shitjen e instrumenteve financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcaktimin e procedurave për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve të instrumenteve financiare.

Ky ligj i përgjigjet si realitetit shqiptar ashtu edhe dinamikës së kërkesave të tregjeve evropiane.

Gjatë vitit 2021, në zbatim të paketës së re ligjore AMF miratoi akte nënligjore të rëndësishme në fushën e tregjeve të kapitalit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive. Në vijim po punohet për plotësimin e kuadrit rregullator të ligjit të ri “Për Tregjet e Kapitalit” edhe me asistencën teknike të Projektit “Forcimi i Kapaciteteve



Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me fokus Zhvillimin i Tregut të Kapitaleve”. Ky projekt do të mbështesë Autoritetin në forcimin e kapaciteteve të tij në rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve.

Në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, AMF me vendimin nr. 127, datë 28.07.2021 miratoi disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”.

Miratimi i Ligjit nr. 56/2020, shënon një hap të rëndësishëm në përmirësimin e mëtejshëm të bazës ligjore që rregullon këtë fushë, adreson më mirë kërkesat e tregut, standardet evropiane, si dhe siguron mbrojtje më të mirë të investitorëve.

Ligji nxit zhvillimin e tregut nëpërmjet ofrimit dhe rregullimit të disa formave të reja të fondeve të investimit, siç janë fondet kryesore, fondet furnizuese apo fondet ombrellë, apo fondet alternative të investimit. Zhvillimi i tregut të fondeve, nxit paralelisht edhe zhvillimin e tregut të kapitaleve, pasi këto fonde janë një investitor institucional shumë i rëndësishëm për këtë treg.

Bordi i Autoritetit ka miratuar të gjitha rregulloret e parashikuara në Ligjin nr. 56/2020 datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”. Rregulloret janë konsultuar me grupet e interesit dhe subjektet që veprojnë në këtë treg. Gjatë vitit 2021 janë miratuar rregulloret e mëposhtme:

- Rregullore nr. 108, datë 30.06.2021 “Për sipërmarrjet dhe nënfondet kryesore dhe furnizuese”.

- Rregullore nr. 107, datë 30.06.2021 “Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve”.

- Rregullore nr. 106, datë 30.06.2021 “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”.

- Rregullore nr. 2, datë 27.01.2021 “Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët”.

Në zbatim të Ligjit nr. 66/2020 “Për Tregjet Financiare të Bazuara në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë” po punohet për hartimin e rregulloreve.

Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE) filloi veprimtarinë e saj në 22 Shkurt 2018, me kufizimin për të tregtuar vetëm tituj të Qeverisë gjatë vitit të parë të veprimtarisë. Edhe pse ky kufizim është hequr që prej muajit shkurt të vitit 2019, titujt e Qeverisë janë i vetmi instrument financiar që tregtohen aktualisht në Bursë. Aktualisht 3 anëtarë tregtojnë në Bursën e Titujve për llogari të portofolit apo klientëve të tyre (3 banka). Volumi i tregtimit gjatë periudhës shkurt 2018 – shtator 2021 arriti në rreth 26.7 milionë Euro, ku kanë dominuar transaksionet e kryera midis bankave, në emër të klientëve institucionalë të tyre.

Në fund të vitit 2019 shoqëria aksionare “Registri Shqiptar i Titujve” – ALREG u licencua nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare (AMF) për kryerjen e funksionit të klerimit dhe të titujve që do të tregtohen në Bursë. Krijimi i një institucioni të tillë, i cili luan rolin e një Depozitari Qendror të Titujve, është një hap i rëndësishëm drejt krijimit të infrastrukturës së plotë të tregut të kapitalit.

Me miratimin nga Bordi i Autoritetit të vendimit Nr. 56, datë 26.03.2021 “Për miratimin paraprak të rregullores të Fondit të Garancisë së shoqërisë “Registri Shqiptar i Titujve, ALREG” sh.a., u hodhën bazat për të siguruar përmbushjen me sukses të procesit të shlyerjes për transaksionet e kryera në Bursë.

Duke filluar nga tetori 2019, ALREG ka regjistruar 8 emetime të obligacioneve me ofertë private me një vlerë rreth 30 milionë Euro. Me anëtarësimin në muajin mars 2021 të ALREG si pjesëmarrës indirekt në sistemin AIPS të Bankës së Shqipërisë, infrastruktura e pas-tregtimit është bërë tërësisht operationale.

4.9.5 Lista e Ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD)
- Instituti i Statistikave (INSTAT)

4.9.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet



Mangësitë e identifikuar nga Banka e Shqipërisë

Sipas Raportit të Progresit të vitit 2021 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, në lidhje me Kapitullin 9, rekomandohet që Shqipëria të përafrojë kuadrin rregullativ me kuadrin e BE-së në lidhje me kërkesat për kapital, që korrespondojnë me Bazel III dhe të vazhdojë zbatimin e politikës makroprudenciale dhe të kuadrit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Në këtë aspekt, evidentohet se kuadri rregullativ i Bankës së Shqipërisë nevojitet të përafrohet në mënyrë të vazhdueshme me kuadrin e BE-së, dhe veçanërisht me aktet më të fundit të miratuara apo të përditësuara nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian apo Autoriteti Bankar Evropian (EBA). Më konkretisht, i referohemi përafrimit me kërkesat e Rregullores 2019/876/EU (CRR2) që ndryshon Rregulloren 575/2013/EU (CRR), në lidhje me raportin e levës financiare, raportin neto të financimit të qëndrueshëm, kapitalin rregullator dhe detyrimet e pranuar, rrezikun e kredisë së kundërpatisë, rrezikun e tregut, ekspozimet ndaj kundërparsive qendrore, ekspozimeve ndaj sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ekspozimet e mëdha, raportimet dhe publikimin e informacionit. Banka e Shqipërisë gjatë dy viteve të fundit ka transpozuar në vazhdimësi një pjesë të konsiderueshme të kërkesave të Rregullores 2019/876/EU, veçanërisht në lidhje me kërkesat për raportin e levës financiare, raportin neto të financimit të qëndrueshëm, ekspozimet e mëdha, etj.

Për të plotësuar mangësitë e evidentuara, bazuar edhe në rekomandimin e Raportit të Progresit të vitit 2021 dhe në prioritetet e renditura në vijim, parashikohet që gjatë periudhës afatmesme 2022-2024, Banka e Shqipërisë të vijojë me përafrimin e kuadrit rregullativ me kërkesat e Rregullores 575/2013/EU dhe 2019/876/EU, por edhe të dokumenteve të tjera të BE-së apo Bazelit, në lidhje me kapitalin rregullator dhe rreziqet e Shtyllës I, që do të plotësojnë më tej kërkesat e Bazel III.

Gjithashtu gjatë vitit 2022 parashikohet të finalizohet puna për transpozimin e Direktivës 2014/92/EU “Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e

pagesave me karakteristika bazike” si dhe të tre rregulloresve përkatëse në zbatim të saj.

Prioritetet e Bankës së Shqipërisë:

- Përafrimi i kuadrit rregullator e metodologjik me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përshtatja e parimeve të Komitetit të Bazelit dhe adresimi i problematikave të vërejtura dhe sugjerimeve të paraqitura nga ana e subjekteve të mbikëqyrura.

- Në periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë synon të punojë për zgjerimin dhe përmirësimin e instrumenteve makroprudenciale, paralelisht me zhvillimet e tregut financiar dhe rreziqeve të mundshme. Në këtë drejtim, fokusi afatshkurtër është operacionalizimi i Shtesës Sistematike të Rrezikut (SyRB) dhe në ndërtimin e kuadrit rregullator për përdorimin e instrumenteve të bazuara në huamarrës si kufijtë e LTV dhe DTI.

- Harmonizimi i vazhdueshëm i politikës monetare, fiskale dhe makroprudenciale.

- Përafrimi i kuadrit rregullator dhe metodologjik me kuadrin rregullator dhe metodologjik dhe praktikën e mira të Bashkimit Evropian në funksion të rritjes së kapacitetit implementues dhe forcimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në banka. Për vitin 2022, në zbatim të rregullores nr. 78/2020 “Për përcaktimin e kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar” do të përditësohet metodologjia për përcaktimin e kërkesës minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar, për ciklin e vitit 2022.

Prioritetet e AMF-së janë:

- Nxitja e qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet mbikëqyrjes efektive të tregjeve;

- Plotësimi i kuadrit ligjor/rregullator dhe zhvillimi i tregjeve;

- Rritja e kapaciteteve mbikëqyrëse përmes projekteve të asistencës teknike;

- Mbrojtja e personave të siguruar dhe investitorëve.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë janë institucione të pavarura të cilat financohen nga të ardhurat e veta dhe jo nga Buxheti i Shtetit.



KAPITULLI 10: SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA

4.10.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë kapitull përfshin rregulla specifike për komunikimet elektronike, shërbimet e shoqërisë së informacionit, në veçanti tregtinë elektronike, shërbimet e aksesit të kushtëzuar dhe shërbimet audiovizive. Në fushën e komunikimeve elektronike *acquis* e Bashkimit Evropian, synon të eliminojë pengesat për funksionimin efektiv të tregut të brendshëm në shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit, të promovojë konkurrencën dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në këtë sektor, duke përfshirë disponueshmërinë e shërbimeve universale moderne. Për sa i përket politikës audio-vizuale, *acquis* kërkon përafrimin ligjor me Direktivën e Televizionit pa Kufij, e cila krijon kushtet për lëvizjen e lirë të transmetimeve televizive brenda BE-së. Gjithashtu, *acquis* synon krijimin e një kuadri rregullator transparent, të parashikueshëm dhe efektiv për transmetimet publike dhe private në përputhje me standardet evropiane dhe kërkon kapacitet për të marrë pjesë në programet komunitare Media Plus dhe Media Training.

4.10.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 10, shoqëria e informacionit dhe media përbëhet nga tre fusha bazë si më poshtë:

- Komunikimet elektronike dhe teknologjitë e informacionit;
- Shërbimet e shoqërisë së informacionit;
- Politika audiovizuale

4.10.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Nenet 102-104 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, parashikojnë detyrimin për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE-së dhe harmonizimin me politikën e BE-së. Neni 102 i MSA parashikon bashkëpunimin në fushën audio-vizuale. Kjo përfshin një detyrim që Shqipëria të harmonizojë politikën e saj në rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimit ndërkufitar me standardet dhe legjislacionin e BE-së. Gjithashtu kërkon që vëmendje e veçantë t'i kushtohet respektimit të të drejtave të pronësisë intelektuale në transmetimin e programeve me mjete të ndryshme, përfshirë tokësore, satelitore, kabllorë etj. Ndryshimet e shpejta në teknologjinë e mediave, realitetin aktual të televizionit digjital në Shqipëri dhe përditësimin e legjislacionit me

standardet dhe praktikën më të mira evropiane në këtë fushë, kanë shërbyer si një nxitje e fuqishme për të ndërmarrë hapat e duhur në krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe një vizioni afatgjatë të qasjeve rregullatore. Neni 103 i MSA mbulon bashkëpunimin në fushën e shoqërisë së informacionit. Neni 104 i Marrëveshjes së Stabilizimit-Asocimit mbulon bashkëpunimin që fokusohet në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.

Pjesa kryesore e *acquis* në fushën e komunikimeve elektronike përbëhet nga Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike, direktiva 2018/1972/EU e miratuar në dhjetor 2018, e cila ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Kodi përfshin masa për nxitjen e investimeve në rrjetet e kapaciteteve shumë të larta, rregulla të reja për spektrin e frekuencave dhe rrjetet celulare 5G, ndryshime në regjimin e shërbimit universal, rregulla për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave. Përveç Rregullores së re të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme, që hyri në fuqi në Maj 2018, rregullat e e-privatësisë në komunikimet elektronike janë duke ndryshuar³³. Pjesë e rëndësishme legjislative është gjithashtu Direktiva për sigurinë e sistemeve të rrjetit dhe informacionit.

Në fushën e politikës audiovizuale, pjesa kryesore legjislative është Direktiva 2010/13/BE për shërbimet audiovizive, që mbulon transmetimet televizive tradicionale dhe shërbimet mediatike audio-vizuale në kërkesë dhe vendos një sërë rregullash minimale për të dy llojet e shërbimeve. Më datë 14 nëntor 2018, Këshilli i BE-së ka miratuar ndryshimet në Direktivën 2010/13/BE me Direktivën 2018/1808/EU “mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive), në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut”. Këto ndryshime përfshijnë disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të minoreneve; rregulla të reja për platformat e shpërndarjes së videove, promovimin e punëve evropiane etj.

³³ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52017PC0010>



Në lidhje me fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias, nga Bashkimi Evropian janë adoptuar ose janë në proces akte ligjore të reja, të cilat bazohen në zhvillimet e fundit të ekonomisë digjitale.

4.10.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Kapitulli 10, shoqëria e informacionit dhe media përbëhet nga tre fusha bazë si më poshtë:

- Komunikimet elektronike dhe teknologjitë e informacionit;
- Shërbimet e shoqërisë së informacionit;
- Politika audiovizuale.

Legjislacioni shqiptar në fuqi për komunikimet elektronike, shoqërinë e informacionit, dhe median audiovizive, i zhvilluar nga viti 2008 e në vijim, është bazuar në *acquis* të BE-së për këtë kapitull.

Në fushën e komunikimeve elektronike, Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është ligji bazë për rregullimin e veprimtarisë në fushën e komunikimeve elektronike, dhe përcaktimin e rregullimeve specifike për shërbimet dhe rrjetet e telekomunikacionit në përputhje me *acquis* të BE-së.

Ky ligj ka transpozuar paketën e direktivave të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2002, të amenduara në vitin 2009, si më poshtë:

- Direktivën 2002/19/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për aksesin dhe interkoneksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të faciliteteve që lidhen me to (Direktiva e Aksesit);
- Direktivën 2002/20/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (Direktiva e Autorizimit);
- Direktivën 2002/21/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva Kuadër);
- Direktivën 2002/22/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 7 mars 2002, për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (Direktiva e Shërbimit Universal);

- Direktivën 2002/58/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 12 korrik 2002, për trajtimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva për privatësinë dhe komunikimet elektronike);

- Direktivën e Komisionit 2002/77/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 16 shtator 2002, për konkurrencën në tregje për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike;

- Direktivën 2009/136/KE dhe 2009/140/KE që kanë amenduar respektivisht direktivat e vitit 2002 (Direktivën 2002/19/KE, Direktivën 2002/20/KE, Direktivën 2002/21/KE, Direktivën 2002/22/KE dhe Direktivën 2002/58/KE).

Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, është një tjetër ligj i rëndësishëm për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, i cili ka transpozuar Direktivën 2014/61/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 15.5.2014, “mbi masat për reduktimin e kostonë së vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë”.

Legjislacioni kombëtar në fushën e komunikimeve elektronike, përfshin dhe një numër aktesh nënligjore, vendime të Këshillit të Ministrave dhe Rregullore të miratuara nga AKEP, për rregullime specifike të lidhura me sektorin e komunikimeve elektronike/telekomunikacionet dhe që janë në harmoni e të mbështetura në *acquis* dhe praktikën e BE-së për këtë fushë sikurse:

- VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimi” që ka transpozuar vendimin e BE-së nr. 243/2012;

- VKM nr. 1187 dt. 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” që bazohet në Planin Evropian të Alokimeve (ECA 2020);

- Udhëzimi i Ministrit nr. 7 dt. 22.10.2019, “për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të menaxhimit të trafikut të komunikimeve si dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve”, që ka transpozuar pjesërisht Rregulloren (BE)



2015/2120 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 25 nëntor 2015, që përcakton masat në lidhje me një akses të lirë të Internetit dhe që modifikon Direktivën 2002/22/KE të shërbimit universal dhe të të drejtave të përdoruesve në fushën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik, si dhe rregulloren (BE) nr. 531/2012 në lidhje me shërbimin roaming në rrjetet publike të komunikimeve mobile brenda Bashkimit Evropian;

- Plan i Përdorimit të Frekuencave, miratuar nga AKEP në harmoni me praktikën evropiane dhe përdorimet në CEPT;

- Rregullore e AKEP nr. 47, datë 26.10.2017 “Për zbatimin e Autorizimit të Përgjithshëm” në përputhje me Direktivën 2002/20/EC dhe Direktivën 2002/21/EC;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1187, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, plotësisht në përputhje me Direktivën 2009/114/EC; Direktivën 2005/82/EC dhe Vendimin 676/2002/EC;

- Rregullorja e AKEP-it Nr. 30, datë 05.12.2013, “Për dhënien e autorizimit individual për përdorimin e frekuencave”;

Vendim i Këshillit Drejtues të AKEP-it nr. 932, datë 11.08.2009 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Numeracionit”, i ndryshuar;

- Rregullorja e AKEP-it Nr. 10, datë 11. 08. 2009 “Për përcaktimin e numrave dhe serive numerike”, e ndryshuar;

- Rregullore nr. 33 datë 15.05.2014 “Për kushtet e përdorimit të frekuencave pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren në këto breza”;

- Rregullore nr. 43 datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” e ndryshuar;

- Rregullore nr. 35, datë 10.09.2015 “Rregullat për përdorimin e përbashkët të faciliteteve dhe aseteve të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike”;

- Rregullore nr. 37, datë 19.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;

- Rregullorja nr. 16, datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”;

- Rregullorja nr. 9, datë 17.07.2009 “Për

analizën e tregut”, ndryshuar me Vendim të Bordit Drejtues nr. 2342, datë 31.07.2013, në përputhje me Rekomandimin 2007/879/EC dhe udhëzimet e Komisionit mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së rëndësishme të tregut në kuadrin rregullator të Komunitetit për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, (2002/C 165/03);

- Rregullore nr. 32, datë 26.12.2013, “Rregulla dhe Udhëzime për Ndarjen e Llogarive dhe Llogaritjen e Kostos për Sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT)”, plotësisht në përputhje me Rekomandimin 2005/698/EC dhe Rekomandimin 2009/396/EC;

- Rregullore nr. 19, datë 14.06.2010, “Për aksesin dhe interkoneksionin”;

- Rregullore “Për zbatimin e FUP dhe qëndrueshmërinë e RLAH me Ballkanin Perëndimor”, miratuar me Vendimin e KD të AKEP nr. 9 datë 9.6.2021;

- Rregullore nr. 49 datë 11.3.2021 “për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike etj.

Një listë e plotë e rregulloreve të miratuara nga AKEP, në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, jepet në linkun më poshtë:

<https://akep.al/vendime-akte/komunikimet-elektronike/>;

Në fushën e shoqërisë së informacionit, kuadri ekzistues ligjor përfshin:

- Ligjin nr. 10128 datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike” i ndryshuar, i cili ka transpozuar Direktivën 2000/31/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 8 qershor 2000, “për disa aspekte juridike të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, sidomos të tregtisë elektronike, në Tregun e Brendshëm (Direktiva për Tregtinë Elektronike)”;

- Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik” ndryshuar me Akt Normativ nr. 8, datë 30.9.2009 “Për nënshkrimin elektronik”, i cili ka transpozuar Direktivën 1999/93/KE;

- Ligjin Nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike” që ka transpozuar Rregulloren e (BE) nr. 910/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 korrik 2014



për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm;

- Direktiva 98/84/KE për shërbimet e aksesit të kushtëzuar është transpozuar në Ligjin nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike ka transpozuar pjesërisht Direktivën nr. 2016/1148/BE të datës 6 korrik 2016, mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në BE;

- Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, i cili transponon direktivën 2001/29/KE për të drejtën e autorit në shoqërinë e informacionit, Direktivën 93/83/KEE për të drejtat e autorit në transmetimet radio-televizive, etj.

Në fushën e shoqërisë së informacionit janë të miratuara disa akte ligjore e nënligjore të lidhura me e-qeverisjen, shërbimet publike elektronike, etj. Një pjesë e tyre si: Ligji për dokumentin elektronik, Ligji për databazat shtetërore, Ligji për konsultimin publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave për politikat për të dhënat e hapura, etj., nuk transpozojnë ndonjë *acquis* të veçantë të BE-së, por janë të mbështetura në praktika të vendeve evropiane për zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Kuadri i interoperabilitetit i miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është në përputhje me kuadrin evropian të interoperabilitetit. Është miratuar VKM nr. 1147, datë 9.12.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Portali unik qeveritar e-albania” dhe për miratimin e rregullave “Për mënyrën e funksionimit të pikës së vetme të kontaktit”, e cila përcakton kërkesat e nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore të pikës së vetme të kontaktit për shërbime elektronike në Republikën e Shqipërisë (e-albania) si porta e vetme digjitale për t’u lehtësuar ofruesve dhe përfituesve të shërbimeve aksesin në informacion, procedura elektronike dhe asistencë efektive në përfitimin e shërbimeve.

Po kështu projektligji “Mbi të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i propozuar për miratim nga Këshilli i Ministrave me VKM nr. 796 datë 12.10.2020, synon transpozimin e pjesshëm të Direktivës (BE) 2019/1024 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

të 20 qershorit 2019 “Mbi të dhënat e hapura dhe ri-përdorimin e informacionit të sektorit publik”. VKM Nr. 553, datë 15.07.2020, “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit” është e mbështetur në praktikën e BE-së.

Në fushën e medias audiovizive kuadri ligjor ekzistues përfshin:

- Ligjin nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar i cili ka transpozuar Direktivën 2010/13/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 10 mars 2010, për bashkërendimin e dispozitave të caktuara të përcaktuara me ligj, akt normativ apo vendim administrativ në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve të medias audiovizive (Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive);

Një numër rregulloresh janë miratuar nga AMA në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Kuadri institucional në kapitullin 10 përfshin:

- institucionet përgjegjëse për politikat dhe rregullimin e sektorit të komunikimeve elektronike/telekomunikacionit: Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë (MIE) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);

- institucionet për fushën e shoqërisë së informacionit: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP për zhvillimin e rrjeteve broadband, si dhe institucione të tjera kontribuuese në aspekte të ndryshme si për tregtinë elektronike, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, për aksesin e kushtëzuar, AMA-n, Ministrinë e Kulturës për të drejtën e autorit në shoqërinë e informacionit etj.;

- Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA), si organi rregullator në fushën e medias audiovizive në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKEP në çështjet e lidhura me planin kombëtar të frekuencave për rrjetet e



komunikimeve elektronike për transmetimet audiovizive, etj.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian, i ngarkuar me Kapitullin 10 (Shoqëria e Informacionit dhe Media), kryesohet nga Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë (MIE), si institucioni përgjegjës për politikën në sektorin e telekomunikacionit/komunikimeve elektronike, me të cilat lidhet dhe pjesa më e madhe e *acquis* të këtij kapitulli bazuar në LGA-në e kapitullit 10.

Në këtë kapitull janë kontribuues të rëndësishëm në seksionet respektive organet rregullatore Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për rregullimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA), për rregullimin e medias audiovizive. Në seksionin e shoqërisë së informacionit, kontributi kryesor vjen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për zhvillimin e shërbimeve elektronike publike, dhe nga AKCESK në zbatim të legjislacionit përkatës për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara dhe sigurinë kibernetike. Në lidhje me fushën e politikës audiovizuale dhe zbatimin e ligjit nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, roli kryesor është tek Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA).

Bazuar në raportin e fundit të BE-së, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim në Bashkimin Evropian përsa i përket shoqërisë së informacionit dhe medias audio-vizuale. Gjatë vitit 2020 progres është bërë me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Cybersecurity dhe planit të saj të veprimit 2020 – 2025, miratimin e planit të veprimit të Digjital Agjenda 2020 – 2022, miratimin e Planit Kombëtar të Broadbandit 2020 – 2025 si dhe miratimin e Politikës Spektrale që transpozoi vendimin e BE-së nr. 243/2012/KE. Legjislacioni për komunikimet elektronike është bazuar në paketën e direktivave të vitit 2002 dhe 2009. Me miratimin e ligjit 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” në vitin 2008, u eliminuan pengesat për sipërmarrësit ndaj hyrjes në tregun shqiptar të komunikimeve elektronike duke siguruar:

- të drejtën e çdo sipërmarrësi për të ofruar rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, për të përmbushur kërkesat e autorizimit të përgjithshëm si edhe ato të

autorizimit individual, të nevojshme vetëm në rastin e përdorimit të burimeve të fundme (frekuenca dhe numra);

- një mjedis rregullator të përshtatshëm, që respekton parimin e paanshmërisë teknologjike;

- futjen në treg të ‘lojtarëve’ të rinj pa kërkuar përdorimin e burimeve të fundme, çka realizohet me procedura të thjeshta dhe të shpejta, pa qenë nevoja e ndonjë vendimi specifik paraprak;

- dhënien e të drejtave të përdorimit burimeve të kufizuara përmes procedurave transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale.

E ndërgjegjshme për rolin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në zhvillimin e shoqërisë dhe rritjen ekonomike, në promovimin e pjesëmarrjes përfshirëse dhe qeverisjes efikase, në respektimin dhe kontributin që jep në përmbushjen e parimeve bazë që shërbejnë për demokraci cilësore, shtet ligjor funksional si dhe përfaqësim politik transparent, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash për zhvillimin e shoqërisë së informacionit. Në përmbushje të angazhimeve të MSA-së, që rrjedhin nga nenet 102, 103 dhe 104 të saj, është punuar për planifikimin dhe implementimin e politikave në fushën e telekomunikacioneve dhe shoqërisë së informacionit. Strategjia ndërsektoriale për Agjendën Digjitale 2015 – 2020, e miratuar në prill 2015, përbënte një dokument strategjik për zhvillimet në të ardhmen në Shqipëri në drejtim të një ekonomie të bazuar në njohuritë. Me vendimin e KM nr. 1081, datë 24.12.2020, është miratuar plani i veprimit të strategjisë ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë”, 2020 – 2022.

Në fushën e komunikimeve elektronike, me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 434, datë 3.6.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020 – 2025”, është miratuar Plan i ri Kombëtar Broadband.

Me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe plani i veprimit” është miratuar dokumenti i politikës spektrale i cili ka bërë transpozimin e vendimit të BE-së 243/2012/EU për miratimin e një programi shumëvjeçar për spektrin radio.

Gjatë vitit 2018 u amendua ligji për komunikimet elektronike për t’i hapur rrugë rregullimit të tarifave të roaming-ut nga AKEP mbi



bazën e marrëveshjeve bilaterale, multilaterale. Më datë 1 korrik 2021, u realizua zbatimi i plotë “roaming si në shtëpi” (RLAH) për vendet e Ballkanit Perëndimor. Tashmë në vendet e rajonit funksionon “roaming si në shtëpi”, bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian për RLAH.

Me vendimin e politikës spektrale të miratuar me VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe plani i veprimit”, është përcaktuar afati për lirim të Digjital Divident 2, më 30 qershor 2022, sipas afatit maksimal në BE.

Në fushën e shoqërisë së informacionit, ka progres në digjitalizimin dhe zhvillimin e shërbimeve elektronike. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit është fuqizuar. Zbatimi i agjendës digjitale të Shqipërisë dhe planit kombëtar për zhvillimin e broadband vazhdon. Shërbimet elektronike të ofruara institucioneve publike dhe qytetarëve janë rritur. Aktualisht është në konsultim publik projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Agjendës Digjitale 2021+ dhe Planit të Veprimit 2021+”.

Mbi bazën e praktikës së BE-së, është hartuar draft Strategjia për 5G për Shqipërinë dhe është në proces rishikimi. Gjithashtu, po vijon puna për transpozimin e direktivës së re të Kodit të Komunikimeve Elektronike EECC (Direktiva 2018/1972/EU), parashikuar për t’u përfunduar brenda vitit 2022.

Në lidhje me Direktivën 2013/37/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 26 qershor 2013, që amendon Direktivën 2003/98/EC mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, është hartuar projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorim të informacionit të sektorit publik”. Me Vendimin e KM nr. 796 datë 12.10.2020, është propozuar për miratim projektligji “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, dhe është dërguar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë.

Në fushën e medias është finalizuar procesi i switchover-it dhe kalimit të plotë në transmetime numerike, në dhjetor 2020. Aktualisht, transmetimet televizive digjitale janë të aksesueshme në të gjithë territorin dhe sigurojnë cilësi të lartë dhe një numër të madh të programeve televizive pa pagesë.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) ka kryer një analizë vlerësimi për sigurinë kibernetike në Shqipëri sipas modelit Cyber Maturity Model (CMM), në kuadër të programit të Bankës Botërore për ndërtimin e kapaciteteve globale për sigurinë kibernetike. Raporti mbi nivelin e maturisë së Shqipërisë për sigurinë kibernetike është publikuar nga AKCESK në 1 mars 2019.³⁴ Strategjia për sigurinë kibernetike është miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 1084, datë 24.12.2020 “Mbi miratimin e Strategjisë Kombëtare për sigurinë kibernetike dhe planin e veprimit 2020 – 2025”. Gjithashtu është miratuar VKM Nr. 553, datë 15.07.2020, “Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit”.

4.10.5 Lista e ministrive dhe institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për kapitullin 10 janë Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE) dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI);

Institucione të tjera kontribuuese janë:

- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP);
- Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA);
- Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK);
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Instituti i Statistikave;
- Radio Televizioni Shqiptar;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Kulturës;
- Kuvendi i Shqipërisë.

4.10.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” përmban një numër të konsiderueshëm aktesh ligjore si direktiva, vendime, rregullore si dhe soft law si komunikata, rekomandime etj.

Rregullimet kryesore për komunikimet elektronike të miratuara me kuadrin ligjor ekzistues

³⁴ <https://cesk.gov.al/pu>
[blicAnglisht_html/Publikime/2019/AlbaniaCMMReport.pdf](https://cesk.gov.al/pu/blicAnglisht_html/Publikime/2019/AlbaniaCMMReport.pdf)



janë të mbështetura në paketën e direktivave të vitit 2002 dhe 2009 për komunikimet elektronike (Direktiva 2002/19/KE) për aksesin dhe interkoneksionin e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të faciliteteve që lidhen me to, Direktiva 2002/20/KE për autorizimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, Direktiva 2002/21/KE për kuadrin e përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, Direktiva 2002/22/KE për shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesit lidhur me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, të ndryshuara në vitin 2009, janë zëvendësuar nga Direktiva 2018/1972/EU, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike (EECC).

Lista e *acquis* për komunikimet elektronike përfshin një numër të madh vendimesh të BE-së (mbi 70), që lidhen me përdorimin e spektrit të frekuencave në breza dhe nënbreza të caktuar. Aktualisht rregullimet për spektrin e frekuencave përfshijnë dispozitat e ligjit për komunikimet elektronike për frekuencat, Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave, si dhe dokumentin e politikës spektrale, të cilat janë në harmoni me praktikën dhe *acquis* të BE-së, por nuk ka akte të veçanta për transpozimin e vendimeve specifike për frekuencat. Është e nevojshme që të analizohen të gjitha vendimet e BE-së për spektrin e frekuencave, sipas listës së LGA-së dhe të shikohet mënyra më e mirë e transpozimit të tyre në kuadrin ligjor kombëtar.

Lista e *acquis*, për kapitullin 10, përmban një numër të madh aktesh të reja të adoptuara nga BE, ose në proces dhe që lidhen me ndryshimet teknologjike. Gjithashtu një pjesë e *acquis* janë në një proces dinamik përditësimi periodik, sikurse *acquis* për komunikimet elektronike, vendimet për spektrit e frekuencave, direktiva për median audiovizive etj. Për një pjesë të *acquis* të re në këtë kapitull që lidhen me zhvillimet digjitale, si platformat digjitale, intelijenca artificiale, etj. për shkak të ndërthurjes që ato kanë me disa sektorë, institucione, është e nevojshme një analizë e detajuar.

Prioritetet normative afatshkurtra dhe afatmesme përfshijnë adresimin e rekomandimeve të BE-së për përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së të Kapitullit 10, në përputhje me zhvillimet e *acquis* të BE-së dhe Agjendën Digjitale.

Bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian në raportin “Shqipëria 2021”, prioritetet e Kapitullit 10 synojnë si më poshtë vijon:

- Transpozimin e Direktivës 2018/1972/EU, Kodi Evropian i Komunikimeve Elektronike të BE, përmes rishikimit të ligjit “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

- Transpozimin e Direktivës 2018/1808/EU mbi koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizive (Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizive) në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut, në Ligjin Nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën E Shqipërisë” i ndryshuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe aktorë të tjerë të përfshirë në proces do të punojnë për transpozimin e kësaj direktive;

- Miratimin e Strategjisë së re për Agjendën Digjitale.

KAPITULLI 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

4.11.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 11 i bujqësisë përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore (PPB). Politika e PPB-së kërkon ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe cilësisë të tilla si agjencia e pagesave, sistemi i integruar dhe i kontrollit të pagesave (IACS), dhe kapaciteti për të zbatuar masat e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte të fermave dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Anëtarësimi në BE kërkon integrimin në Organizimin e Tregut të Përbashkët për një sërë produktesh bujqësore, përfshirë bimët e arave, sheqerin, produktet me origjinë shtazore dhe bimë të specializuara. Rregullat e CMO-së janë veçanërisht komplekse. CMO mbulon 21 produkte/grup produktesh bujqësore. Kjo



rregullore ka një aspekt të brendshëm që mbulon ndërhyrjen në treg dhe rregullat e marketingut dhe organizatave të prodhuesve dhe një aspekt të jashtëm që mbulon tregtinë me vendet e treta.

Ky kapitulli gjithashtu përfshin legjislacionin për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe treguesit gjeografike dhe specialitetet tradicionale për produktet bujqësore dhe ato ushqimore dhe kontrollin e kësaj mbrojtje; rregullat për bujqësinë organike dhe kontrollin e inspektimit; ndihmat shtetërore në bujqësi; dhe krijimi dhe funksionimi i një sistemi për rrjetin e të dhënave të kontabilitetit në fermë, i cili është një mjet shumë i rëndësishëm për formimin e PPB.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (CAP) kërkojnë krijimin, modifikimin dhe / ose përforsimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, *acquis* paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, *acquis* thjesht përdor terma të tilla si “autoriteti kompetent” për t’iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo Shteti Anëtar të vendosë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të *acquis*. Megjithatë, funksionet që Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në *acquis*.

4.11.2 Struktura e kapitullit

- Çështjet Horizontale
- Organizimi i tregut të përbashkët
- Zhvillimi rural
- Prodhimi organik
- Politikat e cilësisë

4.11.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agroindustrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Neni 96 përcakton se fokusi duhet të jetë në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e bujqësisë.

Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit

bujqësor dhe sektorit agroindustrial shqiptar dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Komunitetit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e bujqësisë janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis e bujqësisë dhe zhvillimit rural përmban një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumë prej të cilave janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Zbatimi i duhur i këtyre rregullave dhe kontrolli efektiv nga një administratë publike efikase janë thelbësore për funksionimin e politikës së përbashkët bujqësore. Kjo kërkon ngritjen e agjencisë së pagesave dhe sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të pagesave, të tilla si Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit, dhe kapaciteti për të zbatuar programet e zhvillimit rural. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat e mbështetjes direkte të fermave dhe për zbatimin e dispozitave për organizimin e përbashkët të tregut për produkte të ndryshme bujqësore.

Zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli i Politikave të Përbashkëta Bujqësore (PPB) kërkon krijimin, modifikimin dhe / ose përforsimin e strukturave të përshtatshme administrative. Në disa raste, *acquis* paraqet specifikime të hollësishme për strukturat e kërkuara administrative. Në shumë raste, *acquis* thjesht përdor terma të tilla si “autoriteti kompetent” për t’iu referuar strukturës administrative që është e nevojshme. Kjo do të thotë se i mbetet çdo Shteti Anëtar të vendosë se cili institucion është përgjegjës për zbatimin efektiv të *acquis*. Megjithatë, funksionet që Shtetet Anëtare të BE-së duhet të kryejnë përmes strukturave administrative që ato krijojnë janë të përcaktuara qartë në *acquis*.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të *acquis* të BE-së janë:



- Rregullorja (BE) Nr. 1305/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 në mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EAFRD) dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1698/2005;

- Rregullorja (BE) Nr. 1306/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore;

- Rregullorja (BE) Nr. 1307/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 në vendosjen e rregullave për pagesat direkte për fermerët nën skemat e mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 637/2008 dhe Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 73/2009 mbi financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 352/78, (KE) Nr. 165/94, (KE) Nr. 2799/98, (KE) Nr. 814/2000, (KE) Nr. 1290/2005 dhe (KE) Nr. 485/2008;

- Rregullorja (BE) Nr. 1308/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 dhjetor 2013 në krijimin e një organizate të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 922/72, (KEE) Nr. 234/79, (KE) Nr. 1037/2001 dhe (KE) Nr. 1234/2007;

- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 834/2007 mbi prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin;

- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 889/2008 e 5 shtatorit 2008 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 834/2007 mbi prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin;

- Rregullorja (BE) Nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 21 nëntor 2012 mbi skemat e cilësisë dhe artikujt ushqimorë për produkteve bujqësore.

4.11.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ka pasur disa përparime në miratimin dhe zbatimin e kuadrit të ri ligjor në fushën e politikave të cilësisë, duke siguruar kapacitet administrative për zbatimin e

programit të instrumentit të asistencës së parazgjerimit për zhvillimin rural (IPARD II). Shqipëria mori besimin për zbatimin e buxhetit për masën “Asistenca Teknike”.

Në kuadër të zbatimit të Programit IPARD II (2014 – 2020), janë realizuar 3 thirrje për aplikime. Nën tre thirrjet për aplikime janë dorëzuar në total 1 057 aplikime me kërkesë totale për grant në vlerën prej rreth 222.6 milion euro.

Thirrja e parë për aplikime

Në total për këtë thirrje janë dorëzuar 317 aplikime ku numri total i projekteve të kontraktuara është 129 projekte me vlerë granti prej rreth 23.1 mln Euro dhe janë 113 investime të përfunduara. Procesi i kontraktimit për këtë thirrje ka përfunduar.

Thirrja e dytë për aplikime

Në total për këtë thirrje janë dorëzuar 371 aplikime dhe janë kontraktuar 188 projekte me vlerë granti prej rreth 31.39 mln Euro dhe janë 75 investime të përfunduara.

Thirrja e tretë për aplikime

Për këtë thirrje janë dorëzuar në total 369 aplikime, ku numri total i projekteve të kontraktuara është 35 projekte. Procesi i kontraktimit nuk ka përfunduar pasi aplikimet janë në kontroll administrativ.

Shuma e parave të disbursuara duke përfshirë pagesat paradhënie (10% - 50%) dhe investime të përfunduara plotësisht për të 3 thirrjet, deri në fund të Tetorit 2021 është: 31.1 milion Euro Granti, nga të cilat 23.33 milion Euro Kontributi i BE, dhe 7.77 milion Euro Kontributi Kombëtar.

Të gjithë thirrjet për aplikim nën këtë program, janë të hapura për të gjithë personat (persona fizik dhe juridikë), puna dhe veprimtaria e të cilëve zhvillohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Për të tre thirrjet për aplikime vihet re se ka pasur një tejkalim të pritshmërisë për të përfituar nga fondet grant. Në sajë të mbështetjes së granteve nga Programi IPARD II, janë rritur së tepërmi kapacitetet e ambienteve të grumbullimit dhe dhomave frigoriferike; linjat e përpunimit të fruta perime; mekanika bujqësore; investimet në serra; njësitë agroturistike; rrjeta antibreshër; thertore; investime përpunim mishi; akuakulturë etj.



Pas marrjes së besimit për masën e Asistencës Teknike, në korrik 2020, ka filluar zbatimi i aktiviteteve të planifikuara sipas Planit Vjetor të kësaj mase. Në zbatim të këtij plani janë realizuar procedurat e mëposhtme:

- Vlerësimi ex-ante për Programin IPARD III; si dhe

- Trajnim i Agjencisë IPARD.

Të dy strukturat operative (Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD), në të tre thirrjet për aplikime, përgatitën dokumentacionin e nevojshëm që u prezantua në fushatat informuese dhe u botuan në faqet e internetit të MBZHR dhe Agjencisë IPARD, siç janë: udhëzimet për aplikantët me të gjitha anekset, plani i veprimit që detajon datat e fushatës informative, objektivi i pjesëmarrjes, përfshirja e specialistëve të zgjerimit në fushatën informative dhe përgjegjësitë e tjera që duhet të kryhen gjatë zbatimit të thirrjeve për aplikim, etj.

Fushatat informuese u implementua nga Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia e Pagesave duke përdorur të gjitha mediat kombëtare dhe lokale. Spote informuese u transmetuan në stacione televizive duke siguruar informacione të përgjithshme në lidhje me masat IPARD II, për ndërgjegjësimin dhe për përfituesit e mundshëm.

Masat e mbështetura nën Mbështetjen Kombëtare për vitin 2021:

Mbështetje për dele / dhi të regjistruara 7,737 aplikime

Mbështetje për bletari 2,098 aplikime

Zëvendësimi i plastikës termike në serra 934 aplikime

Mbjellja e bimëve medicinale aromatike 1,177 aplikime

Bujqësia Organike 123 aplikime

Certifikimi Global GAP 26 aplikime

Linjë makineri pajisje vaj ulliri, BM dhe qumësht 16 aplikime

Investime në bujtina, turizëm rural 24 aplikime

Investime në Agroturizëm 18 aplikime

Në total për vitin 2021 kishim 12,153 aplikime.

Buxheti i Mbështetjes Kombëtare në total është 6.2 mln Euro, i cili mbulon 3,028 aplikime nga 12,153. Deri më tani realizimi i buxhetit për Skemat Kombëtare është 86.2% e buxhetit të përgjithshëm. Shuma e disbursuar në total: 5.6 milion Euro.

Në fushën e organizimit të tregut të përbashkët është miratuar legjislacioni zbatues për ligjin e ri për

vajin e ullirit. Janë miratuar dy akte ligjore në sektorin e vajit të ullirit i cili pjesërisht harmonizon legjislacionin kombëtar përkatës me *acquis*:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 235, datë 21.3.2017 “Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërësive të ullirit”. Në këtë vendim përcaktohen dhe përditësohen karakteristikat e cilësisë, natyrshmërisë dhe sigurisë për vajin e ullirit dhe vajin e bërësive të ullirit, duke siguruar një produkt cilësor tek konsumatori i fundit dhe sigurimin e një konkurrence të ndershme në treg. Për çdo karakteristikë dhe kriter janë përcaktuar limitet përkatëse, në përputhje me Rregulloren e Komisionit Evropian (EEC) Nr. 2568/91 e datës 11 korrik 1991 “Mbi karakteristikat e vajit të ullirit dhe vajit të mbetjes së ullirit dhe mbi metodat përkatëse të kryerjes së analizave”, si dhe Standardet e COI të vitit 2015 të zbatuara për tregtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërësive të ullirit;

- Urdhër nr. 512 datë 12.10.2016 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të përhershëm të degustimit të vajit të ullirit të virgjër”. Ky urdhër përcakton përbërjen e komisionit, numrin e anëtarëve, institucionet dhe grupet të cilëve duhet t’i përkasin, detyrat e kryetarit dhe anëtarëve, si dhe përmes shtojcës që i bashkëlidhet urdhrit, përcakton, metodat e vlerësimit organo-shqisor, fjalorin, infrastrukturën e dhomës së degustimit, elementët, mbikëqyrjen e degustuesve, fletët e vlerësimit.

Për bujqësinë organike, është arritur progres në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për prodhimin organik me *acquis* të BE –së, ku është miratuar ligji 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe pothuajse është plotësuar me akte nënligjore. Komisioni për Prodhimin Organik (KPB) është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e trupave të kontrollit për certifikimin e produkteve organike. Mbikëqyrja e trupave të kontrollit, për llogari të KPB, kryhet nga Sektori për Prodhimin Organik dhe Standardet e Marketingut të Produkteve Bujqësore dhe Blegtorale që është përgjegjës për hartimin e legjislacionit, regjistrimin e operatorëve organikë



dhe mbledhjen dhe përgatitjen e informacionit statistikor për prodhimin organik.

Gjatë viteve të fundit ka vazhduar dhe është rritur mbështetja financiare për bujqësinë organike nëpërmjet skemave direkte, ku përfshihen fermat biologjike dhe ato në kalim drejt bujqësisë biologjike.

Përsa i përket politikave të cilësisë, gjatë vitit 2019 është miratuar ligji nr. 8/2019 datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”. Ky ligj krijon skemat e cilësisë dhe përcakton institucionet përgjegjëse për njohjen dhe mbrojtjen e emërtimeve të origjinës, treguesve gjeografikë dhe specialiteteve tradicionale të garantuara për produktet bujqësore dhe ato ushqimore. Në zbatim të këtij ligji janë parashikuar akte nënligjore, të cilat janë në proces hartimi. .

4.11.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për kapitullin 11 është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është edhe institucioni koordinues i grupit ndërinstitutional të punës.

Pjesë e Grupit Ndërinstitutional të Punës për Kapitullin 11 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Drejtësisë (MD)
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)
- Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve (AKDC)
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
- Agjencia Kombëtare e Shqipërisë dhe Informacionit (AKSHI);
- Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI);
- Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)

4.11.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Në lidhje me zbatimin e Programeve IPARD, strukturat operative (Autoriteti Menaxhues dhe Agjencia IPARD) janë të ngritura dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat e parashtruara në

rregulloret e BE-së. Me gjithë arritjet e deritanishme kërkohet forcim i vazhdueshëm i kapaciteteve të autoriteteve IPARD për të zbatimin e masave të reja në kuadër të Programeve IPARD.

Në fushën e bujqësisë organike, në zbatim të Ligjit Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, është plotësuar kuadri ligjor në lidhje me aktet nënligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 336, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin, kalimin, rregullat përjashtuese të prodhimit dhe kontrollin e prodhimit biologjik bimor dhe të algave të detit”;

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr. 131, datë 28.03. 2018 “Për Miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 830, datë 18. 12. 2019 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për grumbullimin, ambalazhimin, transportin, ruajtjen, etiketimin, njoftimin e aktivitetit dhe kontrollin e produkteve biologjike”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 859, datë 24.12.2019 “Për Përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e komisionit për prodhimin biologjik”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2020 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për prodhimin e ushqimeve biologjike të përpunuara për kafshë, ushqimeve biologjike të përpunuara, majave biologjike dhe rregullat përjashtuese”;

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr. 288, datë 8.6.2020 “Për Miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në përpunimin e ushqimeve biologjike”;

Për zbatimin e ligjit Nr. 8/2019, datë 26.2.2019 “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” janë miratuar aktet nënligjore:

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 677 datë 16.10.2019 “Për miratimin e logos kombëtare për produktet bujqësore dhe ushqimore me emërtimin “Specialitet Tradicional i Garantuar”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 860 datë 24.12.2019 “Për funksionimin, kohëzgjatjen,



organizimin dhe detyrat e Komisionit për Skemat e Cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore";

- Udhëzim Nr. 7 datë 21.4.2020 "Për formën dhe përmbajtjen e regjistrit për produktet bujqësore dhe ushqimore me tregues specialitet tradicional i garantuar";

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Nr. 299, datë 29.7.2020 "Për miratimin e listës së produkteve bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor";

- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 424 datë 16.10.2020, "Për përcaktimin e formës dhe përmbajtjes së certifikatës së cilësisë për përputhshmërinë e produktit bujqësor ose ushqimor me specifikimet teknike të produkteve të regjistruara";

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 425 datë 16.10.2020, "Për përcaktimin e formatit të aplikimit dhe kundërshtimit të produkteve bujqësore ose ushqimore si Specialitet Tradicional të Garantuar";

- Vendim i këshillit të Ministrave nr. 231 datë 19.4.2021 "Për përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e Komisionit për miratimin dhe auditimin e trupave certifikuese";

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401 datë 6.7.2021 "Për përcaktimin e kriterëve të

hollësishme për miratimin dhe kompetencat e trupave certifikuese";

Gjithashtu, projektligji "Për vreshtarinë dhe verën" është miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më datë 24 dhjetor 2020 dhe është në proces miratimi në Kuvendin e Shqipërisë.

Me gjithë arritjet e deritanishme kërkohet plotësimi i bazës ligjore lidhur me skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, ligjin për vreshtarinë dhe verën, si dhe masat direkte sipas CMO.


Kapacitetet e AZHBR

Një strukturë e re organizative e AZHBR-së u miratua përmes Urdhrit të Kryeministrit Nr. 156 datë 18.1.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin Nr. 140 datë 17.09.2018 "Për miratimin e strukturës dhe organogramit të Agjencisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Agjencia e Pagesave)".

Stafi i Agjencisë IPARD u rrit me 14 pozicione të reja IPARD, dhe rrjedhimisht numri i përgjithshëm i punonjësve u bë 183, të cilët u punësuan sipas Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil". Ndërkohë ngarkesa e punës është rishikuar në përputhje me rrethanat për vitin 2021, struktura do të rritet me njëzet punonjës të rinj.



Numri total i punonjësve është 203.



Gjatë vitit 2021, janë kryer më shumë se 25 programe/tema trajnimi për të rritur kapacitetin e punonjësve ekzistues dhe të rekrutuar së fundmi për rregullat dhe procedurat IPARD II.

Në këto trajnime kanë marrë pjesë më shumë se 59 punonjës. Ditët totale të trajnimit janë 26 ditë.

Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria synon këto prioritet:

- Zhvillimin e Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS), përfshirë përmirësimin e regjistrat të fermave dhe kafshëve;
- Miratimin e planit të zbatimit për regjistrat e Rrjetit të të Dhënave Kontabël të Fermës (FADN), me qëllim sigurimin e të dhënave konsistente, sistematike dhe të certifikuara;
- Hartimi dhe miratimi në Komisionin Evropian të Programit IPARD III 2021 – 2027;
- Forcimi i kapaciteteve administrative të nevojshme për zbatimin e Programeve IPARD;
- Forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve kombëtare përgjegjëse për të lehtësuar zbatimin e suksesshëm të programit IPARD;
- Plotësimin e kuadrit ligjor për produktet organike, në linjë me legjislacionin e ri të BE-së, i cili hyn në fuqi në 2022;

- Plotësimin e kuadrit ligjor për emërtimet e mbrojtura të origjinës, treguesit gjeografike dhe specialitetet tradicionale të garantuar;

- Miratimin e ligjit për vreshtat dhe verën si dhe të akteve nënligjore;

- Miratimin e ligjit “Për bletarinë”;

- Garantimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e legjislacionit.

Çështje të tjera horizontale

MBZHR është në proces të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021 – 2027. Është ngritur Grupi i Punës për këtë qëllim dhe është hartuar Dokumenti Konceptual Strategjik si dhe drafti i parë i strategjisë, me asistencë të projektit GIZ. Janë krijuar grupe tematike pune me pjesëmarrje dhe të grupeve të interesit që në fazat e para të hartimit. Dokumenti strategjik i referohet CAP dhe nuk synon përafrim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ky dokument parashikohet të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.



KAPITULLI 12: POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

4.12.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 12 mbulon rregullat e hollësishme në fushën e sigurisë ushqimore. Politika e përgjithshme e produkteve ushqimore përcakton rregullat e higjienës për prodhimin e produkteve bujqësore. Më tej, legjislacioni i Bashkimit Evropian përcakton rregullat e hollësishme në fushën e veterinarisë, të cilat janë thelbësore për të ruajtur shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë e produkteve ushqimore me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Në fushën e fitosanitetit, rregullat e Bashkimit Evropian mbulojnë çështje të tilla si cilësia e farërave, materialet e mbrojtjes së bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve.

4.12.2 Struktura e kapitullit

- Siguria ushqimore
- Politika veterinare
- Politika fitosanitare
- Farat dhe Fidanët
- Ushqimi për kafshë
- OMGJ-të

4.12.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë ligjin e saj kombëtar me atë të BE-së.

Bashkëpunimi në fushën e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian është parashikuar në nenin 96 të MSA-së. Në nenin 96 përcaktohet se fokusi duhet të jetë në fushat me përparësi që lidhen me acquis e Bashkimit Evropian në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të synojë në mënyrë të veçantë modernizimin dhe ristrukturimin e sektorit shqiptar bujqësor dhe agro-industrial, dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit dhe praktikave shqiptare me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Acquis për politikat e sigurisë ushqimore, politikat veterinare dhe fitosanitare pasqyron qasjen e integruar të BE-së në sigurinë ushqimore me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda Bashkimit Evropian nëpërmjet masave koherente nga ferma në tavolinë dhe monitorimit adekuat, duke siguruar

funksionimin efektiv të tregut të brendshëm. Parakushtet kryesore për një vend kandidat në këtë fushë janë transpozimi i legjislacionit të BE-së, si dhe zbatimi i tij nga një administratë e strukturuar mirë dhe e trajnuar.

Acquis në këtë kapitull përmban një numër shumë të madh rregulloresh direktivash dhe vendimesh.

Për zbatimin e legjislacionit të sigurisë ushqimore, shteti anëtar duhet të ketë strukturat administrative të përshtatshme që të jetë në gjendje që të kryejë inspektimin dhe kontrollin e produkteve ushqimore duke përfshirë kapacitetet e duhura laboratorike. Rregullat bazë janë përcaktuar në Rregulloren e përgjithshme për ushqimet për njerëzit dhe kafshët Nr. 178/2002 për parimet dhe kërkesat e përgjithshme të prodhimit ushqimor, përpunimit, paketimit, etiketimit, parketimit dhe shpërndarjes. Në veçanti, ky akt përcakton përkufizimet, parimet dhe detyrimet që mbulojnë të gjitha fazat e prodhimit dhe shpërndarjes së ushqimit për njerëz dhe kafshë. Plotësimi i kërkesave të gjurmueshmërisë për të gjithë ushqimin për njerëz dhe kafshë, ashtu edhe për operatorët e biznesit, janë të detyrueshme për zbatim. Legjislacioni për sigurinë ushqimore mbulon paketimin, etiketimin, marketingun, aditivët, tretësit e nxjerrjes, aromatizuesit, materialet e kontaktit ushqimor, shtesat ushqimore, ujërat minerale dhe rrezatimet jonizuese, ndotësit, ushqimet e reja, ushqimet e ngrira të shpejta, cilësinë e farërave dhe materialit shumues, produktet, organizmat e dëmshëm, të drejtat e varieteteve të bimëve, si dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Në fushat e politikave të veterinarisë, Rregullorja Nr.2016/429 për sëmundjet e transmetueshme të kafshëve përcakton rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të kafshëve të cilat janë të transmetueshme të kafshët ose të njerëzit. Këto rregulla parashikojnë priorizimin dhe kategorizimin e sëmundjeve dhe përcaktimin e përgjegjësisë të stabilimenteve për shëndetin e kafshëve, zbulimin e hershëm, njoftimin dhe raportimin e sëmundjeve, mbikëqyrjen, programet e çrrënjësjes dhe statusin pa sëmundje, ndërgjegjësimin, gatishmërinë dhe kontrollin për sëmundjet, regjistrimin dhe miratimin e stabilimenteve dhe transportuesve, lëvizjet dhe gjurmueshmërinë e kafshëve,



produkteve germinale dhe produkteve me origjinë shtazore, hyrjen e kafshëve, produkteve germinale dhe produkteve me origjinë shtazore në Bashkimin Evropian dhe eksportin e dërgesave të tilla nga Bashkimi Evropian, lëvizjet jo-tregtare të kafshëve shtëpiake si dhe masat emergjente që duhen marrë në rast të një situatë emergjente të një sëmundjeje. Këto rregulla synojnë të sigurojnë përmirësimin e shëndetit të kafshëve për të mbështetur prodhimin e qëndrueshëm bujqësor dhe të akuakulturës, funksionimin efektiv të tregut të brendshëm si dhe një reduktim të efekteve negative në shëndetin e kafshëve, shëndetin publik dhe mjedisin të sëmundjeve të caktuara dhe masave të marra për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve. Legjislacioni i veterinarisë mbulon sistemet e kontrollit në tregun e brendshëm, produktet me origjinë shtazore, certifikimin, sistemin e kontrollit të importeve, pikat e inspektimit kufitar, identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve të të gjitha specieve dhe regjistrimin e lëvizjes së tyre, masat e kontrollit për sëmundjet në kafshë, sëmundjet e kafshëve si dhe tregtinë e kafshëve të gjalla dhe embrioneve.

Rregullorja Nr. 2016/2031 për masat mbrojtëse kundër parazitëve të bimëve vendos rregulla për të përcaktuar rreziqet fitosanitare të paraqitura nga çdo specie, lloj ose biotip i agjentëve patogjenë, kafshët ose parazitët e dëmshëm për bimët ose produktet bimërore ('dëmtuesit') dhe masat për reduktimin e rreziqeve të tyre në një nivel të pranueshëm.

Duke ndjekur reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore pjesët kryesore të acquis të BE-së në fushën fitosanitare janë:

- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 2019/2072 e datës 28 nëntor 2019 për krijimin e kushteve uniforme për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve dhe shfuqizimin e Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 690/2008 dhe ndryshimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2019;

- Direktiva Nr. 2009/127/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, përsa i përket makinerive për aplikimin e pesticideve;

- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 2017/269 e datës 16 shkurt 2017, në lidhje me statistikën e

pesticideve, sa i përket listës së substancave aktive;

- Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 540/2011 e datës 25 maj 2011 zbatimi i Rregullores (KE) Nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me listën e substancave aktive të miratuara;

- Direktiva Nr. 2009/128 /KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 21 tetorit 2009 duke krijuar një kornizë për veprimin e Komunitetit për të arritur përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve.

Rregullorja Nr. 2016/625 mbi kontrollet zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve përcakton rregullat për kryerjen e kontrolleve zyrtare dhe aktivitetet e tjera zyrtare nga autoritetet kompetente, financimin e kontrolleve zyrtare, asistencën administrative dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve në funksion të zbatimit korrekt të rregullave, miratimin e kushteve që duhet të plotësohen në lidhje me kafshët dhe mallrat që hyjnë në Bashkim nga një vend i tretë, krijimin e një sistemi informacioni të kompjuterizuar për të menaxhuar informacionin dhe të dhënat në lidhje me kontrollet zyrtare. Këto rregulla zbatohet për kontrollet zyrtare të kryera për verifikimin e respektimit të rregullave për zbatimin e legjislacionit në fushat e sigurisë, integritetit dhe shëndetit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë në çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes, lëshimi i qëllimshëm në mjedis i organizmave të modifikuar gjenetikisht për qëllime të prodhimit të ushqimit dhe ushqimit, sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë në çdo fazë të prodhimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimit dhe përdorimit të ushqimit për kafshë, kërkesat për shëndetin e kafshëve, parandalimin dhe minimizimin e rreziqeve për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve që rrjedhin nga nënproduktet e kafshëve, kërkesat e mirëqenies për kafshët, masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve, kërkesat për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e qëndrueshëm të pesticideve, prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike, përdorimi dhe etiketimi i emërtimeve të



mbrojtura të origjinës, treguesve gjeografikë të mbrojtur dhe specialiteteve tradicionale.

4.12.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka arritur **njëfarë niveli të përgatitjes** në këtë fushë. Shqipëria ka bërë **disa përparime**. Shqipëria krijoi Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Shqipëria ka bërë disa përparime mbi rekomandimet e vitit 2020, por ato mbeten të vlefshme duke qenë se kërkohet përparim i mëtejshëm.

Në lidhje me **sigurinë ushqimore në përgjithësi**, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer kontrole të rregullta zyrtare në përputhje me planin vjetor të bazuar në risk.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrole zyrtare në Pikat e Kontrollit Kufitar duke përfshirë produktet me origjinë shtazore, origjinë jo shtazore, kafshë të gjalla, produkte mjekësore veterinarë, material mbjellës shumëzues bimor dhe produkte për mbrojtjen e bimëve. TRACES përdoret rregullisht.

Sa i përket **politikave veterinarë**, qeveria miratoi ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve drejton dhe koordinon shërbimin veterinar rajonal. Ky institucion i ri ka bërë të mundur bashkëpunimin dhe vlerësimin më të ngushtë të nevojave të terrenit. Rritja e numrit të veterinerëve nga 166 gjithsej për vitin 2020 në 531 në 2021 ka rritur ndjeshëm identifikimin e hershëm të sëmundjes dhe të gjitha masat veterinarë të marra në shkallë vendi. Gjithashtu, është bërë e mundur kryerja dhe monitorimi efikas për stafin veterinar, veçanërisht për ata të sapo rekrutuar. Një faqe interneti po mbështetet nga IPA 2016 “Projekti i Sigurisë Ushqimore”.

Programet për monitorimin e brucelozës dhe tuberkulozit në tufat e bagëtive me më shumë se 10 krerë kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2020. Vaksinimi kundër sëmundjeve të dermatozës nodulare në bagëti dhe bruceloza të kafshët e remontit në të imtat vazhduan edhe gjatë vitit 2020. Me mbështetjen e BE-së, përfunduan dy fushatat e para të vaksinimit kundër tërbimit për periudhën 2020 – 2022. Vaksinimi i tretë pritet të bëhet në nëntor 2021. Verifikimi dhe regjistrimi në mbarë vendin i numrit të kafshëve në Shqipëri është duke u zbatuar dhe vendi ka bërë një përparim të mirë

në regjistrimin dhe identifikimin e të imtave dhe derrave, edhe pse kjo është ende në vazhdimësi. Gjithashtu, raportimi i sëmundjeve të kafshëve dhe lëvizjes së kafshëve është përmirësuar.

Në lidhje me reformën në sektorin veterinar, është miratuar udhëzimi Nr. 17 datë 24.9.2021 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë mekanikisht” dhe Udhëzimi Nr. 18, datë 24.9.2021 “Mbi përcaktimin e kushteve të tregjeve të kafshëve të gjalla”. Urdhri i Ministrit Nr. 366, datë 9.9.2021 “Për kryerjen e veprimtarive të kontrollit në thertore dhe tregje”, i cili i lejon veterinerët zyrtarë të kryejnë veprimtarinë e tyre në tregje dhe thertore.

Në datën 15.10.2021 ka filluar kontrolli para dhe pas therjes i kafshëve në thertore nga veterinerët zyrtarë të shërbimit veterinar rajonal. Format i ri i certifikatës së shëndetit të kafshëve dhe dokumenteve të tjera pasqyron shërbimin veterinar të sapo organizuar, si dhe janë prodhuar edhe vulat e reja të mishit, duke ofruar një informacion më të plotë dhe të besueshëm mbi gjurmueshmërinë e produktit tek konsumatori.

Në zbatim të Urdhrit Nr. 17, datë 24.9.2021, sistemi RUDA është vendosur dhe aksesuar në të gjitha thertoret. Ky aktivitet do të ndihmojë në pasqyrimin e shpejtë të të dhënave, në baza ditore, në mënyrë që të mbyllet kontrolli i lëvizjes së kafshëve dhe të bëhet një hap i mëtejshëm në gjurmueshmërinë e produkteve nga kafshët.

Në lidhje me **vendosjen në treg të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe nënprodukteve të kafshëve**, Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve, përfshirë produktet mjekësore veterinarë, mbetjet e pesticideve, metalet e rënda dhe mikotoksinat në kafshët e gjalla dhe produktet me origjinë shtazore është kryer rregullisht, në përputhje me kërkesat dhe metodat analitike të vlefshme.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit merr rregullisht mostra nga stabilimentet që eksportojnë produkte peshku, të cilat analizohen për përmbajtjen kimike dhe mikrobiologjike, përfshirë histaminat.

Kapaciteti për të monitoruar nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në produktet me origjinë bimorë është rritur. Instituti i Veterinarisë dhe Sigurisë Ushqimore teston një numër të konsiderueshëm të substancave kimike në përputhje me Udhëzuesit e Komisionit mbi



procedurat e vlefshmërisë së metodave dhe kontrollin cilësor analitik për analizat e mbetjeve dhe pesticideve në ushqime dhe ushqime për kafshë.

Sa i përket **rregullave të sigurisë ushqimore**, Shqipëria ka vazhduar me ndryshimet në aktet rregullatore të mëparshme kombëtare në lidhje me kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, qumështin dhe produktet e qumështit, molusqet e gjalla dhe bivalvore dhe peshqit dhe produktet e peshkimit për të siguruar një përafrim të pjesshëm me Rregulloren (KE) Nr. 2074/2005 e datës 5 dhjetor 2005 që përcakton masat zbatuese për produkte të caktuara sipas Rregullores (EC) Nr. 853/2004 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe për organizimin e kontrolleve zyrtare sipas Rregullores (KE) Nr. 854/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe Rregullorja (KE) Nr. 882/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, duke deroguar nga Rregullorja (KE) Nr. 852/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe duke ndryshuar Rregulloret (EC) Nr 853/2004 dhe (EC) Nr 854/2004 (Tekst me rëndësi për ZEE)

Për **politikën fitosanitare**, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka vazhduar miratimin e substancave aktive të mbrojtjes së bimëve në të njëjtën linjë me Rregulloret Zbatuese të Komisionit. Shqipëria nënshkroi një marrëveshje me Maqedoninë e Veriut për njohjen e certifikatave fitosanitare. Pas reformave në këtë sektor, shërbimi fitosanitar përfshihet edhe në Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) duke kryer detyra që lidhen me monitorimin dhe verifikimin e gjendjes fitosanitare për të gjithë dëmtuesit e bimëve në vend, duke mbikëqyrur rrezikun e përdorimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve në produkte që paraqesin rrezik të lartë në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe lëshojnë certifikata fitosanitare për eksport.

Në vazhdim të Planit vjetor “Për miratimin e planit kombëtar të kontrolleve zyrtare të bazuara në rrezik dhe kampionimit për ushqimin, ushqimin e kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe inputet bujqësore, si dhe plani i kampionimit në PIK për vitin 2021”, është hartuar plani vjetor i monitorimit të mbetjeve të pesticideve në 18 produkte me origjinë bimore. Në Planin Kombëtar të Monitorimit të mbetjeve të pesticideve në fruta-perime të miratuar për periudhën qershor 2020 –

prill 2021, krahasuar me vitin 2020 është rritur numri i produkteve me origjinë bimore që do të monitorohen nga 12 në 18 dhe numri minimal i mostrave që do të analizohen në vitin 2021 është 1000 mostra.

Përsa i përket politikave në fushën e veterinarisë, janë hartuar programet e mëposhtme:

- Strategjia për kontrollin e Antraksit, me Nr. 2189 prot. e datës 10.3.2021, parashikon vaksinimin e vatrave të planifikuara dhe atyre të reja;

- Urdhër Nr. 200, datë 19.5.2021 “Programi i kontrollit të brucelozës së gjedhit”, parashikon testimin e fermave me drejtim prodhim qumështi me 5 krerë e lart;

- Urdhër Nr. 163 datë 12.4.2021 “Programi i Kontrollit të Brucelozës për ruminantët e vegjël”, parashikon vaksinimin e ruminantëve të vegjël për remont;

- Urdhër Nr. 377 datë 9.9.2021 “Programi i kontrollit të tuberkulozit të gjedhit” parashikon testimin e fermave me drejtim prodhim qumështi me 10 krerë e lart;

- Urdhër Nr. 350 datë 31.8.2021 “Plani i Kontrollit të Sëmundjeve së Dermatozës Nodulare” parashikon vaksinimin e gjedhit të remontit;

- Vaksinimi i dhelprave të kuqe për sëmundjen e tërbimit.

Sektori i Epidemiologjisë dhe IR në bashkëpunim me kompaninë e mirëmbajtjes së sistemit po punon për përmirësimin e sistemit RUDA në lidhje me kalimin nga internet explorer në google chrome, për mundësinë e hapjes dhe përdorimit të këtij sistemi në çdo kohë dhe kudo përmes ipad, telefon, laptop etj. Aktualisht sistemi RUDA ka kaluar në server test dhe do të testohet për disa kohë në mënyrë që të verifikohen të gjitha datat që sistemi disponon. RUDA do të aksesohet për të eksportuar informacion për krijimin e regjistrit të fermës. Gjithashtu, janë rishikuar planet e kontigjencës të sëmundjeve së influencës aviare dhe aftës epizootike. Janë përgatitur planet e monitorimit të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe influencës aviare me bazë rrisht.

Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitetit, me mbështetjen e Projektit IPA “Mbështetje për



Standardet e Sigurisë Ushqimore, Veterinare dhe Fitosanitare” dokumenti mbi analizën e mangësive ligjore i është nënshtruar një rishikimi të plotë. Ky dokument ka përfunduar dhe vazhdon të përditësohet në përputhje me aktet e reja të Acquis, akteve të transpozuar në legjislacionin shqiptar, gjetjeve nga përgatitja e Tabelave të Përputhshmërisë si dhe nga Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative. Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative është përgatitur në fushën e sigurisë ushqimore dhe është në proces në fushën e veterinarisë dhe fitosanitetit.

Për vitin 2021 janë përgatitur aktet e mëposhtme:

- Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 2 datë 13.1.2021 “Për vendosjen e rregullave të hollësishme në lidhje me standardet e marketimit dhe tregtimit të vezëve”, që përafron pjesërisht Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 589/2008 e 23 qershorit 2008 “Mbi vendosjen e rregullave të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1234/2007 në lidhje me standardet e marketimit dhe tregtimit të vezëve”;

- Udhëzimi Nr. 3 datë 18.1.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontrollleve Zyrtare me Bazë Risku dhe i Marrjes së Mostrave për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK) për Vitin 2021”;

- Udhëzimi Nr. 11 datë 10.5.2021 “Për nivelin maksimal të mbetjeve të pesticideve në fruta, perime, fara të freskëta dhe/ose të përpunuara”. Ky udhëzim bazohet në Bazën e të dhënave të Pesticideve të BE-së, të Komisionit Evropian, për Nivelet Maksimale të Mbetjeve (MRL);

- Udhëzimi Nr. 12 datë 1.6.2021 “Për miratimin e Planit për Monitorimin e Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore, në produktet banane, domate, karota, kastravec, mollë, patate, rrush tavoline, sallatë jeshile, spec, spinaq, ullinj tavoline, shalqi, pjepër, mandarinë, lakër, pjeshkë + nektarinë, shegë dhe luleshtrydhe”.

Aktet nënligjore të mëposhtme janë përgatitur me qëllim përmirësimin e kornizës ligjore dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e veterinarisë:

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 367 datë 9.9.2021 “Për rregullat minimale që zbatohen për mbrojtjen e pulave për prodhimin e mishit” i përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2007/43 / KE e datës 28 qershor 2007 për përcaktimin e rregullave minimale për mbrojtjen e shpendëve të mbajtura për prodhimin e mishit;

Legjislacioni i mëposhtëm është përgatitur për kontrollin e sëmundjes së dermatozës nodulare dhe gripit të shpendëve.

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 163/1, datë 20.4.2021 “Për miratimin e planit të kontigjencës së sëmundjes së dermatozës nodulare”;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 228, datë 1.6.2021 “Për disa masa mbrojtëse kundër gripit të shpendëve me patogjenitet të lartë në shpendët, që shfaqet në Republikën e Kosovës”;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 234, datë 2.6.2021 “Për miratimin e planit të kontigjencës së gripit të shpendëve”;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 241, datë 7.6.2021 “Për miratimin e rregullores “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e gripit të shpendëve në shpendët”;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 242, datë 8.6.2021 “Për krijimin e qendrës kombëtare të krizave”;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 261, datë 24.6.2021 “Për disa masa shtesë për parandalimin dhe kontrollin e gripit të shpendëve, në pikat e inspektimit kufitar, mbarështimin, lëvizjen dhe tregtimin e shpendëve”.

Për fushën fitosanitare me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së, janë miratuar për vitin 2021 aktet e mëposhtme ligjore:

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 40, datë 22.1.2021 “Për përditësimin e Urdhrit Nr. 72, datë 02.03.2017 “Për miratimin e substancave aktive të produkteve të mbrojtjes së bimëve” përgatitur në bazë të përafrimit të plotë të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/2101, Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/2105, Rregullores Zbatuese të



Komisionit (BE) 2020 /2007, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2020/2104, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2020/2087.

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 169, datë 21.4.2021 “Për përditësimin e urdhrit Nr. 72, datë 02.03.2017 “Për miratimin e substancave aktive të produkteve të mbrojtjes së bimëve”, përgatitur në bazë të përafrimit të plotë të Komisionit. Rregullorja Implementuese (BE) 2021/81, Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/567, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/427, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/129, Rregullorja Implementuese e Komisionit (EU) 2021/134, Komisioni Rregullorja Zbatuese (BE) 2021/413, Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/52, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/566, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/79, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/459, Komisioni Rregullorja Zbatuese (BE) 2021/556, Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/574, Rregullorja e Komisionit (BE) 2021/383.

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 354, datë 2.9.2021 “Për përditësimin e Urdhrit Nr. 72, datë 02.03.2017 “Për miratimin e substancave aktive të produkteve të mbrojtjes së bimëve” përgatitur në bazë të përafrimit të plotë të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2021/917 datë 7 qershor 2021, Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2021/843 datë 26 maj 2021. , Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/853 e datës 27 maj 2021, Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/1191 e datës 19 korrik 2021, Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/745 e datës 6 maj 2021, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/726 e 4 maj 2021, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/795 e 17 maj 2021, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/1379 e datës 19 gusht 2021, Rregullorja Implementuese e Komisionit (BE) 2021/824 e 21 majit.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 562, datë 29.9.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 335, datë 6.6.2018 “Për miratimin e rregullave të detajuara të regjistrimit dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve të mbrojtjes së

bimëve”. Amendamenti konsiston në transpozimin e plotë të legjislacionit të BE-së në lidhje me tërheqjen nga tregu të PMB-ve që përmbajnë substancë aktive e cila nuk është miratuar. Amendamenti VKM jep bazën ligjore për përgatitjen e urdhrit të ministrit për secilën prej tyre.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale në fushën e veterinarisë është rritur numri i veterinerëve nga 166 në total për vitin 2020 në 531 në 2021 duke rritur ndjeshëm identifikimin e hershëm të sëmundjes dhe të gjitha masat veterinarë të marra në shkallë vendi.

Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve drejton dhe koordinon shërbimin veterinar rajonal. Ky institucion i ri ka bërë të mundur bashkëpunimin dhe vlerësimin më të ngushtë të nevojave të terrenit. Gjithashtu, është bërë e mundur kryerja dhe monitorimi efikas për stafin veterinar, veçanërisht për ata të saporekrutuar.

4.12.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për këtë kapitull është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

MBZHR është përgjegjëse për formulimin e politikave, legjislacionit dhe strategjive për kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore me qëllim integrimin e kontrollit të ushqimit si një funksion kyç në mbrojtjen e shëndetit dhe interesave të konsumatorit, duke siguruar konkurrencë të ndershme në tregun kombëtar dhe futjen e ushqimit produkteve në tregun ndërkombëtar.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 12 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB)
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)
- Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve (AKDC)
- Enti i Farave dhe Fidanëve (EFF)



- Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)

4.12.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritet

Nëpërmjet projektit IPA “Mbështetje për sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe standardet e fitosanitetit”, tabela e analizës së mangësive legjislative (LGA) i është nënshtruar një rishikimi të plotë dhe vazhdon të përditësohet në përputhje me rezultatet dhe gjetjet nga përgatitja e Tabelave të Përputhshmërisë (ToCs), dhe Analizës institucionale dhe Mangësive Ligjore (IAGA) dhe duke e krahasuar me *acquis* të BE.

Bazuar në analizën e mangësive ligjore, transpozimi i *acquis* së Bashkimit evropian me legjislacionin vendas në lidhje me kontrollin zyrtar, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve do të kryhet në vitin 2023.

Legjislacioni vendas në këtë kapitull është përafëruar në mënyrë të pjesëshme. Ndërkohë që në Shqipëri ekziston tashmë një kuadër i përshtatshëm institucional për zbatimin e *acquis* në këtë Kapitull, ende kërkohen disa rregullime dhe forcimi i kapaciteteve administrative të institucioneve ekzistuese.

Në lidhje me sigurinë ushqimore, edhe pse Autoriteti Kombëtar i Ushqimit kryen kontrole të rregullta zyrtare në përputhje me planin vjetor të bazuar në risk, problematikë mbetet hartimi dhe miratimi i një metodologjie të përmirësuar të vlerësimit të riskut, për shkak të mungesës së sistemeve të nevojshme operacionale të teknologjisë së informacionit që nuk mund të kompensohen me burimet njerëzore ekzistuese të nevojshme për të analizuar të dhënat. Cilësia e statistikave të inspektimit duke mos e kufizuar atë vetëm në numrin e inspektimeve ose masave të marra për shkeljet, mbetet për tu përmirësuar.

Për sa i përket legjislacionit në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë, si dhe në fushën e organizmave të modifikuar gjenetikisht, mbetet për tu hartuar kuadri ligjor i mëtijshëm si dhe përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Reforma e shërbimit veterinar ende nuk është përfunduar, përfshirë personelin në të gjitha nivelet dhe miratimin e procedurave të brendshme operacionale. Është rëndësishme të krijohet një strukturë koherente me kërkesat e ligjit të BE-së për shëndetin e kafshëve. Në këtë duhet të krijohen kapacitetet e nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive duke përfshirë vlerësime të besueshme

të përhapjes së sëmundjeve, nëpërmjet një analize të plotë të të dhënave, planifikimit dhe zbatimit të sistemeve efektive për parandalimin dhe/ose çrënjosjen e sëmundjeve.

Regjistri i kafshëve duhet të përfshijë më shumë informacion mbi kafshët e tjera, të tilla si derrat, kuajt, shpendët dhe kafshët e tjera siç përmenden në Ligjin përkatës të BE-së për Shëndetin e Kafshëve.

Në fushën e fitosanitetit, kuadri ligjor mbi kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë dhe produkte bimë si dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve duhet të plotësohet në përputhje me aktet normative të BE-së. Zbatimi i plotë i tyre është shumë i rëndësishëm.

Prioritetet afatshkurtra në fushën e sigurisë ushqimore përfshijnë:

- Forcimin e sistemit të sigurisë ushqimore dhe të sistemeve të kontrollit;

- Përf forcimin e kapaciteteve laboratorike në fushën e sigurisë ushqimore;

- Plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë në lidhje me ushqimet për përdorime të veçanta ushqyese, aditivët në ushqime, rregullat zbatuese për autorizimin e deklaratave shëndetësore, informimin e konsumatorëve për mungesën ose reduktimin e pranisë së glutenit në ushqim, vendosjen e niveleve maksimale të koksidiostateve ose histomonostateve në ushqim që rezultojnë nga bartja e pashmangshme e tyre në ushqimin përR kafshë, përcaktimin e procedurës së marrjes së mostrave dhe metodat për analizimin e ushqimeve të ngrira shpejt të destinuara për konsum njerëzor, rregullat e hollësishme mbi kërkesat minimale për pikat e inspektimit kufitar, prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit për kafshë të medikuar; përdorimin e acidit laktik për të eliminuar kontaminimin e karkasave të gjedhit, dallimin midis materialeve të ushqimit për kafshë, aditivëve të ushqimit për kafshë, produkteve biocidale dhe PMV-ve.

- Zbatimi i rregullave të sigurisë ushqimore përmes kontroleve zyrtare të përmirësuar, përfshirë kushtet e kontrollit dhe kontrollin;

- Miratimi i një metodologjie të re me bazë risku për planifikimin e kontroleve zyrtare të sigurisë ushqimore; zbatimi i kontroleve zyrtare sipas planeve vjetore të përditësuara të



inspektimit të bazuara në një metodologji të përmirësuar me bazë risku për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore;

- Zëvendësimi i planit të monitorimit vjetor të mbetjeve të pesticideve me një plan kontrolli kombëtar, bazuar në faktorët shtesë të riskut, ku përfshihet konsumimi nga grupet e ndjeshme (vulnerabël) si dhe nga fazat e përpunimit para konsumit.

Prioritetet afatshkurtra në fushën e veterinarisë përfshijnë:

- Fillimin e hartimit të ligjit mbi shëndetin e kafshëve në përputhje me *acquis* e Bashkimit Evropian në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar të sigurisë ushqimore.

- Përfundimin e reformës në shërbimin veterinar, përfshirë personelin në të gjitha nivelet dhe miratimin e procedurave të brendshme operacionale.

- Marrjen në pronësinë e plotë të fushatave të vaksinimit kundër tërbimit, duke kaluar në të ardhmen në përdorimin e mjeteve të veta për fushata të tilla vaksinimi, në përputhje me detyrimet e harmonizimit me *acquis* përkatëse të BE-së si dhe vazhdimi i zbatimit me efikasitet i programit të vaksinimit kundër tërbimit (2020 – 2022);

- Përfshirja në regjistrin e kafshëve më shumë informacion mbi kafshët e tjera, të tilla si derrat, kuajt, shpendët dhe kafshët e tjera siç përmenden në Ligjin përkatës të BE-së për Shëndetin e Kafshëve.

- Krijimi i kapaciteteve të nevojshme për mbikëqyrjen pasive dhe aktive duke përfshirë vlerësime të besueshme të përhapjes së sëmundjeve, nëpërmjet një analize të plotë të të dhënave, planifikimit dhe zbatimit të sistemeve efektive për parandalimin dhe/ose çrrënjosjen e sëmundjeve.

- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi kontrollin e sëmundjeve në kafshë, higjienën e mirëqenien e kafshëve, kontrollet veterinarë në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimi i plotë i tyre.

Prioritetet afatshkurtra në fushën e fitosanitetit përfshijnë:

- Fillimin e hartimit të ligjit mbi shëndetin e bimëve në përputhje me *acquis* e Bashkimit Evropian në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar të sigurisë ushqimore.

- Përforcimi i kapaciteteve laboratorike në fushën fitosanitare;

- Regjistrimi i operatorëve profesionist;

- Trajnimin dhe miratimin e operatorëve për lëshimin e pasaportës bimë;

- Monitorimi, kontrolli dhe evidentimin të dëmtuesit karatinorë dhe jo karatinorë;

- Forcimi i strukturave implementuese i shërbimit fitosanitar;

- Përmirësimi i kontrollit të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe konsolidimi i kapaciteteve të monitorimit të pesticideve në produktet ushqimore;

- Plotësimi i kuadrit ligjor mbi kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në bimë dhe produkte bimë si dhe produkteve për mbrojtjen e bimëve në përputhje me aktet normative të BE-së dhe zbatimi i plotë i tyre.

KAPITULLI 13: PESHKIMI

4.13.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo kërkon futjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, e cila përfshin politikën e tregut, menaxhimin e burimeve dhe flotës, inspektimin dhe kontrollin, masat strukturore dhe kontrollin e ndihmës shtetërore. Në disa raste, marrëveshjet dhe konventat ekzistuese në fushën e peshkimit me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare është e nevojshme që të përshtaten.

4.13.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 13 nuk është i ndarë në nënkapituj.

4.13.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Sipas Nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin kombëtar me *acquis* e BE-së.

Detyrimi nga Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit rrjedh nga neni 96 i MSA-së. Neni përcakton rëndësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellët me interes të përbashkët me prioritetin që lidhet me *acquis* e BE-së për peshkimin, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare lidhur me rregullat e organizimit ndërkombëtar dhe rajonale të peshkimit për menaxhimin dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e peshkimit (me



përjashtim të ruajtjes së burimeve biologjike detare) janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis për peshkimin përbëhet nga rregulloret, të cilat nuk kërkojnë transpozimin në legjislacionin kombëtar, dhe kërkojnë marrjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për të zbatuar rregullat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit. Fusha e veprimit, objektivat dhe parimet e PPP-së janë të përcaktuara në Rregulloren kuadër të Politikës së Përbashkët të Peshkimit (Rregullorja e Këshillit (BE) Nr. 1380/2013).

PPP përcakton rregullat për ruajtjen e burimeve të gjalla ujore, kufizimin e ndikimit në mjedis të peshkimit dhe kushtet e aksesit në ujëra dhe resurse. Ai gjithashtu përfshin një politikë strukturore dhe rregulla specifike për menaxhimin e kapacitetit të flotës, kontrollin e aktivitetit të peshkimit dhe zbatimin e rregullave të saj. PPP bazohet në këshilla të shëndosha shkencore dhe ofron një kornizë për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave të peshkimit. Masat specifike të menaxhimit për shfrytëzimin e qëndrueshëm të peshkimit në Detin Mesdhe përcaktohen në Rregulloren (EC) Nr. 1967/2006 (Rregullorja Mesdhetare). Rregulla të veçanta zbatohen gjithashtu për menaxhimin e disa specieve, si për shembull, për ngjallën evropiane (Rregullorja 1100/2007).

Në lidhje me menaxhimin e resurseve dhe flotës, *acquis* përmban rregulla specifike për rregullimin e kapacitetit të peshkimit me qëllim që të kërkojë një ekuilibër midis flotës dhe rezervave, ashtu edhe matjen e tonazhit. Shteteve Anëtare u kërkohet të mbledhin dhe përditësojnë të dhënat lidhur me kapacitetin e peshkimit në një regjistër të veçantë të flotës së peshkimit. Inspektimi dhe kontrolli janë kryesisht përgjegjësi e Shteteve Anëtare që kanë nevojë të sigurojnë kapacitetet administrative për zbatim efektiv, ndërsa korniza ligjore është përgatitur në nivel të BE. Acquis përcakton ndërmjet të tjerash rregulla të

hollësishme për regjistrimin dhe raportimin e kapjeve dhe funksionimin e një sistemi monitorimi satelitor të anijeve.

Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 përcakton dispozitat për Fondin Evropian të Peshkimit Detar (EMFF) dhe përcakton masat financiare për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit, masat përkatëse në lidhje me Ligjin e Detit, zhvillimin e qëndrueshëm të fushës së peshkimit dhe akuakulturës, dhe peshkimin e brendshëm, si dhe Politikën e Integruar Detare. Për të përfituar nga Fondi Evropian i Peshkimit Detar, Shtetet Anëtare të BE duhet të miratojnë një dokument strategjik dhe një Program Operacional (OP). Shtetet Anëtare gjithashtu duhet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative dhe të kontrollit me qëllim që të sigurojnë një zbatim të shëndoshë dhe efikas të Programit Operacional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian për politikën e tregut përcaktohet nga Rregullorja Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe i Këshillit si dhe është i bazuar në organizatat profesionale, standardet e përbashkëta të marketingut, informacionin për konsumatorin, rregullat e konkurrencës dhe intelijenca e tregut.

Përveç rregulloreve të përgjithshme të ndihmës shtetërore, *acquis* përmban rregulla specifike të ndihmës shtetërore të zbatueshme për sektorin e peshkimit dhe akuakulturës.

Duke pasur parasysh kompetencën e saj ekskluzive në fushën e ruajtjes së burimeve biologjike detare, BE është pjesë e një numri të marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtare. Në disa raste, marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare duhet të përshtaten ose të shfuqizohen përpara anëtarësimit.

Shqipëria ka harmonizuar kuadrin e saj ligjor dhe dispozitat e rregulloreve kombëtare me dispozitat e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (CFP) me qëllim që në mënyrë adekuate të përgatisë sektorin dhe administratën për përmbushjen e plotë të detyrimeve të saj në kuadër të Politikës së Përbashkët të Peshkimit.

Pjesët kryesore të *acquis* të BE-së janë:

- Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës, duke ndryshuar rregulloret e Këshillit (KE) Nr.



1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizimi i Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 104/2000;

- Rregullorja Nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1954/2003 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe duke shfuqizuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 2371/2002 dhe (KE) Nr. 639/2004 dhe Vendimit të Këshillit 2004/585/EC;

- Rregullorja (BE) Nr. 2017/1004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2017 për krijimin e një kornize të Unionit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetje për këshilla shkencore në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 199/2008;

- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009 për krijimin e një sistemi të kontrollit të Komunitetit për të siguruar respektimin e rregullave të politikës së përbashkët të peshkimit, duke ndryshuar rregulloret (KE) Nr. 847/96, (KE) Nr. 2371/2002, (Nr. 811/2004, (KE) Nr. 768/2005, (EC) Nr. 2115/2005, (KE) Nr. 2166/2005, (KE) Nr. 388/2006, (KE) Nr. 509/2007, (KE) Nr. 676/2007, (KE) Nr. 1098/2007, (KE) Nr. 1300/2008, (KE) Nr. 1342/2008 dhe rregullat shfuqizuese (KEE) Nr. 2847/93, (KE) Nr. 1627/94 dhe (KE) Nr. 1966/2006.

- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1100/2007 e datës 18 shtator 2007 për vendosjen e masave për rikuperimin e stokut të ngjallave evropiane.

- Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 mbi Fondin Evropian të Detarisë dhe Peshkimit dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit (KE) Nr. 2328/2003, (EC) Nr. 861/2006, (KE) Nr. 1198/2006 dhe (KE) Nr. 791/2007 dhe Rregullorja (EU) Nr. 1255/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

4.13.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në peshkim, ka bërë progres të mirë duke finalizuar procesin e riaktivizimit të sistemit të monitorimit të anijeve (VMS) duke forcuar kapacitetet të inspektimit dhe kontrollit për të parandaluar peshkimin e

paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar. Qeveria miratoi planin për zonat e përcaktuara për akuakulturën në shkurt 2021, megjithatë, licencimi i sipërmarrjeve të akuakulturës do të zhvillohet në këto zona të përcaktuara pas diskutimeve me ministrinë e linjës.

Për krijimin e një tregu funksional të shitjes me shumicë të peshkut dhe ngritjen e sistemit të informacionit për tregtimin e peshkut ka përfunduar ndërtimi i tregut të tregimit të peshkut në Shëngjin. Ndërsa ndërtimi i tregut të Vlorës është në proces ndërtimi.

Janë identifikuar Zonat e Lejuara të Akuakulturës për hartimin e planeve shumëvjeçare strategjike kombëtare me qëllim zhvillimin e akuakulturës në Shqipëri.

Shqipëria ka përditësuar regjistrin e anijeve të peshkimit dhe ka bërë përparime për përmirësimin e statistikave të zbarkimit. Është vënë në zbatim sistemi i lëshimit të certifikatave të zënies për produktet e peshkimit.

Në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare, Shqipëria ka vazhduar të marrë pjesë në aktivitetet e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun dhe ka përmbyshur rekomandimet e dhëna. Përpos kësaj, Shqipëria ka përmbyshur të gjitha kërkesat e rekomandimet e Komisionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut. Shqipëria ka përmirësuar ndjeshëm raportimet në këto organizata në përputhshmëri me kërkesat e tyre.

Shqipëria ka përgatitur dhe dorëzuar Statlant37A_GFCM_FAO_2018 dhe Albania008A_2018, duke rishikuar të gjitha të dhënat e kapur që nga 2013. Nga ana tjetër, gjatë vitit 2018, Shqipëria dorëzoi të gjitha të dhënat sipas GFCM_DCRF-2017 si dhe ICCAT - Task I + II (2014 - 2017).

Në kuadër të peshkimit, Shqipëria nënshkroi Deklaratën MedFish4Ever të Maltës në lidhje me qëndrueshmërinë e burimeve të peshkimit në Mesdhe (një iniciativë e BE-së për të kthyer peshkimin në Mesdhe për qëndrueshmëri dhe në këtë mënyrë të ruajë rritjen ekonomike dhe vendet e punës) si dhe deklaratën e konferencës së Nivelit të lartë të peshkimit artizanal (HIL-SSF) në shtator 2018 në Maltë.



Me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së në fushën e peshkimit, për vitin 2021 janë përgatitur aktet e mëposhtme:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 113, datë 17.2.2021 “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”. Ky vendim i Këshillit të Ministrave është hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 103/2016 “Për Akuakulturën”, i ndryshuar, me qëllim zhvillimin e sektorit të akuakulturës në vend;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 330, datë 2.6.2021 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.719, datë 12.10.2016 “Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit”, të ndryshuar. Ky Vendim i Këshillit të Ministrave është përafruar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2017/218, datë 6 shkurt 2016 “Për regjistrin e flotës së peshkimit të Bashkimit”. Vendimi përcakton informacionin minimal për karakteristikat dhe aktivitetin e anijeve, të cilat duhet të shfaqen në regjistrin kombëtar të flotës së peshkimit;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 476, datë 30.7.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.402 datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e masave menaxhuese për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det”. Ky Vendim i Këshillit të Ministrave është përafruar pjesërisht me Rregulloren (BE) Nr. 1343/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 dhjetor 2011 mbi disa dispozita për peshkimin në zonën e marrëveshjes së GFCM (Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun) dhe Rregulloren (BE) 2019/1241 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 20 qershor 2019 për ruajtjen e burimet e peshkimit dhe mbrojtja e ekosistemeve detare nëpërmjet masave teknike. Vendimi ka për qëllim shtimin dhe përf forcimin e masave menaxhuese për ruajtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në det, në harmoni me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, mjedisor dhe social;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 255, datë 17.06.2021 “Për një ndryshim në Urdhrin Nr. 216, datë 29.05.2020

“Për një plan shumëvjeçar të menaxhimit të peshkimit të qëndrueshëm në detin Adriatik (nëzonat gjeografike 17 dhe 18), Rekomandimi GFCM/43/2019/5;

- Urdhri i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 402, datë 30.09.2021 “Për miratimin e Rregullores “Për hartimin e një plani për hedhjen e disa peshkimeve fundore në det”. Ky urdher është pjesërisht i përafruar me Rregulloren e deleguar të Komisionit (BE) Nr. 2017/86 të datës 20 tetor 2016 “Për krijimin e një plani të hedhjes së mbeturinave për disa peshkime fundore në Detin Mesdhe”. Urdhëri ka për qëllim reduktimin e hedhurinave duke shtuar detyrimin e zbarkimit për disa forma të peshkimit fundor në det;

- Rregullore Nr. 1, datë 19.7.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e tregut të Shëngjinit për tregtimin e produkteve peshkore”.

4.13.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni lider për kapitullin 13 është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që është edhe institucioni koordinues i grupit ndërinstitucional të punës.

Pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 13 janë dhe institucionet e mëposhtme:

- Instituti i Statistikave (INSTAT)

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)

4.13.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Mangësitë e identifikuara

Shqipëria duhet të kompletojë personelin e administratës së peshkimit dhe të krijojë kapacitetet e nevojshme administrative të sektorit të peshkimit për të zbatuar politikat kombëtare në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së (CFP) dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Pavarësisht krijimit të Drejtorisë së Peshkimit dhe Akuakulturës kapacitetet administrative mbeten akoma të ulëta.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 113, datë 17.2.2021 “Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi zonat e përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri” është miratuar dokumenti udhëzues të politikave mbi zonat e



përcaktuara për akuakulturë (ZPA) në Shqipëri, vetëm për një zone të vetme, ndërkohë që do të vazhdojnë diskutimet me aktorët e tjerë të përfshirë për miratimin edhe për zonat e tjera detare.

Prioritetet

Gjatë vitit 2022 Shqipëria synon këto prioritetet:

- Arritja e përputhjes së mëtejshme me kuadrin ligjor me rregullat e BE në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe ujërat e brendshme;
- Rritja e kapaciteteve të administratës së peshkimit, si dhe grumbullimi, përpunimi i të dhënave të zënieve për hartimin e planeve të menaxhimit të peshkimit si dhe raportimin në organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit (GFCM);
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Peshkimit;
- Zhvillimi i mekanizmave të duhura për grumbullimin e të dhënave në nivel kombëtar, e cila duhet të jetë plotësisht në përputhje me *acquis* të BE;
- Zbatimi dhe zhvillimi i politikave për organizimin e tregjeve të produkteve të peshkut me shumicë dhe pakicë dhe promovuar përmirësimin e cilësisë së produkteve të peshkut;
- Zgjerimi i mëtejshëm i porteve të peshkimit ekzistuese, ndërtimin e shkallëve për riparimin e anijeve dhe ndërtimin e bankinave për anijet e peshkimit në Vlorë, Sarandë dhe Shëngjinit, në mënyrë që të rritet gatishmërinë e treguesve teknike për flotën e peshkimit detar;
- Mbështetje për dhënien e kredive të buta për operatorët e peshkimit me qëllim riparimin dhe modernizimin e anijeve të tyre të peshkimit, pa rritur sforcën e peshkimit;
- Rritja e nivelit të përpunimit industrial të produkteve të peshkimit dhe të akuakulturës, përmirësimin e marketingut të tyre përmes rritjes së cilësisë dhe sigurisë;
- Forcimi i kapaciteteve të inspektimit, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes.

KAPITULLI 14: POLITIKA

E TRANSPORTIT

4.14.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së për sektorin e transportit synon përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurt, efikase dhe miqësore me mjedisin. Legjislacioni i fushës së transportit mbulon sektorët e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, transportin

e kombinuar, transportin ajror dhe detar. Ai ka të bëjë me standardet teknike dhe të sigurisë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në kontekstin e tregut të brendshëm të transportit.

4.14.2 Struktura e kapitullit

- Transporti rrugor
- Transporti hekurudhor
- Transporti detar
- Transporti ajror
- Transporti i kombinuar

4.14.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politiken e transportit rregullohet nga disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Neni 106 “Transporti” parashikon që palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së, me qëllim ristrukturimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit shqiptar, përmirësimin e lëvizjes së lirë të udhëtarëve dhe mallrave, lehtësimin e aksesit në tregun dhe infrastrukturën e transportit, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore trans-evropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Neni 59 i MSA-së në lidhje me Protokollin 5 “Për transportin tokësor” përcakton detyrimet e palëve në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit midis Komunitetit dhe Shqipërisë. Neni 59 parashikon se palët do të sigurojnë trafikun rrugor transit të pakufizuar bazuar në zbatimin efektiv të parimit të mosdiskriminimit. Në transportin detar, palët do të aplikojnë në mënyrë efektive parimin e aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik në baza komerciale pa hyrë në marrëveshje për ndarjen e mallrave me shtetet e treta, duke eliminuar të gjitha masat e njëanshme dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera që mund të pengojnë aksesin në transportin detar dhe garantimin e trajtimit kombëtar ndaj anijeve të palës tjetër. Në transportin ajror, palët do të bien dakord mbi kushtet e aksesit të ndërsjellët në tregun e transportit ajror.

Neni 70 dhe Neni 59(6) përcaktojnë se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së me qëllim përmirësimin e



sistemit të transportit dhe shërbimeve të transportit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat në kapitullin 14 i përkasin grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian, d.m.th. grupit të kompetencave të ndara mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare. Sipas Nenit 4 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si Bashkimi Evropian ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjore në fushën e transportit. Shtetet anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk e ushtron këtë kompetencë ose ka vendosur të mos e ushtrojë këtë kompetencë.

Politika e transportit e Bashkimit Evropian synon mobilitetin e qëndrueshëm, duke kombinuar konkurrueshmërinë e Evropës me mirëqenien e qytetarëve të saj, dhe duke kontribuar kështu në rritjen e sigurisë dhe forcimin e të drejtave. Ky është një komponent thelbësor i Evropa 2020, dhe kontribuon në kohezionin social dhe territorial. Objektivat e politikës së transportit të Bashkimit Evropian janë: të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm duke nxitur krijimin e një sistemi të integruar transporti të sigurtë, konkurrues, me përdorim eficient të burimeve, që respekton mjedisin, lehtësisht të përdorshëm dhe efektiv, i cili ofron një nivel të lartë të lëvizjes së qëndrueshme në Bashkimin Evropian, duke mbrojtur mjedisin, duke promovuar standardet e punës dhe kualifikimeve për sektorin dhe duke mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve. Politika e transportit të qëndrueshëm e Bashkimit Evropian kërkon një sistem transporti të integruar, ndërveprues dhe të ndërlidhur për të përballuar nevojat ekonomike, sociale dhe mjedisore të shoqërisë.

Politika e transportit e Bashkimit Evropian rregullohet nga Titulli VI, nenet 90 – 100 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Një pjesë e rëndësishme e *acquis* përbëhet nga legjislacioni i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë në formën e rregulloreve dhe vendimeve. Pjesa e mbetur e *acquis* në këtë kapitull, përbëhet nga direktiva, rregullore, vendime, etj., që kanë nevojë të transpozohen.

Acquis në këtë kapitull mbulon transportin rrugor, atë hekurudhor, transportin e brendshëm

ujor, transportin e kombinuar, aviacionin, transportin detar dhe navigacionin satelitor.

Pjesë të *acquis* në këtë kapitull janë të mbuluara nga Marrëveshja për Zonën Evropiane të Përbashkëta të Aviacionit, konkretisht në Aneksin I.

4.14.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Dokumenti strategjik bazë për sektorin e transportit është Strategjia Sektoriale e Transportit 2016 – 2020 miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020”. Zbatimi i këtij dokumenti strategjik është monitoruar rregullisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe grupi i posaçëm për monitorimin e Strategjisë. Raportimi final i zbatimit të Strategjisë së Transportit është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/Presentation-of-4th-Monitoring-Report-on-Sectoral-Transport-Strategy-and-Action-Plan-2016-2020-June-2021.pdf>.

Dokumente të tjera strategjike në sektorin e transportit janë edhe “Rishikimi i dytë i Planit Kombëtar të Transportit (PKT3)”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 40, datë 21.01.2020, dokument i cili po zbatohet, duke qenë se konsiderohet si një instrument në funksion të politikave të transportit. Po ashtu, për implementimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka nxjerrë Urdhrin Nr. 185, datë 18.6.2020 “Për zbatimin e “Strategjisë për aplikimin e sistemeve inteligjente në transportin rrugor”.

Në transportin rrugor ka vazhduar puna për përafrimin e legjislacionit të fushës me *acquis* të BE-së.

Akti ligjor bazë në sektorin e transportit hekurudhor është Ligji nr. 142/2016 “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”. Ky akt ligjor është i përafruar pjesërisht me Direktivën 2012/34/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 nëntor 2012 për krijimin e një zone të vetme evropiane hekurudhore, Direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 mbi sigurinë



hekurudhore, Direktivën (BE) 2016/797 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 mbi ndërveprimin e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian, Direktivën 2007/59/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007 mbi certifikimin e makinistëve të lokomotivave dhe trenave operative në sistemin hekurudhor në Komunitetin Evropian”, Rregulloren (BE) 2016/976 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016 për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Hekurudhat dhe që shfuqizon rregulloren (KE) nr. 881/2004, Rregulloren (KE) 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 tetor 2007 për shërbimet e transportit publik të udhëtarëve me hekurudhë dhe rrugë dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KKE) nr. 1191/69 dhe nr. 1107/70, Rregulloren (KE) 1371/2007 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007 mbi të drejtat dhe detyrimet e pasagjerëve hekurudhorë. Bazuar në këtë akt ligjor dhe në legjislacionin për zbatimin e tij, do të kryhet gjatë vitit 2022 riorganizimi i plotë i strukturës institucionale për sektorin e transportit hekurudhor.

Në transportin ajror, akti ligjor bazë është Ligji nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”. Ky akt ligjor është i përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) 2018/1139 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2018 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një Agjencie të Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian, dhe që ndryshon Rregulloret (KE) nr. 2111/2005, (KE) nr. 1008/2008, (BE) nr. 996/2010, (BE) nr. 376/2014 dhe direktivat 2014/30/BE dhe 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe që shfuqizon Rregulloret (KE) nr. 552/2004 dhe (KE) nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3922/91, Rregulloren (KE) nr. 1008/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 shtator 2008 mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore në Komunitetin Evropian, Rregulloren (KE) nr. 1070/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 tetor 2009, që ndryshon Rregulloret (KE) nr. 549/2004, (KE) nr. 550/2004, (KE) nr. 551/2004 dhe (KE) nr. 552/2004, me qëllim përmirësimin e performancës dhe

qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit evropian, Rregulloren (BE) nr. 996/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 tetor 2010 mbi hetimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil, e cila shfuqizon direktivën 94/56/KE, Rregulloren (KE) Nr. 300/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2008 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil, e cila shfuqizon rregulloren (KE) nr. 2320/2002”, e ndryshuar. Faza I e Marrëveshjes Shumëpalëshe për Krijimin e një Zone të Përbashkët të Aviacionit Evropian (ECAA), po zbatohet, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Protokollin I të kësaj Marrëveshjeje. Me vendimin nr. 1/2019, datë 31 korrik 2019, të Komitetit të Përbashkët të kësaj marrëveshjeje, është miratuar zëvendësimi i Aneksit I të saj, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së, L 211/4, datë 12.08.2019.

Në fushën e transportit detar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vazhduar punën me përafrimin e legjislacionit të fushës.

Gjatë vitit 2021, përparim është arritur në zbatimin e planit të rishikuar kombëtar të transportit (PKT3) dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe planit të saj të veprimit për periudhën 2021 – 2025. Puna ka avancuar për zgjerimin e Korridoreve të gjelbra me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në transportin rrugor, u miratua Ligji nr. 63/2021 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime të ligjit Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Ligji është në përputhje të pjesshme me Direktivën 2014/45/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit 3 prill 2014 mbi kontrollin teknik periodik të mjeteve rrugore dhe rimorkiove të tyre dhe shfuqizimin e Direktivës 2009/40/KE dhe Rregullores Zbatuese të Komisionit Evropian 621/2019. Me miratimin e Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6, datë 12.11.2021 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore” u përafra plotësisht kjo Direktivë.

Gjatë këtij viti vazhdoi zbatimi i Strategjisë së sigurisë rrugore. Po ashtu, filloi edhe hartimi i Strategjisë së re të sigurisë rrugore.

Është miratuar legjislacioni zbatues për ngritjen e autoriteteve të reja hekurudhore, duke përfshirë Ligjin nr. 88/2021 “Për krijimin e Autoritetit të



Sigurisë Hekurudhore”, Ligjin nr. 89/2021 “Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor”, Ligjin nr. 90/2021 “Për ndarjen e shoqërisë “Hekurudha Shqiptare SH.A.” dhe Ligjin nr. 91/2021 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare”, duke përafuar kështu pjesërisht Direktivën (BE) 2012/34, të datës 21 nëntor 2012, për krijimin e një zonë të vetme evropiane hekurudhore, Direktivën (BE) 2016/798 mbi sigurinë hekurudhore (e kodifikuar), Direktivën (BE) 2016/797, të datës 11 maj 2016 mbi interoperabilitetin (ndërveprimin) e sistemit hekurudhor brenda Bashkimit Evropian.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të përafritit të legjislacionit me *acquis* në fushën e transportit detar gjatë 2021 ka përafuar disa direktiva. Konkretisht Direktiva 2009/21/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 prillit 2009 mbi përputhshmërinë me kërkesat e shteteve të flamurit, miratuar me urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 410 datë 27.10.2021 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e kontrollit shtetëror të flamurit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Direktiva nr. 2978/94, datë 21 nëntor 1994, “Për zbatimin e Rezolutës së IMO-s A.747(18) “Për matjen e tonazhit të hapësirave të balastit në anijet cisternë të naftës me balast të veçuar”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 412, datë 28.10.2021 “Për matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë të naftës”.

Në fushën e transportit detar, në zbatim të masave për përmirësimin e performancës së anijeve me flamurin shqiptar në kuadër të memorandumit të Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual (Paris MoU) MIE në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe me Sekretariatit Permanent të TCT ka hartuar një Road Map i cili është i përbërë nga 33 masa. Në zbatim të këtyre masave gjatë 2021, është miratuar Urdhri i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 410 datë 27.10.2021 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e kontrollit shtetëror të flamurit në Republikën e Shqipërisë”, i cili përafuron plotësisht Direktivën 2009/21/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 23 prillit

2009 mbi përputhshmërinë me kërkesat e shteteve të flamurit.

Legjislacioni shqiptar në transportin ajror është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Shqipëria është duke përmbushur kushtet në lidhje me përfundimin e fazës së parë të Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit ECAA, duke përfshirë në legjislacionin kombëtar, kuadrin ligjor të BE-së, i përcaktuar në Shtojcën I të ECAA, e përditësuar me vendimin e Komisionit Evropian nr. 1/2019 e 31 korrikut 2019. Në zbatim të ligjit nr. 96/2020, datë 23.07.2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, i përafuar pjesërisht me legjislacionin evropian gjatë vitit 2021 janë miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë aktet nënligjore, si më poshtë:

- Urdhri nr. 26, datë 18.1.2021 “Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të Menaxhimit të Trafikut Ajror dhe të lundrimit ajror, si dhe funksionet e tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre”, i cili përafuron plotësisht Rregulloren e Zbatimit të Komisionit (BE) nr. 2017/373 e datës 1 mars 2017;

- Urdhri nr. 197, datë 10.5.2021 “Për miratimin e rregullores “Për transportin ajror të mallrave të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë” i cili është në zbatim të Konventës për Aviacionin Civil (ICAO);

- Urdhri nr. 296, datë 29.7.2021 “Për miratimin e rregullores mbi shërbimet e informacionit aeronautik në R.Sh”, i cili është në zbatim të Aneksit 15 të Konventës për Aviacionin Civil (ICAO);

- Urdhri nr. 163, datë 26.3.2021 “Për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil”, i cili përafuron plotësisht Rregulloren e Zbatuese të komisionit (BE) 2015/1998 e datës 5 nëntor 2015;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 739, datë 3.12.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil dhe rregullat për procesin e investigimit”, i cili përafuron plotësisht Rregulloren (KE) Nr. 996/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 tetor 2010 mbi



investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil dhe shfuqizon Direktivën 94/56/EC;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 24.12.2021 “Për përcaktimin e standardeve bazë për ruajtjen e Aviacionit Civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, që rrezikojnë sigurinë e Aviacionit Civil”, i cili përafron pjesërisht Rregulloren (BE) nr. 300/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 11 mars 2008 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil dhe shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 2320/2002, e ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 18/2010 e datës 8 Janar 2010.

4.14.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 14, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94 “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;
- Hekurudha Shqiptare Sh.a.;
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Regjistri Detar Shqiptar Sh.A.;
- Autoriteti i Aviacionit Civil;
- Instituti i Statistikave (INSTAT).

4.14.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritet

Me gjithë zbatimin e mirë të Strategjisë së sigurisë rrugore, është i nevojshëm hartimi i Strategjisë së re të sigurisë rrugore. Kjo Strategji duhet të përfshijë masa të reja në lidhje me reduktimin e njollave të zeza në infrastrukturën rrugore, por njëkohësisht të forcojë edukimin dhe masat për zbatimin e legjislacionit përkatës në bashkëpunim me të gjitha ministrive dhe institucioneve përkatëse. Kjo Strategji do të duhet të jetë në përputhje me Planin e Veprimit për Sigurinë Rrugore të Komunitetit të Transportit. Po ashtu, legjislacioni për sistemet e menaxhimit të trafikut dhe sigurinë rrugore do të duhet të përmirësohet më tej.

Në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme duhet të miratohen kriteret dhe procedurat e licencimit të institucioneve të formimit profesional, si dhe udhëzimet për programin e trajnimit dhe testimit të këshilltarëve të sigurisë. Janë hartuar tashmë 4 akte nënligjore në lidhje me këto çështje dhe gjatë vitit 2022 do të përfundojë konsultimin ndërinstitucional i tyre.

Në transportin hekurudhor, është miratuar tashmë kuadri ligjor për ndarjen e shoqërisë Hekurudha Shqiptare sh.a. dhe ngritjen e institucioneve të reja për rregullimin e transportit hekurudhor. Kapacitetet institucionale të këtyre institucioneve duhet të forcohen duke pasur parasysh zbatimin e legjislacionit të miratuar si dhe hartimin dhe miratimin e legjislacionit plotësuar në përputhje me acquis. Në sektorin hekurudhor do të vazhdojnë edhe përpjekjet për rritjen e volumit të mallrave të transportuara, për zgjerimin e transportit ndërkufitar hekurudhor, etj.

Në transportin detar, do të vijohet me zbatimin e planit të posacëm të masave për përmirësimin e situatës për anijet me flamur shqiptar. Pas forcimit të kapaciteteve institucionale të njësisë për kontrollin e flamurit do të vijohet me trajnimin e mëtejshëm të stafit dhe shtimin e inspektimeve. Kjo do të krijojë mundësi që gradualisht të përmirësohet situata në anijet me flamur shqiptar dhe të iniciohen procedurat për nënshkrimin e Memorandumit të Parisit për Kontrollin Shtetëror Portual.

Një mangësi që do të plotësohet gjatë vitit 2022 dhe në vijim është ngritja e sistemit të monitorimit dhe informacionit të anijeve (VTMIS).

Në transportin ajror, do të vazhdohet me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit. Janë përmbushur tashmë kushtet e përcaktuara në Shtojcën I të Marrëveshjes për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit. Gjatë vitit 2022 dhe më tej, do të vazhdohet me plotësimin e kushteve të mëtejshme të kësaj Marrëveshjeje.

Mangësi ka edhe në lidhje me zbatimin e sistemeve inteligjente në transport. Kjo do të përfshijë hartimin e dokumenteve strategjike (përveç transportit rrugor) dhe pastaj zbatimin e tyre përmes planeve të dedikuara të veprimit.

Legjislacioni shqiptar për të drejtat e pasagjerëve nuk është plotësisht në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Edhe kjo është një mangësi që duhet të përmbushet në periudhën e ardhshme.



Prioritetet e ministrive dhe institucioneve shqiptare të përfshira në kapitullin 14 gjatë vitit 2022 janë:

- Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Transportit për periudhën 2021 – 2025 dhe planit të saj të veprimit (me implikimet financiare plotësuar sipas PBA afatmesëm);

- Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë së re të Sigurisë Rrugore në përputhje me Planin e Veprimit për Sigurinë Rrugore të Komunitetit të Transportit;

- Zbatimi i legjislacionit për reformën e sektorit hekurudhor në përputhje me Planin e Veprimit Hekurudhor të Komunitetit të Transportit dhe garantimi i funksionimit të plotë të rrjetit të transportit hekurudhor;

- Përsheptimi i marrjes së masave konkrete për përmirësimin e performancës së anijeve detare me flamur shqiptar.

KAPITULLI 15: ENERGJIA

4.15.1 Përmbajtja e kapitullit

Objektivat e politikës energjetike të BE-së përfshijnë, ndër të tjera, rritjen e konkurrencës në tregjet e energjisë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimeve me energji, mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Acquis i BE-së për energjinë përbëhet nga rregullat dhe politikat veçanërisht në lidhje me zhvillimin e sektorëve të energjisë elektrike, gazit dhe naftës, energjitë e rinovueshme, konkurrencën dhe ndihmën shtetërore (përfshirë sektorin e qymyrit), tregun e brendshëm të energjisë (hapja e tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit), akses jodiskriminues në rrjetet e energjisë, reduktimi i varfërisë energjetike, siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimi si dhe promovimi i burimeve të rinovueshme të energjisë dhe efica e energjisë.

Për sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, Kapitulli 15 përfshin Traktatin e Komunitetit të Energjisë, si dhe Traktatin e Kartës së Energjisë dhe instrumentet përkatëse.

4.15.2 Struktura e kapitullit

- Siguria e furnizimit
- Tregu i energjisë
- Eficenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë
- Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

4.15.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

Kërkesat e MSA-së në sektorin e energjisë përcaktohen në nenin 107 të tij, i cili parashikon se bashkëpunimi energjetik do të fokusohet në fushat prioritare që lidhen me acquis të BE-së në fushën e energjisë, duke përfshirë aspektet e sigurisë bërthamore sipas rastit. Bashkëpunimi në sektorin e energjisë do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe do të bazohet në Traktatin e nënshkruar rajonal të Komunitetit të Energjisë me synimin për integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë evropiane. Prandaj, prioritetet për përafrimin ligjor dhe rregullator të Shqipërisë me acquis të BE-së për energjinë rrjedhin qartë nga acquis e Komunitetit të Energjisë, d.m.th., nga ato akte ligjore të BE-së, të cilat janë përshtatur dhe inkorporuar për Komunitetin e Energjisë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë.

Përveç kësaj, neni 17(2) i MSA-së përcakton se tregtia e produkteve të mbuluara nga Traktati për themelimin e Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike do të kryhet në përputhje me dispozitat e atij Traktati. Neni 70 i MSA-së përcakton më tej se Shqipëria duhet të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me acquis të BE-së, duke synuar, ndër të tjera, të përmirësojë sektorin e saj të energjisë.

Lidhur me kërkesat e acquis të BE-së, politikat sipas Kapitullit 15 bëjnë pjesë në Grupin II të kompetencave të BE-së, d.m.th., kompetencat e përbashkëta (neni 4 i TFEU): BE-ja dhe vendet e BE-së kane kompetencën të nxjerrin ligje dhe të miratojnë akte ligjorë të detyrueshme. Vendet e BE-së ushtrojnë kompetencën e tyre aty ku BE-ja nuk ushtron ose ka vendosur të mos ushtrojë kompetencën e saj.

4.15.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin energjetik të Shqipërisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 31.07.2018. Strategjia është në përputhje me përpjekjet kombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të përmbushur angazhimet e saj sipas MSA-së, Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Strategjia fokusohet në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe liberalizimi i tregut të



energjië me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët e ekonomisë.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në sektorin e energjië për anëtarësim në BE. Gjatë disa viteve të fundit, është arritur një progres i dukshëm në përafrimin e rregulloreve që rregullojnë sektorët e energjië elektrike dhe gazit si dhe shkëmbimet ndërkufitare të energjië. Vazhduan më tej aktivitetet për garantimin e qëndrueshmërisë ekonomike të sektorit të energjië elektrike dhe gazit dhe për zbatimin e legjislacionit sektorial përkatës. U ndoq zbatimi i masave të buta organizative dhe është bërë progres i mirë me ngritjen e bursës së energjië përgjegjëse për funksionimin e tregut të organizuar të energjië elektrike të ditës në avancë dhe brenda ditës.

- Siguria e furnizimit

Legjislacioni shqiptar për sigurinë e furnizimit është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së.

Qeveria e Shqipërisë po i jep një shtysë të re reformave të energjië, ndërkohë që konsolidon përpjekjet ekzistuese për të siguruar kushte të favorshme për zhvillimin e energjië së rinovueshme dhe për të respektuar angazhimet e saj rajonale dhe ndërkombëtare. Ndërsa tregu ka dëshmuar përparime të konsiderueshme vitet e fundit, Qeveria Shqiptare tani është më e vendosur se kurrë për të rritur investimet që do të formësojnë të ardhmen e energjië, duke krijuar një udhërrëfyes të qartë strategjik për burimet e rinovueshme.

Legjislacioni shqiptar në tregun e energjië elektrike është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjië elektrike” i ndryshuar është plotësisht i përputhur me Direktivën 2009/72/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjië elektrike dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/54/EC dhe Rregulloren (EC) No 714/2009. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjië Elektrike”. Miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut të Energjië Elektrike ishte hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjië elektrike në Shqipëri në një treg të energjië plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjië.

- Tregu i energjië

Legjislacioni shqiptar që rregullon marrëdhëniet në tregjet e energjië elektrike dhe gazit është kryesisht në përputhje me *acquis* të BE-së për energjinë.

Ligji nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjië elektrike”, i ndryshuar, është hartuar dhe miratuar në përputhje me Direktivën 2009/72/EC dhe Rregulloren (KE) Nr. 714/2009. Bazuar në këtë ligj, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016 Modeli i Tregut të Energjië Elektrike, i cili shihet si hapi përmbyllës drejt zhvillimit të një tregu plotësisht konkurrues të energjië elektrike në Shqipëri, në zbatim të angazhimeve të saj në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjië.

Në përputhje me kërkesat e ligjit nr.43/2015 dhe modelit të tregut të energjië elektrike, Enti Rregullator i Energjië Shqiptare (në vijim “ERE”) miratoi Rregullat e Tregut të Energjië Elektrike (Vendimi nr. 214, datë 28.12.2016), të cilat rregullojnë tregun e ditës në avancë dhe brenda ditës të energjië elektrike, si dhe Rregullat e Tregut të Balancimit të Energjië Elektrike (Vendimi nr. 106, datë 02.07.2020), të cilat kërkojnë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Sh.A të sigurojë shërbime balancimi nëpërmjet një procesi konkurrues të bazuar në treg.

Tregu i balancimit të energjië elektrike u lançua në prill të vitit 2021, ndërsa tregu i energjië elektrike i ditës në avancë dhe brenda ditës pritet të bëhet funksional gjatë vitit 2022.

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 dhe ndryshimet e tij të mëvonshme, kërkesat për paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjië elektrike në zbatim të Rregullores (BE) nr. 543/2013 janë transpozuar në legjislacionin kombëtar shqiptar dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit OST Sh.A. ka filluar me publikimin e të dhënave në Platformën e Transparencës ENTSO-E.

Të tre Kodet e Rrjetit të Energjië Elektrike për lidhjet në rrjet të zbatueshëm në Komunitetin e Energjië – Rregullorja (BE) 2016/631, Rregullorja (BE) 2016/1388 dhe Rregullorja (BE) 2016/1447 – u transpozuan nga ERE në 2018. Megjithatë, siç raportohet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjië, zbatimi i plotë i tyre ende nuk është përfunduar.



- Eficenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë

Ligji nr. 124/2015, datë 12.11.2015 “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, është kryesisht në përputhje me Direktivën 2012/27/BE, veçanërisht si rezultat i ndryshimeve të saj të miratuara në vitin 2021. Ky ligj synon krijimin dhe zbatimin e politikave kombëtare të Shqipërisë dhe rregullore për të promovuar dhe përmirësuar përdorimin efikas të energjisë, dhe përcakton objektivat përkatëse të detyrueshme për sektorin publik, privat dhe konsumatorët e mëdhenj. Siç kërkohej me Ligjin Nr. 124/2015, KM themeloi Agjencinë për Efiçencë të Energjisë si një institucion përgjegjës për zbatimin e politikave dhe promovimin e masave për efiçencën e energjisë.

Ndryshimet në ligjin nr. 124/2015, të paraqitura me ligjin nr. 28/2021 të datës 8.03.2021, konsistojnë në përafrim të mëtejshëm të rregulloreve të efiçencës së energjisë me Direktivën 2012/27/EC dhe përmbajnë dispozita që kërkojnë përafrimin dhe harmonizimin e Efiçencës së Energjisë kombëtare dhe lokale me Planet e Veprimit me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, futja e skemave të detyrimit për efiçencën e energjisë, përmirësimi i efiçencës së energjisë në ndërtesat ku ndërtesat qeveritare pritet të luajnë një rol shembullor, dispozita për të dhënat e konsumit të energjisë etj.

Ligji Nr. 116/2016, datë 10.11.2016 “Për performancën energjetike të ndërtesave” është kryesisht në përputhje me Direktivën 2010/31/BE. Ky ligj rregullon përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave, duke marrë parasysh kushtet klimatike lokale, nivelet e komoditetit të brendshëm të një ndërtese dhe gjithashtu efektivitetin e kostos për ndërtimin e ndërtesave të reja dhe rindërtimin e atyre ekzistuese.

Në zbatim të ligjit nr. 116/2016, KM ka miratuar një sërë rregulloresh zbatuese, të cilat specifikojnë më tej masat dhe procedurat për përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave dhe gjithashtu kurojnë boshllëkun e mëparshëm të akteve nënligjore të munguara për zbatimin praktik të ligjit. Në veçanti, KM miratoi vendimet e mëposhtme:

- Vendimi nr. 537, datë 08.07.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës energjetike të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesës”;

- Vendimi nr. 256, datë 27.03.2020 “Për metodologjinë e llogaritjes së niveleve optimale të kostos për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave”;

- Vendimi nr. 958, datë 02.12.2020 “Për procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës energjetike të ndërtesave dhe modelin, përmbajtjen, kushtet e regjistrimit të “Çertifikatës së performancës energjetike” të ndërtesave përkatëse;

- Vendimi nr. 954, datë 25.11.2020 “Për kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe numrin e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesin e mbikëqyrjes së certifikatave të performancës energjetike të ndërtesave”;

- Vendimi nr. 1094, datë 24.12.2020 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare për llogaritjen e performancës energjetike në ndërtesa”.

Këshilli i Ministrave në dhjetor 2022 ka miratuar Planin Kombëtar të integruar të Energjisë dhe Klimës bazuar në Rekomandimin 2018/1/MC-EnC dhe në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1999, ku parashikohen targetet dhe masat e efikasitetit të energjisë.

Nga ana tjetër, transpozimi kombëtar dhe zbatimi i rregulloreve të etiketimit të energjisë në Shqipëri ka patur vonesa, referuar Rregullores (BE) 2017/1369 dhe Rregulloreve përkatëse të Deleguara në përputhje me përshtatjet e Komunitetit të Energjisë të viteve 2014 dhe 2018. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë thekson çështjet e zbuluara të pajtueshmërisë dhe mungesën e progresit të transpozimit dhe zbatimit të nevojshëm. Kurimi i këtij hendeku në përafrimin e ligjit kombëtar të Shqipërisë me rregullat e BE-së për etiketimin e energjisë shihet si një nga prioritetet kryesore për periudhën e ardhshme.

Ligji nr. 7/2017, datë 02.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i ndryshuar, synon nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme në Shqipëri dhe është kryesisht në përputhje me Direktivën 2009/28/KE. Një sërë aktesh nënligjore ende mungojnë për të zbatuar plotësisht Ligjin në përputhje me acquis të BE-së.

Në zbatim të Planit të Konsoliduar Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme



(PKVRE) për 2019 – 2020, i ndryshuar i cili përcakton një shtrirje të PKREAP (2019 – 2020) deri në vitin 2021 dhe parashikon një rritje mesatare të gjeneruesve të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme në masën prej 738 MW nga të cilat: hidroenergji – 57 MW, energji diellore (fotovoltaike) – 490 MW, energji e erës – 150 MW, dhe energji nga mbeturinat – 41 MW, siç kërkohej nga neni 22 i Direktivës 2008/28/KE, Shqipëria informon rregullisht Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për zbatimin e PKRE-së dhe paraqet raportet e saj të progresit të energjisë së rinovueshme.

Gjithashtu, me synimin për të nxitur përdorimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, dhe konkretisht për të nxitur prodhimin e energjisë elektrike nga energji diellore dhe e erës, KM miratoi skemën për zhvillimin konkurrues të prodhimit të energjisë së rinovueshme dhe masat mbështetëse përkatëse. Në vijim të kësaj skeme, janë përfunduar me sukses dy ankande konkurruese për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese fotovoltaike me një kapacitet total të instaluar 240 MW dhe është shpallur një ankand i ri për ndërtimin e impianteve me erë me një fuqi të instaluar prej 70 – 150 MW.

Shqipëria ka pasur disa përparime në reformat e tregut të energjisë elektrike dhe masat e reformës së lidhjes, në sektorët e burimeve të rinovueshme dhe gazit dhe në linjat e interkonjeksionit rajonal, si dhe në kalimin nga prodhimi ekskluziv dhe hidrocentral në burimet e rinovueshme të energjisë fotovoltaike dhe të erës. Përpjekje të tilla duhet të ndiqen më tej duke marrë parasysh angazhimet e saj sipas Marrëveshjes së Parisit për Ndryshimet Klimatike dhe nevojën për t'u angazhuar në tranzicionin e energjisë së pastër në përputhje me Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, siç është miratuar nga Samiti i Sofjes në nëntor 2020.

Ligji nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, ka përafruar pjesërisht Direktivën 94/22/EC, të datës 30 maj 1994 për kushtet për dhënie dhe përdorimin e autorizimeve për zbulim, kërkim dhe prodhimin e hidrokarbureve. Në këtë ligj përcaktohen bazat mbi të cilat kryhet aktiviteti i kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve në Shqipëri. Në të janë të përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe

prodhimin e hidrokarbureve, duke përfshirë si kusht edhe garantimin e sigurisë kombëtare në rastin e lidhjes apo transferimit të kuotave të marrëveshjes hidrokarbure. Në të janë të përcaktuar edhe parimet bazë që duhet të ketë një marrëveshje hidrokarbure.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Master Plani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nëpërmjet Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (Projekti TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe nëpërmjet gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Ionian Adriatik Pipeline (Projekti IAP), gazsjellësi Shqipëri – Kosovë (Projekti ALKOGAP).

Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, është ende në fuqi. Ligji është i përafruar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2009/119/KE të datës 14 shtator 2009 që vendos një detyrim ndaj Shteteve Anëtare për të ruajtur rezervat minimale të naftës bruto dhe/ose produkteve të naftës. Ligji përcakton detyrimin për të mbajtur një rezervë sigurie për naftën dhe nënproduktet e naftës për 90 ditë të mesatares së shitjeve, duke filluar nga 2010.

Ligji nr. 9876, datë 14.2.2008 “Për prodhimin, transportin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport” i ndryshuar, është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

Ligji nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KE. Në bazë të këtij Ligji, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 590, datë 9.10.2018 “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”. Miratimi i Modelit të



Tregut të Gazit është një hap i rëndësishëm drejt zhvillimit të tregut të gazit në Shqipëri duke garantuar një treg plotësisht konkurruese, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ligji Nr. 81/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”, ka përafuar Rregulloren 2017/1938 e Parlamentit Evropian konsiston në masat që duhet të merren për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz dhe ka në thelbin e saj miratimin e planit të veprimit parandalues dhe të një plani emergjence për masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e furnizimit me gaz.

Kuadri i politikave në mbrojtjen e rrezatimit përfshin tre dokumente të politikave:

- Politika për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, e përgatitur si dokumenti Nr. 1319/3 e 25.03.213 nga Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi;

- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 435, datë 14.10.2015 “Për miratimin e dokumentit “Hapat strategjike për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”. Dokumenti është i vlefshëm për periudhën 2017 – 2030 duke përcaktuar masat që duhen marrë për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Shqipëri;

- Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 434, datë 14.10.2015 “Për miratimin e dokumentit “Arsimi dhe trajnimi për mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimi jonizues dhe hapat për zbatimin e tij”, që përcakton masat për trajnimin e personelit që merret me materiale radioaktive.

Akti kryesor ligjor në mbrojtjen e rrezatimit është Ligji Nr. 8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues”, i ndryshuar, pjesërisht i përafuar me Direktivën e Këshillit 2013/59/Euratom të 5 dhjetorit 2013 që përcakton standardet themelore të sigurisë për mbrojtjen kundër rreziqeve që dalin nga ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues dhe shfuqizimin e Direktivave 89/618/Euratom, 90/641/Euratom, 96/29/Euratom, 97/43/Euratom dhe 2003/122/Euratom. Kjo direktivë është e përafuar pjesërisht me:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Shqipëri”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 9, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për kategorizimin e burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 7.01.2010 “Për miratimin e Rregullores për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me rrezatim jonizues”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 877, datë 30.10.2015 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen fizike të materialeve radioaktive”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 957, datë 25.11.2015 “Për miratimin e rregullores mbi nivelet e përqendrimit të radonit të brendshëm dhe përqendrimin radioaktiv në mallra, me qëllim mbrojtjen e publikut”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 638, datë 7.09.2016 “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e sigurt të mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 815, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Rregullores për transportin e sigurt të materialeve radioaktive”;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 700 datë 21.11.2018 “Për miratimin e rregullores “Për përgatitjen dhe reagimin në rast emergjence radiologjike për mbrojtjen e punonjësve dhe të publikut;

- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 801 datë 11.12.2019 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut dhe punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimit jonizues, dhe sigurisë ndaj ekspozimeve mjekësore me burimet e rrezatimit jonizues”.

Përveç kësaj, në fushën e mbrojtjes bërthamore dhe rrezatimit, Shqipëria ka ratifikuar konventat e mëposhtme ndërkombëtare:

- Konventa e përbashkët për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të përdorur dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive, ratifikuar me Ligjin Nr. 10379, datë 24.02.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e bashkuar “Për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive” i cili hyri në fuqi më 27.09.2011;

- Konventa për Sigurinë Bërthamore, ratifikuar me Ligjin Nr. 10380, datë 24.02.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në



Konventën për Sigurinë Bërthamore”, që ka hyrë në fuqi më 27.09.2011;

- Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore, ratifikuar me Ligjin Nr. 8853, datë 31.01.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore’”, hyrë në fuqi më 4.04.2002. Amendamentet e Konventës për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore të ratifikuara me Ligjin Nr. 88/2013, datë 21.02.2013 “Për ratifikimin e ndryshimeve në Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore”, hynë në fuqi më 6.03.2013;

- Konventa për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor, e ratifikuar me Ligjin Nr. 9026, datë 13.03.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për njoftimin e hershëm të një aksidenti bërthamor’”, që hyri në fuqi më 30.10.2003;

- Konventa për ndihmën në rastin e një aksidenti bërthamor ose të emergjencave radiologjike, ratifikuar me Ligjin Nr. 9015, datë 20.02.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për ndihmë në rast aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjik”, e cila hyri në fuqi më 31.05.2003;

- Konventa mbi protokollin shtesë, ratifikuar me Ligjin Nr. 10314, datë 16.09.2010 “Për ratifikimin e Protokollit Shtesë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për zbatimin e garancive për të gjitha aktivitetet bërthamore në Shqipëri”, e cila hyri në fuqi më 3.11.2010.

4.15.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - Enti Rregullator i Energjisë (ERE);
 - Agjencia Kombëtare Bërthamore;
 - Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi;
 - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
 - Agjencia për Eficiencë të Energjisë;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

4.15.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Disa nga strukturat kryesore kombëtare institucionale dhe administrative për zbatimin e

Direktivës (BE) 2018/2001 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme nuk janë krijuar ende. Miratimi i akteve nënligjore të mbetura në zbatim të ligjit nr. 7/2017, datë 02.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

Bazuar në VKM nr. 275, datë 16.05.2018, deri në krijimin e Operatorit të Energjive të Rinovueshme këto funksione do të kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE).

Funksionet e Agjencisë përgjegjëse për burimet e rinovueshme të energjisë kryen Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore.

EEA mbetet një institucion relativisht i ri, prandaj trajnimi i stafit dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të ecur më tej me zbatimin e masave për eficientë të energjisë.

Sipas parashikimeve të meparshme të bazuara në Direktivën 2009/125/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 21 tetorit 2009 që krijon një kornizë për vendosjen e kërkesave të ekodizajnit për produktet e lidhura me energjinë, e cila nuk është ende pjesë e Komunitetit të Energjisë acquis, është i përjashtuar pasi nuk shihet më si prioriteti më i madh i transpozimit. Megjithatë konsiderohet të jetë një zgjidhje e kujdesshme për të zhvilluar legjislacionin kombëtar të ekodizajnit paralelisht me rregulloret e etiketimit të energjisë.

Finalizimi i rekomandimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjise për ndarjen funksionale të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike duke emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili do të monitorojë zbatimin e programit të pajtueshmërisë së OSSH, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në dhjetor 2020.

Përparësitë e mëposhtme tregohen brenda fushës së Kapitullit 15:

1. Siguria e furnizimit:

– Finalizimi dhe miratimi i projektligjit “Për krijimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e stoqeve minimale të sigurisë së naftës bruto dhe produkteve të naftës” për të siguruar përafrimin e plotë me Direktivën 2009/119/KE për sistemin e ruajtjes së naftës.

2. Tregu i energjisë:

– Liberalizimi i tregut të energjise dhe rritja e sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

– Finalizimi i ndarjes funksionale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së



energjisë elektrike dhe përmirësimi i rregullave të ndërrimit të furnizuesit të energjisë elektrike.

– Zhvillimi dhe miratimi i akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

– Nisja e tregut të organizuar të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe brenda ditës dhe zbatimi i bashkimit të tregut të energjisë elektrike me Kosovën, duke përfshirë përcaktimin e NEMO.

3. Efienca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë:

– Finalizimi i përafrimit të ligjit kombëtar me rregullat e efiençës së energjisë (Direktiva 2012/27/BE) dhe performancën energjetike të ndërtesave (Direktiva 2010/31/BE) me zhvillimin dhe miratimin e akteve të tjera nënligjore.

– Përditësimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Efiençën e Energjisë dhe zhvillimi i Planeve të Veprimit përkatës vendor për Efiençën e Energjisë.

– Finalizimi i transpozimit kombëtar dhe zbatimi i Direktivës 2018/28/KE që përfshin (i) plotësimin dhe miratimin e bazës ligjore parësore për përdorimin e energjisë së rinovueshme në transport (biokarburantet), dhe (ii) zhvillimin dhe miratimin e akteve nënligjore të mbetura në zbatim. Miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 7/2017, datë 02.02.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” duke përafruar pjesërisht direktiven 2018/2001.

KAPITULLI 16: TATIMET

4.16.1 Përmbajtja e kapitullit

Rregullat e BE-së për tatimet mbulojnë tatimin mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës si dhe aspekte të tatimit të korporatave. Gjithashtu, këto rregulla disjplinojnë bashkëpunimin ndërmjet administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për parandalimin e evazionit fiskal.

4.16.2 Struktura e kapitullit

1. Tatimi i tërthortë: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe detyrimet e akcizës

2. Tatimi i drejtpërdrejtë

3. Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë

4.16.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Neni 98 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon se Shqipëria dhe BE-ja do të vendosin bashkëpunimin në fushën e tatimeve. Ky bashkëpunim përfshin masat që synojnë forcimin e reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe ristrukturimin e administratës tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE-ja e njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin tatimor. Gjithashtu, ky nen kërkon konsultime ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare të BE-së, me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve midis tyre, për të siguruar një nivel të barabartë për sa i përket tatimit të biznesit.

Acquis në fushën e tatimeve mbulon gjerësisht fushën e tatimeve indirekte, që përfshin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) dhe detyrimet e akcizës. Ai përcakton fushën e zbatimit, përkufizimet dhe parimet e TVSH-së. Detyrimet e akcizës mbi produktet e duhanit, pijet alkoolike dhe produktet energjike janë gjithashtu objekt i legjislacionit të Bashkimit Evropian. Për sa i përket tatimeve direkte, *acquis* mbulon disa aspekte të tatimit mbi të ardhurat nga kursimet e individëve dhe tatimet e korporatave.

Acquis në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë ka të bëjë me aspekte të caktuara të tatimeve të fitimit dhe shmangies së taksimit të dyfishtë. Fokusi është në eliminimin e parregullsive për aktivitetet ekonomike ndërkufitare ndërmjet ndërmarrjeve brenda Bashkimit. Kodi i Sjelljes për Taksimin e Biznesit përfaqëson një angazhim politik nga Shtetet Anëtare për të trajtuar konkurrencën e dëmshme tatimore. Shtetet Anëtare janë të detyruara të mos vendosin masa të reja të dëmshme tatimore dhe të rikthejnë ato ekzistuese.

Legjislacioni i BE-së në fushën e bashkëpunimit administrativ dhe asistencës së ndërsjellë midis autoriteteve tatimore dhe doganore të Shteteve



Anëtare siguron mjete për të shkëmbyer informacione me qëllim parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangien e tyre dhe ndihmën e tyre në zbatimin e legjislacionit doganor. Informacione të caktuara lidhur me tatimet dhe doganat shkëmbehen automatikisht, informacione të tjera shkëmbehen në mënyrë spontane ose pas një kërkesë.

Acquis në fushën e kapaciteteve operacionale dhe kompjuterizimit mbulon fusha të ndryshme të taksimit. *Acquis* për Sistemin e Shkëmbimit të Informacionit mbi Vlerën e Shtuar (VIES) parashikon shkëmbimin e drejtpërdrejtë elektronik të të dhënave ndërmjet administratave kombëtare të TVSH-së. Kjo lejon që administratat kombëtare të monitorojnë dhe kontrollojnë tregtinë brenda BE-së dhe të zbulojnë parregullsi të mundshme. Lidhur me akcizat, *acquis* kërkon që sistemet e IT-së t'u lejojnë Shteteve Anëtare të shkëmbejnë informacion mbi prodhuesit dhe tregtarët e produkteve të akcizës. Sisteme të tilla janë Regjistri Evropian i operatorëve (Sistemi për Shkëmbimin e të Dhënave të Akcizave - SEED) dhe sistemi për monitorimin e Shërbimeve Qendrore / Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Akcizat (CS/MISE). Lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit mbikëqyren brenda BE-së nëpërmjet Sistemit Elektronik të Lëvizjes dhe Kontrollit të Akcizës (EMCS). Në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë, Shtetet Anëtare duhet të vendosin një sistem të shkëmbimit automatik të informacionit për pesë kategori të të ardhurave dhe kapitalit (të ardhurat nga punësimi, tarifrat e drejtorëve, pensionet, produktet e sigurimit të jetës dhe pronësia e të ardhurave nga pronat e paluajtshme (dividentë, fitime kapitale, të ardhura të tjera të gjeneruara në lidhje me pasuritë e mbajtura në një llogari financiare, çdo shumë në lidhje me faktin nëse një institucion financiar është obliguesi apo debitori, duke përfshirë pagesat e riblerjes, balancat e llogarisë) përmes formave të kompjuterizuara standarde.

4.16.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e taksimit. **Njëfarë përparimi** është arritur, në veçanti me përafrimin e pjesshëm me Direktivën e Bashkimit, Ndarjes së Shoqërive, zvogëlimin e stoku të detyrimeve në rimbursimet e

TVSH-së dhe shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare.

Për **tatimet indirekte**, norma standarde e TVSH-së është 20% dhe normat e reduktuara janë 6% dhe 10%. Megjithatë, ka rritje të mëtijshme të numrit të përjashtimeve si për jahtet dhe mjetet ujore jo më të vjetra se 20 vjet. Lehtësimi i kriterëve të riskut në prill 2020 dhe procedurat e thjeshtuara rezultuan në pagesa më të shpejta të rimbursimit të TVSH-së. Që nga prilli 2020, publikohet rregullisht stoku tremujor i rimbursimit të TVSH-së. Deri në mars 2021, stoku u reduktua në 48.5 milionë euro, krahasuar me 93.3 milionë euro në dhjetor 2019 dhe 137 milionë euro në dhjetor të vitit 2018. Që nga janari 2021, në përgjigje të ndikimit të COVID-19, vetëm tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 81 750 euro (pragu i mëparshëm ishte 16 350 euro) i nënshtrohen TVSH-së dhe ata me qarkullim vjetor mbi 40 870 euro mund të zgjedhin nëse duan t'i nënshtrohen TVSH-së. Ligji i akcizës takson të gjitha produktet energjetike të listuara në Direktivën 2003/96/EC.

Me ligjin Nr. 85/2019, datë 18.12.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 184, datë 31.12.2019, u miratuan disa përjashtime nga TVSH-ja që lidhen me procesin e ndërtimit, të cilat konsistojnë në mbështetjen e procesit të rindërtimit të zonave të prekura nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Gjithashtu, me anë të këtij ligji u miratua edhe trajtimi si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, i automjeteve me motor vetëm elektrik, të reja, me zero km e që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër.

Lidhur me kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar, nga data 1 janar 2021, është aplikuar si kufi minimal i regjistrimit, qarkullimi prej 10 milionë lekë në një vit kalendarik, bazuar në përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 576, datë 22.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 139, datë 29.07. 2020. Ndërkohë që, çdo person i tatueshëm që ka një qarkullim vjetor më të madh se 5 milionë lekë, ka të drejtë të zgjedhë të zbatojë regjimin normal të TVSH-së.

Ndërkohë, me ligjin nr. 64/2020, datë 14.05.2020 u miratua përjashtimi nga TVSH-ja për importimin e jahteve dhe mjeteve të tjera ujore, që



përdoren për qëllime turistike, kënaqësie dhe argëtimi, jo më të vjetra se 20 vjet, që përfshihen në kodin 8903 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Me ligjin nr. 123/2020, datë 15.10.2020, pjesë e furnizimeve që trajtohen me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 6% u bë edhe furnizimi i shërbimit të punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive/federatave sportive apo për investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive, të përcaktuar në legjislacionin e fushës për sportin.

Me Ligjin nr. 111/2021, datë 25.11.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për inputet bujqësore është vendosur aplikimi i normës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar prej 10%.

Norma e kompensimit për prodhuesit bujqësorë është ndryshuar nga 6 për qind në 0 për qind. Gjithashtu, është vendosur përjashtimin nga TVSH-ja për importimin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë.

Taksimi i akcizës është pjesërisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së. Vajrat minerale janë shënuar për disa përdorime. Akciza e favorshme për duhanin e përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri vazhdon. Prodhuesit e vegjël të pijeve alkoolike gëzojnë tarifa të reduktuara tatimore. Ligji i akcizës takson të gjitha produktet energjetike të listuara në Direktivën 2003/96/EC përveç elektricitetit.

Akciza e duhanit është rritur gradualisht duke vendosur një kalendar rritje për të gjitha kategoritë e “Duhani dhe nënprodukteve të tij të përcaktuar në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar së fundmi me Ligjin nr. 114/2021.

Janë shtuar kategoritë, shisha, nargjile dhe nikotinë (produkte duhani për përdorim oral). Me ndryshimet e bëra është vendosur unifikimi i akcizës për “Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike” me nivel akcize 6 lekë/litër i cili hyn në fuqi në 1 korrik 2022. Gjithashtu, është vendosur indeksimi i nivelit të akcizës çdo dy vjet në masën e normës zyrtare të inflacionit të shpallur nga INSTAT, me përjashtim të duhanit dhe nënprodukteve të tij.

Me ligjin e sipërcituar, është hequr rimbursimi i akcizës së lëndëve djegëse për industrinë, të cilat përdoren për nevoja teknologjike të prodhimit të produkteve në këta sektorë (farmaceutika, tullat, çimento, birra dhe nafta bruto).

Me ligjin Nr. 98/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili është në fuqi që nga 1 janar 2019 është vendosur për herë të parë si produkt akcize duhani me ngrohje. Për duhan me ngrohje, produkte duhani të riformuar dhe me substanca të tjera, që konsumohen nga një proces ngrohje nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani, niveli i taksimit është 6 000 lekë/kg.

Rimbursimi TVSH. Administrata tatimore ka përmirësuar ndjeshëm volumnin, procedurat dhe afatet e rimbursimit të TVSH-së.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, u rimbursuan shuma prej 16.508 miliardë lekë – kërkesa për rimbursim të TVSH-së, afërsisht 30% më pak se në vitin 2019 (nga 23.509 miliardë lekë të rimbursuara në vitin 2019). Për periudhën janar – qershor 2021, DPT ka rimbursuar në total 15.3 miliardë lekë (8.1 miliardë lekë ose 112% më shumë se gjatë semestrit të parë të vitit 2020). DPT pastroi të gjithë stokun e mbartur para vitit 2020, përfshirë pagesën e fundit të bërë për tatimpaguesin TAP në 30.06.2021. Për periudhën janar – gusht 2021, DPT ka rimbursuar gjithsej 17.9 miliardë lekë, ose 45% më shumë se sa ishte planifikuar (12.3 miliardë lekë) për këtë periudhë. Deri në fund të gushtit 2021 ekzistonte një stok i TVSH-së prej 1.3 miliardë lekësh, i ulur me 87% në krahasim me vlerën e stokut më 31.12.2020.

Duke filluar nga muaji dhjetor 2019, Administrata Tatimore rimbursonte brenda afatit ligjor çdo tatimpagues të vogël dhe të mesëm, duke i dhënë prioritet kompanive eksportuese dhe atyre investuese. Stoku i mbetur i TVSH-së përfshin 2 – 3 investitorë të mëdhenj. Bazuar edhe në ndryshimet ligjore të miratuara, stoku i TVSH-së për këta investitorë të mëdhenj vazhdon të paguhet me këste mujore, bazuar në marrëveshjet e arritura me ta. Parashikohet që ky stok të bëhet zero brenda vitit 2021, që do të thotë se në vijim nuk do të ketë asnjë subjekt që nuk rimbursohet në afatet e përcaktuara ligjore dhe administrata tatimore mbyll përfundimisht këtë problem shumëvjeçar.



Për sa i përket **tatimeve direkte**, institucionet financiare janë të detyruara ligjërisht të llogarisin, mbajnë në burim dhe deklarojnë tatimin mbi të ardhurat nga të ardhurat nga kursimet. Në përgjigje të situatës së COVID-19, afati i dorëzimit të pasqyrave financiare u zgjat, u vendos përjashtimi nga tatimi mbi fitimin për bizneset e vogla dhe shtyrja e përkohshme e pagesave të tatimit mbi fitimin për të gjitha bizneset e tjera me disa përjashtime. Për më tepër, ndryshime u bënë në tatimin direkt për të mbështetur taksapaguesit e prekur nga pandemia COVID-19. Si rezultat, që nga janari 2021, tatimpaguesit me të ardhura vjetore totale deri në 14 milionë lekë (afërsisht 115 000 euro) i nënshtrohen një norme 0% të tatimit mbi fitimin, ndërsa tatimpaguesit me të ardhura vjetore totale mbi këtë prag, do t'i nënshtrohen një norme 15%. Që nga dhjetori 2020, Shqipëria e përafroi pjesërisht kuadrin e saj ligjor me Direktivën e Bashkimeve duke lejuar shtyrjen e taksimit të fitimit të kapitalit derisa aktivet/detyrimet të shiten nga kompania marrëse, nëse si kompania transferuese dhe marrëse janë rezidente në Shqipëri.

Shqipëria i është bashkuar Kornizës Gjithëpërfshirëse të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) mbi Erozionin e Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit (BEPS) në gusht të vitit 2019. Në këtë kuadër Konventa Shumëpalëshe (MLI), për zbatimin e masave që lidhen me Marrëveshjet për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë për parandalimin e Erozionit të Bazës së Tatueshme dhe Transferimin e Fitimit (BEPS), u miratua në parlament me ligjin Nr. 93 datë 16.07.2020 dhe u dorëzua instrumenti i ratifikimit pranë OECD-së. Kjo Konventë ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2021.

Në lidhje me **bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën reciproke**, në janar 2020, u miratua Ligji për shkëmbimin automatik të informacionit për llogaritë financiare, duke synuar përafrimin me Standardet e Raportimit të Konformitetit dhe përafrimin e pjesshëm me Direktivën përkatëse të BE-së të vitit 2014. Aktualisht ka filluar dhe është në vazhdimësi të kryhet çdo vit shkëmbimi automatik i informacionit për llogarite financiare.

Në lidhje me negocimin e marrëveshjeve për taksimin e dyfishtë, gjatë vitit 2021 miratua në parim marrëveshja me Finlandën dhe janë zhvilluar negociatat me Sllovakinë si dhe do të vijojnë

procedurat për miratimin e saj. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 u ratifikua dhe marrëveshja e taksimit të dyfishtë me Izraelin.

Është miratuar ligji Nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” me objekt zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standardeve të përbashkëta të raportimit. Përpara shkëmbimit të parë të informacionit, u hartua dhe miratua baza ligjore (Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 613, datë 29.7.2020 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”) dhe u ngrit infrastruktura e nevojshme, përfshirë sistemin e IT-së së DPT-së për zbatimin e këtij angazhimi.

Për sa i përket **kapacitetit operacional dhe kompjuterizimit**, 1040 punonjës të DPT-së përfituan trajnime online në vitin 2020, sipas programit vjetor të trajnimit, i cili është i bazuar në nevoja. Që nga janari 2021, faturat elektronike janë bërë të detyrueshme për transaksionet jo me para në dorë midis bizneseve dhe qeverisë, në përpjekje për të rritur pajtueshmërinë tatimore dhe për të reduktuar informalitetin.

Me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit është miratuar “Struktura Organizative e Administratës Tatimore Qendrore” dhe me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.79, datë 27.03.2020 është miratuar “Organigrama e Administratës Tatimore Qendrore” me një numër prej 1450 punonjës, nga të cilët 1122 trajtohen me status nëpunësi civil dhe 328 trajtohen me dispozita të Kodit të Punës. Aktualisht rezultojnë 132 vende vakante me status Nëpunësi Civil dhe 15 vende vakante me Kod Pune. Vakancat janë pasqyruar dhe planifikuar në Sistemin HRMIS të DAP.

Gjatë vitit 2020 janë punësuar gjithsej 43 punonjës/nëpunës, nga të cilët 7 nëpunës janë emëruar në pozicione pune me status nëpunësi civil, sipas procedurave të DAP, 5 nëpunës civilë janë emëruar në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe 31 punonjës të emëruar në pozicione që trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Gjatë këtij viti, 3 punonjës/nëpunës janë larguar nga detyra për shkak të masave disiplinore.

Gjatë vitit 2021 janë punësuar gjithsej 138 punonjës/nëpunës, nga të cilët 57 nëpunës emëruar në pozicione pune me status nëpunësi civil, sipas procedurave të DAP, 60 nëpunës civilë



janë emëruar në zbatim të vendimeve gjyqësore dhe 21 punonjës të emëruar në pozicione që trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Gjatë këtij viti, 3 punonjës/nëpunës janë larguar nga detyra për shkak të masave disiplinore.

Programi vjetor i trajnimeve për vitin 2021 u miratua nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve bazuar në nevojat e administratës tatimore. Për vitin 2021 sipas programit të trajnimeve dhe kalendarit të trajnimeve të QTATD/ASPA janë trajnuar gjithsej 667 nëpunës/punonjës të administratës tatimore.

Administrata tatimore me strukturat e monitorimit në terren gjatë vitit 2020 ka kryer 17 979 verifikime me shtrirje në të gjithë territorin e vendit ku janë konstatuar 4 214 subjekte me shkelje të legjislacionit tatimor. Strukturat e verifikimit në terren kanë ushtruar verifikime në zbatim të planeve të punës dhe kanë kryer verifikimin e subjekteve, të cilët paraqesin risk të lartë në mosrespektimin e legjislacionit tatimor. Veprimtaria ditore është përqëndruar kryesisht në TP dalë nga moduli i riskut me tematika të përcaktuara dhe me elementë të identifikuar paraprakisht për verifikim.

Ndërsa në periudhën janar – shtator 2021 janë kryer 3996 verifikime ku janë konstatuar 408 shkelje të legjislacionit tatimor. Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren ka operuar me anë të listave të ardhura nga DMR me kriteret e thyera, sipas planeve të punës. Gjithashtu janë ndjekur denoncimet dhe shkresat e ardhura në DPT dhe në rajone për verifikim në vend. Në zbatim të Planit Operacional të DPT-së për Sezonin Turistik veror 2021 janë kryer verifikime në zonat me aktivitet më të lartë ekonomik gjatë sezonit turistik.

Veprimet e ndërmarra në kuadër të Luftës kundër Informalitetit

Bazuar në Vendimin Nr. 24, datë 23.06.2021 u miratua *Plani sektorial i Rindërtimit*.

U analizuan të dhënat tatimore për periudhën prill 2019 – gusht 2020 për të gjithë TP të cilët janë të pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja në kuadër të procesit të Rindërtimit.

- Bazuar në rregullat e thyera u përcaktuan metodat e trajtimit si më poshtë:

- 228 letra të personalizuar

125 vizita fiskale

- 45 kontrolle tatimore

- 324 kontrolle nga zyra

- Bazuar në Vendimin Nr. 23, datë 27.05.2021 u miratua Rregullat e Riskut për monitorimin e tatimpaguesve në kuadër të ndryshimit të pragut të TVSH-së dhe TF dhe u hartuan:

- 5 Kriteria lidhur me Pragun e ri të TVSH-së prej 10 mln lekë (në fuqi nga 1 Janar 2021).

- 4 Kriteria lidhur me Pragun e ri të Tatim Fitimit prej 14 mln lekë (në fuqi nga 1 Janar 2021).

- Bazuar në vendimin nr 23, datë 27.05.2021 u miratua *Analiza e përgjithshme e Sektorëve me risk*. Nga analiza e sektorëve me risk bazuar në rregullat e thyera të Modullit të riskut për periudhën korrik 2020 – qershor 2021, vihet re se sektorët me risk me të lartë janë: Tregtia me pakice, Aktivitete të shërbimit të pijeve, Tregtia me shumice dhe Ndërtimi.

- Bazuar në Vendimin Nr. 23, datë 27.05.2021 u miratua *Plani Sektorial i Turizmit*. Plani i Turizmit u zhvillua për periudhën maj – shtator 2021 për të gjitha subjektet që operojnë në fushën e turizmit dhe Bar-restorante. Disa nga rezultatet e Planit të Turizmit: rritje me 6% e numrit të TP të rinj 2021 – 2020, rritje me 14% e numrit të punonjësve të deklaruar 06/2021 – 2019, rritja me 31% e pagës për kontribute, ulja me 33% e numrit të punonjësve me pagë minimale, ulja me 17% e TP që deklarojnë vetëm 1 punonjës 08/2021 krahasuar me 06/2021, 175 TP kanë kaluar në përgjegjësinë e TVSH.

- Evidentimi i TP me aktivitet të fushës së “Tregtisë” të cilët kanë rënie qarkullimi për periudhat krahasuese janar – mars 2021/janar – mars 2019. Për këta TP u kryen verifikime në terren nga DVKT.

- Evidentimi i TP me xhiro mbi 8 milion lekë bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-së për periudhën janar – gusht 2021. DRT kanë bërë verifikimet përkatëse dhe kanë marrë masa për ndryshimin e përgjegjësiave tatimore sipas rekomandimit në BM.

- Evidentimi i TP aktivë me xhiro mbi 8 milion lekë sipas DRT-ve, bazuar në të dhënat e deklaratave të Tatim fitimit të Thjeshtuar. DRT pasi kanë kryer verifikimet përkatëse kanë marrë masa për ndryshimin e përgjegjësiave tatimore sipas rekomandimit në BM.

- Bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-së për periudhën janar – mars/maj/qershor/korrik/gusht 2021 janë



analizuar të dhënat e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me *Blerje 25% më të lartë se Shitje* (pasi janë hequr Blerjet dhe Importet për Investime). Këta TP janë ndjekur nga DRT përkatëse.

- Bazuar në të dhënat e deklaratave të TVSH-së për muajin Prill 2021 janë identifikuar tatimpaguesit *Mos-deklarues/Deklarues me vlerë Zero* të cilët rezultojnë me *Xhiro në Kasën fiskale*. Këta TP janë trajtuar nga DRT përkatëse.

- Bazuar në Deklaratat e TF, TFTH janë evidentuar TP Aktiv për të cilët *Xhiro në kasë pa TVSH 2020 është më e madhe se të ardhurat tatimore* tek deklarata e TF, TFTH 2020 (Diferenca >100,000). Këta TP janë trajtuar nga DRT përkatëse.

Procesi i Fiskalizimit

Zbatimi i Ligjit Nr.87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar i quajtur ndryshe “Projekti i Fiskalizimit” ka vijuar normalisht.

Nga Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesit janë kryer trajnime periodikisht që prej muajit Nëntor 2020. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 1 252 përfaqësues të enteve publike. Deri në muajin Shtator 2021, në trajnime kanë marrë pjesë gjithsej 30 481 tatimpagues dhe 3 433 kontabilistë.

Në kuadër të informimit nga strukturat e Administratës Tatimore gjatë periudhës 1 mars – 14 prill përveç trajnimeve janë realizuar edhe 15 747 vizita informuese në vendet e ushtrimit të aktivitetit, kryesisht të subjekteve të biznesit të vogël, me qëllim informimin për procesin e fiskalizimit, kritereve, kushteve që duhet të plotësohen, detyrimin ligjor, afatet e zbatimit etj.

Gjatë periudhës maj – gusht 2021, është zbatuar plani i masave për ofrimin e asistencës për tatimpaguesit në lidhje me regjistrimin e të dhënave në portalin Self Care, si në Këndin e Biznesit të Vogël pranë çdo drejtorie rajonale tatimore dhe me vizita në terren, duke asistuar 6 365 tatimpagues. Prej datës 1 shtator, për një periudhë 3-mujore, do të vijojë zbatimi i planit të masave për informimin dhe ofrimin e asistencës në vendet e ushtrimit të aktivitetit të tatimpaguesve të biznesit të vogël, të cilët duhet të përfshihen në procesin e Fiskalizimit, faza B2C, si dhe për ndërgjegjësimin e tatimpaguesve që kryejnë transaksione pa para në dorë, B2B. Në zbatim të planit të masave, deri më tani janë zhvilluar rreth 3 000 vizita ditore në terren.

Duke filluar nga data 1 janar 2021 ka filluar lëshimi i faturave elektronike kundrejt enteve publike në përmbushje të detyrimit ligjor që rrjedh nga ligji, por edhe midis tatimpaguesve, pavarësisht se ligji e parashikon të detyrueshëm nga data 1 korrik 2021 për transaksionet pa para në dorë (midis tatimpaguesve). Ndërkohë, më datë 1 shtator 2021 ka filluar procesi i fiskalizimit për transaksionet me para në dorë (tatimpagues – konsumator).

Për periudhën 1.1.2021 – 24.09.2021, rezulton se 33 615 tatimpagues kanë lëshuar në total 40 532 220 fatura, nga të cilat 2 014 136 janë fatura elektronike, ndërsa 38 518 084 fatura janë me para në dorë.

Nga totali i faturave elektronike të fiskalizuara, rezulton se 131 053 prej tyre janë lëshuar kundrejt enteve publike, ndërsa 1 883 083 janë lëshuar kundrejt subjekteve private. Deri më sot, nga këto fatura elektronike të fiskalizuara, rezulton se 588 881 prej tyre janë pranuar nga ana e bleresit.

Lëshimi i faturave elektronike nga ana e tatimpaguesve vijon si nga zgjidhjet softëare që ofrojnë kompanitë e certifikuara, edhe nga Portali Self Care.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë ka lancuar versionin 3.0 të Sistemit Informatik të Kadastrës Fiskale i cili përmban të gjitha funksionalitetet e nevojshme për taksimin dhe faturimin e taksës së pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”. Asistencë e vazhdueshme është ofruar për bashkitë lidhur me implementimin e reformës së taksës së pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”.

4.16.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë:

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale (Institucioni lider)

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

4. Ministria e Financave dhe Ekonomisë / Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjet



tatimore, duke administruar taksat dhe tarifatat kombëtare, të përcaktuara me ligjet përkatëse. Qëllimi kryesor i DPT-së është të ndihmojë tatimpaguesit që të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e aplikueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga këto taksa të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke u ofruar tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) është institucioni kryesor doganor në Republikën e Shqipërisë dhe ka autoritetin për të zbatuar ligjin për Akcizat në R.SH, duke administruar detyrimet e akcizës në prodhimin e brendshëm dhe në import.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë dhe Bashkitë janë institucionet përgjegjëse për implementimin e reformës së taksës së pasurisë së paluajtshme.

4.16.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Për **tatimet indirekte**, taksimi i akcizës është pjesërisht i harmonizuar me acquis e BE-së. Vajrat minerale janë shënuar për disa përdorime. Akciza e favorshme për duhanin e përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri vazhdon. Prodhuesit e vegjël të pijeve alkoolike gëzojnë tarifa të reduktuara tatimore. Prioritet i Administratës Tatimore për vitin 2021 është zerimi i stokut të TVSH-së.

Për **tatimet direkte**, ligji i ri për tatimin mbi të ardhurat është planifikuar të prezantohet në vitin 2022 dhe të futet në fuqi në vitin 2023. Ky ligj do të trajtojë çështje që lidhen me tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimin duke synuar harmonizimin me ndryshimet ekonomike gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, synohet harmonizimi i mëtejshëm i direktivave në fushën e tatimeve direkte. Ky ligj njëkohësisht përaftron pjesërisht Direktivën ATAD (EU) 2016/1164. Negociimi i Marrëveshjeve të Tatimit të dyfishtë, veçanërisht me shtetet e BE-së, është një tjetër prioritet në këtë fushë.

Për **bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën reciproke**, Shqipëria ende nuk ka nënshkruar marrëveshje për taksimin e dyfishtë me Danimarkën, Qipron, Lituani, Portugalinë, Sllovakinë dhe Finlandën.

Për sa i përket **kapacitetit operacional dhe kompjuterizimit**, në mars 2020 personeli i administratës tatimore u reduktua më tej nga 1512 në 1450. Që nga prilli 2021, numri i vendeve të lira të punës mbeti shumë i lartë në 168 (11.6%), pavarësisht përmirësimit në krahasim me 193 (13.3%) në raportin e vitit të kaluar. Shqipëria nuk ka ende kapacitetin teknik për të lehtësuar shkëmbimin efikas të informacionit. Sistemi elektronik i administratës tatimore ka funksionuar që nga janari 2015, por nuk ka afate për arritjen e ndërldhjes dhe ndërveprimit me sistemet e BE-së. Zbatimi i bazës ligjore për kadastrën fiskale, të miratuar në vitin 2018, është vonuar, për shkak të të dhënave jo të plota, duke penguar funksionimin e saj. Bashkitë kanë vazhduar me përpilimin e informacionit të nevojshëm, ndërsa është planifikuar të ndryshohet baza ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë gjatë proceseve të punës ka hasur vështirësi lidhur me disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave nga databazat e të dhënave që disponojnë institucionet e tjera, kryesisht të dhënat me informacione gjeografike për pasuritë e paluajtshme.

Lidhur me politikat tatimore, prioritet mbetet përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe përmirësimi i administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së tatueshme. Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet:

- Harmonizimit të mëtejshëm të politikave tatimore me acquis e BE-së
- Krijimit të klimës së favorshme të biznesit për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja
- Formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë
- Përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore për realizimin e të ardhurave, duke u bazuar në profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, si dhe standarde, të cilat krijojnë besueshmëri tek qytetarët, partnerët ndërkombëtarë dhe komuniteti i biznesit vendas dhe të huaj.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 parashikohet të miratohet Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) 2022 – 2026, e hartuar me asistencën teknike të Fondit Monetar Ndërkombëtar, ku

prezanton reformat në fushën e politikave tatimore dhe administrimit tatimor dhe doganor që parashikohen të ndërmerren gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare, me synim përmirësimin e politikave fiskale, rritjen e të ardhurave tatimore dhe efektivitetit të administratës tatimore dhe doganore në mbledhjen e tyre.

KAPITULLI 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

4.17.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e politikës ekonomike dhe monetare rregullohet nga Titulli VIII (nenet 119 deri 144) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU), dhe nga legjislacioni përkatës zbatues. Dispozitat e Traktatit që lidhen me miratimin e euros nuk zbatohen për Shtetet Anëtare me një përjashtim të përkohshëm siç përcaktohet në Nenin 139 të TFEU.

Legjislacioni përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në Shtetet Anëtare, duke ndaluar financimin e drejtpërdrejtë të sektorit publik nga bankat qendrore dhe duke ndaluar qasjen e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare i konsiderojnë politikat e tyre ekonomike si një çështje me interes të përbashkët dhe i nënshtrohen një mbikëqyrje me të gjerë fiskale, ekonomike dhe financiare. Ata janë të detyruar gjithashtu t'i përmbahen rregullave të detajuara në lidhje me karakteristikat e kuadrit të tyre kombëtar në fushën e buxhetit. Shtetet e reja Anëtare duhet të përmbushin gjithashtu kriteret e përcaktuara në Traktat në mënyrë që të jenë në gjendje të adoptojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Deri atëherë, ata do të jenë një Shtet Anëtar me përjashtim nga përdorimi i euros dhe do të trajtojnë politikat e tyre të kursit të këmbimit si një çështje me interes të përbashkët.

4.17.2 Struktura e kapitullit

- Politika ekonomike
- Politika monetare

4.17.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të Bashkimit Evropian

Neni 87 i MSA-së përcakton bashkëpunimin në fushat e politikave ekonomike dhe tregtare, duke theksuar se Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformës ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse

dhe formulimit e zbatimit të politikës ekonomike në ekonominë e tregut. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, Komuniteti mund të ofrojë asistencë të dizenuar për të mbështetur përpjekjet e Shqipërisë për krijimin e një ekonomie tregu funksionale dhe përafrimin gradual të politikave të saj me politikat e orientuara drejt stabilitetit të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Acquis përbëhet kryesisht nga dispozitat dhe protokollet e Traktatit, si dhe rregulloret dhe vendimet që nuk kërkojnë transpozim në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, siç tregohet në nenin 131 të TFBE, secili Shtet Anëtar do të sigurojë që legjislacioni i tij kombëtar, duke përfshirë edhe statutet e bankës qendrore, të jetë në përputhje me TFBE dhe Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankës Qendrore Evropiane (Statuti i ESCB/ECB). Rregulloret sipas këtij kapitulli u kërkojnë shteteve anëtare të identifikojnë rreziqet e mundshme, parandalojnë ose korrigjojnë çdo deficit fiskal të tepërt si dhe pabarazitë makroekonomike të dëmshme. Direktiva 2011/85 përcakton kërkesat për kuadrot buxhetore të Shteteve Anëtare.

4.17.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës ekonomike dhe monetare. Progres i kufizuar është bërë në drejtim të Llogarive Kombëtare dhe Njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tepërt. Nevojitet ende progres i qenësishëm për të arritur përputhshmërinë e plotë me ESA 2010. Siç konstaton raporti i fundit i Raport Progresit, përafrimi i mëtejshëm i Ligjit të Bankës së Shqipërisë me *acquis* dhe përmirësimi i koordinimit të politikave qeveritare me palët jo-qeveritare mbeten prioritetet kryesore.

Politika ekonomike

Si vend kandidat për anëtarësim në BE, Shqipëria paraqet një herë në vit në Komisionin Evropian Programin e Reformave Ekonomike (ERP).

ERP për periudhën 2021 – 2023 paraqet prioritetet kryesore, politikat dhe reformat e qeverisë shqiptare dhe Bankës së Shqipërisë në aspektet ekonomike. Ky program bazohet në Ligjin nr. 88, “Për Buxhetin e 2020” dhe në Kuadrin



Makroekonomik dhe Fiskal 2022 – 2024, të miratuar në janar 2021³⁵.

Viti 2020 ka qenë, në aspektin ekonomik dhe të financave publike, një ndër vitet më të vështira në tre dekada. Shqipëria, përveç tronditjes nga pandemia e COVID-19 që u përhap në të gjithë botën, pak përpara saj u godit edhe nga tërmeti, dhe sigurisht efekti negativ në ekonomi është i amplifikuar. Sidoqoftë, me gjithë ndikimin e rëndë që të dy goditjet kanë patur, në sajë të përgjigjeve relativisht mjaft të mira të politikave ekonomike (fiskale e monetare), të dhënat statistikore të disponueshme dëshmojnë se situata e përgjithshme në mbyllje të vitit 2020 ishte konsiderueshëm më pak e rëndë nga sa pritej në fillim të pandemisë, si dhe përgjatë vitit 2021 rimarrja e ritmit të ekonomisë është konsiderueshëm më e shpejtë se sa pritshmëritë fillestare. Deri më tani, duket se fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit ka rezistuar relativisht mjaft mirë ndaj këtyre goditjeve.

Ekonomia shqiptare përgjatë vitit 2020 regjistroi një recesion prej 4 përqind, e cila për shkak të pandemisë arriti kulmin e turrjes së PBB-së në tremujorin e dytë në rreth -11.3 përqind, por duke shfaqur shenja rimëkëmbje e duke u rikthyer përsëri në terren pozitiv në tremujorin e fundit të vitit. Ndonëse i gjithë viti 2020 regjistroi një recesion të fortë për historikun tonë ekonomik (në tre dekada ka pasur recesion vetëm në vitin 1997 në nivelin 11 përqind, madje edhe gjatë krizës globale financiare të vitit 2008 – 2009 ekonomia shqiptare arriti të shmangë recesionin), vlen të theksohet se ky recesion ishte shumë më i përmbajtur sesa parashikimet tona fillestare që varionin nga rreth -6 përqind (projeksioni i MFE) deri në rreth -8 përqind nga institucione të tjera vendase dhe ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2020, si kundër-përgjigje kryesore për amortizimin në një farë mase të goditjes prej pandemisë, u ndërmor një politikë fiskale majft ekspansioniste. Rrjedhimisht, deficit i përgjithshëm buxhetor arriti në vlerën rreth 6.8% të PBB-së dhe borxhi publik u rrit në rreth 76% të PBB-së, pra me rreth 10 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2019.

Për të kryer një politikë të tillë fiskale ekspansioniste në kundërpërgjigje të goditjes, qeveria aktivizoi gjatë vitit 2020 “klauzolat e devijimit” nga rregullat fiskale, si klauzola të parashikuara që më parë në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), duke mos cënuar kështu kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve dhe agjenteve ekonomike. Gjithashtu, me synimin për të ruajtur sa më shumë të ishte e mundur të pacënuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, element kyç ky për financat publike si një fondament makroekonomik, sidomos për vende të vogla dhe me nevoja ri-financimi buxhetor relativisht të larta siç është Shqipëria, u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore në Korrik të 2020 (në kulmin e pandemisë) duke përfshirë një rregull tjetër të ri fiskal në LOB, i cili sanksiononte ligjërisht që balanca primare e buxhetit të rikthehej në së paku në një nivel të balancuar (pra, jo më e vogël se sa zero) duke filluar nga viti 2024 e në vijim.³⁶

Ky rregull u mirëprit mjaft pozitivisht nga të gjitha institucionet ndërkombëtare (përfshirë patjetër edhe agjencitë e rating-ug) dhe rrjedhimisht nga aktorët ekonomik në tërësi, si një iniciativë mjaft e duhur dhe efektive për të ruajtur kredibilitetin dhe qëndrueshmërinë e financave publike, jo vetëm në periudhën afatmesme dhe afatgjatë post-pandemisë, por madje vlerësojmë se ishte mjaft ndihmuese për të siguruar një financim (huamarrje) relativisht mjaft normal edhe në afatin e shkurtër përgjatë goditjes, pra përgjatë vitit 2020 dhe pjesës së parë të këtij viti, pavarësisht magnitudës mjaft më të lartë të huamarrjes se sa tipikisht.

Tashmë, që prej vitit 2022 dhe në vijim, objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse, do jetë sërish konsolidimi fiskal.

Politika fiskale do targetojë një trajektore rënëse të borxhit publik, pra një trajektore rënëse graduale por e përvitshme, ndërsa balanca primare do të

³⁵ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, më datë 13.01.2021, nr. 7

³⁶ Rregulli origjinal sanksiononte “që prej 2023”, por më pas kjo u ndryshua sërish në Korrik të 2021 dhe u bë “që prej 2024”



rikthehet në nivel pozitiv nga viti 2024 e në vijim, në përputhje edhe me rregullat fiskale në LOB.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, ne do synojmë që të ruajmë një raport të shëndetshëm të shpenzimeve buxhetore korente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) do targetohen të jenë rreth 5 përqind e PBB në çdo vit buxhetor.

Defiçiti buxhetor për vitin 2022 planifikohet të jetë në nivelin 5.4 përqind të PBB nga rreth 6.8 përqind i pritshëm për vitin 2021. Balanca primare edhe për këtë vit pritet të jetë sërisht negative në rreth -2.7 përqind, gjithsesi në një përmirësim nga rreth -4.6 përqind që pritet për vitin 2021.

Megjithatë, balanca korrente fiskale (diferenca midis investime publike dhe deficit fiskal) do të jetë pozitive në vitin e ardhshëm 2022, në nivelin prej 1 përqind të PBB nga një nivel i pritshëm përsëri pozitiv prej 0.5 përqind këtë vit, në përputhje kjo me rregullin respektiv fiskal (“rregullin e artë” të buxhetit). Gjithashtu edhe borxhi publik bruto do t’i rikthehet një trajektore rënëse duke filluar që nga 2022, në përputhje me rregullin respektiv fiskal, ku pritet të bjerë në rreth 78.9 përqind të PBB nga rreth 80 përqind i pritshëm për këtë vit. Balanca primare do të rikthehet në nivel pozitiv (suficit primar) nga viti 2024 e në vijim. Edhe ky target tashmë është ligjërisht i detyrueshëm, ku në LOB përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Sipas skenarit bazë, borxhi publik pritet të bjerë në rreth 74.9 përqind në vitin 2025 dhe më tej në rreth 67.9 përqind në vitin 2028.

Politika monetare

Siç përmendet në raport progresin e fundit të Komisionit Evropian, Banka e Shqipërisë është financiarisht e pavarur dhe ka instrumente, kompetenca dhe kapacitete administrative të mjaftueshme për të funksionuar efektivisht dhe për të zbatuar një politikë monetare eficiente. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë është plotësisht operacional.

Një nga objektivat kryesorë të Bankës së Shqipërisë është forcimi i mëtejshëm i mirëqeverisjes. Strategjia afatmesme përcakton tre shtylla kryesore për arritjen e këtij objekti: (i) forcimi i pavarësisë; (ii) rritja e transparencës; dhe (iii) përmirësimi i llogaridhënies.

Së fundmi, Banka e Shqipërisë ka bërë progres të konsiderueshëm për të rritur llogaridhënien ligjore në Parlamentin Shqiptar, si dhe transparencën e sektorit financiar në media dhe në publikun e gjerë.

Përsa i përket shtyllës së parë të mirëqeverisjes, pavarësia e Bankës është sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë. Si një institucion i pavarur kushtetues, organizimi dhe funksionimi i Bankës rregullohet nga ligji i saj organik, me përjashtim kur Kushtetuta thotë ndryshe.

Sipas Komisioni Evropian, Ligji i Bankës së Shqipërisë është gjerësisht në linjë me *acquis* dhe sigurohet një shkallë e lartë pavarësie për Bankën dhe përcakton si objektiv primar ruajtjen e stabilitetit të çmimeve (pavarësia funksionale). Ligji sanksionon se Banka nuk duhet të kërkojë ose të marrë instruksione nga autoritete të tjera dhe se është i vetmi institucion përgjegjës për politikën monetare dhe atë të kursit të këmbimit (pavarësia institucionale). Megjithatë, ligji ende nevojitet të përafrohet më tej me Statutin e Bankës Qendrore Evropiane në terma të pavarësisë personale të anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës.

Për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve, Banka e Shqipërisë ndjek një politikë monetare e cila hartohet dhe zbatohet sipas parimeve të regjimit të inflacionit të shënjestruar. Në përputhje me këtë regjim, Banka e Shqipërisë ndjek një regjim të kursit të lirë të këmbimit. Tiparet kryesore të regjimit të politikës monetare janë publikuar në Dokumentin e Politikës Monetare. Banka e Shqipërisë e ka përkufizuar objektivin e inflacionit si ndryshim vjetor të çmimeve të konsumit në nivelin 3.0% gjatë një horizonti kohor afatmesëm. Vendimet e politikës monetare bazohen në devijimet e inflacionit të parashikuar nga objektivi dhe vlerësimi i pritjeve për inflacionin. Zbatimi i politikës monetare kryhet nëpërmjet një set-i instrumentesh të tregut të hapur: i) operacione të tregut të hapur; ii) lehtësirat njëditore; iii) rezerva minimale e detyruar. Kuadri i politikës monetare dhe ai i kursit të këmbimit janë të përshtatshëm për arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve dhe nuk pritet të ndryshojnë në afatin e mesëm. Instrumentet e politikës monetare janë subjekt kalibrimi me qëllim rritjen e efikasitetit të transmetimit të politikës monetare në tregje.



Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare stimuluese që prej vitit 2009 për t'iu përgjigjur presioneve të ulëta inflacioniste nga ambienti i huaj dhe ai i brendshëm, me synim final arritjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve. Politika monetare stimuluese është transmetuar në kushte të favorshme financimi, duke i shërbyer nxitjes së kërkesës dhe forcimit gradual të presioneve të brendshme inflacioniste. Me përhapjen e pandemisë COVID-19, Banka e Shqipërisë intensifikoi stimulimin monetar, duke ulur normën bazë të interesit me 50 pikë bazë, në nivelin 0.50%, si dhe duke ofruar likuiditet të pakufizuar në sistemin bankar. Këto masa kanë mbetur të pandryshuara gjatë vitit 2021.

Banka e Shqipërisë pret që ekonomia të rritet ndjeshëm në vitin 2021 e udhëhequr nga rimëkëmbja e kërkesës së brendshme dhe të huaj³⁷. Rritja e kërkesës agregate pritet të shoqërohet me rritje të punësimit dhe të pagave, duke sjellë rritjen e presioneve inflacioniste. Banka e Shqipërisë pret që inflacioni të rritet në mënyrë të qëndrueshme rreth objektivit 3.0% në vitin 2022. Politika monetare do të vijojë të orientohet nga arritja e objektivit të stabilitetit të çmimeve. Rritja e qëndrueshme e ekonomisë dhe e presioneve të brendshme inflacioniste do të kërkojë normalizimin gradual të politikës monetare në tremujorët e ardhshëm. Pavarësisht kësaj, politika monetare do të ruajë kahun lehtësues në afatin e mesëm, duke mbajtur normën e interesit nën nivelin ekuilibër. Në kushtet kur stimuli fiskal pritet të reduktohet gradualisht, kahu lehtësues i politikës monetare është i nevojshëm për të mbështetur vijimin e rritjes së qëndrueshme të ekonomisë dhe të ankorimit të pritjeve të agentëve rreth objektivit të bankës qendrore.

Statistikat Financiare të Qeverisë në Shqipëri dhe Procedura e Identifikimit të Zhbilancimeve Makroekonomike

Shqipëria, si vend kandidat për anëtarësim në BE, ka detyrimin e hartimit dhe dërgimit në

Eurostat të Tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar si dhe të treguesve shtesë lidhur me Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ) dhe po punon intensivisht prej disa vitesh tashmë edhe nëpërmjet projektit “Përmirësimi i Kapaciteteve për Statistikat Financiare të Qeverisë (SFQ), në vendet e Evropës Juglindore”, i financuar nga SECO³⁸. Në bazë të memorandumit të bashkëpunimit (viti 2016) ndërmjet INSTAT, BSH dhe MFE, këto tre institucione punojnë ngushtë për harmonizimin e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar sipas standardeve të kërkuara në Sistemin Evropian të Llogarive (ESA2010). Referuar përgjegjësiave institucionale, MFE është institucioni kryesor për burimin e të dhënave për prodhimin dhe publikimin e statistikave financiare të qeverisë. INSTAT është përgjegjës për përpilimin e statistikave jo-financiare për sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe transmetimin në Eurostat të tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar. Gjithashtu, INSTAT në kuadër të harmonizimit të tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar, ka ndërmarrë detyrimin për mbledhjen dhe përpilimin e të dhënave financiare të institucioneve ekstra buxhetore, klasifikuar si pjesë e sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme, sipas ESA2010. INSTAT transmeton në mënyrë të rregullt, në muajt Prill dhe Tetor të çdo viti, tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar sikurse kërkojnë nga Eurostat për vendet kandidate për anëtarësim në BE. Këto të dhëna janë dërguar në formë eksperimentale dhe jo për publikim. Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për hartimin e Statistikave Financiare të sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme, duke ndjekur metodologjinë ESA2010, si dhe ka detyrimin e raportimit pranë Eurostat dhe ECB të treguesve të kërkuar.

Për plotësimin e standardit metodologjik dhe rregullator, po vazhdon të punohet në drejtim të adresimit të mangësive lidhur me statistikave financiare të qeverisë. Aktualisht, ka përfunduar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të njësive ekstra-buxhetore dhe po punohet për konsolidimin e tyre me të dhënat buxhetore të qeverisë. Parashikohet që kjo bazë të furnizojë vlerësimin e statistikave GFS dhe Tabelave të EDP në raportimet e radhës në EUROSTAT. MFE ka

³⁷ Parashikimet e Bankës së Shqipërisë janë kryer në tetor 2021. Banka e Shqipërisë nuk publikon parashikimet makroekonomike. Informacioni mbi vlerësimin e zhvillimeve ekonomike e financiare, perspektiva e prituri dhe qëndrimi i politikës monetare gjenden në Raportin Tremujor të Politikës Monetare (https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Raportet_Periodike/)

³⁸ Swiss State Secretariat for Economic Affairs (SECO).



iniciuar një projekt me Bankën Botërore dhe ka avancuar në drejtim të implementimit të Standardit Ndërkombëtar për Kontabilitetin Publik, i cili do të mundësojë vlerësimin dhe raportimin e saktë të deficitit dhe nivelit të borxhit të qeverisë së përgjithshme. Ndërkohë, në kuadër të projektit SECO, brenda vitit 2021, pritet që do të marrë zgjidhje edhe çështja e hartimit të statistikave me frekuencë tremujore të Qeverisë së Përgjithshme (GFS). Ndërkohë, është në fazë testimi një sistem IT i qendëruar të dhënash, ku tre institucionet e përfshira do të jenë njëkohësisht furnizues dhe përdorues të informacionit. Sistemi do të përmbajë të dhëna të integruara dhe të harmonizuara me standardet GFSM2014³⁹, ESA2010, si dhe rezultat i tij do të jenë Tabelat EDP, për transmetim në Eurostat. Në të njëjtën kohë, sistemi do të mundësojë harmonizimin cilësor të raportimit të llogarive financiare të qeverisë së përgjithshme pranë Eurostat dhe ECB nga Banka e Shqipërisë dhe raportimet e GFS të MFE për Bankën Botërore dhe FMN-në me Tabelat EDP. Me sugjerimin e ekspertit, sistemi do të instalohet në serverat e INSTAT-it, i cili do të mbajë rolin e administratorit.

Shqipëria ka bërë progres lidhur me Procedurën për identifikimin e Zhbalancimeve Makroekonomike (MIP). Në përfundim të projektit statistikor mbi treguesit e matjes së zhbalancimeve makroekonomike, në kuadër të IPA2017, Shqipëria raportoi në Eurostat (në Korrik 2021), burimet e të dhënave në seri kohore të shoqëruara me metadatat respektive si dhe raportet e përditësuara të cilësisë, në përputhje me objektivat e projektit.

4.17.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Instituti i Statistikave (INSTAT)
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)

4.17.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Në kuadër të rekomandimit të Komisionit Evropian në Raport Progresin për Shqipërinë, të publikuar së fundmi (tetor 2021) mbi përmirësimin e koordinimit të politikave ekonomike qeveritare dhe mekanizmat e konsultimit me palët jo-

qeveritare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në funksion të hartimit të dokumenteve si ERP dhe Buxheti Vjetor, kryhen konsultime me palët e interesit. Për ERP kryhen konsultime dhe dëgjesa si me institucionet e tjera të Qeverisë (ministrinë e linjës) dhe institucionet e varësisë, po ashtu dhe me palët e interesit për çështje të ndryshme në varësi të politikave strukturore që janë prezantuar dhe propozuar. Pothuajse e njëjta procedurë ndiqet dhe për etapat e hartimit të Buxhetit Vjetor.

Në ndërlidhjen mes Qeverisë dhe palëve private, vijnë në ndihmë dhe struktura të pavarura që kanë për objektiv të lehtësojnë dialogun midis përfaqësuesve të komunitetit të biznesit, organizatave ndërkombëtare, donatorëve dhe qeverisë. Kjo krijon një klimë të favorshme, jo-diskriminuese dhe transparente të biznesit dhe investimeve, lehtëson zhvillimin e besimit të ndërsjellë midis komunitetit të biznesit dhe qeverisë në Shqipëri dhe kontribuon në një institucionalizim në rritje të dialogut efektiv të politikave. Mund të përmendet Këshilli i Investimeve dhe krahastij, struktura të tjera që ndihmojnë për të njëjtin qëllim, janë: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore, Këshilli Kombëtar i Punës, Këshilli Konsultativ i Punësimit, Këshilli Ekonomik Kombëtar, etj.

Në synimet afatmesme të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me qëllim harmonizimin me *acquis*, konkretisht sipas përcaktimeve të kapitullit të 17 si dhe në linjë me rregullat dhe praktikën më të mira të vendeve të tjera anëtare të BE, do të jetë krijimi i Këshillit Fiskal si organ i pavarur. Gjithashtu, synohet krijimi i një njësie/sektori të veçantë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, i cili do të ketë si funksion primar dhe të vetëm përpilimin dhe diseminimin e statistikave financiare të qeverisë (GFS) sipas standardeve të aplikuara në BE (ESA2010) si dhe ndjekjen dhe reflektimin në mënyrë sistematike e periodike të këtyre standardeve.

Banka e Shqipërisë po punon për hartimin e ligjit të ri organik në përputhje me kriteret ligjore që duhet të përmbushen për t'u bërë pjesë integrale e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore. Ky ligj do të jetë në linjë me Traktatin

³⁹ Manuali i Hartimit të Statistikave Financiare të Qeverisë (FMN, 2014).



e BE-së dhe Statutin e BQE-së. Sipas interpretimit të Komisionit Evropian, detyrimi i konvergencës ligjore nuk kërkon harmonizimin e legjislacionit të bankës qendrore, por vetëm përshtatshmërinë e tij me qëllim eliminimin e papajtueshmërive me Traktatin e BE-së. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian parashikon adoptimin e ligjit të ri të Bankës së Shqipërisë brenda Tremujorit të katërt 2022. Ky proces do realizohet në bashkëpunim me FMN-në dhe Bankën Qendrore të Italisë.

Synohet përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit teorik dhe operacional të politikës monetare. Banka e Shqipërisë operon nën kuadrin e një politike monetare të ankoruar në regjimin e inflacionit të shënjestruar ku objektivi për inflacionin do të vijojë të jetë në nivelin 3.0% në afatin e mesëm. Vendimmarrja e politikës monetare mbështetet në një kuadër të konsoliduar analizash dhe parashikimesh. Megjithatë, ndryshimet në peizazhin ekonomik e financiar dhe risitë në fushën ekonomike, bëjnë të nevojshëm përditësimin e vazhdueshëm të modeleve të parashikimit dhe të analizës së politikës monetare, të aplikimit të teknikave bashkëkohore në fushën e modelimit, si dhe të përditësimit të njohurive të personelit me të rejtat më të fundit.

Prioritet është mbështetja e zhvillimit të tregjeve financiare në funksion të përmirësimit të mekanizmit të transmetimit dhe ruajtjes së stabilitetit financiar. Transmetimi i politikës monetare kërkon tregje të zhvilluara financiare. Politika monetare ka gjetur transmetim të mirë në tregjet ekzistuese, megjithatë zhvillimi i tyre mbetet prioritet për autoritetet mbikëqyrëse. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë mbështet Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në projektin pilot për emetimin e titujve referencë nëpërmjet Zhvilluesve të Tregut. Gjithashtu, në bashkëpunim me institucione të tjera, Banka e Shqipërisë do të mbështesë zhvillimin e tregut valutor, nëpërmjet nxitjes së instrumenteve financiarë për mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit. Për këtë, në vijimësi synohet

Prioriteti i GNP të statistikave financiare të qeverisë mbetet raportimi i të dhënave të harmonizuara ndërmjet tre institucioneve dhe përafrimi i plotë me standardet ESA 2010.

Lidhur me procedurën MIP, përtej punës së konsiderueshme që është zhvilluar deri tani,

progres i mëtejshëm nevojitet në llogaritjen e dy treguesve kryesorë: Indeksi i kostos së punës për njësi nominale dhe indeksi i çmimeve të banesave si dhe treguesit ndihmës Shpenzimet e brendshme bruto për Kërkim dhe Zhvillim (R&D).

KAPITULLI 18: STATISTIKAT

4.18.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore bazuar në parime të tilla si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, konfidencialiteti i të dhënave individuale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare.

Instituti kombëtar i statistikave vepron si pikë referimi për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. *Acquis* mbulon metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme si statistikat makro-ekonomike, statistikat demografike dhe sociale, statistikat rajonale dhe statistikat mbi biznesin, transportin, tregtinë e jashtme, bujqësinë, mjedisin, shkencën dhe teknologjinë.

Për periudhën e këtij dokumenti, pas një procesi të hollësishëm vlerësimi, INSTAT do të propozojë projektligjin “Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore”, projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e Nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteteve CPA 2015”. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, me autoritetin që i jep ligji për statistikat zyrtare, do të miratojë dokumentet udhëzues me qëllim përafrimin e *acquis* zbatuese të rregulloreve/direktivave të BE-së.⁴⁰

4.18.2 Struktura e kapitullit

Struktura e kapitullit 18 “Statistikat” është si më poshtë:

- Statistikat Demografike dhe Sociale;
- Statistika Ekonomike;
- Statistikat Sektoriale;
- Statistikat e Mjedisit dhe Multidomain.

⁴⁰ Sipas Ligjit Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, neni 17 pika 4, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve të parashikuara në nenin 20, shkronja “b”, të këtij ligji, vetëm për INSTAT-in. Neni 20 shkronja b Bordi Drejtues t’i propozojë Drejtorit të Përgjithshëm nxjerrjen e udhëzimeve dhe vendosjen e standardeve për t’u zbatuar nga institucionet e Sistemit Kombëtar Statistikor, për të siguruar cilësinë në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare, si dhe të monitorojë zbatimin e tyre.



4.18.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar për statistikë zyrtare me atë të Bashkimit Evropian buron nga nenet 70 dhe 88 të MSA-së.

Neni 88 parashikon se “bashkëpunimi midis palëve do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis të Komunitetit në fushën e statistikave”. Kjo do të synojë në veçanti zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna krahasimore, të besueshme, objektive dhe të sakta të nevojshme për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformat në Shqipëri. Ai gjithashtu do ti mundësojë Institutit të Statistikave të Shqipërisë që të plotësojë më mirë nevojat e përdoruesve të saj kombëtarë dhe ndërkombëtarë (si administratës publike, ashtu edhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të miratuara nga Kombet e Bashkuara, Kodi i Praktikave të Statistikave Evropiane i dhe dispozitat e Ligjit Evropian Statistikor dhe të zhvillohet drejt acquis të Komunitetit.

Acquis në fushën e statistikave përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është direkt i zbatueshëm në Shtetet Anëtare siç janë Rregulloret e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Vendimet dhe Rregulloret e Komisionit. Për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor parashikohen rregulla të zakonshme. Acquis statistikore përmban gjithashtu një gamë të gjerë të manualeve metodologjike në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politikat ekonomike dhe monetare, statistikë demografike dhe sociale dhe kërkimet. Marrëveshjet ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare si kodi i praktikës në statistika ofrojnë një bazë tjetër për prodhimin statistikor.

Puna e Sistemit Kombëtar të Statistikave bazohet në Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2017 – 2021 të miratuar me VKM 10/2017, datë 9.2.2017. Ky është dokumenti kryesor që rregullon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Statistikor Kombëtar i nevojshëm për të vëzhguar gjendjen ekonomike, sociale dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet statistikore të parashikuara në Nenet 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, të cilat janë në

përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane. Programi shërben gjithashtu për të orientuar INSTAT-in dhe agjencitë e tjera statistikore drejt cilësisë së prodhimit statistikor të kërkuar nga standardet e acquis. Në vitin 2022, Kuvendi i Shqipërisë do të miratojë Programin Kombëtar për Statistikat Zyrtare 2022 – 2026.

Ligji nr. 17/2018, datë 05.04.2018 “Për statistikë zyrtare” është hartuar sipas Kodit të Praktikës dhe Rregullores Evropiane të Statistikave EC 223/2009 dhe parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane.

Baza ligjore për zhvillimin, mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave të Bankës së Shqipërisë është Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i cili është pjesërisht në përputhje me Rregulloren 184/2005 KE.

4.18.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave. Njëfarë progresi është bërë veçanërisht në përafrimin me standardet ESA 2010, në publikime më të shpejta dhe të reja mbi statistikë, si dhe ka pasur rritje në transmetimin e të dhënave në Eurostat.

Në lidhje me rekomandimin e vitit të kaluar, emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm i INSTAT u realizua dhe plani i veprimit u përgatit, sidoqoftë duhet të finalizohet dhe rekomandimet e tjera mbeten të vlefshme. Gjithashtu Ligji i Censit të Popullsisë u miratua. Roli i Sistemit Kombëtar të Statistikave të Shqipërisë u forcua më tej dhe burimet u përmirësuan, megjithatë, metodat e mbledhjes së të dhënave duhet të modernizohen dhe proceset statistikore të prodhimit të përmirësohen. Komunikimet me përdoruesit duhet të përmirësohen.

Lidhur me infrastrukturën statistikore, Ligji për statistikë zyrtare është në fuqi dhe në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane, dhe shumica e klasifikimeve janë në përputhje me Standardet e BE-së.

Qeveria Shqiptare ka miratuar kërkesën e INSTAT që organikës së tij në vitin 2022 ti shtohen 13 punonjës të rinj.

Vitet e fundit i është kushtuar vëmendje specifike zbatimit të kornizës ligjore nën të cilën INSTAT dhe Sistemi Kombëtar i Statistikave kryejnë aktivitetet e tyre statistikore. Në zbatim të Ligjit Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”,



Qeveria Shqiptare ka miratuar vendimin Nr. 541, datë 29.9.2021, Për miratimin e Nomenklaturës së Shteteve dhe Territoreve për Statistikat e Tregtisë së Jashtme të Mallrave dhe ndarjen gjeografike për statistikat e tjera të biznesit’.

Statistikat demografike dhe komponentët e saj si: Popullsia, Lindjet, Vdekjet, Shtesa Natyrore dhe Migracioni Neto prodhohen në përputhje me rregulloret dhe definicionet e përdorura nga EUROSTAT. INSTAT ka transmetuar këto të dhëna si dhe metadata nëpërmjet platformës elektronike Metadata Handler me frekuencë vjetore (Euro SDMX Metadata Strukturore, ESMS). INSTAT transmetoi të dhënat kryesore të popullsisë në Eurostat në qershor 2021 si dhe do të transmetojë të dhënat e detajuara demografike në dhjetor 2021.

INSTAT ka përpunuar analizuar dhe transmetuar për herë të parë në Eurostat të dhëna mbi vdekjet javore sipas karakteristikave kryesore demografike (NUTS 3, SEX dhe AGE). Këto të dhëna u transmetuan si të dhëna finale për vitin 2020, gjithashtu janë transmetuar edhe të dhënat paraprake të vdekjeve sipas javëve të 2021. INSTAT ju bashkua nismës nga EUROSTAT në mënyrë vullnetare për statistika sa më të detajuara dhe me periodicitet të lartë në kuadër të situatës të shkaktuar nga pandemia globale COVID-19.

INSTAT në përputhje me PSZ 2017 – 2021 ka mbledhur, përpunuar, analizuar dhe shpërndarë që prej 2017 të dhënat mbi të huajt me leje qëndrimi, të huajt e parregullt si dhe statistikat mbi azil kërkuesit në Shqipëri. Këto të dhëna bënë të mundur plotësimin e disa indikatorëve mbi azil kërkuesit të cilët kërkohen nga pyetësorët e Eurostat dhe janë transmetuar së fundmi në Shkurt të 2021. Në kuadër të përafrimit të statistikave të lejeve leje qëndrimi, të huajt e parregullt si dhe statistikave mbi azil kërkuesit, INSTAT ka hartuar formate tip për mbledhjen e tyre nga burimet administrative në përputhje me rregulloret dhe definicionet e përdorura nga EUROSTAT.

INSTAT në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi statistikat e migracionit në Shqipëri ka zhvilluar një studim të gjerë në 24 mijë familje në vitin 2019 me mbështetjen e IOM. Ky studim i cili u publikua në Shtator 2020 bën të mundur vlerësimin e Migracionit që prej vitit 2011 e në vazhdim, dhe

prodhimin dhe përmirësimin e një sërë treguesve që lidhen me statistikat e Migracionit.

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vërtetim statistikor që kryhet pranë njësisë ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Rezultatet e kësaj ankete përdoren gjithashtu për përditësimin e peshave të përdorura në Indeksin e Çmimeve të Konsumit dhe llogaritjen e Konsumit Final të NjEF si një agregat i rëndësishëm i PBB me metodën e shpenzimeve. Nga janari i vitit 2014, ABF është një anketë e vazhdueshme dhe me baza vjetore. Prej vitit 2019, për të gjithë kampionin informacioni në ditar mbledhet me periudhë mbledhjeje të të dhënave 1 javë. Rezultatet kryesore të ABF 2020 u publikuan në Tetor 2021. Aktualisht është duke u kryer në terren anketa e vitit 2021, kampioni i së cilës vazhdon në madhësinë e kampionit të vitit 2020 për të studiuar dhe analizuar treguesit kryesorë të konsumit për 6 bashki kryesore.

Për sa i përket Anketës së Turizmit në Familje “Pushime dhe Udhëtime”, ka përfunduar grumbullimi i të dhënave në terren për vitin 2020. Aktualisht, është duke u përgatitur publikimi i rezultateve kryesore me të dhënat e vitit 2020, të cilat do të bëhen publike në Nëntor 2021. Të dhënat e vitit 2020 janë transmetuar në EUROSTAT sipas kërkesave dhe udhëzimeve të përkatëse. Grumbullimi i të dhënave në terren për tremujorin e tretë të anketës për vitin 2021 ka përfunduar, ndërkohë ka përfunduar hedhja e të dhënave për tremujorin e parë dhe të dytë.

Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Njësitë Ekonomike Familjare (NjEF) dhe Individë, ka përfunduar procesi i mbledhjes së të dhënave në terren për vitin 2021 në periudhën Qershor–Korrik 2021. Të dhënat e vitit 2020 janë transmetuar në EUROSTAT sipas kërkesave dhe udhëzimeve të përkatëse. Aktualisht, është duke u kryer procesi i editimit dhe përpunimit të të dhënave për vitin 2021. Publikimi i rezultateve kryesore për të dhënat e vitit 2021, të cilat do të bëhen publike në Dhjetor 2021.

Gjatë vitit 2020, INSTAT kreu valën e katërt të anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, (SILC) gjatë periudhës korrik – nëntor (shtyrë si rezultat i situatës së pandemisë). Gjatë kësaj periudhe puna është fokusuar në pastrimin e të



dhënave të SILC 2019 si dhe përgatitjen e skedarëve agregat, përditësimin të programeve si dhe ndërtimit të skedarit të konsoliduar për të dhënat e SILC 2017, 2018 dhe 2019. Procesi i përfundimit dhe transmetimit në EUROSTAT të të dhënave të konsoliduara të SILC 2019 u shty si rezultat i pandemisë dhe u dërguan dhe validuan në EUROSTAT në Prill 2021. Linku i mëposhtëm paraqet rezultatet kryesore të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, 2017, 2018, 2019: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-aan/j/publikimet/2021/matja-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2019/>

Gjatë vitit 2021 u realizua gjithashtu Anketa e Të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës për vitin 2021 gjatë periudhës Maj – Shtator 2021. Gjithashtu po realizohet dhe procesimi i të dhënave të SILC 2020 si dhe krijimi i fileve të konsoliduara për vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Për herë të parë Shqipëria do të prodhojë dhe indikatorët longitudinal ku studjohen individët për një periudhë 4 vjeçare (2017 – 2020).

Që nga viti 2019, INSTAT është duke zhvilluar Sistemin e Integruar European të Statistikave të Mbrojtjes Sociale (ESSPROS).

Në vitin 2021 Shqipëria realizoi modulën e Përfituesve të pensioneve për vitet 2018 – 2019 dhe transmetoi të dhënat paraprake në EUROSTAT. Gjithashtu INSTAT ka mbledhur të dhënat cilësore dhe sasiore për sistemin bazë të cilin e ka transmetuar në EUROSTAT në formë testimi.

Për të përmirësuar dhe zhvilluar më tej sistemin ESSPROS në vend, Shqipëria po asistohet nga një mbështetje teknike ad-hoc nga projekti IPA.

Në përputhje me PSZ 2017 – 2021, INSTAT prodhon dhe publikon statistika të përditësuara mbi shkaqet e vdekjeve dhe shëndetin publik. Me fillimin e implementimit të Nomenklaturës së miratuar të Shkaqeve të Vdekjeve (ICD-10) do reflektohen ndryshimet në statistikat e shkaqeve të vdekjeve sipas rekomandimeve të Eurostat. Në kuadër të projekteve IPA 2017, INSTAT gjatë vitit 2020 kreu për herë të parë Anketën Europiane të Shëndetit (EHIS), ku procesi i mbledhjes së të dhënave përfundoi në dhjetor 2020, me një shtrirje 4 mujore në terren. Në korrik të vitit 2021,

INSTAT transmetoi në Eurostat mikrodatat e anketës EHIS. Në Tetor të vitit 2021, INSTAT gjithashtu dërgoi në Eurostat raportin e cilësisë dhe raportin final të projektit. Rezultatet e anketës pritet të publikohen brenda tremujorit të katërt të vitit 2021. Rezultate të cilat do të plotësojnë dhe pasurojnë tërësinë e të dhënave të shëndetit publik sipas ECHI (European Core Health Indicators), si dhe do lehtësojnë krahasimin e të dhënave, të cilat do shërbejnë për të monitoruar shëndetin, kujdesin shëndetësor në nivelin e standardeve të BE-së.

Në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, INSTAT është asistuar vazhdimisht nga IPA 2014, 2015 dhe 2017. Klasifikimi ndërkombëtar i krimeve për qëllime statistikore (ICCS) është ende në proces hartimi. INSTAT ka përfunduar për të gjithë nivelet hartëzimin e klasifikimit bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, dhe tetë nivelet e para të klasifikimit janë finalizuar dhe dakortësuar me grupin ndërinstitucional teknik të punës. Zbatimi i këtij klasifikimi, nga INSTAT dhe institucionet përgjegjëse për prodhimin e statistikave të drejtësisë penale, do siguroj krahasueshmëri të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Nga viti 2013, INSTAT transmeton në Eurostat pyetësor mbi statistikat e krimeve. Në kuadër të projektit IPA-2017 “Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale”, INSTAT po zhvillon setin e zgjeruar të krimeve me interes në BE, vepra penale të cilat janë në linjë me klasifikimin ICCS. Të gjitha aktivitetet e projektit kanë përfunduar dhe dërguar në Eurostat.

Në përputhje me PSZ 2017 – 2021, INSTAT publikon çdo vit statistika të përditësuara gjinore në një botim të dedikuar “Gra dhe Burra në Shqipëri. Në Janar të vitit 2020, INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lançuan për herë të parë raportin e Indeksit të Barazisë Gjinore (GEI). Treguesi i barazisë gjinore është një vlerë themelore e Bashkimit Evropian dhe është thelbësor për zhvillimin e politikave gjinore të një vendi. Si i tillë matja e progresit të barazisë gjinore është një pjesë integrale dhe efektive e politikë bërësve. Gjatë vitit 2021, INSTAT ka nisur punën përgatitore për llogaritjen e GEI 2021, nëpërmjet kombinimit të treguesve të përzgjedhur të barazisë gjinore në një masë të vetme përmbledhëse. Pas analizimit të të dhënave, llogaritjet e GEI 2021 do dërgohen për validim te



EIGE dhe pritet brenda tremujorit të katërt 2021 të përfundojë llogaritja e treguesit për vitin 2021.

Për sa i përket statistikave të arsimit, INSTAT publikon çdo vit statistika të përditësuara mbi regjistrimet dhe diplomimet sipas programeve dhe niveleve arsimore, në institucionet arsimore publike dhe private. Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit ISCED-11 përdoret për të klasifikuar të dhënat dhe për të prodhuar statistika sipas niveleve dhe fushave të studimit. Statistikat e arsimit bazohen në burime administrative, kryesisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Tregues shtesë në lidhje me ndjekjen në shkollë dhe arsimin e të rriturve janë llogaritur duke përdorur Anketën për Arsimin e të Rriturve (AES) dhe të dhënat e Anketës së Forcës së Punës (LFS). Për herë të parë, anketa AES është zhvilluar në vitin 2017 dhe raundi i ardhshëm është planifikuar brenda viteve 2023 – 2024. Statistikat e arsimit transmetohen çdo vit në UNESCO-UIS përmes pyetësorëve shumë të detajuar. Përmirësimet e mëtejshme në lidhje me cilësinë e të dhënave dhe transmetimi i të dhënave në Eurostat do të jenë objektivi kryesor lidhur me këto statistika.

Sektori i Tregut të punës kryen vlerësime për dy aktivitete statistikore me frekuencë tremujore: “Anketën Tremujore të Forcave të Punës” dhe “Prodhimin e të Dhënave Administrative të Tregut të Punës”. Për të “Dhëna Administrative mbi Pagat”, me frekuencë tremujore dhe vjetore, do të vazhdojë publikimi duke përdorur të dhënat administrative të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjatë 2021 është kryer Anketa rreth “Strukturës së Kostos nga Puna” e planifikuar çdo katër vjet. Rezultatet e para të kësaj ankete priten në 2022.

Gjatë vitit 2021, INSTAT ka arritur të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga PSZ-së 2017 – 2021. Janë realizuar sipas moduleve objektivat si më poshtë:

- Tregues statistikorë mbi forcat e punës, punësimin dhe papunësinë sipas gjinisë, aktivitetit ekonomik, grup profesioneve, grup moshave, nivelit arsimor dhe qarqeve (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 2 2021);

- Tregues statistikorë mbi të papunët e regjistruar gjithsej dhe sipas gjinisë, grup moshave, nivelit arsimor dhe qarqeve, të papunët e regjistruar që përfitojnë pagesë papunësie, të

papunët afatgjatë të regjistruar dhe shkalla e papunësisë së regjistruar;

- Tregues statistikorë mbi strukturën e të ardhurave nga puna për orë pune, mujore dhe vjetore sipas karakteristikave individuale të punonjësve (gjinia, moshë, profesioni, niveli më i lartë arsimor i arritur), dhe punëdhënësit (aktiviteti ekonomik, madhësia dhe pronësia e ndërmarrjes) (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 2 2021);

- Tregues statistikorë mbi pagën mesatare mujore për të punësuarit me pagë në sektorin shtetëror dhe për të gjithë sektorët ekonomikë sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup profesioneve, hendekun gjinor në paga sipas aktiviteteve ekonomike dhe grup-profesioneve (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 2 2021).

Gjatë vitit 2021, ka vazhduar puna përgatitore për Censin e Popullsisë dhe Banesave e cila gjatë këtij viti është fokusuar në organizimin e Censit të dytë Pilot, pasi ka organizuar tre testime në terren nga muaji Marsi deri në muajin Korrik 2021. Pilot Censi filloi më datë 4 tetor 2021 dhe do të zgjasë gjashtë javë në terren. Qëllimi kryesor i këtij Pilot është testimi i çdo faze, në mënyrë që të përmirësohen të gjitha materialet dhe procedurat për një Census të suksesshëm vitin e ardhshëm. Pilot Censi po kryhet në 50 zona të ndryshme (me karakteristika specifike) të shpërndara në nëntë bashki, si Tiranë, Fushë Arrëz, Dibër, Korçë, Kamëz, Durrës, Selenicë, Dropull dhe Pustec. Këto zona kanë tipologji të ndryshme dhe mbulojnë disa grupe të popullsisë si minoritete të ndryshme, grupe fetare, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara etj. Nga pikëpamja metodologjike, të tre pyetësorët si pyetësorët për familjet (Njësitë Ekonomike Familjare), banesat kolektive dhe personat e pastrehë u përditësuan në bazë të rezultateve të testit të tretë të Censit në terren dhe rishikimit të aplikimeve përkatëse CAPI. Pyetësori është hartuar duke u bazuar në rekomandimet e OKB-së dhe Eurostat-it për raundin e Censit të vitit 2020 dhe pasqyron të gjitha kërkesat e Rregullores së Censit (EC) Nr. 763/2008 - të gjitha temat thelbësore. Për më tepër, ai përmban kërkesat e përdoruesve, të mbledhura përmes tabelave konsultative dhe siguron krahasueshmëri me pyetësorin e mëparshëm të Censit. Janë përgatitur manualët për anketuesit,



kontrollorët dhe mbikëqyrësit, materialet e trajnimit dhe testet e vlerësimit. Për procesin Pilot Census janë rekrutuar 50 anketues, 6 kontrollues dhe 3 mbikëqyrës. Janë organizuar trajnime pesëditore për secilin nivel të stafit të përfshirë në terren. Mbikëqyrësit, stafi logjistik dhe IT u trajnuan në një trajnim. Një tjetër trajnim është organizuar për kontrollorët e të gjitha bashkive ndërsa një trajnim për anketuesit (9 bashki janë pjesë e Pilot Censit). Në fund të çdo trajnimi janë organizuar teste vlerësimi. Për të siguruar monitorimin e punës në terren gjatë pilotimit, përveç kontrollorëve, mbikëqyrësve, stafit rajonal dhe qendror të INSTAT, është krijuar një dashboard, i cili mundëson një monitorim të plotë të punës në terren në kohë reale. Për sa i përket komunikimit me përdoruesit, janë zhvilluar disa aktivitete si:

- Përditësimi i seksionit të dedikuar të Censit në faqen e INSTAT <http://instat.gov.al/al/cens-2022/> ;

- Ndarja e Informacioni mujor me Komisionin qendror të Censit;

- Shpërndarja e posterave dhe fletëpalosjeve në Bashkitë e përzgjedhura;

- Organizimi i nëntë tryezave informative në bashkitë pilot me fokus grupe të ndryshme si përfaqësues të komunave, universiteteve, shkollave, grupeve etnike, grupeve fetare dhe personave me aftësi të kufizuara;

- Konferencë për shtyp mbi fillimin e Censit Pilot të Popullsisë dhe Banesave;

- Spote televizive mbi pilot censin për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës në lidhje me këtë aktivitet;

- Fushata e mediave sociale për të shpërndarë dhe promovuar më tej pilot censin.

Qëllimi i organizimit të tryezave të rrumbullakëta ishte informimi i fokus grupeve mbi procesin dhe aktivitetet e Pilot Censit dhe për të kërkuar bashkëpunimin e tyre në këtë proces të rëndësishëm. Aktivitetet e ardhshme që parashikohen në periudhën nëntor – dhjetor 2021 janë:

- Organizimi i Anketës së Pas-Regjistrimit (PES) pilot (kampioni që do të vendoset);

- Tabelimi i rezultateve të Pilotit, për përdorim të brendshëm;

- Reflektimi i gjetjeve të pilot censit në të gjitha proceset e Censit të Popullsisë dhe Banesave

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë një punë intensive në fushën e statistikave të Llogarive Kombëtare për rritjen e nivelit të përputhshmërisë me ESA 2010, konkretisht në përmirësime metodologjike apo edhe në shtimin e treguesve të rinj. Projekte të ndryshme IPA shumë-përfutuese, nga BE dhe jo vetëm, kanë ndihmuar në zhvillimin e Llogarive Kombëtare dhe do të vazhdojnë të japin asistencë teknike deri në implementimin e plotë të saj.

Në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017 – 2021, janë realizuar, sipas moduleve objektivat, aktivitetet më poshtë:

- Llogaritë Vjetore sipas sektorëve institucionalë – Vlerësimi dhe publikimi i Llogarisë së Prodhimit dhe Gjenerimit të të ardhurave sipas sektorëve institucional 2018;

- Agregatët kryesorë të Llogarive Kombëtare;

- Vlerësimi dhe publikimi i treguesve të PBB-së sipas metodës së prodhimit dhe metodës së shpenzimeve, 2019 me çmime korrente dhe çmimet e vitit të mëparshëm;

- Tregues statistikorë mbi PBB tremujore, me metodën e prodhimit, me çmime korrente, me çmimet e vitit të mëparshëm dhe “chain link” sipas aktivitetit ekonomik, e përshtatur dhe e pa përshtatur sezonalisht (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 3 2020);

- Tregues kryesor statistikorë mbi PBB tremujore, me metodën e shërbimeve, me çmime korrente, me çmimet e vitit të mëparshëm dhe “chain link”, e përshtatur dhe e pa përshtatur sezonalisht (Publikimi i fundit korrespondon me Tremujorin e 3 2020);

- Kryerja e llogaritjeve për kalimin nga treguesi i PBB në treguesin e të Ardhurave Kombëtare Bruto - AKB (GNI);

- Tabelat burime përdorime dhe tabelat input-output – Përpilimi dhe publikimi i tabelave Burime – Përdorime (TBP për vitin referencë 2018 me çmime korrente në tre nivele detajimi);

- Llogaritë rajonale – Vlerësimi dhe publikimi i treguesve të PBB-së sipas rajoneve statistikore nivel 2/3 2019;

- Llogaritë e Administratës Publike – Publikimi i “Listës së Institucioneve të sektorit publik 2020”.

INSTAT është pjesë e Programit të Transmetimit ESA 2010, duke transmetuar rregullisht në EUROSTAT, treguesit e Llogarive



Kombëtare (Llogaritë Kombëtare Vjetore dhe Tremujore, Llogaritë Rajonale, Llogaritë jo-financiare sipas sektorëve Institucional, Tabelat Burime – Përdorime dhe IOT), në formatin SDMX. Banka e Shqipërisë transmeton Llogaritë Financiare sipas sektorëve Institucional. Përpjekje të vazhdueshme bëhen nga INSTAT për të rritur të dhënat dhe numrin e tabelave të transmetuara.

Në përmbushje të detyrimeve në kuadër të përafrimit të statistikave të Llogarive Kombëtare janë përgatitur dhe publikuar në faqen zyrtare të INSTAT metadatit strukturore të Llogarive Kombëtare, të cilat janë transmetuar në EUROSTAT nëpërmjet Metadata Handler (Euro SDMX Metadata, ESMS).

INSTAT në bashkëpunim me BSH dhe MFE transmeton rregullisht (dy herë në vit) në Eurostat, Tabelat e njohimit të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (EDP). Dërgimi i fundit është kryer në Tetor 2021, duke përdorur formatin zyrtar të kërkesave të EUROSTAT. Këto tabela vlerësohen të jenë pjesërisht të përafruara me rekomandimet e ESA 2010 dhe Manualin e Deficitit dhe Borxhit (MDGG 2014).

Për plotësimin e tabelave EDP është i nevojshëm identifikimi i tërësisë së njësive institucionale që klasifikohen nën Qeverinë e Përgjithshme, në përputhje me standardet ESA2010. Listat e njësive të sektorit publik dhe atij financiar hartohen në përputhje me ESA2010 dhe publikimi i tyre plotëson detyrimet e rrjedhura në kuadër të integritetit. Lista e dakortësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka e Shqipërisë dhe INSTAT përditësohet dhe publikohet rregullisht, çdo vit.

Shqipëria është e përfshirë dhe ka bërë progres në sistemin Procedurës së Imbalancës Makroekonomike (MIP). Ky sistem është një mekanizëm mbikëqyrjeje për monitorimin e politikave ekonomike dhe zbulimin e dëmeve të mundshme në funksionimin e duhur të ekonomisë së një shteti anëtar, të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, apo dhe të Bashkimit Evropian në tërësi. Aktualisht, INSTAT dhe Banka e Shqipërisë, kanë arritur të sigurojnë informacionin e nevojshëm (plotësimi i tabelave, sipas serive kohore të dipsonueshme) për 14 treguesit kryesorë dhe 25 tregues ndihmës. Janë hartuar metadatit respektive për të gjithë

treguesit kryesorë dhe dokumentimin për treguesit ndihmës.

Politika e Revizionimit të statistikave Makroekonomike, mbështetur në Politikën e Harmonizuar të Revizionimit (HERP), e cila është e detyrueshme për të gjithë vendet anëtare të Bashkimit Evropian është publikuar në faqen zyrtare të INSTAT. Kjo politikë u hartua në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën e Shqipërisë. Metadatit Strukturore të Llogarive Kombëtare janë të publikuara gjithashtu, në faqen zyrtare të EUROSTAT dhe INSTAT.

Në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi Statistikat e Bizneseve, INSTAT është asistuar vazhdimisht nga programet IPA 2017 dhe 2019.

Sa i përket “Statistikave të Biznesit”, INSTAT ka vlerësuar përditësuar dhe transmetuar në Eurostat të dhëna mbi treguesit ekonomik, në përputhshmëri me konceptet dhe përkufizimet evropian. Gjatë vitit 2021 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017 – 2021, janë realizuar disa objektivat. INSTAT mirëmban dhe është përgjegjës për përditësimin e regjistrave të biznesit. Regjistrat përditësohen dhe mirëmbahen me burimet administrative dhe statistikore.

- Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore, ndërmarrjet, që kryejnë veprimtari ekonomike, duke kontribuar në prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Në qershor të vitit 2021 u publikuan të dhënat e regjistrat me vit referencë 2020. Botimi shoqërohet me raportin e cilësisë ESQRS (Struktura Standarde e Raportit të Cilësisë ESS) i cili botohet çdo vit në faqen zyrtare të INSTAT dhe transmetohet në Eurostat;

- Regjistri Statistikor i Njësive Lokale është ndërtuar në vitin 2010 dhe përditësohet çdo vit. Ky regjistër është baza kryesore për prodhimin e statistikave rajonale;

- Për shkak të globalizimit, krahasueshmëria ndërkombëtare e të dhënave statistikore është bërë shumë e rëndësishme. Regjistri i Grupeve të Ndërmarrjeve dhe Grupet e Ndërmarrjeve Shumëkombëshe (MNE) është ndërtuar dhe mirëmbahet prej vitit 2018.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve



ekonomike jo-bujqësore me vrojtim vjetor. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri, pavarësisht formës ligjore të tyre. Të dhënat paraprake publikohen 11 muaj pas vitit të referencës; të dhënat finale publikohen 14 muaj pas vitit të referencës në botimin e veçantë “Rezultate të Përgjithshme të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve”, në Vjetarin Statistikor dhe faqen elektronike të INSTAT-it. Rezultatet publikohen në nivel kombëtar, sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes. Gjithashtu, INSTAT prodhon dhe Statistika Strukturore të Ndërmarrjeve sipas rajoneve, të cilat kanë si qëllim të tregojnë zhvillimin dhe strukturën e aktiviteteve ekonomike të tyre.

Gjatë vitit 2021 u realizua prodhimi i rezultateve finale të Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike 2019 dhe rezultateve paraprake 2020. Gjithashtu, u realizua përpunimi dhe prodhimi i statistikave strukturore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme 2019. INSTAT ka kryer vlerësimin e statistikave strukturore në nivel rajonal për treguesit kryesorë për vitin 2019. Në Qershor 2021 u transmetuan në Eurostat disa nga treguesit kryesorë. Për të siguruar vazhdimësinë dhe përmirësimin e cilësisë të treguesve statistikorë të ndërmarrjeve, INSTAT shfrytëzoi edhe burimet administrative për editimin dhe imputimin me të dhëna të treguesve kryesorë.

Prej vitit 2018, mbledhen dhe përpunohen të dhënat për prodhimin e Statistikave të Produkteve Industriale (PRODCOM). Statistikat PRODCOM janë vlerësuar vetëm për përdorim të brendshëm dhe nuk janë publikuar dhe transmetuar në Eurostat. Për përmirësimin e cilësisë së të dhënave nevojitet zhvillimi i infrastrukturës së duhur statistikore për prodhimin e këtyre statistikave. Kjo seri me të dhëna do të shërbejë për një analizë më të plotë të treguesve të prodhimit dhe shitjes së produkteve industriale.

INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat Afatshkurtra të Ndërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore. Gjatë viteve të fundit të dhënat janë siguruar në mënyrë të kombinuar nëpërmjet burimeve administrative dhe vrojtimit tremujor. Statistikat Afatshkurtra përfshijnë gjithë ndërmarrjet aktive në Shqipëri, pavarësisht

formës ligjore të tyre. Të dhënat publikohen 60 ditë pas mbylljes së tremujorit referencë për Lejet e Ndërtimit dhe 75 ditë për Statistikat Afatshkurtra. Prej vitit 2018, të dhënat transmetohen rregullisht me bazë tremujore për disatregues kryesorë dhe raportet e cilësisë për të gjithë anekset e Statistikave Afatshkurtra të Ndërmarrjeve.

Gjatë vitit 2021 burimet administrative u përdorën për analizën dhe prodhimin e treguesve afat-shkurtër. Në rast të mungesës së burimit administrativ u përdor kontaktimi i ndërmarrjeve me vrojtim të drejtëpërdrejtë në ndërmarrje.

Gjatë vitit 2021 në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar:

- Indeksi i Tregtisë me Pakicë tremujor, publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e dytë 2021;

- Statistikat Afatshkurtra, Të mirat dhe Shërbime, publikim tremujor i fundit korrespondon me tremujorin e dytë 2021;

Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i lejeve të ndërtimit grumbullohet nga zyrat rajonale të INSTAT në bashkëpunim me zyrat urbanistike të bashkive përkatëse. Të dhënat mbi lejet e ndërtimit të miratuara ofrojnë informacion për ndërtesat dhe punime inxhinierie në vend.

Gjatë vitit 2021, në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime tremujore mbi lejet e ndërtimit; publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e tretë 2021.

Në zbatim të Ligjit Nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 17/2018, datë 05.02.2004 “Për statistikat zyrtare”, “Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2017 – 2021”, Banka e Shqipërisë ka vijuar me prodhimin dhe publikimin e blloqeve statistikore të prezantuara nëpërmjet statistikave monetare e financiare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Banka e Shqipërisë është kujdesur që të gjithë treguesit e përgatitur prej saj të garantojnë plotësimin dhe respektimin e të gjitha parimeve të statistikave zyrtare, të tilla si integritetin, transparencën, cilësinë, koherencën, konfidencialitetin etj.

Banka e Shqipërisë ka qënë e angazhuar në programin IPA Shumëpërfutuese 2017 për statistikat e Tregtisë Ndërkombëtare të Shërbimeve, ku fokus kryesor i projektit është



përmirësimi i metodologjive statistikore kryesisht për shërbimet për përpunim, shërbimet e transportit të mallrave, matja e importit të FISIM, shërbimet qeveritare dhe mbulimi më i gjerë i të dhënave duke përfshirë transaksionet e llogarive jashtë të rezidentëve.

Në kuadrin e investimeve të kryera, Banka e Shqipërisë ka përfunduar projektin një vjeçar për automatizimin e prodhimit të bllokut të statistikave të sektorit të jashtëm. Aktualisht puna ka vijuar paralelisht në sistem dhe MS Office ekzistues për të garantuar vijueshmërinë e hartimit të statistikave të periudhave të ardhshme vetëm me sistem. Ky sistem përfshin hartimin mujor të statistikave të bilancit të pagesave, një nga pyetësorët e planifikuar për raportim në Eurostat.

Për sa i përket aktiviteteve zbatuese për statistikën monetare janë prodhuar dhe publikuar rregullisht treguesit monetarë mujorë dhe tremujorë, të tillë si: agregatat monetarë, depozitat, kreditë, normat e interesit të depozitave dhe kredive për sasi të reja dhe sasi gjendje, bilancet sektoriale dhe paraqitjet monetare të korporatave depozituese dhe institucioneve të tjera financiare.

Lidhur me hartimin e statistikave të llogarive financiare ka vijuar puna lidhur për konsolidimin e burimeve të informacionit dhe metodikës së vlerësimit në hartimin e Llogarive Financiare, për të gjithë sektorët ekonomikë, në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore Evropiane dhe Eurostat-it. Banka e Shqipërisë publikon rregullisht si Llogaritë Financiare të Shqipërisë, në frekuencë vjetore së bashku me analizën e tyre.

Në kuadrin e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e cilësisë së treguesve të Procedurës së Deficitit të Tejkalluar (EDP), ka vijuar puna për harmonizimin e të dhënave të llogarive financiare me statistikën e financave të qeverisë. Gjithashtu, puna vijon për implementimin e rregullores 501/2004 EC për hartimin e llogarive financiare me bazë tremujore.

Lidhur me statistikën e sektorit të jashtëm, Banka e Shqipërisë ka transmetuar rregullisht në Eurostat pyetësorët e mëposhtëm, me bazë tremujore dhe vjetore:

- Bilanci pagesave tremujore;
- Pozicioni i investimeve ndërkombëtare;
- Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve sipas shteteve;

- Fluksi i investimeve direkte sipas shteteve;
- Të ardhurat nga i investimeve direkte sipas shteteve;
- Fluksi dhe të ardhurat nga investimet direkte sipas shteteve dhe aktivitetit ekonomik;
- Stoku i investimeve direkte sipas shteteve;
- Stoku i investimeve direkte sipas shteteve dhe aktiviteteve;
- Banka e Shqipërisë vijuar rregullisht publikimin e tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve sipas shteteve, si një produkt i ri statistikor.

Lidhur me statistikën monetare dhe llogaritë financiare, Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2021 bashkëpunoi ngushtë me bankën e Portugalisë në kuadrin të programit “Përforcimi i kapaciteteve të bankave qendrore të Ballkanit Perëndimor, me qëllim integrimin në Sistemit Evropian të Bankave Qendrore”, mbështetur nga TAIEK, ECB. Aktiviteti ka qenë i fokusuar në integrimin e microdatabasave në sistemin datawarehouse për qëllime statistikore dhe është perceptuar si i tillë në funksion të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve të statistikave për të përballuar sfidat që do të sjellë zhvillimi teknologjik i BSH në kuadrin të menaxhimit të informacionit statistikor për vendimmarrje.

Në kuadrin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) për përafrimin metodologjik të statistikave me standardet ndërkombëtare dhe harmonizimin e tyre sipas acquis komunitare, gjatë vitit 2021 është punuar për përafrimin e Rregullores (BE) Nr. 2021/379 e Bankës Qendrore Evropiane, e 22 Janarit 2021 në lidhje me zërat e bilancit të institucioneve të kreditit dhe sektorit të institucioneve financiare monetare. Rregullorja, do të shoqërohet me paketën raportuese dhe udhëzuesin përkatës për përcaktimin dhe vlerësimin e treguesve, si dhe do të mundësojë harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e hartimit të agregateve monetare. Kjo siguron njëkohësisht, përputhshmëri me kërkesat në raportim të Bankës Qendrore Evropiane, në përmbushje të kërkesave për një sistem raportues gjithëpërfshirës dhe dinamik.

Banka e Shqipërisë ka përfunduar në tetor 2021, projektin IPA 2017 për statistikën e Tregtisë Ndërkombëtare të Shërbimeve. Gjatë këtij projekti janë mbyllur me sukses aktivitetet si:

- kryerja e vrojtimin pranë ndërmarrjeve që kanë objektiv përpunimin e mallrave të zotëruara nga rezidentët. Ky vërtetim pati si qëllim matjen e vlerës së shtuar gjatë përpunimit të këtyre mallrave nga ndërmarrjet rezidente, që do të shërbejë në hartimin e shërbimeve për përpunim. Rezultatet e këtij vërtetimi u diskutuan dhe u dakordësuan me ekspertin e projektit, duke vlerësuar se në matjen e këtyre shërbimeve, vërtetimi pranë ndërmarrjeve jep një përfaqsim më të mirë të vlerës së shërbimit kundrejt të dhënave bruto të databazës doganore. Banka e Shqipërisë do të kryejë për tre vjet rresht vërtetimin pranë ndërmarrjeve për të pasur një konsistencë në seri kohore të vlerësimit të këtij treguesi;

- hartimi i importit të FISIM, përbën një tjetër përmbushje e aktivitetëve;

- në kuadër të shtimit të burimeve statistikore, është arritur me sukses përfshirja e raportimit të informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimore për kompensimin e punonjësve, nga Albcontrol-i për ndarjen me shtete të transportit ajror dhe nga Ministria e Financave për shërbimet qeveritare në përmirësimin e raportimit;

- përlogaritja e kostonë së transportit dhe sigurimeve, bazuar në rekomandimet e ekspertit duke mospërfshirë tregtinë me vendet fqinje me supozimin që kostonë e transportit ndërmjet Shqipërisë dhe to është e papërfillshme;

- krijimi i regjistrin të ndërmarrjeve me llogari bankare jashtë dhe hartimi i formës së raportimit në kuadër të mbulimit më të gjerë të të dhënave;

- plan veprimi në kuadër të Rregullores së re Evropiane të Statistikave EU 2019/2152, ku do të raportohen dy tregues të rinj lidhur me tregtinë ndërkombëtare të shërbimeve – sipas karakteristikave të ndërmarrjes dhe sipas mënyrës së ofrimit të shërbimeve. Gjatë këtij aktiviteti, u identifikuan burimet kryesore të të dhënave dhe u dakordësua një plan veprimi afatmesëm ku u specifikuan rolet e Bankës së Shqipërisë dhe INSTAT-it;

- përditësimi i metodologjisë së hartimit të tregtisë së shërbimeve duke përfshirë të gjithë treguesit që patën impakt gjatë projektit;

- hartimi për herë të parë nga Banka e Shqipërisë raporti i cilësisë së tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve, nën mbikëqyrjen e ekspertit.

Banka e Shqipërisë në shtator 2021 realizoi hartimin dhe hedhjen e metadave në sistemin e Eurostat Metadata Handler për të gjithë treguesit të mbuluar nga *acquis* përkatëse. Këto metadata u validuan me sukses nga Eurostat.

Në kuadër të përmirësimit dhe përmbushjes së treguesve mbi Statistikat e Sektoriale, INSTAT është asistuar vazhdimisht nga programet IPA 2017 dhe 2019. Në këtë kontekst, INSTAT ka vlerësuar përditësuar dhe transmetuar në Eurostat të dhëna mbi këta tregues, në përputhshmëri me konceptet dhe përkufizimet evropiane. Gjatë vitit 2021 në përmbushje të objektivave të PSZ-së 2017 – 2021, janë realizuar objektivat si më poshtë:

- INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon Statistikat e Energjisë Elektrike të grumbulluara prej burimeve administrative. Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, importin dhe eksportin bruto të energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudhën tremujore të siguruar nga burimet administrative. Gjatë vitit 2021, në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime tremujore mbi statistikën e energjisë elektrike; publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e tretë 2021;

- INSTAT mbledh dhe publikon Bilancin e Përgjithshëm të Energjisë, i cili paraqet situatën aktuale në sektorin e energjisë në Republikën e Shqipërisë. Ai është përmbledhje e gjithë bilanceve të burimeve energjitike të disponueshme dhe është hartuar i plotë që nga viti 1998. Bilanci paraqet origjinën dhe përdorimin specifik sipas burimeve të energjisë dhe përbëhet nga dy pjesë kryesore: furnizimi dhe përdorimi i energjisë;

- INSTAT transmeton çdo vit në Eurostat mini-pyetësorë; pyetësorët vjetorë (Energjia Elektrike dhe Ngrohja, Gazi Natyror, Nafta, Qymyri, Energjia e Rinovueshme dhe Mbetjet, Konsumi i Energjisë në Familje dhe Vlerësimi i përmbledhur i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë); pyetësorët mujorë (Nafta, Gazi dhe Energjia Elektrike) dhe çmimet e energjisë (Energjia Elektrike dhe Gazi për Familjet/Industrinë);

- INSTAT prodhon dhe publikon statistikën mbi Lëvizjen e Shtetasve të cilat paraqesin të



dhëna të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj: sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë), pikave kufitare, qëllimit të udhëtimit të shtetasve të huaj, hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve. Statistikat mbi Lëvizjet e Shtetasve publikohen afërsisht 21 ditë pas përfundimit të muajit referues (T+21), sipas datës së paracaktuar në Kalendarin e Publikimeve të INSTAT. Të dhënat mbi Lëvizjen e Shtetasve janë të dhëna administrative. Gjatë vitit 2021 në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime mujore mbi lëvizjen e shtetasve; i fundit korrespondon me muajin Tetor 2021.

Lidhur me Statistikat e Turizmit – ana e ofertës – INSTAT mbledh, përpunon dhe publikon statistikën mbi “Strukturat Akomoduese” me vërtetim të drejtpërdrejtë me anketues. Në Korrik 2017, me mbështetjen e projekteve IPA MB nisi vërtetimi mujor për mbledhjen e informacionit pranë ndërmarrjeve. Në Korrik 2020, u publikuan për herë të parë të dhënat e Anketës së Turizmit mbi “Strukturat Akomoduese”, për periudhën kohore 2018 – 2019. Të dhënat mbledhen me frekuencë mujore, ndërsa publikimi për vitet 2020 dhe 2021 është kryer me frekuencë tremujore. Pas publikimit, të dhënat dhe raporti i cilësisë për Strukturat Akomoduese transmetohet në Eurostat. Publikimi i fundit korrespondon me tremujorin e tretë 2021.

Statistikat mbi Shkencën përfshijnë vërtetimet dyvjeçare në të gjithë sektorët ku ky aktivitet potencialisht zhvillohet: Sektori i biznesit, i organizatave jofitimprurëse, qeveritar, institucionet e arsimit të lartë si dhe statistikën lidhur me fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për këtë aktivitet. Metodologjia e ndjekur bazohet në Rregulloret e KE për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave për Shkencën dhe Teknologjinë, si dhe në Manualin e Frascat-it 2015. INSTAT gjatë vitit 2021 grumbulloi nëpërmjet vërtetimit të dhënat për të katër sektorët dhe të dhëna administrative për Statistikat GBARD. Të dhënat e grumbulluara janë në fazën e përpunimit.

Statistikat mbi Teknologjinë përfshijnë treguesit statistikorë mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) nga ndërmarrjet. Treguesit statistikorë të përdorimit të TIK në ndërmarrje përfshijnë vërtetimin vjetor në ndërmarrje me 10 dhe me shumë të punësuar.

Grumbullimi i të dhënave realizohet me metodën CAPI, nëpërmjet intervistës ballë për ballë me tabletë. Metodologjia e ndjekur dhe pyetësori i përdorur është në përputhje me Rregulloret e KE. Statistikat e përdorimit të TIK në ndërmarrje prodhohen nga viti 2015 e në vazhdim dhe prej vitit 2021, prodhohen dhe publikohen në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në rregullore. Treguesit statistikorë për këtë nënfushë publikohen në nivel kombëtar sipas aktiviteteve ekonomike të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2) dhe madhësisë së ndërmarrjes. Gjatë vitit 2021, në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar dy publikime vjetore; i fundit korrespondon me vitin 2021.

Statistikat e Inovacionit përfshijnë vërtetimin dyvjeçar në ndërmarrje ku mbledhet informacion për tre vite referencë. Metodologjia e ndjekur është në përputhje me botimin e katërt të Manualit të Oslos dhe Rregulloret e KE, për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave për Shkencën dhe Teknologjinë. INSTAT prodhon tregues për aktivitetet e Inovacionit në ndërmarrje prej periudhës referuese 2017 – 2019 duke u bazuar në pyetësorin e harmonizuar të BE-së. Për të qënë në përputhje me periudhën referuese të mbledhjes së të dhënave me vendet e BE-së, vërtetimi i fundit u krye nga INSTAT në vitin 2020 për periudhën referuese 2018 – 2020.

Të dhënat u publikuan në qershor 2021. Treguesit statistikorë për këtë nënfushë u publikuan në nivel kombëtar sipas aktiviteteve ekonomike të klasifikuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike Rev.2 (NVE Rev.2) dhe madhësisë së ndërmarrjes. Gjatë vitit 2021, në përmbushje të objektivave të PSZ-së, janë realizuar publikime mujore për statistikën e Transportit dhe sigurisë në rrugë, i fundit korrespondon me muajin tetor 2021.

Mbi Statistikat e Mjedisit, deri në vitin 2019 statistikën mbi “Mbetjet e Ngurta Urbane në Shqipëri” mbështeteshin në të dhëna të mbledhura në terren nëpërmjet anketës vjetore mbi mbetjet urbane pranë subjekteve që ushtronin veprimtarinë e mbledhjes dhe menaxhimit të tyre. Në vitin 2021, INSTAT për mbledhjen e të dhënave mbi mbetjet e ngurta urbane referuar vitit 2020, ka vazhduar me aplikimin e metodës inovative nëpërmjet pyetësorëve elektronikë “online” pranë gjithë bashkive të vendit. Kjo metodë e re do të



mundësojë prodhimin e disa indikatorëve të rinj të disagreguar në nivel qarku dhe në nivel bashkie. Gjatë kësaj periudhe, INSTAT ka vijuar me publikimet vjetore për llogaritë e flukseve të materialeve mjedisore (E — MFA) dhe taksat e mjedisit dhe do të vazhdojë t'i prodhojë ato në baza vjetore. Në kuadër të projektit IPA shumë-përfituese 2017, ka filluar punën për vlerësimin e situatës në lidhje me prodhimin e llogarive të emetimeve në ajër dhe llogarive të tjera mjedisore (EGSS, PEFA, EPEA). Gjatë vitit 2021 INSTAT ka përfunduar punën për ngritjen e sistemit për prodhimin e llogarive të Emetimeve në Ajër, si dhe ka prodhuar të dhënat për vitin 2016.

Për prodhimin e statistikave të blegtorisë, kryhen vrojtime mujore (siç janë therja e bagëtive, të leshtave, të dhirtave dhe derrave në thertore, therja e shpendëve në thertore, grumbullimi dhe përpunimi i qumështit, prodhimi i vezëve). INSTAT, gjithashtu zhvillon edhe vrojtimin vjetor mbi përpunimin e qumështit. Të dhënat mujore janë të disponueshme dhe dërgohen në EUROSTAT për vlerësim, megjithatë ato ende nuk shpërndahen në shkallë vendi pasi informacioni nuk është ende i plotë për këto statistika, pasi mungojnë të dhënat e therjeve jashtë thertoreve si dhe prodhimi i qumështit të lopës në fermë, etj. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021, për anketat mujore në blegtori, INSTAT me synim që të përmirësojë metodologjinë e mbledhjes së të dhënave, ka testuar aplikimin e metodës me tablet (CAPI).

Në lidhje me Statistikat e Peshkimit, në muajin korrik 2021, INSTAT në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (si burimi kryesor i informacionit statistikor), ka realizuar publikimin e këtyre statistikave. Gjithashtu janë dërguar në Eurostat të dhëna të hollësishme në lidhje me statistikën e Peshkimit dhe Akuakulturën si dhe ka përfunduar përgatitja dhe dërgimi në EUROSTAT i “Metadatave lidhur me Statistikat Peshkimit dhe Akuakulturës”.

Lista e fermave e Censit të Bujqësisë 2012 është përdorur si një bazë zgjedhje për Anketën Vjetore të Bujqësisë (AAS). Për shkak të mungesës së burimeve të tjera të të dhënave administrative, baza e zgjedhjes aktualisht përditësohet vetëm nga informacioni i ardhur nga vrojtimet vjetore në bujqësi. Baza e zgjedhjes përditësohet gjithashtu me listën e fermave të reja të hartuara çdo vit nga

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).

Në Shqipëri Vrojtimi Vjetor i Bujqësisë (AAS) përfshin përdorimin e tokës, sipërfaqet e mbjella dhe prodhimi i produkteteve bimore, numrin e bagëtive dhe prodhimin e kafshëve, bilancet, kontributin e punës në bujqësi si dhe shpenzimet. Sa i përket të dhënave të këtij vrojtimi, në kuadër të programit IPA shumë-përfituese 2015 u realizua seria kohore 2013 – 2017 lidhur me statistikën e tokës dhe prodhimit bimor. Në vazhdimësi të punës së kryer, me mbështetjen e IPA shumë-përfituese 2017, është realizuar seria kohore 2013 – 2018 sa i përket statistikave të numrit të krerëve dhe prodhimeve blegtorale. Ndërkohë në kuadër të Projekti IPA shumë-përfitues 2017 po punohet për plotësimin e serive kohore 2018 – 2020 për statistikën e prodhimeve bimore dhe blegtorisë.

Në lidhje me statistikën e çmimeve të produkteve bujqësore, kryhet një vërtetim mujor mbi çmimet e prodhimit. Indekset e çmimeve të prodhimit publikohen çdo vit në nivel kombëtar. Të dhënat mbi çmimet e inputeve bujqësore mblidhen nga vërtetimet tremujore (INPUT1 dhe INPUT2). INSTAT zhvillon një anketë të dedikuar për çmimet e kafshëve për mbarështrim. Të dhënat për çmimet dhe qiratë e tokës bujqësore mblidhen me anë të Vërtetimit Vjetor në Bujqësi.

Në vitin 2022 do të fillojë prodhimi i indeksit të çmimeve të prodhimeve bujqësore me bazë vitin 2020 (2020=100). Gjithashtu nëpërmjet asistencës teknike do të mundësohet prodhimi për herë të parë të indeksit të inputeve të prodhimeve bujqësore. Në vijim, INSTAT do të fillojë dërgimin në EUROSTAT të të dhënave mbi çmimet e prodhimeve bujqësore.

Sektori i llogarive ekonomike në bujqësi harton dhe transmeton Llogaritë Ekonomike në Bujqësi (EAA) vetëm për përdorim të brendshëm. Të dhënat e EAA janë përdorur kryesisht për përpilimin e Llogarive Kombëtare vjetore dhe tremujore, si dhe për përpilimin e llogarive rajonale për bujqësinë. Aktualisht, INSTAT nuk prodhon dhe nuk publikon të gjithë grupin e llogarive dhe treguesve të EAA për publikim. Bazuar në rezultatet e IPA shumë-përfituese 2017, Censit të ardhshëm të bujqësisë dhe misionëve ad-hoc, ngritja e sistemit të llogarive ekonomike në bujqësi planifikohet të përfundojë gjatë vitit 2025.



INSTAT ka planifikuar të kryejë Censin e Bujqësisë. Me qëllim përditësimin e listës së fermave bujqësore, si një bazë zgjedhje për Censin e ardhshëm të Bujqësisë, INSTAT ka përfshirë në Censin e Popullsisë dhe Banesave 2022, një rubrikë të veçantë me pyetje dedikuar Bujqësisë dhe Blegtorisë. Gjithashtu, sipas rekomandimeve të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, INSTAT ka përfunduar dokumentet strategjike të Censit të bujqësisë si dhe planin e aktiviteteve të cilët janë në formë drafti. Arritjet kryesore gjatë vitit 2020 – 2021 janë:

- Përmirësimi metodologjik në aplikimin e vrojtimeve vjetore duke implementuar metodologjinë e mbledhjes së të dhënave online për mbetjet urbane krahas asaj tradicionale në fushën e përdorimit të ujit dhe të lëndës së drurit në industri;

- Dërgimi për herë të parë në EUROSTAT i Metatdatës të Statistikave të Peshkimit;

- Prodhimi për herë të parë të indikatorëve mbi produktet organike në bujqësi;

- Prodhimi i indikatorëve në nivel qarku për statistikën mbi mbetjet e ngurta urbane;

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS) për qëllime statistikore, shërben për përditësimin e vazhdueshëm të zonave të Censit. Gjatë vitit 2020, INSTAT ka kryer kontrollin e cilësisë dhe përditësimin e gjedatbazës së ndërtesave dhe hyrjeve të tyre, të të dhënave të ardhura nga përditësimi në terren i informacionit gjeohapësinor të vitit 2019, në mbështetje të Censit të Popullsisë dhe Banesave. Procesi i përditësimit të gjedatbazës po kryhet përmes një softëre ArcGis duke përdorur një model të dedikuar. Baza e të dhënave gjeohapësinore për qëllime statistikore, e përditësuar dhe e mirëmbajtur, do të shërbejë për mbështetjen e aktiviteteve statistikore (Cense, vrojtime, anketa, etj.), inventarizimin e numrit të ndërtesave dhe karakteristikave të tyre.

4.18.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

INSTAT është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e funksionimit të Sistemit Kombëtar të Statistikave (SKS), i përbërë edhe nga dy agjenci statistikore si Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka e Shqipërisë. Institucionet e tjera publike si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe

Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, etj., dhe institucionet e tyre të varësisë, kontribuojnë në prodhimin e statistikave zyrtare si ofrues të informacionit statistikor dhe të dhënave administrative.

Banka e Shqipërisë, si agjenci statistikore është institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave monetare dhe financiare, dhe llogarive financiare, gjithashtu përgjegjës për prodhimin e statistikave të bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si agjenci statistikore, është përgjegjëse për prodhimin e statistikave financiare të qeverisë. Gjithashtu së bashku me Bankën e Shqipërisë, ajo mbështet dhe furnizon me të dhëna INSTAT-in për hartimin e tabelave input-output në kuadër të EDP.

4.18.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Qëllimi kryesor i INSTAT-it është të përafrtojë më tej legjislacionin e tij me acquis të BE-së në lidhje me standardet statistikore evropiane dhe të rrisë rolin e saj si koordinator i Sistemit Kombëtar të Statistikor.

Bazuar në rekomandimet e fundit të BE-së, për vitin 2021 prioritetet e identifikuara janë si më poshtë:

- Të zbatohet Censin e Popullsisë dhe Banesave në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së dhe standardet ndërkombëtare;

- Të finalizohet planin e veprimit dhe buxhetin e parashikuar të detajuar për censin e Bujqësisë të vitit 2024;

- Të zbatohet Ligjin për Statistikat Zyrtare dhe të vazhdojë përmirësimin dhe rolin e tij si Koordinator i Sistemi Statistikor Kombëtar si dhe zgjerimin e numrit të agjencive statistikore.

Prioritete të tjera bazuar në programin e Statistikave Zyrtare 2022 – 2026, në Strategjinë e Zhvillimit të INSTAT, si dhe në rezolutën e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikës për vitin, janë si në vijim:

- Rishikimi i shportës së produkteve bujqësore të përfshira në llogaritë ekonomike në bujqësi dhe ribazimi i Indeksit të Çmimeve në Bujqësi (2020 = 100).

- Fokusimin në nevojat e të dhënave për përpilimin e moduleve të Llogarive Ekonomike në Mjedis. INSTAT do të përqendrohet në zhvillimin e mëtejshëm të moduleve: Llogaritë e



emetimeve në ajër, Llogaritë e flukseve fizike të energjisë, dhe Taksat mjedisore;

- Kryerja e suksesshme e Censit të Bujqësisë;
- Mbështetje e aktiviteteve statistikore me informacion gjeo-hapësinor (cense, vrojtime, anketa, etj.).

- Implementimi i vazhdueshëm i Sistemit Evropian i Llogarive ESA 2010;

- Rritja e llojshmërisë së tabelave të transmetuara në EUROSTAT, në kuadër të Programit të Transmetimit ESA 2010;

- Transmetimi i të dhënave mbi Vdekjet Javore, kërkesë vullnetare nga Eurostat në kuadër të pandemisë globale;

- Fokusimin në nevojat e të dhënave për përpilimin e moduleve të mbetura, INSTAT do të përqendrohet në zhvillimin e mëtejshëm të moduleve: Llogaritë rrjedhëse fizike të energjisë (physical energy flow accounts), produktet dhe shërbimet në sektorin e mjedisit (environmental goods and services sector), llogaritë e shpenzimeve për mbrojtjen e mjedisit (environmental protection expenditure accounts);

- Hartimi i statistikave të bilancit të pagesave me frekuencë mujore;

- Hartimi i llogarive financiare me baza tremujore (stock dhe fluks).

Gjithashtu, INSTAT ka parashikuar përafrimin e disa akteve të BE-së në PKIE 2022 – 2024 të parashikuara nga Kapitullin 18 Statistikat, për harmonizim të mëtejshëm me standardet e BE-së. Aktet e parashikuara në zbatim dhe të rekomandimeve të EU janë si më poshtë:

- Projektligji “Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore”;

- Projektudhëzim “Në mbështetje të implementimit të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare”;

- Projektudhëzim “Për Vrojtimet Statistikore të Qumështit dhe të Nën-Produkteve të tij”;

- Projektudhëzim “Për zbatimin e rregullores për Vrojtimet Statistikore të Qumështit dhe të Nën-Produkteve të tij”;

- Projektvendim “Për zbatimin e Nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteteve”;

- Projektudhëzim “Për Zbatimin e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës”.

Këto akte do të kërkojnë Përkthim të legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, trajnime të

vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit, organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores si dhe tavolina konsultuese me grupet e interesit.

KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

4.19.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull fokusohet në funksionimin e dialogut social, veçanërisht strukturat e përgjithshme ligjore mbi sindikatat dhe organizimet e punëdhënësve, e drejta për të organizuar/bashkuar sindikatat, kontratat kolektive dhe veprimi industrial, e drejta e grevës, mekanizmat trepalësh të konsultimit, duke përfshirë këshillin ekonomik dhe social, dialogun/kontratat, marrëveshjet dypalëshe dhe përfshirjen e partnerëve social në hartimin dhe zbatimin e legjislacionit.⁴¹

4.19.2 Struktura e kapitullit

Lista e nënkapitujve, si më poshtë:

- Ligji i Punës;
- Shëndeti dhe Siguria në Punë;
- Dialogu Social;
- Politikat e Punësimit;
- Fondi Social Evropian;
- Përfshirja Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuar;
- Mbrojtja Sociale;
- Antidiskriminimi dhe Shanset e Barabarta.

4.19.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Detyrimi i përgjithshëm për të përafruar ligjin Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga Neni 70 i MSA-së. E ndarë nga kjo dispozitë, Shqipëria nuk ka vetëm detyrimin për të sjellë teknikisht legjislacionin e saj kombëtar në linjë me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë edhe zbatimin e tij. Sipas Nenit 77 të MSA-së, Shqipëria duhet të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të BE-së në fushat e kushteve të punës, sidomos në shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mundësi të barabarta.

Detyrimet në fushën sociale dhe politikave të punësimit rrjedhin nga Neni 99 mbi “Zhvillimin dhe përmirësimin e Sistemit të Sigurisë Sociale”, Neni 48 “mbi Koordinimin e sistemeve të

⁴¹ Kapitulli 23 “Drejtësia dhe të Drejtat Themelore” mbulojnë lirinë e asamblesë dhe shoqërive nga një perspektive themelore e të drejtave.



Mbrojtjes Sociale për Komunitetin e Qytetarëve Punëtorë në territorin Shqiptar dhe të shtetasve Shqiptarë të punësuarve në vendet e Bashkimit Evropian”.

Nenet 46, 47, 48, 77, 99 të MSA-së përcaktojnë bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, duke synuar në modernizimin dhe ristrukturimin e shërbimeve të punësimit dhe trajnimit profesional, zbatimit të programeve të punësimit aktiv dhe pasiv dhe mbështetjen e përafrimit gradual të legjislacionit Shqiptar dhe praktikave në fushën e tregut të punës dhe trajnimit profesional me rregullat dhe standardet e Unionit.

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standarde minimale për ligjin e punës, barazinë gjinore, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mos diskriminimin. Në bazë të Nenit 153 të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Evropian (TFBE), Unioni mbështet dhe plotëson aktivitetet e Vendeve Anëtare në fushën e politikave sociale. Fondi Social Evropian është mjeti kryesor financiar përmes të cilit BE mbështet zbatimin e strategjisë së saj të punësimit dhe kontribuon në përpjekjet e përfshirjes sociale (rregullat e zbatimit janë të përfshira në Kapitullin 22, i cili merret me të gjitha instrumentet strukturorë).

Në fushën e aftësive të kufizuara, BE-ja është pjesë e Kuvendit për të Drejtat e Personave me Aftësi Ndryshe të Kombeve të Bashkuara dhe ka përshtatur një strategji që synon integrimin, përhapjen e çështjeve të aftësive të kufizuara me politikën e përshtatshme të Unionit dhe rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrjes e njerëzve me aftësi ndryshe, njëloj si të tjerët.

Marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura me punësimin, punën dhe çështjet sociale, siç është Kuvendi i ONP dhe Kuvendi i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, duhet të merren në konsideratë.

4.19.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në fushën e politikave sociale dhe punësimit. Disa përpertime janë bërë në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës.

Shqipëria ka vijuar ristrukturimin e sistemit të qeverisjes së punësimit, siç parashikohet në ligjin e ri për arsimin dhe formimin profesional (AFP).

Reforma e shërbimeve sociale po përparon, duke synuar rritjen financiare dhe administrative, për të forcuar nivelin lokal.

Disa përpertime u bënë në zbatimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm, veçanërisht në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe në përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të institucioneve dhe shërbimeve të tregut të punës. Shqipëria ka vazhduar ristrukturimin e sistemit të saj të qeverisjes së punësimit, në përputhje me ligjet për arsimin dhe aftësimin profesional dhe promovimin e punësimit.

Sa i përket **legjislacionit të punës**, Kodi i Punës i ndryshuar është duke u zbatuar. Me qëllim përmirësimin e monitorimit të zbatimit të legjislacionit të punës dhe mbledhjes së të dhënave të inspektimit nga ISHPSHSH është zhvilluar një platformë e quajtur “Matrica”. Ky shërbim është projektuar për vendosjen e standardeve në marrëdhëniet me biznesin dhe shërben si një mundësi testimi për çdo subjekt, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të punës, duke krijuar mundësinë e vetëkorrigjimit. Gjithashtu “Matrica” shërben edhe për standardizimin e punës së inspektoreve të punës në çdo vendimarrje dhe kjo pasi:

- Rrit inteligjencën profesionale të inspektorëve të punës, siguron transparencë në vendimarrjen e tij dhe minimizon abuzimin me detyrën.

- Synon trajtimin e barabartë, për mos respektimin e të njëjtës dispozite ligjore, në kushte të barabarta

Nëpërmjet përpunimit të të dhënave të inspektimit të marra nga “Matrica” orientojmë inspektimin në baze të nivelit të riskut të subjekteve.

Me qëllim monitorimin e punës së fëmijëve, është hartuar një udhëzues praktik për inspektorët e punës në identifikimin dhe kontrollimin e formave të punës së fëmijëve dhe reagimin e duhur. Ky udhëzim i veçantë do të forcojë rolin e inspektorëve të punës në identifikimin dhe referimin e punës së paligjshme të fëmijëve.

Me VKM Nr. 479, datë 17.6.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 15.2.2017 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë”, e cila u miratua dhe hyri në fuqi me botimin në Gazeta Zyrtare e datës 22.06.2020, është shtuar detyrimi i inspektorëve të



punës për të zbatuar këtë udhëzues praktik si shtojca II e cila i bashkëlidhet kësaj VKM-je.

Lidhur me **shëndetin dhe sigurinë në punë**, dokumenti i politikës së sigurisë dhe shëndetit në punë 2016 – 2020 dhe plani i tij i veprimit janë në zbatim. Gjatë viteve 2013 – 2017, Shqipëria miratoi ligje që përafrojnë 19 direktiva të BE-së të lidhura me Direktivën Kuadër për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.

Gjate vitit 2019, hyri në fuqi VKM-se Nr. 596 datë 4.09.2019 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në VKM Nr. 639 datë 07.09.2016 “Për rregullat, procedurat dhe llojet e testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës që kryejnë punëmarrësit, si dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”.

Gjatë viteve 2018 – 2019, Shqipëria u përqendrua në zbatimin efektiv të instrumenteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Aksidentet në punë hetohen nga ISHPSHSH-ja dhe ndahen sipas llojit të aktivitetit. Në këtë kontekst, për vitin 2019 rezulton se sipas degëve rajonale numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë, Durrës, Dibër dhe Lezhë.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i rasteve të hetimit të aksidenteve në punë, rezulton në sektorin e ndërtimit i cili zë 24.8% të totalit të inspektimeve për aksident në punë, duke vijuar me “ndërmarrjet prodhuese” të cilat zënë 24.3% të totalit të inspektimeve për aksident në punë. Punëmarrësit e aksidentuar në sektorin e ndërtimit zënë 25.5% të punëmarrësve të aksidentuar në punë gjatë vitit 2019.

Situata e çështjeve të sigurisë dhe të shëndetit në punë ka marrë vëmendje të shtuar nga vetë subjektet. Si rezultat i pasojave të mos deklarimit të aksidenteve, parashikuar në ligjin përkatës, vërehet ndërgjegjësim i rritur për deklarim të aksidenteve në punë nga punëdhënësi. Janë krijuar lehtësira për marrjen e informacionit të shtuar dhe të kryerjes së këtij raportimi, nëpërmjet faqes zyrtare, duke mundësuar deklarim të aksidenteve në çdo ditë dhe orë të javës, përfshirë ditët e pushimit javor apo ditët e festave zyrtare.

Përveç aksidenteve të njoftuara nga vetë punëdhënësit ashtu siç ligji e parashikon, gjatë vitit 2019 ka pasur të regjistruara edhe aksidente nga burime të tjera e konkretisht nga organet e Prokurorisë, media, ankesa të vetë punëmarrësve të

aksidentuar të ardhura drejtpërdrejtë pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës apo nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes.

Me qëllim përmirësimit e ndërgjegjësimin publik dhe promovimin e politikave të SSHP-së, në kuadër të Fushatës Evropiane 2 vjeçare 2018 – 2019, e udhëhequr nga EU-OSHA, me temë “Menaxhimi i substancave të Rrezikshme”, janë zhvilluar aktivitete nga ISHPSHSH, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rreziqet e paraqitura nga substanca të rrezikshme në vendin e punës dhe të promovojë një kulturë të parandalimit të rreziqeve, të sistemit të raportimit dhe të investigimit të lëndimeve në punë.

Nuk janë regjistruar raste të fëmijëve të aksidentuar në punë, grave shtatzëna/ gra me fëmijë në gjë apo persona me aftësi të kufizuara, grupe këto që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislacioni i punës.

Nga viti në vit konstatohet rritje e numrit të subjekteve që ndërmarrin masat për krijimin e kushteve të sigurta të punës, e konkretisht për periudhën janar – gusht 2020, vërehet rritje e:

- Numrit të subjekteve që mbulohen me shërbim mjekësor, (konstatohet në 41% të subjekteve të inspektuara);

- Numrit të subjekteve që përdorin pajisje mbrojtëse individuale, (87% të subjekteve të inspektuara);

- Numri i subjekteve që përdorin pajisje mbrojtëse kolektive, (80% të subjekteve të inspektuara);

- Numrit të punëmarrësve që përdorin pajisjeve mbrojtëse kolektive dhe individuale, (70% të punëmarrësve të konstatuar);

- Shërbimit të ndihmës së parë, (76% të subjekteve të inspektuara);

- Shërbimit të mbrojtjes ndaj zjarrit, (75% të subjekteve të inspektuara);

- Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe përfaqësuesve në Këshillat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, (në 41% e subjekteve të inspektuara);

- Ekziston Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut, (në 58 % të subjekteve të inspektuara).

Prioritetet e ISHPSHSH-së në drejtim të krijimit të kushteve të sigurta të punës kanë orientuar edhe planifikimin e inspektimeve në subjektet që paraqesin rrezikshmëri për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve, si dhe zhvillimin e



takimeve ndërgjegjëse me biznesin si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Vërehet një rritje e konsiderueshme e Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, dhe ekzistencës së dokumentit të vlerësimit të riskut, kjo si pasojë e kërkesës së vazhdueshme nga Inspektorati i Punës në këtë drejtim. ISHPSHHSH inkurajon jo vetëm ngritjen e këtyre Këshillave por dhe efektivitetin e tyre. Gjithashtu, kërkon që dokumenti i vlerësimit të riskut të jetë konform legjislacionit në fuqi.

Në lidhje me **dialogun social** në nivel qendror, Këshilli Kombëtar i Punës (KKP)

ka zhvilluar një mbledhje më 16 shkurt 2021.

KKP ka konsultuar një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me:

1. Zbatimin e Ligjit nr. 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

2. Informacion për procedurën e ndjekur për ratifikimin e Konventës 190 “Për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës” të ILO-s.

3. Informacion lidhur me studimin për sfidat në biznesin e vogël dhe të mesëm për të përballuar situatën e Pandemisë si dhe implementimi i projektit “Fuqizimi i grave kundër COVID-19 në sektorin Fason”.

4. Informacion për veprimtarinë e Grupit të Punës për përmirësimin e procedurave të ndërmjetësimit/pajtimin për zgjidhjen e konflikteve kolektive të punës

Më parë, Këshilli Kombëtar të Punës ka zhvilluar online 2 mbledhje në vitin 2020 (12 qershor dhe 16 tetor) ku janë konsultuar çështje të rëndësishme lidhur me situatën e krijuar nga pandemia dhe masat e marra nga Qeveria në sektorin e shëndetësisë, arsimit, turizmit, paga minimale, ratifikimi i konventës 190 të ILO-s “Për dhunën dhe ngacmimin” si dhe raportim nga Inspektorati për zbatimin e legjislacionit të punës në sektorin privat dhe publik.

Në lidhje me kriteret e matshme të përfaqësimit të partnerëve socialë në Këshillin Kombëtar të Punës, Grupi i Punës bazuar në propozimet e partnerëve socialë dhe ekspertizës së ILO, ka hartuar një projektvendim. Projektvendimi u miratua në parim nga Këshilli Kombëtar i Punës.

Kriteret e Përfaqësueshmërisë u miratuan me VKM nr. 54, datë 29.1.2020 nga Këshilli i Ministrave, të cilat do të garantojnë legjitimitetin e KKP-së, ndikimin politik dhe rritjen e besueshmërisë së mendimeve dhe rekomandimeve të këtij Këshilli.

Mekanizmi kryesor për rregullimin e dialogut dypalësh social janë marrëveshjet kolektive të punës. Gjatë viteve 2020 – 2021 janë nënshkruar 20 kontrata kolektive në nivel degë-profesioni, si dhe një numër i madh i kontratave kolektive të nënshkruara në nivel ndërmarrje. Procesi i kontraktimit kolektiv është më i zhvilluar në zonat e mëdha urbane, për shkak të përqendrimit të sipërmarrjeve më të mëdha, veçanërisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë. Në këto fusha partnerët socialë janë më të fortë dhe kanë një shkallë më të lartë bashkëpunimi mes tyre. Organizatat e punonjësve dhe punëdhënësve janë krijuar dhe funksionojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili bazohet në parimin e lirisë së asociimit dhe të së drejtës për t'u organizuar.

Në kuadër të minimizimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve u hartua dhe më pas u miratua nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë Udhëzimi nr. 13, datë 12.5.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave për ndërmjetësimin dhe pajtimin e mosmarrëveshjeve kolektive të punës, si dhe procedurat përkatëse”. Gjithashtu, Rrjeti Shtetëror i Ndërmjetësimit u krijua me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 129, datë 6.7.2021.

Gjatë viteve 2020 – 2021, vëmendje i është kushtuar përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të Rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësimit dhe Zyrave Shtetërore të Pajtimin, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës. Për këtë arsye, në bashkëpunim me ILO, janë zhvilluar disa webinare për trajnimin e ndërmjetësve dhe anëtarëve të 12 Zyrave Shtetërore të Pajtimin. Qendra e Trajnimit të Torinos, ILO ka organizuar një kurs të avancuar për certifikimin e rrjetit Shtetëror të Ndërmjetësve.

Sa i përket politikave të punësimit, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (NESS) 2014 – 2020, dhe plani i saj i veprimit, janë rishikuar dhe kohëzgjatja e tyre është shtyrë deri në vitin 2022 (siç është miratuar me VKM në tetor 2019). Rishikimi i Strategjisë u bë pas Raportit të Vlerësimit Afatmesëm që përfshin periudhën 2014 – 2018. Raporti vlerësoi se të katër prioritetet



strategjike janë akoma relevante. Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019 – 2022 dhe planit të saj të veprimit është të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës. Plan i veprimit përqendrohet në rritjen e mundësive për punë të denjë përmes politikave efikase të tregut të punës, sigurimit të arsimit dhe aftësimin cilësor të të rinjve dhe të rriturve, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, dhe forcimin e sistemit të qeverisjes së tregut të punës dhe kualifikimeve. Strategjia rishikoi indikatorët deri në vitin 2022, sipas një baze të dhënash, në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT. Secila masë do të zbatohet nga mbështetja e parashikuar në MTBP, si dhe nga projektet e donatorëve që janë duke u zbatuar.

Një prej Objektivave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022 është zgjerimi i mbulimit, përfshirjes dhe efektivitetit të shërbimeve të punësimit. Në kuadër të realizimit të këtij objekti, drejtoritë përgjegjëse në AKPA kanë parashikuar realizimin e aktiviteteve për periudhën në vijim.

Këshilli i Ministrave miratoi krijimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) në korrik 2019 (VKM 554/2019). Struktura e propozuar e Agjencisë së re është miratuar dhe në Drejtorinë e Përgjithshme është parashikuar rritje e stafit nga 36 në 90 persona. Plotësimi i stafit ka filluar pas miratimit të kësaj strukture. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, procesi i plotësimit të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKPA nisi gjatë muajit Qershor 2020. Edhe pse është parashikuar që plotësimi i stafit të shtrihet deri në vitin 2022, në fund të vitit 2020 parashikohet të plotësohet 54% e vendeve vakante në Drejtorinë e Përgjithshme. Në fund të muajit Shtator 2020 rezulton se për:

- 15 vende vakante ka përfunduar procesi i plotësimit të tyre;
- 4 vende vakante po zhvillohen konkurset;
- 5 vende vakante janë shpallur dhe janë në fazën e aplikimit nga kandidatët;
- 6 vende vakante janë në pritje për tu shpallur nga DAP.

Pas miratimit të ligjit për nxitjen e punësimit Nr. 15/2019 një pakete e rishikuar dhe programesh për nxitjen e punësimit të reja janë miratuar programesh për nxitjen e punësimit është miratuar. Programet përfshijnë mbështetje të ndryshme për punëkërkuarët e papunë si:

- Punësim i subvencionuar (ku janë përfshirë punëkërkuarët e papunë nga grupet e veçanta si të rinjtë, gratë me fëmijë në ngarkim, PAK, romet emigrante të kthyer me problem ekonomike, përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesës së papunësisë të papunët afatgjatë, viktimat e dhunës etj.

- trajnimin nëpërmjet punës
- praktika profesionale
- pune publike në komunitet
- vetëpunësim
- programet COVID-19

40 zyra punësimi janë organizuar dhe operojnë me modelin e ri të shërbimeve të punësimit. Performanca e politikave të punësimit në tregun e punës është e lidhur ngushtë me punën e stafit, të sistemit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, si dhe me menaxhimin e mirë të buxhetit të tij vjetor. 329 punonjës të zyrës dhe stafit drejtues janë të trajnuar për programet e reja të Nxitjes së punësimit.

Reformimi i Kornizës Ligjore ka dhënë një kontribut domethënës në konsolidimin dhe reformimin e politikave të punësimit dhe aftësive në Shqipëri, të cilat janë detajuar në Planin e rishikuar të Veprimit 2019 – 2022, të ndërtuar në bazë të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019 – 2022.

Karta e performancës si një mjet monitorimi i cilësisë së shërbimeve, përcakton arritjet vjetore të indikatorëve më të rëndësishëm që masin nivelin e shërbimit të Zyrës së Punës ndaj klientëve të saj: punëkërkuarët dhe punëdhënësit. Treguesit kryesor të performancës si punësimet, përfshirja në programet aktive të tregut të punës, numri i VLP-ve të shpallura dhe rritja e numrit të punëdhënëseve klientë të Zyrës së Punës, detajohen edhe në tregues të tjerë që i referohen prioritizimit të grupeve vulnerabel në zbatim të treguesve të strategjive përkatëse dhe indikatorë të tjerë strategjik.

Përcaktimi i objektivave bazohet në karakteristikat e regjistrimit të punëkërkuarëve dhe punëdhënëseve, ecurisë së treguesve të



monitorueshëm të periudhave të mëparshme, objektivat në lidhje me secilin grup vulnerabël të përcaktuar në strategjitë e tyre dhe indikatorë të tjerë strategjik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për herë të parë në vitin 2019 SHKP, nën mbështetjen e GIZ, nis të zbatojë në të gjitha Qendrat e Formimit Profesional paketën Start Smart për zhvillimin e aftësive të buta të punëkërkuësve të papunë, të cilat pritet të ndikojnë në zhvillimin e aftësive të punësueshmërisë.

Sa më sipër u bë planifikimi dhe shpërndarja e targetit për çdo ZP dhe QFP duke u fokusuar në Pu.Pa-të e nivelit të parë dhe të dytë të punësueshmërisë, kryesisht të atyre që orientoheshin për të ndjekur një kurs formimi profesional.

Gjithashtu, për realizimin e objektivit u realizua trajnimi i stafit dhe u siguruan ambjentet dhe pajisjet informatike.

Gjatë vitit 2019 dhe 2020 në kurset Start Smart morën pjesë 13,834 punëkërkuës të papunë në shkallë vendi.

U hartua dhe miratua në muajin maj 2019 manuali për sistemin e referimit dhe administrimit të kursit Start Smart, i cili përbëhet nga dy pjesë, përkatësisht:

- ZP (sistemi i referimit)
- QFP (sistemi i dokumentimit)

Ky manual standardizoi procesin dhe rregulloi marrëdhënien QFP- ZP. Me mbështetjen e GIZ u realizua një trajnim me qëllim administrimin e procesit nga QFP-të.

Marrëveshja midis AKPA-s dhe Shërbimit Social Shtetëror të nënshkruar për ri-integrimin në tregun e punës të përfituesve aktualë dhe ish të ndihmës në para, dha si rezultat:

Viti 2018:

- Punësimin e 1,705 përfituesve të mëparshëm dhe 2,253 përfituesve;
- Pjesëmarrjen e 435 përfituesve të mëparshëm dhe 356 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrjen e 327 përfituesve të mëparshëm dhe 394 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Viti 2019:

- Punësimin e 1,168 përfituesve të mëparshëm dhe 1,875 përfituesve;

- Pjesëmarrjen e 403 përfituesve të mëparshëm dhe 311 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;

- Pjesëmarrjen e 92 përfituesve të mëparshëm dhe 361 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Viti 2020:

- Punësimin e 205 përfituesve të mëparshëm dhe 904 përfituesve;

- Pjesëmarrjen e 15 përfituesve të mëparshëm dhe 39 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;

- Pjesëmarrjen e 14 përfituesve të mëparshëm dhe 54 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Gjatë vitit 2019 SHKP ka ndërmarre nismën për nënshkrimin e marrëveshjeve me Njësitë e Qeverisjes Vendore në kuadër të forcimit dhe bashkërendimit të politikave të punësimit në nivel rajonal dhe vendor.

Këto marrëveshje konsistojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje dypalëshe me qëllim shërbimin e institucionalizuar dhe ndihmën ndaj punëkërkuësve për një jetë më të mirë dhe dinjitoze, si dhe në koordinimin e përpjekjeve institucionale në nivel vendor dhe rajonal nën objektivin kryesor të uljes së nivelit të papunësisë në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore dhe adresimin sa më efektiv të problematikave sociale me të cilat përballen individët.

Për sa më lart, gjatë vitit 2019 janë realizuar 4 marrëveshje bashkëpunimi; përkatësisht, a) me Bashkinë Maliq, b) Bashkinë Korçë, c) Bashkinë Fier dhe ç) Bashkinë Delvinë.

Në kuadër të **Fondit Social Evropian** nuk ka pasur zhvillime.

Në nënfushën mbi **Përfshirjen Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuar**,

Matja e treguesve të përfshirjes sociale në kuadrin e zhvillimit dhe uljes së varfërisë është prioritet, duke marrë në konsideratë rëndësinë e të dhënave dhe treguesve për politikëbërjen. Në këtë fushë ka një proces ndërveprues ndërmjet MSHMS dhe ministrive të linjës për të mbledhur të dhëna statistikore për përfshirjen sociale. Është hartuar raporti i monitorimit të Dokumentit të Përfshirjes Sociale 2016 – 2020, dokumenti paraparak për përfshirjen sociale, me rekomandime për MSHMS, INSTAT dhe aktotrë të tjerë të rëndësishëm për përfshirjen sociale.



Politikat dhe strategjitë e Qeverisë së Shqipërisë për përfshirjen sociale të Personave me Aftësi të Kufizuara janë në përputhje me objektivat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Strategjisë Evropiane të Aftësisë së Kufizuar 2021 – 2030. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar 2021 – 2025, i cili është miratuar nga Qeveria me VKM Nr. 276, Datë 12/05/2021.

Plani i Veprimit është hartuar në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe në konsultime të gjera me partnerët dhe shoqërinë civile. Në këtë proces, dokumenti u konsultua edhe me Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar si dhe me Grupin e Monitorimit Ndërinstitucional të Politikave -IPMG në shkurt 2021.

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021 – 2025, aksesueshmëria është një synim kryesor i politikës i shoqëruar me masa ndërsektoriale. Nga vlerësimi i Planit Kombëtar 2016 – 2020, rezultoi se legjislacioni për aksesueshmërinë duhet të forcohet dhe duhet të vendosen mekanizma për monitorimin dhe zbatimin e standardeve. MSHMS ka kryer një Analizë të Legjislacionit me boshllëqet dhe çështjet e zbatimit, si dhe ia ka dorëzuar ministrive të linjës për shqyrtim, duke theksuar nevojën për analizën e situatës legislative për secilën fushë.

MSHMS ka përmirësuar situatën e qendrave shëndetësore duke përmirësuar shumë standardet e aksesueshmërisë në ndërtesa në 28 qendra shëndetësore, gjatë vitit 2021 në Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë.

Gjithashtu janë përmirësuar standardet e aksesueshmërisë fizike në shkollat e restauruara pas tërmetit nga programi “EU4Schools”, zbatuar nga PNUD në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare. Kjo është shtrirë në njëmbëdhjetë bashkitë e prekura, konkretisht: Krujë, Durrës, Kurbin, Kamëz, Kavajë, Tiranë, Mirditë, Lezhë, Rrogozhinë, Shijak, Vorë.

MSHMS po bashkëpunon me ADISA “Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara në Shqipëri” për të ofruar shërbime për Personat me Aftësi të Kufizuara në Qendrat e Shërbimeve të Integruara ADISA.

Në harkun kohor 2021 – 2025 të gjitha institucionet janë angazhuar për masat për aksesueshmërinë në ndërtim, infrastrukturë, transport, komunikim dhe aksesueshmërinë e informacionit në të gjitha sferat, arsim, punësim, shërbime, turizëm. Megjithatë, duhet të alokohen fonde në mënyrë specifike për masat mbi aksesueshmërinë, veçanërisht aksesin në informacion. Njësitë vendore ende nuk planifikojnë apo buxheton aksesueshmërinë në planet e zhvillimit social-ekonomik.

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar përmirëson cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara. Reforma zgjeron rrjetin e integritetit të shërbimeve sociale, nëpërmjet punësimit dhe formimit profesional, në bashkëpunim me pushtetin vendor. Krahas këtyre objektivave, Mbulimi Universal Shëndetësor mbetet një angazhim i Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet promovimit të një jetese të shëndetshme, koordinimit të përpjekjeve dhe rritjes së investimeve në të gjithë sektorët që lidhen me shëndetin. Kjo reformë është në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Standardet Ndërkombëtare të OBSH-së dhe Klasifikimin Ndërkombëtar të Funksioneve (ICF). Dokumenti i politikave dhe Plani i Veprimit të Reformës së Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar (VKM nr. 380, datë 5.6.2019) është në zbatim për shtrirjen progresive të reformës. Aktualisht reforma po zbatohet në qarkun e Tiranës me 6 komisione multidisiplinare. Vlerësimi bio-psiko-social është zbatuar në Durrës duke vazhduar në Elbasan.

Shërbimet e Kujdesit Social të ofruara për personat me aftësi të kufizuara, për vitin 2021, të mbështetura nga Fondi Social u krijuan në Tiranë, Librazhd, Lushnjë, Lezhë, Kavajë. Mbështetja e përgjithshme në vitin 2021 është 26,131,622 lekë.

Janë miratuar masa ligjore që trajtojnë situatën e personave me vështirësi në dëgjim. Me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar” i cili jep një përkufizim ligjor të rolit të përkthyesit të gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë. Zbatimi i ligjit nr. 111 datë 14.12.2017 “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike” parashikon ndihmë juridike falas për grupet vulnerabël, duke synuar veçanërisht personat me aftësi të kufizuara.



Ndihma juridike duhet t'u përshtatet të gjitha kategorive të PAK.

Ka edhe zhvillime në lidhje me legjislacionin për shëndetin mendor. Në këtë drejtim, në vitin 2020, MSHMS ngriti një grup pune për ndryshimin e ligjit nr.44/2012 "Për shëndetin mendor". Ligji nr. 20/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" i ndryshuar, përmirësoi kuadrin ligjor për mbrojtjen ligjore në fushën e çrregullimeve të shëndetit mendor.

Në lidhje me stigmën dhe diskriminimin, kuadri ligjor për mbrojtjen kundër diskriminimit në Shqipëri parashikon ndër të tjera përkufizime për forma të reja të diskriminimit (si diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, segregacioni, ngacmimi seksual, diskriminimi i strukturuar, nxitja dhe ndihma ndaj diskriminimit dhe qëllimi i deklaruar i diskriminimit), duke iu referuar praktikës ndërkombëtare si dhe rrethanave aktuale sociale. Format ekzistuese të diskriminimit, si rasti i "viktimizimit", janë riformuluar gjithashtu (neni 3). Ligji Nr. 93/2014 përfshin gjithashtu dispozitat për diskriminim duke pasur parasysh edhe përshtatjen e arsyeshme.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është fokusuar në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ndikimin në grupet vulnerabël, duke pasur parasysh se në Axhendën 2030, barazia e mundësive dhe mosdiskriminimi janë pjesë e OZHQ-ve. Projekti i PNUD LNB "Askush të mos mbetet pas" ka mbështetur hartimin e planeve sociale në bashki. Në këto plane trajtohen disa çështje të rëndësishme për aftësinë e kufizuar, por jo aksesueshmëria. LNBdo të vazhdojë të fokusohet tek personat dhe grupet e cënueshme për të pasur akses të përmirësuar në shërbimet publike që mbështesin përfshirjen dhe mirëqenien e tyre sociale. Është ofruar mbështetje përmes LNB për organizimin e personave me aftësi të kufizuara në forumet e advokimit për akses në shërbime publike cilësore dhe informacion për personat që nuk dëgjojnë mbi të drejtat e tyre.

Ligji Nr.15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit", në dispozitat e tij ka parashikuar krijimin e një Fondi Social të Punësimit, i cili do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin në punë, formimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbimet mbështetëse, rindërtimi dhe vendosja në punë e

personave me aftësi të kufizuara. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2019 – 2022 dhe plani i saj i veprimit parashikojnë masa për punësimin dhe formimin profesional të grupeve vulnerabël nëpërmjet profilizimit më të mirë të fuqisë punëtore dhe planeve individuale të punësimit. Programet e reja dhe të rishikuara të Nxitjes së Punësimit, duke përfshirë ato për situatën COVID-19, për një përgjigje më të mirë ndaj nevojave të punëkërkuësve të papunë, veçanërisht atyre më të rrezikuar, në bashkëpunim me AKSHP, Shërbimin Social Shtetëror dhe autoritetet vendore. Pavarësisht nga pandemia COVID, 697 punëkërkuës të papunë me aftësi të kufizuara u regjistruan në zyrat e punës deri në prill 2021. Megjithatë punësimi është i ulët. Po ashtu janë 18 persona të punësuar deri në korrik, me ndërmjetësim ose të gjetur punë individualisht. Trajnimi profesional për 58 persona me aftësi të kufizuara është ofruar në periudhën janar – korrik.

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga fushat e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Në vitin shkollor 2020 – 2021, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat jo speciale në arsimin publik u rrit me rreth 64%, krahasuar me vitin shkollor 2014 – 2015, duke arritur në 3 575. Në fillim të vitit shkollor 2020 – 2021, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme në arsimin publik ishte 4 672. Aktualisht, vetëm 11.5% e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar në arsimin parauniversitar ndjekin institucionet e arsimit special.

Në sistemin e arsimit parauniversitar publik dhe privat gjatë këtij viti, përfshirë arsimin parashkollor (1 176 në publik) janë punësuar rreth 1 275 mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. Raporti fëmijë me aftësi të kufizuara/ndihmës mësues këtë vit është 3.7. Profili i mësuesit të arsimit special është përcaktuar si një profesion i rregulluar dhe po punohet për t'u dhënë përparësi mësuesve të licencuar në këtë profil si mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me pjesëmarrjen në shoqëri, jetën politike dhe publike, aksesueshmëria është parakusht për të luftuar stigmën dhe diskriminimin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofroi formate të aksesueshme në zgjedhjet e fundit, spote në gjuhën e shenjave dhe asistencë për PAK. Në fushën e kulturës dhe sportit, elementet e aksesueshmërisë janë parakusht për përfshirje. Në këtë aspekt,



projektet pilot kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme për të ndikuar në treguesit e pjesëmarrjes.

COVID-19 dhe Personat me Aftësi të Kufizuara

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të masave të marra për parandalimin dhe kufizimin e përhapjes së epidemisë së COVID-19, vizitat e kufizuara në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit social të familjarëve, miqve dhe të afërmeve të përfituesve, me qëllim parandalimin e infektimit të tyre me COVID-19; Rritja e masave higjieno-sanitare; Kontaktet me njësitë vendore të kujdesit shëndetësor për të monitoruar situatën shëndetësore të përfituesve; Për çdo rast të dyshuar është Protokoll i Miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

MSHMS ka nxjerrë edhe Urdhrin nr. 226, datë 02.04.2020 “Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe aftësi të kufizuara në punë”, por kjo nuk ka ndikuar në pagesat e përfituesve ekzistues, vendimet e të cilëve përfundonin afatin gjatë kësaj periudhe.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u asistua nga UNDP për të hartuar Protokollin për Funksionimin e Qendrave Publike dhe Jopublike, Jo Rezidente, Ofrimin e Shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara, gjatë dhe pas Periudhës së Fatkeqësive Natyrore, deri në përfundim të masave të distancës fizike/sociale për shkak të pandemisë COVID-19, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 381, datë 23.6.2020.

MSHMS ka bashkëpunuar me PNUD-in për identifikimin e zonave të mbështetjes emergjente, duke synuar reduktimin e ndikimit tek grupet më të varfra dhe më vulnerabël. U aktivizur rrjeti i profesionistëve të qendrave të zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara për t'i mbështetur ata shërbime sociale të specializuara online. Shoqatës Kombëtare Shqiptare të të Shurdhërve iu ofrua mbështetje për të ofruar informacion të besueshëm dhe të përditësuar në lidhje me COVID-19 në gjuhën e shenjave për komunitetin me dëmtim të dëgjimit, si dhe për të krijuar dhe mbajtur një linjë telefonike 24 orëshe për informacion / shërbime referimi. për këtë komunitet. Njoftimet ditore për

shtyp nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në kuadër të **mbrojtjes sociale**, zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020 (SKMS), e shtyrë deri në vitin 2023 ka sjellë shndërrimin e skemës së ndihmës ekonomike (NE) në një skemë aktive që mundëson ri-integrimin shoqëror; rishikimin e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjen dhe sigurimin e ri-integrimit të fëmijëve në familje dhe në komunitet, duke siguruar kujdes të veçantë për jetimët social dhe biologjik, dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të integruara të mirëqenies sociale dhe komunitare. SKMS shtjellon gjithashtu nevojën për të krijuar lidhje dhe integrim më të mirë midis politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale dhe politikave të mbrojtjes sociale. Veprimi do të kontribuojë në të tre objektivat dhe do të ketë një fokus të veçantë në objektivin e tretë, që lidhet me decentralizimin lokal dhe zhvillimin e shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror dhe komunitar.

Sa i përket **Antidiskriminimit dhe Shanseve të Barabarta**,

Barazia Gjinore

Nga vlerësimi i “Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2016 – 2020”, përgatitur nga MSHMS në dhjetor 2020 rezulton se në tërësinë e saj kjo Strategji është realizuar në masën 80% duke evidentuar arritje në drejtim të fuqizimit të gruas, avancimit drejt barazisë gjinore dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Në mënyrë specifike, nën Qëllimin Strategjik 1 “Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave” janë evidentuar si arritje sa në vijim:

- Ka rritje të pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në tregun e punës.

- Ka rritje të aksesit të grave dhe burrave në programet e punësimit.

- Hendeku gjinor në paga sipas të dhënave të INSTAT për vitin 2020 është 6.6%. Krahasuar me vitin 2019 ka një rënie me 3.5%. Ka rritje të përfshirjes së vajzave e të rejave në fushat e studimit të lidhura me shkencën dhe inovacionin.

- Evidentohet një reduktim me rreth 8% i punës së papaguar të grave.

- Ka përmirësime ligjore, për të drejtat pronësore mbi tokën bujqësore.



- **Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 – 2030 me VKM Nr.400/30.06.2021**⁴². Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë strategji ndërthuren apo lidhen dhe me masat dhe veprimet e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020 – 2025 të Bashkimit Evropian, të specifikuar më tej në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021 – 2025. Në tërësinë e saj “SKBGJ 2021 – 2030” përbëhet nga katër qëllime strategjike kryesore, ku zënë vend edhe objektiva specifike që reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të barazisë gjinore, bazuar dhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me emergjencat civile, fatkeqësitë natyrore apo fushat e reja deri tani të pa adresuara apo shumë pak të adresuara në lidhje me barazinë gjinore (mjedisi dhe ndryshimet klimatike, dixhitalizimi, etj.).

- **Në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi për personat LGBTI** – Në fund të majit 2021, u lançua Raporti i Vlerësimit mbi Planin Kombëtar të Veprimit për LGBTI në Shqipëri, 2016 – 2020 i cili u përgatit në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me mbështetjen dhe ekspertizën teknike të ofruar nga Këshilli i Evropës. Raporti i plotë në faqen web: <https://rm.coe.int/raport-vleresimi-al-en-1-/1680a3977f>.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgatitur Planin Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI + 2021 – 2027, në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht ato të vetë personave LGBTI + ose me fokusin kryesor në këtë grup të synuar, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazinë dhe mosdiskriminimin në Shqipëri. “PKV LGBTI+ 2021 – 2027” është i treti plan veprimi në nivel kombëtar me fokus mbrojtjen e të drejtave, ofrimin e shërbimeve cilësore, rritjen e ndërgjegjësisë dhe zvogëlimin e nivelit të papranueshmërisë së shoqërisë kundrejt

personave LGBTI+ në Shqipëri. Si i tillë ky PKV reflekton përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që Qeveria e Shqipërisë i kushton krijimit të një shoqërie në themel të së cilës qëndron e drejta, merita dhe vlerat qytetare, sociale e profesionale e çdo individ, si dhe qeverisjes në mënyrë të përgjegjshme, efikase, transparente, në interes të zhvillimit të vendit, duke luftuar korrupsionin, pabarazinë përpara ligjit, pandëshkueshmërinë apo diskriminimet e çdo lloji qofshin.

FËMIJËT

Në mbledhjen e Këshillit të Ministrave datë 03.11.2021, u miratua Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026, e cila ka natyrë ndërsektoriale që përfshin qëllime, objektiva dhe masa, të cilat kanë si synim:

a) Të ndikojnë në jetën e fëmijëve, përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimeve në të gjitha nivelet;

b) Të promovojnë një kulturë të të drejtave të fëmijëve dhe të hedhë bazat për pjesëmarrje kuptimplote të fëmijëve në Shqipëri;

c) Të mundësojnë mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës;

ç) Të sigurojnë të dhëna cilësore në funksion të përmirësimit të politikave dhe programeve të hartuara për ta;

d) Të realizojnë edukimin në funksion të mbrojtjes së fëmijëve online, duke garantuar kështu mirëqenien dhe një të ardhme më të mirë për fëmijët.

Me Ligjin nr. 124/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, u miratuan me 15 tetor 2020 ndryshimet ligjore në Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi me 18 nëntor 2020. Këto ndryshime ligjore përmirësojnë kuadrin ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi në Shqipëri, pasi parashikojnë:

- Shtimi në nenin 1 të ligjit, shkaqet e mbrojtura për të cilat ndalohet diskriminimi, ku diskriminimi është rritur për shkak të shtetësisë, karakteristikave seksuale, të jetuarit me HIV/AIDS dhe pamjes së jashtme.

- Shtimi i formave të reja të diskriminimit (si diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, segregimi, ngacmimi seksual, diskriminimi i strukturuar, nxitja dhe ndihma ndaj diskriminimit dhe qëllimi i deklaruar i diskriminimit), duke iu referuar

⁴² Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.112, datë 15.07.2021.

Shiko: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112>



praktikës ndërkombëtare si dhe aktuale. rrethanat sociale. Janë riformuluar edhe format ekzistuese të diskriminimit, si “viktimizimi”. (Neni 3)

- Parashikohen si dispozitë më vete, forma të rënda diskriminimi, të cilat do të konsiderohen të tilla në ato raste kur sjellja diskriminuese është e motivuar nga më shumë se një shkak, është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një kohë të gjatë, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën. Në raste të tilla ligji ka parashikuar dyfishim të sanksioneve. (Neni 3/1 dhe neni 33)

- Theksohet detyrimi i autoriteteve publike për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin në ushtrimin e funksioneve të tyre. (Neni 7, pika 3).

Janë shtuar dhe riformuluar kriteret për t’u zgjedhur si Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku ndër të tjera parashikohet që kandidati të ketë integritet të lartë moral dhe veprimtari të spikatura në komunitet; të ketë diplomë universitare të ciklit të dytë ose diplomë të bashkuar me të, në përputhje me rregullat për unifikimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi; ose të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe ligjore. (Neni 24, shkronjat “a”, “b” dhe “c”).

- Është riformuluar një nga rastet e shkarkimit të Komisionerit, kur konfirmohet fakti i pamundësisë së ushtrimit të detyrës prej më shumë se tre muajsh. (neni 28, germa “b”).

- Janë shtuar dhe ndryshuar disa nga kompetencat që ligji i njeh **Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi**, ku ndër të tjera përmendim kompetencën për shqyrtimin e ankesave nga persona apo grupe personash që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet jo vetëm në Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, por tashmë edhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Si kompetencë është shtuar edhe e drejta e Komisionerit për të monitoruar zbatimin e ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Përcaktohet se Komisioneri ka kompetencën për të shqyrtuar ankesat nga organizatat që kanë një interes legjitim për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë diskriminim ose në emër të tyre për çështje që kanë të bëjnë me interesin kolektiv. Vlen të theksohet si arritje, rritja në ligjin e

Komisionerit për të ngritur padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesat kolektive, si dhe e drejta për të inicuar Kushtetutën. Gjykata, kur gjatë veprimtarisë së saj konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve. (neni 32)

- Është ritheksuar detyrimi i të gjitha institucioneve publike dhe subjekteve private për të mbështetur Komisionerin, duke ofruar informacionin që i nevojitet dhe duke garantuar aksesin në informacion në kryerjen e detyrave të tij, në përputhje me legjislacionin që rregullon të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. (neni 32)

- Për të motivuar rritjen e numrit të ankesave lidhur me individë të komunitetit LGBTI por edhe të ankesave lidhur me denoncimin e rasteve të ngacmimeve seksuale në vendin e punës, dispozita u shfuqizua me ligjin e mëparshëm që sanksiononte që Komisioneri nuk merr parasysh ankesat anonime, që do të thotë se tani rastet e cituara më sipër mund të paraqesin ankesa anonime. (neni 33)

- Është zgjeruar mundësia e subjekteve ankuese për t’iu drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi me ndryshimet e reja është rritur afati kohor nga një në dy vjet, brenda të cilit pala ankuese mund të bëjë ankimin. (neni 33).

- Ndryshimet e reja ligjore mundësojnë detyrimin e medias kombëtare të publikojë vendimet e Komisionerit që kanë konstatuar diskriminim përmes gjuhës së urrejtjes. Vendosja e një detyrimi të tillë do të mundësonte efektivitet më të madh.

- Procedura e ekzekutimit të gjobave dhe vendimeve të Komisionerit është shtuar si dispozitë më vete, sipas së cilës vendimet e gjobave të Komisionerit, të pa ankimuara brenda afatit të parashikuar në ligj, bëhen titull ekzekutiv dhe ekzekutohen në mënyrë të detyrueshme nga zyra përmbartimore, me kërkesë të KMD-së.

Në fushën e **ligjit të punës**, për sa i përket zbatimit, janë ndërmarrë hapa pozitivë për promovimin e ndryshimeve të Kodit të Punës. Janë zhvilluar aktivitete trepalëshe (punëdhënës, punëmarrës dhe punonjësit e administratës së punës) me qëllim njohjen me risitë dhe ndryshimet e dispozitave të tij. Gjithashtu, është hartuar



Komentari i Kodit të Punës i cili do t'i shërbejë Administratës së Punës, që ka në fushën e saj të përgjegjësisë zbatimin e legjislacionit të punës. Promovimi i komentarit të Kodit të Punës është bërë në disa qytete si Tiranë, Korçë, Vlorë dhe Shkodër.

Sa i përket **shëndetit dhe sigurisë në punë**, me synim përafrimin e legjislacionit shqiptar mbi sigurinë dhe shëndetin në punë me atë të acquis të BE-së, nga masat ligjore të parashikura në PKIE 2019 – 2021 janë miratuar dy dhe e treta është në proces sipas afateve të paracaktuara.

Lidhur me **dialogun social**, me synim përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe zgjidhjes miqësore të konflikteve në punë, është krijuar Rrjeti Shtetëror i Ndërmjetësimit si dhe janë ngritur Zyrat Shtetërore të Pajtitimit (Zyra Kombëtare e Pajtitimit dhe Zyra e Pajtitimit në 12 qarqe) me qëllim funksionimin e tyre për zgjidhjen e konflikteve kolektive ndërmjet palëve, sipas parashikimeve ligjore për trajtimin në kohë të tyre.

Dakortësimi i kriterëve të përfaqësueshmërisë nga partnerët social dhe harmonizimi i nivelit të përfaqësueshmërisë në Këshillin Kombëtar të Punës me qëllim maksimizimin e impaktit të veprimtarisë së saj, u realizua me miratimin e VKM nr. 54, datë 29.1.2020 nga Këshilli i Ministrave.

Në zbatim të urdhrave të Ministrave të Financave dhe Ekonomisë është krijuar një Grup Punë I përbërë nga Përfaqësues të MFE dhe Partneret Social për përmirësimin e procedurave të ndërmjetësimit/pajtitimit për zgjidhjen e konflikteve kolektive të punës. Në bashkëpunim me ekspertin e ILO-s dhe ekspertin kombëtar u hartua dhe u miratua Udhëzimi I Ministrave nr.13, datë 12.5.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave për ndërmjetësimin dhe pajtimin e konflikteve kolektive të punës, si dhe procedurat përkatëse”.

Për nënfushën e **politikave të punësimit**, miratimi i ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” në Mars 2019, plotësoi kornizën ligjore që lidhet me politikën/programet e punësimit dhe zhvillimin e aftësive. Kjo ka krijuar hapësirë të bollshme për zhvillimet si më poshtë:

- diversifikimin e programeve të nxitjes së punësimit dhe shërbimeve të punësimit të miratuara gjatë vitit 2020 4 VKM me 7 programe duke përfshirë dhe programe për nxitjen e punësimit të personave të dale të papunë si pasojë e COVID-19;

- ofruesit e punësimit dhe arsimit profesional dhe formimit janë tashmë nën menaxhimin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA);

Lidhur me **përfshirjen sociale dhe personat me aftësi të kufizuara**, MSHMS ka monitoruar treguesit socialë për grupet e cenueshme me qasje në punësim, arsim profesional; mbrojtja sociale; arsimi; shërbime shëndetësore; banesa sociale; ndihma juridike.

MSHMS ka koordinuar për miratimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, VKM Nr.276, Datë 12.05/2021 duke marrë masa të reja dhe parashikim buxheti.

Sa i përket **mbrojtjes sociale**, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale u rishikua dhe u zgjat deri në vitin 2023, duke ruajtur të njëjtat politika dhe synime. Me miratimin e Ligjit Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, u shmangën procedurat burokratike gjatë procesit të vendimmarrjes duke hequr rolin e Këshillit Bashkiak, i cili nuk ka më autoritet për të miratuar listat e përfituesve të skemës së Ndhmës Ekonomike, pasi ato janë deklaruar të pranueshme në bazë të formulës dhe vendimi është marrë nga Shërbimi Social Shtetëror.

U miratuan procedura të reja kontrolli, duke krijuar një sistem monitorimi transparent dhe efikas përmes sigurimit të moduleve të reja në SMI që përbëhen nga profili i riskut, menaxhimi i rastit, menaxhimi më i mirë i pagesave direkt të familjeve dhe monitorimi i tyre përmes lidhjes me Thesarin, Bankat dhe Zyrat e Postës.

“Strategjia e daljes” dhe plani i saj i veprimit po zbatohet me qëllim promovimin e integritetit në jetën shoqërore të familjeve përmes programeve të nxitjes së punësimit, në mënyrë që kjo skemë të mos përdoret si një mekanizëm përfitimi që mund të çojë në papunësi të zgjatur tek familjet përfituese të ndihmës ekonomike dhe ta shndërrojë atë në një skemë aktive.

Metodologjia e kontrollit të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është miratuar. Staf i strukturave të kontrollit në drejtoritë qendrore dhe rajonale të Shërbimit Social Shtetëror janë trajnuar për përdorimin e metodologjisë së re të kontrollit, me qëllim shmangien e abuzimit në skemën e aftësisë së kufizuar. Pagesat dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar, pagesa për asistentët personal dhe



përfitimet në natyrë janë ristrukturuar dhe janë kombinuar me shërbimet sociale, të shëndetësisë, arsimit, formimit profesional, punësimit, etj.

Janë fuqizuar dhe rritur përmes trajnimeve të vazhdueshme kapacitetet e stafit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të Shërbimit Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal, dhe të strukturave shëndetësore që referojnë rastet dhe stafin e institucioneve që ofrojnë shërbime në qarkun e Tiranës. Gjithashtu, është hartuar korniza e re ligjore për zbatimin e një vlerësimi të aftësisë së kufizuar bio-psiko-sociale në mbarë vendin duke reflektuar kombinimin e përfitimeve të pagesave në para me shërbime të integruara. Skema e re e vlerësimit të aftësisë së kufizuar po aplikohet në qarkun Tiranë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka filluar të bëjë funksionale Fondin Social duke i akorduar 14 bashkive mbështetje financiare nga Fondi Social për vitin 2020, për krijimin e 14 shërbimeve të reja, me një fond 61,412,587 ALL, synohet që deri në fund të vitit 2022 të financohen 35 bashki. Prioritet do kenë ato bashki, në të cilat nuk ofrohet asnjë shërbim shoqëror. Ndërsa për bashkitë në të cilat rezulton se mundësia e përdorimit të shërbimeve është tepër e kufizuar, për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm, duhet të shihet mundësia e harmonizimit dhe e plotësimit të nevojës në bashkitë më të afërta.

Aktualisht, rreth 40 bashki janë mbështetur nga UNICEF, UNDP dhe World Vision për të zhvilluar dhe hartuar planet sociale të kujdesit shoqëror të cilat janë bazat për ndërtimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Stafi i shërbimeve sociale në 19 bashki janë trajnuar për përdorimin e MIS (Regjistri Elektronik) për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe trajnim, i cili vazhdon në vitin 2020 me mbështetjen e UNICEF

Në kuadër të procesit të De-Institucionalizimit, ka filluar ka filluar zbatimi Planit Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2020, miratuar më VKM 706/2020.

Plani i veprimit ka ndërthur politika dhe programe specifike, për të reduktuar institucionalizimin e fëmijëve, duke transformuar shërbimet e ofruara në institucionet rezidenciale, në shërbime multidisiplinare me bazë komunitare, të cilat ofrojnë përkujdesje alternative dhe të

specializuar, duke ofruar mundësi për jetesë më të mirë dhe të pavarur.

Zhvillimet ligjore për periudhën aktuale në fushën e sigurimeve shoqërore janë paraqitur si më poshtë vijon:

Gjatë vitit **2020** janë miratuar ligjet e mëposhtme:

- Ligj nr. 65/2020, datë 21.05.2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

- Ligj nr. 156/2020, datë 17.12.2020 “Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore, të krijuara si diferencë nga rishqyrtimi i pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bazuar në kriteret e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 24.11.2016”;

- Ligj nr. 165/2020, datë 23.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

- Ligj nr. 166/2020, datë 23.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

- Ligj nr. 167/2020, datë 23.12.2020 “Për faljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, që ish-punonjësit e nëntokës kanë ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të llogaritura për periudhën që kanë përfutur, sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët njëkohësisht kanë zhvilluar aktivitet ekonomik si të punësuar ose vetëpunësuar”;

- Ligj nr. 169/2020, datë 23.12.2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”;

- Akt normativ i KM nr. 33, datë 11.12.2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Gjatë vitit **2020** janë miratuar VKM të mëposhtme:



- VKM nr. 262, datë 30.03.2020 “Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve”;

- VKM nr. 263, datë 30.03.2020 “Për indeksimin e pensioneve”;

- VKM nr. 447, datë 3.06.2020 “Për emërtimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës”;

- VKM nr. 448, datë 3.06.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”;

- VKM nr. 720, datë 16.09.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar”;

- VKM nr. 1042, datë 18.12.2020 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2020”.

Gjatë vitit 2021 janë miratuar VKM të mëposhtme:

- VKM nr. 196, datë 31.3.2021 “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”;

- VKM nr. 432, datë 15.07.2021 “Për miratimin e listës së ish-kooperativave bujqësore për të cilat nuk disponohet dokumentacioni i vjetërsisë në punë”.

Si dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Udhëzim i Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 6, datë 6.4.2021 “Për zbatimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021 “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së Vlerësuar”

Në nënfushën e **Antidiskriminimit dhe Shanseve të Barabarta**

Kapacitetet e strukturave të barazisë gjinore janë fuqizuar. Është rritur roli i Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore nëpërmjet miratimit të shumë dokumenteve të rëndësishme dhe çështjeve të trajtuara gjatë mbledhjeve të organizuara lidhur me situatën e barazisë gjinore në vend.

Nëpunësit gjinorë janë caktuar në çdo ministri dhe bashki. Aktualisht në 11 ministri janë emëruar nëpunësit gjinorë, si dhe në Policinë e Shtetit e INSTAT kemi pikë kontakti. Në nivel vendor, në 59 bashki janë të emëruar nëpunësit gjinorë (nga 61 bashki në total), të cilët në shumicën e rasteve luajnë dhe rolin e koordinatorit vendor. Për koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, në janar 2020 u hartuan përshtatjet e reja të tyre të punës të cilat u përshtatën edhe me ndryshimet e fundit të Ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Janë ngritur kapacitetet e tyre për çështjet e buxhetimit gjinor; ndryshimeve që pësoi në korrik të vitit 2018 Ligji 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, njohjes së Rezolutës të KS të Kombeve të Bashkuara 1325 “Gruaja, Paqja, Siguria”; trajnime për sistemin REVALB, trajnime lidhur me Procedurat Standarte të Veprimit dhe Protokollet e miratuara gjatë 2020 për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare

Nëpërmjet zbatimit të VKM për “Integrimin Gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm”, iu është dhënë mundësia për planifikim dhe menaxhim të buxhetit mbi baza gjinore disa sektorëve dhe programeve buxhetore që janë kritike në ofrimin e mbështetjes ekonomike dhe fuqizimit të grave. Me asistencën e UN Women, aktualisht është bërë e mundur që numri i programeve buxhetore që përfshijnë plotësisht ose pjesërisht elementët e buxhetimit të përgjithshëm gjinor në Programet Buxhetore Afatmesme të tyre të rritet gradualisht duke shkuar në 39 të tilla të identifikuar në PBA 2020-2021.

Ngritja e kapaciteteve ka qenë gjithashtu në fokus të punës për dy vitet e fundit ku janë trajnuar nëpunësit gjinorë, përfaqësuesit e ekipit të menaxhimit të programeve, drejtuesit e sektorit të financës dhe buxhetit në ministri si dhe pushtetin vendor lidhur me procesin e përgatitjes së programit buxhetor 2019-2021 dhe përfshirjen në



të të buxhetit të përgjithshëm gjinor. Në nivel qendror janë trajnuar rreth 70 persona dhe në pushtetin vendor rreth 90.

Ka disa arritje pozitive në fushën e legjislacionit, rritjes së kapaciteteve të profesionistëve për çështjet LGBTI dhe fushatave të përvitshme të ndërgjegjësimit, si dhe ka patur përmirësime ligjore në disa ligje duke përfshirë edhe çështjet LGBTI.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar korrik 2020 'Protokollin për Trajtimin e Fëmijëve me Zhvillim Atipik të Gjenitaleve'. Ishte hera e parë që ky lloj Protokollit miratohet dhe pritet të sigurojë mbrojtje për fëmijët ndër-seksualë në Shqipëri, të cilët iu nënshtruan ndërhyrjeve mjekësore të panevojshme dhe të pakthyeshme, u përballën me mjekim të panevojshëm, mungesë të aksesit në informacion dhe paaftësi për marrjen e vendimeve pjesëmarrjen në vendimet që ndikojnë në trupin e tyre.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, ka zhvilluar disa cikle trajnimesh për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve gjinorë në bashki, duke u përqendruar në konceptet drejt orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Gjatë tre cikleve të trajnimit, u trajnuan rreth 45 persona;

- Ndërgjegjësimi i publikut përmes fushatave vjetore nën Diten e Homofobisë synonte të bënte të papranueshëm diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes. Institucionet shtetërore, në bashkëpunim me OJQ-të, Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të mbështetur nga donatorët dhe ambasadat po kryejnë çdo vit aktivitete që kanë marrë vëmendjen e publikut, si dhe mbulimin në media. Në lidhje me fushatën e vitit 2020 duhet të themi se për shkak të situatës së katastrofës natyrore për shkak të pandemisë COVID-19, fushata u organizua on-line. Këtë vit marshimi i Krenarisë së Tiranës u zhvillua nën moton "Bëhu krenar! Ngrini flamurin!" dhe lidhet me Festivalin e 11-të të Diversitetit LGBTI në Shqipëri, një ngjarje kombëtare e Ambasadës PINK Shqipëri. Flamuri LGBTI u vendos gjithashtu në mjediset e Ministrisë si një shenjë e bashkërendimit dhe përpjekjeve të bashkuara dhe më të mira për të mbrojtur të drejtat e personave LGBTI.

- "Strehëza" është qendra e parë rezidenciale në Shqipëri në kuadër të ofrimit të shërbimeve për komunitetin LGBTI. Qëllimi i saj është të ndihmojë këtë komunitet, duke ofruar integritet dhe strehim të sigurt. "Strehëza" ka filluar aktivitetet e saj që nga dhjetori i vitit 2014. Qendra "Strehëza" është një shërbim për të gjithë të rinjtë LGBTI, të cilët përballen me dhunë, diskriminim dhe nevojë për strehim, për shkak të orientimit të tyre seksual dhe identitetit gjinor. Kjo qendër ofron një gamë të plotë shërbimesh dhe funksionon sipas "Standardeve të Shërbimeve të Kujdesit Social" që janë të licencuar që nga viti 2016. "Strehëza" për herë të parë ka filluar të financohet nga Mekanizmi i Fondit Social të sapo hapur në maj 2019, përmes fondeve të buxhetit të shtetit.

4.19.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucioni përgjegjës për kapitullin 19 është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).

Institucione të tjera kontribuuese për Kapitullin 19 janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE),
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHS),
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA),
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH),
- Agjencia Kombëtare për Edukimin, trajnimin Profesional dhe Kualifikimet
- Ministria e Brendshme (AKETK),
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHMDF),
- Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH),
- Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH),
- Ministria e Brendshme (MB);
- Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD),
- Instituti i Statistikave (INSTAT),
- Zyra e Avokatit të Popullit,
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme,
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Në ndihmë të koordinimit të punës së institucioneve përgjegjëse për kapitullin 19 në aspektin financiar dhe për të dhënat statistikore, ka



angazhim të veçantë nga ministria përgjegjëse për fushën e financave (MFE) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT).

Në ndihmë të koordinimit të punës midis institucioneve ndërkombëtare dhe institucioneve përgjegjëse për kapitullin 19 është ngritur Sekretariati i Integritetit Evropian nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEFA).

4.19.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Objektivat kryesore të Shqipërisë për sa i përket politikave të punësimit dhe sociale përfshijnë:

- Zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit të reja dhe të rishikuara duke përfshirë programet e COVID-19;

- Miratimin e një programi të ri për garancinë rinore që të adresojë kryesisht NEET;

- Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;

- Intensifikimin e përpjekjeve për zbatimin e strategjisë së mbrojtjes sociale 2015 – 2020, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, forcimin e aftësive dhe burimeve të pushtetit vendor për të vlerësuar nevojat e kujdesit shoqëror në territorin e tyre;

Qeveria e Shqipërisë është e vendosur të zhvillojë një politikë sociale dhe punësimi, që është në linjë me kërkesat e BE-së dhe praktikave më të mira, duke investuar në kapital njerëzor dhe kohezion social, si një ndër shtyllat kryesore të vizionit strategjik primar e të bërit një anëtar i Bashkimit Evropian.

Prioritetet në fushën e **mbrojtjes sociale** janë:

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale për 2020 – 2023 dhe Planit të saj të Veprimit;

- Zbatimi i “strategjisë së daljes” që mundëson ri-integrimin shoqëror të përfituesve të NE;

- Shtrirja graduale e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar;

- Zbatimi i Planit Kombëtar të de-institucionalizmit 2020 – 2022 që synon zëvendësimin e qëndrave rezidenciale me shërbimet të kujdesit social alternative komunitare;

- Vendosja e lidhjeve dhe integrimi më i mirë ndërmjet politikave aktive të punësimit dhe përfshirjes sociale dhe politikave të mbrojtjes sociale.

Sa i përket fushës së **barazisë gjinore**, në fokus është:

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030;

- Fuqizimi i mëtejshëm së makinerisë së posaçme gjinore kombëtare dhe sigurimi i financimit të duhur.

Në lidhje me komunitetin e **LGBTI**, prioritetet janë:

- Miratimi dhe zbatimi i Planit LGBTI 2021 – 2027;

- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, profesionistëve të fushës.

Në lidhje me **Fëmijët**, prioritetet janë

- Zbatimi i “Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026” i miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave datë 03.11.2021;

- Funksionimi i një sistemi mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve. Forcimi i kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve. Përmirësimi i mekanizmave dhe shërbimeve specifike dhe të integruara për të trajtuar format më të rënda të dhunës, duke përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin në internet.

Për çështjet e **Sigurimeve Shoqërore** prioritetet kryesore mbeten:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elemente të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme;

- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës dhe zhvillimi i kapaciteteve të ISSH-së, implementimi gradual i projekteve të nisura për ngritjen e një sistemi kompleks e të automatizuar informacioni për plotësimin e funksioneve të sigurimeve shoqërore edhe për të tretët;

- Mbështetje e shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit, përmes koordinimit të skemave të mbrojtjes sociale me vendet e BE-së edhe më tej duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh.



Sa i përket **përfshirjes sociale dhe personave me aftësi të kufizuara**, prioritetet janë:

- Harmonizimi i të dhënave për përfshirjen sociale për grupet në nevojë;
- Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2021 – 2025 për Personat me Aftësi të Kufizuara;
- Përmirësimin i bazës ligjore sipas parimeve të Ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

Në kuadër të planit të veprimit të rishikuar të **Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019 – 2022** janë parashikuar, si prioritare:

- Nxitja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës;
- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;
- Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial;
- Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve.

Në lidhje me kërkesat e **shëndetit dhe sigurisë në punë**, objektivi kryesor mbetet zbatimi i politikave dhe ligjeve më të mira dhe më të dobishme për SSHP, të cilat mund të zbatohen në një mënyrë të dobishme duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të SSHP.

Në fushën e legjislacionit të punës prioritetet do të jetë përmirësimi i zbatimit të tij në sektorin publik dhe atë privat.

Në lidhje me zhvillimin e **dialogut social** ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve objekti kryesor mbetet promovimi i avantazheve të zgjidhjes paragjyqësore të konflikteve në punë; aftësimi i punëmarrësve dhe punëdhënësve për negociim dhe parandalim të mosmarrëveshjeve në punë; përmirësim i efektivitetit të shërbimit të ndërmjetësimit dhe pajtimit të mosmarrëveshjeve kolektive në punë.

Gjithashtu, rendisim prioritetet, si më poshtë:

- Ngritja e një sistemi monitorimi në mënyrë që Këshilli Kombëtar i Punës të vlerësojë shkallën në të cilën rekomandimet e saj janë marrë në konsideratë/zbatuar nga Këshilli i Ministrave.

- Përmirësimi i procedurave të ndërmjetësimit/pajtimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kolektive të punës, në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe të shpejtë.

- Rikostituimi i Këshillit Kombëtar të Punës si institucioni më i lartë i dialogut social në nivel qendror ku përfaqësimi i organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve në këtë Këshill do të përcaktohen sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 54, datë 29.1.2020.

- Ngritja e kapaciteteve të ndërmjetësve të Zyrave të Punësimit nëpërmjet trajnimeve për bazën e të dhënave në sistemin e menaxhimit të çështjeve, për marrëveshjet kolektive dhe Sindikatat.

- Nxitja dhe zhvillimi i dialogut social në Këshillin Kombëtar të Punës për konsultimin e çështjeve në interes të Organizatave të Punëdhënësve dhe Punëmarrësve.

- Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve kolektive të punës nëpërmjet procedurave të ndërmjetësimit dhe pajtimit.

KAPITULLI 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

4.20.1 Përmbajtja e kapitullit

Politika industriale e BE-së kërkon të promovojë strategji industriale që rrisin konkurrencën duke përsheptuar përshtatjen ndaj ndryshimeve strukturore, duke inkurajuar një mjedis të favorshëm për krijimin dhe rritjen e biznesit në të gjithë BE-në, si dhe investimet vendase dhe të huaja. Ajo synon gjithashtu të përmirësojë mjedisin e përgjithshëm të biznesit në të cilin operojnë Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Ajo përfshin privatizimin dhe ristrukturimin (shih gjithashtu Kapitullin 8-Politika e konkurrencës). Politika industriale e BE-së përbëhet kryesisht nga parimet e politikave dhe komunikimet e politikave industriale, forumet e konsultimit të BE-së dhe programet e Komunitetit, si dhe komunikimet, rekomandimet dhe shkëmbimet e praktikave më të mira në lidhje me NVM-të që synojnë të përmirësojnë formulimin dhe koordinimin e politikave të ndërmarrjeve në tregun e brendshëm mbi bazën e një përkufizimi të përbashkët të NMV-ve. Zbatimi i politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.



4.20.2 Struktura e kapitullit

- Politika industriale – Operacionet sektoriale
- Privatizimi dhe ristrukturimi
- Mjedisi i biznesit
- Politika e NVM-ve

4.20.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi mes BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me politikat e ndërmarrjeve dhe atyre industriale rregullohet në disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Së pari, **Neni 86** përcakton se bashkëpunimi do të synojë të kontribuojë në potencialin për zhvillim dhe rritje të Shqipërisë. Masat do të hartohen për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social në Shqipëri. Këto masa do të marrin parasysh bashkëpunimin rajonal.

Neni 91 përcakton se palët (si BE dhe Shqipëria) do të synojnë të sjellin një klimë të favorshme për investimet private të cilat janë vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë.

Neni 92 përqendrohet në bashkëpunimin industrial që mbulon modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare, forcimin e sektorit privat, bashkëpunimin ndërmjet operatorëve ekonomikë etj. Bashkëpunimi industrial do të marrë parasysh edhe aspektet rajonale të politikave industriale. *Acquis* e BE-së do të përafrohet gjithashtu.

Neni 93 i dedikohet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe synon të fokusojë bashkëpunimin BE-Shqipëri në zhvillimin dhe forcimin e NVM-ve duke marrë parasysh Aktin e Biznesit të Vogël, etj.

Neni 94 trajton turizmin si një sektor të veçantë të industrisë. Neni 94 parashikon forcimin e rrjedhës së informacionit mbi turizmin dhe transferimin e njohurive. *Acquis* në lidhje me turizmin duhet të përafrohet gjithashtu.

Së fundi, **Neni 70** i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit përcakton detyrimin e përgjithshëm të Shqipërisë për të përfuar legjislacionin e saj me *acquis* e BE-së.

Në lidhje me kërkesat e BE-së, politikat në këtë Kapitull hyjnë nën grupin e III⁴³ të kompetencave

të BE-së, d.m.th nën fushat ku BE mund të mbështesë, koordinojë ose plotësojë aktivitetet e vendeve anëtare dhe ku BE nuk ka të drejtë të kalojë akte ligjërish detyrues. Shtetet anëtare kanë ende kompetenca ekskluzive në këto politika, ndërsa BE mund të mbështesë përmirësimin e tyre. Dokumenti më i rëndësishëm për politikën industriale të BE-së është “Evropa 2020: Strategjia për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse”⁴⁴, e cila paraqet dokumentin kuadër të zhvillimit industrial të BE-së.

Instrumentet e politikës së ndërmarrjeve dhe asaj industriale janë zhvilluar në programin e BE-së për Konkureshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME). Programi ofron mbështetje financiare për ndërmarrjet dhe politike bërësit dhe është i përqendruar në veprimet që promovojnë qasjen në financa, hyrjen në tregje, sipërmarrjen, shërbimet e mbështetjes së biznesit siç është Rrjeti i Ndërmarrjeve Evropiane, zhvillimi i politikave më të mira në mbështetje të NVM-ve. Një instrument i rëndësishëm politik është Direktiva 2011/7/BE për luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet tregtare. Programet e politikave hapësinore të BE-së janë gjithashtu pjesë e këtij kapitulli, pasi ato kontribuojnë në përmirësimin e konkureshmërisë së BE.

Për sa i përket kërkimit dhe inovacionit, referenca kryesore është kapitulli XIX i Traktatit (TFEU) me dispozitat e kërkimit, legjislacioni i Horizon 2020 duke përfshirë dispozitat specifike të asociimit, kërkesat e Zonës Evropiane të Kërkimit, reformat kombëtare dhe Semestrin Evropian, “Open Science” dhe “Open Access”, Politikat “Open Access”, Programi i ardhshëm “Horizon Europe”, Integriteti i Kërkimit, etj.

4.20.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur.

Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, miratuar me Vendimin

⁴³ Grupi i parë i politikave përfshin kompetencat ekskluzive të BE-së (ku aktet detyruese ligjore miratohen në nivelin e BE-së), ndërsa kompetencat e përbashkëta (si BE-ja, ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjërish të detyrueshme; vendet anëtare mund ta ushtrojnë

këtë të drejtë vetëm kur BE nuk mund të veprojë ose ka zgjedhur të mos veprojë) bie nën grupin e dytë. Më shumë informacion mbi: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=URISERV:ai0020&from=EN>

⁴⁴ Evropa 2020: Një strategji për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, / * COM / 2010/2020



e Këshillit të Ministrave nr. 4466, datë 30.07.2021, përbën kuadrin strategjik për zhvillimin dhe mbështetjen e ndërmarrjeve dhe investimeve në Republikën e Shqipërisë. Tre objektivat kryesore të saj janë (i) Tërheqja dhe Ndërkombëtarizimi i Investimeve; (ii) Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni (iii) Zhvillimi i kapitalit njerëzor.

Strategjia BIDS 2021 – 2027 është në përputhje me strategjitë dhe programet gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015 – 2020, Programin e Reformës Ekonomike (ERP), si dhe në nivel ndërkombëtar me Planin e Veprimit për Tregun e Përbashkët 2021 – 2024 (CRM) për Ballkanin Perëndimor dhe Strategjinë e re të BE-së për NVM-të.

Gjatë vitit 2021, është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë projektligji “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”. Projektligji përafron pjesërisht Rekomandimin e Komisionit të BE-së të datës 6 maj 2003, lidhur me mbledhjen e të dhënave dhe metodat në llogaritjet për kategorizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zbatimin e metodologjisë së përdorimit të saj nga bizneset si dhe shton përkufizimin për ndërmarrjet e mesme. Projektligji rregullon edhe ofrimin e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore, dhe përcakton format e mbështetjes shtetërore për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si: mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, nga partnerë zhvillimi vendas ose të huaj, garancitë e kredive shtetërore sipas ligjit në fuqi për borxhin dhe garancitë shtetërore.

Sa i përket instrumenteve të politikës industriale, Shqipëria ka marrë pjesë në programin COSME të BE për NVM dhe Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve (EEN) përmes një konsorciumi të udhëhequr nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Në vijimësi, Shqipëria ka realizuar rekomandimet e OECD në “Aktin e Biznesit të Vogël”. Instrumenti COSME ka përfunduar në dhjetor 2021. COSME është zëvendësuar nga KE me programin “Single Market Program”, në të cilin Shqipëria do të behet pjesë nëpërmjet negociatave me KE. Deri më tani Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shprehur letrën e interesit për pjesëmarrje pranë KE në nëntor 2021.

Instrumenti i NVM-ve në kuadër të programit evropian Horizon 2020 synon mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) që kanë ide inovative për të sjellë në treg produkte, shërbime e modele të reja biznesi. Shqipëria merr pjesë në Horizon 2020 si një vend i asociuar. Pjesëmarrja e saj në Horizon 2020 është përmirësuar ndjeshëm dhe ka tregues në rritje.

Në kuadër të këtij Programi, AKKSHI (NASRI), ka organizuar 160 ditë informuese dhe trajnuese. Një pjesë e këtyre aktiviteteve janë organizuar në bashkëpunim me DG Research and Innovation të Komisionit Evropian, Research Executive Agency, Agency for the Promotion of European Research (APRE), etj. Performanca e Shqipërisë në Programin Horizon 2020 nga viti 2014 në vitin 2020, ka përmbushur objektivat e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor 2017 – 2022, rritje të aplikimeve dhe projekteve të fituara me më shumë se 10% në vit.

“Ditët Informative” të realizuara kanë pasur ndikimin e tyre në përmirësimin e ndodhur. Workshopet dhe Seminaret si dhe Informacionet e Letrat Lajmeve që Agjencia (NASRI) dërgon periodikisht kërkuesve sipas bazës së të dhënave të tyre. Kjo bazë të dhënash përfshin përafërsisht 3,900 kërkues e hartuar nga agjencia me të dhëna sasiore dhe cilësore;

Në këtë kontekst NASRI do të vazhdojë të koordinojë dhe promovojë “Horizon Europe”, i cili është programi kuadër i radhës për kërkim dhe inovacion;

Në funksion të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit 2017 – 2022, e cila pasqyron dhe përfshin gjashtë Prioritetet e ERA-s, NASRI ka vazhduar të koordinojë dhe promovojë Horizon Europe, MSCA, COST, EURAXESS, Charter and Code, HRS4R dhe CEEPUS program.

Bashkimi i QKR dhe QKL, mundësoi krijimin e QKB-së, si një qendër e vetme me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe licencimit të biznesit. Kjo ka sjellë një reduktim të mëtejshëm të barrierave administrative për bizneset që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mjedisit të biznesit, është krijuar një grup pune për reformën e rregullimit në fushën e licencimit. Në kuadër të kësaj reforme, grupi i punës ka propozuar eliminimin e 22 licencave dhe përmirësimin e



mëtejshëm të procesit të licencimit, me anë të riklasifikimit të licencave ose reduktimin e afatit të vendimmarrjes për 49 licencat e tjera. Aktualisht janë eliminuar 12 licenca.

Digjitalizimi i shërbimeve qeveritare ka zvogëluar barrën administrative për NVM-të. Sistemi e-Albania, i menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), lejon që bizneset të kryejnë më shumë se 300 shërbime përkatëse on line. Veçanërisht, taksat mund të paraqiten dhe paguhen në internet, duke sjellë uljen e barrës rregullore për NVM-të.

Në kuadër të reformës së ndërmarrë nga Qeveria shqiptare për digjitalizimin e shërbimeve qeveritare, një pjesë e shërbimeve funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit ofrohen vetëm on line nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania dhe nga vitit 2020, të gjitha shërbimet funksionale të Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrimin dhe licencimin/lejimin e biznesit ofrohen vetëm on line nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, dhe për aplikimet on line tarifa e aplikimit është 0 ALL.

Falimenti në Republikën e Shqipërisë është i rregulluar nga Ligji Nr. 110/2016 “Për falimentimin” dhe nga aktet nënligjore në zbatim të tij. Kuadri i përgjithshëm i inspektimeve rregullohet nga Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tij. Veprimtaria e autoriteteve inspektuese sektoriale rregullohet me akte ligjore të veçanta. Që nga janari i vitit 2019, të gjitha projektligjet që plotësojnë kriteret respektive i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit rregulator.

Në lidhje me të mësuarit e aftësive të sipërmarrjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) ka ndërmarrë Reformën e Kurrikulave dhe duke filluar nga viti 2014 e në vijim zhvillon programet e lëndëve shoqërore duke përfshirë në to kompetencat kyçe që duhet të fitojnë nxënësit në kuadrin e “Lifelong learning”, ku bëjnë pjesë edhe aftësitë e sipërmarrjes. Po kështu, janë miratuar udhëzime për ndjekjen ose përfundimin me kohë të shkurtuar të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë për ata të cilët nuk kanë mundur ta realizojnë atë.

Në fushën e prokurimit publik, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 850, datë 4.11.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020 – 2023 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj”. Kjo Strategji synon

përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimeve publike në Shqipëri, duke rritur më tej eficiencën dhe transparencën, forcuar konkurrencën e lirë dhe të ndershme dhe trajtimin e barabartë dhe shmangur korrupsionin dhe diskriminimin. Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” është përafuar në një shkallë të konsiderueshme me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht Direktivat 2014/24, 2014/25, si edhe Direktivat 89/665 dhe 92/13 të ndryshuara nga Direktiva 2007/66.

Gjatë viteve të fundit, institucionet publike shqiptare janë fokusuar në luftën kundër informalitetit. Autoritetet tatimore kanë kryer dhe kanë përmirësuar analizat e vlerësimit të riskut në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Përpjekje maksimale janë duke u kryer për të ndryshuar sjelljen mos përmbushëse të tatimpaguesve. Në mënyrë të veçanta, gjatë sezoneve turistike janë hartuar dhe zbatuar plane sektoriale për uljen e informalitetit dhe reduktimin e evazionit fiskal në sektorin e turizmit. Plane të tjera sektoriale janë hartuar bazuar në rezultatet e vlerësimeve të riskut, si për shembull në sektorin e ndërtimit, etj.

Gjatë periudhës 2020 – 2021, administrata tatimore u përfshi në një proces shumë të rëndësishëm në lidhje me Fiskalizimin, i cili do të ndihmojë drejtpërdrejt në marrjen e të dhënave të sakta në kohë reale për të gjitha transaksionet e biznesit me administratën tatimore, por edhe të gjithë informacionin që qarkullon në marrëdhëniet “biznes me biznes” dhe “biznes me qeveri”.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka shtuar po ashtu aktivitetin e tij në luftën kundër punës informale dhe zbatimin e përgjithshëm të legjislacionit të punës dhe të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka ofruar instrumente financimi për të stimuluar sipërmarrjen në inovacion, konkurrueshmërinë, startup-et dhe artizanatin, për të mbështetur prodhimin e tarifave nën regjimin e përpunimit të brendshëm dhe konkurrencës. Në vijim do të miratohen edhe instrumentet e reja të cilat do t'u përshtaten nevojave të reja të NVM-ve.

Në kuadër të masave për përballimin e pandemisë COVID-19 dhe pasojave të saj, Qeveria Shqiptare miratoi dhe zbatoi: dy Paketa Financiare si mbështetjen sociale për qytetarët dhe bizneset, alokoi buxhet shtesë për sektorin e shëndetësisë,



për sektorin e mbrojtjes për punën e tyre humanitare dhe një fond shtesë në Fondin Rezervë për shpenzime të tjera të nevojshme dhe të paparashikuara.

Në total, për paketën e parë dhe të dytë financiare, buxheti i shtetit disbursoi rreth 13 miliard lekë për bizneset dhe qytetarët.

Turizmi përbën një degë tepër të rëndësishme për ekonominë shqiptare. Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 413, datë 19.06 2019, përcakton kornizën strategjike për zhvillimin e sektorit. Zbatimi i kësaj Strategjia monitorohet rregullisht nga Grupi Tematik për Zhvillimin e Turizmit dhe Kulturës, i drejtuar nga Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit, sipas urdhrat të përbashkët të Ministrat të Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrat të Kulturës nr. 395, datë 19.12.2019.

Për shfrytëzimin e plotë të potencialit turistik të Shqipërisë dhe rritjen e punësimit dhe të ardhurave, Qeveria shqiptare ka miratuar një sërë masash stimuluese, si Ligji nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar” dhe aktet në zbatim të tij, të cilat përcaktojnë rregullat dhe kriteret e zhvillimit të aktiviteteve të turizmit detar, llojet e mjeteve të lundrimit të kënaqësisë, mjetet dhe pajisjet e tjera, infrastrukturën e nevojshme, standardet e sigurisë dhe përgjegjësitë institucionale për këto aktivitete.

Ndryshimet në Ligjin nr. 92/2014, “Mbi taksën e vlerës së shtuar në Republikën e Shqipërisë” mundësuan përjashtimin nga TVSH-ja 20% në importin e mjeteve lundruese turistike të cilat nuk janë më shumë se 20 vite të prodhuara nga momenti i importimit, synuan krijimin dhe zgjerimin e flotës shqiptare të mjeteve lundruese turistike miqësore me mjedisin dhe stimulimin e zhvillimit të infrastrukturës së marinave.

Rregullisht sezoni turistik menaxhohet nga një task forcë e drejtuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe me përfaqësues nga institucionet dhe agjencitë që janë përgjegjëse për promovimin dhe marketimin e turizmit, menaxhimin e vijës bregdetare, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës (rrugore, elektrike, ujore), mbrojtjen e shëndetit, sigurisë ushqimore, sigurisë fizike dhe rendit publik, mbrojtjes së konsumatorit, emergjencave civile, tatim taksave dhe zhvillimit të kulturës, etj. Në kuadër të pandemisë COVID-19, për menaxhimin e sezonit turistik, në vitin 2020

dhe 2021 u ngrit edhe Komiteti Ad Hoc për Menaxhimin e Sezonit Turistik i drejtuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, i cili koordinoi masat në nivel kombëtar për të adresuar emergjencën e krijuar nga pandemia dhe për të siguruar eficiencën e nevojshme të gjithë aktiviteteve.

Lidhur me industrinë, hartimi i një dokumenti të ri të Strategjisë së Zhvillimit të Industrisë do të bazohet në dokumentin e hartuar nga UNIDO dhe të miratuar nga Qeveria Shqiptare “Programi i Vendit për Shqipërinë Industriale Gjithëpërfshirëse dhe të Qëndrueshme 2020 – 2024”, bazuar në strategjinë e re BIDS 2021 – 2027.

Kuadri ligjor për zhvillimin teknologjik dhe ekonomik, përbëhet nga Ligji Nr. 9789/2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të zhvillimit teknologjik dhe ekonomik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij. Kuadri ligjor për zonat e zhvillimit teknologjik dhe ekonomik është i plotë. Ndryshimet e fundit të bëra në bazën nënligjore kanë krijuar mundësinë që si zhvillues i zonës të mund të jenë dhe njësitë e qeverisjes qendrore ose vendore. Pushteti vendor bazuar në projektet për zhvillim nëpërmjet thithjes së investimeve dhe rritjen e punësimit, në territorin që ka në administrim, mund të aplikojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të kërkojë shpalljen e një zone brenda territorit të saj, ku pushteti lokal do të marrë rolin e zhvilluesit.

Procesi i privatizimit mbetet përparësi në zhvillimin ekonomik. Sipas objektivave që lidhen me privatizimin e pasurive në pronësi të shtetit, ministri përgjegjës për ekonominë rishikon çdo vit planin për privatizimin e pasurive publike..

Gjatë vitit 2021, Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për Kapitullin 20 përditësoi analizën e mangësive ligjore, dhe analizën e mangësive institucionale dhe administrative për kapitullin si pjesë e përgatitjeve për takimet bilaterale në kuadër të procesit screening.

Tryeza e Konsultimit dhe Këshillimit për Kapitullin 20 u ngrit në maj të vitit 2021 dhe tashmë disponon rregullat e punës për funksionimin e duhur si një platformë konsultimi midis aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë në procesin e anëtarësimit në kapitullin përkatës.

Gjatë vitit 2021, fokusi kryesor i është kushtuar hartimit të politikave për zhvillimin e NVM-ve si



miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027 dhe hartimit të projektligjit për zhvillimin e NVM-ve si dhe vlerësimit të nevojave të NVM-ve. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur projekturdrin e Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021 – 2027 dhe Planin e Veprimave të saj”, me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse zbatuese. Aktualisht, projekturdhri i është dorëzuar zyrtarisht për mendim ministrive të linjës, përpara miratimit nga Kryeministri.

Gjatë vitit 2021, një grup pune i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, AIDA, dhe ekspertë të TAIEK, punuan së bashku për të hartuar skemën e re në mbështetje të NVM-ve shqiptare, si dhe miratuan ndryshimet që vijnë nga reagimet e komunitetit të biznesit, direktivat e BE dhe rekomandimet e ekspertëve. Në saj të kësaj asistence, MFE dhe AIDA dizenuan skemën e granteve.

Në qershor 2021, Këshilli i Investimeve finalizoi sondazhin “Vlerësimi i ndikimit të COVID-19 në aktivitetin e biznesit në Shqipëri”, lidhur me identifikimin e problematikave të krijuara nga pandemia dhe mënyrat e mjetet për të ndihmuar biznesin shqiptar.

Që nga tetori 2020, nëpërmjet Instrumentit këshillues “CoSolve 19”⁴⁵ janë trajnuar 197 biznese përmes procesit këshillimor (45 – sektori i bujqësisë; 74 – sektori i turizmit; 78 – sektorë të tjerë). Me ndihmën e BERZH-it, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe AIDA ngritën dhe bënë funksionale në prill 2021 platformën “Access to Finance” e cila ofron informacion mbi instrumentet financiare në dobi të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, që duan të zgjerohen dhe investojnë në aktivitetin e tyre duke përfutur nga mundësitë financiare që ofron tregu, me grante, kredi apo iniciativë të tjera financimi. Deri në fund të nëntorit 2021 janë publikuar 56 thirrje të reja për grante ose tendera/hua. Platforma është aksesuar 12 506 herë në total për periudhën maj – nëntor 2021. Në shtator – tetor 2021, MFE

ka kontaktuar të gjithë donatorët kryesorë që operojnë në Shqipëri për të marrë një informacion të përmbledhur mbi programet/projektet e tyre në vazhdim që lidhen me aksesin në financa për SME-të dhe masat mbështetëse të biznesit. Synimi kryesor është të sigurojë një hartë të asistencës ekzistuese të ofruar dhe për të ndihmuar AIDA-n të bashkëpunojë me donatorët të hartojë programet e saj të zonës së ndërhyrjes së SME-ve.

Gjithashtu, në mars 2021, MFE publikoi një raport mbi “Mbështetje për dixhitalizimin e SME-ve në Shqipëri për të zbutur ndikimin negativ ekonomik të COVID-19”.

Kuadri ligjor është përmirësuar me miratimin e Ligjit nr. 64/2021 “Për një ndryshim në ligjin nr. 48/2014 “Për vonesat në detyrimet kontraktuale dhe tregtare”, i cili përafroi më tej Direktivën 2011/7/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 16 shkurt 2011 për luftën kundër pagesës me vonesë në transaksionet tregtare.

Është përgatitur drafti për një ligj të ri për start-up-et. Projektligji “Për mbështetjen dhe zhvillimin e start-up-eve inovative” i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave më datë 20 dhjetor 2021 dhe u paraqit për miratim Kuvendit të Shqipërisë.

Në kuadër të përmirësimit të kuadrit rregullator (për nën indikatorin dalje nga tregu) është miratuar VKM nr. 65, datë 03.02.2021 “Për miratimin e rregullores së marrëveshjeve jashtëgjyqësore të riorganizimit të përsheptuar”. Objekti i rregullores është përcaktimi i procedurave për lidhjen e marrëveshjeve të riorganizimit të përsheptuar jashtë gjykatës ndërmjet debitorit, i cili është objekt i ligjit për falimentimin, dhe dy ose më shumë kreditorëve, nëse debitori është i paafte.

Shqipëria po vazhdon të zbatojë masat për zgjerimin e bazës së tatimpaguesve me qëllim rritjen e transparencës dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për biznesin.

Në dhjetor 2019 u ratifikua “Ligji për krijimin e Korporatës Shqiptare të Investimeve”. Si një agjenci e krijuar rishtas e qeverisë për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimeve dhe rigjallërimin e aseteve të zgjedhura të sektorit publik të papërdorura, fokusi i AIC gjatë vitit 2020 ka qenë në përgatitjen e akteve nënligjore të AIC (Karta e AIC). Rregulloret u finalizuan në maj të vitit 2020. Struktura e AIC tashmë parashikon një organizatë të vogël, me katër departamente: operacionet, zhvillimi i biznesit, departamenti ligjor

⁴⁵ një nismë e përbashkët e programeve dypalëshe të Bashkëpunimit Dypalësh për Zhvillim Gjermano-Shqiptar: “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit arsim dhe trajnim profesional” (ProSEED) dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm Rural (SRD).



dhe financa / thesari. Paralelisht me organizimin e brendshëm të AIC, janë duke ndërmarrë hapa për identifikimin e projekteve që AIC mund të marrë dhe shqyrtimin e ideve të mundshme të projektit. Projektet e AIC ndahen në katër kategori të gjera: prodhimi, logjistika, bujqësia dhe turizmi.

Lidhur me ngritjen e Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Elbasan, Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr. 238, datë 20.03.2020 “Për miratimin e nënshkrimit të kontratës ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe zhvilluesit “Italdruri Elbasan shpk” për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e teknologjisë dhe ekonomisë- zonë zhvillimi në Elbasan”. MFE ka miratuar fillimin e aktivitetit si përdorues të Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik, Elbasan shoqërinë “Today Sofas” i cili do të investojë në harkun kohor prej 5 vitesh një vlerë prej 1,000,000 euro.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi zgjatjen e afatit të aplikimeve për investime strategjike deri në 31 dhjetor 2023, në kuadër të Ligjit Nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Me Vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 1/8, datë 15.07.2021 është miratuar statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit “Zona Teknologjike e Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Tiranë”, me subjekt propozues Bashkia Tiranë, në një sipërfaqe prej 35 ha. Projekti propozohet të realizohet nga Bashkia Tiranë, si institucioni zhvillues i zonës, në bashkëpunim me institucionet e tjera publike.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e vendimeve të KIS ka filluar procedurën për ndryshimin e VKM-së nr. 646/2015, të ndryshuar, me qëllim përafrimin e bazës ligjore për zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik me atë të investimeve strategjike.

Privatizimi i paketave aksionere strategjike (shoqërive tregtare që operojnë në sektorë me rëndësi të veçantë për ekonominë) vazhdoi të zbatohet në përputhje me Ligjin Nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar. Gjatë vitit 2020 u privatizuan në total 12 asete shtetërore, duke realizuar 401,539,296 lekë dhe 303,767,835 Bono Privatizimi. Gjatë periudhës janar – tetor të vitit 2021 janë privatizuar në total 7

asete shtetërore, duke realizuar 24,696,978 lekë dhe 57,852,504 Bono Privatizimi.

Lidhur me instrumentet e politikave të ndërmarrjeve dhe industriale, në datën 1.11.2021, grupi i punës për programin kombëtar “Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar”, me përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP), i ftuar nga ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, zhvilluan një takim. Në takim u diskutua për organizimin ndërinstitucional të punës mes ministrive të përfshira në programin kombëtar “Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar” midis Ministres së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ministria për Rininë dhe Fëmijët do të punojë për ngritjen e një grupi ndërinstitucional pune me anëtarë të nivelit vendimmarrës dhe ekspertësh. Ministria për Rininë dhe Fëmijët do të mbajë kontaktet me UNICEF për ekspertët e huaj që do të rekrutohen dhe angazhohen në hartimin e programit kombëtar “Edukimi për artet dhe zejet në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar”.

Gjithashtu, me VKM Nr. 759 datë 09.12.2021 u miratua në parim projekt marrëveshja ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Programin kuadër për kërkimin dhe inovacionin “Horizon Europe”. Aktualisht po zhvillohen bisedime me Komisionin Evropian për nënshkrimin e marrëveshjes, e cila pritet të finalizohet brenda tre mujorit të parë 2022. Pas nënshkrimit, marrëveshja do të miratohet sërish me VKM në tërësi dhe pastaj do të kalojë për ratifikim në parlament.

4.20.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 20, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94 të “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e GNIP për Integrimin Evropian” dhe janë si më poshtë:



- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) (institucioni koordinues);

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS);

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM);

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Ministria e Drejtësisë;

- Ministria e Mbrojtjes;

- Ministria e Kulturës;

- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA);

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI);

- Agjencia e Prokurimit Publik (APP);

- Autoriteti i Konkurrencës (AK);

- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB);

- Sekretariati i Iniciativës së Transparencës për Industrinë Nxjerrëse (EITI);

- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit;

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

- Banka e Shqipërisë (BSH);

- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimet Sociale;

- Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike;

- Instituti i Statistikave (INSTAT).

4.20.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Mangësitë e identifikuara

- Niveli i ulët ose mungesa e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet organeve kompetente qeveritare dhe organizatave joqeveritare

- Shtyrja e miratimit të ligjit të ri për Start Up inovativ

Prioritetet

Sipas raportit të progresit të BE-së 2021, nevojitet:

- Adresimi i sfidave kryesore për mjedisin e biznesit, veçanërisht reduktimin e barrës rregullatore dhe rritjen e pjesëmarrjes në programet e financimit të disponueshëm për bizneset, progresin me miratimin e ligjit për inovacionin dhe ngritjen e agjencisë së start-ups, dhe sigurimin e plotë të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve;

- Përsheptimi i përafrimit të plotë të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së për pagesat e vonuara;

- Përsheptimi i miratimit të ligjit të unifikuar të investimeve për të adresuar sfidat ndaj konkurrueshmërisë dhe rritjes, siç theksohet në rekomandimet e përbashkëta të Programeve të Reformës Ekonomike të 2019 dhe 2020.

KAPITULLI 21: RRJETET

TRANS-EVROPIANE

4.21.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përfshin politikën e Rrjeteve Trans-Evropiane në fushat e transportit, telekomunikacionit dhe infrastrukturës energjetike, përfshirë udhëzimet e Komunitetit për zhvillimin e Rrjeteve Trans-Evropiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Përcaktimi dhe zhvillimi i Rrjeteve Trans-Evropiane, si dhe promovimi i ndërlidhjes së duhur dhe ndërveprimit të rrjeteve kombëtare synojnë të përfitojnë plotësisht nga tregu i brendshëm dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit në vend dhe më gjerë.

4.21.2 Struktura e kapitullit

- Rrjetet Trans-Evropiane të Transportit;

- Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë;

- Rrjetet Trans-Evropiane të Telekomunikacionit.

4.21.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

Bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë në lidhje me Rrjetet Trans-Evropiane, rregullohet nga disa nene të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Lidhur me këtë, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në nenin 106 “Transporti” përcakton se palët, d.m.th. Shqipëria dhe Bashkimi Evropian do të përqendrohen në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së, duke synuar rristurimin dhe modernizimin e mënyrave të transportit të Shqipërisë, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multimodale dhe lidhjen me rrjetet kryesore trans-evropiane dhe arritjen e standardeve operative të krahasueshme me ato të Bashkimit Evropian.

Në sektorin energjetik, neni 107 përcakton se bashkëpunimi në energji do të bazohet në Traktatin rajonal të Komunitetit të Energjisë të nënshkruar me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet e energjisë të Evropës, i cili është ratifikuar



nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006, “Për ratifikimin e Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë”.

Për sektorin e telekomunikacionit, bashkëpunimi midis BE-së dhe Shqipërisë përcaktohet në nenin 104 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, “Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik”, duke parashikuar që bashkëpunimi do të përqendrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në këtë fushë.

Neni 70 përcakton se Shqipëria do të përafrojë gradualisht legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së me qëllim përmirësimin e sistemit dhe shërbimeve të transportit dhe energjisë.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat në kapitullin 21 i përkasin grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian, d.m.th. grupit të kompetencave të ndara mes Bashkimit Evropian dhe shteteve të tij anëtare. Sipas Nenit 4 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si Bashkimi Evropian ashtu edhe shtetet anëtare mund të miratojnë akte ligjore në fushën e rrjeteve trans-evropiane. Shtetet anëtare e ushtrojnë kompetencën e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk e ushtron këtë kompetencë ose ka vendosur të mos e ushtrojë këtë kompetencë.

Politikat e Bashkimit Evropian në lidhje me rrjetet trans-evropiane të transportit (TEN-T) dhe energjisë (TEN-E) bazohen në tre shtylla kryesore: baza ligjore për TENs, Nenet 170 – 172 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, Rregullorja (BE) Nr. 1315/2013 për udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjetit trans-evropian në transport dhe energji, dhe Rregullorja (BE) 1316/20132 për ngritjen e Instrumentit *Connecting Europe*, duke amenduar Rregulloren (BE) 913/2010 dhe shfuqizuar Rregulloret (KE) 680/2007 dhe (KE) 67/2010. Ky kuadër ligjor përcakton objektivat e politikës së Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë rrjetet e transportit dhe energjisë dhe synojnë përshtatjen dhe zhvillimin e rrjeteve dhe sigurimin e ndërlidhshmërisë dhe ndërveprimit të tyre. Politikat e TEN-T dhe TEN-E i janë nënshtruar një rishikimi thelbësor. Instrumenti i ri i financimit për rrjetet trans-evropiane, Instrumenti *Connecting Europe* (CEF) dhe udhëzimet e rishikuara TEN-T dhe TEN-E hynë në fuqi në 1 janar 2014. Qëllimi i ngritjes dhe zhvillimit të rrjeteve trans-

evropiane dhe nxitja e ndërlidhjes dhe ndërveprimit të duhur të rrjeteve kombëtare bëhet për të shfrytëzuar plotësisht avantazhin e tregut të brendshëm dhe për të kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.

4.21.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet

Shqipëria ka arritur njëfarë niveli përgatitjeje për anëtarësim në fushën e rrjeteve ndër-evropiane. Shqipëria ka bërë disa përparime, si në rrjetet e transportit ashtu edhe në atë energjetik duke përfshirë funksionimin e plotë të gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP) i përfunduar tashme që në vitin 2020, si dhe lidhjes energjetike me Kosovën.

Në fushën e rrjeteve Trans-Evropiane të Telekomunikacionit, Shqipëria është pjesë e lidhjes me fibër optike të rrjetit Trans BalkanLine dhe Adria 1 dhe Adria 2.

Lidhur me rrjetet trans-evropiane të transportit, Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 811, datë 16.11.2016, “Për miratimin e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016 – 2020” ka përfunduar dhe në bazë të saj u përgatit Raporti i katërt i Monitorimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit 2016 – 2020 dhe Planit të Veprimit, i cili u aprovua më 30 qershor 2021, si dhe u botua në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/4th-Monitoring-Report-May-2021-Transport-Sector-Strategy-final-21.06.2021.pdf>.

Mbi bazën e Strategjisë së Sektorit të Transportit dhe Plani i saj i Veprimit 2016 – 2020, nga Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë ka filluar puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe planit të saj të veprimit për periudhën 2021 – 2025. Edhe Strategjia e re parashikon zhvillimin e rrjeteve bazë dhe gjithëpërfshirëse të transportit në përputhje me kërkesat e BE-së nën qasjen trans-evropiane.

Me Ligjin Nr. 8/2018, datë 26.02.2018 “Për ratifikimin e Traktatit që themelon Komunitetin e Transportit” u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ky Traktat, që është një nga dokumentet më të rëndësishëm për të gjithë sektorët e transportit, dhe që do të jetë udhërrëfyese për vitet në vijim. Zbatimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit do



të përmirësojë sektorin e transportit, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe do të përmirësojë në lidhjen e rrjetit shqiptar të transportit me rrjetin e transportit të BE-së. Traktati parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislacioneve kombëtare me *acquis* e BE-së, për të gjitha fushat e transportit.

Zbatimi i Traktatit që themeloi Komunitetin e Transportit (Ligji Nr. 8/2018, datë 26.02.2018) do të rrisë edhe më tej integrimin e rrjetit shqiptar dhe rajonal të transportit në rrjetet evropiane të transportit. Sipas Traktatit, Neni 8(1) “Infrastruktura”, hartat e zgjatjes indikative të rrjeteve gjithëpërfshirëse dhe bazë TEN-T në Ballkanin Perëndimor janë pjesë përbërëse e Traktatit të detyrueshme për të gjithë palët në Traktat. Neni 3 i Traktatit përcakton se palët kontraktuese janë të detyruar të harmonizojnë legjislacionin e tyre me *acquis* e BE-së, në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe vendimet e Komitetit Drejtues Rajonal.

Dokumenti kryesor i politikave në sektorin e energjisë është Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 – 2030, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 480, datë 31.07.2018. Kjo Strategji përcakton se vizioni i Shqipërisë është zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimal.

Për zhvillimin e infrastrukturës së gazit në Shqipëri, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektori të gazit natyror në Shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. Master Plani i Gazit përcakton linjat kryesore për zhvillimin e tregut dhe shërbimeve të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar nga gazsjellësi Trans Adriatik (TAP), por edhe vendburime potenciale të gazit të zbuluara dhe konkretizuara në vend, apo edhe të gazsjellësve të tjerë si gazsjellësi Adriatiko-Jonian dhe gazsjellësi Shqipëri – Kosovë.

Shoqëria Trans-Adriatic Pipeline AG ka përfunduar ndërtimin e gazsjellësit TAP në

territorin e Shqipërisë dhe së fundmi ka filluar procesin e transmetimit të gazit natyror.

Në fushën e telekomunikacionit, ndërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, sektori i telekomunikacioneve, në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar i cili është i bazuar në paketën e direktivave të BE-së për komunikimet elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Për zhvillimin e infrastrukturës digjitale, broadband, Këshilli i Ministrave ka miratuar me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, Planin e ri Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020 – 2025, i cili ka përcaktuar si vizion: “*Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit*”. Në këtë dokument janë përcaktuar dhe objektivat strategjike të zhvillimit të broadband si zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës broadband, reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve broadband gjithëpërfshirëse dhe rritja e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit.

Gjatë vitit 2021, Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë ka filluar punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Transportit dhe planit të saj të veprimit për periudhën 2021 – 2025. Në këtë draft janë përfshirë të gjitha prioritetet e rajonale dhe të BE-së, të shprehura në Agjendën Jeshile (Green Agenda), në Planin Ekonomik të Investimeve (Economic Investment Plan), Strategjinë për një transport të zgjuar dhe qëndrueshëm për Ballkanin Perëndimor (Smart and Sustainable Strategy for the Western Balkan), si dhe të gjitha Planet e Veprimit të parashikuara në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

Gjatë vitit 2021, ka vazhduar të zbatohet edhe Plani i rishikuar kombëtar i transportit (PKT3), si një instrument për zbatimin e prioriteteve dhe politikave të sektorit të transportit.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Shqipëria nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka marrë pjesë aktive në Komitetin Drejtues rajonal të Traktatit të Komunitetit të Transportit dhe në Komitetet Teknike të ngritura nga TKT.

Në rrjetin kryesor rrugor, janë bërë disa përparime në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese. Ka përparime në



përgatitjen e projekteve të infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe portuale, veçanërisht përgjatë korridorit të VIII dhe korridorit Adriatiko-Jonian. Bypass-et e Fierit dhe Tepelenës janë tashmë të përfunduara dhe të hapura për qarkullim që nga mesi i vitit 2020. Punimet e bypass-it të Vlorës po ecin intensivisht dhe nga data 15 korrik bypass-i u hap për qarkullim për sezonin veror. Studimi për korridorin rrugor Adriatiko Jonian përfundoi në dhjetor 2020.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është pothuajse i përfshirë në rrjetin rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km, ka 200 kilometra linjë dhe degë hekurudhore dytësore. Sa i përket projekteve të ndërlidhjes, Kontrata për rehabilitimin e linjës hekurudhore Durrës – Tiranë dhe ndërtimin e një linje e re për në aeroportin ndërkombëtar është nënshkruar më 3 shkurt 2021. Projekti i detajuar për lidhjen hekurudhore Vorë – Hani i Hotit u përfundua në qershor 2021 dhe aktualisht duke qenë se ky projekt konsiderohet i maturuar është aplikuar në thirrjen e 6-të për Investime të WBIF. Prioriteti është dhënë edhe lidhjes hekurudhore përgjatë Korridorit të VIII, për të cilën ka përfunduar projekti i detajuar i segmentit hekurudhor Durrës – Rrogozhinë dhe po vijohet me pjesën tjetër (Rrogozhinë – Pogradec) për hartimin e projektit paraprak. Në shtator 2021 është firmosur nga tre ministrat përgjegjës për transportin (Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria) një Memorandum Mirëkuptimi për zhvillimin e Korridorit të VIII, i cili reflekton angazhimin politik të tre palëve për zhvillimin dhe realizimin e një Korridori të qëndrueshëm, sipas standardeve evropiane TEN-T.

Në fushën e transportit detar, Porti i Durrësit, i cili është i vetmi port i rrjetit kryesor në Shqipëri, do të zhvendosë aktivitetet e tij të ngarkesave në zonën e Porto Romanos disa km në veri të Durrësit. Në nëntor 2020, qeveria përfundoi një marrëveshje dhjetëvjeçare për bashkëpunimin ekonomik me Qeverinë e Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA), duke përfshirë rrizhvimin e Portit të Durrësit dhe transformimin e tij në një marinë të madhe. Në qershor 2021, Autoriteti Portual i Durrësit nisi tenderin për një kontratë shërbimi për transferimin e aktiviteteve të ngarkesave nga Porti i Durrësit në Porto Romano.

Për sa i përket infrastrukturës aeroportuale, në prill 2021 u inaugurua zyrtarisht aeroporti i Kukësit në veri të Shqipërisë, dhe fluturimet kane filluar normalisht, kryesisht me linjat ajrore me kosto të ulët. Qeveria nënshkroi në prill 2021 kontratën për ndërtimin e një aeroporti të tretë ndërkombëtar në Vlorë, në jug të Shqipërisë, punimet e të cilit priten të fillojnë brenda vitit 2021. Gjithashtu gjatë vitit 2021 është shpallur procedura për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit të Sarandës.

Për sa lidhet me arritjet në sektorin e gazit natyror, projekti IAP. Projekti WB15-REG-ENE-02 “Projektimi paraprak i tubacioneve të gazit Adriatik Jon – pjesët e Malit të Zi dhe Shqipërisë”, është në fazën përmbyllëse nga konsulenti SUEZ (IPF6 AT). Projekti ka filluar në shtator 2018. Gjatë vitit 2019, procesi i ridrejtimt për sektorin shqiptar përfundoi dhe u miratua nga institucionet shqiptare. Më 6 nëntor 2019, konsulenti paraqiti draftin e Projektimit Paraprak për Seksionin Shqiptar. Në shkurt të vitit 2020, konsulenti SUEZ IPF 6 paraqiti draftin përfundimtar të VNMS-së për seksionin shqiptar të IAP. “Projektimi Paraprak i Gazsjellësit Adriatik Jon – Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë”. Më datë 24.08.2020 konsulenti IPF6 paraqiti draft Projektin Implementimi i Planit për seksionin shqiptar të projektit IAP. Së fundmi konsulenti ka paraqitur draftin final për sa lidhet me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Social.

Gazsjellësi Fier – Vlorë. Komiteti Drejtues i WBIF më 6 dhjetor 2018 miratoi një grant prej 1.1 milion euro për përgatitjen e tubacionit të gazit “Fieri – Vlora: Dizajnimi i Hollësishëm dhe Dokumentet e Tenderit”. Termat e Referencës u miratuan në shtator 2019. Konsulenti Hill International – Projekti i Konsorciumit IPF 7 (WB20-ALB-ENE-04), dorëzoi në janar 2020 për komente dokumentin “Metodologjia për tubacionin e gazit Fieri – Vlorë: Dizajni i Hollësishëm dhe Dokumentet e Tenderit”. Projektimi i Hollësishëm dhe Dokumentet e Tenderit” u miratua zyrtarisht nga Komiteti Drejtues i projektit të lartpërmendur. Projekti është në fazën përmbyllëse të tij.

ALKOGAP. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë po aplikon për një grant asistence teknike për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, VNMS / VNM për Shqipërinë të Gazsjellësit Alkogap.



Projekti synon të krijojë një rrugë të re furnizimi për gazin natyror nga Lindja e Mesme dhe rajoni Kaspik i transportuar nga Gazsjellësi Trans Adriatik, në veri-lindje të zonës së Ballkanit Perëndimor drejt Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë. Projekti ALKOGAP megjithatë do të planifikohet si një tubacion me dy drejtime, drejtimi i mundshëm i furnizimit gjithashtu mund të jetë në veri-jug, nga Unaza e Gazit e Komunitetit të Energjisë (ECGR), ose burime të tjera

Për zhvillimin e rrjeteve të telekomunikacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka iniciuar projektin për Zhvillimin e Broadbandit Rajonal i cili është pjesë e Projekteve Kombëtare të NSPP (National Single Project Pipeline) të miratuara nga Komiteti Kombëtar i Investimeve. Me mbështetjen e WBIF ka përfunduar studimi i fizibilitetit për zhvillimin e broadbandit rajonal në korrik 2020. Aktualisht kanë nisur dy projektet e WBIF për zhvillimin e broadband në zonat rurale dhe të bardha në veri dhe jug të vendit. Shqipëria është pjesë e projektit rajonal të WBIF për Digital Balkan Highway, të iniciuar nga Banka Botërore në vitin 2017 dhe që synon rritjen e kapaciteteve ndërkufitare për broadband duke shfrytëzuar kapacitetet e lira të fibrës optike të operatorëve të transmetimit të energjisë.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, dhe zhvillimin e rrjeteve të së ardhmes, është nënshkruar në 2 Nëntor 2020, në Tiranë gjatë Samitit të tretë Digjital të Ballkanit Perëndimor Memorandumi i Bashkëpunimit “Për udhërrëfyesin (Roadmap) për 5G, për transformimin Digjital në Ballkanin Perëndimor”.

Ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit të Republikës së Kosovës është nënshkruar në Tiranë në 2.10.2020, Memorandumi i Bashkëpunimit për krijimin e korridorit digjital 5G dhe lehtësimin e lëvizjes në të ardhmen.

Në lidhje me ndërldhjen digjitale dhe bazuar në angazhimet rajonale në fushën digjitale, me datë 1 korrik 2021, filloi zbatimi i *roamingut si në shtëpi* (RLAH) në vendet e Ballkanit Perëndimor duke lehtësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe përmirësuar klimën e biznesit.

Më shumë informacion për zhvillimet në fushën e rrjeteve të komunikimeve elektronike jepet në

kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”.

Gjatë periudhës 2018 – 2020 është përfunduar:

1. Rindërtimi i Nënstacioneve:

- Rehabilitimi i centralit 110 kV në Stacionin Memaliaj;

- Rehabilitimi i centralit 110 kV në Stacionin Laçi 1;

- Rikonstruksioni i anës 110 kV në Nënstacionin Kajan;

- Rikonstruksioni i Nënstacionit 110 kV Jagodina;

- Rikonstruksioni i Stacionit 110/35/20/6 Lushnjë (Plasma);

- Rikonstruksioni i impiantit 110 kV të nënstacionit të Librazhdit (mbetet instalimi i pajisjeve të telekomunikacionit);

- Rehabilitimi i anës 110 kV të Nënstacionit Fushë-Arrëz;

- Rehabilitimi i centralit 110 kV në Stacionin Laçi 2;

- Rehabilitimi i centralit 110 kV të Nënstacionit Rubiku;

- Rehabilitimi i anës 110 kV të Nënstacionit Iba;

- Punime civile për rikonstruksionin e traktit 110 kV të linjës Fieri – Kuçovë;

- Punime civile për riparime dhe rikonstruksione në nënstacionin Rrashbulli dhe Zemblaku;

- Rehabilitimi i anës 110 kV të nënstacionit të Përrenjasit.

2. Investimet e përfunduara: rikonstruksione dhe ndërtim linjash të reja:

- Ndërtimi i linjës së re 110 kV me dy qarqe Ulëz – Skuraj;

- Rikonstruksioni i linjës 110 kV Laçi 1 – Laçi 2;

- Demontimi dhe ndërtimi i linjës së re 110 kV me një qark Skuraj – Laçi 1;

- Ndërtimi i linjës 110 kV, Nënstacioni Sallmone – Gjiri i Lalëzit dhe trakti shtesë 110 kV në Substacionin Sallmone;

- Përfundimi i linjës kablllore 110 kV Tiranë 2 – Selitë dhe lidhja me nënstacionin e Kombinatit 110/20 kV.

Projektet e mëposhtme janë në fazën e zbatimit:

1. Sapo ka nisur ndërtimi i nënstacionit të Shumatit 220/110/35 kV, financuar nga OST S.A. në vlerën 144 milionë lekë. Ndërtimi i këtij



stacioni do të ndikojë në të gjithë unazën 110 kV të zonës verilindore të Shqipërisë, me të cilën janë lidhur ose janë në ndërtim një numër i madh hidrogjeneratorësh. Ky nënstacion do të rrisë sigurinë e sistemit duke reduktuar numrin e shkyçjeve dhe ndërprerjeve në HEC-et ekzistues të lidhur me rrjetin dhe me klientët në zonë, si dhe do të reduktojë humbjet teknike.

2. Është në ndërtim e sipër linja 220 kV Komsit – Shumat financuar nga OST S.A në vlerën 199.9 milionë lekë. Projekti parashikon ndërtimin e një linje 220 kV me dy qarqe, me qark të instaluar me përcjellës ACSR 490/65 mm² me gjatësi 48.5 km dhe përbëhet nga 147 shtylla të reja metalike. Linja do të lidhë anën 220 kV të nënstacionit të Komsit me Burrelin dhe anën 220 kV të nënstacionit të ri 220/110/35 kV. Ndërtimi i kësaj linje do të ndikojë pozitivisht në uljen e ngarkesës së linjës 110 kV të unazës verilindore;

3. Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laçi 2 – Ura e Matit dhe Skuraj – Ura e Matit financuar nga OST S.A në vlerën 233 milionë lekë. Projekti parashikon çmontimin e linjës ekzistuese 110 kV Laçi 2 – Ura e Matit dhe Skuraj – Ura e Matit, ndërtimi i linjës së re 110 kV Laçi 2 – Ura e Matit me dy qarqe me përcës ACSR 240/40 mm² me gjatësi rreth 5.6 km, ndërtim. i linjës së re 110 kV Skuraj – Ura e Matit me qark me përcjellës ACSR 240/40 mm² rreth 4.5 km i gjatë. Ndërtimi i kësaj linje do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapacitetit të transmetimit të flukseve të energjisë nga hidrocentralet e Ulzës, Shkopetit dhe HEC-eve të tjerë të zonës drejt qendrës së ngarkesës kryesisht në Tiranë;

4. Ndërtimi i linjës 110 kV Fibër – Librazhd me dy qarqe dhe trakte të linjave përkatëse në Nënstacionin Fibër dhe Librazhd financuar nga OST S.A në vlerën 464 milionë lekë. Projekti parashikon ndërtimin e linjës së re 110 kV Fibër – Librazhd me dy qarqe rreth 23 km të gjatë, me përcës ACSR 240/40 mm² dhe ndërtimin e dy trakteve të linjës në stacionet Librazhd dhe Fibër. Ndërtimi i kësaj linje do të ndikojë pozitivisht në rritjen e kapacitetit transmetues të flukseve energjetike nga HEC-et aktualisht të lidhur dhe BRE-te e pritshme në të ardhmen e afërt, duke rritur sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike, duke përmirësuar profilin e tensionit brenda kufijve të lejuar.

Investimet shtesë për të cilat janë nënshkruar kontratat në vitin 2020 & 2021 dhe që janë në proces zbatimi janë:

1. Ndërtimi i linjës së re 110 kV, me një qark Cërriku – Kajani – Kuçovë – Jagodinë dhe rehabilitimi i trakteve dalëse të linjave 110 kV të stacioneve Cërriku dhe Kuçovë;

2. Zhvendosja e linjës ajrore me dy qarqe 220 kV Tiranë 2 – Elbasan;

3. Rikonstruksioni i linjës 110 kV Librazhdi – Përrenjasi;

4. Ndërtimi i linjës së dyfishtë 110 kV Nënstacioni Elbasani – Nënstacioni Fibër;

5. Ndërtimi i qarkut të ri të dyfishtë 110 kV Elbasani – Cërriku;

6. Punimet parësore, furnizimi dhe instalimi i transformatorit TR 63 MVA, 220/20 kV, në nënstacionin Tirana 1, punime dytësore për përshtatjen e tij me sistemet ekzistuese;

7. Ndërtimi i linjës së re 110 kV me një qark Lushnjë – Fier;

8. Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe 110 kV Burreli – Bulqizë dhe rehabilitimi i nënstacioneve 110 kV Burreli dhe Bulqizë.

Projektet rajonale të interkonjeksionit, masat e reformës

- Linja e interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Linja e interkonjeksionit 400 kV ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës ka përfunduar më 28.06.2016. Më 20.04.2020, u përmbyll me sukses marrëveshja e re për kyçe ndërmjet operatorit të sistemit të transmissioinit të Kosovës (OST) KOSTT dhe ENTSO-E nga Grupi Rajonal i Evropës Kontinentale (RGCE). Pas votimit, e më pas nënshkrimit, KOSTT dhe Republika e Kosovës fitojnë pavarësinë energjetike nga Serbia dhe Operacionin e Pavarur si Zonë Rregullatore, në kuadër të Bllokut Rregullator Kosovë – Shqipëri. Më datë 14.12.2020, Marrëveshja e Kyçjes ndërmjet KOSTT-it dhe operatorëve të sistemit të transmissioinit (OST) nga Evropa Kontinentale ka hyrë në fuqi duke shënuar ditën e parë të funksionimit të KOSTT-it si zonë kontrolli brenda bllokut të përbashkët të kontrollit me OST-në Shqiptare, OST. Përveç kësaj, linja e re 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë tani është në funksionim duke kontribuar në shkëmbimet e mëtejshme ndërkufitare.



- Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Maqedoni e Veriut. Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Maqedoni e Veriut, është një nga projektet më të rëndësishme të sektorit elektroenergjetik shqiptar dhe në përputhje të plotë me politikat e Qeverisë Shqiptare për mbështetjen e sektorit elektroenergjetik, i cili synon rritjen e kapaciteteve të transmetimit të energjisë elektrike, për të përmirësuar. Siguria e furnizimit me kosto efikase dhe reduktimi i humbjeve në transmetimin dhe furnizimin me energji elektrike në Shqipëri, krijojnë kushtet për një treg të integruar të energjisë në rajon dhe krijimin e kapaciteteve të importit dhe eksportit të energjisë elektrike.

4.21.5 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për Kapitullin 21, sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94 “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian” janë si më poshtë:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Autoriteti Rrugor Shqiptar;
- Instituti i Transportit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Drejtoria e Përgjithshme Detare;
- Portet detare, Sh.A;
- Autoriteti Portual i Durrësit;
- Hekurudha Shqiptare Sh.a;
- Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor;
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- Enti Rregullator i Energjisë;
- Agjencia për Eficiencën së Energjisë;
- KESH, Sh.A;
- OST sh.a.;
- OSHEE sh.a.;
- Albpetrol sh.a.;
- ALBGAS sh.a.;
- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial;
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë;
- INSTAT.

4.21.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Moszbatimi i plotë i Rregullores (BE) Nr. 347/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 17 prill 2013 mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane dhe shfuqizimin e vendimit nr. 1364/2006/KE dhe

ndryshimin e rregulloreve (KE) nr. 713/2009, (KE) Nr 714/2009 dhe (KE) Nr 715/2009, pavarësisht VKM-së Nr. 685 datë 14.11.2018 “Përmirësimin e praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta, rajonale, në infrastrukturën e sektorit të energjisë”.

Publikimi i një manuali mbi procedurat për procesin e dhënies së lejeve, të zbatueshëm për Projektet me interes të Komunitetit të Energjisë do të lehtësojë realizimin e projekteve strategjike të infrastrukturës në vazhdim, veçanërisht të linjës së interkonjeksionit 400 kV Shqipërisë – Maqedonia e Veriut (në ndërtim e sipër), si dhe përgatitjet e vazhdueshme për projektet e gazifikimit dhe infrastrukturës së gazit, veçanërisht projekti ALKOGAP dhe Gazsjellësi Jon Adriatik.

Prioritetet e vitit 2022 janë:

- Vazhdimi i zhvillimit të rrjeteve kryesore të transportit dhe energjisë në përputhje me: (i) strategjitë kombëtare për transportin dhe energjinë; (ii) prioritizimin e investimeve në infrastrukturë në kuadër të Listës Prioritare të Projekteve; (iii) Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor duke kontribuar në Agjendën e gjelbër;

- Vazhdimi i harmonizimit të kuadrit ligjor me *acquis* e BE-së dhe rregulloret për TEN-T (rrjetet transevropiane të transportit) dhe TEN-E (rrjetet transevropiane të energjisë), duke përfshirë transpozimin e plotë të udhëzimeve për infrastrukturën transevropiane të energjisë;

- Zbatimi i planeve të veprimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit për transportin rrugor, sigurinë rrugore, transportin hekurudhor dhe lehtësimin e transportit dhe forcimi i kuadrit institucional dhe kapaciteteve administrative për zhvillimin dhe monitorimin e rrjeteve transevropiane;

- Në lidhje me komunikimet elektronike rekomandohet transpozimi i direktives së re 2018/1972/EU (Kodi i Komunikimeve Elektronike të BE-së). Ky prioritet është përfshirë edhe në Kapitullin 10.

KAPITULLI 22: POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORË

4.22.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato zbatuese, të cilat nuk kërkojnë përafrimin në legjislacionin kombëtar.



Këto rregullore përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe Fondit të Kohezionit duke pasqyruar organizimin territorial të secilit vend. Këto programe janë negociuar dhe janë dakordësuar me Komisionin, por zbatimi është përgjegjësi e Shteteve Anëtare. Shtetet anëtare duhet të respektojnë në përgjithësi legjislacionin e Bashkimit Evropian, për shembull, në fushat e prokurimit publik, konkurrencës dhe mjedisit, kur përzgjedhin dhe zbatojnë projektet. Shtetet anëtare duhet të kenë kuadrin institucional dhe kapacitete zbatuese adekuate për të siguruar programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë të përshtatshme dhe me kosto efektive nga këndvështrimi i menaxhimit dhe kontrollit financiar.

4.22.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 22 nuk është i ndarë në nënkapituj.

4.22.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis të Bashkimit Evropian

Republika e Shqipërisë në Kapitullin 22 do të fokusohet në:

- Zbatimin e nenit 110 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit që përcakton se palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë rajonale. Ndiurma financiare e siguruar nga BE është e rregulluar me nenet 112 – 115 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA);

- Marrjen e masave për të reduktuar pabarazitë ekonomike, duke krijuar rajone konkurruese, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, zhvillim social, mjedisor dhe rrjedhimisht ekonomik dhe social të vendit në përputhje me standardet e BE;

- Përgatitjet e strukturave institucionale shqiptare për të zbatuar pas hyrjes në Bashkimin Evropian, programet e Bashkimit Evropian të përmendura më lart.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e kohezionit ekonomik, social dhe territorial (politikat rajonale) janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funksimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet

anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i ushtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Acquis në këtë kapitull përbëhet kryesisht nga rregulloret kuadër dhe ato zbatuese, të cilat nuk kërkojnë përafrimin në legjislacionin kombëtar. Këto rregullore përcaktojnë rregullat për hartimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Evropiane Strukturore dhe të Investimeve (ESIF) të cilat do të reflektohen në organizimin territorial të secilit vend. Këto programe janë negociuar dhe janë dakordësuar me Komisionin, por zbatimi është përgjegjësi e Shteteve Anëtare.

Kuadri ligjor duhet të jetë i miratuar për të lejuar programimin shumë-vjeçar në nivel kombëtar dhe vendor dhe fleksibilitetin buxhetor, duke mundësuar kapacitetin bashkëfinancues në nivel kombëtar dhe vendor dhe duke siguruar kontrollin financiar të përshtatshëm dhe eficient dhe auditivin e ndërhyrjeve. Shtetet anëtare duhet të respektojnë legjislacionin e Bashkimit Evropian në përgjithësi, kur përzgjedhin dhe zbatojnë projektet në fushat që kanë lidhje me politikat rajonale dhe instrumentet strukturore të tilla si prokurimi publik, konkurrenca dhe mjedisi, jo-diskriminimi dhe barazia mes burrave dhe grave.

Kuadri institucional përfshin përcaktimin dhe ngritjen e të gjitha strukturave në nivel kombëtar dhe vendor të kërkuara nga rregulloret ashtu edhe ngritjen e një sistemi zbatimi me përcaktime të qarta të detyrave dhe përgjegjësi për organet e përfshira. Kuadri institucional kërkon po ashtu, ngritjen e një mekanizmi eficient për koordinimin ndërinstitucional ashtu edhe përfshirjen dhe konsultimin në një partneritet të gjerë të organizatave për përgatitjen dhe zbatimin e programeve.

Duhet të sigurohen kapacitetet administrative të përshtatshme në të gjitha strukturat relevante. Kjo përfshin rekrutimin dhe trajnimin e stafit të kualifikuar dhe me eksperiencë dhe marrjen e masave për të mbajtur në punë këtë staf. Në këtë kontekst, Shtetet anëtare nevojitet që të miratojnë rregullimet e nevojshme organizative, të miratojnë procedurat dhe organigramat dhe të përgatisin dokumentet shoqëruese.

Procesi i programimit mbulon përgatitjen e Marrëveshjeve të Partneritetit (PA) dhe të një serie programesh operacionale (OP) duke përfshirë



vlerësimet ex-ante. Shtetet anëtare duhet të organizojnë partneritete të gjera për përgatitjen e dokumenteve të programimit. Ato duhet të sigurojnë që është krijuar një listë e mjaftueshme projektsh që lejon zbatimin e plotë financiar të programeve. Shtetet anëtare duhet të realizojnë edhe masa informative dhe publicitare specifike në lidhje me instrumentet strukturore.

Ngritja e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi përfshin ngritjen e strukturave të monitorimit dhe vlerësimit në organet e ndryshme relevante ashtu edhe instalimin e një sistemi të menaxhimit të informacionit, tërësor dhe të kompjuterizuar (MIS) të aksesueshem dhe të përdorshëm nga të gjitha organet e interesuara.

Duhet të ngrihet një kuadër i veçantë për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke përfshirë auditin. Ky përfshin përcaktimin dhe ngritjen e të gjitha strukturave të kërkuara nga rregulloret ashtu edhe ngritjen e një sistemi zbatimi me përcaktim të qartë të detyrave dhe përgjegjësi për organet e përfshira.

4.22.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. Për këtë qëllim, situata e hartimit të dokumentave strategjike po evolon dhe shumë procese po zbatohen nga institucionet kyç që ndikojnë në progresin e zbatimit të kushteve për zhvillimin rajonal.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 ka përfunduar fazën e zbatimit dhe aktualisht ka filluar procesi për hartimin e strategjisë së re kombëtare që do të shtrihet për periudhën deri në vitin 2030

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030⁴⁶

Për përgatitjen e SKZHI është hartuar draft metodologjia për procesin e hartimit, duke u bazuar në parimin e *funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale* të lidhura me planifikimin e integruar dhe sistemin informatikë IPSIS (Integrated Planning System Management

Information System), miratuar me VKM Nr.290, date 11.4.2020. Gjithashtu, është përgatitur draft Urdhëri për miratimin e standartit metodologjik për SKZHIE 2030 dhe për fillimin e procesit për SKZHIE 2030, i cili përmban metodologjinë përkatëse për SKZHIE 2030. Aktualisht ka përfunduar procesi për identifikimin e prioriteteve afatmesme 2022 – 2024, përmes përgatitjes së Dokumentit të Politikave Prioritare 2022 – 2024, i cili është miratuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në mars 2021. Ky dokument orientoit diskutimin për përgatitjen dhe miratimin e tavanëve të buxhetit për periudhën 2022 – 2024, me Urdhër të Ministres së Financave dhe Ekonomisë.

Në kuadër të përgatitjes së SKZHI 2030, është angazhuar mbështetje me asistencë teknike nga OKB, për hartimin e draftit të SKZHIE 2030, si edhe për analizën e rritjes ekonomike dhe kostimin e SKZHIE 2030. Kjo strategji do të sigurojë mbështetje veçanërisht për orientimin e Programimit Buxhetor Afatmesëm në ciklet brenda harkut kohor 2030, si edhe në harmonizim me dokumentet e lidhura me strategjinë e Bashkimit Evropian për zgjerimin /Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Gjithashtu, SKZHIE 2030 do të përfshijë qëllimet e politikave për politikën afatgjatë të lidhura me zhvillimin rajonal të vendit, në përputhje edhe me ligjin 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin: (neni 11/6).

Në lidhje me kuadrin e përgjithshëm të politikave dhe prioriteteve sektoriale, SKZHIE – 2030 siguron:

- **Lidhjen me prioritetet afatmesme të Qeverisë Shqiptare,** ku prioritetet e parashikuara në programin e Qeverisë, si edhe sektorët prioritarë të Qeverisë, janë pjesë integrale e vizionit drejt të cilit duhet të zhvillohet vendi dhe politikën strategjike që përcaktohen në SKZHIE, në funksion të vizionit.

- **Lidhja e plote e PBA me SKZHIE** përmes:

- hartimit të një kuadri makroekonomik për 2030, që përfshin prioritetet e politikave për 2030, financimin e huaj të parashikuar apo programuar, si edhe aspekte të tjera lidhur me financimin dhe të ardhurat.

- qëllimet e politikave të mirëpërcaktuara për 2021 – 2030, të cilat përfshijnë edhe objektivat në kuadër të integritetit evropian. Për këtë qëllim,

⁴⁶ Me krijimin e Agjencisë së Shtetit për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmes, VKM 642, dt. 29.10.2021, kompetencat për përgatitjen dhe koordinimin e SKZHIE 2030 janë transferuar nën këtë agjenci. Për konfirmim të metejshëm të materialeve të prezantuara mund të nevojitet konsultim me agjencinë.



Udhëzimi për hartimin e Buxhetit përcakton detajet teknike të përfshirjes së politikave dhe zbrërthimin e objektivave në PBA e ardhshme në funksion të realizimit të qëllimeve 2021 – 2030.

- **Lidhjen e plotë me agjendën e integritetit të vendit/MSA**, ku aktivitetet, masat dhe angazhimet në kuadër të MSA-së janë pjesë integrale e SKZHIE-së dhe planifikimit buxhetor afatmesëm.

SKZHIE 2030 siguron gjithashtu boshtin orientues për të gjitha programimet e fondeve të partnerëve për zhvillim, duke përfshirë financimin përmes IPA-s, si instrument financimi i BE për Shqipërinë, apo edhe strategjitë për zhvillimin e vendit që kanë donatorët shumëpalësh (si BB, UN etj) apo dypalësh (si SIDA, SDC, Gjermania, Italia etj). Duke qenë në sintoni me proceset planifikuese edhe me Bashkimin Evropian, që ne synojmë të anëtarësohemi, SKZHI përfshin një hark kohor 10 vjeçar, ku 7 vjet është edhe cikli planifikues i politikave të vetë BE-së, ndërkohë që deri në 2030 është edhe harku kohor i zbatimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Me miratimin e VKM-së 642, datë 29.10.2021, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës”, koordinimi i procesit të programimit dhe monitorimit të asistencës IPA kryhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (KKIPA). KKIPA dhe ZM KKIPA kanë të njëjtat detyra dhe përgjegjësi siç kërkohet në Marrëveshjen Kuadër të BE-së ndërmjet KE – Shqipëri.

Në përputhje me VKM e mësipërme, Drejtoria e përkohshme të Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale IPA dhe Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial do të jenë pjesë integrale e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës. Gjatë muajit Nëntor 2021 e vijim duhet të kryhet procesi i ristrukturimit dhe transferimit të funksioneve nga institucionet përgjegjëse aktuale në Agjencinë e re të krijuar, duke synuar plotësimin me staf të të gjithë pozicioneve të miratuara në strukturën e Agjencisë.

Zyrtari Kombëtar Autorizues (Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë) mban përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të asistencës IPA në Shqipëri duke siguruar

ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve sipas IPA I dhe IPA II. ZKA-ja mbështetet nga strukturat drejtuese, të cilat përbëhen nga Fondi Kombëtar dhe Drejtoria për Mbështetjen e ZKA/NAO. Të dyja këto janë struktura të veçanta brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat përgjigjen tek NAO/ZKA për funksionimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar të zbatimit indirekt të Programeve IPA-IPARD në Shqipëri.

Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës e Akredituar nga BE u krijua me Ligjin Nr. 90/2016, datë 15.09.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit për Programet e Asistencës të akredituar nga BE në Republikën e Shqipërisë”. Agjencia ka si objekt të veprimtarisë auditimin për sistemet e menaxhimit dhe kontrollit për veprimet, transaksionet dhe llogaritë vjetore të mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian.

Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s ka finalizuar procedurat e brendshme për miratimin në parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian, në lidhje me Programin Vjetor Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II). Paketa financiare është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 157, datë 17 mars 2021, si dhe është nënshkruar nga KKIPA me datë 12 prill 2021, duke i hapur rrugë zbatimit të programit. Kosto totale për këtë Program është 105,42,991 Euro. Për shkak të zgjedhjeve dhe shpërbërjes së Parlamentit të mëparshëm, nuk u gjet koha e duhur për ratifikimin e kësaj Marrëveshje nga ana e Parlamentit. Procesi i ratifikimit nga parlamenti i projektligjit pritet të përfundojë brenda muajit dhjetor 2021.

Për sa i përket programimit të instrumentit financiar IPA III, gjatë tremujorit të dytë u realizua procesi i konsultimit publik mbi draft dokumentin e Përgjigjes Strategjike Kombëtare për IPA III, duke u bazuar në ligjin Ligjin 146/2014 “Për Konsultimin Publik”, Urdhrin e Këshillit të Ministrave nr. 3 datë 29.01.2021 për Konsultimin Publik, si dhe Kodin Evropian të Sjelljes në Partneritet.



Në përfundim të konsultimit, u hartua një raport përmbledhës, në të cilin është dhënë informacion lidhur me aktivitetet e konsultimit, palët e interesit të përfshira, si dhe komentet lidhur me Përgjigjen Strategjike Kombëtare. Ky raport është botuar në regjistrin elektronik në muajin Korrik 2021. Dokumenti i Përgjigjes Strategjike Kombëtare për IPA III është në fazën e finalizimit, pas reflektimit të komenteve të grupeve të interesit, donatorëve, DBE-së dhe komenteve të Komisionit Evropian, të cilat i janë përcjellë KKIPA-s në fund të korrikut.

Në fund të korrikut 2021, Komisioni Evropian i dorëzoi KKIPA-s paketën e propozuar të programeve që do të përfitojnë nga asistenca IPA III:

- BE për Drejtësinë – 8 mln EUR – Përfituese Ministria e Drejtësisë;
- BE për të Drejtat e Pronësisë – 10 mln EUR – Përfituese Kryeministria dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- BE për Natyrën/SPIN – 6 mln EUR – Përfituese Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- BE për Ekonominë Qarkulluese – 30.9 mln EUR - Përfituese Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- BE për Inovacionin (faza e dytë) – 10 mln EUR- Përfituese Ministria e Financës dhe Ekonomisë.

KKIPA u njoftua nga Komisioni Evropian se në fund të vitit 2021, ose fillim 2022, gjatë Komitetit IPA pritet të merret vendimi përfundimtar mbi miratimin e paketës IPA për vitin 2021.

Duke filluar nga muaji mars 2022, institucionet përfituese, nën koordinimin e KKIPA/ ZM KKIPA kanë punuar për të përgatitur 9 draft dokumentash veprimi për paketën programuese për IPA 2022. Paketa u finalizua dhe u përcoll pranë Komisionit Evropian në datën 16 nëntor 2021, sipas afatit të përcaktuar më parë.

Lista e Vetme e Projekteve Kombëtare (NSPP) 2020 u miratua më 30 Korrik 2020 nga Këshilli Kombëtar i Investimeve (NIC) / Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), që është organi vendimmarrës, i kryesuar nga Kryeministri. Ndërkohë është në proces përgatitja e metodologjisë së NSPP-së për standartizimin, formatet dhe procedurat duke synuar përmirësimin e përgjithshëm të përgatitjes së listës së vetme

sektoriale dhe të Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP) dhe cilësinë e paketave të dokumenteve të kësaj liste. Rritja e cilësisë së kësaj liste dhe prioritizimit dhe përgatitjes së projekteve i përgjigjet rëndësisë në rritje të Instrumentit të Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Sikurse specifikuar edhe në Strategjinë e BE-së të Zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, të datës 6 shkurt 2018, Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) do të jetë gjithmonë e më tepër instrumenti kryesor për investimet në rajon. Në këtë kuadër, WBIF po zhvillohet dhe pëson ndryshime (WBIF 3.0) në mënyrë që të përshtatet edhe me perspektivën e re financiare 2021 – 2027 si dhe me IPA III.

Nëpërmjet hartimit dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Investimeve (NIC)/Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) më 15 Korrik 2020 i Deklaratës së Politikave Prioritare 2021 – 2023 është siguruar lidhja e Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP) me Planin e Buxhetit Afatmesëm (PBA).

Monitorimi i asistencës IPA realizohet nga Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare (zyra mbështetëse e KKIPA), e cila në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian monitoron implementimin e projekteve/programeve nën menaxhim direkt dhe indirekt, progresin drejt arritjes së objektivave dhe rezultateve të synuara, sigurimin e qëndrueshmërisë së investimeve IPA në Shqipëri, etj.

Për kryerjen e funksionit të Monitorimit, strukturat përkatëse mbështeten në Marrëveshjen Kuadër dhe legjislacionin vendas për implementimin e fondeve të BE-së IPA I (2007 – 2013), IPA II (2014 – 2020) dhe IPA III (2021 – 2027), marrëveshjet ndërinstitucionale të zbatimit dhe manualët e procedurave. Manualët e procedurave të Zyrës Mbështetëse të KKIPA për Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin rishikohen/përditësohen çdo vit.

Gjatë vitit 2021, procesi i Monitorimit dhe Vlerësimit të fondeve IPA, përfshirë mbledhjet, konsultimet dhe trajnimet u realizuan në sesione online, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19. Roundi i parë i mbledhjeve të Komiteteve Sektoriale të Monitorimit u anulua për shkak të zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në Prill 2021, ndërsa roundi i dytë është parashikuar të zhvillohet gjatë



muajit Nëntor 2021, në sesione online. Gjithashtu, Komiteti i Monitorimit të IPA për vitin 2021 është parashkuar të zhvillohet në Dhjetor 2021.

Megjithatë, Shqipëria synon të forcojë më tej kapacitetet e saj lidhur me menaxhimin e IPA-s si pjesë e përgatitjeve për anëtarësimin në BE. Kjo është në përputhje me rekomandimin e Raportit të KE-së të vitit 2020 për Shqipërinë që bëri thirrje për forcimin e kapaciteteve administrative, veçanërisht të Njësisë Qendrore të Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU) të Ministrisë së Financave, Zyrës për Mbështetje të Zyrtarëve Kombëtar të Autorizuar dhe Autoritetit të Auditimit dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në kuadër të Bashkëpunimit Territorial, Shqipëria merr pjesë në 8 Programe Ndërkufitare dhe Transnacionale nën perspektivën IPA II 2014 – 2020, koordinimi dhe zbatimi i të cilave kryhet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe konkretisht Struktura Operuese në Drejtorinë e Bashkëpunimit Territorial. Në këtë aspekt janë ngritur dhe funksionojnë të gjitha strukturat e përfshira në zbatimin e Programeve të Bashkëpunimit Territorial, si: zyrat e Kontrollit të Nivelit të Parë (FLC), Sekretariatet e Përbashkëta, Antenat, Pikat e Informimit, etj. Drejtuesi i Strukturës Operuese është caktuar me urdhrin e Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme/ nr. 366, datë 29.07.2021.

Gjithashtu, MEPJ ka ndjekur procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të financimit (alokimet përkatëse vjetore) për programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar, konkretisht: Programi IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri, Programi IPA CBC Maqedoni e Veriut – Shqipëri dhe Programi IPA CBC Shqipëri – Kosovë.

Gjatë vitit 2021 janë shpallur disa thirrje për projekt propozime ku vihet re një numër i lartë i aplikantëve nga Shqipëria, çka tregon një rritje të interesit nga ana e tyre për të përfituar nga fondet e BE-së. Sfidat kryesore në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e institucioneve dhe organizatave shqiptare mbetet rimbursimi i kostove të TVSH-së dhe sigurimi i kuotës së bashkëfinancimit (15% e vlerës së projektit).

Gjatë kësaj periudhe, ka vijuar procesi për përgatitjen dhe hartimin e programeve të reja të bashkëpunimit territorial për Perspektivën e III të

Instrumentit të Para-Anëtarësimit IPA. Strukturat Operuese në bashkëpunim të ngushtë me strukturat homologe, të vendeve fqinje, po koordinojnë procedurat për hartimin e programeve të reja IPA III.

Gjithashtu, Shqipëria ka intensifikuar pjesëmarrjen e saj në Strategjinë e BE për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR), duke kontribuar në zbatimin e saj, sidomos në kuadër të identifikimit të masave dhe projekt-ideve me karakter rajonal.

Në kuadër të prioritizimit të politikave afatmesme, si një fazë parapërgatitore për SKZHI 2030, është përgatitur dhe miratuar Dokumenti i Politikave Prioritare 2022 – 2024, i cili siguron edhe buxhetimin e prioriteteve dhe përcaktimin e tavanëve të PBA-së në terma afatmesëm. Dokumenti i Politikave Prioritare hartohet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike edhe VKM Nr. 185, datë 29.3.2019 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) përgatitet nga Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, në Kryeministri, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me qëllim ndikimin në procesin e shpërndarjes së burimeve midis sektorëve. Për vitin 2021, DPP është diskutuar nga Komiteti i Planifikimit Strategjik, kryesuar nga Kryeministri, në fazën e diskutimit të prioriteteve strategjike të buxhetit në shkurt dhe në korrik dhe është miratuar në mbledhjen e KPS në mars 2020.

Analiza e Dokumentit mbi Politikat Prioritare bazohet në analizën e kryer mbi:

- prioritete e përcaktuara në dokumentet e kuadrit strategjik të vendit për sektorët/politikat, të miratuara me VKM;
- prioritetet e përcaktuara nga ministrinë e linjës dhe Kryeministrin, të bazuara në Programin e Qeverisë;
- si edhe projektet prioritare strategjike të ministrive të linjës, pjesë e Paketës Kombëtare e Projekteve Strategjike (PKPS), miratuar në Komitetin e Planifikimit Strategjik.

Dokumentet e Politikave Prioritare (DPP) përbën një fazë të ndërmjetme përpara përcaktimit të tavanëve buxhetore për Planifikimin Buxhetor Afatmesëm, si edhe për përgatitjen e draftit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030. Procesi për përgatitjen e SKZHI



2021 – 2030 bazohet në parimin e funksionimit të plotë të gjithë mekanizmave dhe proceseve aktuale të lidhura me Sistemin e Planifikimit të Integruar.

Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin u miratua në Korrik 2020 (Ligji nr. 102/2020). Ky ligj përcakton parimet bazë, objektivat, përgjegjësitë, rregullat e zhvillimit rajonal dhe kohezionit, si dhe kuadrin institucional e strategjik të këtij zhvillimi në Republikën e Shqipërisë. Sipas këtij ligji, zhvillimi rajonal zbatohet në përputhje me parimin e partneritetit, subsidiaritetit, qëndrueshmërisë, planifikimit, programimit, transparencës, përqendrimit dhe koordinimit. Ligji për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin synon:

a) Të përcaktojë instrumentet e posaçme dhe kuadrin institucional e financiar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin në Republikën e Shqipërisë;

b) Të përcaktojë kuadrin strategjik dhe institucional të hartimit të politikave afatgjata zhvillimore rajonale në zbatim të politikave kombëtare, duke siguruar nxitjen e zhvillimit të balancuar ekonomik, shoqëror e kulturor rajonal;

c) Të sigurojë që autoritetet politikëbërëse të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre planifikuese për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të rajoneve;

d) Të sigurojë harmonizimin e strategjive sektoriale në një politikë të përbashkët zhvillimore rajonale, duke e mbështetur atë edhe me buxhetin përkatës.

Fondi Shqiptar i zhvillimit, bazuar në përgjegjësinë e deleguar nga zyra e Zv. Kryeministrit është duke punuar mbi përfundimin e akteve nënligjore që do të bëjnë të mundur implementimin e Ligjit mbi Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin.

Janë identifikuar 10 akte nënligjore të cilat derivojnë nga ligji mbi definimin e rajoneve të zhvillimit, ai i ngritjes së bordeve të monitorimit dhe Komitetit Kombëtar, procedurave të programimit dhe planifikimit, strukturës dhe përmbajtjes, konsolidimi i autoritetit menaxhues, organizmat e ndërmjetëm, mekanizmat financues databaza etj.

Në këtë kontekst nga Dhjetori 2020 deri në Prill 2021 Qeveria e Shqipërisë përfaqesuar nga Zv. Kryeministri i Shqipërisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit mbajtën një cikël prej 26 takimesh dhe

konsultimesh me publikun në 12 Rajone të lokalizuar në 4 Rajonet e Zhvillimit.

Përgjatë këtyre takimeve 5 akte nënligjore janë konsultuar dhe diskutuar duke sjellë në përgatitjen e draftve të VKM-ve nga FSHZH me suportin dhe asistencën teknike të qeverisë Zviceriane dhe Austriake nëpërmjet Programit të Zhvillimit Rajonal në Shqipëri.

Akti i parë nënligjor “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin” është aprovuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 459, 30.7.2021.

Ndërkohë janë përgatitur 4 draft VKM të tjera të cilat vijojnë si më poshte:

1. Draft- Politikat për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

2. Draft- VKM për Komitetin Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin

3. Draft- VKM për Bordet e Monitorimit të Zhvillimit Rajonal dhe Kohezionit

4. Draft- VKM mbi Strukturat dhe Procedurat për hartimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe kohezionin dhe hartimin e Planeve Rajonale për Zhvillimin Kombëtar dhe Kohezionin.

Këto drafte janë finalizuar dhe një konsultim publik zyrtar është iniciuar. Për shkak të vonesave shkaktuar nga situata e COVID-19, raundi i dytë i procesit të konsultimit për këto akte nënligjore pritet të përfundojë në fundin e Dhjetorit 2021. Parashikohet se procesi i aprovimit të 4 akteve nënligjore të lartpërmendura do të përfundojë në tremujorin e parë të 2022.

Nga Dhjetori i 2020 në Prill të 2021 një cikël prej 26 takimesh/konsultash publike janë organizuar në 12 rajone të cilat bëjnë pjesë në 4 Rajonet e Zhvillimit të vendit. Ky proces u orientua nëpërmjet qasjes “Informo- Komunikoh- Degjo-Reflekto” për të adresuar nevojat lokale dhe rajonale për zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë nëpërmjet një sistemi që mundëson implemetimin e Politikave për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin. Përgjatë këtij cikli me 26 takime, 183 aktorë institucionalë dhe jo-institucionalë kanë qenë pjesëmarrës në diskutimet mbi reformën e zhvillimit rajonal, objektivat e politikave, nevojat dhe sfidat e komuniteteve në nivel lokal dhe rajonal drejt zhvillimit rajonal dhe kohezionit.



Pjesëmarrësit në diskutimet e tyre u fokusuan në 2 drejtime kryesore:

1. Nevojat dhe mekanizmat për implementimin dhe si Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal do të adresojë këto nevoja. Ndërhyrjet Infrastrukturore (kryesisht infrastrukturë rrugore, ujësjellëse dhe elektricitet) janë identifikuar si nevoja kryesore për investim në të gjitha rajonet përkrah ngritjes së kapaciteteve për projektimin e ndërhyrjeve duke përfshirë përgatitjen e studimeve të fizibilitetit.

2. Diskutimet konkrete dhe propozimet për përmirësimin e akteve nënligjore u orientuar mbi tema si ngritja e Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin dhe Bordet e Monitorimit, forma, organizimi dhe funksionimi i tyre dhe përfaqësimi më i mirë i tyre. Këto propozime janë konsideruar dhe reflektuar në dokumentet reflektuese respektive.

Në diskutimin mbi Bordet e Monitorimit, kryebashkiakët shprehën interesin e tyre në të paturit një rol aktiv duke vënë në dukje nevojën për bashkëpunim me aktorë të tjerë (jo-institucionalë) në kuadrin e zhvillimit. Aktorët jo-institucionalë shfaqën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar dhe për të dhënë kontributin e tyre në proces nëpërmjet pjesëmarrjes në takime të ardhshme me të njëjtin focus. Gjithashtu shprehën nevojën për tu përfaqësuar në Bordet e Monitorimit, ku pesha e votës së tyre dhe vendimarrja të kenë të njëjtën peshë me aktorët e tjerë pjesëmarrës në Bord.

Ligji mbi Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin dhe nën aktet ligjore pjesë e këtij ligji adresojnë në mënyrë të qartë përgjegjësitë e të gjitha institucioneve të përfshira në këtë proces. Suporti i autoriteteve shqiptare për Zhvillimin Rajonal është qartaz jo vetëm teknik dhe ligjor por gjithashtu financiar. Qeveria Shqiptare ka definuar qartë mënyrat dhe burimet e financimit për Programin Operacional me një jetëgjatësi prej 7-vitesh. Përfshirja e institucioneve ndërkombëtare dhe e vendeve partnere është një garanci për qëndrueshmërinë e kësaj iniciative.

I gjithë procesi dhe mënyra e parashikimit të mbarëvajtjes dhe aprovimit të Programit për Zhvillimin Rajonal do të sigurojë një qasje të barabartë, të drejtë, të paanshme. Të njëjtat parime do të ndiqen në procesin e implementimit. Ligji në vetvete vendos parimet mbi të cilat sistemi i ngitur për Zhvillimin Rajonal do të bazohet.

Parimet që Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), aktualisht po aplikon në procesin e programimit kanë në thelb koordinimin dhe integrimin e programeve të ndryshme të cilat të kombinuara me njëra-tjetrën reflektojnë arsyetimin: $1+1=3$. Thënë qartë programet kombinohen në një mënyrë e cila maksimizon impaktin në territor duke integruar ndërhyrje të ndryshme dhe burime të ndryshme financimi për të arritur rezultate dhe efekte maksimale.

FSHZH është duke menaxhuar programe të ndryshme financuar nga buxheti i shtetit, hua dhe grante. Buxheti i shtetit për infrastrukturën rajonale dhe lokale përdoret për bashkë-financimin e disa programeve zhvillimi në territor deri në masën 10%. Aktualisht, në kuadër të programit financiar nga qeveria Austriake dhe Zviceriane janë publikuar dy thirrje për aplikime ku financimi realizohet në masën 85% nëpërmjet grantit dhe 15% nëpërmjet bashkë-financimit dhe bashkive përkatëse. Këto nisma konsiderohen si skema pilote për t'u kapitalizuar dhe replikuar përgjatë përgatitjes dhe implementimit të Programit Operacional për Zhvillimin Rajonal.

Bazuar në VKM nr. 185, datë 29.3.2018 “Për procedurat e administrimit të investimeve publike” dhe VKM nr. 52, datë 6.2.2019 “Për miratimin e kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2019”, Komiteti i Planifikimit Strategjik / Këshilli Kombëtar i Investimeve miratoi në 15 Korrik 2020, Deklaratën e Politikave Prioritare (DPP) 2021–2023, e cila përfshin projektet strategjike, pjesë e Listës së Vetme të Projekteve Kombëtare (NSPP), që do të jënë pjesë e Buxhetit të vitit 2020 dhe Planin Buxhetor Afatmesëm 2021 – 2023 (PBA). Deklarata e Politikave Prioritare (DPP) 2021–2023, do të rishikohet çdo vit në të njëjtën linjë me procedurën e hartimit të PBA-së.

Shtatë Komitete të Monitorimit Sektorial, të ngritura për herë të parë në vitin 2019, janë tashmë plotësisht funksionale, me takime të organizuara sipas sektorëve përkatës, dy herë në vit.

Për herë të parë në 2019, filluan përgatitjet për kryerjen e një Vlerësimi të zbatimit të projekteve gjatë fazës së implementimit të tyre (Interim Evaluation). Ushtrimi i Vlerësimit filloi në 2020 dhe dorëzoi raportin përfundimtar të vlerësimit “Qëndrueshmëria e projekteve të financuara nga BE-ja në Shqipëri” në Shkurt 2021, i cili ju



shpërnda insitucioneve të përfshira për ndjekje të mëtejshme.

Gjithashtu, në muajin Prill 2021 ka nisur punën programi i vlerësimit “Vlerësimi i veprimeve nën Menaxhimin Indirekt me Vendin Përfitues për IPA –II”. Raporti paraprak i vlerësimit u dorëzua në Shtator 2021, i cili u është shpërndarë institucioneve të përfshira për komente, përpara dorëzimit të raportit përfundimtar.

Në lidhje me bashkëpunimin territorial, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme vijon me procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse të financimit (alokimet përkatëse vjetore) për programet IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar si: IPA BNK Shqipëri – Kosovë, IPA BNK Maqedoni e Veriut – Shqipëri, IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.

Gjatë vitit 2021 janë shpallur disa thirrje për projekt propozime ku ka vijuar numri në rritje i aplikantëve shqiptarë, çka tregon një rritje e interesit nga ana e tyre për të përfutur nga fondet e BE-së.

Sfida kryesore në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar nga ana e institucioneve dhe organizatave shqiptare akoma mbetet rimbursimi i kostove të TVSH-së dhe sigurimi i kuotës së bashkëfinancimit (15% e vlerës së projektit). Në fund të vitit 2019, u amendua legjislacioni për rimbursimin e TVSH-së me qëllim lehtësimin e procesit të rimbursimit (kryesisht për OJQ-të) por është ende herët të vlerësohet nëse kjo ndërhyrje mund të konsiderohet e suksesshme. Në lidhje me sigurimin e bashkëfinancimit, pavarësisht përpjekjeve gjatë vitit 2020 për ngritjen e një fondi të dedikuar (Fondit Kombëtar), problematika ka ende nevojë për adresim. Në nivel Ministrie, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është përpjekur vazhdimisht të adresojë këtë problematikë por zgjidhja e kësaj shtate është jashtë kompetencave dhe autoritetit të MEPJ. Çështja e bashkëfinancimit nuk lidhet vetëm me mungesën e një Fondi të dedikuar Kombëtar por edhe me papërgjegjshmërinë e disa përfutuesve të cilët nuk parashikojnë fondin e bashkëfinancimit në projekt buxhetin afatmesëm, siç kërkohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Në kuadër të procesit për përgatitjen e programeve të reja të Bashkëpunimit Territorial për Perspektivën e III-të të Instrumentit të Para-Aderimit IPA, Drejtoria e Bashkëpunimit

Territorial të MEPJ, në rolin e strukturës operuese dhe koordinuese të këtij procesi, ka finalizuar ngritjen e Task Forcës (TF) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtare respektivisht për programet IPA bilaterale dhe ato transnacionale, si një ndër hapat kryesor të programimit për periudhën 2021 – 2027.

Këto Task Forca, në rastin e programeve bilaterale IPA BNK, përbëhen nga përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrive të linjës, AMSHC-së dhe Këshillave të Qarqeve të zonave aktuale të secilit program bilateral ku vendi ynë merr pjesë. Gjithashtu është ngritur Task Forca e programeve transnacionale dhe atij trilateral, të përbëra nga anëtarët e secilit vend partner të këtyre programeve dhe nga pala shqiptare, nga zyrtarët e programit specifik si dhe përgjegjësi i sektorit të programimit, të Drejtorisë së Bashkëpunimit Territorial të MEPJ, të cilët koordinojnë këto programe në nivelin kombëtar. Në këtë kontekst, janë organizuar një sërë takimesh me grupet e TF me qëllimin kryesor, ndër të tjera, për të identifikuar prioritetet, në bazë të nevojave më relevante për vendin tonë dhe në bazë të rekomandimeve të Komisionit Evropian, gjithashtu edhe në bazë të shtrirjes gjeografike. Brenda vitit 2021, programet e reja bilaterale 2021 – 2027 janë hartuar dhe dërguar pranë komisionit Evropian për të marrë miratimin përfundimtar, i cili pritet të jetë në fund të vitit 2021, ose në fillim të vitit 2022. Në vijim, për shkak të kompleksitetit dhe arkitekturës së programeve Ndërkombëtarë dhe Ndër-rajonale, procesi i hartimit të dokumentit për secilin program vijon me intensitet të lartë, duke realizuar një sërë takimesh të taskforcave të përbashkëta, e gjithashtu edhe në nivele teknike për specifika të ndryshme, si: planifikimi i alokimeve, mekanizmat zbatues, përgjegjësitë e strukturave, formatet dhe planifikimi i thirrjeve të ndryshme për projekte më karakter qeverisës, strategjik, shkallë të lartë dhe të ulët, etj. në të ardhmen për përshtatjen dhe zbatimin me efikasitet të programit.

Procesi i programimit merr një rëndësi të veçantë për programimin e IPA BNK Shqipëri – Kosovë, ku Shqipëria është vendi lider (programi i vetëm ku vendi ynë ka rolin e liderit). Dokumenti i programit është përgatitur në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Tiranë, si dhe dy strukturat operuese të këtij programi IPA BNK, si dhe me asistencën e ekspertëve të kontraktuar nga Komisioni Evropian për këtë qëllim.



4.22.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Ministria e Evropës dhe Punëve të Jashtme;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- INSTAT;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Agjencia e Auditimit për Programet e Ndihmës së Akredituar në BE.

4.22.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Prioritetet në Kapitullin 22 janë në përputhje me rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Evropian siç janë paraqitur në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2021 për Shqipërinë. Këto prioritate janë:

- Të përgatisë zbatimin efektiv të *acquis* së kapitullit 22 sipas kërkesave dhe faktorëve të fondeve të ardhshme strukturore/kohezionit në strukturën institucionale, sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kapacitetet administrative, duke siguruar që të gjitha instrumentet dhe fondet të bëhen gradualisht në përputhje me kërkesat e BE-së, bazuar në parimet e programimit dhe partneritetit. Duke pasur parasysh këtë, koordinimi ndërmjet agjencive për asistencën e para-aderimit ka nevojë për përmirësim dhe çështjet duhet të adresohen në lidhje me planifikimin strategjik, zbatimin dhe monitorimin e kapaciteteve të projekteve infrastrukturore sipas planit ekonomik të investimeve;

- Të vazhdohet me hartimin e strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal (2021 – 2027) dhe të plotësohen planet e zhvillimit rajonal (2021 – 2024), të cilat duhet të nxisin potencialin e zhvillimit të të gjithë rajoneve në Shqipëri, me qëllim që t'u ofrohet atyre mundësi për t'u zhvilluar si dhe për të vazhduar me ndërhyrje të decentralizuara, bazuar në planet dhe strategjitë e integruara lokale dhe / ose rajonale;

- Të forcohet më tej kapaciteti administrativ i organeve qendrore, rajonale dhe lokale, veçanërisht në nivel qendror sidomos në Njësinë Qendrore të Financave dhe Kontraktimit (CFCU), në zyrën Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues, Autoritetit të Auditimit

dhe Zyrës Mbështetëse të Koordinatorit Kombëtar të fondeve IPA, në të vecanti duke siguruar personel adekuat;

KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE

4.23.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 23 është një kapitull thelbësor në procesin e stabilizim asociimit dhe mbart një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme, sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore.

Më konkretisht, Politikat e BE-së në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej Bashkimin Evropian si një fushë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Vendosja e themeleve për një gjyqësor të pavarur dhe efikas mbart rëndësi të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe standardi i lartë i gjykimit nga ana e gjykatave janë thelbësore për respektimin e sundimit të ligjit. Me qëllim realizimin e këtij objekti, kërkohet angazhim i fortë për shmangien e çdo ndikimi të jashtëm, si dhe për t'i përkushtuar burime të mjaftueshme financiare dhe rritje kapacitetesh. Me rëndësi të veçantë janë dhe krijimi i garancive ligjore për procedurat e një gjykimi të drejtë. Po kështu, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive, pasi kjo paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Një kuadër i fortë ligjor dhe institucione të besueshme janë të nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin e korrupsionit. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë respektin për të drejtat themelore dhe të drejtat e qytetarëve të BE-së, siç garantohet nga *acquis* dhe nga Karta e të Drejtave Themelore.⁴⁷

Këto parime janë përkthyer në një kuadër ligjor të Bashkimit Evropian që përcakton të drejtat dhe detyrimet e Shteteve Anëtare të tij dhe gjithashtu të atyre vendeve candidate që synojnë të jenë shtete anëtare të BE-së. Prandaj është e domosdoshme për secilin vend kandidat që synon të bëhet një shtet anëtar i BE-së për të njohur dhe përafruar *acquis* e BE-së që mbulon Kapitullin 23.

⁴⁷ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en



Përveç kësaj, Shtetet Anëtare duhet të luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive pasi paraqet një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe për sundimin e ligjit. Neni 83 (1) i TFBE përcakton kompetencën e BE-së për të hartuar rregulla minimale në lidhje me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e korrupsionit. Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave themelore është i domosdoshëm. Sipas nenit 6 të TBE-së dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), BE respekton të drejtat themelore, të garantuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian siç rezulton nga traditat kushtetuese të përbashkëta për Shtetet Anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës së BE-së. Kështu, ato janë të detyrueshme për institucionet e Bashkimit në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe për Shtetet Anëtare kur zbatojnë të drejtën e BE-së (neni 51 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian).

4.23.2 Struktura e kapitullit

Tre shtyllat kryesore për reformat në këtë kapitull janë:

1. Sistemi Gjyqësor;
2. Lufta kundër korrupsionit;
3. Përmirësimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore.

Të tre këto shtylla janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të ndërsjelltë me njëra tjetrën.

4.23.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Përafrimi i parimeve dhe *acquis* së BE-së për kapitullin 23 përbëjnë një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri. Në veçanti, nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së janë të një rëndësie thelbësore për këtë kapitull. Sipas nenit 78 të MSA-së, një rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet forcimit të sundimit të ligjit dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si dhe të zbatimit të ligjit dhe administrimit të drejtësisë. Përveç kësaj, neni 78 i MSA-së përcakton se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efektivitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të organeve të policisë dhe të zbatimit të ligjit duke siguruar trajnime të përshtatshme si dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Gjithashtu, përafrimi me *acquis* dhe standardet e BE-së për kapitullin 23 është një nga kërkesat që vendi kandidat në BE duhet të zbatojë gjatë procesit të negociatave për aderim në BE.

Lidhur me përafrimin e legjislacionit të BE në legjislacionin e brendshëm, duhet theksuar se *acquis* i transpozueshëm ndahet në “hard *acquis*” (*acquis* që buron nga aktet me efekt detyrues siç janë traktatet, direktivat, rregulloret etj. të BE-së) dhe “soft *acquis*” (*acquis* që buron nga standardet, parimet e rekomandimet e institucioneve të BE-së apo organizatave të tjera ndërkombëtare relevante). Analiza paraprake ka vlerësuar totalin e “hard *acquis*”, i cili përbëhet nga 61 akte, ndërsa “soft *acquis*” përbëhet nga 65 akte⁴⁸.

4.23.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021, Shqipëria ka arritur një nivel të caktuar përgatitjeje/është e përgatitur në mënyrë të moderuar për zbatimin e *acquis* së BE-së dhe standardeve evropiane në këtë fushë. Suksesi i mirë është arritur përmes zbatimit të reformës në drejtësi. Gjykata Kushtetuese ka rifituar funksionalitetin e plotë me emërimin e gjyqtarëve të rinj. Gjykata e Lartë ka rritur efikasitetin e saj me emërimin e gjashtë gjyqtarëve të rinj. Procesi i vetting-ut ka vijuar të japë rezultate të prekshme. Kuadri ligjor ka vijuar të fuqizohet duke siguruar një drejtësi më efikase. Përpjekjet operationale kundër korrupsionit po sjellin rezultate. Nevojiten përpjekje shtesë për të rritur sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve që vijnë nga korrupsioni dhe për të pasur rezultate në çështjet e nivelit të lartë. Në lidhje me të drejtat themelore, ka pasur progres në shumicën e fushave, megjithatë duhet të vijojnë përpjekjet për zbatimin. Në lidhje me të drejtat për pronën, duhet të bëhet më shumë progres në regjistrimin e parë të pronave dhe në proceset e pronësisë kalimtare, në një mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Reforma në Drejtësi

⁴⁸ Pas një analize të përgjithshme të nivelit të harmonizimit për Kapitullin 23, ku janë hartuar 39 draft ToCs me 2374 faqe, duke përfshirë krahasimin me rreth 60 akte ligjore dhe nënligjore kombëtare rezulton se 66% e akteve janë pjesërisht të harmonizuara, 25% nuk janë harmonizuara dhe 9% është vlerësuar si jo relevante për harmonizim në këtë moment.



Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2021, Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për funksionimin e gjyqësorit. Është bërë progres i mirë, me zbatimin e vazhduar të reformës në drejtësi dhe procesin e vetting-ut, që ka avancuar në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht impaktit të pandemisë së COVID-19. Një arritje e rëndësishme u shënuar në fund të vitit 2020, me emërimin e tre gjyqtarëve të rinj në Gjykatën Kushtetuese. Me shtatë gjyqtarë në detyrë, Gjykata Kushtetuese rifitoi kuorumin e saj të nevojshëm me minimumin prej gjashtë anëtarësh për të zhvilluar seancat plenare, duke u bërë në këtë mënyrë plotësisht operacionale dhe duke përmbushur kushtin e rëndësishëm për Konferencën e parë Ndërkombëtare. Progresi ka vijuar edhe me emërimet në Gjykatën e Lartë, me ngritjen në detyrë të gjashtë gjyqtarëve të rinj në mars dhe në korrik 2021, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Parlamenti miratoi ndryshimet në dhjetë ligje me synimin për të fuqizuar më tej efikasitetin e sistemit gjyqësor dhe kapacitetin e tij për të trajtuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Procesi i vetting-ut ka vijuar me dhënien e rezultateve konkrete, nën mbikëqyrjen e kujdesshme të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Deri më sot, 62% e dosjeve të vetting-ut të trajtuara kanë rezultuar në shkarkime nga puna, ose dorëheqje. Magjistratët e shkarkuar nga detyra nga organet e vetting-ut po ndiqen penalisht nga Prokuroria e Posaçme. Gjykata e SPAK ka sekuestruar asetet e një ish-prokurori të përgjithshëm dhe të dy ish-gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të një ish-gjyqtari të Gjykatës së Lartë. Organet e vetëqeverisjes së gjyqësorit kanë vijuar të përmbushin mandatet e tyre.

Rivlerësimi kalimtar i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting-u) ka avancuar në mënyrë të qëndrueshme dhe ka dhënë rezultate të prekshme.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), për periudhën 1 janar – 5 nëntor 2021 ka dhënë 144 vendime, nga të cilat 50 vendime konfirmimi në detyrë, 61 vendime për shkarkim nga detyra, 24 vendime për ndërprerje procesi, 8 vendime për përfundim procesi dhe 1 vendim pezullim nga detyra për një vit dhe detyrimin për ndjekjen e trajnimit për një periudhë një vjeçare pranë Shkollës së Magjistraturës.

Koleji i Posaçëm i Apelit (KPA), vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit

të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik, ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në total, që nga fillimi i procesit të Vetting-ut janë marrë gjithsej 120 vendime juridiksioni rivlerësimi nga KPA.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, gjatë periudhës janar – 31 tetor 2021, ka shqyrtuar gjithsej 131 vendime dhe 13 prej tyre janë në proces shqyrtimi sipas afateve ligjore. Për 131 vendimet e shqyrtuara, Komisionerët Publikë kanë vendosur të ankimojnë 13 vendime në Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe për 118 vendime të KPK-së kanë vendosur të mos ushtrojnë ankim.

Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, gjatë periudhës janar – 31 tetor 2021, u ka paraqitur Komisionerëve Publikë 8 rekomandime me shkrim, për të ushtruar ankim. Në regjistrin e denoncimeve të publikut, për periudhën janar – 31 tetor 2021, janë regjistruar 172 denoncime.

Institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë

Institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë kanë vijuar të jenë plotësisht funksionale dhe kanë operuar me efikasitet të plotë. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) për periudhën 1 janar 2021 – 30 nëntor 2021, ka marrë 522 vendime në 86 mbledhje plenare. Vendimarrja ka qenë e fokusuar në miratimin e akteve nënligjore, akteve kolektive administrative dhe atyre me karakter individual. Kjo punë voluminoze ka synuar të trajtojë prioritetet dhe problematikën më urgjente të sistemit gjyqësor si dhe objektivat strategjike të përcaktuar në Planin Strategjik të KLGJ. Aktualisht KLGJ është në fazën përfundimtare të miratimit të një plani të ri strategjik për sistemin gjyqësor, për periudhën 2022 – 2024, plan i cili, i bazuar në rezultatet e planit të mëparshëm 2019 – 2020, do të formësojë të ardhmen e gjyqësorit në funksion të një reforme gjithëpërfshirëse. Këshilli i Lartë i Prokurorisë nga ana e tij ka marrë gjithsej 388 vendime.

Anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së

Në dhjetor të vitit 2021, 5 anëtarëve të KLGJ-së (3 prej radhëve të gjyqësorit dhe 2 anëtarë jo gjyqtar) u mbaron mandati. Për pasojë, Këshilli në bashkëpunim me Gjykatën e Lartë kanë iniciuar hapjen e procedurës për aplikime të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në përfundim të procedurës së votimit, Mbledhja e



Përgjithshme e Gjyqtarëve, zgjodhi tre anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfaqësues nga të treja shkallët e gjyqësorit. Dy anëtarët e tjerë, jo-gjyqtarë, pritet të zgjidhen së shpejti nga Kuvendi.

Gjatë vitit 2021, janë zgjedhur 5 anëtarët e rinj të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e prokurorëve të të gjitha niveleve. Më datë 28.01.2021, në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve, u përzgjedhën dy anëtarët e rinj të KLP, kurse në Mbledhjen e Përgjithshme të Prokurorëve më datë 15.10.2021, u përzgjedhën dhe tre anëtarët e rinj të Këshillit, për shkak se tre anëtarëve aktual, të cilët janë zgjedhur nga rradhët e prokurorëve të të gjitha niveleve, u përfundon mandati në dhjetor 2021. Gjithashtu, gjatë vitit 2021, Kuvendi i Shqipërisë ka shpallur vakancat për dy anëtarë joprokurorë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Për më shumë informacione në lidhje me shpalljen e vakancave nga Kuvendi i Shqipërisë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, lutemi referojuni Kriterit Politik.

Kuadri ligjor

Dokumenta strategjikë: Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe Plan i Veprimit.

Në kuadër të angazhimit për zbatimin e reformës në drejtësi, Ministria e Drejtësisë vijon monitorimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për periudhën 2019 – 2021. Progresi për periudhën janar – dhjetor 2020 gjendet i pasqyruar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë,⁴⁹ bashkërisht edhe me të gjitha raportet 6-mujore të monitorimit.

Me qëllim avancimin e objektivave të Reformës në Drejtësi për 5 vitet e ardhshme, Ministria e Drejtësisë ka përfunduar procesin 1-vjeçar të punës për hartimin e paketës strategjike për fazën e dytë të zbatimit të reformës në drejtësi, e cila konsiston konkretisht në:

- Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021 – 2025;
- Planin e Veprimit 2021 – 2025;
- Pasaportën e Indikatorëve.

SND 2021 – 2025 synon të konsolidojë kuadrin ligjor dhe institucional të sistemit të drejtësisë, të përfshijë praktikën moderne evropiane në drejtësinë penale, të përmirësojë infrastrukturën e sistemit të drejtësisë dhe të ofrojë zgjidhje për IT-në, duke përfshirë këtu zgjidhjet inovative elektronike që mbështesin rritjen thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë. SND 2021 – 2025 ka përcaktuar 4 qëllime madhore politike, si dhe 16 objektiva specifike. Vizioni i kësaj Strategjie është një “Sistem i drejtësisë i pavarur, llogaridhënës, i aksesueshëm, transparent dhe eficient që mbron të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane”. Ky vizion synohet të jetësohet përmes katër qëllimeve të politikës të listuara si më poshtë:

- Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhëniën;

- Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;

- Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;

- Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjitha institucionet e sektorit”.

Në kuadër të zbatimit të Qëllimeve të Politikave, janë parashikuar 3 investime madhore si programi e-justice, zbatimi i Hartës së Re Gjyqësore në Shqipëri, vijimësia e programit të Drejtësisë për të Mitur.

Ky draft i përgatitur në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Misionit EURALIUS V është konsultuar gjerësisht me të gjithë aktorët e përfshirë në proces dhe aktualisht janë duke u ndjekur procedurat për miratimin e draftit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021 – 2025 dhe Planit të saj të Veprimit.

Profesionalizmi dhe Kompetenca

⁴⁹ <https://drejtesia.gov.al/ep-content/uploads/2021/05/Raporti-Vjetor-i-Monitorimit-Janar-Dhjetor-2020-n%C3%AB-zbatim-t%C3%AB-Strategjis%C3%AB-Nd%C3%ABrsektoriale-t%C3%AB-Drejt%C3%ABsis%C3%AB-dhe-Planit-t%C3%AB-Veprimit.pdf>

*Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë*

Gjykata Kushtetuese që prej muajit dhjetor 2020 përbëhet nga 7 anëtarë. Në realizim të detyrës së tij funksionale kushtetuese, në korrik të vitit 2021, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) ka filluar procedurën e verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve që kanë kandiduar fillimisht për tre vendet vakante për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, të çelura në fillim të muajit qershor nga Gjykata e Lartë. Gjatë ecurisë së procesit të verifikimit të figurës së kandidaturave, për shkak të dorëheqjes së kandidatëve ose për shkak të vendimmarrjes së KED për “Ndalim kandidimi”, numri i kandidaturave për njëren nga tre vakancat shkoi nën numrin dy. Në lidhje me këtë vakancë, KED mori vendim për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë si subjekti që e ka vënë në lëvizje, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për këtë vakancë. KED po vijon gjithashtu procesin e vlerësimit të kushteve ligjore për 2 vakancat e tjera. Aktualisht ka përfunduar procesi i mbledhjes dhe ballafaqimit të dokumentacionit, si dhe ai i përgatitjes së një pjesë relacionesh, dhe brenda muajit dhjetor 2021 mund t'i përcjellë Gjykatës së Lartë listën me kandidaturat për dy vendet vakante për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese.

Funksionimi i plotë i Gjykatës së Lartë mbetet prioritet jo vetëm për Këshillin e Lartë Gjyqësor, por edhe për të gjithë sistemin gjyqësor. Plotësimi i 9 vendeve vakante të Gjykatës së Lartë shënon hapin e parë drejt funksionimit të saj të plotë. Për momentin, Gjykata e Lartë ka mundur unifikimin e praktikave nëpërmjet rishikimit të çështjeve nga një trup gjykues prej 5 anëtarësh.

Aktualisht, procesi është në vazhdim për 5 vendet e tjera të shpallura tashmë të lira, të cilat janë pezull për shkak të ankesave të kandidatëve dhe procesit të rivlerësimit kalimtar. Ndërkohë, në mbledhjen plenare të datës 17.11.2021, Këshilli vendosi hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë nga radhët e gjyqtarëve edhe për 3 pozicionet e fundit të lira, të cilat ishin ende të pashpallura.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, krahas plotësimit të trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ka marrë masa për rritjen e efikasitetit të gjykatës si strukturë organizative, duke mundur plotësimin e organigramës së kësaj gjykate dhe konkretisht, të

Njësisë së Shërbimit Ligjor. Kjo e fundit ka një peshë të konsiderueshme dhe një mision të rëndësishëm në Gjykatën e Lartë, sepse ushtron funksione këshillimore dhe ndihmëse në procesin e vendimmarrjes, duke ndikuar ndjeshëm në numrin e çështjeve gjyqësore të trajtuara. Aktualisht, kjo njësi funksionon me 5 ndihmës magjistratë dhe 14 këshilltarë ligjorë. Ndërkohë, 2 këshilltarë ligjorë janë në proces verifikimi dhe kualifikimi për t'u pranuar në shërbimin gjyqësor civil. Për sa i përket vitit akademik 2021 – 2022, 4 këshilltarë ligjorë kanë nisur programin e trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.

Funksionimi i Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Pas krijimit të Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (me Vendim të KLGJ Nr. 288, datë 18.12.2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka punuar intensivisht për plotësimin e vendeve vakante në këto gjykata. Në tetor 2021, për shkak të shkarkimeve nga organet e vettingut dhe emërimeve në Gjykatën e Lartë, Gjykata e Posaçme e Apelit ka në detyrë 6 gjyqtarë nga 11 që parashikon ligji, ndërsa Gjykata e Posaçme e shkallës së parë ka 7 gjyqtarë në detyrë, 3 prej të cilëve janë caktuar nga skema e delegimit, nga 16 të tillë të parashikuar.

Për shkak të kërkesave ligjore për këto pozicione dhe mungesës së burimeve njerëzore që ka ardhur si rezultat i procesit të vettingut, pavarësisht hapjes së vazhdueshme të thirrjeve për vende vakante në të dy shkallët e Gjykatave Speciale, numri i aplikimeve ka mbetur shumë i ulët.⁵⁰

Gjendja aktuale e vakancave në sistemin prokurorial dhe emërimi i magjistratëve të rinj

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë përpjekje të konsiderueshme për plotësimin e vendeve vakante prioritare të gjyqtarëve dhe vazhdimin e progresit në rekrutimin e magjistratëve të rinj. Gjatë vitit 2020 janë emëruar në funksione gjyqësore një

⁵⁰ Gjatë vitit 2021, KLGJ ka publikuar 25 thirrje (nga të cilat 12 janë thirrje të përsëritura për shkak të mungesës së aplikimeve). Gjithsej kanë dorëzuar dokumentacionin 10 aplikantë, që në disa raste kanë aplikuar për më shumë se një pozicion të shpallur. KLGJ dhe Euralius V ka ndërmarrë një sërë fushatash sensibilizuese duke ftuar gjyqtarët të aplikojnë për këto pozicione, gjë që konfirmon qartë angazhimin e Këshillit për kompletimin e plotë të strukturës organizative të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.



numër total prej 44 magjistratësh (të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitet 2018 – 2019 dhe 2019 – 2020).

Organika e sistemit të prokurorisë përbëhet nga 341 prokurorë. Në sistemin prokurorial, aktualisht janë në detyrë 242 prokurorë, ndër të cilët 219 janë prokurorë në detyrë, 20 prokurorë janë komanduar në organet e sistemit të drejtësisë dhe për 3 prokurorë është miratuar leja e papaguar nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga momenti i konstituimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë caktuar në detyrë 18 prokurorë të rinj.

Ndërkohë, në lidhje me rekrutimin e kandidatëve të rinj magjistratë, KLGJ dhe KLP, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, kanë rritur gradualisht numrin e kandidatëve të pranuar në trajnimin fillestar. Në kuadër të procesit të rekrutimit të magjistratëve të rinj, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi në datat 19.04.2021 dhe 22.04.2021 provimin për kandidatët magjistratë dhe këshilltarë/ndihmës ligjorë. Në bazë të rezultateve u shpallën fitues 65 kandidatë magjistratë, prej të cilëve 35 në profilin “Gjyqtar”, 25 në profilin “Prokuror” dhe 6 të tjerë në profilin “Këshilltar dhe ndihmës ligjor”.

Ngritje në detyrë

Në kuadër të ngritjes në detyrë të drejtuesve të zyrave të prokurorive, përgjatë vitit 2021 janë emëruar 10 drejtues. Deri në vitin 2020, vakancat për këto pozicione janë plotësuar nëpërmjet caktimit të përkohshëm të drejtuesve. Përfundimi i kësaj procedure do të sjellë qëndrueshmëri në sistemin prokurorial dhe për rrjedhojë, edhe më shumë efikasitet. Gjithashtu, përgjatë vitit 2021 janë transferuar me lëvizje paralele 24 prokurorë. Të dyja këto procedura kanë filluar në fund të vitit 2020 dhe do të konkludohen brenda vitit 2021.

Rritja e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha shkallëve. Prioriteti i punës së ILD është shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha pretendimeve të paraqitura si nga qytetarët, ashtu edhe nga institucionet lidhur me veprimet, mosveprimet ose sjelljet e magjistratëve brenda apo jashtë funksioneve të tyre. Në lidhje me trajtimin e ankesave të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit

të Lartë të Drejtësisë, deri më tani rezultojnë 4085 ankesa të konfirmuara në total, 1323 ankesa të trajtuara, 2762 ankesa në proces trajtimi dhe 146 ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar. ILD ka miratuar 38 vendime për fillimin e hetimit disiplinor, prej të cilave janë dërguar 15 kërkesa për procedim disiplinor pranë KLGJ dhe 4 kërkesa për procedim disiplinor pranë KLP.

Në bazë të ligjit nr. 115/2016, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kryen edhe inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të KLGJ, KLP, Ministrisë të Drejtësisë apo Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve. Bazuar në këtë Plan, për periudhën janar – tetor 2021 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë 2 vendime (gjatë muajit qershor) për kryerjen e inspektimit tematik të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Po ashtu, gjatë muajit maj 2021, ILD, me financim nga Bashkimi Evropian, ka publikuar Manualin për Hetimin Disiplinor ndaj Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ky manual është një përmbledhje e komenteve dhe analizave ligjore të bazuara në legjislacionin që lidhet me hetimet disiplinore ndaj magjistratëve në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarëve

Gjatë vitit 2021 KLGJ ka plotësuar paketën e akteve nënligjore të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.⁵¹ Për të gjithë gjyqtarët për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar ka marrë formë të prerë dhe janë përcjellë dosjet përkatëse pranë Këshillit, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional.⁵²

⁵¹ i) rregullat plotësuese për vlerësimin e gjyqtarëve të cilët janë të komanduar në pozicionin e ndihmës magjistratit në Gjykatën e Lartë; (ii) metodologjinë e pikëzimit; (iii) format standarde të tabelave me të dhëna statistikore (iv) format standarde të formularëve të vlerësimit të ndihmës magjistratit, mendimit të kryetarit dhe mendimin e Kolegjit; si dhe (iv) rregullat e përzgjedhjes me short të çështjeve për vlerësim.

⁵² Këshilli, deri më 30 Nëntor 2021, ka përfunduar procedurat e vlerësimit etik dhe profesional për 36 gjyqtarë për periudhën e vlerësimit 2013-2016 dhe 2019, duke miratuar në Mbledhje Plenare 72 raporte të vlerësimit. Deri në fund të vitit 2021, pritet që të miratohen edhe 16 projekt-raporte të tjera të vlerësimit etik dhe profesional,



Vlen të theksohet se në këtë proces i është dhënë përparësi gradimit dhe vlerësimit të përsheptuar të detyruar të kandidatëve aplikantë për ngritje në detyrë në Gjykatë të Lartë, në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatat e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Kodi i Etikës

Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ përgjegjës për miratimin e Rregullave dhe Kodit të Etikës dhe për monitorimin e tyre, miratoi Kodin e Etikës Gjyqësore, me Vendimin Nr. 171, datë 22.04.2021, ndërkohë që më 11.10.2019, KLGJ ka caktuar një gjyqtar si Këshilltar për Etikën.

Kodi i Etikës Gjyqësore synon të garantojë rritjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe dhënien e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën, standardet e njohura ndërkombëtarisht të drejtave të njeriut dhe ligjin. Trajnimi i gjyqtarëve për Kodin e Etikës pritet të fillojë në tremujorin e parë të vitit 2022, ndërsa po vijon puna për hartimin e Udhëzuesit për Respektimin e Kodit të Etikës.

Cilësia e drejtësisë dhe efienca

Shkolla e Magjistraturës është përgjegjëse për garantimin e cilësisë së formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë dhe atij vazhdues për magjistratët në detyrë. Aktualisht, Programi i Formimit Fillestar po realizohet me kurrikula të përmirësuara, të cilat kanë një qasje më praktike dhe synojnë që kandidati për magjistrat të përfitojë kompetenca dhe aftësi që lidhen me profesionin që ai pritet të ushtrojë dhe veçanërisht me njohuri të qëndrueshme dhe të thelluara për të drejtën, zbatimin e saj nga pikëpamja praktike, aftësim për përgatitjen e seancës gjyqësore dhe zhvillimin e debatit gjyqësor, mes të tjerash. Me të njëjtën metodologji, Shkolla e Magjistraturës ka realizuar edhe rishikimin e planit mësimor dhe kurrikulave të vitit të dytë akademik, i cili, në nenin 263 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikohet si një vit program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë dhe prokurorë nën kujdesin e Shkollës dhe nën drejtimin e një gjyqtari

ose prokurori me kualifikim të lartë. Lidhur me trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve, Shkolla ka analizuar Metodologjinë për Vlerësimin e Aktiviteteve trajnuese dhe pas një procesi të gjatë analize dhe përpunimi, ka bërë pjesë të saj shumë elemente cilësore matëse të ekspertizës dhe efektivitetit të trajnimeve. Trajnimet vazhduese bazohen tërësisht në kërkesat e vetë magjistratëve dhe zhvillohen sipas një metodologjie që ka në bazë interaktivitetin.

Efienca

Për të garantuar efikasitetin e plotë të sistemit gjyqësor është miratuar një paketë e plotë ligjore, e cila konsiston në disa shtesa dhe ndryshime të 10 ligjeve⁵³ të reformës së sistemit të drejtësisë. Këto ndryshime ligjore synojnë të rrisin efikasitetin e Gjykatës së Lartë në uljen e numrit të dosjeve të trashëguara, të sigurojnë funksionimin e Gjykatave të Apelit, përsheptimin e gjykimit të disa çështjeve në Gjykatat e Shkallës së Parë, funksionimin e duhur të organeve drejtuese të sistemit të drejtësisë, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Prokurorisë së Përgjithshme, rritjen e kapaciteteve të Gjykatave

⁵³ -Ligji Nr. 41/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

-Ligji Nr. 42/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 97/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

-Ligji Nr. 44/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

-Ligji Nr. 43/2021 Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

-Ligji Nr. 49/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar;

-Ligji Nr. 48/2021 Për një ndryshim në Ligjin Nr. 25/2019 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore”;

-Ligji Nr. 47/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

-Ligji Nr. 50/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

-Ligji Nr. 46/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

-Ligji Nr. 45/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar;



Speciale kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe përmirësimin e garancive dhe përfitimeve që ofron statusi i magjistratit.

Në drejtim të efikasitetit të sistemit gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka ndërmarrë masa administrative, ligjore dhe strategjike të cilat synojnë të minimizojnë efektin e procesit të rivlerësimit kalimtar në boshatisjen e sistemit gjyqësor, krahas mbështetjes me prioritet të reformës në drejtësi.

Harta e re Gjyqësore

Një Grup Ndërinstitucional Pune, pjesë e të cilit është edhe Ministria e Drejtësisë, është ngritur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në vitin 2019 me synimin për të punuar për një projektpropozim të Hartës së re Gjyqësore, në përmbushje të detyrimit ligjor për riorganizimin periodik të gjyqësorit në përputhje me nevojat e sistemit, për garantimin e efikasitetit si dhe aksesit në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër, janë mbajtur një sërë takimesh si të nivelit vendimmarrës, ashtu edhe atij teknik mes dy institucioneve dhe palëve të tjera të interesuara. Këto shkëmbime u intensifikuan më tej në tremujorin e fundit të vitit 2021, me qëllimin për të mundësuar një diskutim të mirëinformuar mbi këtë çështje, përfshirë këtu edhe përditësimet dhe statistikën më të fundit mbi dinamikën e zhvillimit të sistemit të drejtësisë.

Grupi i Punës bëri një vlerësim të gjendjes aktuale të sistemit gjyqësor, duke marrë në konsideratë vëllimin e çështjeve gjyqësore, numrin e çështjeve të prapambetura (backlog), ngarkesën e gjyqtarëve, aksesin në drejtësi, etj. Në analizën e Grupit të Punës janë marrë parasysh edhe studimet ndërkombëtare në këtë drejtim, standardet më të mira evropiane dhe Rekomandimet e CEPEJ. Analiza ka mbërritur në përfundimin se sistemi gjyqësor është duke funksionuar përtej kapaciteteve të tij dhe nën kushte të vështira.

Projektpropozimi parashikon përqendrimin e gjykatave në të dyja nivelet dhe të gjitha juridiksionet (të përgjithshëm dhe administrativ). Ministria e Drejtësisë është shprehur dakord në parim me propozimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës. Së fundmi grupet kanë punuar për të arritur një marrëveshje për dy çështje specifike, të ngritura nga Ministri i Drejtësisë, konkretisht:

- Vijimi i ofrimit të shërbimeve administrative në të gjitha gjykatat që propozohen të shkohen, për të siguruar akses të qytetarëve në shërbimet gjyqësore, veçanërisht në regjistrë, si dhe për të garantuar që në këtë fazë të mos ketë staf të tepërt;

- Gjykata e Dytë Administrative e Shkallës së Parë (përveç Tiranës), do të vendoset në Lushnjë, ku tashmë ka ambiente të disponueshme gjyqësore.

Takimet e njëpasnjëshme u fokusuan në diskutimin e detyrimeve financiare që lindin nga zbatimi i Hartës Gjyqësore në lidhje me disponueshmërinë e ambienteve të gjykatës, për të garantuar një zbatim të shpejtë dhe efektiv të saj. Po ashtu, është diskutuar edhe mbi një afat kohor për Planin e Zbatimit për të garantuar transferimin e logjistikës, si dhe edukimin e duhur ligjor për qytetarët lidhur me shërbimet gjyqësore që preken nga zbatimi i Hartës.

Nëpunësit civilë gjyqësorë

Këshilli e ka konsideruar rritjen e burimeve njerëzore si një mekanizëm për të minimizuar, për sa është e mundur, ndikimin e procesit të vetingut në mungesën e burimeve njerëzore. Gjatë vitit 2020, për herë të parë, Këshilli, përmes një pakete aktesh nënligjore, nisi procesin e reformës së administratës gjyqësore, duke synuar garantimin e një administrate gjyqësore të qëndrueshme, profesionale dhe me integritet të lartë. Në kuadër të kësaj reforme, për herë të parë, gjatë vitit 2020, u ngritën njësitë e shërbimit ligjor në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, si një mekanizëm për përshpejtimin e zgjidhjes së çështjeve gjyqësore. Aktualisht në këto njësi janë emëruar 28 asistentë ligjorë (9 në 2020 dhe 19 në 2021).

Gjithashtu, në sistemin janë rekrutuar në total edhe 65 nëpunës civilë gjyqësorë, përkatësisht 21 në vitin 2020 dhe 44 deri në nëntor 2021.

Për sa u përket Sistemeve të Menaxhimit të Çështjeve në përdorim nga sistemi gjyqësor në Shqipëri (Ark-IT dhe ICMIS), ato kanë demonstruar një sërë mangësish. Bazuar në problematikat e konstatuara, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hartuar ndërhyrje strategjike në Sistemin aktual të Menaxhimit të Çështjeve, të cilat për herë të parë në 15 vjet, janë përcaktuar nga vetë përdoruesit e tij. Falë këtij procesi, në vitin 2020 janë aplikuar 84 përmirësime strategjike, me qëllim rritjen e transparencës, efikasitetit dhe aksesit të



qytetarëve në vendimet gjyqësore. Njëkohësisht, gjatë vitit 2021 u krijua dhe Qendra e Teknologjisë së Informacionit. Në kuadër të garantimit të funksionalitetit të Qendrës, më 19.10.2021 u zhvillua takimi i parë i Bordit Drejtues të Qendrës, takim i cili shënoi krijimin e Qendrës si institucion publik me personalitet juridik.

Një tjetër masë e ndërmarrë për rritjen e efikasitetit të Gjykatës së Lartë është miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ky Memorandum mbështet administrimin e Gjykatës së Lartë me burime njerëzore dhe reduktimi i stokut të çështjeve të pazgjidhura është ndër kontributet më të rëndësishme që ai ofron. Aktualisht, janë punësuar 12 oficerë për reduktimin e çështjeve të pazgjidhura. Që nga gushti 2020, oficerët e reduktimit të çështjeve kanë inventarizuar shumicën dërrmuese të dosjeve gjyqësore. Më tej, në bazë të listës prioritare të përcaktuar nga Gjykata e Lartë, janë hartuar raportet për 3222 dosje të cilat janë dorëzuar në Kolegjet Administrative, Penale dhe Civile.

Bazuar në “Udhërrëfyesin për Funksionimin e Gjykatës së Lartë”, përgatitur nga KLGJ dhe Gjykata e Lartë në korrik 2020, Gjykata e Lartë ka hartuar një Plan Veprimi për Uljen e Numrit të Çështjeve”. Ky Plan Veprimi ka si qëllim të dokumentojë arritjet dhe sfidat ende të pranishme për reduktimin e numrit të çështjeve. Qasja në drejtësi, administrimi më eficient dhe efektiv i saj, si dhe rritja e besueshmërisë së munguar në sytë e publikut janë përparësitë kryesore të këtij Plani të hartuar në përputhje edhe me Planin e ri Strategjik të KLGJ. Vëmendje dhe kujdes i veçantë në hartimin e tij i është kushtuar edhe përfshirjes së rekomandimeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.

Si tregues i rritjes së funksionalitetit të Gjykatës së Lartë është edhe fakti që për periudhën 1 janar – 12 nëntor 2021, kjo gjykatë ka evaduar 2,513 çështje (1478 çështje në vitin 2020).

Gjithashtu, masat *ad hoc* që Këshilli ka marrë në funksion të garantimit të funksionalitetit dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor lidhen me përballimin e vakumit të krijuar nga procesi i vetëqutur, duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të gjyqtarëve të shkarkuar nga detyra. Kështu, gjatë vitit 2020 janë adresuar 629 kërkesa gjyqësore për

delegim gjyqtarësh dhe janë caktuar 874 gjyqtarë për të gjykuar çështje të veçanta gjyqësore në gjykata të ndryshme, ndërsa në vitin 2021, në përgjigje të 698 kërkesave të gjykatave të periudhës janar–nëntor 2021, Këshilli ka bërë 866 delegime për gjykimin e çështjeve të veçanta gjyqësore në gjykata të ndryshme.

Lufta kundër korrupsionit

Sipas raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021, Shqipëria ka arritur një nivel të caktuar përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Është arritur progres në fuqizimin e luftës kundër korrupsionit. Po vijon zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit. Po ashtu, vetting-u në gjyqësor po sjell rezultate në luftën kundër korrupsionit. SPAK ka kontribuar në përmirësimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale në çështjet e korrupsionit.

Funksionimi i SPAK

Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin Nr. 6, datë 28.01.2021, miratoi numrin e përgjithshëm (20) të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Aktualisht, Prokuroria e Posaçme ka në përbërje të saj 17 prokurorë të emëruar në mënyrë përfundimtare, pasi në muajin dhjetor 2021 është bërë emërimi i 2 prokurorëve të tjerë, Z. Elvin Gokaj dhe Z. Alfred Shehu.

Në lidhje me funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, kanë filluar ushtrimin e detyrës 28 hetuesit e parë të kësaj strukture dhe vazhdon faza e përzgjedhjes së 32 hetuesve të tjerë për të plotësuar numrin prej 60 hetuesish.

Ngritja e institucioneve të posaçme për luftën kundër korrupsionit ka filluar të japë edhe rezultatet e para, ku SPAK ka regjistruar disa raste të hetimit dhe gjykimin të zyrtarëve të lartë si vijon:

- Hetimi në ngarkim të zyrtarëve të Ministrisë së Brendshme, të cilët dyshohet se kanë kryer veprat penale të “Shkeljes së barazisë në tendera”, parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal. Abuzimet janë konstatuar në një tender që lidhet me blerjen e uniformave të Policisë së Shtetit;

- Hetimi në ngarkim të shtetasit F. T., me detyrë kryetar i Bashkisë së qytetit të Lushnjës dhe disa zyrtarëve të tjerë të kësaj Bashkie, të cilët dyshohet se kanë kryer veprat penale të “Shkeljes së barazisë në tendera”, parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal.



- Përfundimi i gjykimit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për shtetasin A.L.L., me detyrë ish-Prokuror i Përgjithshëm, duke e deklaruar fajtor për veprën penale të fshehjes së pasurisë dhe duke e dënuar me burgim. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë u la në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

- Prokuroria e Posaçme iu drejtua gjykatës me kërkesë për revokimin e vendimit për pushimin e çështjes penale në ngarkim të ish-ministrit të Mbrotjtjes F.M. dhe vijimin e procesit gjyqësor ndaj shtetasit F.M., i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, si dhe për kryerjen e veprës penale “Shpërdorim i detyrës” në bashkëpunim me subjekt ushtarak-kudër komandues, parashikuar në nenet 70/2 të Kodit Penal Ushtarak dhe neni 25 i Kodit Penal. Gjykata e Posaçme kundër Krimin dhe Korrupsionit vendosi që të rrëzonte kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për rihapjen e hetimeve, por ky vendim u ndryshua nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila vendosi të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, monitoron periodikisht zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Planit të Veprimit 2020 – 2023, të miratuar me VKM Nr. 516, datë 1.7.2020, nëpërmjet një strukture monitorimi, planifikimi dhe koordinimi, konkretisht Komiteti Koordinues për Monitorimin e Strategjisë, të kryesuar nga Ministri i Drejtësisë dhe në përbërje të të cilit janë 10 Zëvendësministra.

Në kuadrin më të gjerë institucional kundër korrupsionit ka patur disa ndryshime strukturore thelbësore. Rrjeti i ri i Koordinatorëve kundër Korrupsionit dhe Drejtoria e Përgjithshme që operon në fushën e antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë janë krijuar së fundmi me VKM Nr. 618, datë 20.10.2021. Këto ndryshime janë të një rëndësie të madhe sepse krijojnë një strukturë qendrore unike nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë dhe drejtimin e Ministrit të Drejtësisë, si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit,

duke shfuqizuar strukturat e mëparshme të decentralizuara nën autoritetin e Kryeministrit. Institucionet e shkrrira, funksionet e të cilave tashmë janë përfshirë në ato të strukturës së re, janë: Njësia e Këshillit të Ministrave për Transparencën dhe Kundër Korrupsionit - DATAK, Njësia e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Evazionit në Kryeministri, si dhe Task Forca Ndërinstitucionale Kundër Korrupsionit. Këto ndryshime trajtojnë gjithashtu rekomandimet e vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare, përfshirë BE-në, për ngritjen e një autoriteti qendror kundër korrupsionit, duke ndjekur edhe praktikatat e mira të vendeve fqinje dhe evropiane.

Në bazë të VKM Nr. 618, datë 20.10.2021, Rrjeti i Koordinatorëve përbëhet nga Koordinatorët kundër Korrupsionit (Koordinatorët) dhe struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë. Misioni i këtij Rrjeti është të mbledhë, analizojë, koordinojë, verifikojë dhe hetojë administrativisht të gjithë informacionin për rastet e korrupsionit dhe praktikatat abuzive e arbitrare, nga vetë Koordinatori ose struktura përgjegjëse kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, me iniciativën e tyre ose me kërkesë të çdo autoriteti publik apo të tretë, përfshirë rastet e korrupsionit të referuara nga platforma “*Shqipëria që Duam*” për institucionet që janë pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, me qëllim parandalimin dhe minimizimin e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore. Po ashtu, një detyrë tjetër e Rrjetit është edhe kryerja e vlerësimeve të riskut të korrupsionit dhe propozimi i masave, rregullave dhe procedurave për menaxhimin e këtij rreziku. Rrjeti i Koordinatorëve përbëhet nga përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror dhe rajonal. Me VKM Nr. 618 të tetorit 2021 (sipërpërmendur), Rrjeti është zgjeruar nga 17 në 44 institucione në nivelin qendror. Në vijim miratimit të kësaj VKM, Ministri i Drejtësisë ka miratuar Rregulloren e funksionimit të Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit.

Nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 553, datë 30.09.2021, është miratuar Metodologjia e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë ka ndjekur me prioritet procesin e hartimit të planeve të integritetit të institucioneve të vërsisë së Ministrisë së Drejtësisë si dhe të gjitha Ministrive të linjës.



Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, gjatë periudhës janar – qershor 2021, ka rishikuar Planin Vjetor të Vizibilitetit dhe Komunikimit në fushën e Antikorrupsionit,⁵⁴ i cili përmban gjithsej 13 aktivitete që do të zhvillohen gjatë vitit 2021, me fokus luftën kundër korrupsionit. Përmbajtja e tij është gjithëpërfshirëse dhe e synuar për grupe të ndryshme interesi.

Në qershor 2021, Ministria e Drejtësisë ka publikuar për herë të parë një përmbledhje mujore të aktiviteteve në fushën e antikorrupsionit, në formën e një buletini mujor. Këto buletine publikohen tashmë çdo muaj në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.⁵⁵ Ministria e Drejtësisë ka finalizuar më 15 qershor 2021 një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ambasadës së Italisë në Shqipëri. Qëllimi i saj do të jetë promovimi i përbashkët i një projekti pilot didaktik-edukativ (moduli anti-korrupsion) dhe do të zhvillohet në disa institucione të arsimit parauniversitar të mesëm të lartë, me qëllim promovimin dhe përhapjen e kulturës së ligjshmërisë dhe qytetarisë së përgjegjshme, si mjete të përshtatshme për parandalimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Po ashtu, Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, bashkëorganizon dhe merr pjesë si institucion partner për të tretën herë radhazi në Javën e Integritetit. Në fokus të aktiviteteve të Ministrisë së Drejtësisë janë të rinjtë dhe përfaqësuesit e sektorit privat.

Veprimtaria e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

Deklarimi dhe kontrolli i pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë dhe sistemi elektronik i deklarimit të interesave privatë.

Gjatë vitit 2020 si dhe gjatë periudhës vijuese janar – nëntor 2021, ILDKPKI ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në kuadër të projekteve asistuese në drejtim të ngritjes së

Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë.

Sistemi Elektronik, në përmbushje të rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Rezolutën e 2019 për ILDKPKI, pritet që të jetë tërësisht funksional në fillim të vitit 2022. Në vijim të proceseve të nevojshme për ta bërë sistemin tërësisht funksional, ILDKPKI kërkoi dhe mori mbështetjen e nevojshme financiare nga buxheti i shtetit për të garantuar mirëmbajtjen e sistemit, si një kërkesë e nevojshme, parashikuar nga VKM Nr. 710/2013.

ILDKPKI ka trajtuar të gjitha kërkesat e individëve apo mediave lidhur me publikimin e deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, brenda afatit 10 ditor, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit manual të përpunimit për redaktimin e të dhënave personale, duke rritur kështu transparencën institucionale. Në këtë kuadër, për t'u theksuar mbetet fakti se nuk janë paraqitur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara.

Volumi gjithmonë e më shumë në rritje tregohet në mënyrë të qartë edhe nga të dhënat e publikimit të deklaratave të interesave privatë, ku gjatë periudhës 2014–2020 ILDKPKI ka publikuar rreth 58.380 deklarata me kërkesë, ndër të cilat vetëm për vitin 2020 janë publikuar rreth 6.182 deklarata me kërkesë, ndërsa për periudhën janar–nëntor 2021 janë publikuar rreth 2.951 deklarata.

Zbatimi i ligjit Nr. 60, datë 2.6.2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

ILDKPKI ka vijuar zbatimin e kompetencave të dhëna nga ligji Nr. 60, datë 2.6.2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

ILDKPKI, gjatë periudhës 2017–2020, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, ka regjistruar dhe trajtuar në total 47 raste sinjalizimi dhe 6 raste kërkesash për mbrojtje nga hakmarrja. Për vitin 2020, ILDKPKI, ka regjistruar dhe trajtuar në total 9 raste sinjalizimi dhe 1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, ndërsa për periudhën janar – nëntor 2021 ka regjistruar 7 raste sinjalizimi të jashtëm dhe 1 kërkesë për mbrojtje.

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme (SHÇBA)

Strategjia e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020–2024 dhe Plani i Veprimit 2020

⁵⁴ <https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Plani-i-Komunikimit-dhe-Vizibilitetit-2021.pdf>

⁵⁵ <https://drejtesia.gov.al/e-buletin/>



– 2022, është dokumenti i parë Strategjik me objektiva afatmesëm dhe afatgjatë i SHÇBA.

Në bazë të nevojës për një reformim rrënjësor të Shërbimit në përputhje me standardet e organizatës së Partnerëve Evropian Kundër Korrupsionit (EPAC) dhe objektivave afatgjatë të Ministrisë së Brendshme dhe Qeverisë Shqiptare, është draftuar dhe dërguar për miratim në Kuvendin e Shqipërisë, Projektligji për “*Ajencinë e Mbikëqyrjes Policore*”. Aktualisht, ky projektligji po shqyrtohet në komisionet e sigurisë dhe të ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Për periudhën 2020 – 2021 (janar – shtator), për sa i përket hetimit administrativ të ankesave & inspektimeve dhe hetimit procedural penal, treguesit statistikorë janë si vijon:

- Hetimi administrative i ankesave & inspektimeve:

- Marrë dhe trajtuar 2.653 ankesa të publikut;

- Marrë dhe shqyrtuar 14.974 telefonata nga Linja e Gjelbër 0800 90 90;

- Kryer 158 Inspektime në 118 struktura.

Në përfundim të hetimit administrativ të ankesave dhe inspektimeve:

- Për 40 punonjës të strukturave janë referuar materialet për fillimin e procedimit penal në prokuroritë e rretheve Gjyqësore përkatëse;

- Për 635 punonjës të strukturave është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore, si personat përgjegjës për shkeljet e evidentuara.

- Hetimi procedural penal

Veprimtaria hetimore e strukturave të SHÇBA-së, e pasqyruar në numrin e referimeve të veprës penale pranë organit të Prokurorisë, konstaton në 384 referime penale, për

- 555 punonjës të strukturave të proceduar;

- 115 punonjës të strukturave me masa sigurie arrestuar/ndaluar/masa të tjera dhe

- 93 punonjës të strukturave me masa sigurie arrestuar/ndaluar/masa të tjera

Raportimet ndërkombëtare

Në fokus të punës së Ministrisë së Drejtësisë për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar ka qenë edhe adresimi i rekomandimeve të mekanizmave monitorues të Konventave të Këshillit të Evropës GRECO, Moneyval, si dhe rekomandimeve të FATF.

Më 3 dhjetor 2020, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) publikoi Raportin e Vlerësimit për Raundin e Pestë të Vlerësimit për

Parandalimin e Korrupsionit dhe Promovimin e Integritetit të Zyrtarëve të Lartë dhe Agjencive Ligjzbatuese”. Në këtë raport, GRECO vlerësoi reformat e ndërmarra nga autoritetet shqiptare, duke theksuar gjithashtu rëndësinë e zbatimit të këtyre reformave për përmirësimin e rezultateve në luftën kundër korrupsionit. Në përputhje me gjetjet e Raportit, GRECO renditi 24 rekomandime për Shqipërinë.

Në vijim, Ministria e Drejtësisë së bashku me të gjitha akorët përgjegjës kanë hartuar një Plan të detajuar Pune për adresimin e këtyre rekomandimeve. Deri në këtë fazë të procesit, nga 24 Rekomandimet e dhëna 8 prej tyre konsiderohen të adresuara plotësisht. Këto rekomandime adresohen nëpërmjet vlerësimit të kapaciteteve dhe performancës së punonjësve dhe planifikimit buxhetor në përputhje me nevojat institucionale për rritjen e burimeve financiare, zhvillimit të trajnimeve për punonjësit e ILDKPKI në fushën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive, trajnimeve në lidhje me sinjalizuesit, si dhe trajnimeve për shkeljet e lidhura me detyrën, hetimet financiare dhe pastrimin e parave. Në përmbushje të rekomandimeve që shtrihen në fushën e përgjegjësisë së Policisë së Shtetit, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është miratuar procedura standarde e punës në lidhje me përcaktimin e rregullave për pranimin dhe administrimin e donacioneve. Manuali me Kodin e Etikës është hartuar në Policinë e Shtetit nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnimin e Hetimeve Kriminale (ICITAP). Është rishikuar edhe Rregullorja e Policisë së Shtetit, duke ngritur Komisionin e Vlerësimit për vlerësimin e punonjësve në procesin e ngritjes në karrierë.

Zbatimi i 16 rekomandimeve të mbetura është ende në proces, bazuar në afate specifike kohore duke iu referuar datës së fundit për dorëzimin e raportit të situatës në prill 2022.

Prej muajit shkurt 2020, Shqipëria ka ndërmarrë një angazhim të nivelit të latë politik për zbatimin e Planit të Veprimit të dakordësuar me ICRG/FATF. Zbatimi i planit është në një nivel të kënaqshëm. Në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të ICRG/FATF, nga institucionet pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës deri më tani janë realizuar objektivat si më poshtë:

- Janë përgatitur 7 analiza risku në kuadër të Vlerësimit Kombëtar të Riskut për PP/FT;



- Është rritur ndërgjegjësimi i subjekteve të ligjit në funksion të rritjes së kapaciteteve parandaluese dhe zbatimit efektiv të sanksioneve ndërkombëtare sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

- Është rritur bashkëpunimi me institucionet mbikëqyrëse nëpërmjet inspektimeve të përbashkëta, duke përfshirë noterët, avokatët, audituesit dhe institucionet financiare.

- Është miratuar kuadri ligjor dhe janë në funksionim të plotë dy regjistrat, ai i pronarëve përfitues dhe ai i llogarive bankare;

- Është miratuar ligji për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, i cili do të jetë një mekanizëm më shumë për transparencën e të dhënave në këtë sektor;

- Është duke përfunduar sistemi i ndërlidhjes së sistemit të letërporosive midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë të Përgjithshme;

- Ka një trend të kënaqshëm në lidhje me rritjen e numrit të sekuestrimeve dhe konfiskimeve për veprat penale në fushën e krimit të organizuar.

- Është hartuar dhe miratuar në KM “Ligji për profesionin e ndërmjetësit të pasurive të paluajtshme”.

- Është hartuar dhe miratuar në KM Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 110/2018 “Për noterinë”.

Të drejtat e njeriut

Në bazë të Raportit të Komisionit Evropian për 2021, në përgjithësi, Shqipëria respekton instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore. Progres është shënuar në fushën e të drejtave për pronën, për sa i përket regjistrimit, digjitalizimit dhe zbatimit të skemës së kompensimit. Në lidhje me të drejtat e minoriteteve, është miratuar një akt nënligjor shtesë për arsimin e pakicave kombëtare, por pjesa tjetër e akteve nënligjore priten ende të miratohen. Po ashtu, është miratuar ligji për censusin e popullsisë, si dhe është përmirësuar kuadri ligjor kundër diskriminimit. Është arritur progres në aspekte të tjera të të drejtave themelore, për shembull në zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe për barazinë gjinore. Është bërë veçanërisht progres në garantimin e financimit të duhur për zbatimin e Strategjive përkatëse,

ndërkohë që në qershor u miratua një Strategji e re për Barazinë Gjinore 2021 – 2030. Po ashtu, janë miratuar aktet nënligjore të lidhura me Ligjin për Strehimin Social.

Të Drejtat e Pronës

Të drejtat e pronës përfaqësojnë një nga elementet e rëndësishme si pjesë e kornizës së të drejtave themelore. Është shënuar progres në fushën e të drejtave pronësore sa i përket regjistrimit, digjitalizimit dhe zbatimit të skemës së kompensimit.

Prioriteti kryesor i Shqipërisë në aspektin e të drejtës së pronës është reformimi i shërbimeve publike në lidhje me të drejtat e pronësisë, me qëllim krijimin e një sistemi modern, efektiv dhe transparent, në përputhje me praktikën më të mira evropiane.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme, pjesë e Reformës së Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Tokës, është miratimi nga Kuvendi i ligjit 11/2018 “Për Kadastrën” dhe ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të ligjit 11/2018 “Për Kadastrën”, deri në shtator 2021, nga 16 akte nënligjore, janë miratuar vetëm 13 VKM, ndërsa në zbatim të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, deri në shtator 2021, nga 19 akte nënligjore, janë miratuar vetëm 13 VKM.

Procesi i përfundimit të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme është duke vijuar. Regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme është kryer në 2.738 zona kadastrale nga 3.058 zona kadastrale që janë gjithsej, nga të cilat 2.625 zona rurale kadastrale dhe 124 zona urbane kadastrale. Nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar në 320 zona kadastrale, me rreth 360 mijë pasuri të paluajtshme. Numri i pasurive të regjistruara është afërsisht 3.542.107 prona nga 4 milionë që është përllogaritja e numrit total të pasurive të paluajtshme në territorin e vendit. Gjatë vitit 2021 ka përfunduar regjistrimi fillestar në 5 zona kadastrale, me rreth 5 mijë regjistrime shtesë të pasurive të paluajtshme.

Në lidhje me procesin e legalizimit, gjatë periudhës 2006 – 2013 janë legalizuar 21 750 ndërtime informale, kurse për periudhën 2014 – shtator 2021 janë legalizuar 207 518 ndërtime informale.

*Kompensimi i pronave*

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka punuar për realizimin e objektivave të përcaktuar në ligjin 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe kompletimin e procesit të kompensimit të pronës”, si dhe ka ndërmarrë disa reforma për zbatimin e ligjit. Objektivat e ATP-së në zbatim të ligjit janë si vijon:

Vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën për kompensim. Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në publikimin e fundit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare Nr. 7, datë 23.02.2021, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vlerësuar gjithsej 26.091 vendime përfundimtare për kompensim të viteve 1993–2013, me një faturë financiare prej 101,125,075,949 lekë;

- Kompensimi financiar dhe fizik i vendimeve përfundimtare. Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, ATP ka ekzekutuar 794 vendime, me një vlerë prej 7,842,824,598.92 lekë (vlëra e kompensimit financiar plus vlëra e llogaritur për kompensim financiar të kërkesave të veçanta) dhe 72 vendime për mbyllje procedimi. Janë shpërndarë 713.22 ha tokë si fond fizik dhe është realizuar trajtimi i kërkesave për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI). Gjithashtu, janë ekzekutuar gjithsej 7 626 kërkesa që nga viti 2016 dhe është shpërndarë vlëra financiare prej 9,290,080,287 lekë;

- Trajtimi i kërkesave të reja të depozituara për njohje pronësie. Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015, ATP ka pasur një afat trevjeçar për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie dhe ka regjistruar në total 16 462 kërkesa për njohje pronësie. Gjatë periudhës nga miratimi i ligjit deri në përfundim të afatit ligjor (2016 – 2019), ATP ka arritur të trajtojë 9 512 kërkesa për njohje pronësie dhe për 6 950 kërkesat e patrajuara, ATP ka përfunduar procedurën e njoftimeve duke bërë me dije subjektet se për njohjen dhe kompensimin e pronës së pretenduar duhet të drejtohen në gjykatë. Është vijuar gjithashtu me përgatitjen dhe arkivimin e dosjeve, në kuadër të të cilit janë tërhequr 3 618 dosje nga subjektet.

- Përparimi i nevojshëm në digjitalizimin dhe hartëzimin e pronave. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka bërë përparim në procesin e digjitalizimit dhe hartëzimit të pronave me krijimin e sistemit elektronik të digjitalizuar Web – Gis. Krijimi i një “harte” unike “vendimesh”

në lidhje me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave mundësoi inventarizimin dhe skanimin e situatës së krijuar ndër vite për të gjitha dosjet që janë trajtuar me vendime nga ish-KKKP-ja, ZRKKP-ja apo AKKP-ja, si dhe mundëson transparencë të institucionit ndaj subjekteve të ligjit dhe përmirësim të efikasitetit të punës në ATP. Gjatë periudhës 2013 – tetor 2021, nga procesi i skanimit të gjendjes aktuale të dosjeve dhe vendimeve të dhëna ndër vite rezulton se:

- Numri i vendimeve të skanuara në regjistrin elektronik të vendimmarrjes së AKKP-së nga viti 1993 deri në ditët e sotme është 123 079 vendime.

- Numri i vendimeve për kthimin dhe kompensimin e pronave të hartografuara është 65 872 hartografime.

- Numri i dosjeve të digjitalizuara është 59 479 dosje.

Sistemi i burgjeve

Në zbatim të misionit të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i ka kushtuar një vëmendje të veçantë krijimit të kushteve të duhura për zbatimin me rigorozitet të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor ekzistues duke u siguruar që të gjitha organet e zbatimit të ligjit të garantojnë trajtimin njerëzor të personave me liri të kufizuar.

Për këtë qëllim dhe në përmbushje të rekomandimeve të dhëna nga strukturat ndërkombëtare, puna është fokusuar kryesisht në ndjekjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës në lidhje me sistemin e burgjeve. Tashmë të gjitha rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bërë pjesë e një Plani të posaçëm Veprimi për adresimin, trajtimin dhe zbatimin e tyre në terma afatshkurtër dhe afatmesëm. Numri total i rekomandimeve specifike të lëna për periudhën e monitorimit janar 2020 – shtator 2021 është 64, prej të cilave 27 janë realizuar, 32 janë në proces dhe 5 nuk janë realizuar.

Lidhur me uljen e mbipopullimit në burgje, sipas të dhënave më të fundit, sistemi i burgjeve është në nivel nënpopullimi -6%. Kjo ka ardhur si rezultat i ngritjes së institucioneve të reja, aplikimit të dënimeve alternative, si dhe zbatimit rigoroz të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.



Me mbështetjen e ekspertëve të Këshillit të Evropës, janë rishikuar të gjitha modulet dhe më specifikisht moduli i "Mekanizmit për Parandalimin e Torturës dhe Keqtrajtimit". Mbi këtë tematikë janë zhvilluar trajnime për trajnerë, si dhe trajnime të stafit të vijës së parë dhe të nivelit të mesëm lidhur me parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit. Gjithashtu, një zhvillim pozitiv në drejtim të vlerësimit të performancës është hartimi i një liste kontrolli lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut në burg, si dhe është publikuar Manuali i të Drejtave të të Burgosurve dhe janë shpërndarë postera informues mbi të drejtat e të dënuarve.

- Në bazë të Ligjit Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", personat me masë mjekësore të detyrueshme duhet të trajtohen nga pikëpamja mjekësore në institucionet e kujdesit shëndetësor që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Duke marrë në konsideratë urgjencën e nevojës së adresimit të masave për këtë kategori, referuar edhe Rrekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës (CPT), si dhe vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për rastin "Strazimiri kundër Shqipërisë", në muajin nëntor 2021 u krye transferimi i 302 i personave me masë mjekësore që vuanin dënimin në IEPV Zahari- Krujë drejt IEVP Lezhë, për t'u ofruar trajtimin e duhur terapeutik dhe trajtimin në përputhje me standardet e kërkuara.

Mbrojtja e të Dhënave Personale

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale përbëhet nga ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, i përafëruar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46/EC të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të procesit të përafrimit të këtij ligji me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680, si një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare, Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me ekspertët e projektit të binjakëzimit "*Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me acquis e Bashkimit Evropian*", ka përgatitur draftin e projektligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të përafëruar me GDPR dhe Direktivën

e Policisë. Po ashtu, janë hartuar dokumentet shoqëruese të projektligjit, si Vlerësimi i Ndikimit të Impaktit (RIA), Relacioni Shoqërues dhe Tabela e Përputhshmërisë (ToC). Gjithashtu, në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit janë rishikuar dhe përgatitur 7 akte nënligjore në përputhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Me qëllim ofrimin e njohurive dhe instrumenteve organizative për të trajtuar sfidat e mundshme në lidhje me zbatimin e kuadrit të ri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar:

- 5 module trajnimi për stafin e Zyrës së Komisionerit mbi kuadrin e GDPR dhe Direktivës së Policisë nga ekspertët të Projektit të Binjakëzimit;

- 3 module trajnimi duke parë rastet në praktikë të implementimit të GDPR dhe Direktivës së Policisë, me qëllim rritjen e kapacitetit administrativ të Zyrës së Komisionerit për të menaxhuar kuadrin e ri ligjor mbi mbrojtjen e të dhënave personale;

- Zhvillimi i një vizite studimore të improvizuar online me qëllim ofrimin e njohurive të nevojshme dhe praktikave më të mira të Italisë dhe Austrisë për stafin e Zyrës së Komisionerit, në lidhje me GDPR dhe Direktivën e Policisë.

Me qëllim që kontrolluesit dhe përpunuesit të veprojnë në përputhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me ekspertët e Projektit të Binjakëzimit, ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjëse me kontrollues dhe përpunues të sektorëve të ndryshëm. Ndër të tjera, në këtë kuadër:

- Janë realizuar 9 aktivitete ndërgjegjëse me pjesëmarrjen e më shumë se 510 përfaqësuesve nga sektorë të ndryshëm;

- Është hartuar 1 komentari në lidhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale;

- Janë hartuar 4 udhëzues në lidhje me detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve, të cilët vijnë në zbatim të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Të Drejtat e Fëmijëve

Shqipëria ka miratuar një kornizë solide normative lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" është i përafëruar me



Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe mund të krahasohet me standardet më të përparuara evropiane në këtë fushë. Në zbatim të këtij ligji janë miratuar 18 akte nënligjore, nga të cilat 13 janë VKM dhe 5 janë Udhëzime.

Më datë 3 nëntor 2021, Qeveria Shqiptare ka miratuar Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026. Ky dokument strategjik konsolidon dhe krijon vazhdimësi të punës së kryer në kuadër të Agjendës Kombëtare të mëparshme për të drejtat e fëmijëve (2017 – 2020), duke adresuar boshllëqet e vazhdueshme dhe sfidat e reja dhe duke reflektuar perspektivat inovative, dhe sidomos ato të lidhura me Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve. AKDF-ja konsolidon dhe krijon vazhdimësi me Planin e Veprimit për Fëmijë 2017 – 2020.

AKDF-ja përmban 4 qëllime strategjike:

- Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve;
- Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve;
- Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë;
- Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Qëllimet e identifikuara mundësojnë vazhdimësinë e Agjendës së mëparshme Kombëtare dhe përafrimin me Strategjinë Evropiane, duke përfshirë përparësitë e Këshillit të Evropës. Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale.

Kuadri strategjik për drejtësinë penale për të mitur

Ministria e Drejtësisë monitoron periodikisht zbatimin e dokumentit strategjik “Strategjia e Drejtësisë për të Mitur”, i shoqëruar me Planin e Veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021, miratuar me VKM Nr. 541, datë 19.09.2018.

Risi e reformës së drejtësisë penale për të mitur janë dhe institucionet e reja, si Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), si dhe Instituti Multidisiplinor i të Miturve. Në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Këshilli i Ministrave miratoi VKM Nr.

314, datë 15.05.2019 “Për organizimin, funksionimin, si dhe përcaktimin e rregullimeve specifike lidhur me strukturën dhe organikën e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve”. Qendra filloi funksionimin më datë 23.03.2021. Misioni i saj kryesor është realizimi i veprimtarisë rehabilituese dhe riintegruese nëpërmjet mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të miturve/të rinjve pas kryerjes së dënimit.

Gjatë periudhës prill – dhjetor 2021, QPKMR ka hartuar draft-Rregulloren për Metodën e Brendshme të Punës dhe Sjelljen e Personelit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Po ashtu, janë bërë kërkime studimore nga eksperiencat e vendeve të tjera për hartimin e modeleve të programeve rehabilituese, riintegruese dhe parandaluese për të miturit/të rinjtë pas kryerjes së dënimit, duke krijuar një panoramë të qartë mbi modelet e programeve rehabilituese, riintegruese dhe parandaluese për të miturit/të rinjtë, të cilat janë efektive edhe pas kryerjes së dënimit, mbi faktorët e riskut që mund të ndikojnë në një sjellje devijante në shoqëri, si dhe mbi rëndësinë e qasjes multidisiplinare dhe bashkëpunimit ndër-institucional në trajtimin e të miturve pas kryerjes së dënimit.

Gjithashtu, është vënë në funksion për herë të parë Sistemi i Integruar të të Dhënave të Drejtësisë për të Mitur, i cili është i aksesueshëm për përdoruesit e autorizuar në adresën <https://www.drejtisipertemitur.org>.

Instituti Multidisiplinor për Rehabilitimin e të Miturve, i krijuar me VKM Nr. 233, datë 17.04.2019, është konceptuar si një mekanizëm që do të zbatojë programet e rehabilitimit dhe riintegrimin për të miturit që janë dënuar me vendim gjykatë me dënim me heqje lirie. Instituti parashihet të funksionojë si një institucion gjysmë i hapur, ku të miturve do t’u kufizohet liria e veprimit/lëvizjes deri në masën që do të pengohen nga kryerja e veprave penale, veçanërisht me synim riintegrimin dhe risocializimin e të miturve në komunitetet e tyre. Lidhur me funksionimin e këtij institucioni, përgjatë vitit 2021 është ngritur Grupi i Punës në Ministrinë e Drejtësisë, i cili po ndjek të gjitha hapat për zbatimin e projektit për ngritjen e Institutit.

Në kuadër të përmirësimit të performancës së sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, në nivel vendor



janë ngritur dhe funksionojnë Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF), të cilat kanë përgjegjësi identifikimin, vlerësimin, marrjen në mbrojtje dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët në rrezik dhune, abuzimi, shfrytëzimi apo neglizhimi. Në të gjithë vendin deri në 2021, kemi një rritje të këtij numri në 241 punonjës për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë vendosur në njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në 61 bashki dhe në njësitë administrative.

Barazia gjinore

Shqipëria ka miratuar një kornizë solide normative që promovon, zbaton dhe monitoron barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin në bazë të seksit, krahas legjislacionit dhe politikave të miratuara me fokus të veçantë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe parimet për fuqizimin ekonomik të gruas dhe mbrojtjen e saj nga çdo formë dhune përkthehen më tej në ligje, politika dhe strategji, ku mund të përmendim Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030, miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021.⁵⁶ Masat dhe veprimet e parashikuara në këtë Strategji ndërthuren me masat dhe veprimet e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020 – 2025 të Bashkimit Evropian. Në tërësinë e saj Strategjia përbëhet nga katër Qëllime Strategjike kryesore:

- Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, personat me aftësi ndryshe, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.

- Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet (zonat rurale, minoritetet etnike, personat me aftësi ndryshe, LGBTI+, të moshuara, nëna të vetme, gra dhe vajza të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.) për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të

barabartë në vendimarrjen politike e publike në nivel vendor;

- Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;

- Aplikimi i integritit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

Një sërë Objektivash specifike reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të barazisë gjinore, bazuar edhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me emergjencat civile, fatkeqësitë natyrore apo fushat e reja deri më tani të paadresuara apo shumë pak të adresuara në lidhje me barazinë gjinore (mjedisi dhe ndryshimet klimatike, digjitalizimi, etj.).

Dhuna në familje

Në vitin 2021 është miratuar VKM Nr. 327, datë 2.6.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe përpunimin e tij, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës”. Ky mekanizëm i cili synon parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, përmes identifikimit dhe raportimit, referimit dhe menaxhimit të rasteve të dhunës, mbështetjes dhe rehabilitimit të viktimave të të gjitha formave të kësaj dhune, si dhe ndëshkimit të dhunuesve e dhënies së mundësisë për rehabilitimin e tyre në programet përkatëse. Për sa i përket ligjit penal, ndryshimet në Kodin Penal në vitin 2020 njohën dhunën psikologjike, si dhe dhunën nga partneri intim si forma të dhunës në familje, e duke rritur njëherësh dënimet me burg për autorët e dhunës në familje.

Mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale koordinon dhe monitoron politikat për përfshirjen sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara, në përputhje me parimet e Konventës së OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Gjatë viteve 2020 – 2021 qeveria shqiptare po zbaton Reformën e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar. Kjo reformë përmirëson cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga ky sistem me vlerësim multidisiplinar, bazuar në nevojat e individit për të lehtësuar integrimin social. Reforma mundëson zgjerimin e një rrjeti të shërbimeve

⁵⁶ Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 112, datë 15.07.2021.

Shiko linkun

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/112/09a2849b-98f1-4800-8b90-fd824b449346>



sociale integruese, nëpërmjet punësimit dhe formimit profesional që do të zbatohet në bashkëpunim me qeverisjen vendore.

Për më shumë informacion për përfshirjen dhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara, lutemi referohuni tek Kapitulli 19 “Politikat Sociale dhe Punësimi”.

Mbrojtja e Pakicave Kombëtare

Detyrimet për zbatimin e ligjit 96/2017 “Për pakicat kombëtare” dhe nxjerrjen e akteve nënligjore vijnë në vazhden e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 849, datë 03.06.1999. Për sa i përket miratimit të legjislacionit zbatues në lidhje me ligjin kuadër të vitit 2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare, në dhjetor 2020 u miratua një akt nënligjor shtesë për arsimin e pakicave, i cili e çoi numrin e akteve nënligjore të miratuara në tetë, nga 12 të tilla të parashikuara.

Në lidhje me 4 aktet nënligjore të mbetura, dy prej tyre janë ende në proces shqyrtimi, konkretisht:

- Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr. 96/2017)”.

- Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/ verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”.

Tashmë ka përfunduar procedura e konsultimit me Ministrinë e Linjës për Projektvendimin “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore” dhe në përputhje me procedurat e brendshme ligjore, Projektvendimi do t’i përcillet Këshillit të Ministrave për miratim.

Pas hartimit të Projektvendimit nga Komiteti i Pakicave Kombëtare dhe përfundimit të procesit të konsultimit të ta gjithë grupeve të interesit, projektvendimi “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe

administrimin e “Fondit për Pakicat Kombëtare”, është në proces konsultimi ndërinstitucional me Ministrinë e Linjës, për t’iu përcjellë më tej për miratim Këshillit të Ministrave.

Të drejtat procedurale

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një nga format më thelbësore të aksesit në drejtësi që çdo shtet duhet ta garantojë në mënyrë efikente dhe efektive. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është një ndër ligjet e miratuara në kuadër të reformës në drejtësi, përmes të cilit u reformua i gjithë sistemi i ndihmës juridike duke ofruar një frymë të re, në sinkron me kërkesat dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian, dhe në zbatim të ligjit janë miratuar të gjitha aktet nënligjore të cilat synojnë të rregullojnë kuadrin ligjor të detajuar për çdo fushë specifike të ndihmës juridike.

Shërbimi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me ndryshimet e reja, është ndarë në 3 forma duke synuar zgjerimin e llojit të shërbimeve ligjore falas, konkretisht:

- Ndihmë juridike parësore (duke përcaktuar qartë ofruesit e këtij shërbimi me synimin për ta rrjetëzuar dhe shtrirë këtë shërbim në të gjithë territorin);

- Ndihmë juridike dytësore (ofruar nga avokatët e miratuar nga DHASH);

- Përrjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Aktualisht qytetarët përfitojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në 10 qytete (Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Gjirokastrë, Pogradec, Vlorë, Shkodër, Lushnjë dhe Dibër). Ndërkohë, pritet hapja e qendrave të reja të shërbimit të ndihmës juridike parësore, konkretisht në Berat, Elbasan, Korçë dhe Kukës, duke e çuar numrin total të qendrave të administruara në 14. Gjithashtu, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur Marrëveshje me 11 klinika ligjore pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë për të ofruar ndihmë juridike parësore, si dhe është në proces të lidhjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Universitetin Epoka. Njëherësh, edhe organizatat jofitimprurëse parashikohen si një ndër ofruesit e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti. Ministri i Drejtësisë ka autorizuar për herë të parë për ofrimin e ndihmës juridike 12 organizata jofitimprurëse. Për sa u përket të dhënave statistikore për ndihmën juridike parësore, numri i



rasteve të trajtuara për periudhën janar – tetor 2021 është 6 772 raste.

Për sa i përket ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore, mundësohet mbulimi me avokatë ofrues të ndihmës juridike dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për vitin 2021 kanë nënshkruar kontratë me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas për ofrimin e ndihmës juridike dytësore 124 avokatë, kurse për vitin 2020 kanë rezultuar 73 avokatë si pjesë të listës së ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Në lidhje me të dhënat statistikore për ndihmën juridike dytësore, regjistrohen 665 vendime të pranuarra për vitin 2021.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar gjithashtu edhe forcimit të kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore, duke ofruar trajnime të detyrueshme për punonjësit e qendrave që ofrojnë këto shërbime në bashkëpunim me ASPA dhe UNDP.

Me qëllim forcimin e aksesit në drejtësi dhe edukimit ligjor të qytetarëve, një rëndësi e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit ndërinstitutional dhe promovimit të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Konkretisht, është bërë i mundur nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe zhvillimi i takimeve ndërmjet aktorëve të sistemit të ndihmës juridike me fokus promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

4.23.5 Lista e ministrive dhe Institucioneve përgjegjëse

- Kuvendi;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Kulturës;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Gjykata e Lartë;
- Gjykata Kushtetuese;
- Kontrolli i Lartë i Shtetit;
- Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit;
- Kolegji i Posaçëm i Apelit;
- Institucioni i Komisionerëve Publikë;

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë;
- SPAK;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Prokuroria e Përgjithshme;
- Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;
- Departamenti i Administratës Publike;
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA);
- Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Agjencia e Trajtimit të Pronave;
- Avokati i Popullit;
- Avokatura e Shtetit;
- Instituti i Statistikave;
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës;
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- Komiteti i Pakicave Kombëtare;
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

4.23.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Gjyqësori

Objekti i harmonizimit në fushën e drejtësisë është vendosur në bazë të standardeve të parashikuara në *acquis* e BE në formën e Rekomandimeve/Udhëzimeve dhe Opinioneve që kanë të bëjnë me Pavarësinë dhe Paanshmërinë, Llogaridhënie, Profesionalizmin dhe Kompetencën, si dhe Cilësinë e Drejtësisë dhe Eficiencën. Sipas analizës ligjore të kryer deri më tani, kuadri ligjor kombëtar është përgjithësisht në përputhje me *acquis* e BE-së për Nënkapitullin e Gjyqësorit.

Brenda objektivave të përcaktuara nga kuadri i politikave kombëtare për këtë fushë, kuadri strategjik i Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2021 – 2025 ka si vizion një sistem të drejtësisë të pavarur, llogaridhënës, të aksesueshëm, transparent



dhe eficient që mbron të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane. Ky vizion synohet të jetësohet përmes katër Qëllimeve të Politikës të cilat janë:

- funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien;

- fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;

- një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;

- koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

Në lidhje me zbatimin e kornizës së politikave kombëtare në këtë fushë, është thelbësor vijimi i konsolidimit të kapacitetit të sistemit gjyqësor dhe institucioneve të qeverisjes, duke përfshirë fuqizimin e mëtejshëm të sistemit për edukimin ligjor dhe me finalizimin dhe zbatimin e hartës së re gjyqësore.

Në nivel normativ:

- Duhet të miratohet dhe të zbatohet Harta e re gjyqësore për rishpërndarjen e gjyqtarëve dhe burimeve brenda sistemit gjyqësor.

Sikurse është sqaruar në seksionin për eficientën në sistemin e drejtësisë, përgjatë gjashtë mujorit të fundit janë ndërmarrë hapa cilësorë për finalizimin e projektit të hartës së re gjyqësore. Në vijim të një sërë takimesh në nivel drejtues dhe teknik, propozimi i përbashkët do të dakortësohet brenda muajit dhjetor. Përgjatë tremujorit të parë të vitit 2022 do të hapet rrugë procesit të konsultimit me të gjithë aktorët e interesuar, i cili do të pasohet nga miratimi i hartës përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Në nivel zbatimi:

- Nevojiten politika vendimtare, planifikim dhe përpjekje buxhetore në mënyrë urgjente për të ngritur një Sistem të ri të Integruar për

Menaxhimin e Çështjeve dhe për të garantuar ndëroperacionalitetin e tij në të gjithë sistemin e drejtësisë, në harmoni me metodologjinë e CEPEJ.

Për sa u përket Sistemeve të Menaxhimit të Çështjeve në përdorim nga sistemi gjyqësor në Shqipëri (Ark-It dhe ICMIS), ato kanë demonstruar një sërë mangësish që kërkojnë domosdoshmërisht investime madhore në sistem. Me krijimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, dhe vënies në funksion të Bordit Drejtues së saj krijohen premiset për të miratuar Udhërrëfyesin për ngritjen e një sistemi të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve.

Në nivelin institucional dhe administrativ:

- Nevojitet konsolidimi i kapacitetit të sistemit gjyqësor dhe institucioneve të qeverisjes së drejtësisë;

- Rekrutimi i inspektorëve shtesë në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ende i nevojshëm;

- Plotësimi i vakancave në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë.

Prioritetet

- Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të KPK për të avancuar ritmet e punës;

- Rivlerësimi me prioritet i subjekteve kandidatë për gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm;

- Hartimi dhe miratimi nga KLP i disa akteve nënligjore, si:

- Rregullorja “Për komandimin e magjistratit në një institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë”;

- Rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit të juridiksionit të përgjithshëm”;

- Rregullorja për Vlerësimin e Punës së Prokurorëve;

- Rregullorja “Për mënyrën e caktimit të kompensimit financiar që përfitojnë prokurorët në skemën e delegimit që delegohen, transferohen përkohësisht ose caktohen përkohësisht”;

- Kodi i Etikës i Prokurorëve.

- Bashkëpunimi i KLP me Shkollën e Magjistraturës, dhe me institucionet e tjera të



drejtësisë, si Prokurori i Përgjithshëm, SPAK, Ministria e Drejtësisë etj.;

- Rritja e numrit të kandidatëve për prokurorë, duke ruajtur standardet dhe cilësinë e prurjeve në Shkollën e Magjistraturës, me qëllim plotësimin e këtyre vakancave dhe funksionimin e duhur të sistemit prokurorial në tërësi;

- Përfundimi i trajtimit të të gjithë ankesave (*backlog*) të përcjella nga KLGJ me dy fonde, konkretisht (i) fondi i parë prej 757 praktika dhe (ii) fondi i dytë prej 1.347 praktikash;

- Trajtimi i ankesave të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda afatit ligjor;

- Rekrutimi i Inspektorëve Jomagjistratë;

- Ristrukturimi i godinës me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

- Trajtimi dhe rritja e kapacitetit të stafit dhe Njësisë së Inspektorëve dhe Ndhmës Inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

- Vënia në funksion e një Sistemi të ri të Integruar të Manaxhimit të Çështjeve.

- Përfundimi i procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë për të gjitha pozicionet e lira dhe identifikimin dhe zbatimin e mekanizmave për reduktimin e *backlog*-ut të çështjeve të prapambetura;

- Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Hartës së re Gjyqësore;

- Përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionet e lira në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- Vazhdimi i zbatimit dhe përfundimi i procesit të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve sipas Programit të Vlerësimit, në përputhje me skemën e re të vlerësimit të gjyqtarëve;

- Verifikimi dhe konfirmimi në detyrë i kancelarëve, në përputhje me Rregulloren mbi “Procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për Kancelar, për Këshilltar Ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për Ndhmës Ligjor në gjykatat e apelit”, të miratuar në vitin 2020;

- Rritja e burimeve njerëzore në gjykata për administratën gjyqësore në shkallë vendi.

Lufta kundër korrupsionit

Objektivi i harmonizimit në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është vendosur aktualisht në bazë të Rekomandimeve të mekanizmave monitorues të Konventave të Këshillit të Evropës, rekomandimeve të GRECO, Moneyval, si dhe rekomandimeve të FATF.

Sipas analizës ligjore të kryer deri më tani, kuadri ligjor kombëtar është pjesërisht i përputhur me *acquis* e BE, për Nënkapitullin e Politikave Kundër Korrupsionit .

Brenda objektivave të përcaktuara nga kuadri i politikave kombëtare për këtë fushë, kuadri strategjik i Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit synon të ketë institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm.

Në lidhje me zbatimin e kornizës së politikave kombëtare në këtë fushë, është thelbësore të demonstrohet progres i mëtijshëm drejt krijimit të një historiku solid të hetimit, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit, si dhe sekuestrimit dhe konfiskimit/rikthimit të aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin.

Në nivel normativ:

- Grupi ndër-institucional i punës kryesuar nga Zëvendësministri i Drejtësisë, me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, përfaqësues nga Prokuria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posaçme, ekspertë të fushës së sekuestrimit, konfiskimit dhe rikuperimit të aseteve kriminale, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri pritet të konkludojë brenda janarit 2022 analizën për modelin më të përshtatshëm ligjor dhe institucional për ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve. Më pas Ministria e Drejtësisë do të iniciojë procesin e hartimit të kuadrit ligjor përkatës;

- Me qëllim adresimin e Rekomandimeve të FATF dhe MONEYVAL për të forcuar luftën kundër pastrimit të parave, duhet të finalizohet puna e deritanishme me miratimin e projektligjit “Për ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme” dhe ndryshimeve në Ligjin 110/2018 “Për noterinë“

**Në nivel zbatimi:**

- Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar që Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe Gjykatat e Posaçme, të adresojnë me efikasitet korrupsionin në nivelet e larta dhe të garantojnë burimet e duhura, aftësinë dhe bashkëpunimin midis këtyre strukturave dhe subjekteve të tjera të prokurorisë dhe të gjyqësorit;

- Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit si dhe Rrjetit të Koordinatorëve në institucionet pjesë e rrjetit Kundër Korrupsionit, do të vazhdojë të jetë në fokus. Garantimi i historikut solid të rasteve të korrupsionit dhe propozimi dhe marrja e masave konkrete, përfshirë këtu dhe kallëzimet penale në prokurori janë në qendër të punës së këtyre strukturave. Ndërkohë, duhet të vijohet me vlerësimet e rrezikut brenda administratës qendrore, në kuadër të hartimit të planeve të integritetit, si mekanizëm parandalues.

Në nivel institucional dhe administrativ:

- Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë do të vijojë me rekrutimin e stafit në Drejtori, e cila duhet të vazhdojë punën e saj dhe të tregojë rezultate në praktikë për hetimin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit në administratën publike;

- Funksionimi me kapacitet të plotë i Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe adresimi prej tyre me efikasitet i korrupsionit në nivelet e larta, garantimi i burimeve të duhura, si dhe aftësimi dhe bashkëpunimi më i madh midis këtyre strukturave dhe subjekteve të tjera të prokurorisë dhe të gjyqësorit;

- Ngirja dhe vënia në funksionim i Sistemit Elektronike të Menaxhimit të Denoncimeve të Rasteve Korruptive (SEMDRK) pranë Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim gjurmimin e rasteve dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së denoncimeve nga qytetarët dhe bizneset;

- Mundësimi i funksionalitetit të plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë në ILDKPKI në fillim të vitit 2022.

Prioritetet

- Vijimi i procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme,

për të përmbushur numrin prej 20 prokurorësh të miratuar me vendim të Kuvendit;

- Zbatimi i Rekomandimeve të Raundit të Pestë të Vlerësimit të GRECO-s;

- Rritja e zbatueshmërisë së objektivave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si dhe adresimi i problematikave të evidentuara nga raportet e fundit;

- Hartimi i kuadrit ligjor për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve;

- Funksionimi me kapacitet të plotë i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit në institucionet pjesë e Rrjetit përmes trajnimeve për praktikant dhe taktikat të hetimit administrativ të korrupsionit;

- Përmbyllja e procesit të hartimit të planeve të integritetit në të gjitha ministrinë e linjës si mekanizma parandalues të bazuar mbi riskun e integritetit në këto institucione;

- Në lidhje me FATF: dalja nga lista gri e Shqipërisë në muajin shkurt të vitit 2022;

- Zbatimi i Strategjisë së Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020–2024 dhe Plani i Veprimit 2020 – 2022”, miratuar me VKM Nr. 554, datë 15.07.2020;

- Miratimi i ligjit “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, i hartuar nga grupi i punës së Shërbimit, nën asistencën e Drejtorisë Juridike të Ministrisë së Brendshme dhe programit ICITAP. Tashmë ligji është në fazën e miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë. Prioritet është draftimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, duke mundësuar zbatimin e tij;

- Forcimi dhe rritja e zbatueshmërisë së Marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe Protokolleve të Veprimit, të lidhura nga SHÇBA, kryesisht me Prokurorinë e Posaçme, Prokuroritë e Shkallës së Parë, Policinë e Shtetit, SHISH, AISM etj.;

- Përdorimi me efikasitet i fondeve të sekuestruara në funksion të luftës kundër krimit të organizuar, duke mbështetur institucionet e përfshira në këtë proces, si dhe OJF-të që merren me trajtimin e viktimave të krimit të organizuar;

- Kapja në kohë dhe me efikasitet e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.



- Rritja e të ardhurave nëpërmjet dhënies me qira të pasurive asete kriminale;

- Realizimi në bazë të një plani kalendarik kontrolli të miratuar, për mirëadministrimin e të gjitha pasurive në administrim;

- Përmirësimi i marrëdhënieve me institucionet e tjera si SPAK, PP, OPGJ, ASHK, DPPP për sa i përket zbatimit të Memorandumeve të nënshkruara të Bashkëpunimit;

- Modernizimi dhe përshtatja e sistemit të informatizuar.

Të drejtat e njeriut

Objekti i harmonizimit në fushën e të drejtave të njeriut bazohet në akte të *acquis* së BE të këtij kapitulli. Sipas analizës ligjore të kryer deri më tani, kuadri ligjor kombëtar është pjesërisht i përafëruar me *acquis*-në e BE-së për Nënkapitullin e të Drejtave të Njeriut.

Në nivel normativ:

- Përafrimi i legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE-së 679/2016 dhe Direktivën 680/2016;

- Miratimi i akteve nënligjore të mbetura për të drejtat e minoriteteve.

Në nivel zbatimi:

- Nevojitet zbatimi në mënyrë efektive i kuadrit ligjor për sistemin e drejtësisë për të miturit;

- Duhet të vijojë procesi i regjistrimit fillestar të pronave të paluajtshme dhe zbatimi i ligjit për finalizimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në një mënyrë tranzitore dhe përfshirëse;

- Nevojitet përmirësimi i sigurisë dhe aksesit të kufizuar në përdorimin e të dhënave personale në bazat e të dhënave nën kontrollin e shtetit;

- Të shtrihet harta e shërbimeve të ndihmës juridike që u ofrohen qytetarëve;

- Vënia në funksionim të plotë të Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve;

- Kuadri ligjor kundër diskriminimit është përmirësuar edhe më tej, por nuk është zhvilluar ende praktika ligjore;

- Duhet të garantohet zbatimi i Kodit të Punës dhe të fuqizohet mbrojtja e punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë.

Në nivel institucional dhe administrativ:

- Zhvillimi i trajnimeve dhe veprimtarive ndërgjegjësuere nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale grupeve të veçanta në fokus nga sektori publik, privat dhe shoqëria civile;

- Rritja e kapaciteteve të stafit inspektues të Zyrës së Komisionerit për t'i pajisur me njohuri dhe kompetenca të nevojshme për të adresuar nevojat inspektuese si në aspektin sasior, ashtu edhe cilësor;

- Vënia në funksionim të plotë të Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të dhe të Rinjve dhe forcimi i kapaciteteve të stafit.

Prioritetet

- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit që përafron Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE-së 679/2016, dhe Direktivën 680/2016;

- Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, me fokus, ndër të tjera, verifikimin e respektimit të parimeve dhe kritereve të përpunimit dhe masave tekniko-organizative në lidhje me garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetin e të dhënave;

- Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në mjedisin digjital;

- Sipas vlerësimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2022 janë parashikuar për t'iu nënshtruar regjistrimit fillestar 60 zona kadastrale rurale, për vitin 2023 janë parashikuar për t'iu nënshtruar regjistrimit fillestar 70 zona kadastrale rurale, dhe për vitin 2024 janë parashikuar gjithashtu për t'iu nënshtruar regjistrimit fillestar 70 zona kadastrale rurale.⁵⁷ Konsolidimi i mëtejshëm dhe forcimi i të drejtave të pronësisë duke avancuar me zbatimin e skemës së kompensimit të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit; kompensimin për komunitetet fetare; kompensimin për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet informale dhe duke e bërë të nevojshme progresin në digjitalizimin dhe hartëzimin e pronës;

⁵⁷ Ecuria e këtij procesi është në varësi të fondeve të alokuara, për arsye se ASHK është një institucion me vetëfinansim.



- Digjitalizimi i ofrimit të ndihmës juridike, krijimi i aplikacionit telefonik të platformës juristonline.al;

- Krijimi i një sistemi të integruar të dhënash për shërbimin e ofruar të ndihmës juridike, sistem i cili do të aksesohet nga të gjithë ofruesit e shërbimit (Case Management System);

- Hapja e qendrave të reja të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore me qëllim mbulimin e 100% të territorit të RSH sipas qarqeve;

- Financimi i Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë (të cilat do të implementojë projektet e tyre me qëllim garantimin e aksesit të barabartë në drejtësi sipas fokus grupeve);

- Zbatimi i “Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026” i miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave datë 03.11.2021;

- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, 2021 – 2030;

- Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje dhe avancimi drejt eliminimit të këtyre formave të dhunës nëpërmjet një sërë masash e veprimesh që do të fokusohen në vitet në vazhdim tek informimi, ndërgjegjësimi (edhe përmes fushatave ndërgjegjëse të përvitshme në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave, apo aktivitete në kuadër të ditëve të shënuara), si dhe krijimi i brezit të barazisë;

- Mekanizma të Koordinuar të Referimit në mbarë vendin (61 bashki) të specializuara për trajtimin efektiv të të gjitha rasteve të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të anëtarëve të këtyre mekanizmave;

- Forcimi i kapaciteteve organizative dhe funksionale të sistemit penitenciar;

- Përmirësimi i shërbimit penitenciar profesional përmes trajnimeve të fokusuara dhe të vazhdueshme;

- Forcimi i mekanizmit të kontrollit të brendshëm përmes ofrimit të një mandati më të gjerë dhe kapaciteteve të përmirësuara operacionale;

- Forcimi i ofrimit të kujdesit shëndetësor të burgosurve, duke përfshirë edhe kujdesin për shëndetin mendor;

- Përmirësimi i proceseve të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e burgjeve;

- Përmirësimi i kushteve infrastrukturore të institucioneve penitenciare, nëpërmjet investimeve dhe pajisjeve logjistike.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së për Kapitullin 23 të *acquis*-së “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian është një detyrim i cili buron prej Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Në këtë kuadër, Shqipëria vazhdon përpjekjet për të përafruar në mënyrë graduale legjislacionin e brendshëm me atë të BE, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe shtrimin e rrugës drejt BE. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Institucionit Lider për Kapitullin 23, ka parashikuar si prioritet për vitin 2022 për t'u përafruar me legjislacionin e BE-së masat ligjore të analizuara si më poshtë vijon:

- Përafrimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27.04.2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon Vendimin Kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.

Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale përbëhet nga ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, përafruar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46/KE të Bashkimit Evropian.

Me hyrjen në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) në maj të vitit 2018, lindi nevoja e përafrimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me këtë akt dhe me Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27.04.2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga



autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/JHA.

Edhe pse GDPR është Rregullore, kompleksiteti i saj kërkon që të ndërmerren hapat e nevojshëm për ndryshimet legjislative në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e saj me kuadrin ligjor në fuqi. Qëllimi i GDPR-së është që të mbrojë privatësinë dhe shkeljet e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale në një kohë kur përpunimi i të dhënave në kuadër të zhvillimeve teknologjike është shumëfishuar nga koha në të cilën është themeluar Direktiva e vitit 1995. Megjithatë parimet kryesore të mbrojtjes së të dhënave janë akoma në përputhje me direktivat e mëparshme, shumë ndryshime janë propozuar për politikën rregullatore. Disa nga risitë që sjell kjo Rregullore mbi mbrojtjen e të dhënave personale janë:

- *Zgjerimi i shtrirjes territoriale të efekteve të saj ligjore:*

Ndoshta ndryshimi më i madh në peizazhin rregullator të mbrojtjes së të dhënave vjen me juridiksionin e zgjeruar të efekteve të GDPR. Më parë, aplikimi territorial i direktivës ishte i paqartë. GDPR e bën zbatueshmërinë e saj shumë të qartë. GDPR do të jetë e zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale nga kontrolluesit dhe përpunuesit që ndodhen në vendet e BE-së, pavarësisht nëse përpunimi kryhet apo jo në këto vende.

- *Forcimi i kriterëve për dhënie të pëlqimit:*

Ka një qasje të re lidhur me konceptin e “pëlqimit” sipas GDPR-së. Në rregulloren e re trajtohen konkretisht aspektet praktike të pëlqimit dhe aspekte të tjera që lidhen me pëlqimin e të miturve ose pëlqimin me mjete elektronike.

- *Të drejtat e reja – E drejta për t’u harruar/ “Right to be forgotten”:*

Kjo do të thotë që subjekti i të dhënave ka të drejtën t’i kërkojë kontrolluesit të bëjë fshirjen e të dhënave personale në lidhje me të, pa vonesë, dhe kontrolluesi ka detyrimin të fshijë të dhënat personale, bazuar në shkaqet e parashikuara në Rregulloren e BE-së.

- *E drejta e transferueshmërisë së të dhënave – Data Portability:*

Subjekti i të dhënave ka të drejtën të marrë të dhëna personale që ai ose ajo i ka dhënë

kontrolluesit, në një format të strukturuar, të përdorur gjerësisht dhe të lexueshëm automatikisht dhe ti transferojë ato të dhëna te një kontrollues tjetër pa pengesë.

- *Forcimi i llogaridhënies:*

GDPR sjell një forcim të llogaridhënies në raport me përpunuesit e të dhënave. Kontrolluesit janë të detyruar të tregojnë më shumë vëmendje në respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave dhe të drejtave në çdo fazë të përpunimit të të dhënave, duke krijuar një kulturë të monitorimit, rishikimit dhe vlerësimit të procedurave të përpunimit të të dhënave apo dhe përmes rritjes së sanksioneve ndaj moszbatuesve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave.

- *Rritja e transparencës:*

Parimi i transparencës kërkon që çdo informacion që i drejtohet publikut ose subjektit të të dhënave të jetë konciz, i aksesueshëm lehtësisht dhe i lehtë për t’u kuptuar, dhe të përdoret gjuhë e lehtë dhe e qartë, e përveç kësaj, sipas rastit, edhe vizualizim.

- *Mbrojtja e të dhënave të fëmijëve:*

Fëmijët meritojnë mbrojtje specifike në lidhje me të dhënat e tyre personale, pasi ata mund të jenë më pak të ndërgjegjshëm për rreziqet, pasojat dhe garancitë përkatëse dhe të drejtat e tyre në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

- *Forcimi i pavarësisë së Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:*

GDPR garanton pavarësinë e plotë të Autoriteteve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke sugjeruar rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare.

- *Krijimi i rrejtës të Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave (DPO):*

GDPR sjell si risi detyrimin për caktimin e Oficerëve të Mbrojtjes së të Dhënave, të cilët duhet të caktohen me qëllimin për të vlerësuar nëse një organizatë kryen një përpunim të gjerë të të dhënave personale.

- *Certifikimi i kontrolluesve – përpunuesve të mbrojtjes së të dhënave:*

Në zbatim të nenit 43 të Rregullores 2016/679, kërkohet certifikimi i kontrolluesve të mbrojtjes së të dhënave sipas kërkesës së tyre. Në këtë kuptim, autoriteti mbikëqyrës duhet të ketë krijuar kushtet e nevojshme ligjore për:

- Hartimin dhe miratimin e aktit ligjor ose nënligjor “Për certifikimin e sistemeve të



menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”;

- Akreditimin e organit certifikues;
- Certifikimin e kontrolluesve.

Sa më sipër, qëllimi i parashikimit të këtij akti në PKIE është harmonizimi i të gjithë kuadrit ligjor ekzistues për mbrojtjen e të dhënave personale me praktikatat më të mira të BE-së, në mënyrë që të garantohen standarde evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Sikurse vërehet, risitë që sjell rregullorja e GDPR janë të shumta. Edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e BE, si një vend që aspron integrimin, duhet të ndjekë trendin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me *acquis*.

Gjithashtu, përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bashkimit Evropian 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27.04.2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit ose ndjekjes së veprave penale ose të ekzekutimit të vendimeve penale, dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” që shfuqizon vendimin kuadër të Këshillit 2008/977/JHA është aktualisht një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare si një nga detyrimet e parashikuara edhe në Raportin e Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021.

Në këtë kontekst, për vetë rëndësinë që mbart Reforma e BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka iniciuar punën për përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë, ku nëpërmjet zbatimit me sukses të Projektit të Binjakëzimit, financuar nga programi i BE-së IPA 2017, sipas aktivitetit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis*-në e Bashkimit Evropian”, është përgatitur draft i projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, i përafëruar me GDPR dhe Direktivën e Policisë, i cili propozohet për t’u miratuar brenda tremujorit të katërt të vitit 2022.

Përafrimi i legjislacionit penal me direktivat e BE-së, si pjesë e Kapitullit 23 dhe Kapitujve të tjerë të *acquis*-së

Nga hyrja në fuqi e Kodit Penal deri aktualisht, kanë kaluar 26 vite. Për shkak të dinamizmit që karakterizon marrëdhëniet shoqërore, gjatë kësaj periudhe kohore janë ndërmarrë një sërë nismash për ndryshimin e tij, të cilat kanë prekur si pjesën e përgjithshme, ashtu edhe pjesën e posaçme të Kodit. Kjo shpeshësi ndryshimesh përbën shkak për prishjen e balancës dhe rrjedhës logjike që duhet të ekzistojë ndërmjet dispozitave të këtij Kodi.

Hartimi i Kodit të ri Penal lindi pikërisht si pasojë e shpeshësisë së ndryshimeve dhe shtesave të pasqyruara në përmbajtje të Kodit Penal, mungesës së efektivitetit të ndryshimeve që janë bërë ndër vite si rrjedhojë e ndryshimit të sanksioneve për veprat penale, riformulimit të dispozitave, dhe si nevojë e harmonizimit të dispozitave mes tyre për të garantuar përputhshmërinë e Kodit Penal me aktet ndërkombëtare në fuqi dhe përafrimin e tij me të drejtën e Bashkimit Evropian. Aktualisht në fokus të së drejtës penale, për shkak edhe të zhvillimeve globale, janë lufta kundër pastrimit të parave, lufta kundër terrorizmit, mbrojtja e të drejtave financiare, mbrojtja e ambientit, ndalimi i trafikimit të narkotikëve, ndalimi i tregtimit dhe qarkullimit të ndaluar të armëve të ftohta apo armëve të fuqishme. Në këtë kuadër, do të mbahen parasysh aktet e Bashkimit Evropian për t’u parashikuar në Kodin Penal me qëllim përafrimin e tyre, në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Me anë të këtij Plani Kombëtar të Integritetit Evropian, synohet përafrimi i Kodit të ri Penal me Direktivat e BE-së, të cilat janë pjesë e Kapitujve 23, 24, 19 dhe 17 të *acquis*, si më poshtë:

- Direktiva 2017/1371⁵⁸ “Mbi luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit Evropian”;

- Direktiva 2017/541 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi luftën kundër terrorizmit”;⁵⁹

- Direktiva 2015/849, ndryshuar nga Direktiva 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare me qëllim pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit”;⁶⁰

⁵⁸ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.

⁵⁹ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

⁶⁰ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.



- Direktiva 89/654 e Këshillit të BE-së “Mbi vendosjen e masave minimum të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”;⁶¹

- Direktiva 89/391 e Këshillit të BE-së “Mbi nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në ambientet e punës”;⁶²

- Direktiva 2011/93/BE “Mbi luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve”;⁶³

- Direktiva 2014/62/BE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian “Për mbrojtjen nga ligji penal të Euros dhe monedhave të tjera kundër falsifikimit”;⁶⁴

- Direktiva 2014/42/BE “Mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve/të ardhurave të krimeve të kryera në Bashkimin Evropian”;⁶⁵

- Direktiva 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”;⁶⁶

- Direktiva “Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA”⁶⁷ i 25 Tetorit 2004 që përcakton dispozitat minimale mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe ndëshkimeve në fushën e trafikimit të paligjshëm të drogës”.

Nevojitet që Kodi Penal të përafrohet me Direktivën 2017/1371 “Në luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit Evropian”, duke parashikuar inkriminimin e cenimit të interesave financiarë të Bashkimit Evropian nëpërmjet mashtrimit, si dhe duke shtuar llojet e dënimeve për personat juridikë.

Gjithashtu, duhet të garantohen standardet e vendosura nga BE nëpërmjet Direktivës 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi luftën kundër terrorizmit”, duke njëhsuar terminologjinë e përdorur, si dhe duke zgjeruar anën objektive të veprave penale terroriste edhe për sa u përket:

- sulmeve ndaj integritetit fizik të personit;
- shkatërrimit të një platforme fikse të vendosur në shelfin kontinental, një vendi publik ose privat që mund të rrezikojë jetën e njeriut ose të rezultojë në humbje të mëdha ekonomike;

- ndërhyrjes së paligjshme në sistemet apo të dhënat,

- vjedhjes së rëndë me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste;

- zhvatjes me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste;

- hartimit ose përdorimit të dokumenteve të rreme administrative me qëllim kryerjen e veprave penale terroriste.

Po ashtu, nevojitet shtimi i veprave penale të udhëtimit me qëllime terroriste dhe lehtësimi apo organizimi i udhëtimit me qëllim kryerjen e veprave terroriste.

Përafrimi i Kodit Penal duhet të bëhet edhe me Direktivën 2015/849, ndryshuar nga Direktiva 2018/843 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare me qëllim pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit”, duke i dhënë një përkufizim të unifikuar veprimtarisë së “*pastrimit të parave*” për të qenë në përputhje me parashikimin e Direktivës dhe standardeve evropiane.

Kodi Penal ka një qasje të re mbi mbrojtjen në punë. Për pasojë, ka lindur nevoja për ta parë këtë qasje në këndvështrim të Direktivës 89/654 të Këshillit të BE-së “Mbi vendosjen e masave minimum të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës”, si dhe Direktivës 89/391 të Këshillit të BE-së “Mbi nxitjen e përmirësimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në ambientet e punës”.

Krimet seksuale kanë marrë një vëmendje të veçantë vitet e fundit, ndaj në Kodin e ri Penal është i nevojshëm përafrimi i plotë me Direktivën 2011/93/EU “Në luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve”. Direktiva parashikon kriminalizimin e figurës së tërheqjes/angazhimit dhe ekspozimit të fëmijëve ndaj akteve seksuale pa pasur nevojën e asistimit në veprimtarinë seksuale, përfshirjen në veprimtari seksuale etj. Masat e dënimit synohen të përcaktohen në përputhje me parashikimet e Direktivës. Direktiva kërkon inkriminimin lidhur me shtrëngimin, detyrimin ose kërcënimin e një fëmije në aktivitete seksuale me një palë të tretë. Direktiva kërkon inkriminimin e blerjes së materialeve pornografike të fëmijëve, etj.

Duke i paraprirë integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian ka lindur nevoja për të parashikuar në legjislacionin e brendshëm penal norma juridike mbi mbrojtjen e monedhës Euro

⁶¹ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 19.

⁶² Direktivë e përfshirë në Kapitullin 19.

⁶³ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

⁶⁴ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 24.

⁶⁵ Direktivë e përfshirë në Kapitullin 23.

⁶⁶ Direktive e përfshirë në Kapitullin 24.

⁶⁷ Direktive e përfshirë në Kapitullin 24.



dhe monedhave të tjera, sipas parashikimeve apo standardeve të vendosura nga Direktiva 2014/62/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian “Për mbrojtjen nga ligji penal të Euros dhe monedhave të tjera kundër falsifikimit”. Direktiva kërkon që shtetet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që sjelljet në vijim të dënohen si vepër penale, kur kryhen me dashje:

- importimi, eksportimi, transportimi, mbajtja e monedhës së falsifikuar kur subjekti ka dijeni se është e falsifikuar;

- instrumente, artikuj, programe kompjuterike dhe të dhëna, dhe çdo mjet tjetër i përshtatur posaçërisht për falsifikimin ose ndryshimin e monedhës;

- karakteristikat e sigurisë, të tilla si hologramet ose përbërës të tjerë të monedhës që shërbejnë për të mbrojtur nga falsifikimi, etj.

Është i nevojshëm përafrimi i Direktivës 2014/42/EU “Mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve/të ardhurave të krimeve të kryera në Bashkimin Evropian”, me qëllim krijimin e një kuadri të plotë ligjor i cili gjen aplikim në rastet e kryerjes së veprave penale në BE të cilat gjenerojnë të ardhura. Përkufizimi i termave dhe dënimet kërkojnë unifikim, ndaj është e rëndësishme që kjo Direktivë të përfshihet në Kodin e ri Penal.

Pavarësisht rëndësisë që i është dhënë në Shqipëri luftës ndaj trafikut të qenieve njerëzore, është e domosdoshme përfshirja në ligjin e brendshëm të parashikimeve të Direktivës 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”, pasi kjo direktivë vendos një standard minimal rregullash që lidhen me përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikut të qenieve njerëzore. Ajo paraqet gjithashtu dispozita duke marrë parasysh perspektivën gjinore për të forcuar parandalimin e këtij krimi dhe mbrojtjen e viktimave të tij. Nëse kjo vepër është kryer nga zyrtarë publikë, kjo gjë do të konsiderohet si rrethanë rënduese. Dënimi në këtë rast duhet të jetë efektiv, dekurajues dhe proporcional. Për këto vepra penale, duhet të merren masat që personat juridikë të mos i shpëtojnë përgjegjësisë. Po ashtu, Direktiva përcakton detyrimet e shtetit për të ofruar ndihmë ndaj viktimave të trafikut, për mbrojtjen e fëmijëve viktimë të krimit të trafikut të qenieve njerëzore dhe për kompensimin e tyre.

Gjithashtu, në kuadër të integritetit evropian të Shqipërisë, ka lindur nevoja për të parashikuar në ligjin e brendshëm penal rregulla juridike mbi dënimet ku vepra përfshin sasi të mëdha droge, si dhe rastet kur vepra përfshin droga të dëmshme për shëndetin ose ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në shëndetin e një numri personash, sipas parashikimeve apo standardeve të vendosura nga Direktiva 2004/757/BE, datë 25.10.2004 “Për vendosjen e rregullave minimum mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikimit të drogës”. Direktiva kërkon që shtetet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që dënimet e parashikuara nga shtetet anëtare duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese dhe të përfshijnë edhe dënime me privim të lirisë. Për të përcaktuar nivelin e dënimeve, duhet të merren në konsideratë elemente faktike, si p.sh. sasi dhe llojet e drogave të trafikuar, si dhe fakti nëse vepra është kryer në kuadër të një organizate kriminale.

Nisma ligjore e përafrimit të Kodit të ri Penal me 10 Direktiva të BE-së, të cilat janë pjesë e Kapitujve 23, 24, 19 dhe 17 të *acquis*-së, në kuadër të projektligjit “Për miratimin e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë” propozohet për t’u realizuar brenda tremujorit të katërt të vitit 2023.

Projektligji “Për ratifikimin e Protokollin që ndryshon Konventën ETS 108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”

Konventa për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (Konventa ETS Nr.108), prej 35 vitesh ka shërbyer si baza e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave e mbi 40 shteteve dhe si i vetmi instrument ligjor detyrues në nivel ndërkombëtar. Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (Konventa ETS Nr.108), si dhe Protokollin shtesë të saj nr. 181, respektivisht me anë të ligjit nr. 9288, datë 07.10.2004, “Për ratifikimin e Konventës “Për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9287, datë 07.10.2004 “Për ratifikimin e Protokollit shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave



personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkombëtar i të dhënave”.

Konventa në fjalë është miratuar që në vitin 1981, shumë kohë përpara epokës së internetit dhe komunikimeve elektronike. Zhvillimi i teknologjisë, globalizimi i informacionit dhe qarkullimi gjithnjë e më i madh i të dhënave personale në ambientin digjital, sjell sfida të reja në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Pikërisht, qëllimi i Protokollit ndryshues (ETS nr. 223) është modernizimi i Konventës (ETS 108) dhe Protokollit shtesë të saj (ETS nr. 181), me qëllim gjetjen e zgjidhjeve përballë këtyre sfidave dhe në të njëjtën kohë forcimin e mekanizmit të vlerësimit dhe mbikëqyrjes së Konventës.

Në këtë kuadër, Protokollin ndryshues rrit nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale. Protokollin në fjalë hyn në fuqi si rregull në momentin që të gjitha shtetet depozitojnë instrumentet e tyre të ratifikimit apo miratimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Që prej hyrjes në fuqi, Protokollin do të konsiderohet pjesë përbërëse e Konventës së ndryshuar.

Teksti i Protokollit ndryshues është hartuar në të njëjtën linjë me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR) EU 2016/679 si dhe Direktivën e Policisë EU 2016/680, me qëllim që shtetet kontraktuese të mos kenë konflikt me detyrimet që burojnë nga legjislacioni evropian, për shkak se shumë shtete janë në proces harmonizimi të legjislacionit të brendshëm të tyre me dy aktet e sipërcituara, sikurse edhe Republika e Shqipërisë.

Duke qenë se Konventa e modernizuar do të përmbajë të njëjtin nivel sigurie të mbrojtjes së të dhënave personale sikurse legjislacioni evropian, hyrja në fuqi e protokollit ndryshues të Konventës, do të kontribuojë në promovimin e standardeve evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale në të gjithë botën. Gjithashtu, rritja e standardeve të mbrojtjes së të dhënave nga Shtetet Palë të Konventës, do të lehtësojë qarkullimin e të dhënave personale midis vendeve të Bashkimit Evropian dhe atyre që nuk janë pjesë e BE-së.

Protokollin ndryshues është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave konform nenit 10 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, nëpërmjet vendimit nr. 1001, datë 9.12.2020 dhe synohet ratifikimi i saj nga Kuvendi me qëllim integrimin në sistemin juridik

vendas, duke shprehur pëlqimin për të qenë i lidhur nga kjo marrëveshje e Këshillit të Evropës. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Drejtësisë ka vijuar me procedurat për nënshkrimin e marrëveshjes, duke i kërkuar Presidentit të Republikës lëshimin e autorizimit përkatës në përputhje me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Kjo fazë do të ndiqet nga procesi i ratifikimit të Protokollit Ndryshues nga Kuvendi i Republikës. Në këtë drejtim, Ministria e Drejtësisë propozon miratimin e projektligjit për ratifikimin e Protokollit që ndryshon Konventën ETS 108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, në tremujorin e katërt të vitit 2022. Miratimi i këtij projektligji është i domosdoshëm për të shprehur pëlqimin për të qenë i lidhur nga Protokollin ndryshues i Konventës ETS 108, e nënshkruar më parë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe të vetë kësaj marrëveshjeje.

Projektvendimi “Për miratimin e hartës së re gjyqësore”

Bazuar në të dhënat statistikore të grumbulluara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në funksion të analizës së hartës së re gjyqësore, si dhe të raporteve vjetore 2019 dhe 2020, vihet re që shpërndarja e numrit të çështjeve, e përfutur si raporti mes numrit të çështjeve të reja të ardhura në gjykatë dhe numrit të gjyqtarëve në secilën gjykatë, është e pabalancuar.

Gjithashtu, në gjykata nuk ka ekuilibër në shpërndarjen e stafit administrativ në raport me gjyqtarët. Shifrat tregojnë se shpërndarja e burimeve nuk është e balancuar në territorin e Shqipërisë dhe se sistemi gjyqësor në Shqipëri dominohet nga gjykatat e vogla (14) dhe gjykatat mesatare (7), ku ka vetëm një gjykatë të madhe (gjykata e rrethit të Tiranës).

Miratimi i paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, në korrik 2016, duke pasur në fokus rritjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor, përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve në gjykata, njëkohësisht prezantoi edhe një qasje novatore në shpërndarjen tokësore të gjykatave, duke përcaktuar parime dhe kritere të reja të konfigurimit të hartës së re gjyqësore.



Në përmbushje të detyrimit ligjor dhe me qëllim zgjidhjen e sfidave të sistemit gjyqësor në Shqipëri lidhur me burimet e kufizuara njerëzore, ngarkesën e punës, delegimet, aksesin, koston dhe efektshmërinë, me urdhrin nr. 78, datë 18.02.2019, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, u ngrit një grup ndërinstitutional pune për vlerësimin dhe riorganizimin e rrethave gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, gjykatave dhe partnerëve ndërkombëtar.

Ky grup pune, bazuar në kriteret e lartpërmendura, realizoi një vlerësim të kujdesshëm të situatës aktuale të gjykatave, bazuar në një metodologji të caktuar, e cila konsiston në studimin e tre indikatorëve kryesorë: popullsia, ngarkesa e çështjeve për gjyqtar dhe distanca midis qytetarëve dhe gjykatave. Gjatë analizës së tij, grupi i punës prioritarizoi aksesin në drejtësi për qytetarët, uljen e kostove, rritjen e cilësisë dhe performancës në dhënien e shërbimeve. Në analizën e Grupit të Punës janë marrë parasysh edhe studimet ndërkombëtare në këtë drejtim, standardet më të mira evropiane dhe Rekomandimet e CEPEJ. Raporti përfundimtar pasqyron një përmbledhje të dokumenteve dhe analizimin e statistikave mbi të cilat u arrit dhe në konkluzionet përfundimtare.

Draft – projekti i hartës së re gjyqësore u përgatit në katër faza:

- Vlerësimi i hartës ekzistuese dhe e treguesve të gjykatave aktuale;

- Përcaktimi i objektivave dhe kriterëve;

- Përcaktimi dhe marrja e të dhënave (statistikave) të nevojshme nga gjykatat dhe institucionet;

- Finalizimi i propozimit për hartën e re gjyqësore.

Nga ana e Grupit të Punës u morën në konsideratë objektivat e mëposhtme në vlerësimin e hartës gjyqësore:

- Garantimi i aksesit në drejtësi, në kuptimin e afërsisë së qytetarëve me gjykatat;

- Ulja e kostove, me qëllim përdorimin efikas të burimeve publike;

- Përmirësimi i cilësisë dhe performancës së shërbimeve të ofruara.

Rezultatet e pritshme janë:

- Zvogëlimi i afatit kohor të zgjidhjes së çështjeve;

- Standardizimi i kohës mesatare të përfundimit të gjykimit në juridiksionin rishikues, pasi mënyra e planifikimit të ngarkesës së gjyqtarëve të apelit do të bëhej mbështetur në të njëjtat standarde, dhe kështu do të arrihej edhe barazia në punë e gjyqtarëve;

- Eliminimi i konsumimit të trupave gjykues, që aktualisht ekziston dhe sjell vështirësi zinxhir nga vonesat dhe zvarritjet në gjykimin e çështjeve, por edhe humbje kohe të panevojshme. Pamundësia e zhvillimit normal të gjykimit në këto gjykata është stimuluar edhe nga kërkesat e bazuara apo jo të palëve për përjashtimin e trupit gjykues, të cilat përsëriten gjatë gjithë gjykimit, në një ritëm të pamundur për t'u ezauruar gjykimi i tyre për mungesë të trupës gjyqësore, dhe që shkakton shpesh delegim të gjyqtarëve.

Ndërkohë KLGJ ka përgatitur një studim fizibiliteti në lidhje me impaktin që do të ketë zbatimi i hartës së re gjyqësore. Ky studim është aktualisht në fazën e konsultimeve dhe do të jetë pjesë përbërëse e projekt propozimit të hartës gjyqësore.

Projektvendimi “Për miratimin e hartës së re gjyqësore” propozohet të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2022.

Projektvendimi “Për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive (SEMDRK)”

Ngritja dhe funksionimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive synon krijimin e një sistemi informatik i cili do të bëjë të mundur mbledhjen, trajtimin e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të rasteve të denoncuar, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave apo përpunimit të informacionit që i bëhet rasteve të denoncuar. Gjithashtu krijimi i këtij sistemi ka si qëllim përmirësimin e saktësisë së statistikave të gjeneruara dhe unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e denoncimeve, duke krijuar një bazë statistikore, që ndihmon në përmirësimin e politikave lidhur me parandalimin dhe luftimin e rasteve korruptive.

Nëpërmjet këtij sistemi do të sigurohet unifikimi i procesit të menaxhimit të informacioneve të ardhura në sistem, sigurimi i kontrollit maksimal të regjistrimit të veprimeve në sistem, reduktimi i



shkresave manuale dhe gjenerimi i raporteve të dobishme dhe relevante në kohë reale.

Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive përmban të dhënat parësore dhe dytësore mbi denoncimet e rasteve të korrupsionit, informacionin mbi menaxhimin, trajtimin dhe statusin e tyre, si dhe raportimin e të dhënave korruptive nga koordinatorët e Rrjetit Antikorrupsion pranë strukturës përgjegjëse për antikorrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë.

SEMDRK-ja është përgjegjëse për krijimin, mbajtjen, administrimin, ndërveprimin me bazat e tjera dhe bërjen të disponueshëm të informacionit në përmbajtje të bazës së të dhënave "Sistemi elektronik i menaxhimit të denoncimeve mbi rekordet korruptive".

Institucioni administrues i SEMDRK-së është Ministria e Drejtësisë, si institucioni përgjegjës për koordinimin e politikave kundër korrupsionit në nivel kombëtar. Struktura përgjegjëse për gjenerimin e të dhënave nga SEMDRK-ja është struktura përgjegjëse për antikorrupsionin në Ministrinë e Drejtësisë.

Projektvendimi "Për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive (SEMDRK)" propozohet që të miratohet brenda tremujorit të katërt të vitit 2022.

KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA, SIGURIA

4.24.1 Përmbajtja e kapitullit

Politikat e BE-së kanë për qëllim të zhvillojnë më tej Bashkimin si një fushë lirie, sigurie dhe drejtësie. Për çështje të tilla si kontrolli kufitar, vizat, migrimi i jashtëm, azili, bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave financimit të terrorizmit dhe lufta kundër terrorizmit, bashkëpunimi në fushën e drogës, bashkëpunimi doganor dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe civile. Shtetet Anëtare duhet të jenë të pajisura në mënyrën e duhur për të zbatuar në mënyrë të përshtatshme kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta. Mbi të gjitha, kjo kërkon një kapacitet administrativ të fuqishëm dhe të integruar brenda agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera relevante, të cilat duhet të arrijnë standardet e nevojshme. Një polici profesionale e organizuar mirë, e besueshme dhe efikase është me rëndësi të madhe. Pjesa më e detajuar e politikave

të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është *acquis* e Schengen-it. Gjithsesi për Shtetet e reja Anëtare, pjesë thelbësore të '*acquis*' të Schengenit, janë implementuar duke ndjekur një Vendim më vete të Këshillit, të marrë pas hyrjes së tij në fuqi.

4.24.2 Struktura e kapitullit

1. Lufta kundër krimit të organizuar
2. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës
3. Lufta kundër terrorizmit
4. Migracioni i rregullt dhe i parregullt
5. Azili
6. Politika e vizave
7. Kufijtë Schengen dhe Kufijtë e Jashtëm
8. Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale
9. Bashkëpunimi Doganor (shih Kapitullin 29)
10. Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)

4.24.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë të drejtën e saj kombëtare me *acquis* të BE-së. Bashkëpunimi në fushën e menaxhimit të kufijve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenin 80 të MSA-së. Në vazhdim, bashkëpunimi në fushën e migracionit midis Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenet 4, 80 dhe 81 të MSA, ndërsa bashkëpunimi në fushën e politikës së vizave dhe azilit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian parashikohet në nenin 80 të MSA.

Neni 80 përcakton që puna duhet përqendruar në zbatimin e legjislacionit të brendshëm për të përmbushur standardet e Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967, për të siguruar respektimin e parimit të moskthimit të individit në vendin që përbën një kërcënim për jetën e tij, si dhe të drejta të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Zhvillimet në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftën kundër krimit të organizuar midis Republikës së Shqipërisë dhe BE-së është parashikuar në nenet 4, 82, 84 dhe 85 të MSA. Nenet 4 dhe 85 të MSA-së parashikojnë bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër trafikimit të paligjshëm. Më tej, nenet 4 dhe 82 të MSA-së parashikojnë bashkëpunim në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të



terrorizmit. Gjithashtu, në nenet 5, 82 dhe 84 SAA, parashikohet bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe BE-së në luftën kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të MSA-së parashikojnë bashkëpunim në luftën kundër drogës. Detyrimet në fushën e doganave parashikohen në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes së të drejtës së pronësisë intelektuale dhe industriale, bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes së mjedisit dhe parandalimi i krimeve ambienteve. Së fundi, bashkëpunimi në çështjet penale është përcaktuar në nenin 85 të MSA-së.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë rregullohet në Titullin V të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (nenet 67 – 89). Për më tepër, Karta e të Drejtave Themelore është bërë e detyrueshme. Protokolli 36 i Traktateve Themelore rregullon statusin e legjislacionit përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, i cili ishte miratuar nën kuadrin e Shtyllës së Tretë së mëparshme të Bashkimit Evropian. Fusha e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë përfshin legjislacionin dytësor në fushat kryesore: Migracioni, Vizat dhe Azili; Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale; dhe Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Civile. Dy fushat e para dominohen nga direktivat dhe vendimet kornizë, ndërkohë që këto të fundit përmbajnë direktiva të zbatueshme drejtpërdrejt. Legjislacioni primar dhe sekondar plotësohet nga një vëllim i madh i jurisprudence së Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

4.24.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Sa i takon kapitullit në tërësi, Shqipëria ka arritur një **nivel përgatitjeje** për të zbatuar *acquis* të BE-së në këtë fushë. Disa përpertime u bënë kur Prokuroria Speciale dhe Byroja Kombëtare e Hetimit filluan të funksionojnë dhe Policia e Shtetit Shqiptar shtoi stafin e tyre. Hetimet financiare duhet të zhvillohen më tej gjatë trajtimit të krimit të organizuar. Shqipëria ka vazhduar të rrisë angazhimin e saj me të gjitha agjencitë e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme të BE-së. Referimet në procedurën e azilit dhe procedurat e kthimit duhet të ndjekin kuadrin ligjor në fuqi. Çështja e kërkesave të pabazuara për azil të paraqitura nga shtetas shqiptarë në shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e lidhura me Shengenin kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Shqipëria duhet

të vazhdojë të trajtojë fenomenin e të miturve të pashoqëruar. Politika shqiptare e vizave duhet të jetë në përputhje me atë të BE-së. *Acquis* për këtë kapitull përbëhet nga një *acquis* voluminoz sa i takon nënfushave të këtij kapitulli.

Lufta kundër krimit të organizuar

Vendi ka një nivel përgatitjeje në zbatimin e *acquis* të BE-së në këtë fushë. Progres i mirë është bërë në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar. Rezultate të prekshme u arritën në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë përmes një bashkëpunimi të shtuar me Shtetet Anëtare të BE-së, Europol dhe Eurojust. Shkëmbimi i informacionit cilësor dhe operacionet e përbashkëta policore që përfshijnë partnerë ndërkombëtarë janë intensifikuar, njësitë e përbashkët hetimore, (JIU) dhe ditët e veprimt të përbashkët (JIT- Joint Action Days) me vendet e BE-së dhe më tej.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të forcuar bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Vlen të theksohet se bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë me të gjitha shtetet, kryesisht bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e informacioneve policore në fushat e hetimit të veprave penale për narkotikët, trafiqet e paligjshme, pastrim parash, krimin ekonomik e financiar, krimin kompjuterik dhe krimeve të rënda, veprave panele në fushën e pronësisë intelektuale dhe industriale dhe krimet mjedisore, ku informacioni është shkëmbyer kryesisht nëpërmjet kanaleve të Interpol, Europol (Nëpërmjet kanalit komunikimit SIENA) dhe oficerëve ndërlidhës policor, Rrjetit CARIN, Zyrës së Interforcës, oficerëve të kontaktit etj. Oficeri ndërlidhës i Europol i vendosur në Tiranë që nga qershori 2019, ka ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe forcave policore të Shteteve Anëtare të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar. Shqipëria ka një oficer ndërlidhës të vendosur në selinë e Europol në Hagë, si dhe një Prokuror në Eurojust. Bashkëpunimi me Interpolin ka vazhduar të japë rezultate pozitive. Shqipëria merr pjesë në gjashtë aktivitete prioritare të EMPACT në kuadër të ciklit të politikave të BE-së.

Ligji për armët është pjesërisht i përafruar me dispozitat e BE-së. Shqipëria ndryshoi më tej këtë ligj në dhjetor 2020, duke transferuar një pjesë të kuadrit rregullator të BE-së në legjislacionin e saj kombëtar. Gjatë 2021, në zbatim të ligjit 74/2014



“Për armët” janë hartuar 13 akte nënligjore të cilat rregullojnë aspekte procedurale dhe harmonizojnë më tej legjislacionin në fushën e kontrollit të armëve të vogla e të lehta me atë të Bashkimit Evropian. Nga këto 13 akte nënligjore, janë miratuar 7 dhe 6 të tjera janë në proces.

Për zbatimin e “Udhërrëfyesit për një zgjidhje të qëndrueshme për zotërimin e paligjshëm, keqpërdorimin dhe trafikimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor”, është në proces hartimi dhe do të miratohet Plani i Veprimit të strategjisë për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta, municioneve të tyre dhe lëndëve plasëse, për vitet 2022 – 2024.

Është miratuar Memorandumi i Bashkëpunimit midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrit të Brendshëm Nr. 1079, datë 15.07.2020, Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm Nr. 10, datë 17.07.2020, dhe Urdhri i Ministrit të Brendshëm Nr. 346, datë 22.10.2020, për të rritur efektivitetin e hetimeve në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare, si dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale.

Ligji për administrimin e aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara, i miratuar në vitin 2019, parashikon krijimin e një zyre për rikuperimin e aseteve (ARO), siç kërkohet nga acquis e BE-së. Në fund të vitit 2020, u miratua një strukturë e re dhe të gjitha aktet e nevojshme zbatuese për Agjencinë si dhe u krijua një sistem elektronik për asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara. Në maj 2021, u krijua një grup pune për vlerësimin dhe ngritjen e ARO, me urdhër të Kryeministrit Nr. 49, datë 28.05.2021 me ekspertë ndërinstitucional nga Ministria e Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme si dhe ekspertë të ndryshëm vendas dhe të huaj si Instituti për Demokracinë dhe Ndërmjetësim (IDM), Këshilli i Evropës etj. Rekomandimet nga ekspertet i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë e cila po udhëheq procesin.

U miratua dhe vu në zbatim Ligj Nr. 154/2020 “Për regjistrin qendror të llogarive bankare” dhe VKM Nr. 415 Date 08.07.2021, Për Rregullat e aksesit të Subjekteve të Interesuara në Bazën e të dhënave të regjistrit qendror të llogarive Bankare. U miratua Iligji Nr. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, që përafrojnë pjesërisht -

Direktivën e (BE) 2018/843 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 30 maj 2018 që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit” dhe që ndryshon direktivat 2009/138/KE dhe 2013/36/BE, Direktivën (BE) 2019/1153 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 Qershor 2019 që vendos rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacionit financiar dhe informacioneve të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të disa veprave penale dhe që shfuqizon vendimin e Këshillit 2000/642/DÇB.

Me VKM Nr. 1140, datë 24.12.2020 është miratuar Strategjia e re kundër Krimeve të Organizuara dhe të Rënda 2021 – 2025 dhe Plani i saj të Veprimit për 2021 – 2022.

Në fushën e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore po zbatohen Procedurat Standarde për Mbrojtjen e Viktimave të Mundshme të Trafikimit, si dhe vijon bashkëpunimi ndërinstitucional për parandalimin, mbrojtjen dhe asistencën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021 – 2023”, me Vendimin Nr. 670, datë 10.11.2021 “Për një shtesë në Vendimin Nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit, 2021–2022”, si dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 177, datë 15.11.2021. Sa i takon luftës kundër trafikimit të personave, vijon zbatimi i aktiviteteve për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, nëpërmjet fushatave ndërgjegjëse, ndjekjes penale, mbrojtjes së viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, ri-integritit të tyre, dënimit të trafikantëve, bashkëpunimit ndërinstitucional, rajonal dhe ndërkombëtar. Mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit ka vazhduar të jetë funksional.

Në 2020, Shqipëria miratoi një strategji të re mbi sigurinë kibernetike dhe një plan veprimi për 2020 – 2025, të cilat mbulojnë përparësitë përkatëse në këtë fushë. Ndërkohë, me Urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr. 494, datë 30.12.2020, u miratua edhe “Strategjia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike dhe Plani i Veprimit për periudhën



2021 – 2025”. Po punohet për ndryshimet legislative bazuar në strategjinë e sipërpërmëndur.

Me Urdhër të Ministrit të Brendshëm Nr. 157, datë 17.02.2021 “Për disa ndryshime në strukturat organike të Policisë së Shtetit”, u krijua Drejtoria Hetimore, Njësia për hetimin e krimit Ekonomik e Financiar, Njësia për hetimin e krimeve kibernetike.

Gjithashtu, progres i dukshëm është bërë edhe në zbatimin e planit të veprimit për të adresuar rekomandimet e FATF. Qeveria ka hartuar edhe një program të posaçëm në nivel kombëtar për zbatimin e këtyre rekomandimeve që monitorohet nga Komiteti kombëtar Kundër Pastrimit të parave dhe një sekretariat i posaçëm teknik, tek i cili institucionet zbatuese raportojnë çdo javë progresin.

Ndërkohë, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe strukturat ligjzbatuese detare, ka implementuar sistemin “Baza e të Dhënave për Trafikun Detar” falë financimit të Forcës së Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar. Ky sistem synon kontrollin e kufijve detare, menaxhimin më të mirë të të dhënave të të gjitha mjeteve lundruese me natyrë tregtare ose jo, që gjenden apo lundrojnë në ujërat dhe portet e Shqipërisë. Gjithashtu ky sistem mundëson rritjen e sigurisë dhe ruajtjen e ujërave shqiptarë, përshtatjen dhe rritjen e sektorit detar shqiptar përmes përdorimit të të dhënave reale, statistikave dhe parashikimeve. Sistemi i ngritur përmbush detyrimet e Direktivës 2010/65/EU.

Instituti i Policisë Shkencore ka miratuar legjislacionin lidhur me organizimin dhe funksionimin e tij si dhe legjislacionin për sa i përket administrimit dhe marrjes së profileve të ADN-së dhe të dhënave daktiloskopike. Shqipëria ka nënshkruar edhe Marrëveshjen e Bashkëpunimit Policor midis vendeve të Ballkanit Jugperëndimor, PCC SEE, “Për shkëmbimin automatik të të dhënave daktiloskopike, të profileve të ADN-së dhe të të dhënave të automjeteve”, si dhe e ka ratifikuar këtë marrëveshje në Parlament.

Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës

Shqipëria ka vazhduar të tregojë përkushtim për të kundërshtuar prodhimin dhe trafikimin e drogës. Drejtoria e Policisë së Shtetit ka filluar monitorimin nëpërmjet dronëve. Në vitin 2020, Shqipëria mori pjesë në 7 ekiye të përbashkëta të hetimit të

mbështetura nga Eurojust lidhur me trafikun e drogës.

Plani i Veprimit 2021 – 2022 për vitin 2021 është në zbatim, miratuar me VKM Nr. 1140, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021 – 2022”.

Më datë 18.02.2021 është nënshkruar Protokoll i Operacional Ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit në Republikën e Shqipërisë dhe Departamentit të Sigurisë Publike të Ministrisë së Brendshme në Itali, “Për Mbështetje të Strategjisë Anti Kanabis – Mbikëqyrja Ajrore 2021”.

Është miratuar Urdhri i DPPSH Nr. 382 datë 28.04.2021, “Për ndjekjen në vijimësi të zbatimit të Protokollit-Operativ miratuar më datë 18.02.2021 nga Ministria e Brendshme e Italisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Është miratuar Plani - Operacional Nr. 457, datë 20.04.2021 “Për monitorimin ajror me Helikopter dhe Dron, për identifikimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike për vitin 2021”.

Shqipëria punon së bashku me Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogën dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA) për rritjen e kapacitetit të saj raportues lidhur me çështjet e drogës dhe për ta sjellë atë në përputhje me udhëzimet/protokollet e EMCDDA.

Një Strategji e re kombëtare e kontrollit të drogës (2019 – 2023) dhe plani i veprimit pritet të miratohet së shpejti.

Lufta kundër terrorizmit

Shqipëria ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe është mjaft i avancuar në përafrimin me pjesën kryesore të acquis të BE-së. Është miratuar me VKM Nr. 1137, datë 16.12.2020 Strategjia Ndër-Sektoriale Kundër Terrorizmit 2021 – 2025, si dhe Plani Veprimit 2021 – 2023. Shqipëria ka bërë përparim shumë të mirë në zbatimin e “Aranzhimit dypalësh me BE-në për operacionalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor”. Në shkurt 2021, Shqipëria paraqiti raportin e saj të dytë të ndërmjetëm mbi zbatimin e marrëveshjes. Në shtator 2021 është paraqitur raporti i tretë i ndërmjetëm mbi zbatimin e kësaj marrëveshje.



Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndërmjet Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme është nënshkruar Memorandumi i Bashkëpunimit Nr. 1079, datë 15.07.2020 “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Njësia Kundër Financimit të Terrorizmit pranë Drejtorisë së Antiterrorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u bë plotësisht funksionale në vitin 2020, referoi 2 raste për “Financimin e Terrorizmit”, në Prokurorinë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) parashikuar nga Neni 230/a i Kodit Penal.

Në zbatim të Planit të Veprimit Ndërinstitucional shtesë “Për Pritjen dhe Trajtimin e Shtetasve Shqiptarë që kthehen nga Zona e Konfliktëve në Siri dhe Irak”, autoritetet riatdhësuan gjashtë gra dhe 18 të mitur nga kampet në Siri në Tetor 2020 dhe Gusht 2021. Kthimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i tyre është përgatitur dhe shoqëruar nga një grup pune ndërinstitucional, me role drejtuese për Qendrën Koordinuese CVE dhe Drejtorinë e Antiterrorit në DPSH. I gjithë informacioni përkatës është ndarë me Europol.

Sa i takon Vendimit për Shkëmbimin e Informacionit dhe Bashkëpunimin lidhur me Veprat Terroriste (2005/671/JHA) është vendosur baza ligjore për krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore, ku përfshihen ato për luftimin e terrorizmit. Ligji Nr. 9539/2006 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8498, datë 10.6.1999 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Ndihmën Juridike të Ndërsjellë në Çështjet Penale dhe Protokollin Shtesë".

Shqipëria vijon me zbatimin e aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve të shërbimeve të specializuara në luftën kundër terrorizmit nëpërmjet shtimit të numrit të burimeve njerëzore dhe logjistike si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Shqipëria është përdoruese e platformës së komunikimit, produkteve, shërbimeve dhe aftësive të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit dhe bashkëpunon me Njësinë e Referimit të Internetit të Europol.

Qendra CVE vijon zbatimin e aktivitetit të planifikuar për përmbushjen e objektivave të Planit

të Veprimit në zbatim të Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, me fokus të veçantë në procesin e riintegritimit të shtetasve të riatdhësuar. Qendra CVE po zbaton programin e ri-integritimit të shtetasve shqiptarë të riatdhësuar nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak për të kthyerit. Aktualisht, Qendra CVE po punon për hartimin e Strategjisë së re për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, e cila planifikohet të miratohet në tremujorin e parë të vitit 2022. Kjo strategji e re synon të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe elementëve përbërës të tij. Kjo qendër gjatë vitit 2021, ka zhvilluar trajnime të shumta për profesionistët dhe aktorët e vijës së parë të përfshirë në zbulimin, parandalimin dhe trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel qendror dhe lokal, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet qendrore dhe lokale, si dhe partnerët kombëtarë/ndërkombëtarë. Gjithashtu, i ka kushtuar vëmendje të madhe informimit dhe ndërgjegjësimit për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm për të gjitha grupet shoqërore, por me fokus të veçantë punonjësit e vijës së parë. Qendra CVE në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, po zbaton projektin në kuadër të programit “Përmirësimi i kapaciteteve penitensiare për adresimin e radikalizmit në burgje në Ballkanin Perëndimor”, ku janë mbajtur forume ndërinstitucionale në qytete të ndryshme. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe në bashkëpunim me CVE realizohen seanca informuese dhe trajnime për mësuesit drejtuesit, psikologët dhe oficerët e sigurisë.

Migracioni i rregullt dhe i parregullt

Kuadri ligjor për migracionin është përafruar kryesisht me acquis të BE-së, por ka nevojë të përditësohet në përputhje me zhvillimet e fundit nga BE.

Bazuar në rekomandimet e BE-së lidhur me menaxhimin e migracionit të parregullt, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në datën 2 nëntor 2021, Ligji Nr. 79/2021, datë 24.06.2021, “Për të huajt”, i cili ka hyrë në fuqi në datë 2 Nëntor 2021. Ligji për të huajt synon të lehtësojë menaxhimin e migracionit të rregullt dhe luftën kundër migrimin të parregullt, si dhe përmirësimin e fushës së të



drejtave të të huajve, në drejtim të mbrojtjes së migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, refugjatëve, azilkërkuesve, si dhe garanton akses në programe dhe shërbime integrimi për të huajt.

Gjithashtu, me qëllim zbatimin e mirë të dispozitave të këtij ligji, janë hartuar dhe janë në fazë konsultimi, përkatësisht Draft VKM "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për shtetasit e huaj që hyjnë dhe qëndrojnë në RSH" si dhe Draft VKM "Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar për të Huajt".

Është në proces draftimi "Udhëzimi për organizimin e fluturimeve të përbashkëta të dy ose më shumë shteteve, për largimin nga territori të të huajve të cilët janë subjekt i urdhrit individual të largimit".

Vijon zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planit të Veprimit 2019 – 2022, duke siguruar një kuadër të qartë për koordinimin ndërinstitucional dhe qeverisjen e migracionit në Shqipëri. Deri tani janë hartuar dy raporte vjetore të monitorimit të zbatimit të këtij dokumenti. Gjithashtu në zbatim të parashikimeve të Strategjisë Kombëtare për Migracionin, janë ngritur Komiteti Teknik i Migracionit, me urdhër të Kryeministrit Nr. 99 datë 27.7.2020, dhe Grupi Drejtues për Migracionin me urdhër të Kryeministrit Nr. 35 datë 10.3.2021.

Një strategji e rinovuar kombëtare e Diasporës 2021 – 2025 u miratua në korrik 2020.

Është hartuar dhe pritet të miratohet një plan kontigjence për një numër të konsiderueshëm të mundshëm të mbërritjeve të migrantëve dhe azilkërkuesve, me një buxhet dhe modalitete të qarta.

Shqipëria ka marrëveshje ripranimi me BE-në dhe protokolle ripranimi me 12 shtete anëtare. Marrëveshja e ripranimit me BE-në po funksionon mirë. Në kuadrin e rekomandimeve të BE-së për nënshkrimin e Marrëveshjes së Ripranimit me vendet e origjinës me qëllim parandalimin dhe goditjen e fenomenit të migracionit të paligjshëm në dhe nëpërmjet vendit tonë, është draftuar Marrëveshja e Ripranimit me Republikën Arabe të Egjiptit dhe është dërguar për ndjekjen e procedurave të brendshme institucionale. Gjithashtu është në përfundim draftimi i Marrëveshjes me Bangladeshin dhe Tunizinë.

Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Frontex për operacionet e kthimit është shumë i mirë.

Kapaciteti i pritjes së emigrantëve u rrit në 2019 dhe 2020 me 18 shtetë të shtuar në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës financiar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin me mbështetjen e BE-së.

Azili

Ligji i ri Nr. 10/2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", hyri në fuqi më 11 mars 2021. Ligji Nr. 10/2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë" është pjesërisht i përafuar me acquis të BE-së dhe garanton parimin e mos-kthimit. Procedurat përshkruajnë trajtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare që mund t'u drejtohen institucioneve kompetente. Ligji i ri për azilin parashikon dhënien e të drejtave të azilit edhe kur kërkesat për mbrojtje ndërkombëtare, paraqiten në zonat tranzit brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, duke u dhënë atyre informacion mbi mundësinë e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Nuk ka pasur raste të kthimit në kufi për shtetasit që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2021 ka vijuar puna për zbatimin e ligjit Nr.10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë" në bazë të të cilit janë miratuar 10 aktet nënligjore dhe ka filluar puna për zbatimin e tyre. Brenda vitit 2022 do të miratohen edhe 5 akte të tjera nënligjore, të cilat janë diskutuar me grupet e interesit dhe me institucionet e linjës. Është përmirësuar infrastruktura për pritjen, akomodimin dhe intervistimin e migrantëve dhe azilkërkuesve, në bashkëpunim me agjencitë e përfshira në këtë proces, me qëllim që të arrihen standardet e BE.

Regjistri elektronik për të dhënat e azilkërkuesve dhe personave që janë në mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, funksionon si një qendër integrale midis Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit dhe Qendrës Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit, duke shkëmbyer informacionin dhe nxjerrjen e statistikave në kohë reale, duke shkurtuar procedurat në vendimmarrje, si dhe duke shërbyer si bazë unike të dhënash në këtë fushë.

Politika e vizave

Kuadri ligjor për vizat në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me ligjin Nr. 79/2021 "Për të huajt".



Bazuar në rekomandimet e BE-së, ligji i ri Nr.79/2021 “Për të huajt”, synon përmirësimin e fushës së të drejtave të të huajve, të lehtësojë menaxhimin e migracionit të rregullt dhe luftën kundër migrimit të parregullt, përmirësimin në drejtim të mbrojtjes së migrantëve dhe anëtarëve të tyre të familjes, si dhe garanton akses në programe dhe shërbime integrimi për të huajt.

Gjithashtu, me qëllim zbatimin e dispozitave të ligjit të sipërcituar “Për të huajt”, janë hartuar dhe janë në fazë konsultimi, përkatësisht Draft VKM “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për shtetasit e huaj që hyjnë dhe qëndrojnë në RSH”, Draft VKM “Formati i vizës pullë dhe vizës elektronike”, si dhe Draft VKM “Për ngritjen dhe funksionimin e Regjistrat Elektronik Kombëtar për të Huajt”.

Me ndryshimin e ligjit “Për të huajt”, në trajtimin e aplikimeve për vizë të shtetasve të huaj, procedohet nëpërmjet sistemit e-visa, i cili ka mundësuar përmirësimin e infrastrukturës për trajtimin e aplikimeve. Në sistemin e aplikimeve për vizë shqiptare (e-visa dhe vizë pullë), është i aksesueshëm nga të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces sipas përcaktimeve të ligjit “Për të huajt”, me synim përmirësimin dhe përafrimin me standardet schengen.

Aktualisht aktet nënligjore për trajtimin, qëndrimin dhe hyrjen e të huajve, në Republikën e Shqipërisë, janë përafruar pjesërisht me direktivat e BE-së.

Lista negative: Regjim i njëjtë vizash për 95 shtete dhe regjim i ndryshëm për 7 shtete.

Lista pozitive: Regjim i njëjtë për 45 shtete dhe regjim i ndryshëm për 15 shtete.

Kufijtë Schengen dhe Kufijtë e Jashtëm

Në zbatim të Programit Vjetor të Policisë së Shtetit për vitin 2021 është miratuar me VKM Nr. 1117, datë 16.12.2020 Strategjia Ndërsektoriale të Menaxhimit të Integruar të Kufirit për 2021 – 2027 dhe Planit të Veprimit 2021 – 2023. Departamenti për Kufirin dhe Migracionin për vitin 2021 ka përqendruar punën në realizimin e prioritetit kryesor, atë të përsosjes së komponentëve të Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe sistemit të sigurisë kufitare, nëpërmjet rritjes së standardeve të kontrollit kufitar, parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar, menaxhimin e migracionit, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe aftësive tekniko-profesionale, forcimit të bashkëpunimit

ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, sipas standardeve të BE-së.

Shërbimet e policisë kufitare dhe migracionit kanë vijuar punën për krijimin e një kuadri ligjor në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për kufijtë e jashtëm të BE dhe aktet që kanë të bëjnë me menaxhimin efektiv dhe efikas të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare. Konsolidimi dhe zbatimi i akteve ligjore e nënligjore në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Migracionit, në zbatimin e standardeve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit për lehtësimin e procedurave gjatë kalimit të njerëzve dhe mallrave nëpërmjet kufirit ka përbërë objektivin kryesor.

Është miratuar Ligji Nr. 22/2020, datë 5.3.2020 “Për disa shtesa në ligjin Nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar” i cili është përafruar pjesërisht me acquis e BE-së.

Në datën 3.08.2021, është hapur dhe ka filluar funksionimi i plotë i Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar me Malin e Zi Grabon – Zatrijevbacka Cijevna.

Vazhdon puna e Komisionit të Përbashkët të Ekspertëve me Malin e Zi për ngritjen dhe hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Zogaj/Republika e Shqipërisë – Skje, Ckla/Mali i Zi, e cila do të ndërtohet në territorin e Malit të Zi. Synohet hartimi i Protokollit mbi implementimin e kontrollit të përbashkët kufitar dhe mënyrën e ndarjes së shpenzimeve gjatë punëve të kryera në pikën e përbashkët të kalimit kufitar.

Ngritja dhe funksionimi i PPKK-ve me Republikën e Kosovës realizohet në zbatim të ligjit Nr. 24, datë 18.04.2019 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimeve të përbashkëta të kontrollit kufitar”.

Me 18 shtator 2021, është miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, VKM “Për miratimin në parim, të Marrëveshjes ndryshuese të “Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar Shishtavec (Kukës) – Dragash (Kosovë)”.



Vazhdon puna me homologët e Kosovës për hartimin dhe miratimin e Protokolleve përkatëse mbi implementimin e kontrollit të përbashkët kufitar dhe pagesën e shpenzimeve gjatë punëve të kryera në pikat e përbashkëta të kalimit kufitar.

Me datë 9 qershor 2021, Këshilli i Ministrave ka vendosur miratimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë së Veriut për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Me datë 16 dhjetor 2020, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave për “Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, ratifikuar me ligjin Nr. 10474, datë 27.10.2011”.

Në kuadër të Procesit të Berlinit, do të rifillojnë takimet e Grupit të Punës “AdHoc” mbi “Marrëveshjen Rajonale për Lirinë e Lëvizjes me Kartat e Identitetit në Ballkanin Perëndimor”, “Marrëveshjen për Lirinë e Lëvizjes së Qytetarëve të Palës së Tretë brenda Ballkanit Perëndimor” dhe Marrëveshjen “Qytetarët e Palëve të Treta, të cilëve nuk u kërkohet të kenë vizë”, organizuar dhe drejtuar nga RCC.

Me datë 18 janar 2021 është firmosur Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Greqisë mbi ngritjen dhe funksionimin e një Qendre Bashkëpunimi Policor dhe Doganor, e cila do të ngrihet në Kakavijë, në ambientet e Pikës Greke të Kalimit Kufitar. Vazhdojnë procedurat për ratifikimin e saj dhe për ngritjen dhe funksionimin e qendrës.

Janë zbatuar masat parandaluese kundër korrupsionit në pikat e kalimit kufitar, përmes instalimit të kamerave, nëpërmjet ankesave dhe denoncimeve në Platformën Digjitale të Bashkëqeverisjes, si dhe në adresat publike të e-mail të Policisë së Shtetit dhe Policisë Kufitare.

Marrëveshja gjyqësore në çështjet civile dhe penale

Në bazë të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust”, që Republika e Shqipërisë nënshkroi në 5 tetor 2018, është emëruar prokurori ndërlidhës për korrespondencën me EUROJUST në janar të vitit 2021 që lehtësoi më tej zbatimin e

marrëveshjes së bashkëpunimit. Ky është një hap i rëndësishëm për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor në luftën kundër krimit të organizuar transnacional.

Ligji për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale me juridiksionet e huaja i cili u ndryshua me Ligjin Nr. 97 datë 07.07.2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” për të thjeshtësuar procedurat për letër-porositë, lejon marrëdhënie të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve gjyqësore, rregullon procedurën e videokonferencës, të masave shtrënguese dhe sekuestrimit, Urdhrit Ndërkombëtar të Arrestit, si dhe Skuadrat e Përbashkëta Hetimore duke përcaktuar afate për secilin procedurë, dhe përshejton ndihmën e ndërsjellë juridike me autoritetet e huaja gjyqësore. Në draftimin e këtyre ndryshimeve janë marrë në konsideratë rekomandimet e MONEYVAL, boshllëqet ligjore të referuara në LGA në Kapitullin 24, etj.

Në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar në çështjet civile, duhet theksuar se ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile, ligjin “Për ndërmjetësimin”, ligjin “Për ndihmën juridike”, ligjin “Për falimentimin” janë miratuar dhe transpozuar në përputhje me standardet e acquis.

Bashkëpunimi Doganor (shih Kapitullin 29) Mbrotjtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)

Shqipëria në kuadër të përafrimit me acquis në fushën e mbrojtjes së monedhës së euros, ka miratuar ligjin Nr.77, datë 11.11.2019 “Për Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën Kundër falsifikimit të Monedhës” bazuar në Vendimin e Këshillit 2001/887/DÇB e 6 dhjetorit 2001 për mbrojtjen e euros nga falsifikimi, për ratifikimin e Konventës së Gjenevës të vitit 1929. Me Komisionin Evropian/DGECFIN në vitin 2019 dhe me Bankën Qendrore Evropiane në vitin 2021, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së monedhës (euros) nga Banka e Shqipërisë. Strukturat e caktuara në nivel kombëtar nga Banka e Shqipërisë, Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme, për mbrojtjen e monedhave (euros) nga falsifikimi po punojnë për hartimin e një marrëveshje bashkëpunimi në këtë drejtim.



4.24.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Integritetit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, Drejtoria e Politikave dhe Strategjiave të Rendit të Rendit dhe Sigurisë Publike, Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë)

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe

Pastrimit të Parave

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

- Ministria e Mbrojtjes

- Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Bizneseve

- Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës
- Autoriteti i Aviacionit Civil
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Kulturës
- Byroja Kombëtare e Hetimit
- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit

dhe Krimit të Organizuar

- Prokuroria e Përgjithshme
- Banka e Shqipërisë
- Shërbimi Informativ i Shtetit
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit

të Dhunshëm

- INSTAT
- Autoriteti i Mediave Audiovizive

4.24.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Përafrimi me *acquis* është duke përparuar në të gjitha fushat e mbuluara nga Kapitulli 24. Si institucion lider për GNPIE 24, Ministria e Brendshme organizoi punën në katër grupe sipas nënfushave të këtij kapitulli. Aktualisht janë përfunduar draftet e para të analizës ligjore të *acquis*.

Lufta kundër krimit të organizuar

Kuadri ligjor në lidhje me krimin e organizuar është **pjesërisht harmonizuar** me *acquis* e BE-së

në këtë fushë. *Sa i takon Krimit Kompjuterik*, Shqipëria duhet të miratojë ndryshimet legjislative për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet. *Sa i takon trafikimit të armëve*, ligji për armët është përafruar pjesërisht me dispozitat e BE-së, por ka nevojë të harmonizohet me zhvillimet më të fundit të *acquis* në këtë fushë. Kuadri ligjor nuk është i plotë lidhur me çaktivizimin e armëve të zjarrit dhe mungojnë standardet kombëtare në çaktivizimin e tyre. Duhet të adresohet mungesa e procedurave standarde dhe mekanizmave në luftën kundër tregtisë së paligjshme të armëve të vogla dhe armëve të lehta (AVL) nga ajri. Masat e marra nga Shqipëria në lidhje me rezervat e municioneve duhet të vijnë në përputhje me direktivat e BE-së. ***Lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore***, evidentohet nevoja e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Procedural Penal lidhur me kompensimin e viktimave të trafikimit, lidhur me përcaktimin e “*Vulnerabilitetit të Personave*”, lidhur me përfshirjen në një nen të vetëm të trafikimit të të rriturve dhe të miturve, lidhur me përcaktimin e qartë të trafikimit të brendshëm tek të miturit, lidhur me shfrytëzimin e të miturve për prostitucion në harmonizim me Konventën e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore, etj. ***Lidhur me konfiskimin***, kërkohet të përfundojë ngritja e një zyre për rikuperimin e pasurive (ARO), përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e pasurive kriminale. Në këtë kuadër, duhet të miratohen dhe zbatohen rregulla për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të pasurive, si dhe miratimin dhe zbatimin e rregullave për të siguruar që asetet e konfiskuara do të ripërdoren në mënyrë efektive, në mënyrë që të mos humbin vlerën e tyre ekonomike.

Ligji për Policinë e Shtetit nuk përmend oficerët e ndërlidhjes të Policisë së Shtetit jashtë vendit dhe rolin e tyre, por Urdhri i MB Nr. 535, datë 11.10.2019, “Për përcaktimin e përgjegjësisë dhe funksionin e Oficerit Ndërlidhës të atashuar pranë përfaqësive diplomatike apo organizatave ndërkombëtare jashtë vendit”, rregullon funksionimin normal të Oficerëve tanë Ndërlidhës.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

Në aspektin e përafrimit me legjislacionin e BE-së dhe të harmonizimit me standardet e BE-së në nënfushën e luftës kundër krimit të organizuar, prioritetet kryesore janë:



- Duhet të miratohet legjislacioni mbi pasurinë e pajustifikuar.

- Duhet përmirësuar Ligji i policisë gjyqësore, për të garantuar një bashkëpunim më efektiv midis oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve.

- Duhet të miratohet dhe të zbatohen rregulla për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të pasurive dhe duhet përmirësuar kapaciteti i saj për të menaxhuar pasuritë e ngrira ose të konfiskuara në mënyrë që ato të mos humbasin vlerën ekonomike.

- Duhet të forcohet zbatimi i ligjit mbi krimin kibernetik nëpërmjet rritjes së kapaciteteve për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale.

- Mbeten për tu miratuar ndryshimet legjislative për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijëve në internet.

- Shqipëria duhet të miratojë procedura dhe mekanizma standarde për të kundërshtuar tregtinë e paligjshme të armëve të vogla dhe të lehta nga ajri.

- Duhet të rritet kapaciteti operacional i DPSH-së.

- Miratimi i një ligji për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, i cili do të vendoste në veçanti një skemë kompensimi të financuar nga shteti.

Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës

Sa i takon luftës kundër drogës, pritet miratimi i strategjisë së re kombëtare e kontrollit të drogës (2019 – 2023) dhe plani i veprimt. Gjithashtu, duhet të përditësohet lista e substancave të ndaluara psikoaktive në mënyrë që të sigurohet një kuadër ligjor për të hetuar dhe ndjekur penalisht në lidhje me substanca të tilla. Në këtë kuadër nevojiten amendime në ligjin Nr.7975, datë 26.07.1995, “Për barnat narkotike dhe substancat psikotrope”, të ndryshuar.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Krijimi i Observatorit Kombëtar të Drogës.

- Krijimi i një Sistemi të Paralajmërimit të Hershëm për shkëmbimin e informacionit në lidhje me substancat e reja psikoaktive

Lufta kundër terrorizmit

Shqipëria ka një kuadër të konsiderueshëm ligjor në luftën kundër terrorizmit, parandalimit dhe luftimit të financimit të terrorizmit, por legjislacioni në këtë fushë konsiderohet **pjesërisht i përafër**. Janë identifikuar disa mangësi ligjore, ndër të cilat

mungesa e një dispozite në legjislacionin shqiptar në lidhje me asistencën dhe mbështetjen veçanërisht për viktimat e terrorizmit, e cila pritet të realizohet në kuadër të miratimit të projektligjit “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. Sa i takon rregullave për dëmshpërblimin e viktimave, legjislacioni shqiptar nuk ka një përcaktim se si do të dëmshpërblehen viktimat e akteve terroriste dhe nuk ka ende një përcaktim për ndalimin e akteve të terrorizmit nëpërmjet mediave audio-vizive.

Legjislacioni shqiptar në raport me Direktivën 2018/843 të datës 30 Maj 2018, që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849 “Për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, dhe ndryshimin e Direktivave 2009/138/ KE dhe 2013/36/BE” përafrohet pjesërisht me ndryshimet e reja të bëra në ligjin Nr. 9917/2008.

Legjislacioni shqiptar nuk parashikon ende një plan sigurie për çdo objekt, siç dhe rekomandohet në Direktivën 2008/114 EC e datës 8 Dhjetor 2008 “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Të vazhdojë përdorimi sistematik i hetimeve financiare paralele lidhur me veprat penale terroriste.

- Autoritetet duhet të vazhdojnë përpjekjet për kthimin e grave dhe fëmijëve të mbetur në kampet në Siri.

Migracioni i rregullt dhe i parregullt

Kuadri ligjor për migracionin duhet të harmonizohet më tej me zhvillimet e fundit në *acquis*.

Negociatat mbi Marrëveshjet e Ripranimit (marrëveshjet për kthimin e emigrantëve të parregullt në vendin e tyre të origjinës) po vijnë kryesisht me vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore. Në kuadrin e parandalimit dhe menaxhimit të migracionit të parregullt janë draftuar nga DKM dhe janë në proces negociimi Marrëveshjet e Ripranimit me Afganistanin, Irakun, Pakistanin, Indinë, Algjerinë, Marokun dhe së fundi Marrëveshje e Ripranimit me Egjiptin (nëntor 2021).

Janë në proces draftimi Marrëveshjet e Ripranimit me Bagladeshin dhe Tunizinë dhe brenda vitit 2022, Departamenti për Kufirin dhe



Migracionin do të dorëzojë draftet për këto dy marrëveshje.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Duhet të zbatohen procedurat e kthimit në përputhje me Ligjin për të huajt dhe të sigurohet që mekanizmi i saj i kthimit për migrantët e parregullt të jetë në përputhje me *acquis* të BE-së duke përfshirë respektimin e plotë të të drejtave themelore. Në këtë kuadër, procedurat standarde të punës do të rishikohen për tu përshtatur me ndryshimet e reja ligjore për të huajt dhe azilin.

Azili

Ligji aktual “Për azilin” është përafuar pjesërisht me *acquis* të BE-së.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Duhet të vijojë zbatimi i ligjit Nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij

- Rritja e kapacitetit të Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë, për të vlerësuar kërkesat individuale, veçanërisht informacionin mbi vendin e origjinës dhe rastet që përfshijnë njerëz vulnerabël.

Politika e vizave

Sa i përket politikës së vizave, ajo nuk është akoma në përputhje të plotë me *acquis*, përfshirë këtu listat e vendeve të treta që udhëtojnë në BE me vizë.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Duhet të sigurohet përafrim i plotë i legjislacionit me politikën e vizave të BE -së.

Kufijtë Schengen dhe Kufijtë e Jashtëm

Lidhur me Shengenin dhe Kufijtë e Jashtëm, ligji Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore zbatuese janë në përputhje me *acquis*. Sidoqoftë, kuadri më i gjerë legjislativ për menaxhimin e kufijve të jashtëm të Shqipërisë nuk është akoma në përputhje të plotë me standardet e BE-së. Strategjia dhe Plan i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufijve 2014 – 2020 përputhet pjesërisht me standardet evropiane.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Ndryshimet në Ligjin për Kontrollin Kufitar mbi Informacionin e Avancuar të Udhëtarëve dhe Regjistrimin e Emrit të Pasagjerit (PNR) duhet të jenë në përputhje me *acquis* të BE-së.

- Kuadri legjislativ për menaxhimin e kufijve të jashtëm të Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me *acquis* të BE-së.

- Duhet të hartohet një marrëveshje e cila zyrtarizon bashkëpunimin ndërmjet Policisë

Kufitare dhe Migracionit dhe Doganave për sigurimin e shkëmbimeve të strukturuar të informacionit dhe qasje të ndërsjellë në bazat e të dhënave.

- Duhet të krijohet një sistem i analizës së riskut bazuar në modelin e përbashkët të analizës së integruar të riskut (CIRAM) të zhvilluar nga Frontex.

- Kompetencat hetimore të policisë kufitare duhet të forcohen, në veçanti për të zbuluar rastet e kontrabandimit të njerëzve dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Për këtë qëllim nevojitet ndryshimi i strukturës organike të strukturave qendrore dhe vendore për kufirin dhe migracionin dhe dhënia e kompetencave hetimore.

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* dhe standardet evropiane është arritur kryesisht, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të promovuar shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

Ligji për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale është ndryshuar me Ligjin Nr. 97/2021, datë 7.7.2021, sikurse parashikohet në disa direktiva të rëndësishme në lidhje me njësitë e përbashkëta hetimore, si Vendimi i Këshillit 2002/465/JHA i 13 qershorit 2002 mbi ekipet e përbashkëta hetimore si dhe Rezoluta e Këshillit e 26 shkurtit 2010 mbi një marrëveshje model për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimor.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Duhet finalizuar procedurat e brendshme për aderimin në Konventën e Hagës të vitit 2005 mbi Zgjedhjen e Marrëveshjeve të Gjykatës dhe Protokollin e vitit 2007 mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet e Mirëmbajtjes.

- Duhet të përmirësohet më tej kapaciteti institucional i strukturës së bashkëpunimit ndërgjyqësor.

Mbrojtja e EURO-s nga falsifikimi (aspektet kriminale)

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* dhe standardet evropiane në fushën e mbrojtjes së monedhave nga falsifikimi është realizuar me ratifikimin e Konventës së Gjenevës për Luftën Kundër falsifikimit të Monedhës të vitit 1929, nëpërmjet ligjit Nr. 77/2019, datë 11.11.2019 “Për



Ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën Kundër falsifikimit të Monedhës”, si dhe me marrëveshjet e arritura në fushën e mbrojtjes së monedhës euros nga Banka e Shqipërisë, respektivisht me Komisionin Evropian/DG ECFIN në vitin 2019 dhe me Bankën Qendrore Evropiane në vitin 2021.

Prioritetet/rekomandimet kryesore për këtë nënfushë

- Përmirësimi i kapaciteteve të strukturës qendrore kundër falsifikimit të monedhave në DPPSH, në përputhje nenin 12 të Konventës së Gjenevës, për koordinimin dhe hetimin rasteve të falsifikimit të monedhave.

- Miratimi i projektligjit për disa ndryshime në Kodin Penal, Nr. 7895, datë 27.1.1995, i ndryshuar, në Nenin 183 “Falsifikimi i monedhave” dhe Nenin 185 “Prodhimi i mjeteve për falsifikim” në kuadër të përafrimit të përkufizimit të veprës penale të falsifikimit të monedhave, sipas Direktivës 2014/62/EU për mbrojtjen e monedhës euro kundër falsifikimit.

- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në Fushën e Parandalimit dhe Mbrojtjes së Monedhave nga Falsifikimi mes Ministrisë Brendshme (DPPSH), Prokurorisë Përgjithshme dhe Bankës Shqipërisë, për rritjen e kapaciteteve dhe masave të nevojshme për mbrojtjen e monedhave kundra falsifikimit, sipas Direktivës 2014/62/BE dhe Rregulloren 1338/2001/BE.

KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

4.25.1 Përmbajtja e Kapitullit

Acquis në fushën e shkencës dhe kërkimit nuk kërkon transpozimin e rregullave të BE-së në rendin juridik kombëtar. Kapaciteti zbatues lidhet me ekzistencën e kushteve të nevojshme për pjesëmarrje efektive në programet kuadër të BE-së. Për të siguruar anetaresimin e plotë dhe të suksesshem me Programet Kuadër, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë kapacitetet e nevojshme zbatuese në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik, duke përfshirë personelin e duhur.

4.25.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli shkenca dhe kërkimi shkencor nuk është i ndarë në nënkapituj. Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, kapitulli 25 përmban:

- Financimin e programit buxhetor për kërkimin shkencor në kuadrin e *Arsimit të lartë*

- Performancën e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)

- Strategjinë e Specializimit Inteligjent, ecuria gjatë 2021

- Politikën e Shkencës së Hapur (Open Science)

4.25.3 Kërkesat e MSA-së dhe acquis të BE

Detyrimi i Shqipërisë për të ndërmarrë iniciativa politike, ligjore, institucionale dhe financiare në kapitullin 25, në mbështetje të konsolidimit të sistemit të kërkimit, rrjedh nga Neni 109 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), i cili përcakton shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (Titulli VIII - Politikat e Bashkëpunimit / Bashkëpunimi për Kërkimin dhe Zhvillimin Teknologjik).

4.25.4 Situata aktuale dhe arritjet kryesore

Sipas “Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë” të vitit 2021 rekomandimet kryesore që janë renditur prej BE-së në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi Shkencor” janë:

- Të rrisë investimet në kërkimin shkencor në përputhje me angazhimet e veta dhe përparësitë e ERA-s;

- Të vazhdojë përparimin në zhvillimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent;

- Të sigurojë nënshkrimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrje më të lartë në Horizon Europe.

Në këtë kuadër sfidat që mbeten në situatën aktuale janë rritja e investimeve për kërkim shkencor dhe inovacion në Shqipëri si dhe mbledhja dhe përpunimi në mënyrën e duhur të statistikave përkatëse që lidhen me këtë fushë.

Gjithashtu duhen konkretizuar përpjekjet për “Strategjinë e Specializimit Inteligjent” për të mundësuar ecjen në një vijë me vendet e rajonit.

Progres është shënuar gjatë viteve 2020 – 2021, veçanërisht në hartimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent e cila ka nisur në vitin 2017 nën drejtimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Komisionin Evropian. Gjithashtu me mbështetjen e projektit “BE për Inovacionin” në 2020 – 2021 ka



përfunduar analiza cilësore, ndërsa EDP pritet të përfundojë së shpejti.⁶⁸

Gjatë 2021 me Urdhrin Nr. 425, datë 2.11.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për Ngritjen e Grupit të Punës për Monitorimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022”, GP do të monitorojë zbatimin e “Strategjisë Kombëtare për kërkimin shkencor, teknologjinë dhe inovacionin 2017 – 2022”.

Për sa i përket programeve kuadër të BE-së, Shqipëria ishte pjesë e Horizon 2020 si një vend i asociuar. Pjesëmarrja e saj në Horizon është përmirësuar ndjeshëm dhe tregon një zhvillim të mirë për vitin 2021. Gjatë vitit 2021 u realizuan negociatat për Marrëveshjen e re Horizon Europe, dhe është arritur dakordësia përkatëse. Pritet firmosja e kësaj Marrëveshjeje në vazhdim.

Financimi i programit buxhetor “Për arsimin e lartë”

Fondet e planifikuara për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për vitin 2022 zënë:

- 25,7% e fondeve totale të MAS;
- 0,06% ndaj PBB-së;
- 1,84% ndaj shpenzimeve publike.

Fondet buxhetore për financimin e programeve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, për vitin 2022 (pa përfshirë fondet jashtë buxhetore) është planifikuar në vlerën prej 11 miliard e 752 milion lekë, nga të cilat:

- **20,1 milion lekë** janë shpenzime personeli për Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacioni;

Gjithashtu edhe buxheti 2022 për programin “**Kërkimi Shkencor**” ka një rritje me **9% ose 66 milionë lekë** më shumë krahasuar me vitin 2021. Për projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor, janë planifikuar në total 250 milionë lekë ose **50 milionë lek më shumë se viti 2021** dhe 16 milion lekë më shumë për projektet kërkimore-shkencore të IAL-ve dhe programeve kombëtare të zhvillimit dhe projekte bilaterale.

Nga prioritet e Qeverisë në Arsimin e Lartë mund të veçojmë:

- Investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe sigurimin e integritet akademik dhe shkencor të universiteteve, me qëllim që të përmirësohet cilësia e produktit universitar, ndërsa diploma e secilit student do të mbartë

vlerën që duhet të ketë. (Plani i Qeverisë 2021 – 2025, Objektivat për arsimin)

Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë – fillojmë punën për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri, si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MAS do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare (Plani i Qeverisë 2021 – 2025, Objektivat për arsimin).

Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese për periudhën 2022 – 2024 është planifikuar 746 milion lekë në vitin 2022 dhe arrin në 732 milion lekë në vitin 2024. Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, përfshin fondet për kërkimin shkencor. Ky grant është i hapur, për konkurrim/aplikim për të gjitha institucionet e arsimit të lartë të akredituara që zhvillojnë kërkim shkencor.

Shpërndarja e fondeve të kësaj kategorie të miratuara në formën e “Granti i punës kërkimore-shkencore”, realizohet nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), mbi bazën e projekteve që institucionet paraqesin dhe duke mbajtur në konsideratë treguesit kryesore për projektet kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese të IAL-ve.

Për vitin 2022, nga granditë e punës kërkimore shkencore është planifikuar të mbështeten aktivitetet sa më poshtë;

- *Financimi i Programeve Kombëtare/Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik të mbështetura financiarisht.* Nxitja e punës kërkimore në IAL-të publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 kërkuesve, ku prioritet kanë femrat.

- **Projekte bashkëpunimi të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare.** Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat.

- **Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër të Programeve të BE-së për Kërkim dhe Inovacion**, pjesëmarrje që premtan arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë.

- **Fonde grand për pjesëmarrje me të drejtë dhe të plotë të Republikës së**

⁶⁸ Entrepreneurial Discovery Process



Shqipërisë në programin Erasmus+, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, propozuar nga Komisioni Evropian, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore 20 milion lekë në vit.

- **Granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese**, për këtë periudhë janë parashikuar 1 miliard e 50 milion lekë me një fond vjetor prej **250 milion lekë në vit**.

- Fonde me financim të huaj rreth 100 milion lekë, janë parashikuar, për financimin apo bashkë-financimin e 50 – 70 projekteve me donatore në vit.

Në total për financimin e programit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor për periudhën afatmesme 2022 – 2024, fondet grant planifikuar me burim financimi buxhetin e shtetit së bashku me fondet nga të ardhurat dytësore si dhe grante të tjera të huaja, parashikohet që në vitin 2022 të arrijnë në 14.4 miliard lekë, në vitin 2023 në 15 miliard lekë, si dhe në vitin 2024 16 miliard lekë.

Të dhënat statistikore

Përsa i përket përmirësimit të të dhënave statistikore të kërkim-zhvillimit dhe inovacionit, janë të përfshira me detaje në kapitullin 18 “Statistikat”.

AKKSHI dhe INSTAT në qershor të 2020, nënshkruan një memorandum bashkëpunimit, i cili parashikon përfshirjen në programin statistikor zyrtar, të një serie indikatorësh për fushën e kërkim & zhvillimit. Në zbatim të kësaj marrëveshje është hartuar një anketë e cila ka për qëllim të mbledhë informacion mbi disa indikatorë të dakordësuar ndërmjet INSTAT dhe AKKSHI-së. Burimet e marrjes së informacionit si dhe periodiciteti i mbledhjes së të dhënave, bazohet kryesisht në manualin “Frascati” dhe atë të Oslos.

Performanca e Shqipërisë në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor (veçanërisht në programin kuadër H2020)

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Horizon 2020 është përmirësuar dhe ka arritur rezultate të kënaqshme, me pjesëmarrje në 53 veprime të Horizon 2020, duke përfutur 5.82 milionë euro të kontributit të drejtpërdrejtë të BE-së. Shkalla e suksesit të propozimeve me pjesëmarrje shqiptare është 8,7 %, (nga 7.8% që nga viti i kaluar) krahasuar me 12.1% normë suksesit të vendeve në Horizon 2020.

Përmes marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik, AKKSHI ka krijuar hapësira për lehtësimin e lëvizjes së kërkuesve të huaj. AKKSHI aktualisht po monitoron zbatimin e Marrëveshjeve me Republikat e Italisë, Austrisë, Kosovës. Në qershor 2021, Shqipëria u bë anëtare e EUREKA. Gjithashtu Shqipëria është duke rishikuar marrëveshjen ekzistuese me Turqinë si dhe duke hartuar një marrëveshje të re me Republikën e Maltës.

Aktualisht ekzistojnë marrëveshje ndërkombëtare të bashkëpunimit dypalësh, të ndara si më poshtë:

- 32 (tridhjetë e dy) marrëveshje me vendet e BE-së;

- 5 (pesë) marrëveshje me vendet e Ballkanit Perëndimor;

- 6 (gjashtë) marrëveshje me shtete në Amerikë, Azi, Afrikë.

Horizon 2020

Në kuadër të Programit Horizon 2020 Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare; Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale, pjesë e AKKSHI (NASRI), ka organizuar 250 ditë informuese dhe trajnuese, në IAL-të publike dhe private. Një fokus të veçantë kanë pasur Thirrjet Tematike Horizon 2020 në ardhje, Rrjetet NCP, CORDIS dhe gjetja e partnerëve.

Gjatë periudhës 2014 – 2021, aplikantët nga Shqipëria kanë paraqitur në Programin H2020 një numër total prej 605 aplikimesh, nga të cilat janë vlerësuar fituese 53 aplikime me vlerë totale prej 5.82 milion EURO.

Zhvillimi i Strategjisë së Specializimit Inteligent

Si pjesë e Politikës së Kohezionit të Komisionit Evropian, Strategjia e Specializimit Inteligent (S3) është një qasje inovative që synon të nxisë rritjen ekonomike dhe vendet e punës, duke mundësuar që çdo rajon i një vendi të identifikojë dhe të zhvillojë përparësitë e veta konkurruese. Përmes partneritetit dhe qasjes nga poshtë-lart, është hartuar strategjia e specializimit inteligjent i bashkë autoritetet lokale, akademinë, biznesin dhe shoqërinë civile, për të bashkëpunuar në zbatimin e strategjive afatgjata të rritjes.

Arritjet kryesore

Ndër arritjet kryesore përgjatë periudhës së raportimit janë si më poshtë:



- Ecuria me përgatitjen e Strategjisë së Specializimit Inteligjent.

- Rritja, e buxhetit për kërkimin shkencor;
- Përmirësimi i infrastruktures së kërkimit shkencor si rezultat i masave në kuadër të “Paktit për Universitetin”.

- Ndërtimi i anketës dhe marrja e informacionit mbi disa indikatore dhe prodhimin e statistikave të fushës së kërkimit shkencor dhe inovacionit;

- Përmirësimi i kuadrit rregullator të vlerësimit të cilësisë së kërkimit shkencor, nepermjet VKM-së nr. 165, datë 21.3.2018. MAS është ngritur një grup pune për të siguruar informacionin e institucioneve të arsimit të lartë i cili do të shërbejë si bazë kombëtare të dhënash për këtë sistem.

4.25.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Ministritë dhe institucionet kryesore përgjegjëse për kërkimin shkencor në Shqipëri janë:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Këshilli për Arsimin e Lartë për Kërkimin Shkencor;

- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

- Institucionet e Arsimit të Lartë
- Instituti i Statistikave – INSTAT;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

4.25.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Mangësitë

Mangësitë që identifikohen nga Raporti i Komisionin Evropian për vitin 2021 lidhen me:

- Mungesën e një metodologjie të qartë për të krijuar financime për kërkimin dhe shkencën.

- Investimet e pakta në kërkimin shkencor dhe masat shoqëruese për të forcuar kapacitetin e kërkimit dhe inovacionit në nivel kombëtar, duke pasur parasysh gjithashtu rëndësinë e inovacionit me Planin Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Strategjinë e Specializimit Inteligjent ende të pamiruar.

Prioritete

Nisur nga rekomandimet e raport progresit 2021 përparësitë kryesore të Shqipërisë në këtë fushë janë:

- Monitorimi i Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022 dhe hartimi i raportit të monitorimit brenda vitit 2021.

- Hartimi i strategjisë “Për kërkimin shkencor 2022 – 2026”, brenda vitit 2023.

- Reformimi dhe përmirësimi i sistemit ligjor dhe institucional i kërkimit shkencor. Në këtë kuadër në Planin për Integrimin Evropian kemi planifikuar që brenda vitit 2023 të kemi miratuar “Ligjin për Shkencën”.

- Sigurimi i pjesëmarrjes në Horizon Europe.

- Ngritja e kapaciteteve të NCP, me qëllim rritjen e nivelit të pjesëmarrjes dhe suksesit në Programet kuadër të BE-së, veçanërisht atë të Horizon Europe.

- Hartimi i metodologjisë kombëtare të investimit të fondeve për kërkimin dhe shkencën.

- Rritja e financimit në nivel kombëtar për shkencën dhe zhvillimin, gjë që është parashikuar edhe në buxhetin afatmesëm të MAS-s.

- Nxitja e bashkëpunimit të akademi-biznes-qeveri (Triple Helix), si dhe përballimi dhe zgjidhja e sfidave social-ekonomike të vendit përmes një kërkimi shkencor sa më cilësor.

- Thëllimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkencës dhe kërkimit shkencor, qoftë në nivel rajonal e ndërkombëtar.

- Përfshirja dhe zbatimi i parimeve të Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor–ERA.

- Miratimi i Strategjisë për Specializimin Inteligjent brenda vitit 2023.

KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

4.26.1 Përmbajtja e kapitullit

Fushat e arsimit, formimit, rinisë dhe kulturës janë kryesisht kompetencë e Shteteve Anëtare. Kuadri i bashkëpunimit për politikat e arsimit dhe formimit synon të konvergojë politikat kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta nëpërmjet metodës së hapur të koordinimit, e cila çoi në programin “Edukimi dhe Formimi 2010”, i cili integron të gjitha veprimet në fushën e arsimit dhe formimit në nivel evropian. Për sa i përket diversitetit kulturor, Shtetet Anëtare duhet të respektojnë parimet e parashikuara në nenin 151 të Traktatit të KE-së dhe të sigurojnë që angazhimet e



tyre ndërkombëtare lejojnë ruajtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor. Shtetet anëtare duhet të kenë kuadrin ligjor, administrativ dhe financiar dhe kapacitetin e nevojshëm zbatues për të siguruar menaxhim të shëndoshë financiar të programeve evropiane të arsimit, formimit dhe rinisë (aktualisht Leonardo da Vinci, Socrates, Youth).

4.26.2 Struktura e kapitullit

- Arsimi;
- Arsimi profesional;
- Rinia;
- Kultura.

4.26.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për të përfunduar legjislacionin shqiptar në arsim me *acquis* të BE-së buron nga neni 70 i MSA-së për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe formim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA thekson se “palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor”. Ky bashkëpunim do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e mirëkuptimit të përbashkët dhe të respektit reciprok ndërmjet individëve, komunitetit dhe njerëzve. Palët gjithashtu zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO-s “Për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore”.

Qëllimi i politikave të BE-së për kulturën është për të inkurajuar bashkëpunimin në mbështetje dhe për plotësimin e veprimeve që lidhen me rritjen e dijes dhe përhapjen e kulturës, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shkëmbimet kulturore dhe krijimet letrare dhe artistike duke përfshirë dhe sektorin audiovizual.

BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare të BE-së në fushën e arsimit dhe kulturës.

4.26.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është e përgatitur mesatarisht në fushën e arsimit dhe kulturës. Në këtë fushë janë bërë disa përparime në drejtim të:

- Miratimit të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021 – 2026;

- marrjen e masave të veçanta në përshtatjen e shpejtë të edukimit në distancë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19;

- digjitalizimit të shërbimeve arsimore;
- forcimit të Agjencisë së re Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë;

- ristrukturimin e vazhdueshëm të Agjencisë Kombëtare për Arsimin, Aftësimin dhe Kualifikimet Profesionale;

- Ristrukturimi i vazhdueshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe Bordit të Akreditimit. Përmirësimi i VKM 109/2017 që harmonizon, organizon veprimtarinë e tyre;

- Hartimi i standardeve të përmirësuara të cilësisë në Arsimin e lartë, pjesë e Kodit të Cilësisë, në përpjekje për t'i afuar ato dhe përputhur me standardet evropiane ESG;

- zbatimin e vazhdueshëm të ligjit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit;

- miratimin e Planit të Optimizimit për ofruesit e AFP;

- zbatimin të strategjisë për kulturën 2019 – 2025.

Arsimi Para universitar

Pandemia COVID-19 konsiderohet një sfidë e madhe globale, e cila ka ndikuar në çdo aspekt dhe sektor të shoqërisë, përfshirë edhe arsimin. Tre format kryesore të mësimin në distancë që u përdoren gjatë kësaj periudhe janë:

- Mësimet të xhiruara dhe të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH). Këto mësimet u ndoqën nga 78.9% e nxënësve, 79.9% e prindërve dhe 96.4% e mësuesve. Nxënësit që nuk arrinin të shohin transmetimet, ndoqën videot në kanalin e Youtube të MAS-së apo

- Komunikimi mes nxënësve dhe mësuesve përmes rrjeteve sociale apo përmes platformave të ndryshme që mundësuan krijimin e klasave virtuale (*google classroom, google hangout, edmodo, zoom* etj.). Një numër shumë i konsiderueshëm i nxënësve, prindërve dhe mësuesve u angazhuan në mësimet online: 96.8% e nxënësve, 95.3% e prindërve dhe 98.7% e mësuesve

- Platforma online akademi.al e cila siguron për nxënësit dhe mësuesit përdorim falas në platformën online për mësimdhënien, e cila bazohet në kurrikulën e arsimit parauniversitar.

Edhe në këtë vit shkollor 2021 – 2022, shkollat do të mbështeten nëpërmjet ofrimit të mësimave të xhiruara dhe të transmetuara në kanalin televiziv



“RTSH Shkolla” dhe në kanalin zyrtar Youtube të MAS, ofrimit të platformës Akademi.al për mësimin online, realizimit të trajnimeve për zhvillimin e aftësive digjitale të mësuesve etj.

Gjatë situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 për t'i ardhur në ndihmë mësuesve, nxënësve dhe prindërve, u hartuan dhe publikun një serë udhëzuesish dhe dokumentesh mbi mësimin në kushtet e shtëpisë; për realizimin e programit lëndor dhe vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë; mbi Programin e mësimin plotësues në gjuhë shqipe dhe matematikë për klasat 1 – 5 me nxënës që paraqitën vështirësi gjatë mësimin të zhvilluar në kushtet e shtëpisë (online); për nxënës që nuk patën akses online gjatë mbylljes së shkollave në periudhën mars – maj 2020; ideuar skenarët e mundshëm për zhvillimin e procesit të mësimdhënies – nxënies në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19.

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve ka vijuar trajnimi i mësuesve për zhvillimin e tyre profesional duke përfshirë edhe nevojat e mësuesve në kuadër të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe ka vijuar edhe funksionimi i rrjeteve profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Prioritet për vitin shkollor 2020 – 2021 ka qenë trajnimi i mësuesve të shkencave të natyrës (Biologji, Kimi, Fizikë). Trajnimi konsiston në përgatitjen e nxënësve me pyetje të formatit të provimit ndërkombëtar PISA. Trajnimet vijnë edhe gjatë vitit shkollor 2021 – 2022.

Në përfundim të vitit shkollor 2020 – 2021, janë realizuar testimet me nxënës në të gjitha klasat e arsimit para universitar rezultatet e këtyre testeve ishin të vlefshme për të orientuar mësuesit lidhur me identifikimin e nevojave të nxënësve për të përmirësuar njohuritë e tyre si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19. Në këtë kuadër Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Para universitar (ASCAP) ka hartuar temat orientuese për të gjitha klasat sipas lendeve përkatëse, të cilat u trajtuan gjatë periudhës 1 – 27 shtator 2021.

Në periudhën 1 – 24 shtator 2021 u zhvillua mësimi plotësues në të gjitha institucionet e arsimit para universitar, në zbatim të udhëzuesit të ASCAP “Për përmirësimin e arritjeve të nxënësve si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19”, me qëllim përfundimin dhe përmirësimin e rezultateve

të nxënësve lidhur me mangësitë e identifikuar gjatë vitit të kaluar shkollor. Shkollat gjithashtu zbatuan një program gjithëpërfshirës me aktivitete argëtuese dhe sportive për nxënës.

Gjatë mësimin plotësues u tregua kujdes në mbështetjen maksimale për nxënës me aftësi të kufizuara (AK). Në vitin shkollor 2020 – 2021 në sistemin arsimor para universitar ndoqën mësimin në institucione arsimore publike dhe private duke filluar nga arsimi parashkollor, 4 672 nxënës me aftësi të kufizuara (AK). Raporti i nxënësve me AK që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special është përmirësuar nga 75% që ishte në vitin 2014 në rreth 90% në vitin 2020 – 2021. Po në këtë vit shkollor u punësuan në sistemin e arsimit para universitar publik dhe privat rreth 1300 mësues ndihmës. Raporti fëmijë me AK/mësues ndihmës këtë vit është rreth 3.7.

Krahas sa më sipër, është përcaktuar si një nga përparësitë e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021 – 2026 kthimi i shkollave speciale në qendra burimore. Në MAS është ngritur Grupi i Punës i cili ka filluar punën për vlerësimin dhe përcaktimin e modelit të qendrave burimore për nxënës me aftësi të kufizuara. Gjithashtu po vijohet të punohet me masat e parashikuara në planin e veprimtimit 2019 – 2023 për fëmijët që nuk dëgjojnë duke miratuar planin e ri mësimor dhe fillimin e hartimit të kurrikulës së re për arsimin bazë; intensifikuar përgatitjet e moduleve për trajnimin e mësuesve të Institutit të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë dhe mësuesve ndihmës në gjuhën e shenjave shqipe për nxënës që nuk dëgjojnë në shkollat e zakonshme.

Një nga arritjet kryesore të MAS këtë vit është miratimi në muajin tetor 2021 i Strategjisë Kombëtare të Arsimit për periudhën 2021 – 2026 me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021. Miratimi i Strategjisë shënon dhe një angazhim të përmbyllur të rekomandimit të KE-së në Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë: ‘të miratojë strategjinë e re për arsimin, duke mbuluar të gjitha nivelet dhe duke siguruar mbrojtjen e dubur financiare si dhe shpenzimet publike të synuara për njerëzit e prekur nga tërmeti dhe pandemia COVID-19.’

Në zbatim të strategjisë së re të arsimit dhe në kuadër të plurilingualizmit, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) prezantoi gjuhën angleze si lëndë e detyrueshme që në klasën e parë. Në këtë kuadër MAS rishikoi planin e mësimdhënies dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Para universitar



(ASCAP) hartoi programet mësimore në gjuhën angleze për klasën e parë dhe të dytë. Pasi të kenë identifikuar dhe analizuar nevojat e mësuesve të klasës së parë të gjuhës angleze për zhvillimin e tyre profesional, MAS dhe ASCAP do të mbajnë punëtori që fokusohen në metodologjinë e mësimdhënies, pedagogjinë për nxënësit shumë të rinj dhe vlerësimin gjatë gjysmës së parë të vitit 2022. Gjithashtu, MAS dhe ASCAP do të hartojnë gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 një manual trajnimi në mbështetje të mësuesve të anglishtes: “Metodologjia e mësimi të anglishtes për nxënësit e rinj”. Përtej kësaj nisme, MAS po punon aktualisht për zbatimin në shkollë të programit “Artet dhe zëjet”.

Në vazhdim të dhënies në përdorim/falas të teksteve shkollore në vitin shkollor 2021 – 2022, kjo reformë u shtri nga klasa I në klasën e IX duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e barrës financiare të familjeve shqiptare. Për vitin shkollor 2021 – 2022 janë rreth 280 000 nxënës nga klasa e 1 – 9, përfshirë edhe 16 kategoritë e veçanta nga klasa 1 – 12, që kanë përfituar tekstet shkollore falas.

Një tjetër risi në fushën e arsimit para universitar është krijimi i Këshillit Kombëtar i Prindërve (KKP), si një organ këshillimor i pavarur, i cili përfaqëson interesat e prindërve në nivel kombëtar. KKP është mekanizmi kryesor i komunikimit dhe këshillimit ndërmjet MAS dhe prindërve.

Po ashtu një arritje në kuadër të bashkëpunimit me diasporën është miratimi i tekstit të përbashkët me Kosovën që do të përdoret për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët në diasporë për nivelin I nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës: “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli I.

Arsimi i Lartë

Lidhur me njohjen automatike të diplomave, Shqipëria është angazhuar të integrojë dhe zbatojë njohjen e kualifikimeve akademike në Ballkanin Perëndimor dhe përmirësimin e cilësisë së njohjes së kualifikimeve akademike në rajon, në përputhje me *acquis*, si pjesë e agjendës së saj të integritetit rajonal, konkretisht planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021 – 2024, miratuar nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor në nëntor 2020.

Konkretisht, në këtë kuadër vendet e rajonit (Ballkanit Perëndimor), me mbështetje e

Sekretariatet e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), kanë kryer takime te nivelit teknik nga përfaqësuesit e secilit prej vendeve për draftimin e Marrëveshjes së Ballkanit Perëndimor për njohjen e kualifikimeve në arsimin e lartë”. Gjatë vitit 2021 në nivel teknik janë organizuar 8-të takime të Negociatorëve Kryesues në nivel të Grupit të Punës për Marrëveshjen për Njohjen e Kualifikimeve Akademike.

Grupi i Punës ka shteruar mandatin e tij për negociimin e Marrëveshjes për Njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë. Kanë ngelur edhe disa çështje, jashtë mandatit të Grupit të Punës, për t’u harmonizuar në një nivel më të lartë politik.

Në lidhje me Procesin e Bolonjës, si pjesë e EHEA dhe Procesit të Bolonjës nga 2003, Shqipëria është shumë e angazhuar të përmbushë të gjitha angazhimet e Procesit të Bolonjës. Në fokus të kërkesës për mbështetjen Shqipërisë në BFUG në vitet e ardhshme duhet të jenë treguesit si vijojnë: implementimi i rezultateve të nxënës në kurrikula; shpërndarja e ECTS sipas rezultateve të nxënës; nxitja dhe inkurajimi i vlerësimit të studentëve në bazë të rezultateve të nxënës; përshtatja e masave për mbështetjen e studentëve që të sigurojnë përfaqësimin e grupeve të nën përfaqësuar; anketimi i të diplomuarve; llogaritja dhe monitorimi i atyre që nuk përfundojnë studimet e larta.

Në kuadër të aplikimit për anëtarësim të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për anëtarësim të plotë në Rrjetin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (ENQA) dhe në Regjistrin Evropian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR), është rishikuar Vendimi Nr. 109, datë 15.02.2017/i ndryshuar i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, si dhe Vendimi Nr. 531, datë 11.09.2018 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë”.

Projekt akti për rishikimin e VKM-së Nr. 109, datë 15.02.2017 përfshin disa nga elementët që mungojnë në lidhje me Standardet dhe Udhëzuesit për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (SUE) që njihen edhe si ESG 2015 (European Standards and Guidelines – 2015),



sidomos ato standarde që kanë të bëjnë me përfshirjen e studentëve në grupet e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit; Përfshirjen e monitorimit të vazhduar të cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të tyre të studimit. Aplikimi i këtyre elementëve mundëson nisjen e procesit të aplikimit për anëtarësim të plotë në ENQA. Anëtarësimi në ENQA i jep mundësinë ASCAL-it të jetë pjesë e Regjistrat Evropean të Sigurimit të Cilësisë (EQAR), i cili mundëson pjesëmarrje në regjistrin e agjencive të besueshme në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Ndërsa Projekt akti për rishikimin e Vendimit Nr. 531, datë 11.09.2018 përfshin disa nga elementët që mungojnë në lidhje me *ESG 2015*, që kanë të bëjnë sidomos me përditësimin e programeve të studimit në drejtim të arritjeve të të nxënës, përmirësimin e mësimdhënies me në qendër studentin, forcimin e mëtejshëm të veprimtarisë të Njësisë të brendshme të sigurimit të cilësisë nëpër universitete, si edhe aspekte të tjera të këtyre standardeve.

Rinia

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës (PKPP) në administratën publike, synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvojë kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale dhe njohjen e administratës publike.

Aplikantët, janë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor". Programi Kombëtar i Praktikave të Punës zgjat 3 muaj. Përfshirja në këtë program është pa pagesë. Periudha e praktikës së zhvilluar njihet si përvojë pune gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e administratës publike.

Ky program, është realizuar deri në vitin 2021 nga ish Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila është mbështetur nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike e jopublike, që ofrojnë gatishmëri për pranimin e aplikantëve. Në vazhdim programi do të ndiqet nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bazë të fushës së përgjegjësisë të përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në vitin 2021, është shpallur thirrja e VI e PKPP. Në këtë Thirrje ka

pasur 2852 aplikantë, nga të cilët janë shpallur 783 fitues për të kryer praktikën tre mujore në administratën qendrore, administratën vendore, institucionet publike të pavarura, si dhe shoqëritë tregtare.

Nga Ministria e Kulturës është hartuar "Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025" dhe miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 903, Datë 24.12.2019 "Për Miratimin e

Strategjisë Kombëtare për Kulturën, 2019–2025", dhe Plani i saj i Veprimt. Ky është dokumenti i parë i këtij lloji, me anë të cilit synohet konceptimi i një udhërrëfyesi për zhvillimin e sektorit të kulturës dhe trashëgimisë kulturore me qëllim të krijimit të kushteve të favorshme për zhvillim individual, social dhe shtetëror.

Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë po plotësohet me aktet nënligjore, shumica e akteve është miratuar dhe po përfundon miratimi dhe hartimi i akteve të mbetura.

Qeveria së fundmi ka racionalizuar institucionet e AFP-së, duke krijuar Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe duke ristrukturuar më tej Agjencinë Kombëtare të AFP-së dhe Kualifikimeve. Në sistemin e AFP-së, tashmë është zhvilluar një cikël koherent politikash të proceseve të brendshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kualifikimeve profesionale, i cili mbështet përshtatshmërinë e kualifikimeve në tregun e punës.

Korniza Shqiptare e Kualifikimeve (KSHK)

Task Forca e ngritur me urdhrin e përbashkët të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me nr. 22, datë 28.1.2020, i ndryshuar ka ekzaminuar dhe veçuar ndryshimet e nevojshme të kornizës ligjore për arsimin në mënyrë që të përmbushë kriteret e referencës në mënyrë që Korniza jonë e Kualifikimeve të referohet Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF) dhe asaj të QF-EHEA.

Task Forca në zbatim të detyrave të saj për ndjekjen e procesit të Referencimit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe të QF-EHEA, krijoi Grupet Teknike për rishikimin dhe detajimin e përshkruesve të niveleve të KSHK-së.

Më tej, në Shtator 2021 nga Zyra Kombëtare Erasmus+ dhe Task Forca në bashkëpunim me grupin e Ekspertëve të Reformës së Arsimit të



Lartë – HERE dhe gjithë aktorët e interesuar (përfshirë ekspertë të huaj dhe vendas), u realizua Seminari Kombëtar me temë: “Referencimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimit në Kornizën Evropiane të Kualifikimit, KEK (EQF) dhe vetë-referencimi në Kornizën e Kualifikimit të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë KK - ZEAL (QF-EHEA)”. Në punën e saj Task-Forca është asistuar nga CEDEFOP, ETF dhe Rrjeti ENIC-NARIC.

Në shtator të 2021, Task-Forca i ka përcjellë Bordit Këshillimor draft raportin e Referencimit. Pas shqyrtimit nga Bordi Këshillimor, Task Forca në takimin e datave 27 – 28 tetor 2021, reflektoi mbi komentet dhe sugjerimet për përmirësimin e draft raportit të Referencimit. Task-Forca përfundon mandatin në fund të vitit 2021 dhe më tej grupet e tjera të punës, në bashkëpunim me institucionet përkatëse që lidhen me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve do të vazhdojnë punën për të reflektuar nevojat e tjera të lidhura me ndryshimet ligjore në këtë fushë.

Buxheti

- Fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë në programin buxhetor afatmesëm për periudhën 2021 – 2023;

- Totali i fondeve/ tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021 – 2023, të miratuara për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, miratuar me Vendimin nr. 577, datë 22.7.2020 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021 – 2023”, për vitin 2021 janë 43 miliard e 852 milion lekë, krahasuar me fondet e rishikuara të vitit 2020 kanë një rritje prej 5.5%, në vitin 2022 janë 44 miliard e 431 milion lekë dhe në vitin 2023 arrijnë në 45 miliard e 512 milion lekë. Fondet e parashikuara për periudhën 2021 – 2023, kanë një rritje mesatare vjetore që shkon nga 5.5%, në 2.4% ndaj vitit paraardhës. Fondet e miratuara për vitin 2023, krahasuar me vitin 2020 sipas VMK nr. 527, datë 22.7.2020, kanë një rritje prej 9%;

- Fondet e miratuara në tavanet përfundimtare për MAS, *pa përfshirë të ardhurat dytësore si dhe fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin*, ndaj totalit të shpenzimeve buxhetore për periudhën 2021 –

2023, parashikohet të arrijnë në 7.6% në vitin 2021, në 7.8% në vitin 2022, dhe në 7.6% në vitin 2023;

- Fondet publike për arsimin, pa përfshirë të ardhurat dytësore si dhe fondet e ministrive të linjës për arsimin si dhe fondet e njësive të vetëqeverisjes vendore për arsimin, ndaj produktit të brendshëm bruto nga 2.4% në vitin 2019, në vitin 2021 arrijnë në 2.5%, në vitin 2022 në masën 2.4, si dhe në vitin 2023 arrijnë në masën 2.3%;

- Fondet për “Sektorin e Arsimit”, parashikuar për periudhën afatmesme 2021 – 2023, ku janë pjesë e fondeve të arsimit, të ardhurat dytësore të IAL publike si dhe të ardhurat e tjera nga të tretët, përfshirë fondet e parashikuara nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financës dhe Ekonomisë “Fonde për arsimin”, fondet e parashikuara të njësive të vetëqeverisjes vendor “për shërbimet dhe funksionet në arsimin para universitar”, si dhe fondet nga projekte të veçantë të donatorëve (*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private), në vitin 2023 parashikohet të arrijnë në 63.3 miliard lekë, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 10.61% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.21%.

Arsimi dhe formimi profesional

Në fushën e politikave të AFP, janë zhvilluar politika të konsiderueshme të zhvillimit të aftësive dhe plotësime në kuadrin ligjor për ligjin e AFP dhe KSHK.

Aktualisht, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive si dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), po plotësohen me burime njerëzore dhe po punohet për rritjen e kapaciteteve të tyre.

Janë regjistruar në vitet e para të shkollave profesionale, për vitin arsimor 2021 – 2022, rreth 4.500 nxënës. Në total numri i nxënësve që ndjekin shkollat profesionale arrin në rreth 17.000 nxënës. Numri i vajzave që ndjekin shkollat profesionale është rreth 3.000 nxënës.

Gjithashtu në vitin arsimor 2020 – 2021 i ndoqën shkollat profesionale 616 nxënës nga komuniteti Romë dhe Egjiptiane. Po ashtu numri i nxënësve me aftësi të kufizuara ishte 153 nxënës.

Trendi i regjistrimeve vijon të jetë konstant në vitet e fundit. Sqarojmë se duke ju referuar të dhënave statistikore sipas INSTAT, numri i nxënësve që përfundojnë klasat e 9-ta nga viti në



vit vjen në ulje, kjo sipas problemeve demografike, lëvizjes së lirë të njerëzve, etj.

Trajnimi fillestar dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve/ instruktorëve ka vazhduar dhe gjatë 2020 dhe pse kjo ishte e vështirë në kushtet e COVID-19.

Një hap shtesë drejt sigurimit të cilësisë është procesi i vetëvlerësimit i cili tashmë është një proces që kryhet çdo vit në të gjithë ofruesit e AFP-së.

Në përshtatje me nevojat e tregut të punës për punonjës të kualifikuar, në vitin 2020 janë hartuar 18 përshkrime / standarde të kualifikimit profesional hartuar 2 skelet kurikula të reja dhe rishikuar 19 skelet kurrikula në përputhje me nivelet 2 – 4 të KSHK.

Në prill të 2021 u miratua Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve profesionale me 122 kualifikime për nivelet 2 – 5 të KSHK.

Procesi i ngritjes së komitetit të parë sektorial është një nga zhvillimet e reja në AFP në Shqipëri. Në mbështetje të pikës 1, të VKM Nr. 426, datë 26.06.2019, “Për mënyrën e organizimit, funksionimit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërbërimit të tyre”, si dhe urdhrat të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë, nr. 64 datë 30.03.2021 është përcaktuar sektori i IT për krijimin e Komitetit të parë sektorial. Po punohet për institucionalizimin e këtij Komiteti si dhe për krijimin e komitetit të dytë sektorial në fushën e turizmit.

Nëpërmjet qendrave publike të formimit profesional janë ofruar kurse formimi sipas kërkesave të tregut të punës. Për periudhën janar – gusht të viti 2021 janë regjistruar 6 246 persona, prej të cilëve 2 747 femra, ndërsa janë certifikuarit rreth 2 614 persona, nga të cilët 1 157 janë femra.

Rinia

Ideja e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 vjen si një domosdoshmëri jo vetëm me miratimin e Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, por edhe për faktin se në dhjetor 2020 ka përfunduar “Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 – 2020”. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese,

për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfida si, përfshirja e tyre në proceset vendimmarrëse, punësimi, edukimi, teknologjia dhe inovacioni, rritja e aktiviteteve në lidhje me artet dhe zejet, shtim të aktiviteteve sportive, vullnetarizëm etj. Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë në përputhje me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019 – 2027. Në kuadër të hartimit të Strategjisë, do të zhvillohen takime me nxënës përfaqësues të shkollave të mesme, studentë përfaqësues nga Universitete të ndryshme, organizata për të rinj dhe përfaqësues nga institucione qendrore dhe vendore. Hartimi i strategjisë do të mbështetet nga UNICEF dhe UNDP, të cilët do të nënkontraktjnë dy ekspertë, një lokal dhe një të huaj.

Kultura

Në vizionin e Qeverisë dhe prioritetet institucionale të Ministrisë së Kulturës, investimet kulturore synojnë të ndikojnë drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetës dhe në edukimin e grup-moshave të ndryshme.

Krijimi i Qendrës Kombëtare për Fëmijë është hapi i parë për politikat dhe programet në favor të familjes dhe fëmijëve, i cili pritet të jetë gati deri në fund të vitit 2021.

Krijimi i laboratorëve artistikë dhe të zejtarisë për 100 shkolla në vit do të përfshijë lidhjen me teknologjinë, platformën e-learning, muzetë virtuale, video tutoriale për fëmijë online dhe në televizion.

“Bonusi i Kulturës”, synon rritjen e aksesit të brezit të ri në produktet dhe shërbimet, që lidhen me artin dhe trashëgiminë kulturore, por dhe përfshirjen e rinisë në të gjitha fushat e veprimtarisë sociale e publike.

“Pakti për Universitetin” ka në fokus bashkëpunimin me universitete brenda dhe jashtë vendit për zhvillimin bashkëkohor të programeve akademike Bachelor, Master dhe PhD në konservim dhe restaurim, artet bashkëkohore. Industria Krijuese e shek. XXI, do të ketë në fokus formimin profesional në restaurimin dhe konservimin e veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore, me autonomi shkencore, financiare dhe organizative në mbështetje të punësimit të artistëve të rinj.

Veçojmë bashkëpunimin e frytshëm me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri,



Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, UNESCO, TIKa ku janë zbatuar dhe po vijojnë zbatimin ndërhyrje restauruese, konservuese në disa objekte të rëndësishme të trashëgimisë kulturore kombëtare:

- Programi EU4culture: “Rijetëzimi i trashëgimisë kulturore të Shqipërisë si pasojë e tërmetit të vitit 2019 në Shqipëri, dhe ndikimet socio-ekonomike të pandemisë globale COVID-19”;

- Po zbatohen projektet: "Milestone III", Creatures, Polyphonia, “MONA- Monumentet në Natyrë” "SMART-CUL-TOUR", "3C IKTK", "Monet MK", "IPA Phygital", IPA "Hamleti"; rojekti me Rajonin e Pulias për rikualifikimin e hapësirës së Parkut të Kinostudios "Parku Artit" rojekti "Inventarizimi me bazë komunitare i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale”;

- Projektet e restaurimit të Xhamisë Mbret, Berat, Xhamia e Beqarëve, Berat, Teqeja e Helvetive, Berat, Xhamia Ethem Beut Tirane dhe Xhamia e Pazarit Gjirokastrë me investitor TIKa të përfunduara;

- Projekti për rehabilitimin e qendrës mesjetare Berat;

- Projekti për digjitalizimin e arkivës teknike të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë kulturore.

Gjatë vitit 2022, një rëndësi e veçantë janë investimet publike, ku për t'u theksuar janë:

- Ngritja e Qendrës së re Kombëtare për Fëmijë;

- Rikonstruksioni i Galerisë Kombëtare të Arteve;

- Rikonstruksioni i Godinës së Teatrit të Kukullave.

Prioritet kanë pasur dhe do të kenë edhe në të ardhmen “Projektet me Thirrje”, , ku gjatë vitit 2021 Ministria e Kulturës ka mbështetur në total 160 projekt propozime në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Në fushën e trashëgimisë kulturore:

- Ditët Evropiane të Trashëgimisë 27 shtator – 3 tetor 2021;

- Përfundimi dhe dorëzimi pranë UNESCO i aplikimit për regjistrim në Listën Botërore të Trashëgimisë Jomateriale të UNESCO të dukurive: Xhubleta, Kërcimi i Tropojës;

- Përgatitja e dosjeve të aplikimit për regjistrim të dukurive të trashëgimisë jomateriale Eposi i Kreshnikëve dhe Transhumanca;

- Projekti “Inventarizimi i Trashëgimisë Jomateriale me bazë komunitetin me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe transmetimin në brezat e ardhshëm”;

- Projekti “Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës” si propozim për nominim në Regjistrine Praktikave më të mira të UNESCO-s;

- Ka përfunduar rikonstruksioni i Njesisë së Digjitalizimit të pasurive kulturore në kuadër të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Kulturës me AADF;

- Përgatitja e draftit të Dosjes “Marubi” për kandidim në programin “*Memory of the Earth*” të UNESCO-s;

- Përgatitja e draftit të Planit të Menaxhimit të Integruar të zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit në kuadër të Marrëveshjes me AADF;

- Projekti APPRODI “*From Ancient Maritime Routes to eco – tourist destinations*” në kuadër të Interreg Adriion;

- Program edukativ me teme “Ikonat e kishave të Vithkuqit dhe Voskopojes në koleksionin e Muzeut Kombëtar i Artit Mejsetar, Korçë”.

Ekspozita të organizuara brenda dhe jashtë vendit

Gjatë vitit 2021, një rëndësi e veçantë kanë patur investimet publike, ndër të cilat për t'u theksuar përmendim:

- Përfundimi i hartimit të 3 planeve të konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në: brenda kalasë së Krujës, zonë arkeologjike A, muri i kalasë së Durrësit me kullën veneciane; kalaja e Prezës dhe xhamia nën kalanë e Prezës;

- Fillimi i zbatimit të projektit madhor të Ministrisë së Kulturës “Rehabilitimi dhe riformulimi i linjës muzeore të Galerisë Kombëtare të Arteve”;

- Përfundimi dhe inaugurimi i zbatimit të ndërhyrjeve restauruese dhe muzealizim i “Mësonjëtorja e pare shqipe”;

- Restaurim i kishës së Shën e Premtes në Lukovë;

- Realizimi i punimeve të konservimit në Portën me kulla dhe Nimfeu, qyteti antik Butrint.



Gjithashtu gjatë 2021 me fonde të buxhetit të shtetit janë zbatuar ndërhyrje restauruese, konsoliduese dhe të mirëmbajtjes në 111 objekte pasuri kulturore.

Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Muzetë Kombëtarë dhe Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike kanë realizuar rreth 190 aktivitete edukuese, promovuese, ekspozita dhe botime përfshirë këtu edhe aktivitete në kuadër të ditëve ndërkombëtare të monumenteve dhe siteve, muzeve, diversitetit kulturor, ditëve evropiane të trashëgimisë dhe ditës kombëtare të trashëgimisë.

Investimet e parashikuara për vitin 2022 do të fokusohen kryesisht në rehabilitimin e monumenteve të kulturës, të cilat janë në faza emergjente dhe të planifikuara si në plane pune dhe parashikimet financiare nga buxheti i shtetit apo dhe donacionet, ku gatë vitit 2022 parashikohen ndër të tjera:

- Vijimi i zbatimit të ndërhyrjeve restauruese në monumentet e kulturës pjesë e programit madhor EU4culture;

- Restaurimi, rikonstrukcioni dhe rehabilitim i hapësirave në muzeun e Arteve të Bukura (Galeria Kombëtare e Arteve);

- Katër projekte për ndriçimin e jashtëm të kalave të Beratit, Krujës, Shkodrës, Gjirokastrës

- Restaurimi i kishës së Shën Kollit, Krutje e Sipërme, Lushnje;

- Vijimi i projekti i digjitalizimit “Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë, për një qasje më të gjerë për të gjithë”, bashkëpunim me AADF;

- Programe kulturore: “Rrugët e Kujtesës” (Projekti për kthimin e burgut të Spaçit në një qendër muzeore në proces përgatitje të Planit të Menaxhimit, Ngritja e Muzeut të Hebrenjve – në proces hartimi i projektit) dhe “Rrugët e Besimit”.

Në zbatim të ligjit 27 / 2018, gjatë vitit 2021 janë miratuar dhe ka filluar puna për zbatimin e gjashtë akteve nënligjore.

Lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e kulturës, Ministria e Kulturës përgjatë vitit 2021 ka nënshkruar 8 Marrëveshje dhe aktualisht janë në proces 16 marrëveshje tjera.

Komisioni Evropian dhe Ministria e Kulturës po vijojnë procedurat ligjore për nënshkrimin e marrëveshjes për aderimin e Ministrisë së Kulturës

në programin “Creative Europe”, brenda muajit dhjetor 2021.

4.26.5 Lista e Ministrive dhe Institucioneve Përgjegjëse

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS);
- Ministria e Kulturës (MK);
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);

- Ministria Shtetit për Rininë dhe Fëmijët (MSHRF);

- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Para universitar (ASCAP);

- Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA);
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL);

- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK);

- Instituti i Statistikave (INSTAT).

4.26.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritet

Sipas raportit për Shqipërinë të vitit 2020 si dhe ai i vitit 2021 Shqipëria konsiderohet si e përgatitur mesatarisht në fushën e arsimit dhe kulturës. Në të dy raportet është rekomanduar miratimi i strategjisë së re për arsimin, *‘duke mbuluar të gjitha nivelet dhe duke siguruar mbrojtjen e duhur financiare si dhe shpenzimet publike të synuara për njerëzit e prekur nga tërmeti dhe pandemia COVID-19.’* Ky rekomandim është përmbushur për sa i përket miratimit të Strategjisë Kombëtare për Arsimin e cila mbulon të gjitha nivelet.

Disa nga prioritetet e MAS mbështetur në Programin e Qeverisë 2021 – 2025 si dhe në SKA 2021 – 2026 janë si më poshtë:

- Përfundojë legjislacionin zbatues të ligjit për AFP-në dhe të zbatojë Planin e Optimizimit deri në vitin 2022 për të zhvilluar shërbime dhe kompetenca në përputhje me nevojat e sektorit privat në nivel lokal;

- Të sigurojë mbrojtjen e duhur financiare ashtu edhe shpenzimet publike të shenjëstruara për personat e prekur nga tërmeti dhe pandemia COVID-19;

- Digjitalizimi në arsim dhe zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencave digjitale;

- Të mësoarit e gjuhës angleze që nga klasa e parë e arsimit bazë;

- Edukimi për zejet dhe artet në arsimin para universitar;

- Shtimi i klasave të profilizuara sportive;



- Përmirësimi i shërbimit për nxënësit me aftësi ndryshe, kthimi i shkollave speciale në qendra burimore;

- Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë për hapjen e filialeve të universiteteve të huaja si dhe për programet e studimit të përbashkëta dhe të dyfishta me to, si edhe mbështetjen për hapjen e programeve në gjuhën angleze;

- Investime infrastrukturore si në kampuse dhe investimet në laboratorë për kërkimin shkencor dhe sigurim të integritet akademik dhe shkencor të universiteteve me qëllim përmirësimin e cilësisë së produktit universitar;

Rinia

- Të miratojë Strategjinë Kombëtare për Rininë 2022 – 2029

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 22.9.2021, “Rinia” tashmë është fushë e përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, për pasojë dhe puna për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë ka kaluar në këtë ministri. Duke marrë parasysh kalimin e kompetencave nga MAS tek Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka pasur disa ndryshime dhe vonesa në procesin e hartimit të strategjisë.

Ministria Znj. Bora Muzhaqi, po realizon një sërë konsultimesh në të gjithë vendin, për të identifikuar prioritetet e strategjisë së rinisë. Këto takime do të zhvillohen me gjimnazistët në të gjithë qytetet e Shqipërisë gjatë periudhës tetor – dhjetor 2021, për të përfshirë të rinjtë në hartimin e kësaj strategjie. Gjithashtu do të zhvillohen edhe takime në universitete për konsultime me studentët, takime me organizatat rinore, institucionet qendrore dhe lokale, grupet jo formale të rinjve, dhe ekspertë në fushën e rinisë.

Parashikohet që “Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029”, të miratohet në tremujorin e tretë, të vitit 2022.

Kultura

Prioriteti kryesor në fushën e artit dhe kulturës mbetet intensifikimi i përpjekjeve për zbatimin dhe realizimin e objektivave të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare të Kulturës 2019 – 2025”, e cila është miratuar me VKM Nr. 903, Datë 24.12.2019 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kulturën, 2019 – 2025” dhe Plani i saj i Veprimit.

Në këtë Dokumenti strategjik, janë marrë në konsideratë dhe eksperiencat më të mira të mëparshme në këtë fushë me qëllim:

- zbatimin e platformës së edukimit përmes artit dhe kulturës në institucionet e artit dhe kulturës, trashëgimisë kulturore dhe në sistemin para universitar;

- fuqizimin e Partneritetit Publik-Privat (PPP) të institucioneve të trashëgimisë kulturore sipas modelit të paraparë në aktet ligjore për trashëgiminë kulturore;

- ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale në nivel qendror, vendor dhe të pavarur;

- përmirësimin e legjislacionit për mbështetjen e zhvillimit të industrisë kreative si forcë e pa shfrytëzuar sa dhe si duhet deri më tani;

- rritjen e buxhetit dhe mbështetjes financiare për artin dhe kulturën;

- forcimi i bashkëveprimit të Ministrisë së Kulturës me komunitetin artistik.

Përparësitë strategjike të Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019 – 2025, në përputhje dhe me programin e qeverisë shqiptare, si dhe me planifikimin buxhetor afatmesëm janë:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i tregut kulturor nëpërmjet një legjislacioni në dobi të krijuesve, krijimtarisë artistike e kulturore dhe trashëgimisë kulturore, si dhe hartimi i paketës së re të skemës së mbështetjes së projekteve të Ministrisë të Kulturës;

- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale – pasuri kombëtare e popullit shqiptar në breza;

- Mbështetja e krijimtarisë dhe aktivitetit krijues të artistëve shqiptarë përmes rritjes së aktiviteteve kulturore dhe përfshirjes së artistëve;

- Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare;

- Zbatimi me sukses i Platformës kombëtare “Edukimi përmes artit” nga të gjitha institucionet e Artit dhe Trashëgimisë dhe në sistemin para universitar;

- Forcimi i partneritetit publik dhe privat për realizimin e projekteve rijetëzuese në qendrat e trashëgimisë kulturore kombëtare.



KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.27.1 Përmbajtja e kapitullit

Politikat e BE-së për mjedisin synojnë që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të mbrojnë mjedisin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen në veprimet parandaluese, parimin “ndotësi paguan”, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim, ndarjen e përgjegjësisë dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të Bashkimit Evropian. Legjislacioni mjedisor i BE-së përfshin mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet dhe organizmat e modifikuar gjenetikisht (OMGJ), zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme. Për aplikimin dhe zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal.

4.27.2 Struktura e kapitullit

- Legjislacioni horizontal;
- Cilësia e ajrit;
- Menaxhimi i mbetjeve;
- Cilësia e Ujit;
- Mbrojtja e natyrës;
- Ndotja industriale dhe menaxhimi i rrezikut
- Kimikatet;
- Mbrojtja nga zhurmat;
- Mbrojtja Civile
- Ndryshimet Klimatike

4.27.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Sipas nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, Shqipëria ka detyrimin të përafrojë legjislacionin e saj kombëtar me atë të BE-së.

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-së buron nga neni 108 i MSA-së, në të cilin citohet si më poshtë:

- Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit të mjedisit, me qëllim të promovimit të qëndrueshmërisë së mjedisit;

- Bashkëpunimi është përqëndruar kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të Komunitetit në fushën e mjedisit.

Në lidhje me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian, politikat e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë pjesë e grupit të dytë të kompetencave të Bashkimit Evropian. Neni 4 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton se në këtë rast, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare kanë të drejtë të miratojnë akte ligjore. Shtetet anëtare mund të ushtrojnë kompetencat e tyre në rast se Bashkimi Evropian nuk i shtron kompetencat e tij ose ka vendosur që të mos i ushtrojë këto kompetenca.

Politikat e Bashkimit Evropian për mjedisin dhe ndryshimet klimatike synojnë të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, kalimin drejt një ekonomie me përdorim eficient të resurseve, emetime të ulëta dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat ekzistuese dhe të ata të ardhshëm. Parimet kryesore të *acquis* të përfshira në këtë kapitull janë: veprimi parandalues, parimi se ndotësi paguan, lufta kundër dëmtimit të mjedisit në burim, përgjegjësia e përbashkët dhe integrimi konsideratave mjedisore, klimatike dhe mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore në politikat e tjera të Bashkimit Evropian. *Acquis* e Bashkimit Evropian në këtë kapitull përmban mbi 200 akte ligjore që rregullojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjeve industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, zhurmat, mbrojtjen civile dhe ndryshimet klimatike.

Respektimi i *acquis* së përfshirë në këtë kapitull kërkon investime të konsiderueshme dhe bashkëpunim të strukturuar ndërmjet të gjithë grupeve të interesit, duke përfshirë autoritetet vendore, industrinë dhe shoqërinë civile. Për më tepër, për aplikimin dhe zbatimin e *acquis* është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal.

4.27.4 Situata aktuale në shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitje në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar procesin e vlerësimit të ndikimit në



mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatat, pyjet.

Në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me *acquis* – legjislacionin evropian, është shënuar progres në fusha të tilla si: menaxhimi i mbetjeve dhe ujit, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Përpjekje të mëtejshme janë ende të nevojshme për forcimin dhe zbatimin e legjislacionit, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, cilësisë së ujit dhe ajrit, si dhe ndryshimet klimatike.

Legjislacioni horizontal

Në lidhje me **çështjet horizontale**, Shqipëria duhet të shtojë përpjekjet për të arritur një harmonizim dhe zbatim të plotë në shumicën e fushave, veçanërisht sa i përket zbatimit të Direktivave të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor, në sektorët e energjisë dhe minierave.

Pjesëmarrja dhe konsultimi me publikun në vendimmarrje, duhet të përmirësohet, veçanërisht në nivelin lokal.

Në korrik 2019, Shqipëria miratoi Ligjin që ndryshon Kodin Penal, duke transpozuar plotësisht Direktivën për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal. Sidoqoftë, zbatimi mbetet një sfidë.

Është përparuar lidhur me zbatimin e mëtejshëm të Direktivës INSPIRE. Nevojitet progres i mëtejshëm për të arritur një harmonizim të plotë me direktivën për përgjegjësinë mjedisore. Shqipëria ka përafruar pjesërisht Direktivën për krijimin e një infrastrukture për informacionin hapësinor (INSPIRE).

Cilësia e ajrit

Zbatimi i masave të planifikuara në Planin kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit miratuar në qershor 2019, shoqërohet me mbështetje financiare dhe forcimin e kapaciteteve teknike.

Aktualisht, pajisjet e monitorimit të ajrit kanë hasur sfida për shkak të nevojës për kalibrim dhe mirëmbajtje. Mbetet për t'u rishikuar buxheti i dedikuar për kalibrimin e tyre.

Përmbushja e detyrimeve nga Konventa e UNECE, mbi Ndotjen e Ajrit në Distançë të Largët Ndërkufitare CLRTAP, kërkon rritjen e kapaciteteve teknike dhe zbatimin e projekteve mbështetëse afatgjata. Njësitë e Vetëqeverisjes

lokale, kanë kapacitete teknike dhe burime të limituara financiare, dhe si rrjedhojë nuk kanë përgatitur planin lokal të cilësisë së ajrit sikurse kërkohen nga legjislacioni kombëtar në këtë fushë. Përafrimi i Direktivës 2016/2284 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 14 Dhjetor 2016 mbi pakësimin e shkarkimeve kombëtare të disa ndotësve atmosferikë, që amendon Direktivën 2003/35/KE dhe që shfuqizon Direktivën 2001/81/EC, CELEX:32016L2284, ka avancuar me miratimin e në shkurt 2020, të VKM-së Nr. 162, datë 19.02.2020 “Për rregullat për përgatitjen, miratimin, rivlerësimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për uljen e emetimeve në ajër”. Zbatimi i legjislacionit duhet të shoqërohet me forcimin e kapaciteteve teknike mbi përcaktimin e tavaneve kombëtare të shkarkimeve në ajër, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, grupeve të interesit, institucioneve publike etj.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar marrjen e masave për adresimin dhe forcimin e kapaciteteve teknike në vend për të siguruar zbatimin e VKM Nr. 162, datë 19.02.2020 “Për rregullat për përgatitjen, miratimin, rivlerësimin dhe zbatimin e programeve kombëtare për uljen e emetimeve në ajër”.

Është miratuar Udhëzimi i përbashkët i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Nr. 6529/2, datë 6.10.2020 “Për mbledhjen, ruajtjen, marrjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e benzinës, dieselit, gazit të lëngët të naftës (gln), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda, lëndëve djegëse të lëngëta detare dhe furnizuesit e këtyre lëndëve djegëse të lëngëta”, i cili transpozoi pjesërisht Vendimin Zbatues të Komisionit (EU) 2015/253 të datës 16 Shkurt 2015 mbi përcaktimin e rregullave për marrjen e mostrës dhe raportimit në kuadër të Direktivës së Këshillit 1999/32/EC lidhur me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse detare dhe Vendimin e Komisionit 2002/159/KE, 18 Shkurt 2002, për një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të dhënave kombëtare mbi cilësinë e lëndëve djegëse.

Menaxhimi i Mbetjeve

Kuadri ligjor është përafruar 53.5%. Strategjia e re kombëtare 2020 – 2035 për menaxhimin e integruar të mbetjeve është miratuar më 27 maj



2020. Ajo synon përfshirjen e parimeve të ekonomisë qarkulluese në sistemin kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.

Gjithashtu është miratuar, Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta“, me Vendimin Nr.1 datë 13.01 2020 nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Në bazë të këtyre dokumenteve, Shqipëria është ndarë në 10 zona mbetjesh. Për secilën zonë do të ndërtohet nga një impiant rajonal për trajtimin e integruar të mbetjeve. Deri tani janë ndërtuar dhe funksionojnë impiantet rajonale (landfilli Bushat, Bajkaj, Maliq, Sharrë, Impianti i trajtimit të mbetjeve të Elbasanit dhe Fierit). Është në proces ndërtimi edhe i landfillëve të Sherishtës, Vlorës dhe Impjanti i trajtimit të mbetjeve Tiranë. Parashikohet që brenda vitit 2030 të ndërtohen landfille për të gjitha zonat e tjera të mbetjeve, Berat, Kukës dhe Dibër.

Në zbatim të VKM Nr. 428 datë 8.06.2016 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, për hartën dixhitale të deponive të mbetjeve urbane", po hartohet harta GIS, e krijuar me informacione që pasqyrojnë situatën aktuale të mbetjeve urbane, deponitë, si dhe zhvillime të tjera në terren.

Është miratuar VKM Nr.402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", e cila transpozon direktivën e katalogut evropian të mbetjeve.

Janë kryer fushata ndërgjegjësimi për reduktimin deri në heqjen nga përdorimi të qeseve të holla plastike me qëllim përdorimin e qeseve prej rrobe. Janë marrë masa për zvogëlimin e qeseve plastike, si dhe plastikës përmes vendosjes së kriterëve të miratuara me Vendimin Nr. 232, datë 26.4.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 177, datë 6.03.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre".

Pas një analize të detajuar të mangësive, sfidave ose progresit në fushën e menaxhimit të mbetjeve, në fund të shtatorit 2020, u përgatit një plan veprimi në fushën e menaxhimit të mbetjeve me mbështetjen e projektit SANE 27. Plani është përgatitur për të gjitha Direktivat dhe Rregulloret e BE-së për nënkapitullin e mbetjeve. Përmbajtja e tij ofron një përshkrim të hollësishëm të situatës aktuale, transpozimin dhe zbatimin e detyrave që do të kryhen në periudhën afatshkurtër (2021 – 2023) dhe afatmesme (2024 – 2027) si dhe një vlerësim të burimeve financiare dhe njerëzore për të kryer këto detyra. Ky plan përcakton rolet dhe

përgjegjësitë e institucioneve të përfshira si dhe afatet për zbatimin e direktivave të përgatitura. Bazuar në identifikimin e vend-depozitimeve në të gjithë vendin, ka filluar rehabilitimi dhe mbyllja e tyre.

Rehabilitimi i tyre ka filluar në bashkitë e Beratit, Ura Vajgurore dhe Kuçova, me mbështetjen e projektit zviceran SECO. Mbyllja e vend-depozitimit në Porto Romano dhe kthimi i tij në një ekopark financohet nga buxheti i shtetit. Një seri trajnimesh janë kryer për të zbatuar plotësisht VKM 319/2018 në lidhje me llogaritjen e kostove dhe tarifave të kërkuara për menaxhimin e mbetjeve në një Njësi të Qeverisjes Vendore. Fillimisht trajnimet u zhvilluan me praninë e përfaqësuesve të komunave dhe më pas për shkak të fillimit të situatës pandemike, trajnimet u zhvilluan në internet përmes platformave të ndryshme: skype, webex, zoom.

Me asistencë të programit të financuar nga qeveria suedeze, "Mbështetje për Përgatitjen e Shqipërisë për Negociatat për anëtarësim në BE", SANE27, nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA), ka filluar përgatitja e një drafti për të vendosur sistemin e Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesit.

Duke mbajtur në konsideratë përgatitjet e Shqipërisë për negociatat me BE, është thelbësore jo vetëm transpozimi i direktivave/rregulloreve të BE, por edhe zhvillimi i praktikave më të mira për zbatimin e sistemit të Përgjegjësisë të Zgjeruara të Prodhuesit.

Në këtë kuadër është përgatitur drafti për të ndaluar prodhimin, importin, përdorimin e çdo lloji qese plastike në vend, i cili u miratua me VKM Nr. 227, datë 12.03.2020 "Për propozimin e projektligjit" Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve, i ndryshuar".

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, projektligji kalon në Parlament dhe diskutohet në komisionet parlamentare, për të marrë formë ligjore.

Objektivat specifike të Dokumentit të Politikave Strategjike synojnë të japin zgjidhje praktike për:

1. Adresimin e problematikave në sistemin e deritanishëm të menaxhimit,
2. Zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe,
3. Përgatitjet e nevojshme për të përmbushur detyrimet nga ndryshimet në Direktivat e BE-së,



përfshirë edhe objektivat e synuar në kuadër të Ekonomisë Qarkulluese.

Arritja e këtyre objektivave, përmirëson cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve, duke dhënë gjithashtu kontribut në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, si dhe hapjen e rrugës drejt integritetit evropian.

Në zbatim të VKM Nr. 538, datë 22.9.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 687, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”, kanë nisur të behen trajnime me përfaqësues të pushtetit vendor.

Cilësia e ujit

Në fushën e cilësisë së ujit, strategjia sektoriale për furnizimin me ujë dhe kanalizimeve 2020-2030 është në proces hartimi. Kjo do të integrojë një mekanizëm të qartë dhe operacional për qëndrueshmërinë financiare të sektorit.

Gjatë vitit 2021 është përgatitur një paketë ligjore nëpërmjet mbështetjes së projektit EUSIWM, financuar nga BE dhe ADA, e cila synon transpozimin e plotë të 9 Direktivave. Në këtë kuadër, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për finalizimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.24 datë 9.02.2021, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”. Ky grup ka filluar punën në prill të vitit 2021 dhe do të vijojë edhe gjatë vitit 2022, deri në finalizimin e të gjithë paketës ligjore.

Gjithashtu me asistencë të projektit EUSIWM (gjatë vitit 2021), ka filluar hartimi i Planeve të Menaxhimit për Basenet Ujore Ishëm, Erzen dhe Mat. Në këtë kuadër, përmes Urdhrit të Kryeministrit Nr. 32, datë 1.03.2021 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për hartimin e planeve të menaxhimit të Baseneve Ujore, Ishëm, Erzen dhe Mat”, janë ngritur grupe ndërinstitucionale pune, me synim finalizimin e planeve të Menaxhimit në basenet e cituara më lart.

Në qershor 2021, Këshilli Kombëtar i Ujit miratoi me Vendimin Nr. 1 datë 15.06.2021, Raportet e Vlerësimit Paraprak të Rreziqeve nga Përmbytjet për Basenet Ujore Drin – Bunë, Mat, Ishëm Erzen, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe shpalljen e zonave ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa që të ndodhin

përmbytje. Në vijim, me urdhrin e Kryeministrit Nr. 75, datë 10.09.2021, është ngritur Grupi ndërinstitucional i punës për hartimin e projektplanit të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet për zonat ku ekziston rreziku potencial nga përmbytjet ose ka gjasa të ndodhin përmbytje, Drin – Bunë 4, 5 dhe 6.

Rrjeti i monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujit dhe sistemi i licencimit duhet të përmirësohen më tej dhe të harmonizohen me kërkesat e *acquis*.

Niveli i përafrimit të legjislacionit të BE-së me atë kombëtar për fushën e menaxhimit të ujrave për disa direktiva të rëndësishme, mbetet i pjesshëm. Miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1015, datë 16.12.2020, e ka rritur nivelin e përafrimit, pasi përmes tij janë përafruar pjesërisht 4 Direktiva, specifikisht Direktiva 2000/60/EC, Direktiva 2009/90/EC, Direktiva 2006/118/EC dhe Direktiva 2007/60/EC.

Është shënuar progres lidhur me nënshkrimin e kontratave të performancës me shërbimet komunale, rregullimin e lidhjeve të paligjshme, skemat e rishikuara të subvencioneve dhe miratimin e një skeme të certifikimit të stafit. Gjatë vitit 2022 pritet të kryhet një analizë e detajuar e kapaciteteve administrative në të gjitha ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizime, si dhe një proces për rekrutimin e stafëve menaxheriale, teknike dhe operuese, me mbështetjen e donatorëve.

PMBU (Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor) Seman u miratua me VKM-në Nr. 453, datë 10.06.2020 “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Seman”. Gjithashtu, PMBU Drin – Bunë, u miratua me VKM Nr. 849, datë 4.11.2020 “Për miratimin e planit të menaxhimit të basenit ujor Drin – Bunë”. Mbi këto plane është bazuar puna në vijimësi për menaxhimin e baseneve ujore.

Mbrojtja e natyrës

Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, kryesisht referuar Direktivave për Habitatet dhe Shpendëve, është në nivel të avancuar. Në zbatim të protokollit të Nagojës për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i tyre, u miratua Ligji Nr. 41/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9875, of 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar, i cili përafron pjesërisht Rregulloren (BE) Nr. 511/2014, datë 16.4.2014 “Mbi masat e



pajtueshmërisë për përdoruesit nga Protokollin e Nagojës mbi aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që realizohen nga përdorimi i tyre në Union”. Është në proces plotësimi i këtij ligji me akte nënligjore, për të realizuar zbatueshmërinë e tij në praktikë.

Gjatë vitit 2022 do të fillojë rishikimi dhe përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, për periudhën deri në 2030, në linjë me kontekstin global Post 2020 për biodiversitetin, të Konventës së biodiversitetit.

Janë miratuar dy VKM, konkretisht:

- VKM Nr. 1156, datë 24.12.2020 “Për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masat dhe kriteret e përdorimit të tyre, si dhe

- VKM Nr. 19, datë 20.01.2021 “Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij”.

Është përgatitur draft marrëveshja midis qeverisë suedeze dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për projektin ‘Ngritja e rrjetit Natura 2000’. Draft-marrëveshja është ende në fazë konsultimi.

Zbatimi i këtij projekti do të sigurojë transpozimin e plotë të Direktivës së Habitave dhe Shpendëve, njëkohësisht do të plotësohet kuadri ligjor i nevojshëm për përputhshmërinë e plotë me këto direktiva. Gjithashtu do të fuqizohen kapacitetet institucionale, lidhur me monitorimin dhe zbatimin, si dhe do të përgatitet një plan institucional zhvillimi, duke marrë në konsideratë një plan gradual për rritjen e kompetencave dhe numrit të stafit si dhe planifikimin e buxhetit dhe shpenzimeve.

Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal për zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor të përditësuar dhe për procesin e ngritjes së rrjetit Natura 2000 në vend, është prioritet i fushës së mbrojtjes së natyrës, si detyrimi kryesor në kuadrin e procesit të integritetit evropian të vendit.

Në kuadër të miratimit të strukturës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, Nr. 26 datë 3.02.2020 është rritur numri i punonjësve të ngarkuar për të bërë monitorimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në tetor 2021 ka përfunduar regjistrimi i fondit pyjor dhe kullosor kombëtar në sistemin kadastral të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet Krijimit të Inventarit Kombëtar të Pyjeve. Ky inventar do të mundësojë akses më të mirë të informacionit nga ana e qytetarëve dhe do të mundësojë transaksionet ligjore me pronat pyjore për bashkitë;

Gjithashtu në korrik 2020 është themeluar Agjencia Kombëtare e Pyjeve, e cila ka si mision qeverisjen e mirë të pyjeve, ruajtjen dhe zhvillimin e tyre, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore shumëfunktionale, si burime natyrore me rëndësi kombëtare, që të realizohet:

- Sigurimi i performancës në sektorin e pyjeve;

- Vlerësimi i gjetjes së pyjeve;

- Të organizojë punën për inventarizimin dhe hulumtim në fushën e pyjeve;

- Organizimi i punës dhe hartimi i dokumentave për menaxhimin e pyjeve;

- Organizimi i punës për monitorimin e pyjeve

Ndodja industriale dhe menaxhimi i rrezikut

Lidhur me ndodjen industriale dhe menaxhimin e rrezikut, përafrimi me legjislacionin e BE-së mbetet sfida.

Transpozimi i Direktivës së Emetimeve Industriale mendohet të jetë rreth 70%, nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të transpozojë pjesërisht në disa nene Direktivën 2010/75 / BE deri në fund të vitit 2022 duke miratuar Projektligjin ekzistues “Për Lejet Mjedisore” të përgatitur me çdo ndryshim të mundshëm.

Kimikatat

Referuar fushës së *kimikateve*, janë ndërmarrë disa hapa pozitivë në kuadër të harmonizimit me Rregulloren e BE-së për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH) dhe me instrumente të tjerë. Në shkurt të vitit 2020 Shqipëria ratifikoi Konventën Minamata për merkurin. Në prill 2021 u miratua VKM Nr. 222/2021, “Mbi miratimin e listës së substancave kandidate”, e cila ka sjellë në legjislacionin shqiptar 211 substanca dhe grup substancash të vlerësuara në aspektin e sigurisë kimike, në zbatim të legjislacionit të Bashkimit Evropian për kimikatat (REACH dhe CLP).



Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 23, datë 03.02.2020, "Për miratimin e strukturës dhe organizimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", ne korrik 2020, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është ngritur Zyra e Kimikateve, si një detyrim ligjor dhe organ kryesor për zbatimin e legjislacionit të kimikateve dhe menaxhimin e tyre në Shqipëri.

Për ti ardhur në ndihmë ngritjes së një helpdesku kombëtar mbi kimikatet, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit është krijuar dhe funksionon adresa e e-mail info.kimikatet@akm.gov.al.

Për të siguruar bashkëpunimin dhe koordinimin midis institucioneve përgjegjëse në zbatim të ligjit 27/2016, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit prej datës 17 mars 2021, ka ngritur grupin ndërinstitucional të punës mbi kimikatet, të përbërë nga 21 institucione të ndryshme që angazhohen sipas legjislacioneve të tyre sektoriale.

Sidoqoftë, legjislacioni i miratuar dhe strukturat e ngritura administrative duhet të forcojnë kapacitetet e tyre teknike në këtë fushë.

Gjithashtu janë ndërmarë disa hapa pozitive lidhur me transpozimin në legjislacionin kombëtar të Rregullores REACH Nr.1907/2006, i cili ka avancuar më tej me miratimin e:

1. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 319, datë 15.05.2019 "Për prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e disa kimikateve dhe artikujve të caktuar të rrezikshëm";

2. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.9, datë 09.01.2019 "Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatis, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë";

Në vijim të miratimit nga Parlamenti Shqiptar të Ligjit Nr. 7/2020 "Për ratifikimin e Konventës së Minamatës "Për merkurin", prej datës 26 Maj 2020, Shqipëria listohet përkrah shteteve që kanë ratifikuar Konventën e Minamatës për Merkurin, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet negative të merkurit. Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 442, datë 26.06.2019 "Për miratimin e rregullave të ndalimit të eksportit të merkurit metalik, komponimeve dhe përzierjeve të caktuara të merkurit, ruajtjes së sigurt të merkurit metalik dhe të kriterëve specifike të ruajtjes së merkurit

metalik të konsideruar si mbetje", i cili ka transpozuar pjesërisht Rregulloren (EU) 2017/852 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 17 maj 2017 mbi merkurin, që shfuqizon Rregulloren (EC) nr. 1102/2008, CELEX: 32017R0852. VKM 442/2019, ka hyrë në fuqi prej datës 1 Janar 2020, dhe synon zbatimin e Konventës së Minamatës për Merkurin.

Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 161, datë 19.02.2020, "Për miratimin e rregullave të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti", i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën e Këshillit 87/217/EEC datë 19 mars 1987, Për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti e amenduar.

Mbrojtja nga zhurmat

Lidhur me nënfushën e mbrojtjes nga zhurmat prioritet mbetet krijimi i hartës së zhurmave, i cili kërkon angazhim serioz dhe aktiv të të gjitha bashkive të vendit.

Autoritetet përkatëse janë duke identifikuar zonat në vend, për të hartuar një hartë digjitale të zhurmave.

Mbrojtja Civile

Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është miratuar nga Kryeministri me Urdhrin Nr. 27, datë 3.02.2020, gjithashtu ligji Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i cili shndërron Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, krijon kushtet për anëtarësimin e Shqipërisë në të ardhmen në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Unionit.

Aktualisht po punohet për hartimin dhe miratimin e akteve të reja nënligjore në zbatim të ligjit.

Agjencia është në procese të ndryshme bashkëpunuese me partnerët dhe strukturat homologe, si dhe në procedura zbatuese të projekteve të ndryshme të financuara nga organizata ndërkombëtare. Këto nisma po ndihmojnë në funksionimin e agjencisë, ngritjen e kapaciteteve, infrastrukturave dhe sistemeve, si dhe për anëtarësimin në të ardhmen në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane (UCPM).

Me mbështetjen e UNDP pritjet të fillojë puna sa më shpejt për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.



Ndryshimet Klimatike

Referuar fushës së *Ndryshimeve Klimatike*, përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* mbetet ende i kufizuar. Në korrik 2019, u miratua Strategjia Kombëtare për Ndryshimet Klimatike për periudhën 2019 – 2030, me objektiva afatgjata. Strategjia fokusohet tek energjia, transporti, bujqësia, përdorimin e tokës dhe pyjeve dhe përmban planin si pjesë të integruar të saj 2 plane veprime, konkretisht Planin për Mitigimin dhe Adpatimin nga Ndryshimeve Klimatike.

Në tetor 2021, Këshilli i Ministrave miratoi me VKM Nr. 581 datë 06.10.2021 Kontributin Kombëtar të Përcaktuar 2021 – 2030 nëpërmjet të cilit parashikohen masat për uljen e emetimeve të Gazeve me Efekt Serrë me 20.9%. Shqipëria gjithashtu ka treguar angazhim të vazhdueshëm edhe për të rritur rezervuarët e GES përmes politikave ambicioze të mbjelljes së pyjeve.

Në dhjetor 2020 Shqipëria miratoi Ligjin 155/2020 “për ndryshimet klimatike” i cili krijon bazën ligjore për fushën e ndryshimeve klimatike dhe përafron pjesërisht legjislacionin Evropian.

Sa i përket raportimit të saj në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, Shqipëria ka dorëzuar në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike Raportin Bienal të Përditësuar në tetor 2021 dhe është duke përgatitur Komunikimin e Katërt Kombëtar i cili pritet të përfundojë deri në vitin 2022.

Si një Palë jo e Aneksit I të UNFCCC (që nga viti 1995), deri më tani Shqipëria ka përgatitur tre Komunikime Kombëtare (përkatesisht në 2002, 2009 dhe 2016) dhe aktualisht po përgatit Komunikimin e Katërt Kombëtar i cili pritet të përfundojë brenda vitit 2022.

Qeveria shqiptare ka shprehur një vullnet dhe angazhim të qartë politik për të përmbushur kërkesat dhe detyrimet e ngulitura në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe protokollet dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa shumë të rëndësishëm drejt dokumenteve të politikave dhe planeve të veprimit për ndryshimet klimatike, duke përfshirë veçanërisht sektorët e energjisë dhe transportit, por edhe bujqësinë, pyjet, menaxhimin e mbetjeve.

Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 3.07.2019 "Për miratimin e dokumentit strategjik dhe planeve kombëtare për zbutjen e gazrave serë dhe për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike", duke përfaqësuar një strategji të përgjithshme ndërsektoriale me objektiva politikë dhe veprime konkrete lidhur me;

- uljen e emetimeve të GES;
- fleksibilitetin ndaj ndryshimeve klimatike.

Me miratimin e këtij akti ligjor, Qeveria e Shqipërisë u bë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor me një Strategji të miratuar lidhur me Ndryshimet Klimatike dhe Planet e Veprimit për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike.

Nga ana tjetër, miratimi i Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2018 – 2030 (korrik 2018) si dokumenti kryesor i politikës së energjisë që përfshin ndryshimet klimatike bazohet në dy shtylla kryesore: (i) zhvillimi i reformave për të nxitur liberalizimin e tregut dhe integrimin rajonal, dhe (ii) investime të mëdha në zhvillimin e qëndrueshëm të nxitur nga pjesëmarrja në iniciativën e Komunitetit të Energjisë dhe në veçanti në nivelin ndërkombëtar nga marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike.

Strategjia parashikon përgatitjen e Planit Kombëtar të Integruar të Energjisë dhe Klimës, si një angazhim i Republikës së Shqipërisë në Takimin Ministror të Komunitetit të Energjisë, puna përgatitore e së cilës ka filluar të sigurojë objektivat kombëtare përtej vitit 2020 dhe në përputhje me Axhenden e BE-së e vitit 2030:

Shqipëria ka filluar punën e nevojshme përgatitore për politikën, aspektet analitike dhe teknike të planeve.

Parlamenti shqiptar miratoi Ligjin Nr. 116/2020 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Dohas të Protokollit të Kiotos të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike. Shqipëria renditet së bashku me vendet që kanë ratifikuar amendamentin e Doha që përcakton periudhën e dytë të angazhimit të Protokollit të Kiotos 2013 – 2020, ka marrë numrin e duhur të ratifikimeve për të hyrë në fuqi. Amendamenti synon zvogëlimin e emetimeve të gazeve serrë (GHG) me 18% krahasuar me nivelet e vitit 1990 për vendet pjesëmarrëse.



Shqipëria ka ratifikuar Amendmentin e Kigalit të Protokollit të Montrealit dhe synon të zvogëlojë përdorimin e hidrofluorokarbureve (HFCs), gazeve të fuqishme serre të përdorura kryesisht në ftohje, kondicionim të ajrit dhe pajisjet e pompave të nxehtësisë, të cilat janë mijëra herë më të dëmshme për klimën sesa CO₂. Amendmenti i Kigalit, i cili hyri në fuqi në janar 2019, ndryshon Protokollin e Montrealit për Substancat që hollojnë Shtresën e Ozonit për të përfshirë substanca – përfshirë hidrofluorokarburet (HFC) - të cilat nuk dëmtojnë shtresën e ozonit, por dihet se kanë potencial të lartë të ngrohjes globale. Ratifikimi i Kigalit nga Republika e Shqipërisë tregon se vendi është i angazhuar në mënyrë proaktive për të adresuar problemet në të ardhmen duke parandaluar një rritje të përdorimit të HFC dhe duke promovuar përdorimin e alternativave miqësore me klimën.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Amendamenti i Kigalit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke hartuar projektligjin “për gazet serrë të fluorinuara” i cili parashikohet të miratohet në dhjetor 2021.

Ndryshe nga NDC-ja 2015 – 2030, e cila parashikonte masa lidhur me vetëm dy sektorë, atë të energjisë dhe industrisë, NDC-ja 2020 – 2030 e ka rritur numrin e sektorëve në 5. Konkretisht:

- Sektori i energjisë dhe transportit;
- Sektori i pyjeve dhe përdorimit të tokës;
- Sektori i bujqësisë;
- Sektori i industrisë, si dhe
- Sektori i mbetjeve.

4.27.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 94, datë 20.05.2019 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, institucioni lider për Kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Ministrinë e linjës dhe agjencitë e pavarura, pjesë e këtij kapitulli janë si më poshtë;

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM);
- Agjencia Kombëtare Mjedisit (AKM);
- Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP);
- Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT);
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);

- Instituti i Shëndetit Publik (ISHP);
- Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU);
- Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM);
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC);
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR);
- Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural (AZHBR);
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ);
- Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE);
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE);
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG);
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT);
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);
- Instituti i Statistikave (INSTAT);
- Ministria e Drejtësisë (MD);
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh);
- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)
- Shërbimi i Toksikologjisë Klinike në QSUT;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetsor (ISHSH);
- Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI);
- Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM);
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU);
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV)

4.27.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Legjislacioni horizontal

Për sa i përket mjedisit, në fushën e *legjislacionit horizontal*, disa nga prioritetet kryesore kanë të bëjnë me:

- zbatimin e legjislacionit kombëtar që ka transpozuar Direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001 “Mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis” dhe



Direktivën e VNM-së (2011/92/BE) “Mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis”, amenduar me Direktivën 2014/52/BE, si dhe transpozimi i plotë i Direktivës 2014/52/BE;

- ngritjen e një grupi pune ndërinstitucional në gjysmën e dytë të vitit 2023 për të vlerësuar nenet e mbetura të Direktivës 2001/42/KE që duhet të transpozohen, pasi sikurse citohet në Progres Raport, sfida më e madhe lidhur me këtë direktivë mbetet implementimi, ndërkohë që përafrimi është arritur;

- forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Nevojitet një pjesëmarrje më efektive e publikut për konsultime në procesin e vendimmarrjes, veçanërisht në nivelin lokal. Progres i mëtijshëm është i nevojshëm për të arritur plotësisht përafrimin dhe zbatimin e direktivave për përgjegjësinë mjedisore, krimin mjedisor dhe inspektimin mjedisor.

Është shumë e rëndësishme që Shqipëria të miratojë strategjinë kombëtare për ujësjellës kanalizimet 2019 – 2030 dhe aktet përkatëse të saj, planet e menaxhimit të baseneve ujore dhe të sigurojë kapacitetet dhe burimet e duhura administrative për agjencitë përgjegjëse.

Rol të rëndësishme duhet të luajë edhe pjesëmarrja e publikut sidomos në procedurat përkatëse, veçanërisht në sektorët e hidrocentraleve, ndërtimeve dhe minierave.

Nevojitet sigurimi i një buxheti të përshtatshëm, forcimi i kapaciteteve të monitorimit dhe raportimit të agjencisë së mjedisit.

Cilësia e ajrit

Prioritet në fushën e cilësisë së ajrit për vitin 2022 vazhdon të mbetet forcimi i bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse me qëllim zbatimin e planit kombëtar të cilësisë së ajrit si dhe:

- përmirësimi i rrjetit të monitorimit;
- sigurimi i burimeve për funksionimin e monitorimit të vazhdueshëm;
- rritja e kapaciteteve teknike në MTM dhe AKM lidhur me detyrimet që rrjedhin nga Konventa për Ndotjen e Ajrit në kontekst të largët Ndërkufitar (CLRTAP);
- zbatimin e VKM 162/2020;
- sigurimi i aksesit të publikut në internet në të dhënat e cilësisë së ajrit dhe;
- sigurimi i përgatitjes së planeve të cilësisë së ajrit për aglomeratet kryesore.

Menaxhimi i Mbetjeve

Mbyllja e venddepozitimeve të shumta jashtë standarteve, mbetet një sfidë. Ndarja në burim e rrymave të mbetjeve dhe instrumenteve ekonomike për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara. Një tjetër prioritet është dhe reduktimi deri në zhdukje e plastikës njëpërdorimshe. Procedura për ndalimin e prodhimit dhe përdorimit të qeseve plastike do të kryhet me amendimin e ligjit Nr.10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Në kuadër të përmbushjes së kërkesave për përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit, janë identifikuar mungesa nga kuadri ligjor kombëtar për të rregulluar sistemin e menaxhimit të mbetjeve lidhur me Përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesit.

Gjithashtu janë identifikuar mungesë fondesh për të ngritur sistemin e plotë të menaxhimit të mbetjeve (kosha, makina teknologjike, landfill-et sanitare) në të gjithë rajonin.

Cilësia e ujit

Implantet e trajtimit të ujërave të ndotura plotësojnë vetëm rreth 15% të popullsisë, duke sjellë shqetësime kryesore si mungesën e licencimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të ndotura, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme dhe ndikimit mjedisor të kufizuar për shkak të rrjeteve dhe lidhjeve në zhvillim e sipër.

Ka një nevojë urgjente për të siguruar harmonizimin e plotë me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane, shtrirjen e rrjeteve të kanalizimeve, licencimin dhe aplikimin e tarifave për të gjitha implantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndërtimin e atyre të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare dhe ato të vizituara nga turistët.

Rrjeti i monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ujit dhe sistemi i licensimit duhet të përmirësohen më tej dhe të harmonizohen me kërkesat e *acquis*. Rrjeti i monitorimit të ujit shtrihet në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe laguna. Nën-sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ka nevojë për përmirësime. Megjithatë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të forcuar kapacitetet, performancën dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve komunale. Hartimi i një ndërhyrjeje të re që synon përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve publike të ujit përmes zhvillimit dhe grumbullimit të shoqërive me synimin e krijimit të kompanive



rajonale është qasja e re e qeverisë shqiptare për rristurimin e thellë të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Për të konsoliduar progresin, nevojitet miratimi i projektligjit për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, si dhe Strategjisë Kombëtare 2020 – 2030.

Mbrojtja e natyrës

Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian (acqui), përsa i takon Direktivave të Shpendëve dhe të Habitaveve, si dhe zbatimi i kuadrit ligjor të përafruar.

Përditësimi dhe rishikimi i dokumentit të politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit deri në 2030. Kryerja e inventarëve të habitaveve dhe specieve si një mundësi për formulimin më të saktë të politikave në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, dhe specifikisht të zonave të mbrojtura, AKZM do të punojë për të garantuar:

- Forcimin e zbatimit të legjislacionit të zonave të mbrojtura dhe konkretisht, një nga prioritetet e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), për vitin 2022 – 2023, do të jetë rishikimi i Ligjit 81/2017 “ Për Zonat e mbrojtura”.

- Identifikimin, studimin dhe plotësimin e formave standarde të propozimit për çdo zonë potenciale Natura 2000, brenda rrjetit të zonave të mbrojtura;

- Menaxhimin e integruar të zonave të mbrojtura;

- Forcimi i kapaciteteve të njësive menaxhuese të zonave të mbrojtura, në nivel qendror dhe lokal.

Në kuadër të detyrimit për përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë Evropian “*acquis*”, gjatë proceseve të hartimit të PKIE, është identifikuar së legjislacioni kombëtar për fushën e mbrojtjes së faunës së egër mbetet i paplotë. Kjo nënkupton që mungon referenca ligjore për të bërë përafrimin e Rregullores 1007/2009 mbi produktet e Fokës, dhe direktiva e 1999/22/Zoo e cila është përafruar 50%.

Në fushën e *pyjeve*, sfidë dhe prioritet i MTM-së mbeten:

- Përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushë, si dhe hartimi i akteve nënligjore që dalin nga Ligji 57/2020, datë 30.4.2020, për Pyjet;

- Bashkerendimi dhe unifikimi i praktikave me të mira në fushën e pyjeve me njesitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe;

- Pyllëzimin e sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në fondin pyjor.

Ndodja industriale dhe menaxhimi i rrezikut

Përsa i përket fushës së ndodjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut një nga prioritetet kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me Direktivën 2010/75/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndodjes), si dhe me Direktivën 2012/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 4 korrik 2012 “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme”, ndryshimi dhe më pas shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 96/82/EC.

Kimikateve

Në fushën e *kimikateve*, prioritetet e MTM-së për vitin 2021 e në vijim, kanë të bëjnë me:

- Suportin për zbatimin e projektit “Mbështetje për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për Përmirësimin e Menaxhimit të Kimikateve” financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), dhe planin vjetor të punës së projektit;

- Mbështetjen teknike të Zyrës së Kimikateve, me qëllim mirëfunksionimin e saj dhe sigurimin e zbatimit të legjislacionit të kimikateve;

- Bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim përmbushjen e detyrimeve nga legjislacioni në fuqi në fushën e kimikateve dhe marrëveshjet ndërkombëtare në këtë fushë.

Mbrojtja nga Zhurmat

Përsa i përket *politikave për zhurmën në mjedis*, mbetet ende sfidë forcimi i kapaciteteve administrative dhe inspektuese, si dhe përgatitja e hartave të zhurmës dhe planeve të veprimit nga ana e Njësive të vetëqeverisjes vendore.

Mbrojtja Civile

Për sa i përket mbrojtjes civile prioritetet për vitin 2021 e në vazhdim janë:

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për mbrojtjen civile;

- Konsolidimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me plotësimin dhe funksionimin



e plotë me kapacitetet njerëzore, logjistike dhe infrastrukture;

- Zbatimi i detyrimeve të Ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Riskut ndaj Fatkeqësive, strategjive vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; Vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në të tre nivelet, në nivel qendror, qarku dhe vendor; Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, planit të emergjencave civile në nivel qarku dhe në nivel vendor;

- Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel kombëtar për implementimin e politikave të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të mbrojtjes civile, referuar Ligjit Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, dhe akteve të tjera nënligjore.

- Përmirësimi i kapaciteteve, infrastrukturës dhe sistemeve për paralajmërimin e hershëm, parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive.

- Anëtarësimi në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile Evropiane.

Tërmetet theksuan urgjencën e ndërtimit të sistemeve efikase të mbrojtjes civile dhe Zvogëlimit të Rrezikut nga Katastrofat (Disaster Risk Reduction DRR) dhe integrimin e DDR në sektorët kryesorë. Pandemia COVID-19 theksoi nevojën për të forcuar kuadrin ligjor dhe kapacitetet institucionale si dhe burimet njerëzore dhe financiare të autoriteteve të mbrojtjes civile gjithashtu në lidhje me urgjencat shëndetësore. Shqipëria inkurajohet të përshpejtojë përgatitjet për të qenë pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile Evropiane (UCPM).

Tërmetet dhe përmbajtjet mbeten një rrezik i madh për vendin. Shqipëria ka bërë pak progres në përafrimin me Direktivën e Përmbajtjeve dhe akoma duhet të rregullojë shërbimet e paralajmërimit të hershëm dhe hidrometrik-meteorologjik.

Kapaciteti administrativ, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërimin e hershëm, parandalimin, gatishmërinë dhe reagimin janë të papërshtatshme.

Në funksion të premtimeve që rezultuan nga Konferenca e Donatorëve pas tërmetit të organizuar nga Komisioni në Bruksel në 17 Shkurt 2020, Shqipëria duhet gjithashtu të vendoset urgjentisht një plan financimi dhe veprimi në zbatim të masave të Mbrojtjes Civile dhe të

strategjisë të rikuperimit të pas-tërmetit (Zvogëlimit të Rrezikut nga Katastrofat) DRR, e cilat përfshijnë gjithashtu veprime kryesore strukturore kombëtare.

Ndryshimet klimatike

Ratifikimi i Amandamentit të Kigalit, të Protokollit të Montrealit, i hap rrugën Shqipërisë për të vendosur bazën e saj për HFC-të, për të ngrirë sasinë e saj të konsumit dhe për të vendosur një plan për heqjen nga përdorimi të HFC-ve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit po harton projektligjin “Për Gazet e Fluorinuara” që do të transpozojë pjesërisht Rregulloren (BE) Nr. 517/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 16 Prillit 2014 mbi gazet me efekt serrë dhe shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 842/2006.

Përgatitja e Planëve Kombëtare për Klimën dhe Energjinë (NECP-ve) do t'i mundësojë vendit të planifikojë në një mënyrë të integruar, objektivat që ka në fushën e klimës me objektivat energjetikë, synimet, politikat dhe masat dhe përafrimin e politikave energjetike shqiptare me ato të BE-së. NECP, pas finalizimit do të zvogëlojnë barrën administrative, do të sigurojnë koherencë më të madhe dhe do të sigurojnë parashikueshmëri afatgjatë për investime.

Puna përgatitore për aspektet analitike dhe teknike të planeve tashmë ka filluar dhe NECP pritet të miratohet brenda vitit 2022. Një çështje tepër serioze dhe shqetësuese mbetet mungesa e strukturave specifike administrative. Prioritet për fushën e ndryshimeve klimatike për 2021-2023 mbetet përafrimi i ligjislacionit dhe hartimi i akteve nënligjore të parashikuara në legjislacionin vendas.

KAPITULLI 28: MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE SHËNDETIT

4.28.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 28 për pjesën e mbrojtjes së konsumatorit, mbulon mbrojtjen e interesit publik për çështje të sigurisë së produkteve dhe interesave ekonomike të konsumatorëve, për aspekte të lidhura me politikën, legjislacionin dhe zbatimin e tij, etj.

Pjesa e shëndetit, përfshin standardet për kontrollin e duhanit, gjakut, indeve, qelizave dhe organeve si dhe barnave për përdorim njerëzor dhe veterinar. Gjithashtu, këtu përfshihen pajisjet mjeksore, produktet kozmetike, shëndeti mendor, parandalimi i abuzimit me drogën, pabarazia shëndetësore, ushqyerja, reduktimi i dëmeve të



lidhura me alkoolin, shfaqja e kancerit, mjedise të shëndetshme duke përfshirë parandalimin e lëndimeve, promovimin e sigurisë, plakjen aktive dhe të shëndetshme si dhe veprimin evropian në fushën e sëmundjeve të rralla.

4.28.2 Struktura e kapitullit

Kapitulli 28 është i ndarë në dy nënkapituj:

- Mbrojtja e Konsumatorit;
- Mbrojtja e Shëndetit

4.28.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Angazhimet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe të dispozitave përkatëse të acquis së BE-së.

Detyrimi për të përafuar ligjin shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 i MSA-së dhe Kriteret e Kopenhagës.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit përmban gjithashtu një dispozitë të përshtatur që merret me mbrojtjen e konsumatorit. Neni 76 i MSA-së kërkon që Shqipëria të sigurojë një politikë të mbrojtjes aktive të konsumatorit; të harmonizojë legjislacionin dhe të sigurojë mbrojtje efikase ligjore të konsumatorëve.

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit përfshin masat rregullatore, rekomandimet për Shtetet Anëtare, koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të Shteteve Anëtare duke përfshirë mbështetjen financiare. Shtetet Anëtare duhet të transpozojnë acquis në legjislacionin kombëtar dhe të krijojnë struktura të përshtatshme administrative të cilat lejojnë mbikëqyrje efektive të tregut dhe zbatimin e acquis. Duhet të sigurohen gjithashtu mekanizma të përshtatshëm gjyqësor edhe jashtë gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe informimin dhe edukimin e konsumatorit dhe një rol për organizatat e konsumatorit.

Acquis për mbrojtjen e konsumatorit përbëhet nga legjislacioni për sigurinë e produkteve dhe Sistemin e Alarmit të Bashkimit Evropian (RAPEX), imitimet e rrezikshme, përgjegjësinë për produktet me defekte, bashkëpunimin ndërkufitar të zbatimit, dëmshpërblimin e konsumatorit, shitjen e mallrave të konsumit dhe garancitë përkatëse, kushtet e padrejta të kontratave, treguesit e çmimeve, të drejtat e konsumatorit, kredia konsumatore, praktikat e padrejta tregtare, etj.

Për sa i përket shëndetit publik, acquis përbëhet nga masat që lidhen me kontrollin e duhanit, kërcënimet serioze për shëndetin ndërkufitar, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, gjakun, indet, qelizat dhe organet, të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar, produktet medicinale dhe kozmetikë, pajisjet medicinale, etc..

Në lidhje me **gjakun**, acquis përbëhet nga masat që lidhen me forcimin e kapaciteteve për implementimin e legjislacionit EU përcaktimin dhe forcimin e kapaciteteve të autoriteteve kompetente pavarura për autorizimin, licencimin, akreditimin, inspektimin, vigjilencën dhe raportimin.

4.28.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Nuk ka pasur përparim në rekomandimet e vitit të kaluar (2021), megjithëse pati njëfarë përparimi në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve.

Sa i përket situatës aktuale në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, Strategjia Ndërsektoriale “Për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut -2020” përfundoi zbatimin e saj. Lidhur me procesin e zbatimit të strategjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëpunim dhe me kontributin e institucioneve pjesëmarrëse të strategjisë (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; dhe institucione të tjera shtetërore si Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut; institucionet e infrastrukturës së cilësisë si Drejtoritë e Përgjithshme të Standardizimit, Akreditimit dhe Metrologjisë; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për Ushqimin; Autoriteti Kombëtar i Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, etj.) përgatiti një raport monitorimi. Raporti u fokusua në realizimin e masave dhe aktiviteteve për secilin objektiv të strategjisë, kryesisht ato të lidhura me zhvillimet legjislative dhe institucionale. Ky raport është publikuar në faqen e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatoreve.

Sa i përket çështjeve që nuk lidhen me sigurinë, ligji horizontal 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, është i përafuar gjerësisht me direktivat kryesore në këtë fushë, siç janë Direktiva mbi kushtet e padrejta të kontratave, Direktiva e shitjes së mallrave dhe garancive, Direktiva e mbi publicitetet çorientues dhe krahasues, Direktiva e praktikave të padrejta



tregtare, Direktiva e kredisë së konsumatorit, etj. Ndryshimi më i fundit i këtij ligji të miratuar në tetor 2018 (Ligji 71/2018), ka rritur më tej shkallën e përafrimit duke e harmonizuar pjesërisht me Direktivën 2011/83 për të drejtat e konsumatorit dhe Direktivën 2013/11 mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ADR). Parimet themelore të disa çështjeve të tjera të lidhura me konsumatorin janë të rregulluara me Ligjin 9902/2008, dhe më tej janë përpunuar me legjislacionin sekondar, siç janë kontratat në largësi të shërbimeve financiare, paketat e udhëtimit, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, etj.

Sa i përket shërbimeve financiare, Banka e Shqipërisë gjatë tremujorit të katërt 2021, ka vijuar procesin e projektimit të disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 48, datë 01.07.2015 “Për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare” në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9662 datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Këto ndryshime synojnë një harmonizim më të lartë me kërkesat e Direktivës së Bashkimit Evropian 2008/48/BE “Mbi marrëveshjen e kredisë për konsumatorët” që rregullojnë marrëveshjet e kredisë konsumatore dhe të kredisë hipotekore për individët me qëllim rritjen e kërkesave të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe janë në përshtatje me detyrimet që rrjedhin për Bankën e Shqipërisë nga dokumentet strategjike të integritetit evropian, raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe planit kombëtar për integritetin evropian (PKIE) 2021 – 2023.

Sa i përket Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bordi i AMF-së ka miratuar një strategji për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit 2017 – 2020, nëpërmjet së cilës synohet përafrimi sa më i plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Strategjia “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje” 2017 – 2020, u përmbyll me realizimin e objektivave të qarta, por edhe me vetëdijen, që në bashkëpunim me të gjithë aktorët e tjerë të rëndësishëm të tregut dhe institucionet financiare e arsimore ta kalojmë edukimin financiar në një nivel tjetër dhe me synimin për të hartuar dhe nisur zbatimin e një strategjie të dytë edukimi për Institucionin, duke marrë nga eksperiencat më të mira në mbarë botën sipas sugjerimeve të OECD-së.

Hyrja në fuqi e ligjit 52/2014 “Për Sigurimin dhe Risigurimin” ka mundësuar të gjithë kuadrin ligjor të nevojshëm për të mbështetur zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve si edhe janë rregulluar parimet themelore të disa çështjeve të tjera të lidhura me konsumatorin.

Gjatë vitit 2020, AMF ka mundësuar sistemin e të dhënave të historikut të dëmeve për pronarin dhe drejtuesit e mjeteve. Gjithashtu konsumatori/investitori mund të kontrollojë në çdo kohë, nëpërmjet një kodi unik të gjeneruar nga sistemi i integruar me shoqëritë e sigurimit, statusin e trajtimit të dosjes së tij të dëmshpërblimit.

Gjithashtu, AMF ka publikuar në faqen web Kartën e të drejtave të konsumatorit dhe investitorit. Kjo Kartë përcakton të drejtat themelore që gëzon konsumatori dhe investitori në marrjen e shërbimeve në tregun financiar jobankar, në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare si edhe ligjeve specifike, të cilat rregullojnë secilin treg financiar jobankar. Ky dokument paraqet informacion të përmbledhur dhe të qartë, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit dhe investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Në dhjetor 2020 është hartuar dhe është publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare fjalori i termave financiar, me qëllim informimin e konsumatorit me termat e tregut financiar jobankar, produktet, shërbimet e ofruara etj.

Në lidhje me zbatimin e çështjeve që nuk lidhen me sigurinë, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK) është organi kryesor përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve. Kapaciteti i KMK forcohet vazhdimisht përmes trajnimeve mbi legjislacionin e BE-së dhe praktikave të zbatimit. Në Takimin e 12 të Nën-komitetit BE – Shqipëri “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shendetit”, nga ana e Komisionit Evropian u vlerësua puna e Komisionit për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke theksuar se ky institucion po lëviz në drejtimin e duhur. Aktivitetet e KMK drejtohen kryesisht në mbrojtjen e interesave të përgjithshme të konsumatorëve, por njëkohësisht u jepet zgjidhje dhe ankesave individuale të konsumatorit. Me



ngritjen e strukturës për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, ankesat individuale të konsumatorëve do të gjejnë trajtim/zgjidhje nga kjo strukturë e re. Komisioni është organ vendimmarrës dhe ka marre vendime në lidhje me kushtet standarde të kontratës në sektorin e shërbimeve, siç janë energjia elektrike, uji, interneti, telekomunikacioni, universitetet. Masat e dhëna nga KMK kanë synuar gjetjen dhe eliminimin e kushteve të padrejta në këto kontrata. Transparenca dhe përgjegjësia e këtij organi sigurohet duke publikuar vendimet e saj dhe raportet vjetore në faqen e internetit të KMK-së. Kjo faqe interneti, që funksionon që nga viti 2015, ka rritur gjithashtu mundësinë e përdorimit të informacionit nga konsumatorët pasi përmban të gjithë legjislacionin, informacionin dhe materialet për ndërgjegjësimin e tyre, si dhe informacionin mbi aktivitetet, si dhe raportet vjetore të KMK. Konsumatorët mund të paraqesin ankesat e tyre edhe përmes kësaj faqe interneti.

Gjatë vitit 2021, në kuadër të angazhimit të Shqipërisë në CEFTA, edhe për sa i takon fushës së tregtisë elektronike dhe mbrojtjes së konsumatorëve, janë zhvilluar negociatat në lidhje me hartimin e Projektvendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) “Për lehtësimin e tregtisë elektronike”. Nëpërmjet këtij vendimi synohet që tregtia elektronike rajonale ndërpalëshe dhe aspektet e lidhura të mbrojtjes së konsumatorit duhet të harmonizohen me dispozitat e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Aktualisht, ky projektvendim është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave dhe mbas miratimit nga palët nënshkruese të CEFTA-s do të ndjekë procedurat e brendshme për ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë.

Për sa i përket çështjeve të lidhura me sigurinë, legjislacioni shqiptar (Ligji Nr. 10480/2011 për “Sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”) është përafëruar gjerësisht me Direktivën e Përgjithshme të Sigurisë së Produkteve 2001/95/EC. Kodi Civil shqiptar, edhe pse pjesërisht, rregullon disa aspekte të parashikuara nga Direktiva 85/374/EEE mbi përgjegjësinë për produktet me defekt. Sa i përket zbatimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), i krijuar në vitin 2016, është institucioni përgjegjës për të siguruar që produkti i

vendosur në treg është i sigurt për konsumatorët. Në çështjet që lidhen me sigurinë e produkteve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, krijuar me VKM Nr. 36/2016, përgjatë periudhës 2019 – 2020 ka vijuar të plotësoj organikën e saj dhe ka aktualisht 61 punonjës nga 80 punonjës që duhet të ketë në total në bazë të organigramës të miratuar më 01.06.2020 e cila ka pësuar një rritje nga 69 pozicione në 80 pozicione në total, 50 prej të cilëve janë inspektorë. Aktualisht, procesi i plotësimit të vendeve vakante të mbetura po vijon nëpërmjet procedurave të konkurrencës të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike dhe pritet shumë shpejt që stafi të rritet edhe më tej. Legjislacioni kombëtar përputhet pjesërisht me acquis të BE-së.

Sa i përket arritjeve kryesore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, në kuadër të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) ndërmjet konsumatorëve dhe tregtarëve, janë miratuar aktet nënligjore si me poshtë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1089, datë 24.12.2020 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve, si dhe për përcaktimin e kritereve shtesë që duhet të përmbushin strukturat për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve”, si dhe

- Urdhri i Kryeministrit nr. 64, datë 30.7.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve”.

Ligji i mbrojtjes së konsumatorëve dhe baza ligjore e sipërpërmendur kanë përcaktuar ngritjen e Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (DPZAM), si institucion varësie pranë Ministrisë përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve, aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Misioni i DPZAM do të jetë garantimi i mbrojtjes së interesave të konsumatorëve në treg, përmes zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, që rrjedhin nga kontratat e shitjes apo shërbimit ndërmjet tyre e që janë në fushën e saj të përgjegjësisë. Kjo strukturë pritet të ngrihet e të jetë funksionale brenda vitit 2022, në ndjekje të procedurave të rekrutimit të nëpunësve të administratës publike.



Për të siguruar harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit me *acquis* të BE-së në fushën e tregtimit në distancë të shërbimeve financiare, sipas planifikimit në PKIE 2020 – 2022, është miratuar VKM nr. 736, datë 3.12.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 615, datë 7.9.2011 “Për tregtimin në largësi të shërbimeve financiare të konsumatorëve”.

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve gjatë vitit 2021, ka vijuar funksionimin në drejtim të zbatimit të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve nëpërmjet zhvillimit të katër mbledhjeve, duke marrë në shqyrtim rreth 40 çështje, 8 prej të cilave të lidhura me mbrojtjen e interesit të përgjithshëm publik të konsumatorëve. Gjithashtu janë shqyrtuar ankesat e konsumatorëve, të paraqitura nga konsumatorë individuale, shoqata e konsumatorëve dhe pushteti lokal. Ankesat kanë gjetur zgjidhje nëpërmjet vendimeve të KMK apo nga procedurat e ndërmjetësimit të ndjekura nga KMK. Gjithashtu, ankesat e tjera i kanë kaluar për kompetencë institucioneve të tjera sipas fushës së përgjegjësisë: ISHMT, AKEP, Banka e Shqipërisë, etj.

ISHMT përgjatë vitit 2021 ka vijuar punën në zbatimin e detyrimeve ligjore të operatorëve ekonomik lidhur me të drejtat e konsumatorëve. Për këtë inspektimet janë zhvilluar në dy drejtime: ato të programuara nga ISHMT dhe ato të iniciuara nga ankesat e konsumatorëve.

- Inspektimet e programuara janë zhvilluar kryesisht në lidhje me etiketimin dhe informacionin në gjuhën shqipe. Në total janë inspektuar 70 operatorë ekonomik. 67 prej tyre i kanë zbatuar detyrat e lëna nga grupet e inspektimit ndërsa 3 prej tyre janë marrë masa administrative në përputhje me ligjin Nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar.

- Në lidhje me ndjekjen e ankesave për mbrojtjen e konsumatorit janë përfshirë të gjithë sektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Produkteve në ISHMT. Ankesat kanë ardhur kryesisht në lidhje me garancinë kontraktuale dhe etiketimin në gjuhën shqipe. Në total janë ndjekur 35 ankesa që lidheshin me produkte nga më të ndryshmet si: celular, makina larëse, syze dielli, detergjent dhe tekstile. Të gjitha ankesat janë zgjidhur në favor të konsumatorëve duke u kompensuar sipas të drejtave që garantohen

nëpërmjet ligjit të mbrojtjes konsumatore. Një pjesë e ankesave i janë drejtuar ISHMT nëpërmjet faqes online (rubrika ANKOHU: <http://ishmt.gov.al/formular-ankese/>), adresës së emailit (info@ishmt.gov.al) dhe nëpërmjet adresës postare (Rruga Shyqyri Bërxolli, Nr 65, Tirana 1001). Pjesa tjetër e ankesave janë përcjellë në ISHMT nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Agjencia për mbrojtjen e konsumatorit.

ISHMT ka marrë masa për rritjen e stafit nëpërmjet ristrukturimit të organigramës. Pas rekrutimeve të reja, stafit të ISHMT i janë shtuar dhe 15 inspektorë të rinj të cilët përpos të tjerave kanë dhe detyra që lidhen me ndjekjen e ankesave mbi mbrojtjen e konsumatorit.

Nëpërmjet trajnimeve është punuar për fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore të stafit të ri të rekrutuar, të cilëve ju është dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm mbi procedurat që duhet të ndiqen për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve.

ISHMT gjithashtu ka qenë e përfshirë dhe në aktivitete që kanë organizuar OJF ku si qëllim ka qenë njohja e legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit. Përfaqësuesit e ISHMT kanë diskutuar mbi këto tema në aktivitete ku grupet e interesit kanë qenë kryesisht konsumatorë nga shoqëria civile. ISHMT gjithashtu ka qenë pjesë dhe e një fushate ku ekspertë të fushës jepnin rekomandime në lidhje me Website-t e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore ku fokusi ishte aksesimi sa më i lehtë i rubrikave të ankesave për konsumatorët.

Prej vitit 2018 ISHMT disponon website-n e saj zyrtar, ku përveç materialeve informuese që janë të publikuar si për konsumatorët edhe për bizneset, ka një seksion të posaçëm ku qytetarët mund të drejtojnë ankesat e tyre. Gjatë vitit 2021, përveç inspektimit si përgjegjësi kryesor, ISHMT ka vijuar me shpërndarjen e broshurave për informimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve dhe operatorëve ekonomik mbi të drejtat e konsumatorit dhe mundësitë e ankimit pranë ISHMT.

Sa i përket Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, deri në muajin shtator 2020 janë trajtuar mbi 150 ankesa nga Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore, të cilat krahasuar me një vit më parë përbëjnë rreth 60% më tepër ankesa të trajtuara. Metodika e



trajtimit të ankesave rregullohet nga Rregullorja 35 “Për trajtimin e ankesave të konsumatorëve”.

Me ndryshimet strukturore të vitit 2020, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore u forcua në kapacitete duke u kthyer në Departament.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), gjatë vitit 2021 ka pasur vetëm 1 (një) ankesë që lidhet me mbrojtjen e konsumatorit. Ankesa i është drejtuar Agjencisë për Mbrojtjen e Konsumatorit ndërsa AMA-s për dijeni.

Në vijim të procedurave tona, AMA i kërkoi kompanisë “DIGIT-ALB” sh.a., ndaj së cilës adresohet ankesa, kontratën që kishte me abonentët e saj. Sipas kontratës së depozituar në AMA, “përmbajtjet programore janë subjekt i ndryshimeve që mund të ndërmarre subjekti/kompania”.

Sa i përket shëndetit publik, nuk ka pasur progres në rekomandimet e vitit të kaluar. Për shëndetin publik, pandemia COVID-19 ka treguar një nevojë të shtuar për gatishmëri emergjente dhe për të rritur kapacitetin e infrastrukturës shëndetësore emergjente. Duhet ende përpjekje për të implementuar qasjen “One Health”, si dhe gatishmërinë shëndetësore për të gjitha rreziqet. Gjithashtu, duhet bërë më shumë në përgjithësi për të forcuar kuadrin e politikave dhe për të siguruar që të gjithë në Shqipëri të kenë mbulim cilësor të kujdesit shëndetësor.

Sa i përket **gjakut**, indeksi i dhurimit është 10.2 dhurime për 1000 banorë (të dhënat e vitit 2020) dhe 19% e tyre janë dhurime vullnetare. Gjaku i dhuruar në nivel kombëtar testohet për agjentë infektivë në një qendër të vetme në Tiranë, ndërkohë që akoma nuk është centralizuar testimi imunohematologjik dhe përpunimi i gjakut në qendrat rajonale. Legjislacioni është harmonizuar në pjesën më të madhe të tij me Direktivën 2002/98/EC dhe direktivat zbatuese të saj edhe pse akoma ka nevojë për ndërhyrje specifike për një harmonizim të plotë me legjislacionin EU.

Sa i përket sëmundjeve të rralla, strategjia kombëtare e shëndetësisë është duke u zhvilluar në bashkëpunim me Bankën Botërore. Në fushën e kërcënimeve serioze ndërkufitare për shëndetin, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse, ekziston baza ligjore për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse dhe është hartuar për të qenë në përputhje me acquis. Ekziston një sistem kombëtar alarmi dhe mbikëqyrjeje për sëmundjet

ngjitëse. Shkalla kombëtare e mbulimit të imunizimit është 97%. Për kontrollin e duhanit është duke u zbatuar ligji për mbrojtjen e shëndetit publik kundër produkteve të duhanit, i cili është hartuar për t’u harmonizuar me acquis. Për parandalimin e abuzimit me drogën dhe reduktimin e dëmeve, janë zhvilluar disa aktivitete parandaluese, kryesisht të iniciuara nga Departamenti i Promovimit të Shëndetit dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit ka miratuar vendimet si më poshtë:

- Vendim Nr. 7, datë 19.2.2020 “Për miratimin e fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë” përafruar me Direktivën e Deleguar të Komisionit 2014/109/BE të datës 10.10.2014 që ndryshon Aneksin II të Direktivës 2014/40/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke krijuar bibliotekën e paralajmërimeve me fotografi që do të përdoren në produktet e duhanit;

- Vendim nr. 8, datë 29.1.2021 “Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit nr. 7, datë 19.2.2020 “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve të fotove të paralajmërimeve për efektet shkatërruese të duhanit, si dhe specifikimet e vendosjes së tyre në paketë”.

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit evropian mbi të drejtat e pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në zbatim të politikave dhe strategjive të qeverisë shqiptare, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor operon përmes zbatimit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare bilaterale (kryesisht me vende anëtare të Bashkimit Evropian) të ratifikuara si më poshtë vijojnë:

- Ligji nr. 9066, datë 15.5.2003, “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;

- Ligji nr. 35/2014, datë 3.4.2014, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës për mbrojtjen shoqërore”, në fuqi;



- Ligji nr. 42/2015, datë 16.4.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut për mbrojtjen shoqërore”;

- Ligji nr. 123/2015, datë 12.11.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen shoqërore”;

- Ligji nr. 151/2015, datë 21.12.2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë për mbrojtjen shoqërore”;

- Ligji Nr. 23/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen Shoqërore dhe të Protokollit përfundimtar të saj”;

- Ligji Nr. 34/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për Mbrojtjen Shoqërore”;

- Ligji Nr. 42/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë për Mbrojtjen Shoqërore”.

Në bazë të Marrëveshjeve të lartpërmendura Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është institucioni përgjegjës për ndjekjen e procedurave administrative lidhur me lëshimin e formularëve të sigurimeve shëndetësore. Në Marrëveshje parashikohen rastet kur një person i siguruar, që ka fituar të drejtën e përfitimit në natyrë sipas legjislacionit të një prej shteteve kontraktuese fiton të drejtën e përfitimeve në natyrë në territorin e shtetit tjetër kontraktues. Në këtë rast përfitimet në natyrë jepen në emër të agjencisë kompetente (FSDKSH) nga agjencia e vendit të qëndrimit, e cila është përgjegjëse për rimbursimin e përfitimeve në natyrë sipas legjislacionit në fuqi.

Programi Kombëtar i **Kujdesit Shëndetësor** siguron kujdes shëndetësor në vendbanime, kryesisht për grupet e marginalizuara rome dhe egjiptiane. Në kuadër të iniciativave të ndërra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë ofruar shërbime të dedikuara falas për gratë rome dhe egjiptiane për pap test, vizita falas dhe të gjitha shërbimet që u nevojiten. Qëllimi i kësaj iniciative është rritja e aksesit ndaj shërbimeve për gratë e marginalizuara që synojnë parandalimin e sëmundjeve nëpërmjet kontrolleve të hershme.

Janë zhvilluar aktivitete/trajtime në fushën e ndërgjegjësimit për HIV në komunitetin Rom dhe Egjiptian. Aktivitetet/trajnimet kanë pasur qëllim që duke përfshirë edhe anëtarë nga komuniteti Rom dhe Egjiptianë të rrisin informacionin mbi infeksionin HIV dhe në këtë grup popullate. Roli i këtyre aktiviteteve është i rëndësishëm për të lehtësuar komunikimin me familjarët gjatë vizitave në shtëpi.

Në lidhje me pajisjet mjekësore, është miratuar Ligji 21/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” në zbatim të rregullores evropiane për pajisjet mjekësore. Rishikimi i ligjit është bërë në vijim të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë evropian dhe ka si qëllim rritjen e sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve mjekësore pas vendosjes së tyre në treg dhe rritjen e aksesit për pacientet. Ligji parashikon pajisjen me licencë të tregtuesve me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgatitur aktin nënligjor që përcakton kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimit për të garantuar cilësinë dhe ruajtjen e standardeve më të mira mbi pajisjet mjekësore që prodhohen në vend. Ndryshimet ligjore rregullojnë edhe tregtimin e pajisjeve mjekësore përmes internetit, dhe gjithashtu forcon masat e marra për çdo subjekt që shkel ligjin.

Në fushën e produkteve kozmetike, në zbatim të Ligjit Nr. 26/2017, datë 16.03.2017 “Për produktet kozmetike”, nuk rezulton të jenë miratuar akte të tjera nënligjore në zbatim të tij, përveç atyre të raportuara më herët, të miratuara në vitin 2020.

Sa i përket përgatitjeve për takimin bilateral në kuadër të fazës screening, gjatë vitit 2021 GNPIE ka vijuar punën për përmbushjen e Planit të Hapave Kyç. Si rezultat, është rishikuar dhe përditësuar në shkurt 2021, Analiza e Mangësive Ligjore (Screening List) dhe Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative, të finalizuara më herët në shtator 2020, duke dhënë një panoramë më të qartë lidhur me mangësitë dhe masat që duhen ndërmarrë në vazhdim për t'i adresuar ato. Ndonëse pjesa që i takon nënkaptullit të shëndetit publik, ka ende nevojë për plotësime të mëtejshme, këto dokumente janë një bazë e mirë pune për përgatitjen e prezantimit për takimin dypalësh.



Gjithashtu, sa i përket substancave me origjinë njerëzore (SoHO), me mbështetjen e projektit SANECA/GIZ janë organizuar gjatë vitit 2021, 2 trajnime mbi kërkesat e acquis, institucionet relevante në nivelin e BE, si dhe procesi i negociatave në fushën e i) gjakut dhe ii) qelizave, indeve e organeve. 8 sesione online janë zhvilluar për këtë qëllim (12 – 13 prill dhe 14 – 15 qershor). Për të dy nënfushat janë përgatitur dy dokumente me rekomandime kyce për hapat që duhen ndërmarrë për të avancuar më tej me përgatitjet në këto dy nënfusha, si dhe duke dhënë informacion mbi institucionet relevante, dokumente të rëndësishme, projekte, etj., që duhen pasur në konsideratë. Gjithashtu, për fushën e gjakut janë përkthyer dy udhërrëfyes të rëndësishme: i) “Udhërrëfyesi i Praktikave më të mira për të siguruar përputhshmërinë me Direktivën 2005/62/KE”, dhe ii) “Udhërrëfyesi për përgatitjen, përdorimin dhe sigurimin e cilësisë së komponentëve të gjakut, Edicioni i 20. Këto dy dokumente do të përbëjnë bazën e manualit të cilësisë që do të mundësojë implementimin e një sistemi kombëtar të menaxhimit të cilësisë në fushën e transfuzionit të gjakut, që përbën një objektiv madhor strategjik për këtë fushë.

Në fushën e **shëndetit publik**, Baby Check Pay është një politikë sociale që është ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare gjatë vitit 2018. Me VKM Nr. 740, datë 12.12.2018 “Për përcaktimin e ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën për dhënien e tij”, e cila hyri më 1 janar 2019, aplikohet bonusi për nënat me foshnja të porsalindura, i cili varion nga 40.000 mijë lekë për fëmijën e parë, 80.000 lekë për fëmijën e dytë dhe 120.000 mijë lekë për fëmijën e tretë dhe në vijim. Këtë bonus e përfitojnë edhe nënat që i lindin fëmijët e tyre jashtë vendit me kushtin që fëmija të regjistrohet sipas afateve ligjore. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare jepet në formën e një çeku në emër të nënës, pranë maternitetit ku ajo ka lindur fëmijën.

Me dekretin 47 (30/01/2019), Qeveria ka aprovuar një ligj për caktimin e kontrollit kombëtar të kancerit të qafës së mitrës në vend. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i kanë kushtuar një buxhet asaj dhe Instituti i Shëndetit Publik kanë përgatitur bazat laboratorike për ekzaminim me bazë HPV. ISHP ka përgatitur gjithashtu kornizën teknike të Programit Kombëtar. Grupi i synuar në

popullatë janë gratë 40 – 50 vjeç, të cilët do të kontrollohen për HPV me rrezik të lartë gjatë 5 viteve. Prej vitit 2019, programi është plotësisht funksional dhe më shumë se 20000 gra janë ekzaminuar dhe u janë ofruar shërbime përcjellëse kur të jetë e nevojshme. Nga ISHP është kryer gjithashtu një vlerësim mbi vitin e parë të programit. Rreth 90% e grave që rezultuan pozitive kishin kryer një vizitë gjinekologjike ose planifikonin ta kryenin së shpejti. Gjithashtu, rreth 90% e grave të intervistuar e vlerësuan shërbimin si ‘të mirë’ ose ‘shumë të mirë’. Gjithsesi, pandemia për 2020 – 2021 ka ulur me rreth 50% përdorimin e shërbimit. Në datë 3.02.2021 është organizuar edhe një dëgjese në komisionin parlamentar të shëndetësisë dedikuar këtij programi të ri.

Në korrik 2020, me Vendim të Këshillit të Ministrave është miratuar Programi kombëtar i depistimit të kancerit të gjirit për diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e duhur në kohë dhe me efikasitet si një paketë e integruar shërbimesh që ofrohet për gratë mbi 25 vjeç. Shërbimet e mamografisë depistuese ofrohen për gratë 50 – 60 vjeç. Programi parashikon si më poshtë vijon:

- Çdo grua e moshës 50 – 60 vjeç do të ftohet çdo dy vjet në mënyrë aktive nga mjeku i familjes për të kryer mamografinë falas në institucionet shëndetësore publike.

- Paketë të integruar shërbimesh që përfshin: shërbimet e organizuara të këshillimit, të informimit dhe ekzaminimit me palpim të gjirit që do ofrohet në qendrat shëndetësore të kujdesit parësor; shërbimit të ekzaminimit me mamografi që ofrohet në qendrat e mamografisë pranë shërbimit spitalor publik, poliklinikave të specialiteteve dhe njësitë e lëvizshme të mamografisë; shërbimet e konfirmimit të diagnozës dhe të trajtimit eventual mjekësor që ofrohet pranë Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza dhe 7 spitale rajonale që kanë punktin e kimioterapisë.

Serish, edhe në këtë rast, pandemia i ka vonuar aktivitetet për fillimin e zbatimit të tij në shkallë të gjerë.

Në gusht 2021 me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur grupi i punës për përgatitjen e planit të ri kombëtar për kontrollin e kancerëve 2022 – 2030. Janë kryer 4 takime dhe dokumenti është në fazë të avancuar.



Në zbatim të synimeve kyçe të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2016 – 2020 dhe Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013 – 2022, atë të deinstitutionalizimit dhe decentralizimit të shërbimeve të shëndetit mendor, dhe parashikimeve të paketës ligjore në zbatim të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar, ndërhyrjet e fundit në fushën e shëndetit mendor synojnë fuqizimin e rrjetit të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor. Në këtë kuadër, me anë të VKM Nr. 558, datë 15.7.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 325, datë 23.6.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për Krijimin e Qendrës Kombëtare “Për Mirëritjen, Zhvillimin dhe Rehabilitimin e Fëmijëve”, si njësi buxhetore, e veçantë”, të ndryshuar” është riorganizuar kjo qendër (tashmë e quajtur Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët) duke zgjeruar grupmoshën përfituese të shërbimeve të saj, nga 0 – 6 vjeç në 0 – 18 vjeç, me qëllim maksimizimin dhe fuqizimin e shfrytëzimit të burimeve infrastrukture dhe njerëzore ekzistuese, të specializuara në shëndet mendor për fëmijët dhe adoleshentët. Për sa i përket kuadrit ligjor në këtë fushë, pavarësisht risive që prezantonte Ligji nr.44/2021 “për shëndetin mendor” i ndryshuar dhe paketa e gjerë e akteve nënligjore, nga ana e mekanizma monitoruese ndërkombëtare si Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin të Torturës/KPT (CPT), u evidentua nevoja për të përmirësuar mbrojtjen ligjore, respektimin dhe forcimin e të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, të sanksionuara në të drejtën ndërkombëtare. Në këtë kuadër, ndryshimet dhe shtesat e reja të miratuara me Ligjin Nr. 20/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” i ndryshuar, adresuan rekomandimet e mësipërme, kryesisht duke diferencuar procedurat e shtrimit nga trajtimi, qofshin ato të një natyre të vullnetshme apo të pavullnetshme. Ndërkohë, ndryshimet e fundit ligjore ofrojnë një mbrojtje të shtuar ligjore për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pa zotësi për të vepruar, në lidhje me procedurat e shtrimit dhe/ose trajtimit të pavullnetshëm, nëpërmjet mundësisë të vlerësimit të këtyre procedurave nga gjykata kompetente (në të njëjtat kushte si personat me zotësi të plotë juridike për të vepruar), pavarësisht pëlqimit të kujdestarit të tyre

ligjor. Aktualisht MSHMS po punon për hartimin e akteve nënligjore që preken nga këto ndryshime.

Në terma strategjike, MSHMS është duke finalizuar dokumentin e Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2022 – 2030, në të cilën janë parashikuar ndërhyrje të veçanta për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të shëndetit mendor me fokus shërbimet me bazë komunitare.

Në **fushën e gjakut** arritja më e rëndësishme ka qenë ndërtimi dhe konsolidimi i një kornize rregulluese e ligjore të harmonizuar në pjesën më të madhe të saj me direktivat EU. Po kështu centralizimi i testimit për agjentë infektivë dhe shtimi i metodës NAT në testimin rutinë të çdo njësie gjaku të dhuruar në vend, kanë qenë ndërhyrje të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm sigurinë e gjakut lidhur me infeksionet e transmetueshme përmes transfuzionit të gjakut.

Bazuar në direktivat dhe standardet e OBSH dhe synimit të përafrimit ligjor me direktivat e BE Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me INSTAT, që është lider në këtë proces, ka hartuar VKM Nr. 135, datë 20.03.2019 “Për Miratimin e Nomenklaturës së Klasifikimit Ndërkombëtar të Sëmundjeve, ICD-10. Kjo VKM konsiston në implementimin e ICD-10 klasifikimin ndërkombëtar i sëmundjeve në të gjitha institucionet shëndetësore të sistemit publik dhe jopublik, në shërbimin parësor dhe spitalor, Ministria e Drejtësisë-Spitali i Burgjeve dhe Mjekësia Ligjore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore për CEMP, Ministria e Mbrojtjes –Spitali i Traumës që ka varësi të dyfishtë institucionale. Kjo nomenklaturë ka për qëllim zëvendësimin e ICD-IX në ICD-10, e cila ka të bëjë me kodifikimin e detajuar të diagnozave në kartelat e pacientit sipas standardeve ndërkombëtare të OBSH dhe BE.

Sa i takon **përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave** dhe ngritjes/funksionimit të Tryezës së Rrumbullakët për Kapitullin 28, me mbështetjen e projektit SANECA-s, gjatë vitit 2021 MFE-ja zhvilloi metodologjinë për identifikimin e palëve të interesuara ndër të tjera në Kapitullin 28 bazuar në një matricë ndikim-rëndësi, me qëllim ngritjen së tryezës përkatëse për Kapitullin 1 në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPEI). MFE shpalli thirrjen për aplikime për Tryezën e Rrumbullakët të Kapitullit 28 të PPEI në Mars 2021 dhe mbajti një sesion informimi për të rritur ndërgjegjësimin tek aktorët



jo-shtetërorë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen në Platformë. Tryeza përkatëse e Kapitullit 28 u krijua në maj 2021, është organizuar mbledhja e parë e tij (korrik 2021) dhe janë miratuar rregullat të procedurës për funksionimin e duhur të saj si një platformë konsultimi midis aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë në procesin e anëtarësimit në kapitullin përkatës.

4.28.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Kuadri institucional që merret me mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit në Shqipëri përbëhet nga institucionet e mëposhtme:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE);
- Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK);
- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT);
- Banka e Shqipërisë (BA);
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS);
- Instituti i Shëndetit Publik;
- Spitalet Universitare për diagnostikimin, trajtimin, trajnimin e specialistëve;
- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

4.28.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Për sa i takon çështjeve të mbrojtjes së konsumatorëve janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Mbështetur në dokumentin “Analiza e mangësive institucionale dhe administrative (IAGA). janë evidentuar mangësitë në kapacitetet institucionale, kryesisht për arsye të numrit të limituar të stafit të strukturës së ngarkuar me çështjet e mbrojtjes së konsumatorëve. Aktualisht, Sektori i Tregut të Brendshëm në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik/MFE, i përbërë nga 3 punonjës, krahas çështjeve të mbrojtjes së konsumatorëve të kapitullit 28 është i ngarkuar dhe me çështjet e lëvizjes së lire të mallrave të kapitullit 1.

- Mungesa e strukturës përgjegjëse për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të

konsumatorëve, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, për ti dhënë zgjidhje ankesave individuale të konsumatorëve, gjithnjë e në rritje.

- Zhvillimet e vazhdueshme teknologjike, në tregun online, shërbimeve dixhitale apo dhe mjeteve dixhitale në përdorim nga konsumatorët, kërkojnë rregullime të legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve. Këto ndryshime, pjesë edhe e direktivave të reja evropiane, do të sigurojnë transparencën e duhur ndaj konsumatorëve, zbatimin e të drejtave të tyre, si dhe përmirësimin e funksionimit të tregut.

Për sa i takon çështjeve të shëndetit publik janë identifikuar mangësitë në vijim:

- Pamjaftueshmëria në gjak (10,2 dhurime/1000 banorë)
- Shumica e dhuruesve janë dhurues familjarë (80%)
- Akoma mbetet një numër i vogël dhuruesish me pagesë jashtë Tiranë (1% e dhurimeve në nivel kombëtar)
- Nuk kemi të implementuar një sistem hemovigilence nuk kemi një autoritet kompetent për hemovigilencën.
- Nuk kemi të implementuar një sistem kombëtar të menaxhimit të cilësisë.
- Në Raportin Vjetor 2021 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për shëndetin mendor, rekomandohet vazhdimi i përmirësimit të aksesit në shëndetësi dhe shërbime për popullatat e pa favorizuara, duke përfshirë njerëzit me çrregullime të shëndetit mendor, të cilat shpesh i nënshtrohen formave të shumta të diskriminimit.

Prioritete në këtë kapitull për periudhën 2022 – 2024 janë:

- Forcimi i kuadrit të politikave për shëndetin publik me miratimin e Strategjisë së re Shëndetësore 2021 – 2030 dhe të sigurojë zbatimin dhe qëndrueshmërinë e saj, përfshirë mbrojtjen financiare, dhe të harmonizojë më tej legjislacionin e saj me acquis të BE-së për shëndetin mbi substancat me origjinë njerëzore dhe ilaçet për njerëzit dhe përdorimi veterinar;

- Përdorimi i mësimeve të nxjerra nga pandemia COVID-19 për të forcuar gatishmërinë emergjente shëndetësore me të gjitha rreziqet, përfshirë kërcënimet përtej sëmundjeve ngjitëse dhe përgjigjeve si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal;



- Përmirësimi i aksesit në shëndetësi dhe shërbime për popullatat e pa favorizuara, përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane, njerëzit e moshuar, njerëzit me mendje ekzistuese problemet shëndetësore, personat me aftësi të kufizuara; dhe popullsitë në zonat rurale ose të largëta, veçanërisht për gratë dhe vajzat që i përkasin këtyre grupeve të cilat shpesh i nënshtrohen formave të shumta të diskriminimit.

- Forcimi i kapaciteteve administrative të strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së konsumatorëve, Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe institucioneve të tjera përkatëse;

- Ngritja dhe bërja funksionale e Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjidhjes Alternative të mosmarrëveshjeve;

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorit me acquis në përputhje me Analizën e Mangësive Ligjore (LGA) për Kapitullin 28 dhe veçanërisht në lidhje me aspektet e kontratave të shitjes së mallrave për konsumatorët, si dhe një zbatim me të mire dhe modernizim të rregullave të BE për mbrojtjen e konsumatorëve; Ky proces do të zbatohet edhe dispozitat e Vendimit të Komitetit të Përbashkët të CEFTA “Për lehtësimin e tregtisë elektronike”, lidhur me aspektet e mbrojtjes së konsumatorit;

- Funksionimi i Inspektoratit të Mbikëqyrjes së Tregut, me kapacitet të plotë punonjësish;

- Zbatimi i kuadrit të politikave për shëndetin publik dhe të sigurohet qëndrueshmëria e ndërhyrjeve;

- Përmirësimi i aksesit në shëndetësi dhe shërbime për njerëzit në nevojë, duke përfshirë: minoritetet rome dhe egjiptiane; personat me aftësi të kufizuara; dhe popullsinë në zonat rurale ose të thella;

- Me rëndësi të veçantë është përmirësimi i aksesit për gratë dhe vajzat që u përkasin grupeve të mësipërme, të cilat shpesh u nënshtrohen formave të shumta të diskriminimit;

- Përpjekje të mëtejshme për përafrimin e plotë me legjislacionin e BE-së për çështjet e produkteve të duhanit, substancat me origjinë njerëzore dhe barnat për përdorim njerëzor dhe veterinar;

- Vlerësimi dhe prioritizimi i ndikimit shëndetësor të politikave të mbrojtjes sociale,

sigurisë në punë, mjedisit, planifikimit dhe rregullimit territorial, duke përfshirë transportin dhe komunikimet, politikat fiskale për të rritur barrën e taksave mbi duhanin, pijet alkoolike, lëndëve djegëse shumë ndotëse, lojërat e fatit dhe lehtësimin të politikave fiskale për produktet me interes të veçantë për shëndetin publik;

- Krijimi/konsolidimi i mekanizmit të koordinimit ndërsektorial për probleme madhorë të shëndetit publik, si droga dhe abuzimi me alkoolin, duhan-pirja, siguria rrugore, siguria ushqimore dhe ushqyerja, shpërthimi i sëmundjeve infektive, rezistenca antibiotike, përgatitja dhe reagimi ndaj pandemive, menaxhimi strategjik i kimikateve, faktorët mjedisorë, ndryshimet klimatike, migrimi, shëndeti dhe përfshirja sociale;

- Përmirësimi i programeve të mbikëqyrjes dhe reagimit ndaj sëmundjeve infektive, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;

- Ngritja e një sistemi mbikëqyrjeje për rezistencën antibiotike dhe të një programi kontrolli dhe monitorimi mbi konsumin dhe politikat e antibiotikëve, përmes përmirësimit të legjislacionit, forcimit të kapaciteteve dhe rrjeteve të informimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik;

- Përmirësimi i përgatitjes dhe reagimit ndaj pandemive dhe i politikave të kontrollit të sëmundjeve (HIV/AIDS, sifilizi, hepatiti viral, programi i imunizimit, etj.), përmes rritjes së kapaciteteve dhe përmirësimit të strategjive kombëtare; përmirësimit të akteve nënligjore, forcimit të kapaciteteve dhe digjitalizimit, si dhe forcimit të laboratorëve mikrobiologjikë të shëndetit publik; ngritjen e një sistemi mbikëqyrjeje për rezistencën antibiotike.

- Rritja e numrit të dhuruesve vullnetarë përmes riorganizimit tërësor të promocionit të dhurimit vullnetar të gjakut në vend, forcimit të kapaciteteve promovuese brenda QKTGJ dhe digjitalizimit të të dhënave të dhuruesve/dhurimeve të gjakut në nivel kombëtar.

- Është në fazë implementimi sistemi informatik kombëtar i menaxhimit të bankave të gjakut, i cili synon të ngushtojë distancën e



komunikimit midis dhuruesit, bankës së gjakut dhe marrësit përmes ofrimit të një sistemi të përbashkët për tre aktorët duke përmbyshur kërkesat për gjak. Sistemi do të bëjë të mundur automatizim e procesit të ruajtjes, procesimit, marrjes dhe analizimit të informacionit që lidhet me menaxhimin administrativ dhe inventarizimin e gjakut dhe produkteve të tij në të gjitha bankat e gjakut dhe spitalet publike/private në vendin tonë.

- Shkëmbimi i informacionit midis bankave të gjakut për të përmbyshur kërkesat për gjak është një nga prioritetet e vënies në funksionim të tij. Sistemi do të garantojë rritje të saktësisë së informacionit mbi gjakun dhe nënproduktet, dhuruesin, testet laboratorike si edhe menaxhimin e mirë të shpërndarjes së qeseve të gjakut duke konsideruar datat e skadencës. Gjithashtu, do të bëjë të mundur ruajtjen e historikut të testeve laboratorike për personat që dhurojnë gjak.

- Përmirësimi i cilësisë së gjakut përmes rritjes së kapaciteteve testuese/përpunuese/ruajtëse, harmonizimit të plotë të standardeve dhe legjislacionit me Direktivat Evropiane dhe dizenjimit/forcimit të kapaciteteve të autoriteteve kompetente për inspektim dhe hemovigjilancë. Implementimi i një sistemi të integruar të hemovigjilancës përmes ngritjes së një rrjeti raportimi dhe vlerësimi të reaksioneve dhe eventeve të padëshiruara.

- Një plan veprimi i ri mbi zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri është planifikuar të hartohet brenda vitit 2022, bazuar në objektivat relevante strategjike të dokumentit të ri të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore 2022 – 2030. Objektivat do të reflektojnë vizionin e dokumenteve ndërkombëtare në shëndet mendor si Planit të veprimit për Shëndetin Mendor të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe dokumentet relevante të EU Soft Acquis në këtë fushë. Ndërkohë, në lidhje me kuadrin strategjik që implikon shëndetin mendor, përveç dokumentit të dedikuar në këtë fushë, Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013 – 2022, shëndetit mendor i është dhënë një fokus i veçantë edhe shëndetit mendor në Kujdes Shëndetësor Parësor, duke parashikuar në dokumentin e parë strategjik për

zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor, miratuar në 2019, ofrimin e shërbimeve socio-shëndetësore pranë qendrave shëndetësore. Kjo qasje është parashikuar edhe në Programin e Qeverisë 2021 – 2025, ku janë planifikuar që brenda vitit 2024 të vihen në funksionim 10 qendra model të mjekësisë familjare, me shërbime të integruara socio – shëndetësore, me fokus kryesor problemet e shëndetit mendor, por edhe shërbimet për fëmijët dhe të rinjtë dhe kujdesin paliativ. Paralelisht po punohet nëpërmjet projektit HAP, në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe aksesit të shëndetit mendor në KSHP, për zhvillimin e udhëzuesit për menaxhimin e çrregullimeve të shëndetit mendor në KSHP (Kujdesi Shëndetësor Parësor), proces i cili do të vijojë me aktivitetet për aftësimin e ekipeve të mjekësisë së familjes (mjekë familje/të përgjithshëm dhe infermierë) në përdorimin e këtij instrumenti në praktikën e tyre të përditshme, me qëllim integrimin më të mirë të shërbimeve në KSHP.

- Gjithashtu, një zgjatje e Dokumentit Strategjik mbi “Parandalimin dhe Reduktimin e Dëmeve të Lidhura me Alkoolin në Shqipëri, 2017 – 2021” dhe Planit të tij të Veprimit do të rishikohet në 2022, duke pasqyruar objektivat strategjike përkatës të lidhura me alkoolin të parashikuara si në Strategjinë e Re Kombëtare të Shëndetësisë 2030, si dhe të dokumenteve përkatëse ndërkombëtare, si të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe acquis përkatëse të BE-së.

- Një Plan Kombëtar për Kontrollin e Drogave dhe një Plani pesë vjeçar i Veprimit për zbatimin e tij është planifikuar të miratohet brenda vitit 2022 duke pasqyruar objektivat strategjike përkatës në lidhje me drogat të Strategjisë së Re Kombëtare të Shëndetit 2030. Objektivat do të pasqyrojnë vizionin e dokumenteve ndërkombëtare, si të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të Qendrës Evropiane të Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat dhe ACQUIS përkatëse të BE-së.

Çështje të tjera horizontale

- Rritja e angazhimit dhe përfshirjes së shoqërisë civile në procesin e negociatave të anëtarësimit, përmes funksionimit të Tryezës për Kapitullin 28, tashmë të ngritur, në kuadër të



Platformës së Partneriteti për Integrimin Evropian.

- Rritja e kapaciteteve të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian, lidhur me përfundimin e fazës *screening* dhe me tej me procesin e bisedimeve të anëtarësimit për Kapitullin 28.

KAPITULLI 29: BASHKIMI DOGANOR

4.29.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së në fushën e Bashkimit Doganor është direkt i detyrueshëm për Shtetet Anëtare, duke siguruar funksionimin e bashkimit doganor si dhe mbrojtjen efektive dhe kontrollin e kufijve të jashtëm. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë ekzistencën e kapaciteteve të nevojshme zbatuese, duke përfshirë lidhjet me sistemet relevante të kompjuterizuara të BE-së. Shërbimet doganore gjithashtu duhet të sigurojnë kapacitete adekuate për zbatimin e rregullave të veçanta të përcaktuara në fushat përkatëse të *acquis* siç janë tregtia e jashtme, dispozitat për shëndetin dhe sigurinë.

4.29.2 Struktura e kapitullit

N/A

4.29.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe Protokollin 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafuar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh *acquis* në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

Acquis në fushën e Bashkimit Doganor përfshijnë Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, Nomenklaturën e Kombinuar, tarifën e përbashkët doganore dhe klasifikimin tarifor, lehtësimin e detyrimeve doganore, pezullimet doganore dhe kuotat e caktuara tarifore, si dhe dispozita të tjera të tilla si ato mbi kontrollin doganor të të drejtave të pronësisë intelektuale, si

dhe ndihmën e ndërsjellë administrative në çështjet doganore dhe transitin.

Implementimi i *acquis* të Bashkimit Doganor kërkon ekzistencën efektive të autoriteteve doganore, në secilin Shtet Anëtar për të siguruar zbatimin korrekt, uniform të rregullave doganore dhe kur është e përshtatshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme për mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore.

4.29.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është e përgatitur mesatarisht në fushën e bashkimit doganor. Përparim i kufizuar është shënuar veçanërisht me regjistrimet e para të operatorëve ekonomikë të autorizuar dhe me emërimin e një koordinatori të rrjetit kundër korrupsionit në administratën doganore. Ka vijuar puna përgatitore për zhvillimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Transitit. Rekomandimet e vitit të kaluar janë adresuar pjesërisht.

Në vijim të vlerësimit të PR 2021, Shqipëria ka avancuar me zbatimin e programit të saj të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA) duke autorizuar 8 operatorët e parë ekonomikë në vitin 2021.

Administrata doganore mbështetet në Strategjinë e Biznesit 2018 – 2021 të miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Në vijim të vlerësimit të PR 2021, Shqipëria ka avancuar me zbatimin e programit të saj të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (OEA) duke autorizuar 4 (katër) operatorët e parë ekonomikë në qershor 2021.

Legjislacioni doganor lidhur me Operatorët Ekonomikë të Autorizuar është i njëjtë me atë të BE-së. Dispozitat për OEA dhe procedurat e thjeshtuara kanë hyrë në fuqi nga 1 janari 2015. Ato parashikohen në ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i cili është në përputhje me Rregulloren nr. 952/2013 “Kodi Doganor i Bashkimit Evropian”) dhe VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014”.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka miratuar Udhëzimin nr. 06, datë 19.10.2020 (nr.prot.19532, datë 19.10.2020) “Mbi zbatimin praktik të procedurave të aplikimit, miratimit, funksionimit dhe mbikëqyrjes së thjeshtimeve



doganore dhe Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar”.

Lidhur me zbatimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët të CEFTA për programet e njohjes së ndërsjellë të Operatorëve të Autorizuar Ekonomikë (OEA), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka krijuar grupin e punës i cili do të verifikojë aplikimet dhe plotësimin e kërkesës ligjore të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kanë organizuar fushata të ndërgjegjësimit të publikut me përfaqësues të biznesit dhe sindikatave mbi promovimin e përfitimeve/avantazheve dhe kritereve për t'u plotësuar për pajisjen me autorizim të AEO. Si rezultat i kësaj fushate ka 15 aplikime për autorizim nga kompanitë të cilat janë nën procesin e shqyrtimit dhe plotësimit të dokumenteve të kërkuara. Janë autorizuar 8 (tetë) operatorët e parë ekonomikë gjatë vitit 2021.

Në kuadër të njohjes reciproke të AEO me vendet e CEFTA, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës pranë Sekretariatit të CEFTA. Dogana shqiptare po bashkëpunon me GIZ-in për zbatimin e projektit rajonal pilot të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar. Ndërkohë në bashkëpunim me GIZ ka filluar plotësimi i gjithë dokumentacionit ligjor në gjuhën angleze për këtë procedurë. Sa i përket certifikimit elektronik të dokumentacionit dhe nënshkrimit elektronik të deklaratës nga ana e Operatorëve Ekonomikë/Agjentëve Doganorë, si dhe nga ana e punonjësve doganorë zbatohet vula elektronike.

Nomenklatura e Kombinuar Mallrave (NKM) miratohet çdo vit duke përafëruar Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave të BE.

Shqipëria zbaton Konventën Rajonale mbi rregullat preferenciale të origjinës Pan-Euro-Mesdhetare (Ligji 1/2012 datë 26.01.2012). Nga 1 shtator 2021 Shqipëria ka filluar zbatimin e rregullave transitore të origjinës preferenciale të Konventës PEM në tregtinë bilaterale me BE (ligji nr. 98/2021 datë 07.07.2021) si dhe nga 1 janar 2022 me vendet EFTA (ligjet Nr. 99/2021 datë 07.07.2021 si dhe 122/2021).

Ligji nr. 101/2021 datë 07.07.2021 ka ndryshuar Shtojcën 4 të Marrëveshjes CEFTA 2006 për të mundësuar zbatimin e rregullave transitore të

origjinës preferenciale të Konventës PEM si rregulla alternative, por s'ka akoma filluar zbatimin.

Janë miratuar ligjet nr. 101/2021 dhe 99/2021 datë 07.07.2021 të cilët kanë ndryshuar Shtojcën 4 të Marrëveshjes CEFTA 2006 si dhe Protokollin B të MTL me vendet EFTA si dhe ndryshimin e marrëveshjeve bilaterale për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë e Republikës së Islandës, duke mundësuar zbatimin e rregullave transitore të origjinës preferenciale të Konventës PEM si rregulla alternative.

Nga 3 maj 2021 ka filluar të zbatohet ligji nr. 82/2020 datë 02.07.2020, i cili ka zëvendësuar Protokollin II të MTL me Turqinë (Koncepti i “produkteve origjinës” dhe “metodat e bashkëpunimit administrativ”) me Konventën Rajonale mbi rregullat pan-Euro-Mesdhetare të origjinës preferenciale.

Më 3 maj 2021 Shqipëria ka nisur zbatimin e Marrëveshjes së Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (ligji nr. 31 datë 08.03.2021).

Në kuadër të Programit IPA 2017 është miratuar Projekti i Binjakëzimit “Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me implementimin e Kodit Doganor të BE-së dhe përgatitjen për ndërveprim me sistemin e IT të BE për mallrat e falsifikuara”. Ky Projekt synon të ndihmojë ADSH-në në përafrimin e akteve të treta dhe udhëzimeve me *acquis* të BE-së dhe praktikat më të mira si dhe të ndihmojë në përgatitjen për ndërveprim me sistemin IT të BE-së për mallrat e falsifikuara. Më datë 24 nëntor 2020 u nënshkrua kontrata dhe aktualisht ky projekt përfundoi në nëntor 2021. Gjatë vitit 2021 janë përkthyer në shqip një sërë rregulloresh dhe manualesh doganore, është bërë analiza e mangësive dhe nevojave (gaps and needs) dhe janë hartuar draftet në gjuhën angleze. në proces hartimi Kodi Doganor, Dispozitat Zbatuese të tij dhe manualët e udhëzimit përkatës, që synojnë përafrimin me *acquis* të BE-së.

Me ligjin nr. 62/2019 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Për Lehtësimin e Tregtisë dhe të Transportit në Ballkanin Perëndimor” me qasje programatike me



shumë faza”, është parashikuar implementimi i sistemit NCTS si dhe përafrimi i mëtejshëm i *acquis* të BE në lidhje me dispozitat për NCTS. Ky projekt përfshin gjithashtu edhe komponentët e Sportelit të Vetëm (*Single window*), dhe Pikën e Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë e Veriut) në Qafë Thanë.

Në shkurt 2020 Ministria e Financave dhe Ekonomisë themeloi një Njësi për Zbatimin e Projektit (PIU) për të siguruar zbatimin teknik të tij. Data e pritshme për përfundimin e projektit është data 15 dhjetor 2025. Tashmë ka nisur zyrtarisht zbatimi i projektit të NCTS, i cili parashikon hartimin e kërkesave/specifikimeve teknike për zhvillimin dhe zbatimin e NCTS. Kjo detyrë përfshin përgatitjen e ligjeve dhe rregulloreve të reja që lidhen me NCTS si dhe përgatitjen e kërkesave teknike dhe funksionale dhe specifikimet e grafikut të punës dhe çdo kërkesë tjetër të nevojshme për fazën 5 të NCTS. Zbatimi i NCTS synon standardizimin e proceseve për NCTS.

Dispozitat ligjore e nënligjore si dhe aktet e nivelit të tretë në lidhje me NCTS janë përgatitur në gjuhën angleze nga ekspertët e Projektit të Bankës Botërore dhe pritet dorëzimi i tyre pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe më pas përkthimi i tyre zyrtar për të vijuar punën e mëtejshme legjislativë nga dogana.

Është në proces puna për hartimin e Kodit Doganor, Dispozitave Zbatuese të tij, akte të cilat do të përfshijnë edhe dispozitat për transitin e përbashkët. Gjithashtu është në proces përgatitja e akteve të nivelit të tretë, në zbatim të Kodit Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij, të cilat përafrojnë manualët dhe udhëzuesit e BE.⁶⁹

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është një nga përfituesit e Investimit të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), fazës së parë me fokus “Lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor (WBTFP). Komponentët e Doganës përfshijnë edhe Projektet për zhvillimin e Sportelit të Vetëm

Kombëtar (National Single Window). Marrëveshja e huasë është nënshkruar në datën 19/06/2019 nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) dhe Qeveria e Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Që prej Shkurtit 2020 Njësia PIU për Zbatimin e Projektit pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave po ndjek procedurat e implementimit dhe kontraktimeve në kuadër të këtij Projekti. Në kuadër të këtij Projekti të Bankës Botërore është kontraktuar në nëntor 2020 kompania KGH Customs Services për të dizenuar NSW në tre shtete: Shqipëri, Serbi dhe Maqedoni e Veriut. Qëllimi i projektit që po zbatohet nga KGH Customs Services është hartimi i “Blueprinti/Udhërrëfyesi për Sportelin e Vetëm Kombëtar (NSW) për Shqipërinë”.

Blueprinti është dorëzuar dhe përmbledh analizat dhe vendimet kryesore të marra për disa aspekte të rëndësishme të Sportelit të Vetëm Kombëtar, duke përfshirë strukturën drejtuese për të mbikëqyrur NS-në, modelin operacional dhe strukturën e tarifave për të mbështetur operacionet, një program të menaxhimit të ndryshimit dhe një plan zbatimi të NS.

Pas fazës përmbyllëse të Blueprint përgatitur nga kompania KGH e cila zhvilloi dhe video konferencën e fundit më datë 29 Tetor 2021, PIU ka përgatitur TORs për: WBTF-ALB-112A: “Technical adviser to support the implementation of legal changes required to support specific features of the new functional model” të cilat do duhet të miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përmes Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 23.01.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore” është miratuar Baza Kombëtare e të Dhënave të Vlerësimit, si një instrument i njohur dhe i rekomanduar nga Organizata Botërore e Doganave. Kjo bazë të dhënash përdoret gjatë procesit të vlerësimit doganor të mallrave kur nuk pranohet vlera e deklaruar (vlera e transaksionit) në respektim të metodologjisë së vlerësimit doganor. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021 zhdoganimi duke përdorur të dhënat e disponueshme (metoda 6 e vlerësimit doganor) ka qenë rreth 6% të totalit të artikujve për këtë periudhë.

Sistemi i menaxhimit të riskut është i automatizuar dhe krahason të dhënat e importit,

⁶⁹Hartimi i Kodit Doganor, dispozitave zbatuese të Kodit dhe të akteve të nivelit të tretë po bëhet në kuadër të Projektit IPA “Support to the Albanian Customs Administration in relation to the implementation of the EU Customs Code and increase of operational capacities in the area of counterfeit goods” si dhe të asistencës së dhënë nga Banka Botërore “Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor”.



eksportit dhe transitit me profilet aktive të riskut. Sistemi i Menaxhimit të Riskut i automatizuar kontribuon në ekuilibrin ndërmjet lehtësimit të tregtisë dhe kontrollit doganor. Gjatë periudhës 1 janar 2021 – 31 dhjetor 2021, 6.6% e numrit të përgjithshëm të deklaratave doganore import/eksport është inspektuar fizikisht (kanali i kuq); 62.9% i janë nënshtruar kontrollit dokumentar (kanali i verdhë), 10.5% kontrollit të pas zhdoganimit (kanali blu) dhe pjesa tjetër e deklaratave (20.1%) nuk i janë nënshtruar kontrollit doganor (kanali i gjelbër).

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të misionit të saj mbrojtës dhe të sigurisë ushtron kontrole me bazë rrisht (profilet e riskut janë efektive në sistemin ASYCUDA World prej vitit 2012) mbi importin, eksportin dhe tranzitin e lëndëve narkotike dhe prekursorëve psikotropikë të narkotikëve. Sistemi i kontrollit doganor për prekursorët e drogës, produktet kimike të rrezikshme dhe “substancat e kontrolluara” është harmonizuar me Konventën e OKB-së të vitit 1988 kundër trafikut të paligjshëm të narkotikëve dhe substancave psikotrope.

Në janar 2021, autoriteti doganor nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me policinë për të aderuar në platformën Europol SIENA dhe jemi në fazën e fillimit të trajnimit të përdoruesve të caktuar për të pasur akses në platformë për shkëmbimin e informacionit. Gjithashtu, në mars 2021, është bërë funksionale baza e të dhënave nCEN (rrjeti kombëtar i zbatimit të doganave) e Organizatës Botërore të Doganave (OBD).

Drejtoria e Hetimit, bazuar në planet e hetimit dhe autorizimet përkatëse ka ushtruar kontrole për evidentimin e subjekteve dhe personave që merren me shkeljet financiare, evazionin fiskal, kontrabandën e mallrave të akcizës ose mallrave të tjera si dhe formalizmin e tregut kryesisht në shitjen e duhanit të grirë, futjen e cigareve kontrabandë, goditjen përfundimtare të kësaj veprimtarie. Gjithashtu, edhe rastet e kapjeve të vlerave monetare në pikat doganore kufitare për periudhën raportuese, janë në vlera shumë të konsiderueshme.

Vlera e deklarimit ‘cash’ në kufi, që prej datës 25.07.2019, është 10,000 euro. Kjo është rregulluar me ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe është në linjë me Rregulloren (BE) 2018/1672 e Parlamentin

Evropian dhe e Këshillit të 23 tetor 2018 për kontrollin e parave cash në hyrje ose dalje nga Unioni, që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1889/2005.

Për sa i takon formës së deklarimit, ajo kryhet në formatin elektronik, pranë Autoriteteve Doganore, në hyrje/dalje të Republikës së Shqipërisë. Formulari deklarimit është në përputhje me Rregulloren (BE) 2018/1672 e Parlamentin Evropian dhe e Këshillit Evropian të 23 tetor 2018 për kontrollin e parave cash në hyrje ose dalje nga Unioni, që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1889/2005. Ndryshimet e ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, (shtuar me ligjin nr. 33/2019, datë 17.6.2019), parashikojnë vendosjen e sanksioneve (gjopa) nga Administrata Doganore sipas rasteve dhe shumave të caktuara kur konstatohet mosdeklarim.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021 Drejtoria e Antikontrabandës ka realizuar 2,705 kontrole, nga të cilat 323 kanë qenë të plota. Kontrollat janë realizuar në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe me organet e tjera ligj zbatuese. Gjatë kontrolleve janë konstatuar 54 raste me shkelje doganore, ku 51 janë me penalitet, me një vlerë totale: 17,545,547 Lekë.

Sistemet e Teknologjisë së Informacionit (TI)-së janë plotësisht të ndërlidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, ndërsa kushtet për akses të drejtpërdrejtë janë krijuar për policinë dhe prokurorinë, si dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

Organika e Administratës Doganore Shqiptare përcaktohet në VKM nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar dhe përbëhet në total nga 1 102 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) dhe nivel vendor (17 Degë Doganore). Nga këta 1 102 punonjës, 808 prej tyre gëzojnë Statusin e Nënpunësit Civil, ndërsa për 294 punonjës, marrëdhëniet rregullohen ndërmjet Kodit të Punës.

Aktualisht janë të punësuar 1 054 punonjës (761 nëpunës civilë dhe 293 me Kodin e Punës) dhe janë 48 vende vakante, me 5% të shkallës aktuale të vendeve të lira të punës.

Përgjatë vitit 2021 nga data 1 janar 2021 deri në 31 dhjetor 2021 janë punësuar pranë Drejtorisë së



Përgjithshme të Doganave gjithsej 52 punonjës, nga këta 41 janë nëpunës civilë sipas procedurave të parashikuara në ligjin për Shërbimin Civil dhe 11 sipas Kodit të Punës. Janë larguar 22 punonjës nga administrata doganore (me ristrukturim, në zbatim të vendimit të Gjykatës, me Komision Disiplinor, pension pleqërie, me kërkesë, transferuar në detyrë tjetër pezullim për një afat deri 2 vjet me kërkesë, për shkak të ligjit).

Gjatë vitit 2021 nga data 1 janar deri në 31 dhjetor në Komisionin Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë shqyrtuar 154 komisione disiplinore, nga të cilat 119 komisione janë zbardhur me vendimet përfundimtare nga të cilat: 1 largim nga puna, 2 largime nga shërbimi civil, 96 ndërprerje ecurie, 2 mbajtje e 1/3 pagës për 1 muaj, 3 mbajtje e 1/3 pagës për muaj 2 muaj, 2 mbajtje e 1/3 pagës për 3 muaj, 1 mbajtje e 1/3 pagës për 4 muaj, 2 mbajtje e 1/3 pagës për 6 muaj, 9 pezullime dhe 1 pezullim nga ngritja në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës së pagës për një periudhë deri dy vjet kurse 35 janë në proces përfundimi.

Gjithashtu, është kryer dhe procedura e vlerësimeve të punës për 6 mujorin e parë 2021 dhe janë përgatitur rezultatet statistikore për 637 nëpunës civilë nga 696 nëpunës në total ku diferenca janë nëpunës civil në periudhë prove.

Në total 125 punonjës janë të pajisur me certifikatë sigurie dhe 29 punonjës janë në proces certifikimi.

Në kuadër të luftës kundër korrupsionit Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale (DASP) për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2021, ka trajtuar 168 raste, denoncime/ankesa, kërkesa për informacion mbi procedurat doganore, të mbërritura nëpërmjet Numrit Jeshil të telefonit, adresës së email antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al, raste të përcjella për ndjekje nga Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion të atashuar pranë DPD ,si dhe raste të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm.

Për të gjitha rastet e trajtuara, në përfundim të verifikimeve të kryera u propozua fillimi i ecurisë disiplinore për 18 punonjës, u lanë rekomandime për strukturat e Administratës Doganore, të cilat ishin objekt kontrolli, si edhe për rastet ku ankesa nuk konsistonte në shkelje të punonjësve të ADSH, u informuan qytetarët lidhur me procedurat doganore, që ata referonin.

Pas krijimit të pozicionit të koordinatorit të rrjetit antikorrupsion në nëntor 2020, në muajin mars 2021, pas autorizimit nga Ministria e Drejtësisë, u emërua koordinatori për një periudhë dy vjeçare. Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion bazuar në VKM-në nr. 899, datë 18.11.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, mund të kërkojë asistencë nga Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale, si dhe nga strukturat e tjera doganore.

Në këtë kuadër, DASP ka patur bashkëpunim shumë të ngushtë me këtë strukturë, ku është angazhuar dhe bashkëpunuar në trajtimin e 17 rasteve/ankesave, të deleguara nga Koordinator i Rrjetit Antikorrupsion i atashuar në DPD.

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Drejtori dhe dy specialistë të Drejtorisë së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale u caktuan pika kontakti të DPD me Koordinatorin e Bashkëqeverisjes në MFE. Që nga ngritja e kësaj strukturë, referuar ligjit për Bashkëqeverisjen, kësaj periudhe janë adresuar/koordinuar brenda afateve ligjore të përcaktuara 19 raste të mbërritura në Platformën e Bashkëqeverisjes adresuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Kjo strukturë kryen në Ministrinë e Financave edhe raportimin ditor mbi ecurinë e procesit të ankesave.

Dy punonjës të Drejtorisë së Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale janë caktuar edhe Njësi Përgjegjëse për Sinjalizuesit, referuar Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm.

Pranë Laboratorit Doganor është funksional sistemi LIMS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Laboratorit).

Në periudhën 28 – 30 qershor 2021 është realizuar në Laboratorin Doganor vizita vlerësuese për fushën e akreditimit, nga ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Në shtator 2021, Laboratorit Doganor i është akorduar Certifikata e Akreditimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e gjithsej 38 treguesve analitikë.

Me plotësimin e kushteve teknike (kalibrim, mirëmbajtje e aparaturave) Laboratori Doganor do të ndjekë procedurat e nevojshme për ruajtjen e statusit si dhe zgjerimin e fushës së akreditimit për tregues të tjerë analitikë. Kapacitetet teknike dhe profesionale në lidhje me metodat analitike dhe sigurinë në laborator janë përmirësuar përmes



trajnimeve nga Organizata Botërore e Doganave. Gjithashtu, njohuritë mbi procedurat e marrjes së mostrës SAMANCTA (Manuali i marrjes së mostrave për Doganat dhe Autoritetet Tatimore) janë përmirësuar përmes trajnimeve nga DG TAXUD dhe Scian Group.

Administrata Doganore Shqiptare, gjatë vitit 2021 ka pezulluar lëshimin e mallrave të dyshuara për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale si më poshtë vijon:

- 380 palë këpucë sportive si cenuese të markave tregtare “Armani” dhe 1,420 palë këpucë sportive si cenuese të markës/ave tregtare “Adidas”, të cilat u konfirmuan nga përfaqësuesit ligjorë si cenuese të së drejtave të pronësisë intelektuale;

- 68 palë këmbisha nate si cenuese të markës tregtare “Sergio Tacchini” bazuar në procedurën ex-officio;

- 600 litra insekticid H10 (1200 cope×500ml) në bazë të një aplikimi të miratuar, të cilat u konfirmuan si cenuese të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe janë në pritje të procedurave të shkatërrimit.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit ligjorë janë shkatërruar 105 çanta/portofola Armani, 50 çanta dhe 50 palë syze Channel, 78 palë këpucë Christian Louboutin dhe 95 copë portofola Montblanc.

Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale ka koordinuar organizimin e operacioneve të përbashkëta ndërinsitucionale si dhe me strukturat brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Ajo ka zhvilluar dhe ka marrë pjesë në trajnime në fushën e pronësisë intelektuale. Përgjatë vitit 2021, janë zhvilluar trajnime teorike dhe praktike mbi përditësimin e njohurive dhe informacionit mbi legjislacionin për Pronësinë Industriale me metodën “Trajnim në punë”. Gjithashtu, janë zhvilluar edhe trajnime online për personelin doganor. Numri i stafit doganor të trajnuar në total është 110 persona në nivelin lokal.

Gjatë vitit 2021 në kuadër të projektit IPA (AL 17 IPA FI 02 20) “Support to the Albanian Customs Administration in relation to the implementation of the EU Customs Code and increase of operational capacities in the area of counterfeit goods”, u instalua sistemi Ines+ dhe janë krijuar përdoruesit për Drejtorinë e Hetimit, Drejtorinë e Antikontrabandës, Drejtorinë e Informacionit, Analizës së disa struktura doganore.

Për të rritur nivelin e informacionit janë draftuar 2 manualët e përdorimit të Ines+ të cilat do miratohen në formën e udhëzuesve për përdoruesit e sistemit. Në zbatim të kalendarit të projektit janë kryer trajnime për një total prej 86 personash i cili synon miratimin e akteve të nivelit të tretë sipas atyre të BE si dhe krijimin e një sistemi të dhënash doganore mbi kapjet, procedurat dhe shkatërrimet e mallrave cenuese si dhe implementimin e procedurës online për aplikimet që do të bëhen nga mbajtësit e së drejtës.

Më 1 janar 2021, ka hyrë në fuqi VKM nr. 1087, datë 24.12.2020 “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2021”. Aktualisht, po punohet për hartimin dhe miratimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2022, sipas versionit të NKM 2022 të BE.

Sistemi doganor “paperless” për procedurat e import-eksportit zbatohet që prej datës 16.05.2019. Aplikimet për regjime doganore (magazinimi doganor, regjimi i përpunimit aktiv, regjimi i përpunimit pasiv dhe regjimi i lejimit të përkohshëm), kryhen përmes shërbimit e-Albania.

Nga data 01 janar 2021 deri në 31 dhjetor 2021 janë zhvilluar trajnime nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Organizata të ndryshme si EXBS, CO, GIZ, OBD, UK Border Force, Kryeministria, MFE, QTATD, ASPA etj, një pjesë e të cilave janë në vijimësi. Si rezultat janë zhvilluar 69 trajnime dhe janë trajnuar 723 punonjës të Administratës Doganore. Gjatë vitit 2021 është mundësuar nga Projekti IPA 2017 hartimi i Strategjisë së Trajnimeve të Administratës Doganore Shqiptare dhe aktualisht jemi në fazën e shqyrtimit të rekomandimeve dhe procedurës së miratimit të Strategjisë brenda vitit 2022.

Lidhur me fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzetë, informacioni i detajuar jepet në kapitullin 1 “Lëvizja e Lirë e Mallrave”.

4.29.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria Kulturës;
- Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së



Informacionit (AKSHI);

- Instituti i Statistikave.

4.29.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Mangësitë e identifikuar janë:

- Projektvendimi për përcaktimin e rregullave për vendosjen e sanksioneve administrative nga organet doganore për mosdeklarimin/deklarimin e gabuar të parasë cash dhe sendeve me vlerë të çmuar në kufi nuk është miratuar akoma;

- Dispozitat e Kodit Doganor dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave për transitin e përbashkët janë në proces;

- Të intensifikojë përpjekjet për të vazhduar luftën kundër kontrabandës, korrupsionit dhe importit të produkteve të falsifikuara duke përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis organeve të përfshira;

- Të aderojë në Protokollin FCTC (Kudër Marrëveshja mbi Kontrollin e Duhanit) për të Eliminuar Tregtinë e Jashtëligjshme të Produkteve të Duhanit;

- Vendosja e “Tarifave të skanimit” për deklaraten doganore vazhdon të jetë në kundërshtim me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit e cila ndalon detyrimet doganore ose tarifatat që kanë efekt të ngjashëm në tregtinë midis BE-së dhe Shqipërisë;

- Kontrabanda ndërkuftare e produkteve të duhanit dhe aktivitete të tjera të paligjshme në rajonet kuftare vazhdojnë të jenë një fushë e rëndësishme ku nevojitet përmirësimi i mëtejshme i mjeteve të bashkëpunimit dhe ato kundër mashtrimit;

Prioritetet janë:

- Përmirësimi i procedurave doganore në mënyrë që të rritet mbledhja e efikase e detyrimeve është një nga prioritetet kryesore në këtë fushë;

- Avancimi me regjistrimin e operatorëve ekonomik të autorizuar, ndjekjes së luftës kundër kontrabandës, dhe trafikeve të paligjshme importeve të produkteve të falsifikuara dhe korrupsionit;

- Ndjekja dhe zbatimi korrekt i Ligjit Nr. 62/2019, për zhvillimin dhe zbatimin e projektit të Sportelit të Vetëm (Single Windows), Platformës NCTS (New Computerised Transit System), si dhe implementimi i Pikës së Përbashkët të Kalimit të Kufirit (me Maqedoninë

e Veriut) në Qafë Thanë;

- Implementimi i korsive të gjelbra me vendet kuftare të BE-së;

- Përmirësimi dhe shtimi i numrit të aplikimeve online për Autorizime të cilat miratohen nga Administrata Doganore nëpërmjet portalit e-albania;

- Përmirësimi dhe zhvillim i sistemit informatik doganor për deklarimin para mbërritjes së mallrave;

- Miratimi dhe publikimi zyrtar i Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave;

- Miratimi i dispozitave zbatuese të Ligjit Nr. 33, datë 17.6.2019 në lidhje me procedurat për vendosjen e sanksioneve (gjobë) nga autoriteti doganor në rastet e mosdeklarimit apo deklarimeve të rremë të parasë cash në kufi. Drafti i projekt VKM-s është përfunduar nga ana e Administratës Doganore dhe është dërguar në MFE për procedurat e mëtejshme;

- Miratimi i ndryshimeve në Kodin Doganor, Dispozitat Zbatuese, dhe miratimi i akteve të nivelit të tretë në zbatim të tyre, duke përfshirë këtu dispozitat për transitin e përbashkët;

- Lufta kundër shkeljeve ndaj pronësisë intelektuale në doganë, sistemit të menaxhimit të riskut sipas modeleve të harmonizuara të menaxhimit të riskut të BE-së, si dhe bashkëpunimit aktiv me partnerët kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Konkretisht, Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale (DMPI) në bazë të strategjisë kombëtare të Pronësisë Intelektuale që pritet të miratohet dhe planit të veprimit të Strategjisë do të:

- Forcojë kapacitetet administrative nëpërmjet trajnimeve online dhe në terren, duke përditësuar kurrikulat aktuale të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe zbatimin në terren të njohurive të përfuara;

- Rritjen e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet instrumenteve të operacioneve të përbashkëta, task force etj.;

- Përmirësimi i strukturës, disponueshmeria dhe sistematizimi i të dhënave statistikore duke rritur përdorimin e sistemit Ines + si dhe transparenca e tyre;

- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale;



- Ndërmarrja e aktiviteteve për të përmirësuar imazhin publik dhe reputacionin e doganave. Aktivitetet dhe veprimet në fushën e luftës kundër korrupsionit do të forcohen dhe zbatohen;

- Ndërlidhja me sistemet dhe standardet e TI të BE-së, përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI;

- Zhvillimi i një cikli trajnimesh në degët doganore si dhe online me qëllim rritjen e kapaciteteve administrative në bashkëpunim edhe me QTATD për sa i përket çështjeve të pronësisë intelektuale.

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

4.30.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni direkt detyrues i BE-së i cili nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar. Ky legjislacion i BE-së rezulton nga angazhimet tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe të BE-së, si dhe nga një numër masash autonome preferenciale tregtare. Në fushën e ndihmës humanitare dhe politikës së zhvillimit, Shtetet Anëtare duhet të zbatojnë legjislacionin e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë aftësinë për të marrë pjesë në politikat e zhvillimit dhe humanitare të BE-së. Vendet aplikuese u kërkohej të harmonizojnë në mënyrë progresive politikat ndaj vendeve të treta dhe pozicionet brenda organizatave ndërkombëtare në lidhje me politikat dhe pozicionet e miratuara nga Bashkimi dhe Shtetet Anëtare të tij.

4.30.2 Struktura e kapitullit

- Politika tregtare;

- Bashkëpunimi për zhvillim dhe ndihma humanitare.

4.30.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70-të i MSA-së, dispozitë nga e cila Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së, por edhe të sigurohet që ajo të zbatohet.

Marrëveshja Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një titull kryesor mbi tregtinë e lirë mes Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas

përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmbledhur janë nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull, si: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74 dhe 97.

Legjislacioni në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga zbatimi i drejtpërdrejtë i legjislacionit të BE-së, i cili nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

Acquis në këtë fushë është produkt kryesisht i angazhimeve tregtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të Bashkimit Evropian si dhe i një sërë masash autonome tregtare. Në fushën e kredive të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, disa elementë të *acquis* kërkojnë përgatitje më të hershme për të pasur një administratë plotësisht të aftë që nga dita e anëtarësimit. Vendeve kandidate u kërkohej të harmonizojnë në mënyrë graduale politikat tregtare ndaj vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare, me politikat dhe qëndrimet e miratuara nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet Anëtare të tij, në mënyrë që të jenë në gjendje të zbatojnë politikën e përbashkët tregtare të BE-së në datë e anëtarësimit. Në fushën humanitare dhe të zhvillimit, Shtetet Anëtare duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe me angazhimet ndërkombëtare të BE-së si dhe të sigurojnë kapacitetet për të marrë pjesë në zhvillimet dhe politikat humanitare të Bashkimit Evropian.

4.30.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Situata aktuale në Shqipëri

Për sa i përket *acquis* për marrëdhëniet me jashtë, Shqipëria ka një nivel të mirë përgatitjeje. Pas kryesimit me sukses të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) nga Shqipëria në vitin 2019, **është bërë përparim i mirë** në adresimin e rekomandimeve të raportit të vitit 2020. Ky vlerësim është më i lartë se i vitit 2020.

Megjithatë, disa nga rekomandimet e vitit 2021 mbeten të njëjta me ato të vitit 2020: Vazhdimi i zbatimit të Planit Kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare; miratimi i legjislacionit përkatës në fushën e kontrollit të eksporteve të mallrave me përdorim të dyfishtë; zbatimi i planit shumëvjeçar të veprimit për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale, veçanërisht zbatimi i Protokollit 5 të CEFTA-s mbi Lehtësimin e Tregtisë dhe negocimi dhe



përfundimi i shpejtë Protokollit 7 të CEFTA-s mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Rekomandimet e reja përfshijnë: përfundimin e negociatave dhe miratimin e Protokollin Shtesë 7; vazhdimin në zbatimin e veprimeve sipas planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR) 2021 – 2024 për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale; përfshirjen dhe njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale; lehtësimin e tregtisë së shërbimeve të ofruara nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë në lidhje me heqjen e kërkesave për leje pune për aktivitete profesionale referuar Protokollit Shtesë 6 dhe promovimin e tregtisë elektronike; si dhe vazhdimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit në fushën e Investimeve.

Për sa i përket **politikës së përbashkët tregtare**, Shqipëria vazhdoi të bashkërendojë pozicionet dhe të bashkërendojë politikat e saj ngushtësisht me ato të BE-së, duke përfshirë dhe politikat brenda Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) për sa i përket Memorandumit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve (DSU), mekanizmat e propozuar të DSU dhe Deklaratën e Përbashkët për Rregulloren e Brendshme të Shërbimeve.

Shqipëria ka ratifikuar Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë me OBT-në dhe ka notifikuar listën e saj të angazhimeve. Për shkak masave të marra gjatë krizës COVID-19, në mars 2020, Shqipëria miratoi urdhrin Nr. 131, datë 08.03.2020 “Për ndalimin e eksportit të barnave dhe pajisje mjekësore” i cili është shfuqizuar me Urdhrin Nr. 324 datë 06.07.2021 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Shqipëria bashkëpunon me vendet e OTAWA Group për përgatitjen e nismës së OBT-së për tregtinë dhe shëndetin në kuadër të përpjekjet globale për të luftuar situatën e pandemisë.

Grupi ndërinstitucional i Koordinimit të Politikës Tregtare dhe Lehtësimit të Tregtisë, i krijuar tashmë, është rikompozuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 104 datë 07.08.2020, po punon dhe në aspekt të rëndësishëm të lehtësimit të tregtisë, për t’iu përgjigjur zhvillimit intensiv të CEFTA-s për zbatimin e Protokollit Shtesë 6 “Për Tregtinë e Shërbimeve”. Ky grup ndërinstitucional ka përfshirë përfaqësues të biznesit nga sektori i turizmit dhe përfaqësues të biznesit të përpunimit të qumështit.

Shqipëria po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006), shteteve të EFTA-s, Turqisë dhe së fundmi Marrëveshjen e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Protokollit i rregullave preferenciale të origjinës me Turqinë është ende në proces.

Në fushën e kontrollit të eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë.

Korniza ligjore përbëhet nga Ligj Nr. 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, që përaftron pjesërisht Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 428/2009 datë 5 maj 2009, “Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të mallrave me përdorim të dyfishtë”.

Bashkimi Evropian ka miratuar Rregulloren e re (BE) 2021/821 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 20 Majit 2021 “Mbi vendosjen e një regjimi komunitar për kontrollin e eksportit, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të mallrave me përdorim të dyfishtë”, për këtë qëllim, Autoriteti i kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), do të nisi konsultimet me partnerët e BE-së për të identifikuar të rejtat e kësaj rregulloreje si dhe për të parashikuar afatin e transpozimit të këtyre ndryshimeve.

Legjislacioni që ka të bëjë me Rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 16.1.2019 “Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese” i ndryshuar është në proces hartimi dhe synohet të përafrohet plotësisht nga projektligji “Për tregtimin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese” dhe projektvendimi “Për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues”.



Projektligji gjatë vitit 2021 u konsultua me shërbimet e Komisionit Evropian dhe u reflektuan amendimet dhe sugjerimet e Komisionit në projekt draft. Ky projektligj parashikohet të miratohet brenda vitit 2022.

Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit ekonomik dhe teknik, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar më shumë se 120 marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik me vende të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe, janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi disa marrëveshje mbi bashkëpunimin ekonomik dhe/ose tregtar me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Turqinë.

Deri më tani, Republika e Shqipërisë ka nënshkruar 46 marrëveshje investimi dypalëshe, marrëveshje të cilat ndikojnë në investimet e huaja dhe mbrojtjen reciproke të tyre në vend, nga të cilat 23 janë nënshkruar me shtetet anëtare të BE-së. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve janë: Austria, Azerbajxhani, Unioni Ekonomik Belgjikë-Luksemburg, Bosnje dhe Hercegovina, Bullgaria, Kina, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Emiratet e Bashkuara Arabe, Egjipti, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Izraeli, Italia, Korea, Kuvajti, Kosova, Lituania, Maqedonia, Malajzia, Malta, Moldavia, Holanda, Polonia, Portugalia, Katari, Rumania, Federata Ruse, San Marino, Serbia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Tunizia, Turqia, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Sa i takon marrëveshjeve në proces, Shqipëria ka në proces negociimi projekt marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite mbi nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve. Pala shqiptare ka dërguar qëndrimin e saj përmes rrugëve diplomatike dhe është në pritje të komenteve nga ana e Arabisë Saudite. Kjo Marrëveshje është në proces.

Në fushën e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare, Shqipëria nuk ka ende një kuadër politik ose ligjor, si dhe asnjë institucion apo njësi specifike për menaxhimin e ndihmës për zhvillim apo ndihmave humanitare. Ai siguron ndihmë humanitare vetëm në baza ad-hoc si përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore të rënda ose situatave të jashtëzakonshme humanitare. Kjo

ndihmë jepet drejtpërdrejtë në mbështetjen përkatëse të buxhetit të shtetit. Ligji i vitit 2001 për Organizatat Jo-Fitimprurëse njeh aktivitetet e mundshme të organizatave të tilla në fushën e ndihmave humanitareve dhe i lejon ata të kryejnë veprimtari zhvillimi dhe ndihme humanitare në Shqipëri dhe diku tjetër.

Përmbledhje e arritjeve kryesore

Pas kryesimit të suksesshëm të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) nga Shqipëria në vitin 2019, është bërë progres i mirë në adresimin e rekomandimeve të raportit të vitit 2020. Shqipëria miratoi dhe ratifikoi Protokollin Shtesë të CEFTA-s (AP) 6. Puna gjithashtu përparoi për zgjerimin e Korsive të Gjelbërta/Korridoreve me Shtetet Anëtare të BE-së. Progres është arritur edhe në rritjen e politikës tregtare lidhur me kapacitetet administrative dhe aktivitetet e komitetit kombëtar të lehtësimit të tregtisë nga krijimi i një njësie të dedikuar tregtare. Shqipëria miratoi listën e saj kombëtare të kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë në përputhje me acquis të BE-së. Për më tepër, Shqipëria miratoi edhe ndryshimet në MSA mbi përditësimet mbi rregullat preferenciale të origjinës së Konventës pan-Euro-Mesdhetare në lidhje me përcaktimin e konceptit të “produkteve origjinuese” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ.

Shqipëria ka vazhduar fushatën e saj ndërgjegjësuere me përfaqësues të sektorit privat në lidhje me procedurat dhe përfitimet e aplikimit për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (OEA) dhe ka regjistruar 12 aplikime nga bizneset vendase. Katër operatorët e parë ekonomikë të autorizuar janë certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe kanë filluar përgatitjet për njohje reciproke nga palët e CEFTA-s. Shqipëria vazhdoi të punojë në përputhje me angazhimet e saj në kuadër të Planit Shumëvjeçar të Veprimit të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale (REA). Qeveria krijoi një mekanizëm për zbatimin dhe monitorimin e REA dhe më vonë, të Tregut të Përbashkët Rajonal. Gjithashtu, është punuar në drejtim të lehtësimit të tregtisë elektronike rajonale dhe në drejtim të njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale, duke filluar nga inxhinierët e ndërtimit si dhe në krijimin e një grupi pune për liberalizimin e tregtisë në sektorin e turizmit. Së bashku me palët e tjera të CEFTA-s, Shqipëria ka punuar për zgjerimin e



korsive/korridoreve të gjelbërta me shtetet anëtare të BE-së, përkatësisht me Greqinë në pikën kufitare Kapshticë – Kakavijë; ka përgatitur dhe dërguar në Sekretariatën e CEFTA-s listën prioritare të produkteve farmaceutike, vaksinave dhe testit për COVID që do të kalojnë nëpër korridoret e gjelbra. Është bërë përpjekje për të reduktuar kohën e pritjes në pikat kufitare të kamionëve dhe për të harmonizuar orarin e punës së gjitha autoriteteve inspektuese me palët fqinje CEFTA. Aktualisht, autoritetet shqiptare po shqyrtojnë një projekt pilot për zgjerimin e korridoreve të gjelbra midis portit të Durrësit dhe atij italian të Ankonës.

Në zbatim të Planit të Veprimit për Krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal, Shqipëria ka miratuar projektvendimin Për miratimin në parim të Vendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore “Për lehtësimin e Tregtisë Elektronike” – VKM 550 datë 29.9.2021.

Progresi i arritur veçanërisht në transparencën rregullatore, përmirësimin e konsultimeve publike në hartimin e politikave tregtare dhe zhvillimin dhe koordinimin e politikave tregtare. Mekanizmi i koordinimit ndërinstitucional të ekonomisë është forcuar përmes miratimit të rregullave dhe procedurave të reja për Komitetin Kombëtar të Lehtësimit të Tregtisë (NTFC).

Bazuar në Urdhrin e Kryeministrit Nr. 104/2020, është krijuar Sekretariati Teknik me përfaqësues të sektorit të Tregtisë në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe të administratës doganore. Deri më tani, janë mbajtur dy takime online të NCTF, përkatësisht në dhjetor 2020 dhe mars 2021 dhe një takim me prezencë më 22 tetor 2021. Plani Kombëtar i Lehtësimit të Tregtisë 2021–2023 u miratua më 30 qershor 2021, që përmban jo vetëm detyrimet për lehtësimin e tregtisë sipas Marrëveshjes CEFTA por edhe masat për adresimin e çështjeve të ngritura nga përfaqësuesit e biznesit. Faqja e internetit e NCCLTT është funksionale (<http://tregtia.gov.al/index.php/sq-al/>).

Në kuadër të procesit të rishikimit dhe ndryshimit të rregullave të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mesdhetare, nga Palët Kontraktuese, Shqipëria ka përfunduar procesin e ndryshimit të protokolleve në lidhje me përcaktimin e konceptit të produkt

originues dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, duke zëvendësuar protokollet përkatëse për marrëveshjet e tregtisë së lirë që Shqipëria ka me BE-në dhe shtetet anëtare të saj, CEFTA, EFTA, me një sërë rregullash alternative të origjinës bazuar në ato të Konventës së ndryshuar. Këto rregulla janë fakultative. Ato synohen të zbatohen në baza provizore, në pritje të përfundimit dhe hyrjes në fuqi të amendamentit të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mesdhetare (Konventa PEM ose Konventa).

1. Ligji Nr. 98/2021 datë 07.07.2021 “Për ratifikimin e Vendimit Nr. 1/2021, i Këshillit të Stabilizim Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri, që ndryshon Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe Shteteve Anëtare të tyre, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, duke zëvendësuar Protokollin 4 të saj, në lidhje me përcaktimin e konceptit “produkte me origjinë” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ”

2. Ligji Nr. 101/2021 datë 7.07.2021 “Për ratifikimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore Nr. 1/2021, i miratuar më 21.6.2021, duke amenduar Aneksin 4 të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006), e cila përcakton Protokollin që përcakton konceptin e “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, të përmendura në nenin 14., paragrafët 1 dhe 3, dhe i cili shfuqizon dhe zëvendëson vendimin Nr. 3/2013 dhe vendimit nr. 3/2015, i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore”

3. Ligji Nr. 99/2021 datë 07.07.2021 “Për ratifikimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët EFTA-Shqipëri nr. 1, datë 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet vendeve EFTA dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përcaktimin e konceptit “produkte me origjinë” dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, si dhe ndryshimin e marrëveshjet për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj”.



Shqipëria tashmë po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e MSA-së) midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendeve të Evropës Lindore (CEFTA 2006), vendeve të EFTA-s dhe Turqisë. Shqipëria, në kuadër të Kryesimit të Marrëveshjes CEFTA për vitin 2019, ka kontribuar në mënyrë konstruktive duke miratuar në parim dy dokumente të rëndësishme:

- Vendimin për njohjen e përbashkët për statusin AEO;
- Protokollin Shtesë 6 mbi tregtinë në shërbime. Këto dokumente do të hynë në fuqi pasi të miratohen në Komitetin e Përbashkët Ministerial.

Negociatat mbi liberalizimin e tregtisë në shërbime janë përfunduar. Në mbledhjen e Komitetit të Përbashkët Ministror të CEFTA më datë 18 dhjetor 2019 u miratua Protokollin Shtesë 6 “Tregtia në Shërbime”.

Të dy dokumentat:

- Vendimin për njohjen e përbashkët të programeve për marrjen e statusit AEO; dhe
- Protokollin Shtesë 6 mbi tregtinë në shërbime janë në fazën e zbatimit të tyre.

Në lidhje me Protokollin Shtesë 7, është avancuar me negociatat dhe janë zhvilluar 7 raunde të tilla, ku Shqipëria mbrojtur interesat e saj në lidhje me çështje si buxheti, përbërja e paneleve dhe dhe përgatitja e raporteve, hyrja në fuqi dhe zbatimi i protokollit. Negociatat do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2022 me synimin e konkludimit të tekstit nga pikëpamja teknike.

Gjithashtu, gjatë Komitetit të përbashkët ministror, i cili përmbylli dhe Kryesimin e Shqipërisë në CEFTA u miratuan Vendimet e mëposhtme:

- Vendimi mbi njohjen reciproke të statusit AEO; si dhe
- Strategjia e Menaxhimit të Riskut në dogana.

Në lidhje me zbatimin e angazhimeve për AEO, janë zhvilluar fushata sensibilizimi me përfaqësuesit e biznesit dhe dhomat e tregtisë në lidhje me kërkesat për autorizime për OEA. Si rezultat i kësaj fushate kemi 9 kërkesa për autorizim për OEA, të cilat janë në proces të shqyrtimit dhe kompletimit të dokumentacionit. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është ngritur grupi i punës për të marrë në shqyrtim aplikimet e Operatorëve Ekonomik për OEA-të me qëllim

verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të parashikuara nga kuadri ligjor e nën ligjor në fuqi. Është bërë një plan kontrolli për 4 kompani nga data 28.09.2020 deri më 18.10.2020.

Në fushën e kontrollit të eksportit për artikujt me përdorim të dyfishtë, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes është struktura përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për mallrat me përdorim të dyfishtë.

Aktualisht janë miratuar:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 668 datë 10.11.2021 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, objekt i kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare” që përafron plotësisht Aneksin 1 të Rregullores e Parlamentit Evropian dhe Këshillit (BE) 2021/821, datë 20 Maj 2021, “Për krijimin e një regjimi komunitar për kontrollin e eksporteve, transferimeve, ndërmjetësimeve dhe transiteve të artikujve me përdorim të dyfishtë”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.31 datë 22.01.2020 “Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si përcaktimin e procedurave lidhur me lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror”.

Ky vendim ka miratuar:

- statusin, organizimin, përbërjen dhe funksionimin të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve;

- afatet, mënyrën dhe të procedurën për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara;

- procedurat për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror.

Shqipëria së fundi, ka miratuar dhe nënshkruar disa Marrëveshje dhe Memorandume dhe Protokolle, bashkëpunimi ekonomik e teknik, specifikisht:

- Marrëveshja e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së



Madhe dhe Irlandës Veriore, u nënshkrua në Tiranë, më 5 shkurt 2021. Kjo Marrëveshje u ratifikua nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin 31/2021, datë 8 Mars 2021;

- Memorandumi i Mirëkuptimit midis “Ministrit të Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrit të Tregtisë të Republikës Popullore të Kinës për Themelimin e Grupit të Punës të Bashkëpunimit për Investime të Përbashkëta”, u nënshkrua në Tiranë dhe Pekin, më 8 shkurt 2021;

- Protokollin e Sesionit të 8-të Komisionit të Përbashkët për Bashkëpunim Ekonomik Shqipëri – Austri, nënshkruar në Tiranë, më 6 tetor 2021

Në vijim, është zhvilluar Sesion i 3-të i Komisionit të Përbashkët Ekonomik Shqipëri-Hungari, parashikuar të zhvillohet në Budapest, më 15 – 16 nëntor 2021;

Në vijim gjatë vitit 2022, janë parashikuar për t'u zhvilluar Sesionet e mëposhtme:

- Sesion i 4 i Komitetit të Përbashkët të Ekonomisë Shqipëri – Arabi Saudite, parashikohet të zhvillohet në nivel Ministri në datat 13 – 14 dhjetor 2021, në Riad.

- Sesion i Komitetit të Përbashkët të Ekonomisë Shqipëri – Egjipt në nivel Ministri

Në kuadër të zbatimit të axhendës rajonale të reformës së investimeve (RIRA), në bashkëpunim me IFC/WB është hartuar me ekspertët e BB, edhe një model i BIT për Shqipërinë, që është ende në fazën e diskutimeve të brendshme, për të vijuar me miratimin final.

Miratimi në vitin 2015 i Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm siguron një kornizë të unifikuar politike të nevojshme për të mundur të bëjmë zgjedhjet e duhura; për të kapërcyer krizat; dhe për të krijuar një botë të qëndrueshme. Me një parim të qartë se të gjithë qytetarët (duke mos lënë askënd pas) duhet të përfshihen në zhvillimin e qëndrueshëm nëpërmjet arritjes së 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG) dhe 169 synimet e tyre themelore, duke marrë parasysh faktin që Shqipëria është përpara hapjes së negociatave me BE-në, OZHQ/SDG-të duhet të konsiderohen gjithashtu nën perspektivën e Integritimit në BE.

Në mënyrë që të sinkronizohet vizioni 2030 me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI) dhe të sigurohet sinergji të të dy

proceseve, kërkohen përpjekje të mëtejshme për të integruar OZHQ/SDG në SKZHI (III), si dhe strategjitë e sektorëve përkatës, politikat dhe planet kombëtare. Një proces planifikimi për hartimin e SKZHI III, i filluar tashmë, synon të përgatisë vizionin afatmesëm për kornizën e planifikimit strategjik të Shqipërisë duke përfshirë kornizën OZHQ/SDG-ve në proces. Planifikohet që Vizioni 2030 të projektohet dhe prezantohet së bashku me SKZHI III.

4.30.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (si përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri);

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; dhe çdo ministri apo institucion që ndikon në tregti;

- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Ministria për Evropën dhe Punëve të Jashtme;

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

- Ministria e Mbrojtjes;

- Ministria e Brendshme;

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

- Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

- Banka e Shqipërisë;

- Autoriteti i Konkurrencës;

- Agjencia e Prokurimit Publik;

- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave Tregtare;

- Insitituti i Statistikave.

4.30.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Në fushën e politikës së përbashkët tregtare:

Mangësitë e identifikuara:

Aktualisht, Shqipëria ka një njësi të vogël të dedikuar që merret me çështjet tregtare në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik. Janë bërë disa përpjekje për të forcuar kapacitetet administrative për politikën tregtare duke krijuar një njësi tregtare, e cila përbëhet nga një drejtues njësie dhe dy ekspertë, si pjesë e Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Ekonomik. Njësia merret me politikat tregtare, duke përfshirë BE-në, CEFTA-n dhe OBT-në, nën mbikëqyrjen e drejtorit të drejtorisë së zhvillimit ekonomik. Dy ekspertë të njësive tregtare së bashku me një ekspert nga drejtoria e doganave formojnë



Sekretariatit Teknik të Komitetit Kombëtar për Politikën dhe Lehtësimin e Tregtisë. Duke marrë parasysh ngarkesën e lartë që po përballon kjo njësi, rëndësia e çështjeve që kanë të bëjnë me mbulimin e tregtisë së mallrave, shërbimeve, aspekteve të lidhura me tregtinë e pronësisë intelektuale, prokurimit publik, tregtisë dhe zhvillimit, tregtisë dhe mjedisit, si dhe marrëdhëniet e zgjeruara që kjo njësi ka me BE-në, CEFTA-n, OBT-në, UNCTAD-in, ITC-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare dhe marrëdhëniet tregtare dypalëshe me vendet e tjera është shumë e rëndësishme që njësi të bëhet një drejtori e përbërë me disa njësi.

Prioritetet në këtë fushë janë:

Në rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021, Shqipëria duhet të:

- vazhdimi i zbatimit të planit kombëtar të veprimit për koordinimin dhe lehtësimin e politikave tregtare dhe forcimin e kapaciteteve administrative;

- vazhdimi i harmonizimit të legjislacionit përkatës me *acquis* në fushën e kontrollit të eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë;

- të përfundojë negociatat dhe më pas të miratojë CEFTA AP 7;

- vazhdimi i zbatimit të veprimeve në kuadër të planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021 – 2024 për zhvillimin e Zonës Ekonomike Rajonale, me qëllim arritjen e integritetit ekonomik të rajonit në lidhje me 4 liritë: Lëvizja e lirë e mallrave, lëvizja e lirë e shërbimeve, lëvizjen e lirë të njerëzve dhe lëvizjen e lirë të kapitalit;

- Intensifikimi i bashkëpunimit përmes iniciativës “Open Balkan”;

- vazhdimi i zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Investime.

Në vijim, referuar prioritetet:

- Shqipëria do të punojë jo vetëm për të rritur dhe forcuar kapacitetet e saj në lidhje me formulimin e politikave tregtare, por edhe për të zhvilluar më tej ato ekzistuese;

- Shqipëria bën një analizë për të zgjeruar njësinë në drejtori me përcaktim të saktë të përgjegjësisë, detyrave dhe funksioneve.

- Shqipëria do të vazhdojë të koordinojë pozicionet e saj dhe t'i përafrojë plotësisht politikën e saj me ato të BE-së, përfshirë edhe ato në kuadër të OBT-së;

- Shqipëria do të sigurojë nivelin ekzistues të koordinimit dhe do të forcojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e përfshira në formulimin e politikave tregtare. Shqipëria ka vazhduar të bëjë notifikimet e kërkuara sipas neneve 1.4, 10.6.2 dhe 12.2.2 të Marrëveshjes së OBT-së për Lehtësimin e Shkëmbimeve Tregtare.

Në fushën e mallrave me përdorim të dyfishtë:

Mangësitë e identifikuara:

- Me miratimin e projektligjit “Mbi tregtimin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese”, do të nisë puna për miratimin e Projektvendimit “Për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues”, brenda vitit 2022.

Prioritetet në këtë fushë janë:

- Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit për kontrollin e eksporteve, transferimit, ndërmjetësimit dhe transitit të artikujve me përdorim të dyfishtë dhe në Listën Ushtarake të Përbashkët të Bashkimit Evropian (Rregullorja e BE 2017/2268) u ndoq nga Vendimi i marrë nga Qeveria në muajin shkurt. Shqipëria ka miratuar tashmë listën kombëtare të kontrollit të mallrave me përdorim të dyfishtë në përputhje me aktet normative të BE;

- Përditësimi i listës së mallrave me përdorim të dyfishtë është prioritet i realizuar për vitin 2021, por mbetet për tu ndjekur sipas ndryshimeve që do të miratojë BE-ja;

- Transpozimi i legjislacionit me aktet normative të BE-së përsa i përket tregtisë së mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose ndëshkim dhe trajtim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues.

Në lidhje me marrëveshjet dypalëshe me vende të treta:

Mangësitë e identifikuara:

Forcimi i strukturave institucionale dhe administrative të kërkuara për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 1219/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 12 dhjetor 2012, për krijimin e aranzhimeve kalimtare për marrëveshjet dypalëshe të investimeve midis shteteve anëtare dhe vendeve të treta.

Prioritetet në këtë fushë janë:

- Prioritet është hartimi i një modeli shqiptar BIT: Statusi: Modeli BIT për Shqipërinë është hartuar me ekspertë të BB, por është ende në fazën



e diskutimeve të brendshme, për të vazhduar me miratimin final;

- Rishikimi i BIT-ve ekzistues me vendet e treta, me të cilat BE-ja nuk ka mandat për të negociuar dhe do të mbetet në fuqi pas datës së pranimit;

- Negociatat për ndryshimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë vazhdojnë, duke u fokusuar në përfshirjen e specifikimeve që lidhen me tregtinë në shërbime dhe investime;

- Zbatimi i një plan veprimi shumëvjeçar për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor; pas rakordimit nga të gjitha vendet WB6 do të vijohet me ndjekjen e procedurave ligjore të mëtejshme për adaptimin zyrtar të standardeve rajonale të pranuar nga WB6, për negociimin e IIA-ve, bazuar tek RIRA.

Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare:

Mangësitë e identifikuar:

- Shqipëria nuk ka kuadër të politikave zhvillimore për bashkëpunim/ndihmë apo agjenci për bashkëpunimin zhvillimor.

- BE rekomandon të krijohet një kornizë ligjore që të mbulon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe politikat e zhvillimit, si dhe ndihmën humanitare ndaj vendeve jo anëtare të BE-së, në përputhje me politikat dhe parimet e BE-së.

- Ligji i vitit 2001 për Organizatat Jofitimprurëse njihet aktivitetet e mundshme të këtyre organizatave në fushën e ndihmës humanitare dhe i lejon ato të kryejnë aktivitete zhvillimore dhe ndihme humanitare në Shqipëri dhe gjetkë.

Prioritetet në këtë fushë janë:

- Prioritet është miratimi i një dokumenti politikash për të trajtuar çështjet e krijimit të strukturës strategjike, ligjore dhe institucionale në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e BE-së.

KAPITULLI 31: POLITIKA E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

4.31.1 Përmbajtja e kapitullit

Vendet anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialogun politik në përputhje me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes së BE-së, të linjëzohen me Deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të aplikojnë sanksionet dhe masat kufizuese të dakordësuara. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) dhe Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP) bazohen në akte juridike,

përfshirë marrëveshje ndërkombëtare detyruese dhe në dokumente politike. Acquis përbëhet nga deklarata, veprime dhe marrëveshje politike.

4.31.2 Struktura e kapitullit

1. Dialogu Politik.

2. Bashkëpunimi me Organizatat

Ndërkombëtare.

3. Kontrolli i Armëve.

4. Zbatimi i Masave Kufizuese dhe Sanksioneve Ekonomike.

5. Lufta kundër Terrorizmit.

6. Politika Evropiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

4.31.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit që në preambul të saj thekson dëshirën e përbashkët për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje dypalëshe dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale, duke pasur parasysh Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian.

Neni 8 “Dialogu Politik” përcakton se dialogu politik ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian zhvillohet më tej brenda kontekstit të MSA-së dhe do të zhvillohet në drejtim të konsolidimit të marrëdhënieve ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe do të kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit.

Pika 3 e nenit 8 në pjesën “Dialogu Politik” përcakton se Shqipëria dhe BE bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të mjeteve për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet respektimit të plotë dhe zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të tyre ekzistuese, detyrime këto që rrjedhin nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare për çarmatimin dhe mospërhapjen, si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare.

Neni 12 “Bashkëpunimi Rajonal” përcakton se në përputhje me angazhimet e saj për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar e rajonal, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Shqipëria duhet të promovojë bashkëpunimin rajonal në mënyrë aktive.

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit të klasifikuar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh nga neni 70 i MSA-së.

Ndërkohë, Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (CFSP) e Bashkimit Evropian u krijua



nga Traktati për Bashkimin Evropian (TEU) në 1993 me qëllim ruajtjen e paqes, forcimit të sigurisë ndërkombëtare, promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, konsolidimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Traktati i Lisbonës, i cili hyri në fuqi më 1 janar 2009, i dha Unionit personalitet juridik dhe një strukturë institucionale për shërbimin e tij të jashtëm si dhe eliminoi strukturën e shtyllave të prezantuar nga TEU në 1993. Traktati krijoi një sërë aktorësh të rinj CFSP, duke përfshirë Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, krijoi Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) dhe përmirësoi Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP), e cila përbën një pjesë integrale të CFSP.

Baza ligjore për CFSP u përcaktua në TBE dhe u rishikua në Traktatin e Lisbonës. Nenet 21-46, Titulli V, i TEU-së përcaktojnë “Dispozitat e Përgjithshme mbi Veprimin e Jashtëm të Bashkimit dhe Dispozitat Specifike mbi Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP)”. Nenet 205 – 222, Pjesa V e Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) mbulojnë veprimin e jashtëm të Bashkimit.

4.31.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Për sa i përket politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, Shqipëria ka një nivel të mirë përgatitjeje. Vendi mbajti kryesimin e OSBE-së në vitin 2020 dhe u zgjodh anëtar jo i përhershëm i Këshillit të Sigurimit të OKB-së për mandatin 2022/2023, duke demonstruar përkushtim ndaj bashkëpunimit shumëpalësh. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në misionet dhe operacionet e BE-së për menaxhimin e krizave dhe të përafrohet plotësisht me të gjitha qëndrimet e BE-së si dhe të zbatojë masat kufizuese të saj, pavarësisht presionit në rritje nga aktorët jashtë BE-së. Shqipëria ka bërë njëfarë progresi duke bërë funksionale pikën fokale për armët e zjarrit në Policinë e Shtetit dhe duke përfunduar përmirësimet e sigurisë të objekteve të ruajtjes së armatimit dhe municionit.

Bashkëpunimi me Organizatat Ndërkombëtare

Shqipëria ka vijuar pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare. Më 11 qershor 2021 Shqipëria u zgjodh për herë të parë anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit për mandatin

2022 – 2023. Gjithashtu, që nga 1 janari 2021 deri në 31 dhjetor 2021, Shqipëria është pjesë e Trojkës së OSBE-së për vitin 2021, si dhe prej 1 janarit të po këtij viti kryeson Grupin e Partneritetit Aziatik për Bashkëpunim të OSBE-së, i cili shërben si forumi kryesor për dialog të rregullt midis Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe Partnerëve Aziatikë (Japonia, Australia, Tailanda, Afganistani dhe Koreja e Jugut) duke qenë se siguria në zonën e OSBE-së është e lidhur me sigurinë në Azi dhe Paqësor.

Nga 1 qershori 2021 deri në 31 maj 2022, Shqipëria kryeson presidencën e Strategjisë EUSAIR dhe të Nismës Adriatiko-Joniane (NAJ). Në këtë kuadër, gjatë muajit shtator 2021, u rakordua me shërbimet e Komisionit Evropian si dhe me përfaqësuesit e Nismës Adriatiko-Joniane, projekt programi dhe projekt kalendar i hartuar nga Qeveria Shqiptare për Presidencën 2021 – 2022. Këto dy dokumente të rakorduara midis palëve u prezantuan gjatë takimit të Bordit Drejtues të EUSAIR në datat 18 – 19 tetor 2021 dhe morën mbështetjen e të gjithë vendeve pjesëmarrëse të Strategjisë EUSAIR. Presidenca shqiptare do të fokusohet në disa fusha si: rinia dhe gjithë përfshirja, turizmi dhe kultura, promovimi i procesit të Integritetit Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërlidhja, digjitalizimi, etj. Një ndër iniciativat kryesore nën presidencën shqiptare do të jetë dhe fillimi i punës për rishikimin e kësaj Strategjie, duke marrë parasysh zhvillimet e viteve të fundit, kryesisht lidhur me pandeminë. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë do të ketë dhe ndërlidhja e perspektivës financiare 2021 – 2027 me objektivat e Strategjisë, si dhe identifikimi i instrumenteve të mundshëm të financimit në kuadër të fondeve ESIF dhe IPA III, të cilat do të mundësonin financimin e një sërë projektesh në katër shtyllat kryesore të EUSAIR.

Ministria e Mbrojtjes është e angazhuar në iniciativën rajonale Ministeriali për Mbrojtjen e Evropës Juglindore, i cili përfshin Iniciativën e Forcës Shumëkombëshe për Paqe-ruajtje në Evropën Juglindore dhe Brigadën e Evropës Juglindore si dhe një sërë projektesh të tjera. Gjatë periudhës 2019 – 2021 Ministria e Mbrojtjes drejtoi këtë iniciativë dhe e dorëzoi zyrtarisht në muajin korrik 2021. Drejtimi i saj ndikoi në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e rolit dhe vizibilitetit të vendit tonë në rajon.



Brenda kornizës së NATO-s, Forcat e Armatosura Shqiptare dhe personeli civil i Ministrisë së Mbrojtjes kanë marrë pjesë në disa misione dhe operacione. Konkretisht në Forcën Ndërkombëtare të Ndihmës së Sigurisë (ISAF) / Misionin e Mbështetjes së Vendosur (RSM) në Afganistan, përfunduar në gusht 2021; në praninë e përparuar të NATO-s (eFP) në Letoni, i cili vijon si kontribut; në aktivitetet e NATO-s në Detin Egje, përfunduar në 2019; në misionin “Liria e Irakut” dhe më pas në misionin e NATOS “NATO TRAINING MISSION” në Irak, përfunduar në 2011; operacionet e IFOR dhe SFOR të drejtuara nga NATO në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe në operacionin e udhëhequr nga NATO, KFOR në Kosovë, i cili vijon si kontribut dhe në Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT) në Kosovë, i cili po ashtu vijon si kontribut.

Brenda kornizës së OKB, Forcat e Armatosura Shqiptare kanë marrë gjithashtu pjesë në disa misione dhe operacione. Konkretisht në misionin “UNOMIG” në Gjeorgji, përfunduar më korrik 2009; misionin “MINURCAT” në Çad, Afrikë, përfunduar në 2009; misionin “UNMISS” në Sudanin e Jugut, Afrikë i cili vijon si kontribut.

Dialogu për të Drejtat e Njeriut

Shqipëria ka ratifikuar shumicën e instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe qëndron e angazhuar për të kontribuar në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Gjithashtu, Shqipëria vazhdon të ndjekë në përgjithësi linjën e BE-së në

promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këmbimet e rregullta me Delegacionin e BE-së brenda Këshillit për të Drejtat e Njeriut kanë rezultuar shumë efektive për veprimet e koordinuara për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Shqipëria vazhdon angazhimin e saj në mbështetje të multilateralizmit.

Gjatë periudhës 2020 – 2021, Shqipëria ka paraqitur gjashtë Raporte Kombëtare për ciklet periodike mbi zbatimin e dispozitave dhe rekomandimeve të Konventave Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, konkretisht:

- Raporti i tretë periodik kombëtar mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).

- Raporti i katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (CESCR).

- Raporti i tretë periodik kombëtar mbi zbatimin e Konventës së OKB-së kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Trajtimit Degradues (CAT).

- Raportet e kombinuara periodike, të trembëdhjetë dhe të katërmbëdhjetë, mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD).

- Raporti i pestë periodik mbi zbatimin e Konventës së OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).

- Raporti i Pestë për zbatimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.

*Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizata rajonale*

Organizata rajonale	Data e pranimit
Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC)	1996
Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC)	27 shkurt 2008
Iniciativa e Evropës Qendrore (CEI)	1996
Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ/BSEC)	25 qershor 1992
Nisma Adriatiko-Joniane (AII)	20 maj 2000
Nisma Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI)	2003
RACVIAC (Qendra Rajonale e Verifikimit të Armë- Kontrollit)	20 shtator 2000
SHBA - Karta e Adriatikut (A-5)	2 maj 2003
Fondi i Ballkanit Perëndimor (selia në Tiranë)	13 nëntor 2015
Task Forca Mjekësore e Ballkanit (BMTF)	Nëntor 2011
Iniciativa Rajonale Detare “ADRION”	20 maj 2000
Ministeriali i Mbrojtjes i Evropës Juglindore (SEDM)	1996

Pjesëmarrja e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare

Organizata ndërkombëtare	Data e pranimit
UN - Kombet e Bashkuara	14 dhjetor 1955
OSBE	20 qershor 1991
Këshilli i Evropës	13 korrik 1995
IAEA - Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike	29 korrik 1957
CTBTO - Organizata për Parandalimin Gjithëpërfshirës të Testeve Nukleare	1996
IOF - Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë	1999
UNAOC - Aleanca e Qyteteve të Kombeve të Bashkuara	2005
UNESCO - Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara	1958
IACA - Akademia Ndërkombëtare për Anti Korrupsionin	21 shtator 2011
Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior NATO	4 prill 2009

*Bashkëpunimi rajonal*

Prioriteti kryesor i politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në rajon është promovimi dhe kontributi në stabilitetin politik, paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik përmes bashkëpunimit si në nivelin dypalësh dhe në atë shumëpalësh. Një rajon i sigurt dhe politikisht i qëndrueshëm që zhvillon lidhje të duhura ekonomike brenda tij, dhe me pjesën tjetër të botës, u shërben interesave kombëtare të Shqipërisë por është gjithashtu në interes të të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe të fqinjëve tanë.

Shqipëria mbetet një pjesëmarrëse dhe përfituese aktive e Procesit të Berlinit, që synon, ndër të tjera, thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar brenda Ballkanit Perëndimor.

Duke iu referuar Samitit të Berlinit 2021, vlerësohet se bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës është një faktor themelor për partnerët e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE dhe jo një zëvendësues i anëtarësimit, si dhe përgëzohet koordinimin pozitiv midis projekteve të nisura në kuadër të Procesit të Berlinit dhe politikave të BE-së, me fokus të veçantë në Planin Ekonomik dhe të Investimeve, Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe Tregun e Përbashkët Rajonal. Gjithashtu evidentohet se Plani Ekonomik dhe i Investimeve është i përqendruar në projektet e transportit të qëndrueshëm, energjisë së pastër dhe lidhjes digjitale të zbatuara përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor.

Në fushën e lidhjes digjitale, Shqipëria njuh zbatimin e plotë të Marrëveshjes Rajonale për Roaming dhe fillimin e regjimit të roaming-ut falas në Ballkanin Perëndimor që nga 1 korriku 2021. Shqipëria ka vullnetin për të vazhduar punën për Draft Udhërrëfyesin për Uljen e Tarifave të Roaming-ut ndërmjet BE-së dhe BP-së. Reduktimi i tarifave të roaming-ut ndërmjet BE-së dhe BP-së është në përputhje me masat në mbështetje të një Agjende Digjitale për Ballkanin Perëndimor, agjendën e Tregut të Përbashkët Rajonal 2021 – 2024 dhe angazhimin e drejtuesve të BP-së për të punuar ngushtë me të gjitha palët e interesuara, përfshirë qeveritë, rregullatorët dhe operatorët celularë si nga BP ashtu edhe nga BE, në mënyrë që të mbështesin zbatimin e një udhërrëfyesi për të lehtësuar uljen e kostove të roaming midis BE-së dhe BP-së. Vlen për t'u theksuar se fluksi i furnizimeve bazë mjekësore dhe ushqimore gjatë

pandemisë COVID-19 është një arritje e Korridoreve të Gjellbra rajonale, duke shërbyer si një shembull i shkëlqyer sesi bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës mund të lehtësojë një përgjigje të shpejtë dhe efektive ndaj efekteve shkatërruese të krizës.

“Ballkani i Hapur”, aktualisht një bashkëpunim mes tre vendeve të rajonit, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, synon të zbatojë sa më shpejt të jetë e mundur në të gjithë rajonin, katër liritë e BE-së, lëvizjen e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit. Kjo nismë do t'u mundësojë vendeve bashkëpunuese të rajonit hapjen e kufijve për të lehtësuar jetën e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Nisma mbështetet nga SHBA dhe BE dhe është në përputhje me Planin për Tregun e Përbashkët Rajonal të Procesit të Berlinit. Kjo nismë duhet parë si një lëvizje e parë e suksesshme për pronësinë tonë rajonale dhe ndihmon në integrimin në BE të vendeve tona, forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe gjenerimin e rritjes ekonomike. Ballkani i Hapur gjithashtu plotëson bashkëpunimin rajonal në kuadrin e nismave të ndryshme rajonale, si Tregu i Përbashkët Rajonal, Agjenda Digjitale, Lidhshmëria, Agjenda e Gjellbër e Ballkanit Perëndimor, Korridoret e Gjellbra dhe Procesi më i gjerë i Berlinit. Kjo nismë është në funksion dhe plotëson përpjekjet e vendeve të rajonit drejt integritimit në BE.

Ballkani i Hapur mbetet i hapur për të gjitha vendet e rajonit dhe është konceptuar si një nismë gjithëpërfshirëse rajonale.

Në takimin e datës 29 korrik 2021 u nënshkruan 3 marrëveshje ndërmjet kryeministrit Rama, kryeministrit Zaev dhe presidentit Vučić:

- Marrëveshja për mobilizimin e tre vendeve për përballimin e fatkeqësive natyrore. Nëse një fatkeqësi natyrore godet një vend, të tre vendet do të mobilizohen për të ndihmuar.

- Memorandum Mirëkuptimi për lehtësimin e importit dhe eksportit të mallrave. Kjo do të eliminojë barrierat dhe do të ndihmojë në rritjen e ekonomive të vendeve.

- Marrëveshja për lëvizjen e lirë në tregun e punës, duke mundësuar akses të lehtë në tregun e punës dhe marrjen e lejeve të qëndrimit.

Ndërkohë është me rëndësi të theksohet se Republika e Shqipërisë nuk ka mosmarrëveshje kufitare, apo ndonjë çështje tjetër kritike të pazgjidhur dypalëshe me vendet fqinje.

*Kontrolli i Armëve*

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 50, date 06.02.2019 është miratuar Strategjia për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024 dhe Plan i Veprimit 2019–2021. Në funksion të monitorimit të Strategjisë, Komisioni Kombëtar mbi Armët e Vogla dhe të Lehta ka qenë plotësisht i angazhuar në koordinimin ndër-sektorial midis institucioneve përkatëse dhe agjencive të zbatimit të ligjit për të koordinuar dhe monitoruar të gjitha aktivitetet në vend në lidhje me Armët e Vogla dhe të Lehta. Takimet periodike dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet anëtarëve të Komisionit Kombëtar të AVL ka vijuar e pandërprerë pavarësisht situatës së pandemisë. Komisioni Kombëtar i AVL-ve ka marrë pjesë në takimet rajonale të koordinuara nga SEESAC, të cilat mbahen si pjesë e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian 2018/1788/CFSP në mbështetje të zbatimit të Udhërrëfyesit Rajonal për Luftën Kundër Trafikut të Paligjshëm të Armëve në Ballkanin Perëndimor.

Në kuadër të zbatimit efektiv të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019 – 2024, për shkak të përfundimit të afatit të Planit trevjeçar të Veprimit 2019 – 2021, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 9 dhjetor 2021 u miratua Plan i Veprimit 2022 – 2024 me masa dhe aktivitete konkrete për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare por edhe në përputhje me objektivat e “Udhërrëfyesit rajonal për një zgjidhje të qëndrueshme për mbajtjen e paligjshme, keqpërdorimin dhe trafikimin e armëve të vogla dhe të lehta dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor deri në vitin 2024” dhe Planit të Veprimit të BE për trafikimin e Armëve të Zjarrit 2020 – 2025. Në këtë plan veprimi janë parashikuar masa që kanë në fokus rritjen e kapaciteteve analitike dhe konsolidimin e Njësive Qendrore të Armëve të Zjarrit si një strukturë më vete, rritjen e kapaciteteve të Institutit të Policisë Shkencore dhe Policisë Kufitare, masa që lidhen me aspektet gjinore, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe subjekteve të licencuara mbi keqpërdorimin, rreziqet dhe kriteret e sigurisë për armët e vogla dhe të lehta, eksplozivët dhe municionet, forcimin e kapaciteteve të hetimit dhe kontrollit përfshirë këtu edhe format e reja të

tregtimit apo trafikimit të armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve (online, përmes kolive postare dhe postës së shpejtë, printimit në 3D etj.)

Gjithashtu është duke u zhvilluar pastrimi i pikave të nxehta të kontaminuara me armatura të pashpërthyer. Në këtë drejtim është duke vazhduar puna për pastrimin e zonës së fundit “hot spot” të evidentuar dhe deklaruar, përkatësisht në rajonin e Jubë – Sukthit, Durrës.

Ndërkohë, në janar 2021 është miratuar programi i punës i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit “Për zbatimin e Objektivave të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municionit dhe Eksplozivëve 2019 – 2024 dhe Planit të Veprimit 2019 – 2021”. Pas miratimit të ligjit për armët në dhjetor 2020, është plotësuar më tej kuadri ligjor dhe nënligjor në lidhje me zbatimin e këtij ligji. Policia e Shtetit ka ndërmarrë veprimtarinë e verifikimit dhe regjistrimit në regjistrin kombëtar të të gjitha armëve në pronësi të qytetarëve të cilat janë dhënë para hyrjes në fuqi të Ligjit 74/2014 “Për armët”. Ka vijuar regjistrimi i armëve të gjahut (armë të cilat sipas ligjit 74/2014, (152/2020) konsiderohen armë të kategorisë “C” në pronësi të qytetarëve). Qytetarët posedojnë 103 062 armë gjahu (nën kategorinë “C”), të cilat janë të regjistruara në sistem në çdo stacion policie (manualisht). Niveli i regjistrimit ka qenë më i ulët krahasuar me vitin e mëparshëm, për shkak të pandemisë COVID-19. Deri më 30 shtator 2021, 71.816 armë, ose rreth 70% e shumës totale të 103 028 armëve në pronësi të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë ishin regjistruar në sistemin e regjistrimit të armëve SIMA. Ndërkohë, për periudhën 1 janar – 30 shtator 2021, 10 928 armë ose 10.61% e shumës totale janë regjistruar në sistemin e regjistrimit të armëve.

Shqipëria ka bërë përmirësime të mëtejshme në sigurinë e ambienteve të magazinimit për armatimet dhe municionet. Përforcimi i sigurisë së depos qendrore të armatimit të Policisë së Shtetit në Mullet përfundoi në shtator. Gjithashtu, ka përfunduar përforcimi i sigurisë i dy sallave të shërbimit të provës në drejtoritë e policisë në Tiranë dhe Durrës.

Për përmirësimin e mëtejshëm të sigurisë së magazinimit të armatimeve dhe municioneve, raportohet se në bashkëpunim me UNDP/SEESAC kanë filluar procedurat për



përmirësimin e infrastrukturës me qëllim plotësimin e standardeve për 12 depo magazinimi të AVL në Policinë e Shtetit. Të gjitha konstruksionet e planifikuara fillimisht në depon e armëve në ‘Mullet’ të Policisë së Shtetit Shqiptar nën projektin e mbështetur nga Departamenti Amerikan i Shtetit përfunduan dhe brenda muajit prill u realizua edhe dorëzimi teknik i tyre.

Në mars 2021, bazuar në kërkesën e Policisë së Shtetit për UNDP SEESAC për mbështetje shtesë për përmirësimin e sigurisë së depove të armatimit të AVL-ve, afati i projektit u zgjat edhe për dymbëdhjetë muaj dhe si rrjedhim përmirësimet shtesë të masave të sigurisë së kontrollit të AVL do të përfundojnë deri më 31 mars 2022. Këto përmirësime përfshijnë: ndërtimin e një dhome brenda depos së ruajtjes dhe magazinimit të armatimit në “Mullet” ku do të vendoset dhe do të përdoret makineria e markimit me lazer për AVL; përmirësimin e kushteve të sigurisë të dhomave të ruajtjes së provave në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit në Tiranë dhe Korçë; dhe prokurimin e rafteve/kasave të ruajtjes së AVL-ve.

Në ligjin nr. 152/21 “Për armët”, të rishikuar, përcaktohet se: “Armët e zjarrit, pjesët kryesore dhe municionet, si dhe ato të grumbulluara me ligj nga Policia e Shtetit të gjetura në ambiente, armët stok nga ristrukturimi i armatimit të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, SHISH, apo hotspote nga strukturat e FA-së i kalojnë Ministrisë së Mbrojtjes me urdher të përbashkët për kalim kapital. Ministria e Mbrojtjes për këto armë, pjesët kryesore dhe municionet e tyre, kryen procedurat e demilitarizimit, asgjësimit të tyre dhe shitjes për skrap.

Ministria e Mbrojtjes, gjatë vitit 2021, për sasitë e armatimit të marra nga Ministria e Brendshme dhe ato të gjetura në hotspote, nëpërmjet Uzinës Mekanike Gramsh, shkatërroi pranë kësaj uzine sasinë prej 15401 copë armë të lehta dhe të vogla. Pjesa kryesore nga këto armë të zjarrit janë armë të konfiskuara nga Policia e Shtetit, disa janë mbledhur përmes fushatave të vazhdueshme të sensibilizimit, ndërsa një pjesë e vogël u grumbulluan nga FA në “hotspote” të ndryshme.

Materialet me përdorim të dyfishtë

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve filloi procedurat e brendshme për

vlerësimin e angazhimit të mundshëm në marrëveshjen Wassenaar. Vlerësimi u krye në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe të gjitha institucionet e tjera që do të jenë pjesë e këtij procesi. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme ranë dakord të vazhdojnë procedurat për anëtarësim.

Ministria e Mbrojtjes ka kontaktuar Sekretariatën Wassenaar për kriteret e aplikimit dhe për të pasur informacion të thellë në lidhje me procesin e anëtarësimit. Sekretariati i ndau MM-së të gjithë informacionin e kërkuar. Gjatë vlerësimit të kryer nga Ministria e Mbrojtjes, Autoriteti i Kontrollit të Eksportit dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, bazuar në kriteret e aplikimit, u deklarua se Republika e Shqipërisë i respekton plotësisht të gjitha kriteret e marrëveshjes Wassenaar. Sidoqoftë, procesi i dokumentimit për përmbushjen e kritereve dhe përgatitjen e dosjes së kandidaturës kërkon kohë, pasi duhet të dorëzohet një listë shteruese e elementeve për secilin kriter me informacion në lidhje me kuadrin legjislativ, politikat, çështjet teknike dhe statistikë. Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti Shtetëror Shqiptar i Kontrollit të Eksporteve po punojnë në këtë proces dhe po mbledhin të gjithë informacionin nga të gjitha institucionet e përfshira.

Mospërhapja e Armëve të Dëmtimit në Masë (C-WMD)

Shqipëria nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 22.01.2020 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërtimeve Masive (DMD) dhe Planit të saj të Veprimit” ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Shkatërtimeve Masive, duke përmbushur detyrimet e Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve shtetërore të saj, në zbatim të përgjegjësisë që burojnë nga Rezoluta 1540 e KS të OKB-së për ndalimin e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë (ADM-së) në nivel rajonal dhe global.

Autoritetet përgjegjëse për realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të Strategjisë kanë vijuar të ndjekin realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit, sipas objektivave të strategjisë. Masë për tu theksuar është procesi i përgatitjes dhe zhvillimit të stërvitjes testuese në nivel kombëtar të kësaj strategjie (Table Top Exercise-TTX). Stërvitja organizohet në



bashkëpunim me Qendrën e Bashkëpunimit për Sigurinë “RACVIAC” dhe mbështetet nga Agjencia e Reduktimit të Rreziqeve të Mbrojtjes (DTRA) dhe Komanda Amerikane për Evropën (USEUCOM), të cilat asistojnë vendin tonë në këtë proces. Aktualisht janë zhvilluar konferencat planëzuese me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet e linjës. Për arsye të situatës aktuale të pandemisë COVID-19, në darkordësi dhe me partnerët, stërvitja e planifikuar për t’u zhvilluar në muajin prill 2021, u zhvillua në periudhën 8 – 10 nëntor 2021.

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për ngritjen e kapaciteteve për mospërhapjen dhe reagimin ndaj situatave me Armë të Dëmtimit në Masë (C-WMD), në Ministerialin e Mbrojtjes së NATO-s, të zhvilluar në datën 22 tetor 2021, Ministri i Mbrojtjes firmosi “Letrën e Qëllimit”, nëpërmjet së cilës vendet anëtare të NATO-s zotohen të bashkëpunojnë mbi zhvillimin e menaxhimit të zbulimit të agjentëve kimikë, biologjikë e radiologjikë, si dhe identifikimin e kapaciteteve, por njëkohësisht edhe për sigurimin e pajisjeve mbrojtëse kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore. Në këtë kuadër, Shqipëria nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes do të marrë pjesë në projektin e NATO mbi bashkëpunimin shumëkombësh në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në fushën “Chemical, Biological, Radiological and Nuclear (CBRN)”.

Si një anëtare e NATO dhe kandidate për BE, Shqipëria do të vazhdojë të inkurajojë, mbështesë dhe forcojë më tej politikën e saj të kontrollit të armëve, çarmatimit dhe mospërhapjen e armëve, si elementë kryesorë të sigurisë Euro-Atlantike dhe globale, si dhe do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet për dialog brenda Këshillit NATO-Rusi, për zvogëlimin e rrezikut të Rusisë dhe rritjen e transparencës së saj.

Zbatimi i Masave Kufizuese dhe Sanksioneve Ekonomike

Ligji Nr. 72, datë 17.10.2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë parashikon detyrimin ligjor për implementimin e Rezolutës së OKB-së lidhur me parandalimin, ndërprerjen dhe shkatërrimin e përdorimit të armëve të shkatërrimit në masë dhe financimin e tyre. Ai gjithashtu parashikon edhe implementimin e masave shtrënguese të vendosura

nga BE, apo Organizata të tjera ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ky ligj nuk përfshin masa kufizuese në lidhje me financimin e terrorizmit, të cilat tashmë janë adresuar nga ligji për Masat kundër Financimit të Terrorizmit.

Zbatimi i masave kufizuese të BE-së, kryhet mbi bazën e ligjit mbi masat kufizuese ndërkombëtare dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Me datë 30.12.2020, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.1128, me anë të së cilës Republika e Shqipërisë ka filluar të zbatojë masat kufizuese në vijim të vendimeve të Këshillit të BE-së. Aktualisht janë miratuar:

1. Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 228, datë 14.4.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare”, të ndryshuar;

2. Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 250, datë 5.5.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar;

3. Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 317, datë 2.6.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar;

4. Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 528, datë 22.9.2021 “Për disa shtesa në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar;

5. Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 628, datë 27.10.2021 “Për një shtesë në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave,



“Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar;

6. Vendimi i Këshilli të Ministrave Nr. 651, datë 3.11.2021 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar;

7. Vendim i Këshilli të Ministrave Nr. 692, datë 18.11.2021 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, i ndryshuar;

8. Vendim i Këshilli të Ministrave Nr. 752, datë 9.12.2021 “Për një ndryshim në Vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar;

9. Vendim i Këshilli të Ministrave Nr. 799, datë 20.12.2021 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar.

Lufta Kundër Terrorizmit

Për sa i përket luftës kundër terrorizmit, vendi ynë është anëtar i koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit dhe vazhdon të mbështesë aleatët dhe partnerët në zonë, duke e konsideruar bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër terrorizmit si një përparësi për agjencitë e zbatimit të ligjit. Ekzistojnë kuadri ligjor dhe strukturat e duhura për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënim të sigurisë nga aktet terroriste. Shqipëria është një vend që nuk ka përjetuar akte terroriste, por është përballur me fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, qytetarë që shkojnë në zonat e konfliktit

në Siri / Irak, madje edhe me familjet e tyre, gratë dhe fëmijët.

Për sa i përket komunikimit midis BE dhe vendeve të treta në fushën e antiterrorizmit, Shqipëria, kur ftohet, përputhet me të gjitha Vendimet dhe Deklaratat e Këshillit të BE. Në këtë kuadër, Shqipëria është plotësisht dakord me politikën e jashtme të BE-së në luftën kundër terrorizmit, duke pasur parasysh veçanërisht promovimin e dialogut ndërkulturor, qeverisjen e mirë dhe për të trajtuar shkaqet themelore të radikalizimit.

Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025 dhe Plani i saj i Veprimit (2021 – 2023), miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1173, datë 16.12.2020 është dokumenti kryesor në luftën kundër terrorizmit. Plani i Veprimit 2021 – 2023, parashikon masa konkrete që duhen të realizohen për përmbushjen e qëllimeve të politikave dhe objektivave specifike, sipas afateve të përcaktuara.

Raporti i monitorimit janar – qershor 2021, është raporti i parë i progresit për implementimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Terrorizmit 2021 – 2025. Raporti ofron informacion mbi progresin e arritur kundrejt çdo qëllimi politik, objektivit specifik bazuar në statusin e arritjeve të treguesve si dhe në zbatimin e reformave kyçe në këtë sektor. Disa nga masat e arritura me sukses në periudhën e 6-mujorit të parë të vitit 2021 janë: mbajtja e nivelit të kërcënimit terrorist në vend “i ulët”; rritja e referimeve për financim të terrorizmit përmes bashkëpunimit të institucioneve dhe agjencive ligj zbatuese; rritja e prezencës së strukturave të inteligjencës në mjedisin virtual dhe *darknet* me qëllim monitorimin e profileve me përmbajtje propaganda terroriste; përmirësimi i shfrytëzimit të kapaciteteve kombëtare për zbulimin në kohë të materialeve të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për prodhimin apo përdorimin e armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyes, Armëve të Dëmtimit në Masë; Forcat e Armatosura kanë përcaktuar listën e objekteve të Infrastrukturës Kritike (IK) me qëllim përmirësimin e sistemit të ruajtjes dhe sigurisë së IK; rritja e kapaciteteve të strukturave të antiterrorit dhe inteligjencës përmes rritjes së pjesëmarrjes në takime, konferenca ose vizita studimore për informimin dhe shkëmbimin e praktikave më të mira mbi dinamikat dhe format e reja të



kërcënimeve terroriste si hetimi i financave të paligjshme dhe transaksioneve të dyshimta, përdorimi i monedhave virtuale (bitcoin) etj.; hartimi i ndryshimeve të paketës ligjore për pastrimin e parave.

Ndërkohë, Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) është në fazat e para të përgatitjes dhe rishikimit të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit. Strategjia e re do të jetë në përputhje me shtyllat strategjike të Qeverisë së Shqipërisë por edhe me angazhimet e Shqipërisë në sferën euroatlantike, duke përfshirë procesin e integritetit në BE dhe përmbushjen e kushteve të BE-së në këtë drejtim. Strategjia do të ketë 3 shtylla kryesore, të cilat ndahen në: Parandalim; Rehabilitim dhe Ri-integritet; Komunikimi Strategjik. Gjithashtu, Qendra CVE në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit synon të ndërhyjë në kurrikulën bazë arsimore për ta pasuruar atë në kuadrin e njohurive arsimore të përgjithshme të nxënësve shqiptarë duke iu referuar konceptit bazë. Sa i takon angazhimit në terren, që nga fundi i Korrikut 2021, Qendra CVE ka koordinuar punën me ministrinë e linjës si dhe me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të lehtësuar procesin e rehabilitimit dhe riintegritetit të mëposhtëm të 19 (nëntëmbëdhjetë) qytetarëve shqiptarë të kthyer nga kampet Al-Hol dhe Roj në Siri më 1 Gusht 2021.

Politika Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë kanë struktura të përshtatshme për të marrë pjesë në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë si dhe në politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes. Në fushën e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP), Shqipëria mbështet Strategjinë Globale për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian. Shqipëria i është bashkuar të gjitha vendimeve të Këshillit dhe deklaratave të Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së, kur i është kërkuar (100% përputhje).

Angazhimi i Shqipërisë në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (CSDP) është në përputhje me orientimet për angazhim aktiv ndërkombëtar në fushën e sigurisë dhe synon vijimin e kontributit për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes si në rajon, ashtu edhe në arenën globale.

Shqipëria merr pjesë në misionet ushtarake të menaxhimit të krizave nën Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP). Aktualisht, Shqipëria merr pjesë në misionin ushtarak EUFOR ALTHEA në Bosnje Hercegovinë. Gjithashtu, në përputhje me prioritetet e Strategjisë Globale të Bashkimit Evropian, në kuadër të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Shqipëria do të përfaqësohet me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Grup Batalionet BE, përkatësisht në Grup Batalionin e 6-mujorit të dytë të vitit 2024 (EUBG 2024-2).

Në përputhje me rekomandimet e dhëna nga Komisioni Evropian, Ministria e Mbrojtjes ka bërë një vlerësim paraprak të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Agjencinë Evropiane të Mbrojtjes (EDA). Në përfundim të këtij procesi vlerësimi, Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme janë duke zhvilluar bisedime të përbashkëta me EDA mbi mundësitë dhe hapësirat për bashkëpunim në të ardhmen.

Në funksion të procedurave të sigurisë për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar me BE, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 836, datë 14.10.2015 “Për miratimin e rregullores për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe BE-së”, i cili përcakton rregullat për shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë, NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, në mars të vitit 2016, është nënshkruar marrëveshja midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi procedurat për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje kërkon realizimin e një vizite inspektuese nga EEAS (Drejtoria e Sigurisë dhe Infrastrukturës e Shërbimit të Veprimit të Jashtëm Evropian), e cila mund të realizohet gjatë vitit 2022, sipas situatës së pandemisë COVID-19.

Ndërkohë, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të Kapitullit 31, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka hartuar ligjin e ri “Për informacionin e klasifikuar”, i cili synon të përafrojë pjesërisht Vendimin e Këshillit të BE 2013/488 i datës 23 shtator 2013 mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së. Drafti përfundimtar i ligjit është dërguar për shqyrtim dhe miratim në Këshill të Ministrave në muajin dhjetor 2021 dhe miratimi i tij



përfundimtar parashikohet të realizohet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2022.

Gjithashtu, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shifrës në Ministrinë e Mbrojtjes, ka hartuar draftin përfundimtar të aktit “Rregullore për përzgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve që përpunojnë informacion të klasifikuar”, i cili synon përafrim të pjesshëm me disa akte të klasifikuara të BE-së, konkretisht me “Politikën e garantimit të sigurimit të informacionit në TEMPEST”, “Udhëzime për sigurinë e informacionit për zgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve TEMPEST” si dhe “Udhëzime për sigurinë e informacionit mbi procedurat e zonimit TEMPEST”. Gjatë muajit dhjetor 2021 është hartuar drafti përfundimtar i projekt rregullores i cili është dërguar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, dhe miratimi i tij përfundimtar parashikohet të realizohet brenda tremujorit të parë të vitit 2022.

4.31.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Ministria e Brendshme.
- Ministria e Mbrojtjes.
- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të

Klasifikuar.

- SHISH.
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Ministria e Drejtësisë.
- Agjencia Kombëtare Bërthamore.
- Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit

të Dhunshëm.

4.31.6 Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Shtetet anëtare duhet të jenë të afta të zhvillojnë dialog politik në kuadrin e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes, të jenë në linjë me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimtarinë e BE-së dhe të zbatojnë sanksionet dhe masat shtrënguese të dakordësuara në nivel të Bashkimit Evropian.

Prioritetet në Kapitullin 31 janë:

- Shqipëria duhet të mbajë linjëzimin e plotë me politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së;

- të vazhdojë zbatimin e strategjisë kombëtare për armët e vogla dhe të lehta, dhe të forcojë hetimin dhe ndjekjen penale të trafikut të armëve të zjarrit;

- të përfundojë me shpejtësi procesin për t’iu bashkuar Marrëveshjes Wassenaar.

Lufta Kundër Terrorizmit

Autoritetet shqiptare po zbatojnë dhe ndjekin një plan unik veprimi për të zbutur rreziqet e identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Riskut për PP/FT të vitit 2019 dhe nga disa analiza risku të kryera gjatë vitit 2020, plan ky i miratuar nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave. Në këtë plan janë përfshirë edhe disa masa konkrete në kuadër të parandalimit të financimit të terrorizmit të cilat po ndiqen në vijimësi për sa i përket realizimit të tyre. Ky vlerësim ka identifikuar nevojat dhe ka bërë rekomandimet përkatëse në funksion të efektivitetit të sistemit dhe përputhshmërisë teknike me Rekomandimet e FATF-së. Rekomandimi 6.5 i FATF-së parashikon zbatimin e sanksioneve kundër financimit të terrorizmit pa vonesë.

Për sa më sipër është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave Projektvendimi “Për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Ngrirjen e Përkohshme të Fondeve apo Aseteve të tjerë Personave ose Enteve të Shpallura”- në mbështetje të nenit 10/1 të Ligjit Nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo asetëve të tjera të personave ose enteve të shpallura nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo organizatat ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, detyrim që buron nga neni 10/1 i Ligjit Nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” (i ndryshuar).

Për të garantuar zbatimin pa vonesë të sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB në lidhje me terrorizmin dhe/ose financimin e tij, element ky që është vlerësuar ende problematik nga Komiteti Moneyval, me Ligjin nr. 32, datë 17.6.2019, që ndryshoi Ligjin nr. 157/2013 “Për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit”, është shtuar nenin 10/1 me titull “Ngrirja e përkohshme”. Në bazë dhe për zbatim të ligjit të mësipërm dhe në funksion të përmbushjes së standardeve të FATF-së janë propozuar ndryshimet që përmbahen në projektvendimin “Për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për



Ngrirjen e Përkohshme të Fondeve apo Aseteve të tjer\ë Personave ose Enteëve të Shpallura”.

KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

4.32.1 Përbajtja e kapitullit

Kapitulli ka të bëjë me miratimin e kuadrit dhe standardeve të pranuar botërisht të tilla si COSO: Internal Control Integrated Framework; INTOSAI: Udhëzues për qeverisje të mirë; Auditi i Brendshëm (International Professional Practices Framework (IPPF); dhe INTOSAI: Parimet Themeluese; Parakushtet për Funkcionimin e Institucioneve Supreme të Auditimit; Parimet Themelore të Auditimit; dhe Udhëzimet e Auditimit, si dhe me përafrimin e *acquis* në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së dhe në atë të mbrojtjes së euros nga falsifikimi.

Objektivat kryesore të kapitullit janë: stabiliteti financiar i Shteteve Anëtare, parandalimi i keqpërdorimit të mjeteve financiare, kontributi në një shpenzim më eficient dhe të përgjegjshëm, i cili ofron një mekanizëm të rëndësishëm për të luftuar korrupsionin.

Objektivat kryesore të kapitullit janë zhvillimi i një sistemi efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikën më të mira të BE-së, mbrojtja e interesave financiare të BE-së, si dhe parandalimi dhe lufta ndaj falsifikimit të monedhës euro.

4.32.2 Struktura e kapitullit

1. Kontrolli i brendshëm financiar publik
2. Auditimi i jashtëm
3. Mbrojtja e interesave financiare të BE-së
4. Mbrojtja e euros nga falsifikimi

4.32.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* së Bashkimit Evropian

Detyrimi i përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e kontrollit financiar me *acquis* të Bashkimit Evropian rrjedh nga nenet 70, 85 dhe 90 të MSA-së.

Në fushën e mbrojtjes së monedhës euro, *acquis* e BE-së ka qëllim të sigurojë koordinimin e duhur të masave të ndërmarra kundër falsifikimit nga autoritetet kombëtare dhe dënimeve adekuate të falsifikatoreve sipas ligjit penal kombëtar.

Legjislacioni i BE-së përmban dispozita themelore në lidhje me mbledhjen dhe analizën e të dhënave teknike dhe statistikore lidhur me

kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara, si dhe me bashkëpunimin mes autoriteteve kombëtare në vendet anëtare të BE-së, Komisionit Evropian, Bankës Qendrore Evropiane, vendeve të treta dhe organizatave ndërkombëtare.

Përcaktimet kryesore:

- Analiza dhe identifikimi – autoritetet në vendet e BE-së, duhet të dërgojnë për identifikim dhe analizë teknike kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara në qendrat e tyre kombëtare të Analizës (rregullore 1338/2001 & 1339/2001);

- Tërheqja nga qarkullimi – bankat dhe institucionet e kreditit duhet ti tërheqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat metalike euro të dyshuara të falsifikuara, dhe ti dorëzojnë ato tek autoritetet kombëtare kompetente (rregullore 1338/2001 & 1339/2001);

- Kontrolli i vërtetësisë – bankat dhe institucionet e kreditit duhet të kontrollojnë vërtetësinë e të gjitha kartëmonedhave dhe monedhave metalike euro që do hidhen në qarkullim (Vendim BQE/2010/14 dhe Rregullore e (KE) Nr. 1210/2010).

Dënimet e Kodit Penal

Më 22 maj 2014, ka hyrë në fuqi, Direktiva e re 2014/62 /BE. Kjo Direktivë ka për qëllim të forcojë mbrojtjen e euros nga falsifikimi me masa ligjore në kodin penal. Direktiva zëvendëson Vendimin Kuadër 2000/383/JHA si dhe plotëson e ndihmon në zbatimin e Konventës së Gjenezës të vitit 1929 për ndalimin e falsifikimit. Masat e reja përfshijnë ashpërsimin e sanksioneve për shkelësit e ligjit dhe përmirësimin e mjeteve të hetimit ndërkufitar.

4.32.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Njëfarë përparimi është bërë veçanërisht me ratifikimin e konventës ndërkombëtare për ndalimin e monedhave të falsifikuara dhe miratimin e një metodologjie të rishikuar për monitorimin e performancës së kontrollit të brendshëm.

Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik

Kuadri strategjik për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP-në) është në fuqi. Masat e KBFP-së janë të përfshira në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (MFP) 2019 –



2022 dhe të detajuara më tej në Dokumentin e Politikave për Zhvillimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2021 – 2022, i cili u miratua në dhjetor 2020.

Në lidhje me **përgjegjshmërinë menaxheriale**, raportimi fokusohet kryesisht në performancën financiare, por me një numër në rritje të institucioneve që raportojnë edhe për performancën kundrejt objektivave.

Legjislacioni për **kontrollin e brendshëm** është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Deklaratat e cilësisë nënshkruhen sistematikisht nga menaxhimi i lartë, por në mungesë të një kornize delegimi, ky mbetet më shumë një ushtrim formal. Në dhjetor 2020, u miratua metodologjia për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbi bazë performance dhe në mbështetje të raportimeve vjetore.

Legjislacioni mbi **praktikën e auditimit të brendshëm** është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Shërbimi i auditimit të brendshëm në sektorin publik është krijuar dhe funksionon duke kontribuar në një efikasitet më të madh operacional, disiplinë buxhetore dhe fiskale dhe pajtueshmëri ligjore dhe rregullatore nga njësitë e sektorit publik duke kërkuar që cdo njësi e sektorit publik të jetë objekt i auditimeve të brendshme të rregullta, sistematike dhe gjithëpërfshirëse. Ligji për auditimin e brendshëm në sektorin publik ka krijuar një sistem institucional, i cili siguron një funksionim adekuat të auditimit të brendshëm. Dispozitat e Ligjit të AB kanë për qëllim të sigurojnë që auditimet e brendshme të rrisin efikasitetin e punës së subjekteve të sektorit publik në një mënyrë që rrit nivelin e shërbimeve të ofruara për përdoruesit, përfituesit dhe tatimpaguesit shqiptarë. Sistemi i trajnimit dhe zhvillimit profesional, duke përfshirë Certifikimin Kombëtar të Audituesve të Brendshëm dhe Trajnimin e Vijueshëm profesional (TVP/CPD) është krijuar për të siguruar që njësitë e AB-së të kenë kapacitetet e nevojshme dhe aftësitë që u mundësojnë atyre të zbatojnë standardet e auditimit të brendshëm të Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm (IIA), dhe me qëllimin përfundimtar për t'u siguruar përdoruesve të raporteve të AB-së siguri mbi cilësinë dhe saktësinë e punës së raportuar. Të gjithë audituesit e brendshëm në detyrë janë të trajnuar duke ndjekur

Programin Vjetor të COP dhe numri i auditorëve të brendshëm të certifikuar rritet nga viti në vit, duke synuar që të gjithë auditorët aktivë të certifikohen. Cilësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm të secilës Njësi AB në ML dhe njësitë e tjera publike monitorohet dhe mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme (megjithëse konsolidimi i Planeve të Auditimit Strategjik dhe Raportet Vjetore të Njësive të AB) për të ruajtur konformitetin me Standardet e Vlerësimet e jashtme të kryera nga NJQH AB në mënyrë periodike (të paktën një herë çdo pesë vjet) rrisin vlerën, pasi ato i mundësojnë aktivitetit të auditimit të brendshëm të vlerësojë përpunshmërinë me Standardet; auditimin e brendshëm dhe statutet e komiteteve të auditimit; vlerësimin e rrezikut dhe kontrollit të organizatës; përdorimi efektiv i burimeve; dhe përdorimi i praktikave të suksesshme.

Njësia qendrore e harmonizimit (NJQH) ofron udhëzime metodologjike dhe monitoron performancën e kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik në bazë të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raporteve të vetëvlerësimit të kryera nga institucionet. Në vitin 2020, NJQH kreu 19 vlerësime të jashtme të cilësisë së auditimit të brendshëm dhe përfundoi 25 vlerësime deri në dhjetor 2021. Në vitin 2021, NJQH filloi vlerësimet e cilësisë për kontrollin e brendshëm në 20 institucione. Raporti vjetor i KBFP i paraqitet Këshillit të Ministrave dhe diskutohet në Kuvend.

Arritjet kryesore paraqiten si më poshtë:

- Realizimi i disa aktiviteteve në kuadër të ofrimit të asistencës teknike në 5 njësi të qeverisë së përgjithshme (Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Bashkia Krujë dhe Bashkia Himarë për ndërtimin e instrumentave të menaxhimit financiar dhe kontrollit;

- Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në 20 njësi të qeverisjes së përgjithshme;

- Është bërë vlerësimi i gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2020 (Raporti Vjetor i KBFP);

- Janë organizuar takime ndërgjegjësuere me menaxherë të 5 njësive të përzgjedhura pilot të qeverisjes së përgjithshme, mbi zbatimin me



rigorozitet të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- Janë zhvilluar 2 seanca 1-ditore trajnimi mbi rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit (26 pjesëmarrës);

- Është bërë rishikimi dhe përmirësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm;

- Është amenduar Manuali i Auditimit të Brendshëm, me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 4, datë 10.01.2020 “Për disa Ndryshime në Manualin e Auditimit të Brendshëm”;

- Udhëzimi “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm” është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 42, datë 27.10.2020;

- Amendimet në Rregulloret “Për trajnimin e vijueshëm” dhe “Certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik”, janë miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;

- Është rritur ndjeshëm vlerësimi i jashtëm i cilësisë së njësive të auditimit të brendshëm. Për vitin 2020 u dha opinionimi për cilësinë e punës së 19 NJAB-ve dhe për vitin 2021 u arrit në 25 vlerësime të jashtme të cilësisë të njësive të auditimit të brendshëm në një vit;

- Janë organizuar 8 javë seanca trajnimi në distancë në kuadrin e Programit Vjetor të Trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm, me qëllim rritjen e kapaciteteve të auditimit të brendshëm në sektorin publik (342 auditues të brendshëm);

- 52 punonjës të rinj të auditimit kanë ndjekur procesin e certifikimit 2020 – 2021 dhe në Shtator 2021, 47 auditues të rinj janë certifikuar si “Auditues të brendshëm në sektorin publik”.

Auditimi i jashtëm

Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), **kuadri kushtetues dhe ligjor** i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (KLSH).

Në përputhje me planin strategjik të zhvillimit 2018 – 2022, KLSH po zbaton aktivitete për të përmirësuar **kapacitetet institucionale**. Është krijuar një grup pune për të përmirësuar legjislacionin aktual dhe ndër të tjera për të siguruar vazhdimësinë pas përfundimit të mandatit të kryetarit të KLSH-së. Vitet e fundit, KLSH ka

marrë masa për përmirësimin e zhvillimit profesional të stafit të auditimit. Në vitin 2020 u përcaktuan detyra të detajuara në fushën e etikës dhe integritetit. KLSH vijoi punën për të rritur ndërgjegjësimin e botës akademike dhe shoqërisë civile mbi rëndësinë e auditimit të jashtëm.

Në lidhje me **cilësinë e punës së auditimit**, në qershor 2020, rregulloret e procedurave të auditimit u rishikuan për të përmirësuar procedurat e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë. Objektivat e auditimit të KLSH-së janë zhvendosur nga auditimet e përputhshmërisë dhe rregullsisë drejt auditimeve që mund të ndihmojnë në parandalimin e dëmit ekonomik dhe shkeljes së rregullave. KLSH ndjek një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në risk. Numri i auditimeve të performancës është rritur dhe përbën rreth 11% të të gjitha auditimeve të kryera në vitet e fundit. Për shkak të situatës së COVID-19, rreth 50% e planit vjetor të auditimit për vitin 2020 nuk mundi të realizohej, megjithatë auditime për prokurimet emergjente të lidhura me COVID-19 janë kryer dhe po vijnë të kryhen.

Ndikimi i punës së auditimit ka shënuar përparim. KLSH harton raporte vjetore për performancën e institucionit, si dhe buletine statistikore, në bazë tremujore. Këto raporte publikohen në faqen e internetit të KLSH-së dhe raportohen në Kuvend. Memorandumi i Mirëkuptimit i vitit 2017 ndërmjet KLSH-së dhe Ministrisë së Financave për monitorimin e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit rezultoi në krijimin e një sekretariati teknik me përfaqësues të të dyja palëve, i cili u bë plotësisht funksional në vitin 2020. Monitorimi efektiv dhe në kohë i zbatimit të rekomandimeve të auditimit është përmirësuar. Në vitin 2020, KLSH raportoi se 75% e rekomandimeve të tij janë në proces zbatimi dhe disa prej tyre janë zbatuar plotësisht. Platforma elektronike për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit është funksionale që nga fundi i vitit 2019 dhe në qershor 2020 është miratuar manuali përkatës.

Zhvillimi profesional i audituesve dhe stafit është mbështetur në Programin Vjetor të Trajnimit për vitin 2020 duke synuar që ndërtimi i kapaciteteve të mbështetet në metodologji të reja e të përditësuara dhe në aplikimin e qasjeve moderne të auditimit. Stafi auditues gjatë vitit 2020 arritur një nivel pjesëmarrje prej rreth 28,5 ditë trajnimi për



çdo auditues (duke tejkaluar objektivin që çdo auditues gjatë 8 viteve të fundit të trajnohet mesatarisht 25 ditë trajnim në vit). Për periudhën janar – gusht 2021 për çdo auditues/specialist janë kryer 8.2 ditë trajnimi.

Në funksion të përafrimit të metodologjisë audituese me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, KLSH gjatë vitit 2020 rishikoi bazën metodologjike të auditimit, nëpërmjet miratimit të dokumenteve të mëposhtme:

- Rregullore e Procedurave të Auditimit, e rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 63, datë 22.06.2020;

- Manuali i Auditimit Financiar, i rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 66, datë 22.06.2020;

- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, i rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 66, datë 30.06.2020;

- Manuali i Auditimit të Performancës i rishikuar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 78, datë 23.06.2020;

- Manuali i Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve dhe të Regjistrimit Institucional të zbatimit të rekomandimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 67, datë 23.06.2020;

- Udhërrëfyesi mbi mënyrën e referimit të veprave penale në prokurori miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 60, datë 31.05.2020.

Manualet e auditimit të miratuara gjatë vitit 2020 u testuan në disa auditime pilot dhe gjatë vitit 2021 aktiviteti auditues është fokusuar në implementimin në praktikë të këtyre manualeve.

Gjatë vitit 2020, KLSH ka dërguar në Parlament Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2019, Raportin e Auditimit për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2019, së bashku me Raportin e konsoliduar të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve me qëllim rritjen e impaktit të punës audituese. Në prill të vitit 2021 është dërguar në Parlament Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2020 dhe në tetor 2021 KLSH i ka përcjellë Kuvendit, Raportin e Zbatimit të Buxhetit për vitin 2020. KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë në prill të vitit 2021 raportin “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për auditimet e evaduara për periudhën janar – qershor 2020”.

Gjatë vitit 2020, KLSH ka dërguar në Kuvendin e Shqipërisë dhe në komisionet respektive parlamentare, 66 vendime dhe raporte auditimi të cilat i përkasin veprimtarisë audituese të vitit 2020. Për periudhën janar – qershor 2021, KLSH ka dërguar në Kuvend, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, 47 raporte auditimi të evaduara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021.

Për të siguruar veprimtarinë e auditimit në përputhje të plotë me standardet ISSAI, KLSH ka rritur gradualisht numrin e auditimeve të performancës. Për periudhën janar – tetor 2021, auditimet e performancës përbëjnë 10.5% të auditimeve të evaduara përkundrejt totalit prej 114 auditimesh.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Shqipëria ka siguruar një nivel të caktuar të përafrimit të acquis në luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të BE-së, por duhet të harmonizohet plotësisht me Direktivën e BE-së, për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të BE-së me anë të ligjit penal.

Shërbimi kombëtar i koordinimit kundër mashtrimit (AFCOS) është një njësi brenda Drejtorisë së Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Rrjeti AFCOS, që përfshin autoritete të tjera përkatëse, është ngritur dhe organizohen takime të rregullta.

Me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 12, datë 25.01.2021 “Për një shtesë në Urdhrin Nr. 84, datë 9.12.2015 “Për caktimin e rrjetit të raportimit të shërbimit AFCOS” Prokuroria Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) është shtuar në Rrjetin e Raportimit të Shërbimit AFCOS.

Shqipëria bashkëpunon me Komisionin Evropian gjatë hetimeve dhe raporton në Komision për parregullsitë dhe rastet e dyshuara të mashtrimit. Shqipëria përgjatë vitit 2019 raportoi tre parregullsi përmes Sistemit Online të Menaxhimit të Parregullsive, të cilat pasi janë ndjekur dhe trajtuar sipas procedurave përkatëse janë mbyllur me sukses. Përgjatë vitit 2020 dhe 2021 janë raportuar në sistem dy parregullsi, të cilat vazhdojnë të jenë të hapura. Në total përmes sistemit janë raportuar 5 parregullsi që prej vitit 2019. Manuali për menaxhimin e parregullsive me fondet e BE-së është miratuar nga Zyrtari i Parë Autorizues (NAO) për fondet e BE-së.



Komisioni Evropian ka zhvilluar një sistem elektronik të Menaxhimit të Parregullsisë, i cili tashmë është funksional. Ky sistem (IMS) u mundëson përfituesve të IPA II, të raportojnë për parregullsitë e zbuluara, përfshirë mashtrimin, dhe ndjekjen e tyre në nivel kombëtar.

Drejtoria e Fondit Kombëtar, Drejtoria e Pergjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve (CFCU), Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), Drejtoria Mbështetëse e Zyrtarit Autorizues Kombëtar (NAOSD) dhe AFCOS/DIFP në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë kanë akses në sistemin IMS.

Shqipëria ka tashmë një historik solid të të dhënave për parregullsitë e raportuara, i dokumentuar nëpërmjet sistemit AFIS-IMS, por jo vetëm.

Mbarëvajtja dhe sigurimi i realizimit të këtij procesi të rëndësishëm, e konkretisht lidhur me identifikimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsisë realizohet/menaxhohet nga Zyrtari Kombëtar Autorizues, nëpërmjet Drejtorisë Mbështetëse të ZKA-së.

Dokumentohet një regjistër/gjurmë për hetimet e kryera, si për ato që janë kryer në bashkëpunim me OLAF, edhe për ato që janë kryer me kërkesë të ZKA-së, të cilat kanë pasur për qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Regjistri lidhur me rastet e hetimeve të kryera nga OLAF, si dhe për ato të kryera nga njësi përgjegjëse pranë DIFP-së, administrohet pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik/AFCOS në referencë të kërkesave të Zëvendësministrit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në cilësinë e Zyrtarit Kombëtarë Autorizues për fondet e BE-së), me mbështetjen e Zyrës NAO.

DIFP/AFCOS ka bashkëpunuar rregullisht me Autoritet Kombëtarë të Rrjetit AFCOS, në varësi të objektit të parregullsisë/çështjes, apo informacionit të kërkuar nga OLAF; AFCOS ka mundësuar për OLAF kontaktin me Përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtarë të përfshira në këtë rrjet, në funksion të bashkëpunimit operacional për rastet e hetimit të kryera nga OLAF, si dhe ka asistuar në dhënien e informacionit të kërkuar nga OLAF.

DIFP/AFCOS ka asistuar/shoqëruar investiguesit e OLAF në misionet e investigimit të kryera në Shqipëri, për hetimin e parregullsisë të identifikuar nga OLAF.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Shqipëria ka ratifikuar Konventën Ndërkombëtare për Luftën kundër falsifikimit të monedhës të vitit 1929, në nëntor të vitit 2019. Shqipëria është e përafuar me acquis të BE-së në lidhje me mbrojtjen e kartëmonedhave dhe monedhave metalike nga falsifikimi, duke përfshirë procedurat për grumbullimin, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre nga qarkullimi.

Analiza teknike kryhet nga Qendra Kombëtare e Analizave të Bankës së Shqipërisë dhe Instituti i Policisë Shkencore. Në vitin 2020, Shqipëria sekuestroi 307 monedha metalike dhe kartëmonedha euro me vlerë 6 000 euro, që përfaqëson 18% të të gjitha monedhave të falsifikuara të sekuestruara. Bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është i vazhdueshëm. Në gusht 2018, Banka e Shqipërisë iu bashkua platformës së ekspertëve të Europolit. Një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komisionit Evropian dhe Bankës së Shqipërisë për monedhat është në fuqi, ndërsa është në pritje një marrëveshje për kartëmonedhat me Bankën Qendrore Evropiane. Shqipëria merr pjesë në aktivitetet në kuadër të programit Pericles 2020.

Banka e Shqipërisë me kuadrin rregullator aktual garanton procedura detyruese për kontrollin e vërtetësisë, tërheqjen e menjëhershme të kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara të falsifikuara të zbuluara në qarkullim. Në Qendrën e Analizës, e cila është struktura përgjegjëse pranë Bankës së Shqipërisë, bëhet dërgimi i kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara të falsifikuara, me qëllim identifikimin, analizën teknike dhe klasifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të falsifikuara. Rregullat për mbrojtjen e euros nga falsifikimi janë përforcuar nëpërmjet miratimit nga Banka e Shqipërisë të Rregullores Nr.42 datë 04.08.2021 “Për medaljet dhe xhetonat të ngjashëm me monedhën metalike euro” dhe të Rregullores Nr.43, datë 4.08.2021 “Për kriteret për riprodhimin e kartëmonedhave dhe/ose monedhave metalike në Republikën e Shqipërisë”. Këto rregullore të cilat përbënin prioritet në përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të mbrojtjes së euro-s nga falsifikimi kanë për qëllim ndalimin e prodhimit dhe shitjes, importimit dhe shpërndarjes të medaljeve dhe xhetonave me pamjen dhe karakteristikat teknike të ngjashme me ato të



monedhës metalike euro si dhe kriteret e lejueshme për rastet e riprodhimeve të pamjeve të kartëmonedhave euro.

4.32.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (institucioni lider)

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit

3. Banka e Shqipërisë

4. Ministria e Brendshme

5. Ministria e Brendshme /Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

6. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

7. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

8. Ministria e Drejtësisë

9. Agjencia e Auditimit të Projekteve të Asistencës së Akredituar nga BE

10. Agjencia për Zhvillim Bujqësor

11. Instituti i Statistikave (INSTAT)

4.32.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Kontrolli i brendshëm financiar publik

Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Qeveria qendrore duhet të ndajë qartësisht përgjegjësitë institucionale në drejtimin e reformave të KBFP-së, në një qasje të koordinuar me administratën publike. Nevojiten përpjekje të forta për zbatimin e reformave të KBFP-së përtej Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Përgjegjshmëria menaxheriale nuk është ende plotësisht e sanksionuar në legjislacion dhe në praktikën administrative. Udhëzimet e miratuara për delegimin e përgjegjësive financiare duhet të zbatohen dhe të shoqërohen me një reformë më të gjerë për delegimin e përgjegjësive operationale dhe administrative, në mënyrë që të kemi një qasje gjithëpërfshirëse për llogaridhënien menaxheriale. Një numër shumë i vogël vendimesh administrative delegohen në praktikë. Rishfaqja dhe rritja e detyrimeve të prapambetura është një tregues për atribuimin ende jo plotësisht efektiv të përgjegjësive dhe kontrollit të angazhimeve. Ligji për administratën shtetërore, ligji për nëpunësin civil dhe ligjet përkatëse për planifikimin e integruar të politikave dhe ligji për sistemin buxhetor duhet të vlerësohen dhe nëse është e nevojshme të ndryshohen për të siguruar një bazë të qëndrueshme për zbatimin e llogaridhënies menaxheriale.

Në lidhje me **kontrollin e brendshëm**, manuali i proceseve të punës duhet të hartohet në të gjithë administratën publike në mënyrë që të përforcohet KBFP-ja, duke përfshirë qartësimin e roleve dhe përgjegjësive në procedurat e ndryshme, përcaktimin e objektivave dhe rezultateve, specifikimin e detyrave që do të delegohen, linjat e raportimit dhe identifikimin e risqeve specifike për procedurat. Njësitë në varësi dhe njësitë e qeverisjes vendore mbeten institucionet më të dobëta për sa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në të gjitha nivelet, menaxhimi i riskut është ende në një fazë të hershme dhe duhet të përfshihet më mirë në menaxhimin e proceseve financiare dhe operationale. Veçanërisht, regjistrat e riskut dhe strategjitë e riskut duhet të zhvillohen nga përdoruesit e buxhetit në nivel qendror dhe vendor dhe të integrohen në procesin e menaxhimit të enteve publike. Numri i kërkesave të paraqitura nga njësitë e auditimit të brendshëm mbetet relativisht i ulët.

Ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin do të ndryshohet bazuar në analizën e magësive të kryer nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit. Qëllimi kryesor për rishikimin e këtij ligji është saktësimi dhe përmirësimi i cilësisë së parimeve, rregullave, procedurave, strukturave administrative dhe metodave për përmirësimin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kuadër të rritjes së efektivitetit të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike.

Ligji për auditimin e brendshëm në sektorin publik duhet të ndryshohet mbështetur në analizën e mangësive të realizuar nga DH AB dhe ekspertët e SIGMA-s dhe ndryshimet në Ligj duhet të pasohen me ndryshime të tjera të nevojshme në aktet e tjera nënligjore. Manuali i auditimit të brendshëm duhet të rishikohet në këndvështrimin e dhënies së udhëzimeve shtesë për çështje të caktuara dhe për ta bërë një dokument plotësisht të aplikueshëm në praktikë. Auditimi i bazuar në rrezik duhet të udhëheqë qasjen e auditimit dhe efektiviteti i auditimeve duhet të përmirësohet përmes vlerësimit të rrezikut. Krijimi dhe funksionimi i shërbimit të auditimit të brendshëm në disa raste nuk sigurohet në përputhje me dispozitat e Ligjit të AB. Ende ka një numër Njësish të AB të cilat nuk përmbushin kërkesën për



të pasur së paku tre punonjës si staf auditues. Numri i vendeve të lira në strukturat e auditimit të brendshëm mbetet thuajse në të njëjtat nivele rreth 11%, dhe vakancat janë kryesisht në njësitë e qeverisjes vendore.

Sa i përket **praktikës së auditimit të brendshëm**, funksioni i auditimit të brendshëm ende nuk lëshon opinione auditimi për efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nëpër njësitë buxhetore. Cilësia e aktiviteteve të auditimit është ende vetëm pjesërisht në përputhje me Standardet IIA dhe kërkesat ligjore. Procedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë së auditimit të brendshëm duhet të bëhen në përputhje me standardet dhe plotësisht funksionale. Monitorimi i zbatimit efektiv dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit të brendshëm duhet të përmirësohet. Kapacitetet dhe aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm duhet të forcohen dhe rriten më tej.

Kapaciteti i **Njërive Qendrore të Harmonizimit (NjQH)** duhet të forcohet më tej.

Auditimi i jashtëm

Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), **kuadri kushtetues dhe ligjor** i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (KLSH). Miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara, të cilat forcojnë fushën e mandatit të auditimit për të mbuluar të gjitha entitetet publike është ende pezull.

KLSH në përmbushje të mandatit kushtetues si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar në Republikën e Shqipërisë, me qëllim përafrimin e plotë të veprimtarisë së tij me standardet ndërkombëtare të auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe të praktikave më të mira, po punon për amendimin e Ligjit 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nëpërmjet amendimit të ligjit synohet të zbatohet dhe rekomandimi i Raportit Vjetor të Komisionit Evropian për sigurimin e vazhdimësisë së veprimtarisë së institucionit edhe pas mbarimit të mandatit të Kryetarit të KLSH-së si dhe të plotësohen mangësitë që lidhen me:

- Certifikimin si “auditues i jashtëm publik” të audituesve të KLSH-së dhe krijimi i një qendre të hapur trajnimi dhe certifikimi multidimensional;

- Moskufizimin e KLSH-së në auditimin e fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian;

- Saktësimin në ligj të kompetencës juridiksionale të audituesve të KLSH-së në auditimin e të gjithë subjekteve publike apo private, të angazhuara, pjesëmarrëse dhe palë në fushat dhe kontratat: 1(koncesionare); (2) e prokurimit publik; (3) e partneritetit publik – privat;

- Saktësimin në ligj të kompetencës së plotë juridiksionale audituese të KLSH-së në auditimin e personave juridikë publikë, ku përfshihen edhe entet rregullatorë si p.sh Enti rregullator i Energjisë (ERE) dhe të Bankës Qendrore të Shqipërisë;

- Legjitimimin e KLSH-së si palë në proceset gjyqësore të iniciuara në bazë të kallëzimeve penale të bëra nga KLSH;

- Plotësimin e kompetencave dhe detyrave ligjore të Kryetarit të KLSH-së;

- Saktësimin e emërimit të raportit vjetor që Këshilli i Ministrave paraqet çdo vit në Kuvend në lidhje me zbatimin e buxhetit.

Cilësia e punës së auditimit duhet të përmirësohet më tej për të përmbushur plotësisht standardet INTOSAI.

Përmirësimi i cilësisë së punës audituese përbën një nga objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së dhe për këtë institucioni do të fokusohet tek:

- Hartimi dhe zhvillimi i një plani specifik trajnimesh i cili ka në fokus zbatimin e kërkesave të Standardit ISSAI 40 “Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë” dhe zbatimi i Udhëzuesit për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit në kontekstin e implementimit të Rregullores së rishikuar të Procedurave të Auditimit dhe manualeve të rishikuara të auditimeve financiare, të përputhshmërisë dhe performancës, si dhe manualit të ri për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve (dokumente të miratuara në qershor 2020).

Në lidhje me **impaktin e punës së auditimit**, pavarësisht nga një shkallë e lartë e rekomandimeve të pranuar nga institucionet, shkalla e rekomandimeve të zbatuara plotësisht duhet të përmirësohet. Në këtë kuadër KLSH do të vijoje:

- T’i ridërgojë Kuvendit të Shqipërisë propozimin për ngritjen e një nën komisioni



parlamentar, pjesë e Komisionit për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së dhe zhvillimin në mënyrë periodike të dëgjësave parlamentare për vlerësimin e veprimeve korrigjuese të ndërmarra nga institucionet e audituara për implementimin e rekomandimeve të KLSH-së;

- T'i ridërgojë Kuvendit të Shqipërisë propozimin për nënshkrimin e një memorandumit mirëkuptimi midis dy institucioneve dhe hartimin e një plani konkret pune për rritjen e kontrollit parlamentar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;

- Për zbatimin e rekomandimit për “Amendimin e kuadrit ligjor të KLSH-së”, i cili siguron ndër të tjera vazhdimësinë e aktivitetit institucional edhe pas mbarimit të mandatit kushtetues të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, KLSH do t'i përcjellë Kuvendit propozimin për amendime në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH” për këtë çështje.

Rritja e impaktit të punës audituese do të realizohet nëpërmjet:

- Përcjelljes në Kuvendin e Shqipërisë të raporteve periodike dhe raportit të konsoliduar mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve;

- Dërgimit periodik të Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin të Raportit të zbatimit të rekomandimeve në funksion të informimit dhe monitorimit nga ana e qeverisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së nga institucionet e qeverisjes qendrore;

- Dërgimit të Komisionet respektive parlamentare të raporteve të auditimit, të auditimit të performancës dhe raporteve me rëndësi dhe ndjeshmëri të lartë publike;

- Kryerjes së auditimeve tematike të veçanta për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve me qëllim evidentimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve dhe hartimin e raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Mangësitë e identifikuara dhe prioritetet

Shqipëria duhet të përafrojë plotësisht Direktivën e BE 2017/1371 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 5 Korrik 2017 “Për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të Unionit me anë të ligjit penal”. Përafrimi i kësaj direktive është parashikuar në

aktet e Ministrisë së Drejtësisë për kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, në kushtet kur Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për përafrimin e legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e Bashkimit Evropian në aspektin penal si dhe është lider për kapitullin 23.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë/strukturat respektive përgjegjëse të saj, ku bën pjesë edhe DIFP/AFCOS, do të kenë rol mbështetës në përafrimin e kësaj direktive, në përputhje me fushën e përgjegjësisë të cdo strukture.

- Miratimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit (2024), e cila synon mbrojtjen e interesave financiare të BE-së është një mangësi e identifikuar gjatë procesit screening, për kapitullin 32 “Kontrolli financiar”, si dhe rekomandimeve në Raportet vjetore të Komisionit Evropian për Shqipërinë. Hartimi i Strategjisë Kombëtare “Për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian” dhe hartimit të Planit të Veprimit, në zbatim të kësaj Strategjie” është përfshirë edhe në Strategjinë e Mbikëqyrjes së Financave Publike 2019 – 2022 (komponenti 6.1, masa 6.1.1 e PFM);

- Draftimi i kësaj strategjie ishte parashikuar të niste në tremujorin e dytë 2020, por për shkak të pandemisë COVID-19, u shty për në vitin 2022. Nga strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (AFCOS/DIFP) është hartuar draft urdhri “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Strategjisë Kombëtare “Për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian” dhe hartimit të Planit të Veprimit, në zbatim të kësaj Strategjie”, i cili është përcjellë për miratim pranë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Në kushtet kur ky proces kërkon një bashkëpunim dhe ndërveprim institucional të vazhdueshëm, ndërmjet përfaqësuesve të rrjetit AFCOS, strukturave menaxhuese dhe operuese në MFE, OLAF, si dhe nga ana tjetër, për vetë rëndësinë që ka ky proces, asistencë teknike vlerësohet e domosdoshme, në funksion të mbarëvajtjes së këtij procesi.

Për hartimin e kësaj strategjie DIFP/AFCOS do të vijojë me koordinimin e mundësimit të asistencës teknike nga OLAF, nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm që ka me këtë strukturë.



Strategjia është parashikuar të miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave brenda 3 muorit të katërt të vitit 2024.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve/burimeve njerëzore në Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik/në Sektorin e Sinjalizimit, Investigimit, Monitorimit dhe AFCOS, do të ndërmerren hapat respektivë për plotësimin e dy vendeve vakante në strukturën e AFCOS.

KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

4.33.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull mbulon rregullat që disiplinojnë fondet e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime konsistojnë kryesisht në: i) kontribute të bazuara në të ardhurat kombëtare bruto të secilit Shtet Anëtar; ii) detyrimet doganore; dhe iii) një burim bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitetet e duhura administrative për të koordinuar në mënyrë adekuate dhe për të garantuar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e burimeve vetjake.

4.33.2 Struktura e kapitullit

Burimet vetjake tradicionale

4.33.3 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe acquis së Bashkimit Evropian

Neni 70 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së, ku gjithashtu përfshihet dhe legjislacioni i BE-së për këtë kapitull.

Sa i përket acquis, ky kapitull përfshin rregulloret në lidhje me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së ('burimet vetjake'). Këto burime përbëhen nga të ashtuquajturat burimet tradicionale vetjake. Acquis në këtë fushë është direkt detyrues dhe nuk kërkon transpozim në ligjin kombëtar.

4.33.4 Situata aktuale në Shqipëri dhe arritjet kryesore

Situata aktuale dhe arritjet kryesore

Shqipëria ka **njëfarë niveli përgatitje** në këtë fushë. **Njëfarë përparimi** është arritur në fushat themelore të politikave që ndikojnë në funksionimin e sistemit të financimit të BE-së, përmes përparimit në zbatimin e Ligjit Organik të Buxhetit 2016, rregullit fiskal dhe vazhdimin të reformës në menaxhimin e financave publike. Përafrimi me acquis të BE-së në fushat themelore të politikave ka vijuar. Shqipëria ka bërë përparim

në përafrimin me standardet e ESA 2010.

Shqipëria ka shënuar përparim në fushat bazë të politikave që ndikojnë indirekt në sistemin e **burimeve vetjake** (kapitujt: 16 Tatimet, 18 Statistikat, 29 Bashkimi Doganor dhe 32 Kontrolli financiar). Shqipëria ka ngritur struktura për mbledhjen e detyrimeve doganore në pikën e importit dhe ka një sistem kombëtar të TVSH-së. Shqipëria ka filluar punën për hartimin e një Strategjie Afatmesme të të Ardhurave e cila do të përmbledhë reformën në fushën e tatimeve.

Përsa i përket burimeve të të Ardhurave Kombëtare Bruto (GNI), është bërë përparim i mëtejshëm në përafrimin me standardet ESA 2010. Shqipëria ka bërë përmirësime metodologjike në statistikën dhe në përmirësimin e shpejtësisë së publikimit të tyre, si dhe në rritjen e numrit të tabelave statistikore që raportohen në Eurostat. INSTAT ka punuar për rishikimin e radhës të benchmarks të llogarive kombëtare dhe ka përgatitur një politikë të harmonizuar rishikimi në koordinim me Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE).

Shqipëria vazhdoi përgatitjet për përmirësimin e vlerësimit të ekonomisë informale. Një projekt pilot për të përmirësuar rregullimet shteruese të vlerësimeve të PBB/GNI, i projektuar në veçanti për të zhvilluar vlerësime të reja eksperimentale mbi aktivitetet e paligjshme dhe auditimin fiskal, është duke u zbatuar. Po ndërmerren gjithashtu përpjekje për të përmirësuar shterueshmërinë e vlerësimeve të llogarive kombëtare.

Në lidhje me **infrastrukturën administrative**, MFE ka përgjegjësinë e përgjithshme për çështjet financiare dhe buxhetore.

INSTAT ka publikuar në faqen zyrtare, inventarin e Burimeve dhe Metodave të përdorura në Llogaritë Kombëtare, duke përdorur strukturën e një inventari burimesh të rekomanduar nga EUROSTAT. Ky inventar është përditësuar me të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të projekteve pilot IPA shumë-përfutuese.

Gjatë vitit 2020, INSTAT përveç tabelave të reja të dërguara, u fokusua gjithashtu edhe në përmirësimin e cilësisë dhe variablave, që janë pjesë e Programit të Transmetimit ESA 2010.

INSTAT transmeton në mënyrë të rregullt, në Prill dhe në Tetor të çdo viti, tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar sikurse kërkohen nga Eurostat për vendet kandidate për në BE. Këto të



dhëna janë dërguar në Eurostat në formë eksperimentale dhe jo për publikim.

4.33.5 Lista e ministrive dhe institucioneve përgjegjëse

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë (lider i kapitullit)

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

4. INSTAT

4.33.6 Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Mangësitë e identifikuar dhe prioritetet

Përsa i përket **burimeve vetjake**, Shqipëria nuk e ka finalizuar ende Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS) që ishte parashikuar të miratohej në vitin 2020.

Në lidhje me burimin e të ardhurave kombëtare bruto (GNI), Shqipëria ka nevojë për të përmirësuar më tej përputhshmërinë me ESA 2010 dhe për të filluar hartimin e Inventarit të GNI-së, në bazë të përshkrimit ekzistues të burimeve dhe metodave të përdorura për përpilimin e llogarive të saj kombëtare. Për shkak të pandemisë COVID-19, rishikimi i standardit të parashikuar për t'u miratuar në vitin 2020 u shty për në vitin 2024.

Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të garantuar marrjen e masave efektive për formalizimin e ekonomisë informale, përmirësimin e shterimit të llogarive kombëtare dhe llogaritjet e PBB/GNI dhe për të luftuar evazionin fiskal dhe mashtrimin me detyrimet doganore.

Për **infrastrukturën administrative**, Shqipëria do të duhet të punojë për krijimin e institucioneve përkatëse të përfshira në sistemin e burimeve të veta, një organ koordinues të burimeve të veta dhe rregullat zbatuese. Këto nevojiten për të siguruar që, me anëtarësimin, do të jetë në gjendje të, llogarisë, parashikojë, mbledhë, paguajë, kontrollojë dhe të raportojë pranë BE-së mbi burimet e veta, në përputhje me acquis.

Në kuadër të procesit Screening, për kapitullin 33 ende nuk janë përgatitur ende Analiza e Mangësive Ligjore dhe Analiza e Mangësive Institucionale dhe Administrative. GNPIE e kapitullit 33 ka kërkuar asistencë teknike të dedikuar për kryerjen e kësaj analize.

Lidhur me prioritet Shqipëria:

- Duhet të vijojë me përafrimin e të dhënave të Llogarive Kombëtare me ESA 2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) dhe përmirësimin e përmbledhjeve të transmetimit të të dhënave në Eurostat.

- Duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me dispozitat e BE-së për TVSH-në dhe detyrimet doganore.

Në fokus është dhe zhvillimi i mëtejshëm i burimeve të brendshme, burimeve të cilat bazohen në tatimin mbi vlerën e shtuar si dhe i atyre burimeve që lidhen me të ardhurat e brendshme bruto.



ANEKSI 1										
MASAT LIGJORE TË PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN 2022-2024										
Kapitulli	Nënkapitulli	Acquis e BE-së	Legislacioni shqiptar	Lloji i aktit të përafuar	Dokument strategjik Po/Jo	Institucioni propozues	Niveli i synuar i përafritimit	Viti i përafritimit	Tremujori i planifikuar për miratim	Përktimi
1	LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE									
1	Qasja e re	Direktiva 2014/29/ BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 Shkurt 2014 mbi harmonizimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me bërjen të disponueshme në treg të enëve të thekshta nën presion (SPVD)	Projektvendimi "Për miratimin e rregullit teknik "Për enët e thekshta nën presion dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara""	VKM	Jo	MFE/MIE	I pjesshëm	2022	IV	Jo
1	Qasja e re	Rregullorja (BE) 2016/426 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 9 Marsit 2016 mbi pajisjet e gazit, që shfuqizon Direktivën 2009/142 /EC	Projektvendimi "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet e gazit dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara""	VKM	Jo	MFE/MIE	I pjesshëm	2023	IV	–
1	Parimet e Përgjithshme dhe fusha e paharmonizuar	Rregullorja (BE) 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 20 Qershorit 2019 mbi mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve	Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore"	Ligji	Jo	MFE	I pjesshëm	2024	IV	Po
		Rregulloreja (BE) 2019/515 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 19 Marsit 2019 mbi njohjen reciproke të mallrave të tregtuara në mënyrë të ligjshme në një shtet tjetër anëtar								
1	Përqasja e re dhe globale	Rregullorja (BE) Nr 258/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 mars 2012 për zbatimin e nenit 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit dhe trafikimit të paligjshëm të armëve të zjarrit, pjesëve dhe përbërësve të tyre dhe municioneve, duke plotësuar Kombet e Bashkuara Konventa kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (Protokolli i OKB-së për armët e zjarrit), dhe vendosja e autorizimit të eksportit, dhe masave të importit dhe tranzitit për armët e zjarrit, pjesët dhe përbërësit e tyre dhe municionin	Projekt-ligji "Mbi përcaktimin e autorizimeve të eksportit, dhe masat për importin, tranzitin e armëve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve"	Ligji	Po	MM/MB	I pjesshëm	2024	IV	Jo
1	Qasja e vjetër	Rregullorja EU 2018/858 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 Maj 2018 mbi miratimin dhe mbikëqyrjen e tregut të mjeteve me motor dhe rimorkiove, sistemeve, komponenteve dhe pjesëve teknike të veçanta të tyre që amendon Rregulloret (EC) Nr. 595/2009 dhe shfuqizon Direktivën 2007/46/EC	Projektudhëzimi i Ministrit të Infrastruktura dhe Energjië "Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe pjesëve të veçanta teknike të destinuara për këto mjete	Udhëzim	Jo	MIE	I plotë	2024	IV	Po
1	Qasja e re	Rregullorja (BE) Nr 305/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2011 mbi përcaktimin e kushteve të harmonizuara për tregtimin e produkteve të ndërtimit dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 89/106/EEC	Projekt Ligji "Për produktet e ndërtimit"	Ligji	Jo	MIE	I plotë	2024	IV	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Direktiva 2014/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 për kthimin e objekteve kulturore të hequra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar.	Projekt Udhëzimi për krijimin dhe funksionimin e "Regjistrit të tregimit të pasurive kulturore", në zbatim të pikës 7, të nenit 116 të Ligjit 27/2018.	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	IV	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Direktiva 2014/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 për kthimin e objekteve kulturore të hequra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar.	Projekt Udhëzimi i përbashkët "Për vlerat mbi të cilat është i detyrueshëm një përshkrim më i detajuar i pasurive kulturore, objekte të veprimeve tregtare", në zbatim të pikës 8, të nenit 116 të Ligjit 27/2018	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	I	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	Direktiva 2014/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 për kthimin e objekteve kulturore të hequra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar.	Projekt Udhëzimi "Për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura", në zbatim të pikës 6, të nenit 130 të Ligjit 27/2018	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjesshëm	2023	I	Jo
1	Përqasja e re dhe globale	DIREKTIVË E KOMISIONIT 2008/43/KE, datë 4 Prill 2008, "Për ngritjen, sipas Direktivës së Këshillit 93/15/KEE, e një sistemi për identifikimin dhe gjurmueshmërinë e lëndëve plasëse për përdorim civil"	Projekt Vendim i KM Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse	VKM	Jo	MM	I pjesshëm	2022	IV	0
2	LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE									
2	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
3	E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME									
3	3.2 Njohja e ndërsjelltë e kualifikimeve profesionale	Direktive 2005/36/EC e PE dhe e Këshillit "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale", e ndryshuar	Projekt Ligji për amendimin e Ligjit 27/2018 "Për trashëgimime kulturore dhe muzetë"	Ligji	Jo	MK	I pjesshëm	2023	IV	Jo



3	3.2 Njohja e ndërsjelltë e kualifikimeve profesionale	Direktive 2005/36/EC e PE dhe e Këshillit "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale", e ndryshuar	Projektvendimi "Për licencimin në fushën e restaurimit dhe trashëgimisë kulturore"	VKM	Jo	MK	I pjesshëm	2023	IV	Jo
4	LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT									
4	Sistemet e Pagesave	Direktiva 2009/110 / EC mbi ushtrimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, që ndryshon direktivat 2005/60 / EC dhe 2006/48 / EC dhe shfuqizon Direktivën 2000/46 / EC	Rishikimi i rregullores nr.2, datë 17.01.2013 "Për administrimin e rrezeve në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka";	Rregullore	Jo	BSH	I pjesshëm	2022	II	
4	Sistemet e Pagesave	Direktiva 2009/110 / EC mbi ushtrimin, ndjekjen dhe mbikëqyrjen prudenciale të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike, që ndryshon direktivat 2005/60 / EC dhe 2006/48 / EC dhe shfuqizon Direktivën 2000/46 / EC	Rishikimi i rregullores nr.11, datë 06.02.2008 "Për instrumentet e pagesave elektronike".	Rregullore	Jo	BSH	I pjesshëm	2022	II	
4	Lëvizjet e kapitalit dhe pagesat	Direktiva 88/361/EEC mbi zbatimin e nenit 67 të Traktatit, dhe nenit 63-66 të Traktatit të funksionimit të Bashkimit Evropian (TFEU)	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave."	Ligj	Jo	MTM, MD, MZHBR	I pjesshëm	2022	IV	
5	PROKURIMI PUBLIK									
5	Konçesione dhe PPP	Direktiva 2014/23 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi dhënien e kontratave të koncesionit.	Draftligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet/PPP"	Ligj	Jo	MFE	I plotë	2023	I	Jo
6	LEGJISLACIONI TREGTAR									
6	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
7	E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE									
7	7.1	1. Direktive (EU) Nr.2015/2436 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 16 Dhjetor 2015 për përaftrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare. 2. Rregullore (EU) 2017/1001 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 14 Qershor 2017 për markat tregtare të Bashkimit Evropian.	Ligji "Për markat tregtare"	Ligj	Jo	MFE/DPPI	I plotë	2024	IV	Jo
7	7.1	1. Rregullore (EC) Nr.469/2009 e e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 6 Maj 2009 për certifikatat e mbrojtjes shtesë për produktet mjekësore. 2. Certifikata e mbrojtjes shtesë Rregullore (EEC) Nr.1678/92 lidhur me krijimin e certifikatave të produkteve mjekësore (kodifikimi i Rregullores (EC) Nr. 469/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 6 Maj 2009 për mbrojtjen shtesë të produkteve mjekësore). 3. Rregullore (EC) Nr. 1610/96 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e certifikatave për mbrojtjen shtesë të produkteve të mbrojtjes bimore. 4. Licencimi i detyrueshëm. Rregullore (EC) Nr. 816/2006 për licencimin e detyrueshëm të patentave lidhur me produktet farmaceutike të përpunuara për eksportim në vëndet që kanë probleme me shëndetin publik. 5. Shpikje bioteknike. Direktiva 98/44/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 6 Korrik 1998 për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknike. 6. Njoftimi i Komisionit për disa nene të Direktivës 98/44/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike.	Ligji "Për patentat dhe modelet e përdorimit"	Ligj	Jo	MFE/DPPI	I plotë	2024	IV	Jo
8	POLITIKAT E KONKURRENCES									
8	Konkurrenca	Udhëzimi mbi kufizimet e konkurrencës "sipas objektit" për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Njoftimi De Minimis, Dokument i Komisionit Evropian, version i dates 03/06/2015 (Bruksel 25.06.2014/SWD (2014) 198)	Udhëzues "Mbi kufizimet e konkurrencës "sipas objektit" për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Rregullorja "Për marrëveshjet me rëndësi të vogël"	Udhëzues	Jo	AK	I plotë	2022	II	Jo
8	Konkurrenca	Manuali i Procedurave të sjelljeve anti-konkurrese (Dokument i Komisionit Evropian, Nëntor 2019)	Rregullorja "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren "Për funksionimin e AK"	Manual	Jo	AK	I pjesshëm	2023	III	Jo
8	Konkurrenca	Praktikat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat sipas neneve 101 dhe 102 të TFEU dhe sipas rregullores së Përqëndrimeve (2 Qershor 2015/Dokument i Komisionit Evropian)	Udhëzues "Mbi praktikat më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat e ndjekura në zbatim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr.9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", I ndryshuar, si dhe në rastet e	Udhëzues	Jo	AK	I plotë	2023	IV	Jo



			përqëndrimeve"							
8	Konkurrenca	Njoftim i Komisionit për referimin e rasteve në lidhje me përqëndrimet (2005/C 56/02)	Udhëzues "Mbi referimin e rasteve në lidhje me përqëndrimet"	Udhëzues	Jo	AK	I plotë	2024	III	Jo
9	SHËRBIMET FINANCIARE									
9	Shërbimet jo Bankare	Direktivë (BE) 2016/2341 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 14 dhjetor 2016 "Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)" Numri celex 32016l2341, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.354, datë 23.12.2016, fq. 37-85.	Projektligji "Për Fondet e Pensionit Privat"	Ligj	Jo	MFE/AMF	I pjesshëm	2022	I	Jo
9	Shërbimet Bankare	Direktiva 2014/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 korrik 2014 "Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike"	Ligj "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike"	Ligj	Jo	BSH	I pjesshëm	2022	IV	-
9	Shërbimet Bankare	1. Direktiva 2014/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 korrik 2014 "Mbi krahasueshmërinë e tarifave që lidhen me llogaritë e pagesave, transferimin e llogarive të pagesave dhe aksesin në llogaritë e pagesave me karakteristika bazike" 2. Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/32, datë 28 Shtator 2017 që plotëson Direktivën 2014/92/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, lidhur me standardet teknike rregullative për terminologjinë e standardizuar në Union për shërbimet më përfaqësuese të lidhura me llogarinë e pagesës. 3. Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/33, datë 28 Shtator 2017 që paraqet standardet teknike zbatuese, në lidhje me formatin e standardizuar të prezantimit të pasqyrës mbi tarifat e aplikuar dhe simbolët e përbashkëta sipas Direktivës 2014/92/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. 4. Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/34, datë 28 Shtator 2017 që paraqet standardet teknike zbatuese, në lidhje me formatin e standardizuar të prezantimit të dokumentit që përmban informacion mbi tarifat dhe simbolët e përbashkëta sipas Direktivës 2014/92/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.	Rregullore "Mbi transparencën për tarifat e lidhura me llogarinë e pagesës dhe mbi shërbimin e transferimit të llogarive të pagesës"	Rregullore	Jo	BSH	I pjesshëm	2022	IV	-
9	Shërbimet Bankare	Rregullore (BE) Nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 "Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit, dhe që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 648/2012"	Rishikimi i rregullores nr.69, datë 18.12.2014 "Për kapitalin rregullator të bankës"	Rregullore	Jo	BSH	I pjesshëm	2023	IV	-
9	Shërbimet Bankare	Rregullore (BE) Nr. 575/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 "Mbi kërkesat prudenciale për institucionet e kreditit dhe shoqëritë e investimit, dhe që ndryshon Rregulloren (BE) Nr. 648/2012"	Rishikimi i rregullores nr.48, datë 31.7.2013 "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"	Rregullore	Jo	BSH	I pjesshëm	2023	IV	-
10	SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA									
10	10.1 Komunikimet Elektronike	Direktiva (BE) 2018/1972 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2018 për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	Ligj "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".	Ligj	Jo	MIE	I pjesshëm	2022	IV	Po
10	10.2 Shërbimet e Shoqërisë së Informacionit	Rregullorja e BE-së nr. 910/2014 i Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, i korrikut 2014 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm"	Projektligji "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara"	Ligj	Jo	KM/AKCESK	I plotë	2022	IV	Po
10		Direktiva e BE-së 2016/1148 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 korrik 2016 lidhur me masat për një nivel të lartë sigurie të rrjetëve dhe sistemeve të informacionit në të gjithë Evropën	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.2/2017" "Për sigurinë kibernetike"	Ligj	Jo	KM/AKCESK	I plotë	2022	IV	Po
10		Rregullorja (BE) 2018/1807 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 nëntor 2018 për kuadrin e qarkullimit të lirë të të dhënave jopersonale në Bashkimin Evropian	Projektligji "Për qarkullimin e lirë të të dhënave jopersonale"	Ligj	Jo	MIE	I pjesshëm	2023	II	Po
10	10.3 Politika audiovizive	Direktiva (BE) 2018/1808 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 nëntor 2018 që ndryshon Direktivën 2010/13/BE për koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose veprime administrative në Shtetet Anëtare në lidhje me ofrimin e mediave audiovizive shërbimet (Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizive) në funksion të ndryshimit të realiteteve të tregut	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.	Ligj	Jo	MIE	I pjesshëm	2022	IV	Po
11	BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL									
11	Organizimi i Përbashkët i Tregut	Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/273 e 11 Dhjetorit 2017 që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëuese dhe certifikimin, regjistrin i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe plotësimi i Rregullores (BE) Nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kontrollat dhe gjobat përkatëse, që ndryshon Rregulloret e Komisionit (KE) Nr. 555/2008, (KE) Nr. 606/2009 dhe (KE) Nr. 607/2009 dhe shfaqizojn Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 436/2009 dhe Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2015/560	Urdher Ministri "Për miratimin e formatit të aplikimit për regjistrim në regjistrin e vreshtave, formatit të ndryshimit të të dhënave dhe rregullave shtesë për funksionimin e regjistrit të vreshtave"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Jo
11	Organizimi i Përbashkët i Tregut	Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/273 e 11 Dhjetorit 2017 që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëuese dhe certifikimin, regjistrin i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe plotësimi i Rregullores (BE) Nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kontrollat dhe gjobat përkatëse, që ndryshon Rregulloret e Komisionit (KE) Nr. 555/2008, (KE) Nr. 606/2009 dhe (KE) Nr. 607/2009 dhe shfaqizojn Rregulloren e Komisionit (KE) Nr.	Urdher "Për miratimin e rregullave për mbajtjen e deklaratave të detyrueshme, formularët që duhet të plotësohen nga operatorët dhe mënyra e grumbullimit të informacionit për prodhimin potencial"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Jo



		436/2009 dhe Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2015/560								
11	Organizimi i Përbashkët i Tregut	Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/273 e 11 Dhjetorit 2017 që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me skemën e autorizimeve për mbjelljet e vreshtave, regjistrin e vreshtave, dokumentet shoqëruese dhe certifikimin, regjistrin i hyrje-daljeve, deklaratat e detyrueshme, njoftimet dhe publikimi i informacionit të njoftuar, dhe plotësimi i Rregullores (BE) Nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kontrollin dhe grabit përkatëse, që ndryshon Rregulloret e Komisionit (KE) Nr. 555/2008, (KE) Nr. 606/2009 dhe (KE) Nr. 607/2009 dhe shfaqon Rregulloren e Komisionit (KE) Nr. 436/2009 dhe Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2015/560	Urdher Ministri "Për miratimin e e rregullave të detajuara për regjistrat e hyrje - daljeve"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	II	
11	Organizimi i Përbashkët i Tregut	Rregullore (EU) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013 Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2019/934 e 12 Marsit 2019 që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me zonat e rritjes së verës ku forca alkoolike mund të rritet, praktikat e autorizuar enologjike dhe kufizimet e zbatueshme për prodhimin dhe konservimin e produkteve të rrushit, përgjendjen minimale të alkoolit për nënproduktet dhe asgjësimin e tyre, dhe publikimin e dosjeve OIV Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/935 e 16 Prillit 2019 që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) Nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me metodat e analizave për përcaktimin e karakteristikave fizike, kimike dhe organoleptike të produktet të rrushit për vere dhe njoftimet e vendimeve të Shteteve Anëtare në lidhje me rritjen e forcës alkoolike natyrore	Urdher Ministri "Rregulla të detajuara në lidhje me praktikën enologjike, protokollet dhe metodat e analizave për produktet e rrushit për verë, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare (OIV) të prodhimit të verës, veçanërisht pasurimi, acidifikimi dhe de-acidifikimi si dhe kufizimet që aplikohen"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	III	
11	Organizimi i Përbashkët i Tregut	Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) 2015/1366 e 11 majit 2015 që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me mbështetjen e sektorit të Bletarisë.	Ligji për Bletarinë	Ligj	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Jo
11	Bujqësia organike	Rregullore e Këshillit Europian Nr. 889/2008, datë 05 shtator 2008, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit 834/2007, "Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike në lidhje me prodhimin biologjik, etiketimin dhe kontrollin", të ndryshuar.	Urdhër Ministri "Për miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik".	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Jo
11	Zhvillimi Rural		Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027	VKM	Po	MBZHR		2022	I	Jo
12	POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE FITOSANITARE									
12	Tregëtia në kafshët e gjalla, spermës, vezëve dhe embrioneve për shpendët dhe vezët për celje	Vendimi i Komisionit 93/152 / EEC i 8 Shkurt 1993 që përcakton kriteret për vaksinat që do të përdoren kundër sëmundjes së Pseudopestit në kontekstin e programeve rutinore të vaksinimit	Draft Urdhër Ministri "Mbi vendosjen e kriterëve të përdorimit të vaksinave që përdoren kundër sëmundjes së Pseudopestit në programet e vaksinimit rutinë."	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Jo
12	Masat e kontrollit për sëmundjet e kafshëve	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2018/1882 e 3 dhjetorit 2018 për aplikimin e disa rregullave të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve të kategorive të listuara dhe krijimin e një liste të llojeve dhe grupeve të specieve që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e atyre	Draft Urdhër Ministri "Mbi zbatimin e disa rregullave të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve të kategorive të listuara dhe krijimin e një liste të llojeve dhe grupeve të specieve që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Jo
12	Rregullat specifike të kontrollit për produktet e kafshëve Specific control rules for animal products	Rregullorja (BE) 2016/429 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 9 mars 2016 mbi sëmundjet e transmetueshme të kafshëve dhe ndryshimin dhe shfaqimin e disa aktive në fushën e shëndetit të kafshëve ("Ligji për Shëndetin e Kafshëve")	Projekt Ligj "Për Shëndetin e Kafshëve"	Ligj	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12	Tregëtimi i spermës, vezëve dhe embrioneve të kafshëve të gjalla brenda BE	Vendimi i Komisionit 2004/226/EC i 4 Marsit 2004 që miraton testet për zbulimin e antitrapave kundër brucelozës së gjedhit në kuadër të Direktivës së Këshillit 64/432/EEC	Draft Urdhër Ministri "Mbi miratimin e testeve të zbulimit të antitrapave kundër brucelozës së gjedhit"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	IV	Jo
12	Kontrolli i sistemit të importit	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/2130 e 25 nëntorit 2019 që përcakton rregullat e hollësishme për operacionet që do të kryhen gjatë dhe pas kontrollave dokumentare, kontrolleve të identitetit dhe kontrolleve fizike të kafshëve dhe mallrave që i nënshtrohen kontrolleve zyrtare në postat e kontrollit kufitar	Draft Urdhër Ministri "Mbi përcaktimin e rregullave që duhet të kryhen gjatë dhe pas kontrollit të dokumentacionit, kontrollit të identitetit dhe kontrollit fizik të kafshëve dhe të mirave, që janë subjekt i kontrolleve zyrtare në PKK"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	III	Jo



12	POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE FITOSANITARE	Rregullorja (BE) 2017/625 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 mars 2017 mbi kontrollin zyrtar dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet për mbrojtjen e bimëve , duke ndryshuar Rregulloret (EC) Nr 999/2001, (EC) Nr 396/2005, (EC) Nr 1069/2009, (EC) Nr 1107/2009, (EU) Nr 1151/2012, (EU) Nr 652/2014 , (BE) 2016/429 dhe (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Rregulloret e Këshillit (EC) Nr 1/2005 dhe (KE) Nr 1099/2009 dhe Direktivat e Këshillit 98/58/EC, 1999 /74/EC, 2007/43/EC, 2008/119/EC dhe 2008/120/EC, dhe duke shfuqizuar Rregulloret (EC) Nr. 854/2004 dhe (EC) Nr. 882/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat e Këshillit 89/608/EEC, 89/662/EEC, 90/425/EEC, 91/496/EEC, 96/23/EC, 96/93/EC dhe 97/78/EC dhe Vendimi i Këshillit 92/438/ EEC (Rregullorja Zyrtare e Kontrollleve)	Projekt Ligj "Për kontrollin zyrtar dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet e mbrojtjes së bimëve "	Ligj	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Po
12	Kapitulli 10 Kontaminantet	RREGULLORE (KE) Nr. 124/2009 e datës 10 shkurt 2009 vendosja e niveleve maksimale për praninë e koksidiostateve ose histomonostateve në ushqim që rezultojnë nga bartja e pashmangshme e këtyre substancave në ushqimin për kafshë jo të synuar	Draft Udhëzim "Mbi vendosjen e niveleve maksimale për praninë e koksidiostateve ose histomonostateve në ushqim që rezultojnë nga bartja e pashmangshme e këtyre substancave në ushqimin për kafshë jo të synuar"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Jo
12	Kapitulli 9 Ushqime të ngjira shpejt	Direktiva e Komisionit 92/2 / KEE e datës 13 janar 1992 që përcakton procedurën e marrjes së mostrave dhe metodën e Komunitetit të analizës për kontrollin zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngjira shpejt të destinuara për konsum njerëzor	Draft Udhëzim "Përcaktimi i procedurës së marrjes së mostrave dhe metoda e Komunitetit për analizën e kontrollit zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngjira shpejt të destinuara për konsum njerëzor"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Jo
12	Kapitulli 2 Rregulla specifike për produktet e kafshëve	Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 101/2013 e datës 4 shkurt 2013 në lidhje me përdorimin e acidit laktik për të zvogëluar kontaminimin mikrobiologjik të sipërfaqes në karkasat e gjedhit	Draft Udhëzim "Përdorimi i acidit laktik për të zvogëluar kontaminimin e sipërfaqes së karkasave të gjedhit"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	III	Jo
12	Kapitulli 2 Rregulla specifike për produktet e kafshëve	2011/25/BE: Rekomandimi i Komisionit i datës 14 janar 2011 për krijimin e udhëzimeve për dallimin midis materialeve të ushqimit për kafshë, aditivëve të ushqimit për kafshë, produkteve biocidale dhe produkteve mjekësore veterinare	Draft Udhëzim " Për dallimin midis materialeve të ushqimit për kafshë, aditivëve të ushqimit për kafshë, produkteve biocidale dhe produkteve mjekësore veterinare"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12	Kapitulli 1 Materialet e ushqimit për kafshë	Rregullore e deleguar e Komisionit (BE) 2019/2090 e datës 19 qershor 2019 që plotëson Rregulloren (BE) 2017/625 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian në lidhje me rastet e mospërfutjes së dyshuar ose të konstatuar me rregullat e Bashkimit të zbatueshme për përdorimin ose mbajtjen e substancave farmakologjike aktive të autorizuar në produkte medicinale veterinare ose si aditivë për ushqimin për kafshë ose me rregullat e Bashkimit të zbatueshme për përdorimin ose mbajtjen e substancave të ndaluara ose të substancave aktive farmakologjike paautorizuara.	Draft Udhëzim "Në lidhje me rastet e mospërfutjes së dyshuar ose të konstatuar me rregullat e zbatueshme për përdorimin ose mbajtjen e substancave farmakologjike aktive të autorizuar në produkte medicinale veterinare ose si aditivë për ushqimin për kafshë ose me rregullat e zbatueshme për përdorimin ose mbajtjen e substancave të ndaluara ose të substancave aktive farmakologjike paautorizuara".	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12	Kapitulli Substancat e padëshiruara	Rekomandimi i Komisionit nr 2004/704/EC i datës 11 tetor 2004 mbi monitorimin e niveleve të dioksinave dhe PCB-ve të ngjashme me dioksinin në ushqimet për kafshë	Draft Udhëzim "Mbi monitorimin e niveleve të dioksinave dhe PCB-ve të ngjashme me dioksinin në ushqimet për kafshë"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	III	Jo
12	Kapitulli Sistemi i kontrollit për importin	Rregullore Zbatuese e Komisionit (BE) 2019/1715 e datës 30 Shtator 2019 që përcakton rregullat për funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit për kontrollin zyrtar dhe përbërësit e sistemit të tij (Rregullorja IMSOC)	Draft Udhëzim "Përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit për kontrollin zyrtar dhe përbërësit e sistemit të tij"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	IV	Jo
12	Kapitulli 2 Aditivët e autorizuar dhe kriteri i pastërtisë	Rregullore(BE) Nr. 1333/2008 e Këshillit dhe Parlamentit Evropian "Aditivët në produktet ushqimore"	Draft Udhëzim "Për Aditivët në produktet ushqimore"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Po
12	Kapitulli 1 Enketimi	Rregullore Zbatuese e Komisionit (BE) Nr.828/2014 e 30 korrikut 2014 "Mbi kërkesat për dhënie të informacionit konsumatorëve për mungesën ose reduktimin e pranisë së glutenit në ushqim.	Draft Udhëzim "Mbi kërkesat për dhënie të informacionit konsumatorëve për mungesën ose reduktimin e pranisë së glutenit në ushqim".	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Jo
12	Kapitulli 6 Materialet në kontakt me ushqimin	Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 284/2011 e 22 Marsit 2011 "Për përcaktimin e kushteve specifike dhe procedurave të hollësishme për importin e enëve të gatimit poliamide dhe melamine me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës dhe Rajoni Special Administrativ Hong Kong, Kinë.	Draft Udhëzim "Për përcaktimin e kushteve specifike dhe procedurave të hollësishme për importin e enëve të gatimit poliamide dhe melamine me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës dhe Rajoni Special Administrativ Hong Kong, Kinë.	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	III	Jo
12	Kapitulli 6 Materialet në kontakt me ushqimin	Direktiva e Këshillit 85/572/EEC e 19 dhjetorit 1985 "Për përcaktimin e listës së simulantëve që do të përdoren për testimin e migrimit të përbërësve të materialeve plastike dhe artikujve që synojnë të vijnë në kontakt me ushqimet.	Draft Udhëzim "Për përcaktimin e listës së simulantëve që do të përdoren për testimin e migrimit të përbërësve të materialeve plastike dhe artikujve që synojnë të vijnë në kontakt me ushqimet.	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	III	Jo



12	Kapitulli 5 Aromatizuesit	Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 873/2012 e 1 Tetorit 2012 "Mbi masat kalimtare në lidhje me listën e aromave dhe materialeve burimore të Bashkimit të përcaktuara në Shtojcën I të Rregullores (KE) Nr. 1334/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit	Draft Udhëzim "Mbi masat kalimtare në lidhje me listën e aromave dhe materialeve burimore"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	III	Jo
12	Kapitulli 5 Aromatizuesit	Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 907/2013 e 20 Shtatorit 2013 "Për përcaktimin e rregullave për aplikimet në lidhje me përdorimin e përshkruesve gjenerikë (emërtimet)"	Draft Udhëzim "Për përcaktimin e rregullave për aplikimet në lidhje me përdorimin e përshkruesve gjenerikë (emërtimet)"	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	III	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	Vendimi i Komisionit 98/109/KE i datës 2 shkurt 1998 që autorizon përkohësisht shtetet anëtare të marrin masa urgjente kundër përhapjes së Thrips palmi Karny në lidhje me Tajlandën	Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve, Thrips palmi	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/1201 e datës 14 gusht 2020 në lidhje me masat për të parandaluar futjen dhe përhapjen brenda Unionit të Xylella fastidiosa (Wells et al.) Vendimi i Komisionit 2002/757/EC i datës 19 shtator 2002 mbi masat fitosanitare të përkohshme emergjente për të parandaluar futjen dhe përhapjen brenda Komunitetit të Phytophthora ramorum Werres, De Cock & Man in 't Veld sp.	Draft Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve, Xylella fastidiosa (Wells et al.)	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	RREGULLORJA ZBATUESE E KOMISIONIT (BE) 2019/2072 e datës 28 nëntor 2019 krijim i kushteve uniforme për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, në lidhje me masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve dhe shfaqizimin e Rregullores së Komisionit (KE) Nr. 690/2008 dhe ndryshimin e Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2018/2019	Draft Urdhër "Masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	RREGULLORE E KOMISIONIT PËR ZBATIM (BE) 2020/1770 e datës 26 nëntor 2020 për llojet dhe llojet e bimëve për mbijellje që nuk përjashtohen nga kërkesa e kodit të gjurmueshmërisë për pasaportat e bimëve sipas Rregullores (BE) 2016/2031 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Komisionit shfuqizues Direktiva 92/105/KEE.	Draft Udhëzim "Per procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t'u miratuar për lëshimin e "Pasaportës Bimore" si dhe rastet e heqjes së miratimit".	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	RREGULLORE (BE) 2016/2031 E PARLAMENTIT EVROPIAN TË KËSHILLIT e datës 26 tetor 2016 mbi masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve, që ndryshon Rregulloret (BE) Nr. 228/2013, (BE) Nr. 652/2014 dhe (BE) Nr. 2014 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit dhe shfuqizimi i Direktivave të Këshillit 69/464/EEC, 74/647/EEC, 93/85/EEC, 98/57/EC, 2000/29/EC, 2006/91/EC dhe 2007/33/EC.	Draft Lajg "Per shendetin e bimeve"	Lajg	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	Direktiva 2009/127/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 tetor 2009 që ndryshon Direktivën 2006/42/EC në lidhje me makineritë për aplikimin e pesticideve	Draft Udhëzim për kriteret teknike të mjeteve dhe makinerive, të cilat përdoren për trajtimet me PMB	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12		Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2015/893 i datës 9 qershor 2015 në lidhje me masat për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda Unionit të Anoplophora glabripennis (Motschulsky)	Draft Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve, Anoplophora glabripennis (Motschulsky)	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	Vendimi Zbatues i Komisionit 2012/138/BE i datës 1 mars 2012 në lidhje me masat urgjente për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda Unionit të Anoplophora chinensis (Forster)	Draft Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve, Anoplophora chinensis	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	IV	Jo
12	POLITIKAT FITOSANITARE	Vendimi zbatues i Komisionit 2012/270/BE i datës 16 maj 2012 në lidhje me masat urgjente për të parandaluar futjen dhe përhapjen brenda Unionit të Epitrix cucumeris (Harris), Epitrix similis (Gentner), Epitrix subcrinita (Lec.) dhe Epitrix tuberos (Gentner)	Draft Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollin e parazitëve, Epitrix cucumeris (Harris), Epitrix similis (Gentner), Epitrix subcrinita (Lec.) and Epitrix tuberos (Gentner)	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2024	IV	Jo
13	PESHKIMI									
13	Menaxhimi	Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1303/2007 e datës 5 nëntor 2007 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1966/2006 mbi regjistrimin dhe raportimin elektronik të aktivitetit të peshkimit dhe mbi mjetet e gjurmimit të distancës; 2013/410 / EU: Vendimi Zbatues i Komisionit i datës 10 korrik 2013 mbi një kontribut financiar të Bashkimit drejt programeve të kontrollit të peshkimit të Shteteve Anëtare për 2013 (njofutur në dokumentin C. (2013) 4256)	Draft Vendimi i Këshillit të Ministrave "Mbi përcaktimin e rregullave për zbatimin e sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe mbledhjet e anijeve të peshkimit për implementimin e këtij sistemi"	VKM	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	IV	Po
13	Menaxhimi	Rregullorja (BE) Nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit, duke amenduar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1954/2003 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe duke shfuqizuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 2371/2002 dhe (EC) Nr. 639/2004 dhe Vendimi i Këshillit 2004/585/EC.	Draft Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore".	VKM	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	I	Po
13	Menaxhimi	Rregullorja (BE) 2019/1154 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 Qershorit 2019 mbi një plan shumëvjeçar të rimëkëmbjes për peshkun shizë në Mesdhe dhe ndryshimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1967/2006 dhe Rregullores (BE) 2017/2107 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit	Draft Urdhër Ministri "Për miratimin e një plani shumëvjeçar rehabilitimi për peshkun shizë"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	II	Po
13	Menaxhimi	Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2018/161 e 23 Tetorit 2017 për krijimin e një përjashtimi të minimis nga detyrimi i zbarkimit për disa lloje peshkimi të peshkimit të pelagjikeve të vegjël në Detin Mesdhe	Draft Urdhër Ministri "Për përcaktimin e sasive minimale të leqeshme që mund të hidhen në det për disa forma të peshkimit të pelagjikeve të vegjël	Urdhër	Jo	MBZHR	I plotë	2022	II	Po



13	Structural policy	Rregullorja e Deleuar e Komisionit (BE) 2015/531 e 24 Nëntorit 2014 që plotëson Rregulloren (BE) Nr. 508/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që identifikon kostot e pranueshme për mbështetje nga Fondi Evropian Detar dhe i Peshkimit me qëllim përmirësimin e higjienës, shëndetit, sigurisë dhe kushtet e punës së peshkatarëve, mbrojtjen dhe rivendosjen e biodiversitetit detar dhe ekosistemeve, zbutjen e ndryshimeve klimanike dhe rritjen e efikasitetit të energjisë të anijeve të peshkimit	Draft Udhëzim për përcaktimin e kostove të pranueshme që mbështeten nga ndërhyrjet strukturore	Udhëzim	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2022	III	Jo
13	Market policy	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 1419/2013 e datës 17 Dhjetor 2013 në lidhje me njohtjen e organizatave të prodhuesve dhe organizatave ndër-sektoriale shtrirjen e rregullave të organizatave të prodhuesve dhe organizatave ndër-sektoriale dhe publikimin e gimeve të parashikuara sipas parashikohet nga Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit për organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës	Draft Rregullorja Ministri "Për menyrën e njohjes së organizatave prodhuese"	Rregullore	Jo	MBZHR / MSH	I pjesshëm	2022	III	Po
13	Market policy	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 1418/2013 e datës 17 Dhjetor 2013 në lidhje me planet e prodhimit dhe marketingut në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet e peshkimit dhe akuakulturës	Draft Rregullorja Ministri "Për planet e prodhimit dhe marketingut të organizatave të prodhuesve"	Rregullore	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Po
13	Market policy	Rekomandimi i Komisionit 2014/117 / BE i 3 Marsit 2014 mbi krijimin dhe zbatimin e Planeve të Prodhimit dhe Tregimit në përputhje me Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi organizimin e përbashkët të tregjeve në peshkim dhe produktet e akuakulturës	Draft Vendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin dhe zbatimin e planeve të prodhimit dhe marketingut të Organizatave prodhuese"	VKM	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	IV	Po
13		Rregullorja (BE) 2019/473 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 Mars 2019 mbi Agjencinë Evropiane të Kontrollit të Peshkimit	Draft Vendim i Këshillit të Ministrave "Për organizimin e Inspektoratit të peshkimit"	VKM	Jo	MBZHR/Inspektorati Qendror	I pjesshëm	2023	III	Po
13		Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 2740/1999 e 21 Dhjetorit 1999 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1447/1999 që krijon një listë të llojeve të shtjelleve që shkelin seriozisht rregullat e politikës së përbashkët të peshkimit	Draft Rregullore "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për listen e shkeljeve të renda në peshkim"	Rregullore	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	III	Po
13	Market policy	Rregullorja (BE) nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Dhjetorit 2013 mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, duke ndryshuar Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224 / 2009 dhe shfuqizimi i Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 104/2000	Draft Vendim i Këshillit të Ministrave "Për organizimin e tregut të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës"	VKM	Jo	MBZHR	I pjesshëm	2023	II	Po
13		Vendimi Zbatues i Komisionit (BE) 2018/1986 i datës 13 Dhjetor 2018 për krijimin e programeve specifike të kontrollit dhe inspektimit për disa aktivitete peshkimi dhe shfuqizimin e Vendimeve Zbatuese 2012/807 / BE, 2013/328 / BE, 2013/305 / BE dhe 2014/156 / BE	Draft Urdhër Ministri "Për miratimin e programeve të inspektimit dhe kontrollit të disa formave të peshkimit"	Urdhër	Jo	MBZHR/Inspektorati qendror	I pjesshëm	2023	IV	Po
14	POLITIKA E TRANSPORTIT									
14	14.1	Rregullore (KE) Nr. 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit date 23 tetor 2007, lidhur me shërbimet publike të transportit hekurudhor dhe rrugor të udhëtarëve dhe që shfuqizon rregulloret (EEC) Nr. 1191/69 dhe (EEC) Nr. 1107/70 të Këshillit	Projektudhëzim "Për shërbimet publike të transportit rrugor dhe hekurudhor të udhëtarëve"	Udhëzim	Jo	MIE	I pjesshëm	2023	IV	Jo
14	14.1	Direktiva 1999/37/BE e 29 prill 1999 mbi dokumentet e regjistrimit të mjeteve rrugore.	Udhëzim për lejen e qarkullimit të mjeteve me motor dhe rimorkiove të tyre	Udhëzim	Jo	MIE	I plotë	2022	IV	Jo
14	14.2	Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2007/59/KE e 23 tetorit 2007 për certifikimin e makinistëve që drejojnë lokomotivat dhe trenat në sistemin hekurudhor në Komunitet	Projektudhëzim "Mbi programin e trajnimit profesional, testimin dhe certifikimin dhe licencimin e makinistëve"	Udhëzim	Jo	MIE	I pjesshëm	2022	IV	Po
14	14.2	Direktiva 2016/798/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 maj 2016, "Mbi sigurinë hekurudhore", Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 138, datë 26.5.2016.	Urdhër Për miratimin e Rregullores "Për kryerjen e Investigimit të Aksidentëve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare"	Urdhër	Jo	MIE	I pjesshëm	2022	I	Po
14	14.2	32018R0763: Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2018/763 e datës 9 Prill 2018 që krijon rregullime praktike për lëshimin e certifikatave të vetme të sigurisë për sipërmarrjet hekurudhore	Projektudhëzim për aplikimin dhe përdorimin e formatit të përbashkët për dhenien e certifikatës së sigurisë hekurudhore	Udhëzim	Jo	MIE	I pjesshëm	2023	IV	Po
14	14.2	Rregullore e Komisionit (BE) nr. 1169/2010 e datës 10 Dhjetor 2010 mbi një metodë të përbashkët sigure për të vlerësuar përputhshmërinë me kërkesat për marrjen e një autorizimi të sigurisë hekurudhore, OJ BE L 327, 11.12.2010, f. 13.	Projektudhëzim mbi përcaktimin e metodës së përbashkët të sigurisë dhe kërkesat e përputhshmërisë për marrjen e autorizimit të sigurisë hekurudhore	Udhëzim	Jo	MIE	I pjesshëm	2023	III	Po
14	14.4	Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) 2019/947 e 24 Maj 2019 për rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot	Projektudhëzim "Mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot"	Urdhër	Jo	MIE	I pjesshem	2022	II	Jo
14	14.4	Rregullore e Deleuar e Komisionit (BE) 2019/945 e datës 12 mars 2019 për sistemet e avionëve pa pilot dhe për operatorët e vendeve të treta të sistemeve të avionëve pa pilot	Projektudhëzim "Për sistemet e avionëve pa pilot dhe për operatorët e vendeve të treta të sistemeve të avionëve pa pilot"	Urdhër	Jo	MIE	I pjesshem	2022	II	Jo
14	14.4	Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) 2015/1018 e 29 Qershor 2015 mbi përcaktimin e një liste që klasifikon ngjarjet në avionin civil, për raportim të detyrueshëm sipas Rregullores (BE) nr.376/2014 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.	"Për ngjarjet e detyrueshme që duhen raportuar në avionin civil në Republikën e Shqipërisë"	Urdhër	Jo	MIE	I pjesshem	2022	II	Jo
14	14.4	Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) 2020/469 e datës 14 shkurt 2020, për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr 923/2012, Rregullores (BE) Nr 139/2014 dhe Rregullores (BE) 2017/373 në lidhje me kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/ shërbimet e lundrimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr 73/2010.	"Kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/ shërbimet e lundrimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës"	Urdhër	Jo	MIE	I pjesshem	2023	I	Jo



14	14.4	Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) 2019/1387 e datës 1 gusht 2019, për ndryshimin e Rregullore (BE) Nr 965/2012 për kërkesat për llogaritjet e performancës së uljes së aeroplanit dhe standardet për vlerësimin e kushteve të sipërfaqes së pistës, përditësimin e kërkesave dhe pajisjeve të caktuara të sigurisë së avionëve dhe operimeve pa posedim të një aprovimi operacional me rreze të zgjeruar.	"Mbi kërkesat për llogaritjet e performancës së uljes së aeroplanit dhe standardet për vlerësimin e kushteve të sipërfaqes së pistës, përditësimin e kërkesave dhe pajisjeve të caktuara të sigurisë së avionëve dhe operimeve pa posedim të një aprovimi operacional me rreze të zgjeruar"	Urdhër	Jo	MIE	I plotë	2023	II	Jo
14	14.4	Rregullore e Zbatimit të Komisionit (BE) 2021/664 e datës 22 prill 2021 për një kuadër rregullator për hapësirën ajrore U-space	Projektturdhër "Mbi një kuadër rregullator për hapësirën ajrore"	Urdhër	Jo	MIE	I plotë	2023	III	Jo
14	4.3	Direktivën e Komisionit 2014/100/BE e 28 tetorit 2014 që ndryshon Direktivën 2002/59/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e një sistemi komunitar të monitorimit dhe informacionit të trafikut të anijeve.	Projektturdhër i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullore për sistemin e monitorimit dhe të informacionit të trafikut të anijeve (VTMIS)"	VKM	Jo	MIE	I plotë	2023	IV	Jo
14	4.3	Direktiva 2003/25/EC e Parlamentit dhe e Këshillit e datës 14 Prill 2003 "Mbi kërkesat specifike për anijet Ro/Ro për pasagjerë" e ndryshuar	Projekt-urdhër "Për miratimin e rregullore "Mbi kërkesat specifike për anijet Ro-Ro për pasagjerë""	Urdhër	Jo	MIE	I plotë	2022	IV	Jo
14	4.3	Direktiva 2008/106/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 Nëntor 2008 "për nivelin minimal të trajnimit të detarëve", e ndryshuar.	Projekt-urdhër "Për miratimin e rregullore "Për nivelin minimal të trajnimit të detarëve""	Urdhër	Jo	MIE	I plotë	2022	IV	Jo
15	ENERGJIA									
15	15.2 - Burimet e rinovueshme të energjisë	"DIREKTIVA (BE) 2018/2001 e datës 11 dhjetor 2018 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" Inkorporuar dhe përshtatur me Vendimin e Këshillit Ministror 2021/14 / MC-EnC e datës 30 nëntor 2021 për inkomporimin e Direktivës (BE) 2018/2001 në acquis communautaire të Komunitetit të Energjisë dhe duke amenduar nenin 20 dhe aneksin I të Traktatit. "	Projektligji për ndryshimin e ligjit nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"	Ligi	Jo	MIE	I pjesshëm	2022	IV	Jo
15	15.2 - Burimet e rinovueshme të energjisë	"DIREKTIVA (BE) 2018/2001 e datës 11 dhjetor 2018 për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" Inkorporuar dhe përshtatur me Vendimin e Këshillit Ministror 2021/14 / MC-EnC e datës 30 nëntor 2021 për inkomporimin e Direktivës (BE) 2018/2001 në acquis communautaire të Komunitetit të Energjisë dhe duke amenduar nenin 20 dhe aneksin I të Traktatit. "	Projektvendim për Kontratën standarde për Diferencë (CfD) për prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë	VKM	Jo	MIE	I pjesshëm	2022	IV	Jo
16	TATIMET									
16	Legjisacioni Tatimor	Direktivë e Këshillit (BE) 2016/1164 e 12 Korrik 2016 e cila përcakton rregullat kundër praktikave të shmagjes së tatimeve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e tregut të brendshëm	Ligji i ri i Tatimit mbi të Ardhurat	Ligi	Jo	MFE	I pjesshëm	2022	IV	Jo
17	POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE									
17	Politika Monetare	Traktati për Bashkimin Evropian (TEU) (12012M/TXT)Titulli VIII, neni 119-144; Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) (12012M/TX1)A 119-143; 219; 258; 271; 282; 352 2. Protokolli nr. 4 mbi Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane (Protokolli nr. 4)	Rishikimi i Ligjit nr. 8269/1997 "Per Banken e Shqipërisë", i ndryshuar	Ligi		MFE (drafiti hartohet nga BSH, por komptencen propozuese prane Keshillit te Ministrave e ka MFE)	I pjesshëm	2022	IV	Jo
18	STATISTIKAT									
18	Statistikat Sektoriale	Rregullorja (BE) 2018/1091 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 korrik 2018 mbi statistikën e integruar të fermave dhe shfrytëzimit të Rregulloreve (KE) Nr 1166/2008 dhe (BE) Nr 1337/2011	Projektligji "Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore"	Ligi	Po	INSTAT	I plotë	2023	II	Po
18	Statistika ekonomike	Vendimi i Komisionit Nr 98/715/EC i datës 13 nëntor 1998, që sqaron aneksin a të Rregulloreve të Këshillit (EC) Nr 2223/96 mbi sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Komunitet lidhur me parimet për matjen e çmimeve dhe vëllimeve, OJ L 340, 16.12.1998	Projekt-Udhëzëm i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT "Në mbështetje të implementimit të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare"	Udhëzim	Jo	INSTAT	I pjesshëm	2023	IV	Jo
18	Statistika ekonomike	Vendimi i Komisionit Nr 2002/990/EC i datës 17 dhjetor 2002, duke sqaruar më tej Aneksin A të Rregulloreve të Këshillit (EC) Nr 2223/96 lidhur me parimet për matjen e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritjet kombëtare, OJ L 347, 20.12.2002	Projekt-Udhëzëm i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT "Në mbështetje të implementimit të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare"	Udhëzim	Jo	INSTAT	I pjesshëm	2023	IV	Jo
18	Statistikat Sektoriale	• DIREKTIVA E KËSHILLIT 96/16/KE e datës 19 mars 1996 mbi anketat statistikore të qumështit dhe produkteve të qumështit Vendimi i Komisionit i datës 18 dhjetor 1996 që përcakton dispozitat doën për zbatimin e Direktivës së Këshillit 96/16/EC mbi anketat statistikore të qumështit dhe produkteve të qumështit	Projekt-Udhëzëm i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT "Për Vrojimet Statistikore të Qumështit dhe të Nën-Produkteve Të Tjër"	Udhëzim	Jo	INSTAT	I pjesshëm	2023	III	Jo
18			Projekt-Udhëzëm i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT "Për zbatimin e rregullore për Vrojimet Statistikore të Qumështit dhe të Nën-Produkteve Të Tjër"	Udhëzim	Jo	INSTAT	I pjesshëm	2023	III	Po
18	Statistika ekonomike	Klasifikimi i produkteve sipas aktivitetit, versioni 2.1 i CPA, Struktura dhe shënime shpjeguese 2015	Projektvendim "Për zbatimin e Nomenklaturës së produkteve sipas aktivitetit"	VKM	Jo	INSTAT	I plotë	2022	IV	Jo



18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja (EC) Nr. 1177/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 qershor 2003 lidhur me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC). OJ L 165, 5.7.2003, f. 1-9								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1980/2003 e datës 21 tetor 2003 për zbatimin e Rregullores (EC) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me përkufizimet dhe përditësuarat e përditësuarat. OJ L 298, 17.11.2003, f. 1-22								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me aspektet e punës në terren dhe procedurat e imputimit. OJ L 298, 17.11.2003, f. 23-2								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1982/2003 e datës 21 tetor 2003 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me rregullat e marrjes së mostrave dhe gjurmimit. OJ L 298, 17.11.2003, f. 29-33								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1983/2003 e datës 7 nëntor 2003 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me listën e variablave parësore të synuar. OJ L 298, 17.11.2003, f. 34-85								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 28/2004 e datës 5 janar 2004, duke zbatuar Rregulloren (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me përmbajtjen e detajuar të raporteve të cilësishë së ndërmjetme dhe përfundimtare, OJ L 5, 9.1.2004								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/2256 e datës 4 dhjetor 2015 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 1983/2003 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me listën e variablave parësore të synuar. (1) OJ L 321, 5.12.2015, f. 12-16	Projekt- Udhëzim "Për Zbatimin e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës"	Udhëzimi i Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT	Jo	INSTAT	I pjesshëm	2023	IV	Po
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja (EC) Nr. 1553/2005 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 shtator 2005, që ndryshon Rregulloren nr. 1177/2003 lidhur me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC). OJ L 255, 30.9.2005								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 676/2006 e datës 2 maj 2006, që ndryshon Rregulloren (EC) Nr. 1980/2003 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me përkufizimet dhe përditësuarat, OJ L 118, 3.5.2006, f.3								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/2256 e datës 4 dhjetor 2015 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 1983/2003 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me listën e variablave parësore të synuar. (1) OJ L 321, 5.12.2015, f. 12-16								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (BE) 2016/114 e datës 28 janar 2016 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me listën e 2017 të objektivave dytësore variabla për shëndetin dhe shëndetin e fëmijëve, OJ L 23, 29.1.2016, f. 40-46								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/310 e datës 22 shkurt 2017 që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me listën e variablave dytësore të synuar për privimin material, mirëqenien dhe vështirësitë e strehimit për vitin 2018, OJ L 45, 23.2.2017, f. 1-9								
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	Rregullorja e Komisionit (BE) 2018/174 e datës 2 shkurt 2018 që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 1177/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me statistikën e Komunitetit mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) në lidhje me listën e variablave dytësore të synuar mbi transmetimin ndër breza të disavantazheve, përbërjen e familjeve dhe evolucionin e të ardhurave për vitin 2019 (Tekst me rëndësi për ZEE-në). OJ L 32, 6.2.2018, f. 35-47								
18	Statistikat monetare, financiare dhe të normave të interesit	Rregullore (BE) Nr. 1073/2013 e Bankës Qendrore Evropiane e 18 Tetorit 2013 në lidhje me statistikën mbi asetet dhe detyrimet e fondeve të investimeve (rishikuar) (BQE / 2013/38)	Projekt- Rregullore e Statistikave Monetare dhe Financiare "Mbi raportimin statistikor të fondeve të investimeve " në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Vendimi i Këshillit Mbikqyrës të BSH	Jo	BSH	I plotë	2022	IV	Po



18	Statistikat monetare, financiare dhe të normave të interesit	Rregullore (BE) Nr. 1374/2014 e Bankës Qendrore Evropiane e 28 Nëntorit 2014 mbi kërkesat e raportimit statistikor për kompanitë e sigurimeve (BQE / 2014/50)	Projekt - Rregullore e Statistikave Monetare dhe Financiare "Mbi raportimin statistikor të kompanive të sigurimit " në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Vendim i Këshillit Mbikqyrës të BSH	Jo	BSH	I plotë	2022	IV	Po
18	Statistikat monetare, financiare dhe të normave të interesit	Rregullore (BE) 2018/231 e Bankës Qendrore Evropiane e 26 Janarit 2018 mbi kërkesat e raportimit statistikor për fondet e pensionit (BQE / 2018/2)	Projekt - Rregullore e Statistikave Monetare dhe Financiare "Mbi raportimin statistikor të fondeve të pensione " në përputhje me standardet ndërkombëtare.	Vendim i Këshillit Mbikqyrës të BSH	Jo	BSH	I plotë	2022	IV	Po
19	POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI									
19	Mundësi të barabarta dhe Antidiskriminim; Përfshirja Sociale; Mbrojtje Sociale; Afësi të Kufizuara, Mundësi Punësimi	Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 5.07.2006 mbi zbatimin e mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (reformuar)	"Për indeksimin e pensione"	VKM	Jo	MFE	I pjesshëm	2022	II	Po
19	Mundësi të barabarta dhe Antidiskriminim; Përfshirja Sociale; Mbrojtje Sociale; Afësi të Kufizuara, Mundësi Punësimi	Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 5.07.2006 mbi zbatimin e mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (reformuar)	Projekt vendim " Per miratimin e koeficientit te indeksimit te bazes se vleresuar per llogaritjen e pensione"	VKM	Jo	MFE	I pjesshëm	2022	II	Po
19	Përfshirja Sociale dhe PAK	Vendimi I Këshillit 26.11.2009 mbi konkluzionet, e Komunitetit Evropian, te Konventes per Kombet e Bashkuara, mbi te Drejtat e Personave me Afësi te Kufizuara. OJ L 23, 27.1.2010	Ligji "Përfshirja dhe aksesueshmëria e PAK"Nr 93/2014 dhe aktet nënligjore	ligj	Jo	MSHMS	I pjesshëm	2023	IV	Po
20	NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE									
20	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
21	RRJETET TRANS-EVROPIANE									
21	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
22	POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURORE									
22	–	–	Pergatitja e dokumentit te planifikimit per orientimin e zbatimit te Politikës Rajonale ne Shqipëri per periudhen 2021-2027	VKM	Po	Zv.Kryeministri/Fondi Shqiptar I Zhvillimit	N/A	2022	II	
22	–	–	Pergatitja/miratimi i Programit Operacional per Zhvillimin Rajonal per periudhen 2021-2027	VKM	Po	Zv.Kryeministri/Fondi Shqiptar I Zhvillimit	N/A	2022	IV	
22	–	–	Ngritja e struktures institucionale dhe organizative te sistemit te menaxhimit dhe kontrollit per zbatimin e Programit Operacional per Zhvillimin Rajonal per periudhen 2021-2027	VKM	Po	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Autoritet Menaxhues)	N/A	2022	IV	
23	GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE									
23	3	Rregullorja (BE) 2016/679 , e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 27 prillit 2016, mbi mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla, dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/EC (Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave) (FZ L.119 i 4 majit 2016, f. 1); Direktiva (BE) 2016/680 , e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 prill 2016, "Mbi mbrojtjen e personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose çkërkutimin e dënimeve penale, dhe mbi lëvizjen e lirë e të dhënave të tilla dhe shfuqizimi i vendimit Kornizë të Këshillit 2008/977/JHA (FZ L.119, i 4 majit 2016, f. 89).	Miratimi i Projektligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale"	Ligj	Jo	MD	I plotë	2022	IV	Po



23	2	Direktiva (BE) 2017/1371, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 korrikut 2017, mbi luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiarë të Bashkimit me anë të ligjit penal; (Kap. 23) Direktiva (BE) 2015/849, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 20 majit 2015, mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, duke ndryshuar Rregulloren (BE) nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe i Këshillit dhe shfuqizimi i direktivës 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe direktivës së Këshillit dhe Komisionit 2006/70/EC (teksti me rëndësi për EEA); (Kap. 23) Direktiva 2014/42/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 3 prillit 2014, mbi ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian; (Kap. 23) Direktiva (BE) 2017/541, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 mars 2017, mbi luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit Kornizë të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit 2005/671/JHA (Kap. 24); Direktiva 2014/62/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014, mbi mbrojtjen e euros dhe monedhave të tjera kundër falsifikimit nga ligji penal dhe zëvendësimin e vendimit Kornizë të Këshillit 2000/383/JHA (Kap. 24); Direktiva 2011/36/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të saj, dhe zëvendësimin e vendimit të Kuadrit të Këshillit 2002/629/JHA (Kap. 24); Direktiva 2011/93/BE, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 13 dhjetorit 2011, mbi luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, dhe zëvendësimin e vendimit Kornizë të Këshillit 2004/68/JHA (Kap. 24); Direktiva e Këshillit 89/654/EEC, e 30 nëntorit 1989, në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendin e punës (direktiva e parë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të direktivës 89/391/KEE) (Kap. 19); Direktiva 89/391, e Këshillit të BE-së, "Mbi nxirjen dhe sigurimin e shëndetit dhe shëndetit të punonjësve në ambientin e punës (Kap. 19); Direktiva 2004/757/BE "Për vendosjen e rregullave minimum mbi elementet përbërëse të veprave penale dhe sanksioneve në fushën e trafikimit të drogës" (Kap. 24).	Miratimi i projektligjit "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".	Ligi	Jo	MD	I plotë	2023	IV	Po
23	3	Protokolli që ndryshon Konventën ETS 108 e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"	Miratimi i Projektligjit "Për ratifikimin e Protokolli të ndryshon Konventën ETS 108 "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale"	Ligi	Jo	MD		2022	IV	Jo
23	1	Rekomandim i KE Vijimi i konsolidimit të kapacitetit të sistemit gjyqësor dhe të institucioneve të qeverisjes, duke përfshirë fuqizimin e mëtejshëm të sistemit për edukimin ligjor dhe duke finalizuar dhe zbatuar hartën e re gjyqësore	Miratimi i Projektvendimit " Për miratimin e hartës së re gjyqësore"	VKM	Jo	MD/KLGJ		2022	IV	Jo
23	2	Rekomandim i KE Vijimi i fuqizimit të luftës kundër korrupsionit; arritja e progresit të mëtejshëm drejt krijimit të një historiku hetimesh, ndjekjes penale dhe gjykimi të çështjeve të korrupsionit, sekuestërimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale që vijnë nga veprat e lidhura me korrupsionin	Miratimi i Projektvendimit "Për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive (SEMDRK) "	VKM	Jo	MD		2022	IV	Jo
24	DREJTËSI, LIRI DHE SIGURI									
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Rregullorja (BE) Nr. 656/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 maj 2014 për vendosjen e rregullave për mbikëqirjen e kufijve të jashtëm detarë në kontekstin e bashkëpunimit operacional të koordinuar nga Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operativ në fushën e jashtme Kufijtë e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian	Rregullore "Për rregullat e mbikqyrjes së kufijve detarë në kuadër të bashkëpunimit operacional të koordinuar midis institucioneve kombëtare dhe Agjensise Evropiane për Kufirin dhe Rojen Bregdetare (FRONTEx)"	VKM	Jo	MB, MM, MEPJ, MEF	I pjesshëm	2022	I	Po
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Direktiva (BE) 2017/541 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 15 Mars 2017 për luftën kundër terrorizmit dhe zëvendësimin e vendimit në kuadër të Këshillit 2002/475/JHA dhe ndryshimin e vendimit të Këshillit 2005/671/JHA	Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit 2022-2026 dhe Plani i Veprimat 2022-2024	VKM	Po	Qendra Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	I plotë	2022	II	Po
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Direktiva BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian datë 27.04.2016 mbi përdorimin e të dhënave të regjistrit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave me qëllime terroriste dhe krime të rënda.	Amendimi I ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"	Ligi	Jo	MB MEPJ MEF	I plotë	2023	IV	Jo



24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Direktiva BE 2016/681 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian datë 27.04.2016 mbi përdorimin e të dhenave të regjistrit të emrit të pasagjerit (PNR) me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave me qëllime terroriste dhe krime të rënda. Direktiva e Këshillit 2004/82/KE, datë 29 prill 2004, "Për detyrimin e transportuesve për të komunikuar të dhënat për pasagjerët"	Miratimi i ligjit për API / PNR	Ligj	Jo	MB MEP MEF	I plotë	2023	IV	Jo
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Direktiva 2015/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 12 gusht 2015 mbi sulmet kundër sistemeve të informacionit dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2005/222/JHA. Direktiva (BE) 2019/713 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 prill 2019 për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve të pagesës pa para në dorë dhe zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/413/JHA	Disa shtesa dhe Ndryshime në Kodin Penal, shtimin dhe rregullimin e disa veprave penale ekzistuese, në fushën e krimeve kibernetike.	Ligj	Jo	MB/DPSH/AKSHI/PP/MD/MSHMS/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve/AKEP/AKCESK	I plotë	2023	IV	Po
25	SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR									
25		16.05.2018 (COM(2018) 306 final) "Një axhendë e rinovuar për R&I - shansi i Evropës për të formuar të ardhmen e saj"	PVKM për miratimin e Strategjisë së Specializimit Inteligent	VKM	Po	MAS		2023	III	Po
25		12012E/TEXT Vështrim i përgjithshëm mbi Dispozitat e Traktatit (TFEU) Kapitulli XIX mbi Kërkimin	Ligji për Shkencën	Ligj	Jo	MAS/AKSHI	I pjesshëm	2023	IV	Po
25		12012E/TEXT Vështrim i përgjithshëm mbi Dispozitat e Traktatit (TFEU) Kapitulli XIX mbi Kërkimin	PVKM për miratimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor	VKM	Po	MAS/AKSHI		2023	IV	Po
26	ARSIMI DHE KULTURA									
26		"Rezoluta e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Përfaqësuesve të Qeverive të Shteteve Anëtare që mbledhen brenda Këshillit mbi një kornizë për bashkëpunimin Evropian në fushën e rinisë". Strategjia e Rinisë e Bashkimit Evropian 2019-2027 (2018/C 456/01)	Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 - 2029	VKM	Po	MSHRF	I pjesshëm	2022	III	Po
26		"REKOMANDIMI I KESHILLIT të 26 Nëntorit 2018 në promovimin e njohjes automatike të ndërsjellë të arsimit të lartë dhe arsimit të mesëm të lartë dhe kualifikimeve të trajnimit dhe rezultateve të periudhave të mësimit jashtë vendit". (2018/C 444/01)	Udhëzim nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njëvje kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar	Udhëzim	Jo	MAS	I pjesshëm	2022	II	Po
26	Arsimi	"REKOMANDIMI I KESHILLIT të 22 majit 2017 mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 Prillit 2008 mbi krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës". Rekomandim i Këshillit të 28 qershorit 2011 për reduktimin e braktisjes së hershme të shkollës.	Projektiligji "për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr 69/2012, për Arsimin Parauniversitar".	Ligj	Jo	MAS	I pjesshëm	2022	IV	
26	Bashkëpunimi i BE-së në fushën e arsimit dhe trajnimit	"REKOMANDIMI I KESHILLIT të 22 majit 2017 mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës dhe shfuqizimin e rekomandimit të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 Prillit 2008 mbi krijimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës".	VKM për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar	VKM	Jo	MAS	I pjesshëm	2023	II	Po
26	Arsimi	Rekomandim i Këshillit të 28 qershorit 2011 për reduktimin e braktisjes së hershme të shkollës.	VKM për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfutrimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para-universitar në institucionet arsimore publike"	VKM	Jo	MAS	I pjesshëm	2022	II	
27	MJEDISI									



27	Menaxhimi I mbetjeve	RREGULLORE (KE) Nr. 1069/2009 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KUNSHILLIT të 21 tetorit 2009 që përcakton rregullat shëndetësore në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e prejardhura që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) Nr. 1774/2002 (Kafsha) Rregullorja për nënproduktet dhe Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 142/2011 e 25 Shkurt 2011 për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 1069/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që përcakton rregullat shëndetësore në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e prejardhura që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor dhe zbatimin e RREGULLORE (BE) 2017/625 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KESHILLIT të datës 15 Mars 2017 mbi kontrollin zyrtar dhe aktivitetin e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin e kafshëve, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet e mbrojtjes së bimëve, duke ndryshuar rregulloret (KE) nr. 999/2001, (KE) nr. 396/2005, (KE) Nr. 1069/2009, (KE) Nr. 1107/2009, (BE) Nr. 1151/2012, (BE) Nr. 652/2014, (BE) 2016/429 dhe (BE) 2016/2031 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1/2005 dhe (KE) Nr. 1099/2009 dhe Direktivat e Këshillit 98/58 / KE, 1999/74 / KE, 2007/43 / KE, 2008/119 / KE dhe 2008 / 120 / KE dhe shfuqizimin e Rregullave (KE) Nr. 854/2004 dhe (KE) Nr. 882/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat e Këshillit 89/608 / KEE, 89/662 / KEE, 90/425 / KEE, 91/496 / KEE, 96/23 / KE, 96/93 / KE dhe 97/78 / KE dhe Vendimi i Këshillit 92/438 / KEE (Rregullorja Zyrtare e Kontrolleve)	Projektvendimi "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu"	VKM	Jo	MTM	I pjesshëm	2022	III	Jo
27	Menaxhimi I mbetjeve	DIREKTIVA 2018/851 që amendon direktivën kuadër të mbetjeve 2008/98/EC e 19 Nëntorit 2008, neni 8 dhe neni 8a	Projektligji "Për miratimin e masave të nevojshme që çdo person juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuari i produktit) mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit"	Ligji	Jo	MTM	I pjesshëm	2023	III	Jo
27	Menaxhimi I mbetjeve	Direktiva (BE) 2018/851 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 30 maj 2018 për ndryshimin e Direktivës 2008/98 / EC mbi mbetjet	Projektligji "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	Ligji	Jo	MTM	I plotë	2024	III	Jo
27	Legjislacioni HORIZONTAL Ndotja industriale	Direktiva 2010/75 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 nëntor 2010 mbi emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes	Projektligji "Për lejet e mjedisit"	Ligji	Jo	MTM	I pjesshëm	2023	IV	Jo
27	Ndryshimet Klimatike	Rregullorja (BE) 2018/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 11 dhjetor 2018 mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin për Klimën, e cila amendon Rregulloret (KE) Nr. 663/2009 dhe (KE) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, Direktivat 94/22/KE, 98/70/KE, 2009/31/KE, 2009/73/KE, 2010/31/BE, 2012/27/BE dhe 2013/30/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivat e Këshillit 2009/119/KE dhe (BE) 2015 /652 dhe shfuqizon Rregulloren (BE) Nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregullorja LULUCF (BE) 2018/841 për përfshirjen e emetimeve dhe largimeve të gazeve sërë nga përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyet në kuadrin e klimës dhe energjisë 2030 e cila amendon Rregulloren (BE) Nr. 525/2013 dhe Vendimin Nr. 529/2013/BE	Projektvendim "Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin, verifikimin e shkarkimeve të gazeve me efekte sërë si dhe për përcaktimin e rregullave të përflogantjes së shkarkimeve dhe përfshirjes së tyre"	VKM	Jo	MTM	I pjesshëm	2022	IV	Jo
27	KIMIKATET	Rregullore e BE 2019/1021 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 mbi natotetit organik të qëndrueshem.	Projektvendim "Për disa ndryshime në VKM Nr. 360, datë 29.4.2015 PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E TYRE"	VKM	Jo	MTM	I pjesshëm	2022	IV	Jo
27	Menaxhimi I Ujërave	1. Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU, e ndryshuar, 2. Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi (Direktiva për ujërat nëntokësore; DUN), e ndryshuar, 3. Direktiva 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikës së burimeve ujore, që ndryshon e për rrjedhojë shfuqizon direktivat 82/176/EEC, 85/513/EEC, 84/156/EEC, 84/491/EEC, 86/280/EEC dhe ndryshon direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, ndryshuar me direktivën 2013/39/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 gusht 2013, që ndryshon direktivën 2000/60/EC për substancat prioritare në fushën e politikës së burimeve ujore dhe 4. Direktivën 2009/90/EC të Komisionit, datë 31 korrik 2009, ku përcaktohen, sipas direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, specifimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin e statusit të trupave ujorë (dscm), 5. Direktiva 2010/75/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes (norganizuar) (dei), 6. Direktiva e Këshillit, datë 21 maj 1991, për trajtimin e ujërave të ndotura urbane (91/271/EEC), 7. Direktiva e Këshillit, datë 12 dhjetor 1991, për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga nitratat që vijnë nga burimet bujqësore (91/676/EEC), 8. Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007, për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga	Projektligji "Për ujin"	Ligji	Jo	AMBU	I plotë	2023	II	Jo



		përmblytjet (nrrp)								
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU	Projektvendimi "Për përcaktimin e kufijve midis rajoneve të baseneve ujore dhe caktimin e ujërave të brendshme dhe bregdetare në Rajonet e Baseneve Lumore"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	II	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU	Projektvendimi "Për përcaktimin e autoriteteve kompetente në Rajonet e Baseneve Lumore"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	IV	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU	Projektvendimi "Për elementet çësore të klasifikimit të statusit ekologjik dhe përkufizimet normative të klasifikimit të statusit ekologjik për ujërat sipërfaqësore"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	II	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU	Projektvendimi "Për karakterizimin e Rajoneve të Baseneve Lumore, rishikimin e ndikimit mjedisor të veprimtarisë njerëzore dhe analizën ekonomike të përdorimit të ujit"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	I	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU	Projektvendimi "Për elementet e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	I	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2000, për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës së burimeve ujore, ndryshuar me; Vendimin nr. 2455/2001/EC dhe Direktivën nr. 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU, 2013/64/EU	Projektvendimi "Për monitorimin e statusit ekologjik dhe kimik të ujërave sipërfaqësore, kërkesat shtesë të monitorimit për zonat e mbrojtura dhe klasifikimin e paraqitjen e statusit ekologjik"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	II	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2008/105/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, Për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikës së burimeve ujore, që ndryshon e për rrjedhojë shfuqizon direktivat 82/176/EEC, 85/513/EEC, 84/156/EEC, 84/491/EEC, 86/280/EEC dhe ndryshon direktivën 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, ndryshuar me direktivën 2013/39/EU të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 gusht 2013, që ndryshon direktivën 2000/60/EC për substancat prioritare në fushën e politikës së burimeve ujore dhe Direktivën 2009/90/EC të Komisionit, datë 31 korrik 2009, ku përcaktohen, sipas direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, specififikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin e statusit të trupave ujore (dscm)	Projektvendimi "Për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave për burimet ujore"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	II	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi (Direktiva për ujërat nëntokësore; DUN), e ndryshuar	Projektvendimi "Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkëqisimi"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	I	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva 2010/75/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për emetimet industriale (parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes (riorganizuar) (de)	Projektvendimi "Për vlerat kufi të emetimeve për ujërat e ndotura nga burimet industriale"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	III	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva e Këshillit, datë 21 maj 1991, për trajtimin e ujërave të ndotura urbane (91/271/EEC)(koduar) (DTUNU), ndryshuar me, direktivën e komisionit 98/15/ce, datë 27 shkurt 1998, Rregulloren nr. 1882/2003/EC, Rregulloren nr. 1137/2008/EC dhe Direktivën e Këshillit 2013/64/EU	Projektvendimi "Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	I	Jo
27	Menaxhimi i Ujërave	Direktiva e Këshillit 91/676/EEC e datës 12.12.1991 për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja e shkaktuar nga nitrati me që vijnë nga burimet bujqësore, e ndryshuar me rregulloren 1882/2003/EC dhe rregulloren 1137/2008/EC	Projektvendimi "Për mbrojtjen e ujërave ndaj ndotjes së shkaktuar nga nitrati e burimeve bujqësore"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	III	Jo



27	Menaxhimi I Ujërave	Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 23 tetor 2007, Për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga përmbytjet (MRP)	Projektvendimi "Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet"	VKM	Jo	AMBU	I plotë	2024	II	Jo
27	Menaxhimi I Ujërave	Direktiva 2008/56/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 17 qershor 2008, Për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës detare mjedisore (direktiva kuadër e strategjisë detare; DKSD);	Projektligji "Për strategjinë detare në Republikën e Shqipërisë".	Ligj	Po	AMBU	I plotë	2023	II	Jo
27	Menaxhimi I Ujërave	Direktiva 2008/56/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 17 qershor 2008, Për ngritjen e kuadrit për veprim komunitar në fushën e politikës detare mjedisore (direktiva kuadër e strategjisë detare; DKSD);	Projektvendimi "Për përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë detare në Republikën e Shqipërisë".	VKM	Po	AMBU	I plotë	2023	IV	Jo
28	MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT									
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Direktiva (BE) 2019/771 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 20 majit 2019 mbi aspekte të caktuara në lidhje me kontratat për shitjen e mallrave, që ndryshon Rregulloren (BE) 2017/2394 dhe Direktivën 2009/22 / KE dhe shfuqizon Direktivën 1999/44/KE	Projekt-Ligj "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", i ndryshuar.	Ligj	Jo	MFE	I pjeshëm	2024	IV	Po
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Direktiva (BE) 2019/2161 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 nëntorit 2019 për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 93/13/EEC dhe Direktivave 98/6/EC, 2005/29/EC dhe 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me zbatimin e të mirë dhe modernizimin e rregullave të BE për mbrojtjen e konsumatorëve.	Draft Urdhër Ministri "Mbi përcaktimin e parimeve dhe udhëzimeve për praktikën e mira të prodhimit të produkteve mjekësore veterinare"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjeshëm	2022	IV	Po
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Rregullore (BE) 2019/4 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Dhjetorit 2018 mbi prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit të medikuar për kafshë, duke ndryshuar Rregulloren (KE) Nr. 183/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/167 / KEE	Draft Urdhër Ministri "Për Miratimin e Rregullores mbi prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit të medikuar"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjeshëm	2023	II	Po
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Rregullorja (BE) 2019/6 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 Dhjetorit 2018 mbi produktet mjekësore veterinare dhe shfuqizimin e Direktivës 2001/82 / EC	Draft Urdhër Ministri "Për një ndryshim në Urdhërin Nr.370, datë 29.7.2014 " Për produktet mjekësore veterinare"	Urdhër	Jo	MBZHR	I pjeshëm	2023	IV	Po
28	Shëndeti Publik	Direktiva 2001/83 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 Nëntorit 2001 mbi Kodin e Komunitetit që ka të bëjë me produktet medicinale për përdorim mjekësor (siç është ndryshuar nga Rregullorja 2019/5 / EC).	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.105/2014 "Për Barnat në Shërbimin Farmaceutik", të ndryshuar"	Ligj	Jo	MSHMS	I pjeshëm	2022	IV	Jo
29	SISTEMI DOGANOR									
29	BASHKIMI DOGANOR	Rregullorja Zbatuese e Komisionit që ndryshon Aneksin 1 të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 e datës 23 korrik 1987 mbi tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (OJ L 256 07.09.1987 f. 1), i ndryshuar http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:1987:256:0001:0675:EN:PDF	Draft Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave 2023"	VKM	Jo	MFE/DPD	I pjeshëm	2022	IV	Jo
29	BASHKIMI DOGANOR	Rregullorja Zbatuese e Komisionit që ndryshon Aneksin 1 të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 e datës 23 korrik 1987 mbi tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (OJ L 256 07.09.1987 f. 1), i ndryshuar http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:1987:256:0001:0675:EN:PDF	Draft Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave 2024"	VKM	Jo	MFE/DPD	I pjeshëm	2023	IV	Jo
29	BASHKIMI DOGANOR	Rregullorja Zbatuese e Komisionit që ndryshon Aneksin 1 të Rregullores së Këshillit (EEC) Nr. 2658/87 e datës 23 korrik 1987 mbi tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe mbi tarifën e përbashkët doganore (OJ L 256 07.09.1987 f. 1), i ndryshuar http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:1987:256:0001:0675:EN:PDF	Draft Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave 2025"	VKM	Jo	MFE/DPD	I pjeshëm	2024	IV	Jo
29	Mallrat kulturore	Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 116/2009 e datës 18 dhjetor 2008 mbi eksportin e mallrave kulturore; Rregullorja (BE) Nr. 1081/2012 e datës 9 nëntor 2012 për qëllimet e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 116/2009 mbi eksportin e mallrave kulturore.	Draft Udhëzimi për procedurat dhe mënyrat e daljes së pasurive jashtë vendit, në zbatim të pikës 4, të nenit 123 të ligjit 27/2018	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjeshëm	2023	I	Jo
29	Mallrat kulturore	Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 116/2009 e datës 18 dhjetor 2008 mbi eksportin e mallrave kulturore; Rregullorja (BE) Nr. 1081/2012 e datës 9 nëntor 2012 për qëllimet e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 116/2009 mbi eksportin e mallrave kulturore	Draft Udhëzim për Miratimin e përcaktimeve të përgjithshme, në zbatim të neneve 124, pika 3, dhe 128 pika 3 lidhur me Nenin 123, 124 dhe 128 të ligjit 27/2018	Udhëzim	Jo	MK/IKRTK	I pjeshëm	2023	I	Jo
30	MARRËDHËNIET ME JASHTË									
30	Instrumenti I Politikës së Jashtme/ Kimberly proces	Aneksat II-III-IV të Rregullores (BE) 2019/125 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 Janarit 2019 në lidhje me tregtinë e mallrave të caktuara që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose nënshkrim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues	Projektvendim për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose nënshkrim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues	VKM	Jo	MM	I plotë	2022	IV	Po



30	Instrumenti I Politikës së Jashtme/ Kimberly proces	Rregullorja (BE) 2019/125 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 Janarit 2019 në lidhje me tregtinë e mallrave të caktuara që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues; Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2020/621 e 18 Shkurtit 2020 për ndryshimin e Aneksve I dhe V të Rregullores (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me tregtinë e mallrave të caktuara që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose ndëshkim tjetër ndëshkim mizor, çnjerëzor ose degradues.	Projektligji për "Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose dënim apo trajtime çnjerëzore, ose degraduese",	Ligj	Jo	MM	I pjeshëm	2022	II	Po
31	POLITIKAT E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES									
31	5	Rekomandimi 6.5 i Task Forcës të Veprimit Financiar (FATF)	Projektvendim "Për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Ngrirjen e Përkohshme të Fondeve apo Aseteve të Tjerë Personave ose Enteve të Shpallura"	VKM	Jo	DPPPP/MFE	N/A	2022	III	Jo
31	6	Vendimi i Këshillit të BE 2013/488 i datës 23 shtator 2013 mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE-së	Ligji "Për informacionin e klasifikuar"	Ligj	Jo	DSIK	I pjeshëm	2022	II	Jo
31	6	1. Politika e garantimit të sigurimit të informacionit në TEMPEST" 2. Udhëzime për sigurinë e informacionit për zgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve TEMPEST" 3. Udhëzime për sigurinë e informacionit mbi procedurat e zonimit TEMPEST"	Rregullore për përzgjedhjen dhe instalimin e pajisjeve që përpunojnë informacion të klasifikuar	VKM	Jo	DSIK	I pjeshëm	2022	I	Jo
32	KONTROLI FINANCIAR									
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Soft acquis	Ligj "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 110/2015 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin'"	Ligj	Jo	MFE	N/A	2022	IV	Po
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Soft acquis/Kuadri Ndërkombëtar i Praktikave Profesionale të Insitutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) KNPP/IPPF	Projektligj i ri "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"	Ligj	Jo	MFE	N/A	2022	IV	Po
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Soft acquis/Kuadri Ndërkombëtar i Praktikave Profesionale të Insitutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) KNPP/IPPF	VKM "Për disa ndryshime në VKM Nr.83, datë 03.02.2016 'Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik', i ndryshuar me VKM Nr.353, datë 11.05.2015"	VKM	Jo	MFE	N/A	2023	IV	Po
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Soft acquis/Kuadri Ndërkombëtar i Praktikave Profesionale të Insitutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) KNPP/IPPF	VKM "Për disa ndryshime në VKM Nr.116, datë 17.02.2016 'Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit"	VKM	Jo	MFE	N/A	2023	IV	Po
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Soft acquis/Kuadri Ndërkombëtar i Praktikave Profesionale të Insitutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) KNPP/IPPF	VKM "Për disa ndryshime në VKM Nr.160, datë 02.03.2016 'Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike"	VKM	Jo	MFE	N/A	2023	IV	Po
32	Auditimi i Jashtëm	Neni 287, paragrafi 3 i variantit të konsoliduar të Traktatit të Bashkimit Europian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Europian	Ligj "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 154/2014 'Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"	Ligj	Jo	KLSH	I plotë	2022	IV	Po
32	Mbrojtja e Interesave Financiare të BE-së	Direktiva (BE) 2017/1371 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 5 Korrik 2017 Për luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të Unionit me anë të ligjit penal.	Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit Për Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së	VKM	Po	MFE	I pjeshëm	2024	IV	Po
33	FINANCAT DHE BUXHETI									
33	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A



ANEKSI 2

TABELA E MASAVE ZBATUESE

Kapitulli	Nënkapitulli	Masa zbatuese e planifikuar	Ministria/ institucioni përgjegjës	Viti i fillimit të aktivitetit	Tremujori i fillimit	Viti i përfundimit të aktivitetit	Tremujori i përfundimit
1	LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE						
1	Parimet e Përgjithshme dhe fusha e paharmonizuar	Udhërrëfyesi Kombëtar (Roadmap) i Lëvizjes së Lirë të Mallrave	MFE	2020	I	2022	IV
1	Parimet e Përgjithshme dhe fusha e paharmonizuar	Plani i Veprimit për përputhshmërinë me nenet 34-36 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian	MFE	2020	I	2022	IV
1	Të gjithë nënkapitujt	Trajnime/workshope për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) kërkesat e acquis dhe aftësitë negociuese;	MFE	2021	I	2022	IV
1	Të gjithë nënkapitujt	Organizimi dhe funksionimi i Tavolinave të rrumbullakëta për kapitullin 1, në kuader të PPiE	MFE	2021	I	2022	IV
1	Përfaqsa e re dhe globale	Asistencë teknike dhe trajnim për strukturat që do të zbatojnë këtë rregullore. Krijoni një praktikë për komunikim dhe transparencë me palët e interesuara".	Ministria e Mbrojtjes/ SECA	2024	I	2024	IV
1	Përfaqsa e re dhe globale	Asistencë teknike dhe trajnim për strukturat që do të zbatojnë këtë rregullore. Krijoni një praktikë për komunikim dhe transparencë me palët e interesuara".	Ministria e Mbrojtjes/ SECA	2022	I	2022	III
2	LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE						
2	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
3	E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME						
3	Njohja e ndërsjelltë e kualifikimeve profesionale	Udhërrëfyesi për harmonizim të plotë me acquis në fushën e njohjes së ndërsjelltë të kualifikimeve profesionale	MAS	2021	IV	2022	IV
3	Njohja e ndërsjelltë e kualifikimeve profesionale	I.Trajnime stafi dhe përfaqësuesve të tjerë nga institucionet përgjegjëse për përafrimin e ligjit 27/ 2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muqetë" dhe VKM "Për licënsimin në fushën e restaurimit dhe trashëgimisë kulturore". II. Konsultime publike me grupet e interesit të masave për përafrimin me acquis	MK	2023	I	2023	IV
4	LEVIZJA E LIRË E KAPITALIT						
4	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
5	PROKURIMI PUBLIK						
5	Konçesione dhe PPP	Udhëzime/Rekomandime/Njoftime (APP nxjerr 1.udhezime, 2. 3.rekomandime dhe 4. njoftime ne menyre te vazhdueshme ne ndihme te AK dhe OE si dhe ne varesi te ndryshimeve te legjislacionit).	MFE	2020	I	2023	I
6	LEGJISLACIONI TREGTAR						



6	Kontabiliteti dhe auditimi	Ndjekja e procedurave përkatëse nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike në kuadër të përfatimit të Rregullores nr.7 datë 02.10.2018 "Për procedurat dhe metodologjinë e Kontrollit të Cilësisë të Auditimit Ligjor" dhe miratimit të saj nga kryetari i Bordit, për sa është e aplikueshme me kërkesat e Rregullores 537/2014 të KE (Rregullorja 537/2014 për auditimin), mbi kërkesat e posaçme në lidhje me auditimin ligjor të njëjësive ekonomike me interes publik. Në këtë kontekst do të përfshihen neni 4, neni 5, neni 15, përfatim pjesor i neni 27, i rregullores 537/2014 për auditimin. Gjithashtu një pjesë e madhe e dispozitave të kësaj direktive janë të reflektuara edhe në dispozitat e ligji 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar, ato dispozita të cilat janë përfatuar pjesërisht ose nuk janë përfatuar me ligjin e auditimit dhe në kërkesat e rregullores nr.7 datë 02.10.2018 "Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë të auditimit ligjor", që janë dispozita të pazbatueshme në kontekstin tonë ose janë të parëndësishëm për momentin dhe do të rishikohen në përndihet në vijim.	BMP	2022	I	2024	IV
7	E DREJTA E PRONËSISË INTELLEKTUALE						
7	7.1	Ngritja e grupit të punës për hartimin e paketës së plotë ligjore për ligjin për markat tregtare dhe për ligjin për patentat dhe modellet e përdorimit	MFE/DPPI	2022	II	2024	IV
7	7.2	Forcimi i kapaciteteve të sektorit të regjistrimit dhe sektorit të monitorimit në DDA përmes trajnimeve dhe/ose masave të tjera të zhvillimit të kapaciteteve.	MK/DDA	2022	IV	2024	IV
7	7.2	Përmirësimi i funksionalitetit të Sportelit Unik SUADA, përmes implementimit të dispozitave të reja ligjore, të cilat garantojnë drejtëm të SUADA-s në mënyrë transparente nga të gjitha agjencitë e licencuara.	MK/DDA	2022	IV	2024	IV
7	7.2	Rritja e kapaciteteve njëzëzore të dedikuara regjistrimit elektronik të të drejtës së autorit.	MK/DDA	2022	IV	2024	IV
7	7.2	ndjekja e aktiviteteve dhe parashikimeve sipas Strategjisë për Pronësinë Industriale 2021-2025	MK/DDA	2022	IV	2024	IV
7	7.2	Pregatitja e një studimi në lidhje me Direktivën 2019/789 "Për transmetimet online dhe ritransmetimet në tregun digital"	MK/DDA	2022	IV	2024	IV
7	7.2	Aktet nënligjore për zbatimin e dispozitave ligjore.	MK/DDA	2023	IV	2025	IV
8	POLITIKAT E KONKURRENCES						
8	Konkurrenca	Zhvillimi i aktiviteteve dhe trajnimeve në fushën e konkurrencës lidhur me shtyllat e ligjit dhe procedurat hetimore	AK	2022		2024	
8	Konkurrenca	Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të advokacisë së Ligjit 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".	AK	2022		2024 e në vijim	
8	Konkurrenca	Pjesëmarrje në trajnime të ndryshme në kuadër të antarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare, si UNCTAD, ICN, OECD, OECD/RCC-GVH, e të tjera	AK	2022		2024 e në vijim	
8	Konkurrenca	Zhvillimi i trajnimeve në kuadër të aplikimit për instrumentin TAIFEX.	AK	2022		2024 e në vijim	
9	SHERBIMET FINANCIARE						
9	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
10	SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA						
10	10.1 Komunikimet elektronike	Projektligji "Për ligjin e ri për komunikimet elektronike"	MIE	2022	I	2022	IV
10		Përgatitja e VNR-së për ndryshimet në ligjin për komunikimet elektronike	MIE	2022	I	2022	I
10		Organizimi i një seminari me palët e interesuara për ndryshimet në ligjin për komunikimet elektronike	MIE	2022	II	2022	II
10		Përgatitja e projektligjit	MIE	2022	II	2022	IV



10		Konsultimi i projektligjit	MIE	2022	II	2022	III
10	10.2 Shoqëria e Informacionit	"Projektligji" "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara "Për dokumentin elektronik".	KM/AKCESK	2022	I	2022	IV
10		Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.2/2017 "Për sigurinë kibernetike"	KM/AKCESK	2022	I	2022	IV
10		Projektligji "Për qarkullimin e lirë të të dhënave jopersonale"	MIE	2023	I	2023	II
10	10.3Media audiovizive	Projektligji për miratimin e ndryshimeve në ligj. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.	MIE/AMA	2022	II	2022	IV
11	BUJQESIA DHE ZHVILLIMI RURAL						
11	Bujqesia organike	Identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i legjislacionit të ri të BE-së, për bujqësinë organike, me qëllim planifikimin e rishikimit të legjislacionit kombëtar ekzistues, në linjë me legjislacionin e BE-së.	MBZHR	2022	II	2023	IV
12	POLITIKAT E SIGURISE USHQIMORE, VETERINARISE DHE FITOSANITARE						
12	Politikat e sigurise ushqimore, veterinare dhe fitosanitare	Trajnimi për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) aftësitë negociuese.	MBZHR	2022	I	2022	IV
13	PESHKIMI						
13	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
14	POLITIKAT E TRANSPORTIT						
30	Sektori Hekurudhor	Ngjitja e Autoritetit Rregullator Hekurudhor(ARRH)	MIE/MFE	2021	IV	2022	I
14	Sektori Hekurudhor	Ngjitja e Autoritetit të Sigurise Hekurudhore(ASH)	MIE/MFE	2021	IV	2022	I
15	Sektori Hekurudhor	Ngjitja e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare (AKIAIHD)	MIE/MFE	2021	IV	2022	I
16	Sektori Hekurudhor	Ndarja e Shoqërisë "Hekurudha Shqiptare" sh.a	MIE/MFE/Hekurudha Shqiptare	2021	IV	2022	I
14	Sektori Hekurudhor	Krijimi dhe forcimi i kapaciteteve ARRH, ASH dhe AKIAIHD	MIE/ARRH/ASH/AKIAIHD	2022	I	2023	IV
14	Sektori Hekurudhor	Shtese stafi per ARRH dhe AKIAIHD	MIE/MFE	2022	I	2022	II
15	ENERGJIA						
15	Nëntitulli: Burimet e rinovueshme të energjisë	Ngjitja e dy grupeve ndërinstitucionale të punës me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e varësishë	MIE/ERE, OST, OSHEE	2022	I	2022	I
15	Nëntitulli: Burimet e rinovueshme të energjisë	Konsultimi i draft-dokumentit të përgatitur me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë	MIE/ERE, OST, OSHEE	2022	III	2022	III
15	Nëntitulli: Burimet e rinovueshme të energjisë	Konsultimi i draft dokumentit të përgatitur me grupet e interesit	MIE/ERE, OST, OSHEE	2022	III	2022	III
16	TATIMET						
16	Tatimet	Përgatitja e dokumentit të projekt ligjit të ri për Tatimin mbi të Ardhurat (Nuk ka masa zbatuese të planifikuar)	MFE	2022	I	2022	IV
17	POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE						
17	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
18	STATISTIKAT						



18	Statistikat Sektoriale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores me grupet e interesit - tavolina konsultuese	INSTAT	2022	I	2022	IV
18	Statistika ekonomike	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistika ekonomike	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Sektoriale	- Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Sektoriale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistika ekonomike	Nomeklatura e produkteve sipas aktiviteve, versioni 2.1, Struktura dhe shënimet shpjeguese	INSTAT	2022	I	2022	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2022	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajtime të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV



18	Statistikat Demografike dhe Sociale	- Përkthim i legjislacionit - Trajnimë të vazhdueshme për rritjen e kapaciteteve të stafit - Organizimi i workshopeve mbi mënyrën e zbatimit të rregullores	INSTAT	2022	I	2023	IV
18	Statistikat monetare, financiare dhe të normave të interesit	Trajnimë të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve	BSH	2022	I	2022	IV
18	Statistikat monetare, financiare dhe të normave të interesit	Trajnimë të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve	BSH	2022	I	2022	IV
18	Statistikat monetare, financiare dhe të normave të interesit	Trajnimë të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve	BSH	2022	I	2022	IV
19	POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI						
Kapitulli 19	Mundësi të barabarta dhe Antidiskriminim; Përfshirja Sociale; Mbrojtje Sociale, Afërsi të Kufizuara, Mundësi Punësimi		MFE/ISSH	2022	2	2024	4
Kapitulli 19	Mundësi të barabarta dhe Antidiskriminim; Përfshirja Sociale; Mbrojtje Sociale, Afërsi të Kufizuara, Mundësi Punësimi		MFE/ISSH	2022	2	2024	4
Kapitulli 19	Përfshirja Sociale dhe PAK		MSHMS	2022	IV	2023	IV
20	NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE						
20	Të gjithë nënkapitujt	Trajnime/workshop-e për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) kërkesat e acquis dhe afërsitë negociuese;	MFE	2021	IV	2022	IV
20	Të gjithë nënkapitujt	Organizimi dhe funksionimi i Tryezave të Rumbullakëta për kapitullin 20, në kuader të PPIE	MFE	2021	IV	2022	IV
21	RRJETET TRANS-EVROPIANE						
21	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
22	POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE						
22		Pergatitja e Planit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin	Zv.Kryeministri/Fondi Shqiptar I Zhvillimit	2020	IV	2022	II
22		Pergatitja e Programit Operacional për Zhvillimin Rajonal	Zv.Kryeministri/Fondi Shqiptar I Zhvillimit	2021	I	2022	III
22		Ngritja e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit për/pe Autoritetin Menaxhues për zbatimin e Programit Operacional për Zhvillimin Rajonal	Fondi Shqiptar I Zhvillimit	2020	I	2023	IV
23	GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE						
23	3	Ngritja e grupit të punës për hartimin dhe finalizimin e paketës së plotë ligjore dhe dokumentave shoqërues për projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.	MD	2022	I	2022	I
23	3	Konsultimi i projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale	MD	2022	II	2022	III
23	3	Miratimi i projektligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale"		2022	IV	2022	IV
23	3	Trajnime dhe ndërgjegjësimi i grupeve të veçanta në fokus nga sektori publik, privat dhe shoqëria civile.	KDIMDP	2022	III	2024	IV
23	3	Shtim kapaciteteve për Zyrën e Komisionerit me qëllim adresimin e kërkesave që burojnë nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale i përfaruar	KDIMDP	2022	III	2024	IV
23	3	Krijimi i Regjistrit për Komunikimet Tregtare të Pakërkua	KDIMDP	2022	IV	2024	IV



23	2	Ngritja e grupit të punës për hartimin e projektligjit për "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"	MD	2022	I	2022	I
23	2	Hartimi i projektligjit për "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"	MD	2022	II	2022	IV
23	2	Konsultimi i projektligjit për "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"	MD	2023	I	2023	II
23	2	Miratimi i projektligjit për "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë"		2023	III	2023	IV
23	2	Trajnime në funksion të forcimit të kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit	MD	2022	II	2023	II
23	2	Nr.	MD	2022	I	2022	IV
23	3	Ngritja e dy qendrave të trajtimit të fëmijëve viktimë të abuzimit seksual	MSHMS	2022	I	2022	III
23	3	Hartimi i protokollit të identifikimit dhe raportimit të dhunës për punonjësit e shëndetësisë, përfshirë rishikimin e formularëve, regjistrave të mbledhjes së informacionit mbi dhunën ndaj fëmijës.	MSHMS	2022	IV	2024	IV
23	3	Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore: Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse mbi fuqizimin e grave, avancimin drejt barazisë gjinore, si dhe kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje (2 aktivitete në vit, 1 në tremujorin e parë dhe 1 në tremujorin e katërt)	MSHMS	2022	I	2024	IV
23	3	Përmirësimi i funksionimit të MKR në nivel vendor: Trajnimi i anëtarëve të MKR-ve për të trajtuar me efektivitet rastet bazuar në legjislacionin e përmirësuar, VKM për funksionimin e MKR të ndryshuar, si dhe në protokollin e procedurat standarde të veprimit të miratuara (2 trajnime në vit, 1 në tremujorin e dytë dhe 1 në tremujorin e tretë)	MSHMS	2022	II	2024	III
23	1	Projektimi i sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve	QTI/KLGJ	2022	I	2022	IV
23	1	Sigurimi i mbështetjes buxhetore për sistemin e menaxhimit të çështjeve	KLGI/MD/KM	2023	I	2023	IV
23	1	Ndërtimi i sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve	QTI/KLGJ	2024	I	2024	IV
23	1	Rekrutimet e inspektorëve jo magjistratë	ILD	2022	I	2022	II
23	1	Krijimi i kushteve të infrastrukturës për kryerjen e detyrës së stafit të ILD-së	ILD	2022	I	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI DHE SIGURI						
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Gjeorgjia	MB/ MEPJ/ MEF	2022	I	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Ukraina	MB/ MEPJ/ MEF	2022	II	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Federata Ruse	MB/ MEPJ/ MEF	2021	IV	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Armenia	MB/ MEPJ/ MEF	2021	IV	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Hin Kong	MB/ MEPJ/ MEF	2022	IV	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Makao	MB/ MEPJ/ MEF	2022	IV	2024	IV



24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Srilanka	MB/ MEPJ/ MEF	2022	IV	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Kepi i Gjelbërt	MB/ MEPJ/ MEF	2022	IV	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Turqi	MB/ MEPJ/ MEF	2022	IV	2024	IV
24	DREJTËSI, LIRI, SIGURI	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Azerbajxhan	MB/ MEPJ/ MEF	2022	IV	2024	IV
25	SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR						
25		Pergatitja e Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër Horizon Europe.	MAS AKKSHI	2020	IV	2024	IV
25		Zhvillimi i procesit të firmosjes së Charter&Code nga IAL Publike/Private dhe ndjekjen e hapit të dytë Marrjen e Logos Ht nga Komisioni Europian	MAS AKKSHI	2022	I	2024	IV
		Ligji për Shkencën 1.Knjimi I Grupit Nderinstitucional të punës (Urdher I Ministrisë të MAS) 2.Hartimi I draft Ligjit (duke përfshirë procesin e konsultimit me eksperte) 3.Diskutimi publik I draft ligjit me aktoret e interesuar 4. Miratimi I Ligjit (procesi i prezantimit dhe miratimit nga KM dhe me tej miratimi i tij në Parlament)	MAS AKKSHI	2023	I	2023	IV
		Zhvillimi i Strategjise së Specializimit Inteligent	MAS AKKSHI	2018	IV	2023	III
		Zhvillimi I Strategjisë për Kërkimin Shkencor 1.Urdheri I Ministrisë të MAS për monitorimin e Strategjisë 2017-21 2.Perfundimi dhe diskutimi I raportit të monitorimit të Strategjisë 2017-2021 3>Ngjitha e GNP për hartimin e Strategjisë për kërkimin Shkencor dhe përcaktimi i detyrave 4.Hartimi i Road map për hartimin e Strategjisë 5.Zhvillimi i Procesit të konsultimeve me aktoret (Qeveritare dhe jo-qeveritare) 6.Perfundimi i draftit dhe prezantimi për diskutim publik 7.Miratimi nga KM i Startegjisë për Shkencën	MAS AKKSHI	2022	I	2022	IV
26	ARSIMI DHE KULTURA						
26	Arsimi	Strategjia Kombëtare për Arsimin. Hartimi i Akteve nenligjore për rishikimin e kurrikulës së gjuhës angleze për klasat III-V. Hartimi i Akteve nenligjore për realizimin e konkursit të teksteve shkollore të gjuhës angleze, klasat II, III-V.	MAS	2022	I	2023	IV
26	Arsimi	Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 - 2029. 1. Takime me nxënës përfaqësues nga gjimnazet në të gjithë Shqipërinë 2. Takime me studentë përfaqësues nga universitetet në të gjithë Shqipërinë 3. Takime me përfaqësues nga Organizatat Rinore 4. Takime me përfaqësues të Institucioneve të qeverisjes qendrore dhe të njëjësive të vetëqeverisjes vendore 5. Hartimi i Draft-Strategjisë 6. Konsultimi i Draft-Strategjisë 7. Miratimi i Draft-Strategjisë	MSHRF	2021	IV	2022	III



26	Arsimi	Ngritja e Grupit të Punes ne MAS per Udhëzim nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësjve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; per lehtësimin e procedurave dhe afateve per hapjen e programeve te perbashketa dhe te dyfishta;	MAS	2022	I	2022	II
26	Arsimi	Regjistrimi i ASCAL ne EQAR (Q2/2023);	MAS/ ASCAL	2021	IV	2023	II
26	Arsimi	Hartimi i VKM per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar	MAS			2023	III
26	Arsimi	Anëtarësimi i plotë i ASCAL (QAAHE) në ENQA (Q4 /2023);	MAS/ ASCAL	2020	I	2023	IV
26	Arsimi	Hartimi i VKM per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM Nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfutimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para-universitar në institucionet arsimore publike"	MAS	2022	I	2022	II
26	Arsimi	Përgatitjet në kuadër të Marrëveshjes për ERASMUS +. 1. Planifikimi /alokimi ne buxhetin 2021, për kontributin (Fee) sipas shumës së dakordësuar me BE 2. Shprehja e interesit nga MAS për të marrë pjesë në Programin e ERASMUS+ 3.Përgatitja për ratifikim në Parlament	MAS	2022	3	2023	IV
27	MJEDISI						
27	Menaxhimi I Mbetjeve	Projektvendimi "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu"	MTM & MBZHR	2021	I	2022	III
27	Menaxhimi I Mbetjeve	Projekt vendimi "Per miratimin e masave te nevojshme që çdo person juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuksi e produktit) mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit".	MTM	2021	IV	2023	III
27	Menaxhimi I mbetjeve	Projektligji "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	MTM	2023	IV	2024	III
27	Mbrojtja Civile	Ngritja dhe funksionimi I sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112"	AKMC	2022	III	2024-2025	Tremujori I fundit I 2025
27	Mbrojtja Civile	Implementimi i Strategjisë Kombëtare të DRR, i vlerësimit të riskut dhe i planit kombëtar te EC	AKMC	2022	III	2024	Tremujori I fundit I 2024
27	Mbrojtja Civile	Mbështetje për ngritjen e sistemit sTESTA/CECIS	AKMC	2023	IV	2024	Tremujori I fundit I 2024
27	Mbrojtja Civile	Përmirësimi i sistemit të Lajmëzimit të Hershëm	AKMC	2023	IV	2024	Tremujori I fundit I 2024
27	Ndryshimet Klimatike	PVKM "Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin, verifikimin e shkarkimeve të gazeve me efekte serrë si dhe per përcaktimin e rregullave të përlogaritjes së shkarkimeve dhe përthitjes së tyre"	MTM	2022	I	2022	IV
27	Kimiketet	VKM "Per disa ndryshime ne VKM Nr. 360, datë 29.4.2015 PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E TYRE""	MTM	2022	IV	2022	III
28	MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT						
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Trajnime/workshope për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) kërkesat e acquis dhe aftësitë negociuese;	MFE	2021	I	2022	IV
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Organizimi dhe funksionimi i Tavolinave të rumbullakëta për kapitullin 28, në kuadër të PNPIE	MFE	2021	III	2022	IV
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Trajnimi i Stafit	MBZHR	2022	III	2023	I
28	Mbrojtja e Konsumatorit	Trajnimi i Stafit	MBZHR	2023	I	2023	III



29	SISTEMI DOGANOR						
29	BASHKIMI DOGANOR	Tarifa e Klasifikimit doganor (procedure, perkthim hartim dokumenti)	MFE/DPD	2022	IV	2022	IV
29	BASHKIMI DOGANOR	Tarifa e Klasifikimit doganor (procedure, perkthim hartim dokumenti)	MFE/DPD	2023	IV	2023	IV
29	BASHKIMI DOGANOR	Tarifa e Klasifikimit doganor (procedure, perkthim hartim dokumenti)	MFE/DPD	2024	IV	2024	IV
29	Mallrat kulturore	Hartimi I dokumentit përkatës të Udhëzimi	MK/IKRTK	2022	IV	2023	IV
29	Mallrat kulturore	Hartimi I dokumentit përkatës të Udhëzimi	MK/IKRTK	2022	IV	2023	IV
30	MARREDHENIET ME JASHTË						
30	Instrumenti I Politikës së Jashtme/ Kimberly proces	Asistencë teknike dhe trajnime për strukturat që do të implementojnë këtë rregullore. Krijimi I praktikës për Komunikim dhe transparencë me grupet e interesit.	AKSHE-MM	2021	I	2022	IV
30	Instrumenti I Politikës së Jashtme/ Kimberly proces	Asistencë teknike dhe trajnime për strukturat që do të implementojnë këtë rregullore. Krijimi I praktikës për Komunikim dhe transparencë me grupet e interesit.	AKSHE-MM	2022	I	2022	IV
31	POLITIKAT E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES						
31	5	Projektvendim "Për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Ngrirjen e Përkohshme të Fondeve apo Aseteve të Tjerë Personave ose Enteve "Të Shpallura"- në mbështetje të nenit 10/1 të ligjit Nr.157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"	MFE-DPPPP	2022	III		
32	KONTROLLI FINANCIAR						
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Hartimi i draft ligjit "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 110/2015 'Për menaxhimin financiar dhe kontrollin'"	MFE	2021	IV	2022	IV
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Rishikimi i Urdhrit të MFE Nr. 108, datë 17.11.2021 "Për manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit"	MFE	2023	I	2023	IV
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Rishikimi i Udhëzimit të MFE Nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike"	MFE	2023	I	2023	IV
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Hartimi projekt ligjit "Për disa ndryshime në Ligjin 114/2015 'Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik'"	MFE	2021	IV	2022	IV
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Hartimi i VKM-së "Për disa ndryshime në VKM-në Nr.83, datë 03.02.2016 'Për miratimin e kritereve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik'", i ndryshuar me VKM-në Nr.353, datë 11.05.2015.	MFE	2022	III	2023	II
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Hartimi i VKM-së "Për disa ndryshime në VKM-në Nr.116, datë 17.02.2016 'Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimi i tanfave të trajnimit'"	MFE	2022	III	2023	II
32	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik	Hartimi i VKM-së "Për disa ndryshime në VKM-në Nr.160, datë 02.03.2016 'Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike'"	MFE	2022	III	2023	II
32	Auditimi i jashtëm	Hartimi i draft ligjit "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 154/2014 'Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit'"	KLSH	2020	IV	2022	IV
32	Mbrojtja e Interesave Financiare të BE-së	Asistencë teknike dhe trajnime për strukturat që do të hartojnë dhe zbatojnë këtë strategji, si dhe forcim kapacitetesh dhe shtesë personeli për strukturën teknike në MFE.	MFE	2022	I	2024	IV
33	FINANCAT DHE BUXHETI						
33	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A



ANEKSI 3

ALOKIMET FINANCIARE

Kapi tulli	Masa zbatuese	Ministria/ institutoni përgjegjës	Kosto (buxheti i shtetit)	2022	2023	2024	Buxheti 2022 - 2024	Kosto (donatorët)	2022	2023	2024	Donatorë 2022 - 2024	Total (masa)
1	LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE												
1	Udhërrëfytesa Kombëtare (Roadmap) të Lëvizjes së Lirë të Mallrave"	MFÉ	Kosto nga buxheti i shtetit	700,000	0	0	700,000	German Government/GI Z. "Support for Albania accession negotiation in economy sector" (SANECA)	1,800,000	0	0	1,800,000	2,500,000
1	Plani i Veprimat për përputhshmërinë me nenet 34-36 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian"	MFÉ	Kosto nga buxheti i shtetit	700,000	0	0	700,000	German Government/GI Z. "Support for Albania accession negotiation in economy sector" (SANECA)	2,100,000	0	0	2,100,000	2,800,000
1	Trajnimi për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) aftësitë negociuese; IV) Tavolina të rrumbullakëta në kuadrin e PPEI	MFÉ	Kosto nga buxheti i shtetit	0	0	0	0	German Government/GI Z. "Support for Albania accession negotiation in economy sector" (SANECA)	5,000,000	0	0	5,000,000	5,000,000
1	Trajnime/workshope për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) kërkesat e acquis dhe aftësitë negociuese;	MFÉ	Kosto nga buxheti i shtetit	0	0	0	0	German Government/GI Z. "Support for Albania accession negotiation in economy sector" (SANECA)	800,000	0	0	800,000	800,000
1	Projektvendim "Për miratimin e rregullit teknik "Për enët e thjeshta nën presion" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"	MFÉ/MIE	Kosto nga buxheti i shtetit	700,000	0	0	700,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	700,000
1	Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet e gazit" dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"	MFÉ/MIE	Kosto nga buxheti i shtetit	0	700,000	0	700,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	700,000
1	Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 "Për tregimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore.""	MFÉ	Kosto nga buxheti i shtetit	0	700,000	700,000	1,400,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	1,400,000
1	Projekt-ligj "Mbi përcaktimin e autorizimeve të eksportit, dhe masat për importin, transitin e armeve të zjarrit, pjesëve përbërëse dhe municioneve"	MM/MB	Kosto nga buxheti i shtetit	0	50,000	50,000	100,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	100,000
1	Projektudhëzim i Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjië "Për miratimin e tipit të mjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njërive të veçanta teknike të destinuara për këto mjete	MIE	Kosto nga buxheti i shtetit	0	300,000	300,000	600,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	600,000
1	Projekt Ligji "Për produktet e ndërtimit"	MIE	Kosto nga buxheti i shtetit	0	0	1,400,000	1,400,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	1,400,000
1	Udhëzimi për krijimin dhe funksionimin e "Regjistrat të tregimit të pasurive kulturore", në zbatim të pikës 7, të nenit 116 të Ligjit 27/2018.		Kosto nga buxheti i shtetit	0	0	0	0	Kosto total euro, nga projekti I financuar nga BE, IPA Kombëtare me titull "Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore"			249,000	249,000	249,000



1	Udhëzimin e përbashkët "Për vlerat mbi të cilat është i detyrueshëm një përshkrim më i detajuar i pasurive kulturore, objekte të veprimjeve tregtare", në zbatim të pikës 8, të nenit 116 të Ligjit 27/2018		Kosto nga buxheti i shtetit	0	0	0	0	Kosto total 249 000 euro, nga projekti I financuar nga BE, IPA Kombëtare me titull "Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore"			249,000	249,000	249,000
1	Udhëzimi "Për procedurat e përditësimit të bazës së të dhënave dhe administrimin e pasurive kulturore të vjedhura", në zbatim të pikës 6, të nenit 130 të Ligjit 27/2018		Kosto nga buxheti i shtetit	0	0	0	0	Kosto total 249 000 euro, nga projekti I financuar nga BE, IPA Kombëtare me titull "Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore"			249,000	249,000	249,000
			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	2,100,000	1,750,000	2,450,000		Kosto total donatorët sipas viteve	9,700,000	0	747,000		
			Kosto total buxheti 2022- 2024				6,300,000	Kosto total donatorët 2022 - 2024				10,447,000	16,747,000
1	Projekt Vendim I KM Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e sistemit të gjurmimit dhe identifikimit të lëndëve plasëse	MM	Kosto nga buxheti i shtetit	50000			50000	Kosto (donatorët)					
2	LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE												
2	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
3	E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME												
3	Udhërrëfyesi për harmonizim të plotë me acquis në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale	Ministria e Arsimit dhe Sportit						18,200,723	18,200,723			18,200,723	18,200,723
3	Përgatitjet e paketës ligjore të Projekt ligjit të amendimit të Ligji 27/2018 "Mbi trashëgiminë kulturore dhe muzeve"	Ministria e Kulturës			10,145,455		10,145,455				10,145,455	10,145,455	20,290,909
3	Përgatitja e paketës së VKM "Mbi licencimin dhe resaturimin oer trashëgiminë kulturore"	Ministria e Kulturës			1,044,545		1,044,545				1,044,545	1,044,545	2,089,090
3			Kosto total buxheti 2022 - 2024	0	11,190,000	-	11,190,000	Kosto total donatorët 2022 - 2024	18,200,723	-	11,190,000	29,390,723	40,580,722
4	LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT												
4	Rishikimi i rregullores nr.2, datë 17.01.2013 "Për administrimin e rrezeveve në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka"	BSH	Kosto nga Banka e Shqipërisë si institucion i pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	3047	-	-	3,047.00	0	0	0	0	0	3,047.00
4	Rishikimi i rregullores nr.11, datë 06.02.2008 "Për instrumentet e pagesave elektronike".	BSH	Kosto nga Banka e Shqipërisë si institucion i pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	3047	-	-	3,047.00	0	0	0	0	0	3,047.00



4	Projekti i "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave"	MTM, MD, MZHBR	Kosto nga buxheti i shtetit (nga MTM, MD dhe MZHBR)	175000	-	-	175,000.00	0	0	0	0	0	175,000.00
4			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	181,094.00	-	-		Kosto total donatorët sipas viteve	0	0	0		
4			Kosto total buxheti 2022 - 2024	181,094.00			181,094.00	Kosto total donatorët 2022 - 2024				0	181,094.00
5	PROKURIMI PUBLIK												
5	Draftligji "Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet/PPP"	MFE	900.000 Lek		900,000		900,000						900,000
5			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve				900,000	Kosto total donatorët sipas viteve	-	-	-		
5			Kosto total buxheti 2022 - 2024				900,000	Kosto total donatorët 2022 - 2024				-	
6	LEGJISLACIONI TREGTAR												
6	NNdjekja e procedurave përkatëse nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike në kuadër të përafrimit të Rregullores nr.7 datë 02.10.2018 "Për procedurat dhe metodologjinë e Kontrollit të Cilësisë të Auditimit Ligjor" dhe miratimit të saj nga kryetari i Bordit, për sa është e aplikueshme me kërkesat e Rregullores 537/2014 të KE (Rregullorja 537/2014 për auditimin), mbi kërkesat e posaçme në lidhje me auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik. Në këtë kontekst do të përafrohen neni 4, neni 5, neni 15, përafrim pjesor i nenit 27, i rregullores 537/2014 për auditimin. Gjithashtu një pjesë e madhe e dispozitave të kësaj direktive janë të reflektuara edhe në dispozitat e ligji 10091/2009, për auditimin, i ndryshuar, ato dispozita të cilat janë përafruar pjesërisht ose nuk janë përafruar me ligjin e auditimit dhe në kërkesat e rregullores nr.7 datë 02.10.2018 "Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë të auditimit ligjor", që janë dispozita të pazbatueshme në kontekstin tonë ose janë të parëndësishme për momentin dhe do të rishikohen në periudhat në vijim.	Bordi i Mbikëqyrjes Publike (vetëfinancim)		0	0	0	0		5,017,200	5,017,200	5,017,200	15,051,600	15,051,600
6			Kosto total buxheti 2022 - 2024	0	0	0	0	Kosto total donatorët 2022 - 2024	5,017,200	5,017,200	5,017,200	15,051,600	15,051,600
7	E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE												
7	Ligji për markat tregtare	MFE/DPPI	Buxheti I DPPI-së	10267	10267	10267						0	0
7	Ligji për patentat dhe modelat e përdorimit	MFE/DPPI	Buxheti I DPPI-së	10267	10267	10267						0	0
7			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	20534	20534	20534		Kosto total donatorët sipas viteve	0	0	0		
7			Kosto total buxheti 2022 - 2024	61602				Kosto total donatorët 2022 - 2024					
7	Forcimi i kapaciteteve të sektorit të regjistrimit dhe sektorit të monitorimit në DDA përmes trajnimeve dhe/ose masave të tjera të zhvillimit të kapaciteteve.	MK/DDA	Buxheti ishtetit	500 (mije)	5000 (mije)	5000 (mije)		Kosto total donatorët 2022 - 2024	6900	0	0		
7	Përmirësimi i funksionalitetit të Sportelit Unik SUADA, përmes implementimit të dispozitave të reja ligjore, të cilat garantojnë drejtëm të SUADA-s në mënyrë transparente nga të gjitha agjencitë e licencuara.	MK/DDA	Buxheti ishtetit	300 (mije)	300(mije)	300 (mije)		Kosto total donatorët 2022 - 2024	1680	0	0		
7	Përmirësimi i kapaciteteve njëzore të dedikuara regjistrimit elektronik të të drejtës së autorit.	MK/DDA	Buxheti ishtetit	160 (mije)	160 (mije)	160 (mije)		Kosto total donatorët 2022 - 2024	0	0	0	0	0



7	Ndjekja e aktiviteteve dhe parashikimeve sipas Strategjisë për Pronësinë Industriale 2021-2025	MK/DDA	Buxheti I shtetisë/MFE/Strukturavete tjera te perfishira ne strategji	5000 (mije)	5000 (mije)	5000 (mije)		Kosto total donatorët 2022 - 2026	0	0	0	0	0
7	Pregatitja e një studimi në lidhje me Direktivën 2019/789 "Për transmetimet online dhe ritransmetimet në tregun digital"	MK/DDA	Donatorw/Projekti ALSIP	0	0	0		Kosto total donatorët 2022 - 2024	700 (mije)				
7	Aktet nënligjore për zbatimin e dispozitave ligjore.	MK/DDA	Buxheti I MK-së/Donatorw/Projekti ALSIP	630 (mije)	0	0		Kosto total donatorët 2022 - 2024	0	0	0	0	0
8	POLITIKAT E KONKURRENCES												
8	Udhëzues "Mbi kufizimet e konkurrencës "sipas objektit" për qëllime të identifikimit të marrëveshjeve të cilat mund të përfitojnë nga Rregullorja "Për marrëveshjet me rëndësi të vogël""	Autoriteti I Konkurrencës		68,000			68,000	0	0	0	0	0	68000
8	Rregullorja "Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren "Për Funsionimin e AK""	Autoriteti I Konkurrencës			62000		62,000	0	0	0	0	0	62000
8	Udhëzues "Mbi praktikën më të mira për zbulimin e informacioneve në procedurat e ndjekura në zbatim të neneve 4 dhe 9 të Ligjit nr.9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", I ndryshuar, si dhe në rastet e përqëndrimeve"	Autoriteti I Konkurrencës			72000		72,000	0	0	0	0	0	72000
8	Udhëzues "Mbi referimin e rasteve në lidhje me përqëndrimet"	Autoriteti I Konkurrencës				88,000	88,000	0	0	0	0	0	88,000
8	Zhvillimi i aktiviteteve dhe trajnimeve në fushën e konkurrencës lidhur me shtyllat e ligjit dhe procedurat hetimore	Autoriteti I Konkurrencës		0	0	0							
8	Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të advokacisë së Ligjit 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" .	Autoriteti I Konkurrencës			360 000	360 000	720 000						720 000
8	Pjesëmarrje në trajnime të ndryshme në kuadër të antarësimit në organizata të ndryshme ndërkombëtare, si UNCTAD, ICN, OECD, OECD/RCC-GVH, e të tjera	Autoriteti I Konkurrencës	0	0	0	0							
8	Zhvillimi i trajnimeve në kuadër të aplikimit për instrumentin TAHEX.	Autoriteti I Konkurrencës	0	0	0	0							
8			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	68,000	494000	448000		Kosto total donatorët sipas viteve	0	0	0	0	1010000
8			Kosto total buxheti 2022 - 2024				1,010,000	Kosto total donatorët 2022 - 2024	0	0	0	0	
9	SHERBIMET FINANCIARE												
9	Projektligji "Për Fondet e Pensionit Privat"	AMF	Kosto total nga AMF si institucion I pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	2,780.00			2,780.00	0	0.00	0	0	0	2,780.00
9	Ligji "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike"	BSH	Kosto total nga BSH si institucion I pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	3,047.00			3,047.00					0	3,047.00
9	Rregullore "Mbi transparencën për tarifat e lidhura me llogarinë e pagesës dhe mbi shërbimin e transferimit të llogarive të pagesës"	BSH	Kosto total nga BSH si institucion I pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	3,047.00			3,047.00					0	3,047.00
9	Rishikimi i rregullores nr.69, datë 18.12.2014 "Për kapitalin rregullator të bankës"	BSH	Kosto total nga BSH si institucion I pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	0.00	3047		3,047.00					0	3,047.00
9	Rishikimi i rregullores nr.48, datë 31.7.2013 "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit"	BSH	Kosto total nga BSH si institucion I pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	0.00	3047		3,047.00					0	3,047.00
9			Kosto totale nga BSH	6,094.00	6094		12,188.00					0	
9			Kosto totale e AMF dhe BSH sipas viteve	8,874.00	6094	0	14,968.00	Kosto total donatorët sipas viteve	0	0	0		14,968.00
9			Kosto totale e buxhetit 2022 - 2024				14,968.00	Kosto total donatorët 2022 - 2024	0			0	



10	SHOQËRIA E INFORMACIONIT DHE MEDIA											
10	Përgatitja e projektligjit për miratimin e ndryshimeve në ligjin për komunikimet elektronike në përputhje me KEE	MIE		500000 ALL			500000 ALL	TA - IPA			TA - IPA (200000€)	200000 Euro
10	Projektligji "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara"	KM/AKCESK		1588920 ALL			1588920 ALL					
10	Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.2/2017" Për sigurinë kibernetike"	KM/AKCESK		1588920 ALL			1588920 ALL					
10	Projektligji "Për qarkullimin e lirë të të dhënave jopersonale"	MIE			500000 ALL							
10	Projektligji për miratimin e ndryshimeve në ligjin 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.	AMA (Vet-financim)		250000 ALL			250000 ALL	TA/TAIEX				TA/TAIEX
10		KM/AKCESK										
10			Total cost state budget by years					Total cost donors by years				
10			Total budget cost 2022 - 2024					Total cost donors 2022 - 2024				
11	BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL											
11	Urdher Ministri "Për miratimin e formatit të aplikimit për regjistrim në regjistrin e vreshtave, formatit të ndryshimit të të dhënave dhe rregullave shtesë për funksionimin e regjistrit të vreshtave"	MBZHR	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2024	3,693.00			3,693.00				-	3,693.00
11	Urdhër "Për miratimin e rregullave për mbajtjen e deklaratave të detyrueshme, formularët që duhet të plotësohen nga operatorët dhe mënyra e grumbullimit të informacionit për prodhimin potencial"	MBZHR	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2025	1,553.00			1,553.00				-	1,553.00
11	Urdher Ministri "Për miratimin e rregullave të detajuara për regjistrat e hyrje - daljeve"	MBZHR	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2026		1,553.00		1,553.00				-	1,553.00
11	Urdher Ministri "Rregulla të detajuara në lidhje me praktikën enologjike, protokollet dhe metodat e analizave për produktet e rrushit për verë, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare (OIV) të prodhimit të verës, veçanërisht pasurimi, acidifikimi dhe de-acidifikimi si dhe kufizimet që aplikohen"	MBZHR	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2027		904.00		904.00				-	904.00
11	Ligji për Bletarinë	MBZHR	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2028	1,368.00			1,368.00				-	1,368.00
11	Urdhër Ministri "Për miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik".	MBZHR	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2029	1,553.00			1,553.00				-	1,553.00
11	VKM "Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027"	VKM	Kosto e buxhetit shtetit 2022-2030	5,000.00			5,000.00				-	5,000.00
11							-				-	-
11			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	13,167.00	2,457.00	-		Kosto total donatorët sipas viteve	-	-	-	15,624.00
11			Kosto total buxheti 2022 - 2024				15,624.00	Kosto total donatorët 2022-2024			-	
12	POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE FITOSANITARE											
12	Urdhër Ministri "Mbi vendosjen e kriterëve të përdorimit të vaksinave që përdoren kundër sëmundjes së Pseudopestit në programet e vaksinimit rutinë."	MBZHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,553.00			1,553.00				-	1,553.00



12	Urdhër Ministri "Mbi zbatimin e disa rregullave të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve të kategorive të të listuara dhe krijimin e një liste të llojeve dhe grupeve të specieve që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për përhapjen e këtyre sëmundjeve"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,390.00		1,390.00					-	1,390.00
12	Ligj "Për Shëndetin e Kafshëve"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		5,000.00	5,000.00					-	5,000.00
12	Urdhër ministri "Mbi miratimin e testeve të zbulimit të antitrapave kundër brucelozës së gjedhë"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024			1,390.00	1,390.00				-	1,390.00
12	Urdhër Ministri " Mbi përcaktimin e rregullave që duhet të kryhen gjatë dhe pas kontrollit të dokumentacionit, kontrollit të identitetit dhe kontrollit fizik të kafsheve dhe të mirave, që janë subjekt i kontrolleve zyrtare në PKK"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024			984.00	984.00				-	984.00
12	Ligj "Për kontrollin zyrtar dhe aktivitetet e tjera zyrtare të kryera për të siguruar zbatimin e ligjit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, shëndetin e bimëve dhe produktet e mbrojtjes së bimëve "	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		3,000.00		3,000.00				-	3,000.00
12	Udhëzim "Mbi vendosjen e niveleve maksimale për pranimë e koksidiostateve ose histomonostateve në ushqim që rezultojnë nga bartja e pashmangshme e këtyre substancave në ushqimin për kafshë jo të synuar"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	984.00			984.00				-	984.00
12	Udhëzim "Përcaktimi i procedurës së marrjes së mostrave dhe metoda e Komunitetit për analizën e kontrollit zyrtar të temperaturave të ushqimeve të ngjira shpejt të destinuara për konsum njerëzor"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,553.00			1,553.00				-	1,553.00
12	Udhëzim "Përdorimi i acidit laktik për të zvogëluar kontaminimin e sipërfaqes së karkasave të gjedhit"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		1,553.00		1,553.00				-	1,553.00
12	Udhëzim " Për dallimin midis materialeve të ushqimit për kafshë, aditivëve të ushqimit për kafshë, produkteve biocidale dhe produkteve mjekësore veterinare"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		1,553.00		1,553.00				-	1,553.00
12	Udhëzim "Në lidhje me rastet e mospërpunues së dyshuar ose të konstatuar me rregullat e zbatueshme për përdorimin ose mbetjet e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar në produkte medicinale veterinare ose si aditivë për ushqimin për kafshë ose me rregullat e zbatueshme për përdorimin ose mbetjet e substancave të ndaluar ose të substancave aktive farmakologjikisht paautorizuara".	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		3,600.00		3,600.00				-	3,600.00
	Udhëzim "Mbi monitorimin e niveleve të dioksinave dhe PCB-ve të ngjashme me dioksinin në ushqimet për kafshë"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024			1,553.00	1,553.00					1,553.00
12	Udhëzim "Përcaktimi i rregullave për funksionimin e sistemit të menaxhimit të informacionit për kontrollin zyrtar dhe përbërësit e sistemit të tij"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024			904.00	904.00					904.00
12	Udhëzim "Për Aditivët në produktet ushqimore"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	904.00			904.00					904.00
12	Udhëzim "Mbi kërkesat për dhënie e informacionit konsumatorëve për mungesën ose reduktimin e pranisë së glutenit në ushqim".	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,368.00			1,368.00					1,368.00
12	Udhëzim "Për përcaktimin e kushteve specifike dhe procedurave të hollësishme për importin e enëve të gatimit poliamide dhe melamine me origjinë ose të dërguara nga Republika Popullore e Kinës dhe Rajoni Special Administrativ Hong Kong, Kinë.	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		1,553.00		1,553.00					1,553.00
12	Udhëzim "Për përcaktimin e listës së simulantëve që do të përdoren për testimin e migrimit të përbërësve të materialeve plastike dhe artikuve që synojnë të vijnë në kontakt me ushqimet.	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		1,368.00		1,368.00					1,368.00
12	Udhëzim "Mbi masat kalimtare në lidhje me listën e aromave dhe materialeve bujqësore"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024			5,024.00	5,024.00				-	5,024.00
12	Udhëzim "Për përcaktimin e rregullave për aplikimet në lidhje me përdorimin e përshkruesve gjeneralë (emërime)".	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024			1,368.00	1,368.00					1,368.00



12	Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollet e parazitëve, <i>Thrips palmi</i>	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		904.00	904.00						904.00
12	Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollet e parazitëve, <i>Xylolla fastidiosa</i> (Wells et al.)	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	904.00		904.00						904.00
12	Rregullore "Masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,368.00		1,368.00						1,368.00
12	Udhëzim "Per procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t'u miratuar për lëshimin e "Pasaportës Bimore" si dhe rastet e heqjes së miratimit".	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,368.00		1,368.00						1,368.00
12	Ligj "Per shendetin e bimeve"	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	3,600.00		3,600.00					-	3,600.00
12	Udhëzim për kriteret teknike të mjeteve dhe makinerive, të cilat përdoren për trajtimet me PMB	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	904.00		904.00					-	904.00
12	Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollet e parazitëve, <i>Anoplophora glabripennis</i> (Matschulsky)	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024	1,368.00		1,368.00					-	1,368.00
12	Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollet e parazitëve, <i>Anoplophora chinensis</i>	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		1,368.00	1,368.00					-	1,368.00
12	Udhëzim "Rregullat në lidhje me masat e vecanta të kontrollit të parazitëve dhe trajtimet për kontrollet e parazitëve, <i>Epirix cucumeris</i> (Harris), <i>Epirix similaris</i> (Gentner), <i>Epirix suberinita</i> (Lec.) and <i>Epirix tuberos</i> (Gentner)	MBZHHR	Kosto e buxhetit të shtetit 2022-2024		904.00	904.00					-	904.00
12												
12			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	10,024.00	24,867.00	14,399.00				-	-	-
12			Kosto total buxheti 2022 - 2024			49,290.00						49,290.00
13	PESHKIMI											
13	Draft Vendimi i Keshillit të Ministrave "Mbi përcaktimin e rregullave për zbatimin e sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe mbështetjen e anijëve të peshkimit për implementimin e këtij sistemi"	MBZHHR		5,000.00		5,000.00					-	5,000.00
13	Draft Vendim i Keshillit të Ministrave "Për marrjen e masave menaxhuese të ruajtjes së burimeve peshkore".	MBZHHR		3,600.00		3,600.00					-	3,600.00
13	Draft Urdher Ministri "Për miratimin e një plani shumëvjeçar rehabilitimi për peshkun shëzë"	MBZHHR		904.00		904.00					-	904.00
13	Draft Urdher Ministri "Për përcaktimin e sasive minimale të lejueshme që mund të hidhen në det për disa forma të peshkimit të pelagjikeve të vegjël"	MBZHHR		904.00		904.00					-	904.00
13	Draft Udhëzim për përcaktimin e kostove të pranueshme që mbështeten nga nderhyrjet strukturore	MBZHHR		1,553.00		1,553.00					-	1,553.00
13	Draft Rregullore Ministri "Për menyrën e njohjes së organizatave prodhuese"	MBZHHR		1,366.00		1,366.00					-	1,366.00
13	Draft Rregullore Ministri "Për planet e prodhimit dhe marketingut të organizatave të prodhuesve"	MBZHHR			1,368.00	1,368.00					-	1,368.00
13	Draft Vendim i Keshillit të Ministrave "Për përcaktimin dhe zbatimin e planeve të prodhimit dhe marketingut të Organizatave prodhuese"	MBZHHR			5,000.00	5,000.00					-	5,000.00
13	Draft Vendim i Keshillit të Ministrave "Për organizimin e Inspektoratit të peshkimit"	MBZHHR			3,600.00	3,600.00					-	3,600.00
13	Draft Rregullore "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për listen e shkeljeve të renda në peshkim"	MBZHHR			1,368.00	1,368.00					-	1,368.00



13	Draft Vendimi i Këshillit të Ministrave "Per organizimin e tregut te prodhimeve te peshkimit dhe akuakultures	MBZHHR			3,600.00		3,600.00					-	3,600.00
13	Draft Urdher Ministri "Per miratimin e programeve te inspektimit dhe kontrollit te disa formave te peshkimit	MBZHHR			904.00		904.00					-	904.00
13							-					-	-
13			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	13,327.00	15,840.00	-		Kosto total donatorët sipas viteve	-	-	-		29,167.00
13			Kosto total buxheti 2022 - 2024				29,167.00	Kosto total donatorët 2022-2024				-	
14	POLITIKA E TRANSPORTIT												
14	Projektudhezim, "Per shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve"	MIE	600000	0	600000	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Udhezim për lejen e qarkullimit te mjeteve me motor dhe rimorkiove te tyre	MIE	600000	600000	0	0	600000						
14	Projektudhezim "Mbi programin e trajnimit profesional, testimin dhe certifikimin dhe licensimin e makinistëve te transportit te mallrave te rrezikshme"	MIE	600000	600000	0	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Urdhër Për miratimin e Rregullores "Për kryjen e Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare"	MIE	600000	600000	0	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Projektudhezim mbi vendosjen e sistemit Evropian te certifikimit te njesive pergegjese per mirembajtjen e mjeteve hekurudhore	MIE	600000	0	600000	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Projektudhezim per aplikimin dhe perdorimin e formatit te perbashket per dhenien e certifikates se sigurise hekurudhore	MIE	600000	0	600000	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Projektudhezim mbi percaktimin e metodese se perbashket te sigurise dhe kerkesat e perputhshmerise per marrjen e autorizimit te sigurise hekurudhore	MIE	600000	0	600000	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Projekturdhër "Mbi rregullat dhe procedurat për operimin e avionëve pa pilot"	MIE	750000	750000	0	0	750000	0	0	0	0	0	750000
14	Projekturdhër " Për sistemet e avionëve pa pilot dhe për operatorët e vendeve të treta të sistemeve të avionëve pa pilot"	MIE	750000	750000	0	0	750000	0	0	0	0	0	750000
14	Projekturdhër "Për ngjarjet e detyrueshme qe duhen raportur në aviaconin civil në Republikën e Shqipërisë"	MIE	600000	600000	0	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	"Kërkesat për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e lundrimit ajror, projektimin e strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësinë e të dhënave, sigurinë e pistës"	MIE	700000	0	700000	0	700000	0	0	0	0	0	700000
14	"Mbi kërkesat për llogaritjet e performancës së uljes së aeroplanit dhe standardet për vlerësimin e kushteve të sipërfaqes së pistës, përditësimin e pajisjeve të caktuara të sigurisë së avionëve dhe kërkesave dhe operimeve pa posëdim të një aprovimi operacional me rreze të zgjeruar"	MIE	700000	0	700000	0	700000	0	0	0	0	0	700000
14	"Mbi një kuadër rregullator për hapësirën ajrore"	MIE	700000	0	700000	0	700000	0	0	0	0	0	700000
14	Projektvendimi i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores për sistemin e monitorimit dhe të informacionit të trafikut të anijeve (VTMIS)"	MIE	750000	0	750000	0	750000	0	0	0	0	0	750000
14	Projekt-urdhër "Për miratimin e rregullores "Mbi kërkesat specifike për anijet Ro-Ro për pasagjerë"	MIE	600000	600000	0	0	600000	0	0	0	0	0	600000
14	Projekt-urdher "Për miratimin e rregullores "Për nivelin minimal të trajnimit të detarëve"	MIE	600000	600000	0	0	600000	0	0	0	0	0	600000
15	ENERGJIA												
15	Titulli i aktit/dokumenti strategjik/masa zbatuese		-		-	-	-	-	-	-	-	-	0



15	Projektligji për ndryshimin e ligjit nr.7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"	MIE/ERE, OST, OSHEE	-	313,000.0	-	-	-	-	-	-	-	-	313,000.0
15	Projektvendim për Kontratën standarde për Diferencë (CfD) për prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë	MIE/ERE, OST, OSHEE	-	313,000.0	-	-	-	-	-	-	-	-	313,000.0
15	Ngritja e dy grupeve ndërinstitucionale të punës me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e varësishë	MIE/ERE, OST, OSHEE	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
15	Konsultimi i draft-dokumentit të përgatitur me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë	MIE/ERE, OST, OSHEE	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0
15	Konsultimi i draft dokumentit të përgatitur me grupet e interesit	MIE/ERE, OST, OSHEE	-	-	-	-	-	Kostoja totale nga donatorët sipas viteve	-	-	-	-	0
15			Kostoja totale buxheti i shtetit sipas viteve	626,000.0	-	-	-	Kostoja totale e donatorëve sipas viteve	-	-	-	-	626,000.0
15			Kostoja totale buxhetore 2022-2024	626,000.0	-	-	-	Kostoja totale e donatorëve 2022 - 2024	-	-	-	-	626,000.0
16	TATIMET												
16	Përgatitja e paketës ligjore të Tatimit mbi të Ardhurat	Ministria e Financave dhe Ekonomisë		2000000	0	0	2000000	0	0	0	0	0	2000000
16			Kosto total buxheti 2022 - 2024	2000000	0	0	2000000	Kosto total donatorët 2022-2024	0	0	0		2000000
17	POLITIKAT EKONOMIKE DHE MONETARE												
17	Rishikimi I Ligjit nr. 8269/1997 "Per Banken e Shqiperise" i ndryshuar			0	3047	0	3047		0	0	0	0	3047
17			Kosto total nga Banka e Shqiperise si institucion I pavarur (jo nga buxheti i shtetit)	0	3047	0	3047	Kosto total donatorët sipas viteve	0	0	0	0	3047
18	STATISTIKAT												
18	Projektligji "Për Censin e Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve									0	8 Mln euro
18	Projekt-Udhëzim "Në mbështetje të implementimit të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	544,934	544,934	544,934			5000 euro	5000 euro			
18	Projekt-Udhëzim "Në mbështetje të implementimit të Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve					Kosto total donatorët sipas viteve	5000 euro	5000 euro	0		
18	Projekt-Udhëzim "Për Vrojtimet Statistike të Qumështit dhe të Nën-Produkteve Të Tj"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	2,790,716	2,790,716	2,790,716		Kosto total donatorët 2022 - 2024			0		
18	Projekt-Udhëzim "Për zbatimin e rregullores për Vrojtimet Statistike të Qumështit dhe të Nën-Produkteve Të Tj"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	2,790,716	2,790,716	2,790,716							
18	Projektvendim "Për zbatimin e Nomenklaturës së produkteve sipas aktiviteve"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	500,000					2500 euro				
18	Projekt-Udhëzim "Për Zbatimin e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës"	INSTAT	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	15,234,395	15,234,395	15,234,395							
19	POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI												
19	Titulli i aktit/ dokumentit strategjik/ masës zbatuese	"Për indeksimin e pensioneve"	MFE /ISSH	75,718	82,601	85,718	244,037					-	244,037
19	Titulli i aktit/ dokumentit strategjik/ masës zbatuese	Projekt vendim " Per miratimin e koeficientit te indeksimit te bazes se vleresuar per llogaritjen e pensioneve"	MFE /ISSH	75,718	82,601	85,718	244,037					-	244,037



19	Titulli i aktit/ dokumentit strategjik/ masës zbatuese	Amendime ne ligjen Nr. 93/2014 "Mbi perfshirjen dhe aksesueshmerine" dhe aktet nenligjore	Ministria e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrte e linjes.	292,640	787,424	787,424	1,867,488					-	1,867,488
19			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	368,358	870,025	873,142		Kosto total donatorët sipas viteve	-	-	-		
19			Kosto total buxheti 2022 - 2024				2,111,525	Kosto total donatorët 2022 - 2024				-	
20	NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE												
20	Trajnime/workshop-e për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) kërkesat e acquis dhe aftësitë negociuese;	MFE	0	0	0	0	0	5,246,000	5,246,000	0	0	5,246,000	5,246,000
20	Organizimi dhe funksionimi i Tryezave të Rrethullakëta për kapitullin 20, në kuader të PPIE.	MFE	0	0	0	0	0	800,000	800,000	0	0	800,000	800,000
20	Totali		Kosto total buxheti 2022 - 2024	0	0	0	0	Total i koston donatorë 2022- 2024	6,046,000	0	0	6,046,000	6,046,000
21	RRJETET TRANS-EVROPIANE												
21	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
22	POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE												
22	(1) Plani Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohëziorin (2) Programi Operacional për Zhvillimin Rajonal (3) Ngritja e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit brenda Autoritetit Menaxhues (FSHZH)	Zv. Kryeministri/Fondi Shqipëri i Zhvillimit	n/a Kostot (nga buxheti i shtetit) janë të planifikuara në mënyrë indikative në draftin e PKZHRK - kostot do të konsultohen me tej and të miratohen si alokime të buxhetit të shtetit në tremujorin e II të 2021	0	260,744,000	324,887,000	585,631,000	Te gjitha masat zbatuese (1, 2 dhe 3) janë të mbështetura nëpërmjet "Programit për Zhvillimin Rajonal në Shqipëri" me asistencë teknike të financuar nga SDC dhe ADA. Alokimet vjetore të kostove janë në mënyrë indikative, duke qenë se jo të gjitha kostot TA adresojnë direkt procesin e përfundimit dhe varen nga progresi i zbatimit të këtyre masave	993,000	726,000	632,000	2,351,000	587,982,000
22	Titulli i aktit/ dokumentit strategjik/ masës zbatuese						0					0	0
22			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve*	0	260,744,000	324,887,000		Kosto total donatorët sipas viteve	993,000	726,000	632,000		
22			Kosto total buxheti 2020 - 2022				585,631,000	Kosto total donatorët 2020 - 2022				2,351,000	
23	GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE												
23	Miratimi i Projektligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (masë ligjore)	MD	Buxheti i shtetit	1,900,000 lekë			1,900,000 lekë						1,900,000 lekë
23	Miratimi i projektligjit "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" (masë ligjore)	MD	Buxheti i shtetit	3,700,000 lekë	3,700,000 lekë		7,400,000 lekë						7,400,000 lekë



23	Miratimi i Projektvendimit "Për ngritjen dhe funksionimin e Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Denoncimeve mbi Rekordet Korruptive (SEMDRK) " (masë ligjore)	MD	Buxheti i shtetit	46,900,000 lekë			46,900,000 lekë						46,900,000 lekë
23	Trajnime dhe ndërgjegjësimi i grupeve të veçanta në fokus nga sektori publik, privat dhe shoqëria civile.	KDIMDP	Buxheti i shtetit	2,000,000 lekë	500,000 lekë	500,000 lekë	3,000,000 lekë		n/a	n/a	n/a	n/a	3 000 000 lekë
23	Shtim kapaciteteve për Zyrën e Komisionerit. Punonjësit (16) Paga	KDIMDP	Buxheti i shtetit	32,460,000 lekë	32,860,000 lekë	30,975,000 lekë	96,295,000 lekë		n/a	n/a	n/a	n/a	96,295 000 lekë
23	Shpenzime kapitale	KDIMDP	Buxheti i shtetit	6,000,000 lekë	4,000,000 lekë	3,000,000 lekë	13,000,000 lekë						13,000,000 lekë
23	Shpenzime operative	KDIMDP	Buxheti i shtetit	10,000,000 lekë	11,500,000 lekë	11,500,000 lekë	33,000,000 lekë		n/a	n/a	n/a	n/a	33,000,000 lekë
23	Regjistri për Komunikimet Tregtare të Pakërkua	KDIMDP	Buxheti i shtetit	11,000,000 lekë	n/a	n/a	11,000,000 lekë		n/a	n/a	n/a	n/a	11,000,000 lekë
23	Trajnime në funksion të forcimit të kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit	MD	Buxheti i shtetit		700,000 lekë	800,000 lekë	1,500,000 lekë						1,500,000 lekë
23	Plotesimi i strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit	MD	Buxheti i shtetit	54,882,000 lekë	58,175,000 lekë	61,665,000 lekë	174,722,000 lekë						174,722,000 lekë
23	Organizimi i aktiviteve të ndërgjegjësuara mbi fuqizimin e grave, avancimin drejt barazisë gjinore, si dhe kundër praktikave të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje	MSHMS	Buxheti i shtetit	271,320 lekë	271,320 lekë	271,320 lekë	813,960 lekë		756,250 lekë	756,250 lekë	756,250 lekë	2,268,750 lekë	3,082,710 lekë
23	Trajnime i anëtarëve të MKR-ve për të trajtuar me efektivitet rastet bazuar në legjislacionin e përmirësuar, VKM për funksionimin e MKR të ndryshuar, si dhe në protokollet e procedurave standarde të veprimit të miratuara	MSHMS	Buxheti i shtetit	0	0	0	0		136,800 lekë	136,800 lekë	136,800 lekë	410, 400 lekë	410,400 lekë
23	Rekrutimet e inspektorëve jo magistratë	ILD	Buxheti i shtetit	1,750 lekë	0	0	1,750 lekë		0	0	0	0	1,750 lekë
23	Krijimi i kushteve të infrastrukturës për kryerjen e detyrës së stafit të ILD-së	ILD	Buxheti i shtetit	64,000 lekë	52,000 lekë	2,000 lekë	118,000 lekë		0	0	0	0	118,000 lekë
23			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	169,179,070 lekë	111,758,320 lekë	108,713,320 lekë	389,650,710 lekë	Kosto total donatorët sipas viteve	893,050 lekë	893,050 lekë	893,050 lekë	2,679,150 lekë	
23			Kosto total buxheti 2022 - 2024				389,650,710 lekë	Kosto total donatorët 2022 - 2024				2,679,150 lekë	
24	DREJTËSI, LIRI DHE SIGURI												
24	Rregullore "Për rregullat e mbikqyrjes së kufijve detare në kuadër të bashkëpunimit operacional të koordinuar midis institucioneve kombëtare dhe Agjensisë Evropiane për Kufirin dhe Rojen Bregdetare (FRONTEx)"	MB, MM, MEPJ, MEF	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative	Jo					Kosto administrative
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Gjeorgjia	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Disa shtesa dhe Ndryshime në Kodin Penal, shtimin dhe rregullimin e disa veprave penale ekzistuese, në fushën e krimeve kibernetike.	MB/DPSH/AKSHI/PP/M D/MSHMS/Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve/AKEP/AKCESK	Kosto administrative										
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Federata Ruse	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Armenia	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Makao	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Ukraina	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Hong Kong	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					



24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Srilanka	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Kepi i Gjelbërt	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Turqi	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Marrëveshje Ripranimi Shqipëri - Azerbajxhan	MB/DPPSH	5,000,000					Jo					
24	Amendimi I ligjit nr. 22/2020 "Për disa shtesa në ligjin nr71/2016 "Për Kontrollin Kufitar"	MB/PSH	5,000,000	0	0	5,000,000	0	Jo	0	0	0	0	5,000,000
24	Miratimi i ligjit për API / PNR	MB/PSH	5,000,000	0	0	5,000,000	0	Jo	0	0	0	0	5,000,000
24	Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit 2022-2026 dhe Plani i Veprimit 2022-2024	Qendra Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative	Kosto administrative	Po	do të buxhetohet nga donatorë të jashtëm	do të buxhetohet nga donatorë të jashtëm	do të buxhetohet nga donatorë të jashtëm	do të buxhetohet nga donatorë të jashtëm	Kosto administrative
25	SHKENCA DHE KERKIMI SHKENCOR												
25	Projekt-Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër Horizon Europe	MAS/AKKSHI	Kosto total Buxheti (2022-2024), në 000 leke	50,000	50,000	50,000	150,000	NA	118,375	121,946	105,019	345,339	495,339
25	Udhëzimet për firmosjen Charter&Code nga IAL Publike/Private	MAS/AKKSHI		150	-		150	NA	-	-		-	150
25	Zhvillimi I Strategjise se Specializimit Inteligjent	MAS/AKKSHI					0					-	-
25	Ligji për Shkencën	MAS/AKKSHI			0		0	Kosto total donatorët sipas viteve	-	500		500	500
25	Zhvillimi I Strategjisë për Kërkimin Shkencor	MAS/AKKSHI		600			600		600			600	1200
25			Kosto total buxheti 2022 - 2024, e 000 leke	50750	50000	50000	150,750	Kosto total donatorët 2022 - 2024	118974.548	122446.128	105018.793	346439.469	497189.469
26	ARSIMI DHE KUTURA												
26	Urdhër i përbashkët i ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional për ngritjen e komitetit të parë sektorial në zbatim të ligjit për Komizën Kombëtare të Kualifikimeve	MFE		480000	1310000	1310000			0	2620000			
26	VKM "Për sistemin e njohjes së mësimi paraprak informal dhe joformal" - në sistemin e Këshillit të Ministrave në pritje të aprovimit.	MFE			40090	40090			0	80180			
26	VKM Për dokumentacionin, procedurat dhe kriteret për kryerjen e inspektimeve shtetërore të sistemit të arsimit dhe formimit profesional	MFE		6280000	12660000	12660000				12660000			
26	Hartimi i VKM për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" për zbatimin e plotë të ESG në përputhje me standardet evropiane.	MAS/ASCAL		801800			801800		0				801800
26	Hartimi i VKM për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" në mënyrë që të pasqyrojë standardet ESG dhe të lejojë zbatimin e plotë të ESG	MAS/ASCAL		6609500			6609500		0				6609500
26	Hartimi i Urdhrit për miratimin Standardeve kritereve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të AFP-së	MFE		4250000	7565090	7565090			600000	8165090			
26	Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 - 2029	MSHRF		3837500	3321875	1910937.5	9070312.5		0	0			



26	Ngritja e Grupit te Punes ne MAS per Udhëzim nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar; per lehtesimin e procedurave dhe afateve per hapjen e programeve te perbashketa dhe te dyfishta;	MAS	298182.27 lekë	298182.27 lekë									
26	Regjistrimi i ASCAL ne EQAR	ASCAL		1268500			1268500					1268500	
26	Rishikimi i VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar	MAS	834318.18						834318.18				
26	Anëtarësimi i plotë i ASCAL (QAAHE) në ENQA (Q4 /2023).	ASCAL			5018500		5018500					5018500	
26	Pagesa për pjesëmarrje në programin ERASMUS+	MAS	270000 euro/ 33.210.000 lekë	90000 euro/ 11.070.000 lekë	90000 euro/ 11.070.000 lekë	90000 euro/ 11.070.000 lekë	270000 euro/ 33.210.000 lekë						
26	Rishikimi i VKM Nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para-universitar në institucionet arsimore publike” ; Parashikohet ndryshimi i VKM, synon per perfshirjen e 11,420 femijeve/nxenesve Rome dhe Egjiptiane qe ndikin arsimin baze klase e pare deri ne klase n e 9-te, te perfitojne burse financiare/ushqimore, jashte vleresimit te kriterëve ekonomike; parshikohen nga ky ndryshim te perfitojne burse financiare ushqimore 3763 nxënës romë +7656 nxënës egjiptianë.(te dhenat per numrin e femijeve rome dhe egjiptiane jane te vitit 2021).	MAS	1500456600			750228300	750228300	1500456600					
26			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve				Kosto total donatorët sipas viteve	0	0				
26			Kosto total buxheti 2022 - 2024						0				
27	MJEDISI												
27	Ngritja dhe funksionimi I sistemit të numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112"	AKMC	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve/euro	1200000	1200000	1200000	3600000	Kosto total donatorët sipas viteve /euro	6,000,000.00 €	6000000	6000000	18000000	21600000
27	Implementimi i Strategjisë Kombëtare të DRR, i vleresimit te riskut dhe i planit kombetar te EC	AKMC	Kosto total buxheti 2022 - 2024/euro	8008000	8008000	8008000	24024000	Kosto total donatorët 2022 - 2024 /euro	20,700,000.00 €	23,000,000.00 €	57020000	120120000	144144000
27	Menaxhimi I Mbetjeve												
27	Projektvendimi "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu"	MTM & MBZHR		672857			672857					0	672857
27	Projekt vendimi 'Per miratimin e masave te nevojshme që çdo person juridik a fizik, i cili zhvillon, prodhon, përpunon, trajton, shet ose importon produkte (prodhuesi i produktit) mbi baza profesionale, të mbajë përgjegjësitë e zgjeruara të prodhuesit".	MTM			336428.5		336428.5	50% kosto-SANIE 27					
27	Projektligji "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"	MTM				356108	356108	50% kosto-IPA III-Circular Economy				0	356108
27			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve					Kosto total donatorët sipas viteve					
27			Kosto total buxheti 2022 - 2024				1365393.5	Kosto total donatorët 2022 - 2024					
27	Drejtoria e lejeve												
27	ProjektLigji “Per lejet e mjedisit”	MTM			600000		600000						



27			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve					Kosto total donatorët sipas viteve			0		
27			Kosto total buxheti 2022 - 2024				600000	Kosto total donatorët 2022 - 2024				0	
27	Ndryshimet Klimatike												
27	PVKM "Për miratimin e rregullores për monitorimin, raportimin, verifikimin e shkarkimeve të gazeve me efekte sërë si dhe për përcaktimin e rregullave të përlogaritjes së shkarkimeve dhe përthithjes së tyre"	MTM	Po	60000			60000	Kosto total donatorët sipas viteve		0 €	0	0	
27	Kimikatat												
27	VKM "Për disa ndryshime në VKM Nr. 360, datë 29.4.2015 PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E TYRE:"	MTM	Po	60000			60000	Kosto total donatorët sipas viteve		0	0	0	
27							120000	Kosto total donatorët 2022 - 2024					
27	Menaxhimi i Ujit												
27	Ligji "Për ujin"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	4305000	4305000	0	0	4305000	6197012.913
27	VKM "Për përcaktimin e kufijve midis rajoneve të baseneve ujore dhe caktimin e ujërave të brendshme dhe bregdetare në Rajonet e Baseneve Lumore"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për përcaktimin e autoriteteve kompetente në Rajonet e Baseneve Lumore"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për elementet cilësore të klasifikimit të statusit ekologjik dhe përkufizimet normative të klasifikimit të statusit ekologjik për ujërat sipërfaqësore"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për karakterizimin e Rajoneve të Baseneve Lumore, rishikimin e ndikimit mjedisor të veprimtarisë njerëzore dhe analizën ekonomike të përdorimit të ujit"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për elementet e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625,043	641927.1958	1,892,013	0	0	0	0	0	1,892,013
27	VKM "Për monitorimin e statusit ekologjik dhe kimik të ujërave sipërfaqësore, kërkesat shtesë të monitorimit për zonat e mbrojtura dhe klasifikimin e paraqitjen e statusit ekologjik"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për standardet e cilësisë mjedisore në fushën e politikave për burimet ujore"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe përkëqësimi"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për vlerat kufi të emetimeve për ujërat e ndotura nga burimet industriale"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane".	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për mbrojtjen e ujërave ndaj ndotjes së shkaktuar nga nitratet e burimeve bujqësore"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	VKM "Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga përmblytjet"	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913
27	Ligji "Për strategjinë detare në Republikën e Shqipërisë".	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	1845000	1845000	0	0	1845000	3737012.913
27	VKM "Për paraqitjen dhe zbatimin e strategjisë detare në Republikën e Shqipërisë".	AMBU	1892012.913	625042.8584	625042.8584	641927.1958	1892012.913	0	0	0	0	0	1892012.913



27			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	9375642.876	9375642.876	9628907.936		Kosto total donatorët sipas viteve	6150000	0	0		
27			Kosto total buxheti 2022 - 2024				28380193.69	Kosto total donatorët 2022- 2024				6150000	
28	MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT												
28	Projekt-Ligj "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 "Per mbrojtjen e konsumatoreve", i ndryshuar.	MFE	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	1,800,000	1,800,000	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	1,800,000
28	Trajnime/workshope për GNPIE në lidhje me: i) takimin bilateral të screening; ii) hartimin e dokumenteve gjatë fazës së negociatave; iii) kërkesat e acquis dhe afësitë negociuese;	MFE	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	German Government/GI Z. "Support for Albania accession negotiation in economy sector " (SANECA)	5000000	0	0	5,000,000	5,000,000
	Organizimi dhe funksionimi i Tavalinave të rrumbullakëta për kapitullin 28, në kuader të PPHE	MFE	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	German Government/GI Z. "Support for Albania accession negotiation in economy sector " (SANECA)	800000	0		800,000	800,000
28	Projekt-Rregullore "Mbi përcaktimin e parimeve dhe udhëzimeve për praktikën e miratimit të prodhimit të produkteve mjekësore veterinarë"	MBZHHR	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	Kosto (donatorët)	0	0		0	0
28	Projekt-Rregullore "Mbi prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit të medikuar"	MBZHHR	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	Kosto (donatorët)	0	0		0	0
28	Draft Urdhër Ministri "Mbi përcaktimin e parimeve dhe udhëzimeve për praktikën e miratimit të prodhimit të produkteve mjekësore veterinarë"	MBZHHR	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	Kosto (donatorët)	0		0	0	0
28	Projekt-Rregullore "Mbi prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit të medikuar"	MBZHHR	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	Kosto (donatorët)	0	0		0	0
28	Draft Urdhër Ministri "Për një ndryshim në Urdhërin Nr.370, datë 29.7.2014 " Për produktet mjekësore veterinarë"	MBZHHR	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	0
28	Projekligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.105/2014 "Për Barnat në Shërbimin Farmaceutik", të ndryshuar"	MSHMS	Kosto total buxheti 2022-24	0	0	0	0	Kosto (donatorët)	0	0	0	0	0
28			Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	0	0	0		Kosto total donatorët sipas viteve	5,800,000	0	0		
28			Kosto total buxheti 2022- 2024				1,800,000	Kosto total donatorët 2022 - 2024				5,800,000	7,600,000
29	SISTEMI DOGANOR												
29	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave 2023"	D.P.DOGANAVE	Kosto (buxheti i shtetit)	2,201,200			2,201,200	Kosto (donatorët)	0	0		0	2,201,200
29	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave 2024"	D.P.DOGANAVE	Kosto (buxheti i shtetit)	2,201,200			2,201,200	Kosto (donatorët)	0	0		0	2,201,200
29	Vendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuara të Mallrave 2025"	D.P.DOGANAVE	Kosto (buxheti i shtetit)	2,201,200			2,201,200	Kosto (donatorët)				0	2,201,200



29	Udhëzimi për procedurat dhe mënyrat e daljes së pasurive jashtë vendit, në zbatim të pikës 4, të nenit 123 të ligjit 27/2018	MK / IKRTK	Kosto (buxheti i shtetit)	0	0	0	-	Kosto total 249 000 euro, nga projekti I financiar nga BE, IPA Kombëtare me titull "Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore"			249000	249000	249,000
29	Udhëzim për Miratimin e përcaktimeve të përgjithshme, në zbatim të neneve 124, pika 3, dhe 128 pika 3 lidhur me Nenit 123, 124 dhe 128 të ligjit 27/2018	MK / IKRTK	Kosto (buxheti i shtetit)	0	0	0	-	Kosto total 249 000 euro, nga projekti I financiar nga BE, IPA Kombëtare me titull "Ngritja e kapaciteteve të Administratës Publike Shqiptare në lëvizjen e lirë të mallrave dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore"			249000	249000	249,000
29			Kosto total buxheti 2022 - 2024	6,603,600	-	-	6,603,600	Kosto total donatorët 2022 - 2024	-	-	498,000	498,000	7,101,600
30	MARRËDHËNIET ME JASHTË												
30	Projektvendim për miratimin e listës së mallrave të cilat mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose trajtim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjërzor ose degradues	MM/(AKSHE)		30,000	0	0	30,000		0	0	0	0	30,000
30	Projektligji për "Për tregtinë e produkteve që mund të përdoren për dënim kapital, torturë ose dënim apo trajtime çnjërzore, ose degraduese",	MM/(AKSHE)		50,000	0	0	50,000		0	0	0	0	50,000
30	Totali		Kosto total buxheti 2022 - 2024	80,000	0	0	80,000	Kosto total donatorët 2022 - 2024	0	0	0	0	80,000
31	POLITIKAT E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES												
31	Titulli i aktit/ dokumentit strategjik/ masës zbatuese						0					0	0
31	Titulli i aktit/ dokumentit strategjik/ masës zbatuese						0					0	0
31	Projektvendim i Keshillit të Ministrave "Për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Ngritjen e Përkohshme të Fondeve apo Aseteve të Tjerë Personale ose Entive Te Shpallura"- në mbështetje të nenit 10/1 të ligjit Nr.157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"	MFE/DPPPP	Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	1,500.00	0	0		Kosto total donatorët sipas viteve	0	0	0		1,500.00
31			Kosto total buxheti 2022 - 2024				0	Kosto total donatorët 2022 - 2024				0	
32	KONTROLLI FINANCIAR												
32	Hartimi i Ligjit "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 110/2015 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"	MFE/DH/MFKK	Buxheti i Shtetit	8,308,800.00	0.00		8,308,800.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	8,308,800.00



32	Rishikimi i Urdhrit Nr. 108, datë 17.11.2021 "Për manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit"	DH/MFKK	Buxheti i Shtetit	3,974,400.00	0.00	0.00	3,974,400.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	3,974,400.00
32	Rishikimi i Udhëzimit Nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike"	MFE	Buxheti i Shtetit	0	3,974,400.00	0.00	3,974,400.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	3,974,400.00
32	Hartimi i projekt-ligjit "Për disa ndryshime në Ligjin 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik"	MFE/DH/AB	Buxheti i Shtetit	2,880,000.00	0.00	0.00	2,880,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4,320,000.00
32	Hartimi i VKM-së "Për disa ndryshime në VKM-në Nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësite të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar me VKM-në Nr.353, datë 11.05.2015"	MFE	Buxheti i Shtetit	1,440,000.00	1,440,000.00	0.00	2,880,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,880,000.00
32	Hartimi i VKM-së "Për disa ndryshime në VKM-në Nr.116, datë 17.02.2016 "Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimi i tarifave të trajnimit"	MFE	Buxheti i Shtetit	1,440,000.00	1,440,000.00	0.00	2,880,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,880,000.00
32	VKM "Për disa ndryshime në VKM-në Nr.160, datë 02.03.2016 "Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit të Brendshëm në njësitë publike"	MFE	Buxheti i Shtetit	1,440,000.00	1,440,000.00	0.00	2,880,000.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	2,880,000.00
32	Ligji " Për disa ndryshime në Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"	KLSH	Buxheti i Shtetit	0.00	0.00		0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
32	Hartimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit Për Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së	MFE/DIFP		0.00	0.00		0.00		3,390,000.00	0.00	0.00	3,390,000.00	3,390,000.00
32	Totali		Kosto total buxheti i shtetit sipas viteve	19,483,200.00	8,294,400.00	0.00	27,777,600.00	Kosto total donatorët 2021 - 2023	3,390,000.00	0.00	0.00	3,390,000.00	31,167,600.00
33	FINANCAT DHE BUXHETI												
33	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1488 lekë